

30 (82-92) (001.32-05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

9

30 (82-92) (001.32-05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

9

30 (82-92) (001.32-05)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

SOCIAL STUDIES

9

Editorial board

Muhamedin Kullashi, editor-in-chief

Frashër Demaj, secretary

Oliver Schmitt, member

Justina Shiroka-Pula, member

Gjyljeta Mushkolaj, member



PRISHTINA
2023

30 (82-92) (001.32-05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

STUDIME SHOQËRORE

9

Këshilli redaktues

Muhamedin Kullashi, kryeredaktor

Frashër Demaj, sekretar

Oliver Schmitt, anëtar

Justina Shiroka-Pula, anëtare

Gjyljeta Mushkolaj, anëtare



PRISHTINË
2023

Copyright © ASHAK

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës “*Studime shoqërore*”
Rr. Agim Ramadani, nr. 305
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. + 383 38 249 303
E-mail: ashak@ashak.org

PËRMBAJTJA

MUHAMEDIN KULLASHI: AGRESIONI I RUSISË MBI UKRAINËN
DHE TRONDITJET GJEOPOLITIKE7

JEAN-YVES TILLIETTE: FACE AU MATIN DU MONDE: LES
HOMMES DU MOYEN ÂGE DEVANT LA CRÉATION..... 37

JENS OLIVER SCHMITT: HYRJE NË DOKUMENTET ARKIVORE
AUSTRO-HUNGAREZE PËR VILAJETIN E KOSOVËS 1870-1914 45

ARSIM EJUPI, HIVZI ISLAMI: GJEOPOLITIKA SI FUSHË
SHKENCORE DHE INTERES TERRITORIAL DJE DHE SOT 75

FRASHËR DEMAJ: QËNDRIMI I RUSISË NDAJ ÇËSHTJES
SHQIPTARE NË KONFERENCËN E AMBASADORËVE NË LONDËR
(1912-1913) 99

GJYLJETA MUSHKOLAJ: KATËRMBËDHJETË VJET ME
KËSHILLIN E EVROPËS DHE JASHTË TIJ 123

SHEMSI KRASNIQI: SHOQËRIA CIVILE DHE AKTIVIZMI
MJEDISOR NË KOSOVË..... 145

LIBURN JUPOLLI: KRONOLOGJI GJITHËPËRFSHIRËSE E
KONTRIBUESVE KOMPOZICIONALË NË SFERËN E MUZIKËS
KLASIKE NË KOSOVË - PËRMBLEDHJE LEKSIKOGRAFIKE DHE
ANALIZË E ELEMENTEVE STILISTIKE 165

MUHAMET MALA: KONVERTIMI DHE TOLERANCA FETARE TE
SHQIPTARËT GJATË SUNDIMIT TË PERANDORISË OSMANE 183

HASAN KALESHI: NDIKIMET TURKE NË LETËRSINË SHQIPE* 195

REXHEP GASHI: TRAFIKIMI I FËMIJËVE: ASPEKTE JURIDIKO-
PENALE, KRIMINOLOGJIKE DHE VIKTIMOLOGJIKE..... 209

KRENARE SHAHINI GOLLOPENI, ABDYLMENAF BEXHETI, DONAT REXHA: THE EFFECTS OF THE FISCAL STIMULUS ON THE INCREASE OF EMPLOYMENT IN KOSOVO AFTER THE PANDEMIC (COVID 19)..... 231

GJERGJI SHUKA: NËNSHTRESA NË TRI KËNGË TË CIKLIT TË KOSOVËS..... 245

MUHAMEDIN KULLASHI: KULTI I MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE ZHBËRJA E FILOZOFISË 287

PROMOVIME

MUHAMEDIN KULLASHI: ANTON BERISHAJ, *NË BOTËN E PËRBASHKËT*, ASHAK, PRISHTINË, 2022..... 311

HIVZI ISLAMI: ANTON VUKPALAJ, *FSHEHJA E KRIMIT*, ASHAK, PRISHTINË, 2021F.251..... 315

HIVZI ISLAMI: MUHAMEDIN KULLASHI, “*ÇËSHTJA E KOSOVËS NË HAPËSIRËN PUBLIKE TË FRANCËS*”, ASHAK, 2021..... 323

JUSUF BAJRAKTARI: FRASHËR DEMAJ, *POZITA GJEOGRAFIKE, POLITIKE DHE POPULLSIA SHQIPTARE NË DOKUMENTET DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË JASHTME TË BRITANISË SË MADHE 1912-1918*..... 329

KRONIKA

HIVZI ISLAMI: DEMARKACIONI DHE IZOLIMI I KOSOVËS 335

SHEMSI KRASNIQI: VËSHTRIM MBI LIBRIN E MUHAMEDIN KULLASHIT: *ÇËSHTJA E KOSOVËS NË HAPËSIRËN PUBLIKE TË FRANCËS. ANALIZA DHE REFLEKSIONE*, ASHAK, 2021, PRISHTINË... 345

GËZIM SELACI: ATDHE HETEMI: LËVIZJET STUDENTORE PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS, 1968, 1981 DHE 1997 NGA (LONDON: PALGRAVE, 2019 DHE PRISHTINË: ARTINI, 2020). 355

Muhamedin Kullashi, Prishtinë

AGRESIONI I RUSISË MBI UKRAINËN DHE TRONDITJET GJEOPOLITIKE

Abstrakt

Agresioni i Rusisë mbi Ukrainën ka nxitur një tronditje të thellë gjeopolitike në Evropë dhe në Perëndim në përgjithësi. Liderët evropianë u mbledhën me urgjencë për t'i ridefinuar parimet e sovranitetit evropian sikurse edhe « autonominë e tyre strategjike ». Ata u dakorduan për dërgimin urgjent të një ndihme të rëndësishme të armatimit Ukrainës. Ata shqyrtuan njëherazi masat që duhen marrë për t'u përballur me rrjedhojat e agresionit rus për paqen dhe stabilitetin e kontinentit evropian; sikurse edhe ato që i takojnë elaborimit të një strategjie të re energjetike, gjë që ka nxitur një zgjim brutal të Evropës dhe Perëndimit në përgjithësi karshi kërcënimeve nga një regjim autokratik e agresiv. Presidenti Makron dhe Kancelari Scholz kanë deklaruar se me këtë agresion hapet një epokë e re në raportet midis Perëndimit dhe Rusisë. Vendet perëndimore i imponuan sanksione të ashpra financiare, komerciale, ekonomike dhe teknologjike të Oksidentit ndaj Rusisë.

Në analizën e mekanizmave ideologjikë të pushtetit autokratik të Putinit janë marrë në shqyrtim shtyllat e neosovjetizmit, i cili do të duhej të sillte një përgjigje ndaj shembjes së pushtetit sovjetik: sllavofilinë, euroazitizmin, konservativizmin e sidomos orientimin antiperëndimor. Ky agresion masiv mbi një shtet sovran evropian i bëri të paqëndrueshme supozimet e disa autorëve mbi projektet politike të Kremlinit ndaj Evropës Perëndimore në përgjithësi.

Këtu kemi shtjelluar po kështu shqyrtimet e disa autorëve evropianë dhe amerikanë (Appelbaum, Eltchaninof etj.) lidhur me ndryshimet politike në Ukrainë të cilësuar, në radhë të parë, me demokratizimin viteve të fundit: pushteti rus i pa këto ndryshime si kontestim i hapur i natyrës dhe logjikës së sistemit të tij.

Ne kemi ekzaminuar këtu edhe pasojat të cilat i prodhoi agresioni i Rusisë kundër Ukrainës dhe në mënyrë më të përgjithshme ndryshimet gjeopolitike që dolën për marrëdhëniet midis vendeve ballkanike e në veçanti ato të Kosovës me Serbinë.

Në anën tjetër, këto ndryshime kanë lëkundur Bashkimin Evropian dhe kanë nxitur disa iniciativa, midis tyre riafirmimin e idesë së zgjerimit të BE-së kah Ballkani Perëndimor. Mirëpo kjo kërkonte një qasje më aktive mbi marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës: Serbia që e konsideron Rusinë si aleate tradicionale, pranoi ta dënonte agresionin rus, por megjithatë nuk vuri sanksione ndaj saj. Ndërkaq, Kosova u solidarizua me masat që i vendosën vendet perëndimore.

Fjalët çelës: Agresioni i Rusisë, Ukraina, sovraniteti evropian, orientimi antiperëndimor, marrëveshja gjithëpërfshirëse Kosovë-Serbi

Pas fillimit të agresionit ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, më 24 fror të këtij viti, studiues të shquar të relacioneve midis vendeve perëndimore dhe Rusisë vunë në pah se brenda dy javësh invazioni rus arriti t'i vërë në lëvizje linjat gjeopolitike në rrafshin botëror e madje edhe rendin botëror.

Kësisoj Sylvie Kauffmann, studiuese e shquar franceze e marrëdhënieve ndërkombëtare, në një artikull zë në gojë një ngjarje episodike larg Evropës në nënkontinentin amerikan, në Venezuelë. Në Karakas të Venezuelës u liruan nga burgu dy ekspertë për çështje të petrolit. Në të njëjtën kohë kryetari Maduro priti në pallatin e vet një delegacion të zyrtarëve të lartë amerikanë. Kjo ngjarje u interpretua si një shenjë e shtendosjes së marrëdhënieve midis SHBA-së dhe Venezuelës, e cila ishte aleati kryesor i Moskës në Amerikën Latine. Maduro e kishte kuptuar shpejt se do të ketë lëvizje gjeopolitike të rëndësishme në nivelin botëror.¹

Historiana amerikane Mary Elise Sarotte në një artikull të botuar në *New York Times*² thekson se këto ngjarje hapin një periudhë të armiqësive të mëdha midis Moskës dhe vendeve perëndimore. Ndërkaq, kancelari gjerman Olaf Scholz dhe presidenti francez Makron theksuan se me këtë agresion hapet *një epokë e re në raportet midis Perëndimit dhe Rusisë*. Kjo ngjarje, në fakt, e mbyll tani një periudhë prej tri decenive pas luftës së ftohtë, e hapur me shpërbërjen e ish-Bashkimit Sovjetik.

Vëzhguesit e tjerë vunë në pah njëherësh se sanksionet e ashpra të vendeve perëndimore ndaj Rusisë paralajmërojnë pasoja të rënda për ekonominë e saj. Ata theksojnë se Putini ka ndërmarrë një varg të masave represive për të penguar çfarëdo kritike e mospajtimi në Rusi me intervenimin ushtarak në Ukrainë. Në anën tjetër, gjerësia e sanksioneve financiare, komerciale, ekonomike e teknologjike e Perëndimit ndaj Rusisë do ta godasë thellësisht ekonominë ruse, e kjo do t'i bëjë, më të theksuara pakënaqësitë sa tek oligarkët e mëdhenj, aq edhe te shtresat e gjera të popullsisë.

Temë tjetër në analizat e situatës së krijuar është zgjimi i BE-së karshi këtij agresioni në truallin e Evropës; agresion që kishte për qëllim të pengojë integrimin e Ukrainës brenda BE-së, pas ndryshimeve të rëndësishme politike që u realizuan.

Agresioni i Rusisë kundër Ukrainës ka nxitur një tronditje të thellë gjeopolitike në Evropë dhe në Perëndim në përgjithësi. Liderët evropianë u mbledhën me urgjencë për t'i ridefinuar parimet e sovranitetit evropian

¹ Le Monde, 26 fror, 2022.

² New York Times, 27 fror.

sikurse edhe « autonominë e tyre strategjike ». Ata u dakorduan për dërgimin urgjent të një ndihme të rëndësishme të armatimit Ukrainës. Ata shqyrtuan njëherazi masat që duhen marrë për t'u përballur me rrjedhojat e agresionit rus për paqen dhe stabilitetin e kontinentit evropian; sikurse edhe ato që i takojnë elaborimit të një strategjie të re energjetike, gjë që ka nxitur një zgjim brutal të Evropës dhe Perëndimit në përgjithësi karshi kërcënimeve nga një regjim autokratik e agresiv. Presidenti Makron dhe Kancelari Scholz kanë deklaruar se me këtë agresion hapet një epokë e re në raportet midis Perëndimit dhe Rusisë. Vendet perëndimore i imponuan sanksione të ashpra financiare, komerciale, ekonomike dhe teknologjike të Oksidentit ndaj Rusisë.

Në analizën e mekanizmave ideologjikë të pushtetit autokratik të Putinit janë marrë në shqyrtim shtyllat e neosovjetizmit, të cilat do të duhej të sillnin një përgjigje ndaj shembjes së pushtetit sovjetik: sllavofilinë, euroazitizmin, konservativizmin e sidomos orientimin antiperëndimor. Ky agresion masiv mbi një shtet sovran evropian i bëri të paqëndrueshme supozimet e disa autorëve mbi projektet politike të Kremlinit ndaj Evropës Perëndimore në përgjithësi.

Këtu kemi shtjelluar po kështu shqyrtimet e disa autorëve evropianë dhe amerikanë (Appelbaum, Eltchaninof etj.) mbi ndryshimet politike në Ukrainë të cilësuar në radhë të parë me demokratizimin viteve të fundit: pushteti rus i pa këto ndryshime si kontestim i hapur i natyrës dhe logjikës së sistemit të tij.

ZGJIMI I EVROPËS

Që nga nëntori i vitit 2021 SHBA-ja i kishin njoftuar vendet evropiane se Rusia po përgatit një invadim kundër Ukrainës. Mirëpo as vendet e BE-së e madje as Ukraina nuk i morën seriozisht këto paralajmërime. Në Konferencën për siguri të Munihut më 18 shkurt një zyrtar i Ukrainës kishte shfaqur bindjen se edhe nëse Rusia sulmon, ky sulm do ishte i kufizuar. Sy supozim doli i gabuar, ngase agresioni brutal i Rusisë bëri që evropianët të tranden, të kërkojnë të ndërtojnë një unitet më të theksuar mes veti, me SHBA-në dhe NATO-n.

Së pari u zhvillua një unitet politik rreth qëndrimeve që duhej ridefinuar karshi Rusisë. Më 2 mars 2022 ky unitet u manifestua në OKB me adoptimin e një rezolute në të cilën u dënua invazioni ndaj Ukrainës nga Rusia, e njëherësh u ndërmorën sanksione të shumta dhe të ashpra ndaj Rusisë. Evropianët dhe amerikanët zhvilluan po kështu një mobilizim të

shpejtë për të siguruar dhe transportuar me vija ajrore ndihma ushtarake masive për Ukrainën. Ishte fjala për armatime të rënda, të cilat duhej t'i ndihmonin ushtrisë ukrainase që t'i rezistojë agresionit rus. Vendet evropiane u ballafaquan tani edhe me domosdoshmërinë për një *strategji të re energjetike*, e cila duhej ta bëjë të mundur pavarësimin nga resurset ruse me gaz dhe petrol. Kësodore, Gjermania nga mbarimi i shkurtit merr vendimin që të heqë dorë nga linja gjermano-ruse Nord Stream 2 e furnizimit me gaz.

Shfat e shteteve dhe qeverive të BE-së zotohen në mbledhjet urgjente në gjysmën e parë të muajit mars t'i japin trajta konkrete afirmimit të parimeve të sovranitetit evropian dhe të « autonomisë strategjike » të vendeve të tyre. Njëra nga çështjet madhore që u shtrua për këto vende, siç vë në pah Kauffman, ishte domosdoja e pavarësimin nga gazi dhe nafta e Rusisë. Njëri nga paradokset që doli qysh në muajin shkurt kishte të bëjë me sanksionet të cilat synonin ta rrënojnë ekonominë e Rusisë, shkonin bashkë me faktin se vendet evropiane ishin të detyruara që çdo ditë t'i paguajnë Rusisë nga 700 milionë dollarë për karburante. Në anën tjetër, situata e krijuar nga agresioni rus bëri që vlerësimi i presidentit Macron, i bërë dy vjet më parë se NATO-ja është në gjendje të « vdekjes cerebrale » të dalë, i tejkaluar me rolin shumë të rëndësishëm që kjo organizatë mori në situatën e re gjeopolitike.

Për shkak të rrezikut nga një luftë bërthamore dhe nga fakti që Ukraina nuk ishte anëtare e NATO-s vendet perëndimore u detyruan të ndërhyjnë me dërgimet e armatimeve të rënda armatës ukrainase, si dhe me ndihma logjistike nga distanca. Kësodore, NATO-ja tani e mori një rol më të theksuar të mbrojtjes kolektive në Evropë. Brenda situatës së re gjeopolitike, e cilësuar me konfrontime në disa nivele midis vendeve perëndimore dhe Rusisë, u shfaqën disa ndryshime edhe në Ballkan. Derisa më parë, ndikimi i Rusisë në Ballkan ishte shumë i favorshëm për Serbinë, në kontekstin e ri, do të ngushtohet gradualisht ky ndikim. Serbia u detyrua, nën presionin e vendeve perëndimore ta dënojë agresionin e Rusisë kundër Ukrainës. Mirëpo ajo megjithatë nuk ndërmori sanksione ndaj Rusisë, duke dashur ta mbajë një lidhje solidariteti me aleaten e moçme. U krijua një situatë ambivalente në raportin midis vendeve perëndimore dhe Serbisë: ato i kërkonin Serbisë t'i vendosë sanksione Rusisë, por në anën tjetër e konsideronin të rëndësishme që ajo të mbetet në sferën e ndikimit perëndimor; kjo ambivalencë bëri që këto vende ta tolerojnë deri diku mosvënien e sanksioneve nga Serbia. Megjithatë, kohë pas kohe, disa qendra evropiane (Berlini, fjala vjen) e kërcënonin Serbinë se mund ta ndëshkojnë me sanksione.

Situata e re gjeopolitike, me luftën e vendeve perëndimore kundër Rusisë për Kosovën ishte e volitshme ngase tani reduktohej ndikimi i Moskës në Ballkan. Kjo njëherësh kishte si rrjedhojë dobësimin e pozicionit të Serbisë.

Julian Fernandez, drejtor i Qendrës Thucydide në Universitetin Paris-Panthéon-Assas dhe Jean-Baptiste Vilmer, specialistë të marrëdhënieve ndërkombëtare në një tekst të përbashkët të botuar në « Le Monde » identifikojnë masat që duhen marrë për « ta përshpejtuar disfatën ruse », pa u angazhuar ushtarakisht në territorin e Ukrainës në këtë konflikt. Këta specialistë të luftës propozojnë tri gjëra: t'i dërgojnë më shumë armë Ukrainës, në veçanti ato që u bëjnë të mundur të mbrohen në mënyrë efikase nga sulmet ajrore të Rusisë; pasi tanimë ishin dëshmuar si efikase sistemet bartëse të mbrojtjes ajrore: *Manpads* dhe *Stringerët* shumë efikas, pastaj raketat tokë-ajër.

PËRMASAT E SHKATËRRIMEVE

Marie Struthers, drejtoreshë e programit “Evropa Lindore dhe Azia Qendrore” brenda organizatës ndërkombëtare *Amnesty International*, në një intervistë për « Le Monde » (21 mars 2022) vë në pah se rusët përdorin një strategji të qëllimshme të terrorizimit, në veçanti, ndaj popullsisë civile në Ukrainë, siç e kishin bërë këtë edhe më parë në Alepo të Sirisë apo në Çeçeni.

Në rrethana kur Rusia bombardon sistematikisht vendbanimet dhe qytetet në Ukrainë, u paraqitën kërkesa për evakuimin e civilëve nga qyteti Marioupol, qytetarët e të cilit me javë të tëra nuk kishin më ujë, rrymë elektrike, gaz dhe internet. Rusët bombardonin edhe civilët e korridoreve humanitare, duke u orvatuar t'i detyrojnë këta të orientohen kah Rusia. Zonja Struthers thekson se trupat ruse e shkelin të drejtën humanitare në mënyrë flagrante. Ajo vë në pah se regjimi i Putinit që nga fillimi ka penguar vendosjen dhe funksionimin e institucioneve që duhet të siguronin liritë dhe të drejtat e qytetarëve në zona të luftës. Ushtria ruse kishte përdorur metoda të njëjta më parë në Siri, me bombardime të vazhdueshme të qyteteve të rrethuara, duke goditur në veçanti edhe tregjet e prodhimeve ushqimore, spitalet e shkollat; ajo ushtri tani edhe në Ukrainë po përdor armë të ndaluara me konventa të luftës.

LEVAT IDEOLOGJIKE TË PUSHTETIT TË PUTINIT

Një pjesë e konsiderueshme e analizave të luftës së sotme në Ukrainë përqendrohet te roli i presidentit të Rusisë dhe sundimit të tij prej dy dekenieve. Michel Eltchaninoff, eseist francez dhe kryeredaktor i revistës « Philosophie magazine » (Paris) është njohës i mirë i politikës së Putinit dhe ideologjisë së tij. Ai shkroi veç të tjerash edhe librat *Lenini ka ecur mbi hënë. Histori e çmendur e kozmistave dhe transhumanistave rusë* (Actes-Sud, 2022) dhe *Në kokën e Vladimir Putinit* (Actes Sud, 2015). Në librin e dytë ai analizon « formimin intelektual » të presidentit të Rusisë i cili e shikon veten si « një filozof me mision civilizues të Rusisë e po ashtu si një historian ». Autori është marrë, në veçanti, me shqyrtimin e arsyeve ideologjike që e kanë shtyrë Putinin ta sulmojë Ukrainën.

Në shkrimet e veta Eltchaninoff-i vë në pah se për Putinin pavarësi i Ukrainës kishte qenë « një tragjedi » e shkaktuar nga « aksionet e qëllimshme të forcave të cilat gjithherë kanë synuar ta thyejnë unitetin tonë ». Disa autorë kanë cekur se ai i ka përvetësuar idetë e filozofit rus Ivan Ilyne (1883-1954), i cili afirmonte nevojën për një « diktaturë kombëtare ». Kjo diktaturë do të duhej t'i kundërvihej « kaosit separatist » pas shembjes së komunizmit në BRSS. Eltchaninof-i cek se Putini që moti e shikonte Kievin si « nënë e qyteteve ruse », sikurse princi Oleg në shekullin X. Ai synon ta rimëkëmbë « unitetin historik të rusëve dhe ukrainasve ». Mirëpo bindjet dhe pikëpamjet e presidentit rus mbajnë gjurmët e shtrembërimeve të fakteve dhe të ngjarjeve historike; ai e ka përvetësuar një interpretim historik nga koha imperiale e shekullit XIX, e cila e vë një lidhje vazhdimësie hipotetike midis principatës së Kievit (IX-XIII) dhe origjinës së Rusisë bashkëkohore. Mirëpo, siç cek Elchaninoff-i, Rusia e Kievit ishte « një perandori shumëtnike e jo një entitet sllav ». Kësodore, vizioni i Putinit del si një « rikonstruktiv imperial ».

Mirëpo, Ukraina, në të vërtetë, e *rizbulon identitetin* e vet në shekullin XIX dhe bëhet republikë e pavarur në vitin 1919. Që nga shekulli XVIII mbretërit e Rusisë, prej Petrit I, e ndalonin përdorimin e gjuhës ukrainase në shkolla e universitete e njëherësh edhe botimet e librave në këtë gjuhë. Uria e organizuar e Stalinit në vitet 1932-1933, për shkak të rezistencave dhe kundërshtimeve, si dhe vullnetit për t'u pavarësuar nga BRSS-ja; e fiton pavarësinë më 1991. Pastaj shpërthen « revolucion i portokalli » në 2004 dhe protestat e forta në Maidan 2013-2014, ku manifestohet vullneti për pavarësi politike të Ukrainës. Autori shton se Putini më 21 shkurt 2022 e zhvillon një ligjëratë publike në televizion, në të cilën thekson se në debatin midis Leninit dhe Stalinit, i pari vuri një « bombë

bërthamore” nën themelet e BRSS-së duke ua dhënë republikave të drejtën për vetëvendosje, ndryshe nga Stalini.

KUNDËR QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

Pak para invadimit të Ukrainës, Putini rikujtoi publikisht intervenimin e NATO-s kundër Serbisë me fjalët që shprehin përjetimin e një fyerjeje madhore, të cilën e mban parasysh kur sulmon Ukrainën. Pikërisht kur zhvillohet intervenimi i NATO-s kundër Serbisë, ai ishte duke u përgatitur për inaugurimin e vet si kryeministër dhe e shikon atë si “ngjarje që rumbullakëson sundimin perëndimor postsovjetik.”

Lidhur me « rrënjët ideologjike të putinizmit » Eltchaninov-i merr parasysh tri shtylla të neosovjetizmit: sllavofilinë, euroaziatizmin dhe konservativizmin. Sipas autorit, ai ishte i ndjeshëm ndaj “patriotizmit sakrifikues të sovjetizmit”. Sovjetofilizmi i tij përbëhet nga një mitologji mbi Luftën e Dytë Botërore, një apologji e pushtimit të hapësirës kozmike dhe me kundërvënje ndaj botës perëndimore.

Nga sovjetofilët Putini veçon Nikollai Danilevskin (XIX), autorin e librit *Rusia dhe Evropa* (1869), i cili ia shton sllavofilisë burimore idenë e “një zhvillimi organik të Rusesë” dhe të një konfrontimi të paevitueshëm me Perëndimin. Ky cilësohet me sundimin e ligjit, epërsinë e tregtisë dhe një formë të materializmit, të cilat do t’i kundërviheshin frontalisht Rusesë; e kjo shikohet si e mbryjtur nga një “krishterim mesianik dhe një spiritualitet.” Autori saktëson se dy vektorët e putinizmit janë apologjia e luftës dhe besimi në një “themel biologjik të civilizimit sllav”. Putin ka qenë i ndikuar edhe nga Konstantin Léontiev-i (1883-1891), autor konservator i cili e shikon Evropën moderne si një “katastrofë antropologjike” e cila ka hyrë në dekadencë qysh nga Rilindja (shek.XIV-XVI).

Eltchaninoff-i mendon se pas rizgjedhjes së tij më 2012 Putini kishte nevojë për *mjete ideologjike* për ta fituar aderimin e popullit rus rreth tij. Ai kritikon martesat midis personave të një gjinie. Kundër ofensivës liberale Rusia duhet, sipas tij, të afrojë e tubojë konservatorët e gjithë botës, të bëhet poli botëror i konservativizmit. Ai ka kërkuar mbështetje edhe te rryma e euroazizmit, e lindur në vitet 1920 tek autorët rusë të emigruar në Evropë, në veçanti në Pragë dhe Sofje. Për përfaqësuesit e kësaj rryme Rusia s’ka asgjë të përbashkët me Evropën Perëndimore, por me popullsitë aziatike, myslimanët, sllavët dhe popujt turkofonë që përbëjnë një “simfoni specifike”, e cilësuar me një kthim kah orienti.

Putin mendon se Rusia ka një pjekuri dhe një superioritet të cilin duhet ta mbrojnë dhe ta ruajnë. Për Eltchaninoff-in *Putini është i mbyllur brenda ideologjisë së vet*; luftën në Ukrainë ai e shikon si luftë të qytetërimeve, midis konservativizmit tradicionalist dhe modernizmit perëndimor. Në fjalimin e 21 shkurtit ai thekson se « ata s'na durojnë ngase ne ekzistojmë ». Ai e sheh një dallim fundamental midis dy civilizimeve.

Editorialisti i së përditshmes prestigjioze franceze *Le Monde* Alain Frachon, specialist i çështjeve gjeopolitike, zhvillon tezën se politika e Putinit nuk është « prodhim i zgjerimit të NATO-s apo e përbuzjeve të Perëndimit ». Ai mendon se për ta kuptuar luftën e Rusisë në Ukrainë duhet kuptuar « personazhi i Putinit meqë kjo është luftë e tij ». Ndërkaq, në analizën e ideologjisë së presidentit rus ai veçon shpjegimin në sajë të despotizmit: « i mbyllur brenda atmosferës së gënjeshtreve të tij, autokrati, i bindur për superioritetin e vet intelektual, tani e tutje i dëgjon vetëm fantazmat e veta. Ai dëshiron të jetë *cari i kohërave moderne*, ai që « do ta rimëkëmbë Rusinë në integralitetin e saj ». Sipas agjencisë zyrtare ruse « Novosti » në artikullin ku paralajmërohet, në fund të frorit, pushtimi i Ukrainës nga trupat ruse. Këto shpjegime e interpretime ishin në kundërtënie së pari me *realitetin e rezistencës* së ukrainasve; mirëpo Putini e ka « realitetin e vet alternativ ».

Disa vrojtues i përshkruajnë reagimet e Putinit si reagim ndaj aksioneve dhe qëndrimeve të botës perëndimore: *ai del si i fyer dhe i lënduar*. Mirëpo Frachon-i e konteston këtë tezë duke rikujtuar disa vendime të rëndësishme të vendeve perëndimore karshi Rusisë: më 1992 është SHBA-ja ajo që bën presion që Rusia të hyjë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Kështu Rusia do të marrë miliarda dollarë huazime afatgjata gjatë viteve. Asaj po kështu i çelen dyert e Këshillit të Evropës më 1996, pastaj të G7. SHBA-ja e mbështet njëherazi Rusinë gjatë krizës së saj monetare me rublën; edhe BE-ja e ndihmon financiarisht me vite. Vendet perëndimore, shton ai, po kështu ia ofruan Rusisë partneritetin me NATO-n që nga viti 1991.

Disa thonë se Rusia e ka përjetuar vështirë intervenimin e NATO-s në Kosovë. Ndonëse vendet perëndimore me atë aksion kishin arritur të ndalin gjenocidin e Serbisë mbi shqiptarët e Kosovës. Në anën tjetër më 2014 Rusia intervenon dhe i pushton Krimenë dhe Donbasin, me arsyetime që i takojnë regjistrin të propagandës dhe trillimeve, duke e shkelur sovranitetin e Ukrainës.

POLITIKA E BASHKËPUNITIT TË SHBA-së DHE E BE-së SI “PROVOKIM”

Frachon-i thekson po kështu se *shkolla neorealiste në politikën e jashtme në SHBA*, duke i dhënë epërsi raporteve të forcës midis shteteve, kritikon qëmoti qëndrimin e udhëheqësve amerikanë. Përfaqësuesit e kësaj shkolle mendojnë se politika e bashkëpunimit e SHBA-së dhe BE-së me Ukrainën, ka qenë « një provokim për Moskën ». Sipas saj Rusia ka të drejtë në një rreth të sigurisë – i përbërë nga vendet me të cilat ka pikëtakime historike e kulturore; ato vende “do të duhej të pajtoheshin” se kanë sovranitet të kufizuar. Pra, situata e Ukrainës e përcakton fatin e saj politik; ajo duhet të pajtohet me “një formë të vasalitetit”. Sipas neorealistëve klasa politike e Ukrainës është dashur ta kuptojë se ka sovranitet të kufizuar. Kësodore, John Mearsheimer, përfaqësues i asaj shkolle mendon se duhen marrë parasysh interesat e sigurisë të Rusisë, por jo edhe të fqinjëve të saj(!?). Ai supozon se Putini cilësohet me një racionalitet të zhvilluar dhe se « ai e kupton se nuk mund ta pushtojë Ukrainën dhe ta integrojë atë brenda Rusisë së madhe si riinkarnim i ish-BRSS-së ». Këta rreshta, studiuesi i Universitetit të Çikagos i kishte shkruar disa ditë para se Putini ta sulmojë Ukrainën. Frachon-i mendon se problemi i neorealistëve qëndron në faktin se « ata mendojnë se Putini mendon si ata ». Neorealistët kësodore *e nënçmojnë forcën e ideologjisë*. Putini ishte i bindur se shumica e ukrainasve mendojnë si ai vetë: ai ka thënë dhe ka shkruar se « Ukraina nuk ekziston », se ajo është pjesë e Rusisë. Për Putinin manifestimet për demokracinë që nga viti 2000 s’janë asgjë tjetër veç « manipulime » të CIA-s, prandaj ai « nuk është në gjendje ta imagjinojë rezistencën heroike të ukrainasve përballë ushtrisë ruse ». Realiteti i mirëfilltë i Ukrainës i ikën Putinit si *misionar i historisë*, sikurse edhe realiteti i mirëfilltë irakian që u pat ikur neokonservatorëve të G.W. Bushit më 2003. Zaten, presidenti Putin nuk është në një pozitë defansive karshi Ukrainës, por në *ofensivë* në shërbim të *restaurimit* të Rusisë së Madhe, siç e konfirmon edhe « Novosti », agjencia e tij e lajmeve.

Putini ka vite që është i kapluar me synimin për ta ripërvetësuar Kievin si « djep i Rusisë »; synim të ngjashëm e kishte edhe Milosheviçi me akademikët dhe shkrimtarët serbë lidhur me Kosovën: në të dy rastet shkelet racionaliteti politik që e cilëson traditën e mendimit filozofiko-politik të Evropës. Stephen Kotkin specialisti i shquar amerikan i Rusisë në gazetën *New Yorker* (3 mars 2022), e vendos Putinin në një vazhdimësi politike ruse. Ai cek se agresori i Ukrainës “nuk është prodhim zgjerimit të NATO-s e as i fyerjeve që Perëndimi i paskësh bërë Rusisë ». Kjo luftë

i takon një “permanence historike ruse”, një vullneti për ekspansion i “pangopshëm dhe misterioz” i një vendi, i cili megjithatë është shteti më i madh me hapësirë dhe potencialisht njëri nga më të pasurit. Vlen të saktësojmë se në këtë hapësirë s’ka vend për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, e as për mirëqenie ekonomike, me gjithë pasuritë e mëdha natyrore e nëntokësore që ai i ka. Një qeveritar i BE-së, së voni, e përshkroi Rusinë « si një stacion i pompave të benzinës dhe raketave bërthamore ».

TRADITA E AUTOKRACISË RUSE

Revista prestigjioze franceze për shkenca shoqërore dhe kulturë « Esprit », e cila botohet një herë në muaj, që nga muaji mars i këtij viti sjell artikuj e studime mbi rrjedhojat gjeopolitike që i shkaktoi në botën e sotme agresioni i Rusisë kundër Ukrainës. Studiuesi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Evropës dhe SHBA-së me Rusinë, Wiliam Farhi në artikullin me titull « Në syrin e Perëndimit » e merr në shqyrtim esenë e shkrimtarit të shquar Joseph Conrad « Autokracia dhe lufta » i botuar më 1905 në *The North American Review* « Autocracy and war », korrik 1905, f. 33-55.

Farhi në hyrje të artikullit të vet thekson se agresioni i Putinit ka nxitur së paku një « zgjim të imponuar e brutal nga një gjumë i thellë » i Perëndimit. Conrad-i në esenë e vet zhvillon një kritikë të ashpër ndaj Rusisë edhe duke e përvetësuar sentencën të cilën ia vesh Bizmarkut thënien se « Rusia është hiçi » në kuptimin se ajo nënkupton mohimin e « mendimit evropian e madje të të gjitha vlerave njerëzore ». Conrad-i kritikon tiparin thellësisht *despotik* të sistemit politik rus, sistem ky i paafhtë që të bëjë çfarëdo për të mirën e njerëzimit e njëherësh i prirur të shkatërrojë çfarëdo forme të përparimit moral apo politik.

Gjashtë vjet më vonë, rikujton Farhi, Conrad-i boton librin që do të quhet romani i tij rus: *Nën shikimin e Perëndimit* (1919). Personazhi kryesor i romanit Razumov të cilin e bren ndërgjegjja, ngase e kishte denoncuar në polici një shok të vetin anarkist si autor të një atentati kundër princit. Ai e ndjen veten të përçarë në njërin anë midis kulturës evropiane e në anën tjetër dhe « karakterit të tij të theksuar rus »; Conrad-i e përkufizon këtë ndasi si një « përzierje të misticizmit me cinizmin », e cila e shpie Razumovin te një përfundim tragjik.

Autori i këtij studimi rikujton se Conrad-i kishte lindur nga prindërit polakë, të cilët i kishte syrgjynosur qeveria cariste. Ai vë në pah qëndrimin thellësisht perëndimor. Farhi e sheh të udhës që pikëpamjet e Conrad-it t’i vendosë në kontekstin e sotëm të ngjarjeve lidhur me Rusinë dhe

Ukrainën. Kësodore ai vë në pah se në atë roman shpërfaqet kritika e « shpirtit rus » si « përzierje e misticizmit dhe cinizmit ». Autori e çmon në veçanti qëndrimin e Conrad-it që ka të bëjë me karakterin e politikës së jashtme të Rusisë dhe themelet ideologjike të aksionit të saj në skenën e sotme ndërkombëtare.^{ib} « Ky misticizëm i autokratit, ai imazh tokësor i autokratit hyjnor dhe i dyfishuar me një cinizëm manipulues, duhet doemos të merret parasysh për ta kuptuar aksionin e tij, rezultat i natyrshëm i të cilit është lufta ». ^{ib} Farhi dëshiron të vërë në dukje se Rusia i kundërvihet Perëndimit edhe kur është e kapluar me ëndrrat për pansllavizmin, pushtimin universal, urrejtjen dhe përbuzjen e ideve perëndimore ».1

Farhi e bën këtu një analogji midis syve të narratorit të romanit Razumov, përkatësisht të autorit Conrad, i cili e kultivonte bindjen se Polonia nuk ka alternativë tjetër për ardhmërinë, veç botës perëndimore. Pyetja që shtron studiuesi i relacioneve të Oksidentit me Rusinë, në fillim të këtij viti, në kontekstin e sotëm të luftës në Ukrainë, ka të bëjë me sytë që shikojnë sot një *zgjim* të Evropës karshi rreziqeve që i paralajmëron agresiviteti i Rusisë; e këto rreziqe e rihapin refleksionin për çështjen e Perëndimit, përkatësisht për definimin e tij. Farhi rikujton se ky u pat definuar në shekullin e Iluminizmit (sh. XVIII) në planin intelektual me arsyen si orientuese, në planin moral me tolerancën dhe njerëzinë, ndërkaq në planin ekonomik e politik me « lirinë, të drejtën dhe demokracinë si horizonte të vetme ». ^{ib} Farhi cek se nga këto premisa doli prirja e Perëndimit që ta kuptojë vetën me botëroren dhe universalen.

Mirëpo lufta e ftohtë midis blloqeve (Pakti i Varshavës nën kontrollin e Rusisë si BRSS dhe NATO-s) bëri që të kristalizohen dallimet e theksuara midis Perëndimit dhe Evropës Lindore. Ndërkaq rënia e Murit të Berlinit, me zgjerimin e ndikimit të liberalizmit dhe të demokracisë, ndikoi që sërish të tretet « orientimi i fortë strategjik e politik i Perëndimit ».3

Momenti i ri brenda këtyre raporteve u krijua me agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe me definimin e Perëndimit nga diskursi rus si « perandori e gënjeshtrës ». Kryetari i Rusisë, si vend që ka statusin e anëtarit permanent në Këshillin e Sigurimit të OKB-së e ka quajtur Perëndimin një armik i dobësuar i paaftë që të mbrohet. Karshi agresionit ushtarak mbi një vend evropian dhe karshi diskurseve zhvlerësuese të botës perëndimore u zgjua Bashkësia Evropiane dhe NATO-ja me mobilizimin e tyre politik e ushtarak.

³ Po aty

Farhi mendon se invazioni rus kishte si objektiv kryesor Oksidentin politik. Disa hulumtues kanë theksuar se kjo goditje ka ndikuar që Oksidenti të zgjohet mjaft shpejt nga letargjia dhe të bashkohet për t'iu kundërvënë Rosisë; ata nënvizojnë se asnjëherë nuk është hetuar një unitet i tillë dhe vullnet për t'iu kundërvënë Rosisë dhe synimeve të saj.

Një aspekt të veçantë të agresionit rus ndaj Perëndimit Farhi e shikon te prirja e tij që ta manifestojë hapur urrejtjen ndaj kësaj bote. Ai mendon se « çmimi politik, ushtarak e ekonomik i invazionit ishte aq shumë në disproporcion e shpërpjesëtim me fitimet e kalkuluara, sa që duhej kërkuar arsye të tjera për këtë vendim ». Armiqësia, të cilën Rusia e manifeston kundrejt Perëndimit dhe vlerave të tij edhe një urrejtje evidente; se ajo e ndjen veten të rrezikuar nga praktikatat politike e juridike që e cilësojnë demokracinë. Rusia kërkon aleanca për këtë orientim politik në Azi (Iran), në Lindjen e Afërt, në disa vende afrikane e latino-amerikane.

Prirja e vendeve perëndimore që pas dy luftërave botërore të kërkojnë prehje në mirëqenie dhe prosperitet u lëkund thellësisht me agresionin e Rosisë kundër Ukrainës.

Transformimi i vlerave, të cilin Conrad-i e dikton: liria, e drejta, drejtësia të ballafaquara me mirëqenien dhe komfortin: temë kjo që e kishin trajtuar edhe historianët romakë. Farhi megjithatë thekson se Oksidenti nuk mund më të lavdërohet që të jetë « një zë global »; ndonëse zëri i saj mund të jetë universal në atë masë sa i drejtohet njerëzimit (njerëzisë) të çdo njeri, tek ana e tij më bujare e njëherësh edhe ajo që më së vështiri arrihet.

Historiani i shquar britanik Antony Beevor në librin e tij të fundit *Rusia. Revolucioni dhe lufta civile, 1917-1921*⁴ vë në pah përmasat enorme të dhunës dhe masakrave nga fillimi i Revolucionit të Tetorit 1917 dhe luftës civile që shkaktoi afro dhjetë milionë viktima. Egërsinë e masakrave dhe krimeve çnjerëzore i konstaton, në sajë të burimeve të verifikuara historike te dy palët ndërluftuese: te « revolucionarët » e kuq dhe te « reaksionarët » e bardhë. « Është Lenini ai që shpiki kampet e përqendrimit « gulag », policinë politike « Ceka » dhe KGB-në, ciklet e torturave sistematike, vrasjet, masakrat. T'i kundërvësh metodat e Leninit me ato të Stalinit është një përrallë. Kjo traditë e përbuzjes totale të jetës njerëzore ka një traditë në Rusi: sot kjo shihet me agresionin kundër Ukrainës, sikurse edhe më parë në dy luftërat e Çeçenisë, në invazionin e Gjeorgjisë apo në intervenimin rus në Siri ». Historiani e gjen njërin nga

⁴ Antony Beevor, *Russie.Révolution et guerre civile 1917-1921*, Calman-Lévy, Paris, 2022.

shpjegimet për përmasat e dhunës dhe të egërsisë në praktikat e përditshme të forcave ruse dhe mënyrës se si oficerët rusë i trajtojnë madje edhe vetë ushtarët e tyre, sikurse dikur në kohën cariste apo sovjetike. E këta ushtarë, në operacionet e tyre ushtarake, i trajtojnë sot civilët, e sidomos gratë me një egërsi të theksuar ».

REZISTENCAT E UKRAINASVE GJATË HISTORISË

Anne Applebaum, specialiste e Evropës Qendrore e Lindore dhe njohëse e mirë e historisë politike të BRSS-së në Universitetin “John Hopkins” (Maryland) mendon se perëndimorët nuk kanë dashur ta shikojnë me sy kritik regjimin e Putinit tani e 15 vjet. « Ne kemi refuzuar të pranojmë se Putini ishte në luftë kundër Perëndimit; për Putinin *demokracitë perëndimore* janë një « rrezik ekzistencial », jo për shkak të armëve të NATO-s, por ngase ai u frikësohet *efekteve të idealeve të lirisë mbi regjimin e tij*. « Ai e ka pushtuar Ukrainën, ngase ky vend nuk e do modelin e tij të autokracisë kleptokratike ». Ne kemi besuar, shton ajo, se nuk do të ketë luftë dhe se ai nuk do ta sulmojë Ukrainën.

Applebaum ndriçon historikun e rezistencës së ukrainasve. Në vitet 30, në të vërtetë, ukrainasit u rebeluan kundër shtetit sovjetik dhe politikës së nacionalizmit të pronave të fshatarësisë e njëherësh shtruan kërkesa politike që lidhen me të drejtat e popullit ukrainas. Autorja vë në pah se në letrat e Stalinit diktohet mllefi kundër formave të ndryshme të rezistencës që bënin ukrainasit kundër shtetit sovjetik. Për këtë arsye ai organizoi në vitet 1932-1933 konfiskimin e drithërave të Ukrainës « holomodor »: urinë artificiale e vdekjeprurëse për miliona ukrainas; këtë operacion Stalini e ndërmori me qëllim që ta ndëshkojë rezistencën e tyre. Applebaum-i saktëson se rezistenca e sotme e ukrainasve frymëzohet edhe me këtë *kujtesë të terrorit stalinian kundër tyre*.⁵

Studiuesit e politikës së Rusisë, nga vende të ndryshme, kanë vënë në shesh se Putini, që nga ardhja e tij në pushtet në vitin 2000, ka vendosur një kontroll gjithëpërfshirës mbi shoqërinë civile të Rusisë, e njëherazi ka përqendruar në duart e veta që të tri pushtetet: ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor (sferën e së drejtës.) Arrestimet dhe vrasjet e gazetarëve dhe veprimtarëve të shoqërisë civile që kritikonin regjimin, pengimi i protestave kundër politikës së tij autokratike dhe qeverisjes së tij, e cila ndrydh manifestimin e *pluralitetit të opsioneve* politike karakterizojnë rrjedhën e

⁵ *Esprit*, Paris, 30 mars 2022.

politikës së Putinit. *Regjimi i Putinit ka funksionuar në atë mënyrë që e ka bërë të pamundur një alternativë politike*; madje edhe hapjen e disa shtigjeve politike nga Gorbachev-i, ai i bllokoi me koncentrimin në duart e veta të të tri pushteteve. Gjasat që të adoptohen ligje që mbrojnë në mënyrë efikase të drejtat dhe liritë e qytetarëve, që sfera gjyqësore të jetë e pavarur, janë shuar gradualisht. Kësodore, konceptioni i tij politik është i përcaktuar me optikën e një policie politike e cila e *ngulfat* sferën politike dhe shoqërinë civile. Regjimi i Putinit gjatë viteve ka ndëshkuar dhe përndjekur ashpër bartësit, jo aq të shumtë në Rusi, e kritikave ndaj tij, qofshin gazetarë, deputetë apo këshilltarë në nivele të ndryshme të sistemit rus. Karakteri represiv i këtij regjimi i ka tiparet e regjimit komunist sovjetik, boshti kurrizor i të cilit ishte policia politike NKVD-ja, aktor i së cilës ishte Putini.

Është theksuar shpesh nga vrojtuesit e politikës së regjimit autokratik rus se *ndryshimet politike, me tipare demokratike në Ukrainë u bënë një kontestim dhe një kritikë nga jashtë e padurueshme*. Agresioni i Putinit kundër Ukrainës ka, në të vërtetë, një objektiv të dyfishtë: në politikën ndërkombëtare dhe në atë të brendshme: ta imponojë dhunën ushtarake e policore si mjet për të penguar procese politike demokratike jo vetëm brenda Rusisë, por edhe te vendet që janë bërë të pavarura me shembjen e Bashkimit Sovjetik. Element kyç i kësaj politike e ideologjie janë gënjeshttrat dhe mohimi radikal i krimeve që i praktikon.

Kryetari i Gjermanisë Steinmeier, në një intervistë së voni pranon një gabim të vetin: Duke pasur parasysh luftën në Ukrainë, të cilën presidenti rus po e udhëheq sot, “vlerësimi im ka qenë se Vladimir Putini nuk do të rrezikojë rrënimin e plotë ekonomik, politik dhe moral të vendit të tij për shkak të çmendurisë së tij imperiale – këtu unë, si të tjerët, jam mashtruar”. Tani, shtoi Steinmeier, duhet të bëj “një bilanc të hidhur”: “Kemi dështuar në ndërtimin e një shtëpie të përbashkët evropiane duke përfshirë Rusinë. Kemi dështuar me qasjen e përfshirjes së Rusisë në një arkitekturë të përbashkët të sigurisë”. Për presidentin gjerman tani është e qartë se me Rusinë nën udhëheqjen e Putinit nuk do të ketë kthim në *status quo*-n e paraluftës. Ndryshe nga Steinmeier ish-kancelarja Angela Merkel e mbrojti qëndrimin e saj për refuzimin e pranimit të Ukrainës në NATO në Samitin e Bukureshtit. Këtë e bëri të qartë përmes një zëdhënëseje.

RUSIA E AKUZUAR NË DY GJYKATA NDËRKOMBËTARE

Më 7 mars 2022 u mbajt procedura gojore para GJND-së në Hagë në sajë të akuzës së Ukrainës kundrejt Rusisë. Në të vërtetë, Ukraina akuzoi Rusinë se e ka keqpërdorur konventën për pengimin dhe ndëshkimin e gjenocidit me qëllim që ta arsyetojë agresionin e vet ushtarak kundër Ukrainës. Duke njoftuar për hyrjen e trupave të veta në Ukrainë më 24 shkurt Putini kishte thënë se kësioj dëshiron « *të parapengojë një gjenocid në realizim e sipër* » në Donbas (i banuar me një pakicë ruse), në lindje të Ukrainës. Kryetari i delegacionit të Ukrainës A. Kornieviç theksoi se është fjala për « një gënjeshtër të tmerrshme »; gënjeshtër kjo që ka për qëllim të maskojë krimet që ushtria e tij i bën çdo ditë në Ukrainë. Të rikujtojmë këtu se Milosheviçi e arsyetonte spastrimin etnik të institucioneve të Kosovës e pastaj të dëbimit dhe masakrave të shqiptarëve me kundërvënie ndaj « gjenocidit kundër serbëve të Kosovës », sikurse Putini për Donbasin.

Do të shtonim se Putini manipulon këtu edhe me një realitet tjetër: me arsyetimin e tij ai mëton të denoncojë "kotësinë" e argumentit të fuqive perëndimore që ndërhyjnë në Kosovë për ta penguar një gjenocid të regjimit serb kundër shqiptarëve të Kosovës. Këtë pohim ai e ka shfaqur disa herë publikisht. Me cinizmin që e karakterizon ligjërimin politik të Putinit, ai sikur do të nënvizojë: përse nuk ishte i vërtetë arsyetimi im për gjenocidin në Donbas nëse ju perëndimorët e arsyetuat kësioj sulmin mbi një shtet sovran- Serbinë.

Përfaqësuesit e delegacionit të Ukrainës, sipas lajmeve të disa agjencive ndërkombëtare, ofruan të dhëna për përmasat e krimeve konkrete që ushtria ruse i bëri në disa qytete të mëdha të Ukrainës: shkatërrimet me bomba e raketa të universiteteve, spitaleve, kishave. Në pledojën e përfaqësuesit të Ukrainës se Rusia me agresionin e vet, përveç krimeve masive kundër civilëve, dëshiron njëherazi ta njollosë kujtesën për Holokaustin e hebrenjve nga nazistët në Luftën e Dytë Botërore: në të vërtetë, ajo e arsyeton agresionin e vet dhe krimet e veta me qëllimin që ta « denacifikojë Ukrainën »; ndërkaq vetë kryetari i këtij shteti është hebre. Gënjeshttrat dhe cinizmi me temën e nazizmit dhe gjenocidit e cilësojnë ligjërimin zyrtar të Moskës.

Oksana Zolotaryova, ofroi të dhëna të dokumentuara të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit në disa qytete të Ukrainës. Rusia, shtoi ajo, duhet ta kuptojë se e drejta ndërkombëtare ka peshë dhe ka vlerë në botën e sotme.

Rusia nuk dërgoi përfaqësuesit e vet në këtë procedurë orale. Një anëtar tjetër i delegacionit ukrainas, Aleksandre Koh, profesor në Universitetin Yale nënvizoi se derisa « loja e Putinit mbështetet mbi forcën, për botën e sotme në perspektivën afatgjatë duhet të jetë e drejta ». Ai theksoi, duke iu drejtuar 16 gjyqtarëve, se roli i GJND-së karshi këtyre ngjarjeve është i rëndësishëm për vetë sistemin e Kombeve të Bashkuara. GJND-ja ka kërkuar më 16 mars ndërprerjen e invazionit. Rrallëherë GJND-ja ka reaguar më shpejt.

Ndërkaq më 2 mars prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare Karim Khan njoftoi se kjo Gjykatë ka hapur një hetim të menjëhershëm për gjendjen në Ukrainë pasi 39 shtete anëtare të kësaj Gjykate kishin ofruar të dhëna për krimet e luftës dhe krime kundër njerëzimit që trupat ruse kishin kryer kundër popullsisë civile në Ukrainë. GJND-ja, kjo instancë e drejtësisë ndërkombëtare, më 16 mars kërkoi nga Rusia ndërprerjen e invazionit.

RUSIFIKIMI I UKRAINËS DHE I KULTURËS SË SAJ

Studiuesi i historisë ukrainase Jaroslav Kombij vë në pah se mbretërit e Rusisë, Petri I (më 1720), Katarina II (më 1722), Aleksandri I (1824), Aleksandri II (1856), Aleksandri III (1883) dhe ministrat e tij nxorën vendime me të cilat ndalohej botimi i librave në gjuhën ukrainase, ndalohej përdorimi i gjuhës ukrainase në shkolla e fakultete, si dhe në institucionet shtetërore. Ata drejtonin po kështu edhe rishkrimin e historisë së ukrainasve. Katarina II njëherësh urdhëroi formimin e Komisionit i cili kishte për detyrë t'i falsifikojë dokumentet origjinale, të shkruajë një histori të re, sipas së cilës bëhet lidhja e drejtpërdrejtë e Ukrainës me principatën e hershme të “Rusisë së Kijevës” dhe fshihet identiteti politik e kulturor i Ukrainës dhe ukrainasve. Më vonë (në shekullin XX), Rusia nuk ka pranuar që të bëhet verifikimi i atyre “origjinaleve” me metodën karbonit radioaktiv (izotopi 14 C), pikërisht pse ky verifikim do të dëshmonte falsifikimin.

Paralelisht me këto masa të mbretërve edhe Sinodet e Kishës Ortodokse ruse ndalonin botimin dhe përdorimin e abetareve në gjuhën ukrainase, si dhe përdorimin e gjuhës ukrainase në regjistrat e lindjes dhe të vdekjes.⁶

⁶ *Esprit*, prill 2022, Paris.

ROLI I KISHËS ORTODOKSE RUSE

Kisha ortodokse ruse, përmes fjalimeve publike të patriarkëve të vet e mbështet agresionin e Putinit kundër Ukrainës. Hulumtuesit e ideologjisë politiko-religjioze të kësaj kishe vejnë në pah se arsyetimi i agresionit rus shpaloset edhe me një ideologji antiperëndimore: kritikohen vlerat kulturore dhe politike të shoqërive perëndimore. Agresioni kundër Ukrainës justifikohet kështu si luftë kundër “forcave të së keqes” të mishëruara në kulturën dhe politikën e vendeve perëndimore. Zëdhënësit e Kishës ortodokse ruse e shohin këtë të keqe të shoqërive perëndimore edhe “në liritë iluzore të inkarnuara në “Gay prides”. Në këtë kritikë shpërfaqet edhe një hipokrizi morale, ngase fenomeni i homoseksualizmit brenda klerit ortodoks është trajtuar sa në shkrime të gazetave, po aq edhe në ato letrare.

Disa hulumtues kanë vënë në pah brenda ideologjisë së Kishës ortodokse aspektet imperialiste, përkatësisht, synimet për ripushtimin e vendeve të pavarura, që kanë dalë nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik. « Mëkati » i këtyre vendeve nuk qëndron, sipas atyre ideologëve, vetëm pse janë pavarësuar, por sidomos pse ia kanë kthyer shpinën Rusisë dhe janë orientuar kah vlerat kulturore e politike perëndimore. Kësodore, ajo ideologji kishtare e ka ushqyer propagandën e ambicieve pushtuese të Krem-linit (V. Cibotaru).

ELOZHET PËR STALININ

Përbashkësia e motiveve ideologjike midis pushtetit putinian dhe Kishës ortodokse ruse u manifestua edhe lidhur me qëndrimin ndaj Stalinit dhe politikës së tij. Emmanuel Grynspan rikujton se në nëntor të vitit 2015 në një tubim publik Putini dhe « Patriarku i të gjitha Rusive » Kirilli jo vetëm që i bënë elozhe Stalinit, por kërkuan « që të pushojnë kritikën kundër Stalinit, meqë ai ka merita të mëdha për modernizimin dhe zhvillimin e vendit.” Ndonëse Stalini brenda politikës së vet represive nuk e kishte kursyer as klerin e Kishës ortodokse ruse. Andrei Arkhanguelski cek se me këto deklarata Kirilli iu bashkua Putinit jo vetëm në legjitimimin e agresionit kundër Ukrainës, por edhe në rivlerësimin e Stalinit, regjimi i të cilit ka mbetur i regjistruar në historinë e njerëzimit me krime masive kundër miliona qytetarëve të Bashkimit Sovjetik.

Për rolin e Kishës ortodokse serbe në nxitjen e urrejtjes ndëretnike në vitet 80 dhe 90 të shekullit të kaluar, si dhe në mbështetjen e agresioneve

dhe krimeve masive të Milosheviçit ndaj Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë e Hercegovinës dhe Kosovës, janë dalluar analizat kritike të sociologes beogradase Radmila Rajiç në librin *Kisha dhe 'çështja serbe'*⁷.

STALINI DHE URIA VDEKJEPRURËSE E UKRAINASVE ("Gladomor")

Në vitet 1930 Stalini ndërmori një varg të masave represive, në veçanti, ndaj intelektualëve dhe shkrimtarëve ukrainas. Ai drejtonte masat e dhunshme të ndalimit të "ukrainizimit" të ukrainasve, përkatësisht ai kriminalizonte përdorimin e lirë të gjuhës ukrainase në shkolla, fakultete e institucione të kulturës.

Shkallën më të lartë të terrorit kundër ukrainasve Stalini e kreu në vitet 1932-1933 duke organizuar me pushtetin e vet, e në veçanti me policinë dhe ushtrinë, urinë masive në trevat ukrainase, duke penguar furnizimin e tyre me drithëra. Si pasojë e këtij operacioni vdiqën nga uria ("Gladomor") 7 milionë ukrainas.

Putini e vazhdon këtë traditë sot me agresionin kundër Ukrainës: me vrasje masive të civilëve, me bombardime të vendbanimeve, spitaleve, shkollave. Mirëpo këtë herë populli dhe shteti i Ukrainës organizuan një rezistencë të fuqishme ndaj ushtrisë ruse. Njëherazi, Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja u mobilizuan për ta mbështetur Ukrainën, duke i dërguar edhe armatim.

Autorët rekomandojnë rritjen e presionit jo vetëm ekonomik, por edhe ushtarak; shtetet evropiane do të duhej të rrisin presionin jo vetëm ekonomik, por po ashtu edhe ushtarak; të ndalojnë importimin e naftës, gazit dhe energjisë ruse, ashtu siç e kanë bërë tanimë amerikanët dhe britanikët.

VIZIONI I KUFIJVE

Profesorja e historisë Sabine Dullin në Universitetin parisien për shkencë politike *Science Po* autore e librave *Kufiri i trashë. Origjinat e politikave sovjetike* (Paris, 2014) dhe *Ironia e fatit. Një histori e rusëve dhe perandoria e tyre* (Paris, 2021). Ajo shpjegon se vizioni i kufijve të Rusisë ka evoluar ndonëse ka mbetur i pandryshuar « imperativi i një zone « të

⁷ Radmila Rajiç, *Crkva i 'srpsko pitanje'*, BIGZ, Beograd, 1995.

trashë « apo zone ndarëse sa më të gjerë të mundshme për t'u mbrojtur nga ndikimet perëndimore ». Ai e kundron Rusinë si fuqi e madhe ndërkaq shembja e Bashkimit Sovjetik krijoi tek ai një ndjenjë turpi e cila e shtyri të ndërtojë në imagjinatën e tij politike një rol historik të kombit « rusomadh » rreth të cilit do të gravitonin Bjellorusia dhe Ukraina.

Historiania Dullin e sheh një ngjashmëri midis Putinit, i cili synonte një Rusi të madhe me pushtimin e Ukrainës dhe Milosheviçit, i cili ëndërronte për « një Serbi të madhe » e mbështetur në « Betejën e shenjtë » para gjashtë shekujve në Fushë-Kosovë; që të dytë, cek ajo, shpërfillin të drejtat e popujve që jetojnë aty.

Putini e kishte përjetuar rëndë shembjen e Bashkimit Sovjetik. Ndryshe nga Serbia e Milosheviçit, Federata ruse, edhe sot mund të quhet një perandori multikombëtare, ngase brenda kufijve të saj jetojnë popuj të ndryshëm; ajo Federatë është e sunduar nga një sistem autokratik.

Historiania Dullin thekson se për Rusinë qoftë e asaj nga mesi i shekullit XIX, qoftë kjo e Putinit e shikojnë rrezikun të Perëndimi, e shohin veten të rrethuar me vende properëndimore: Finlandën, Poloninë.

Dullin shpjegon represionin që Rusia dhe rusët kanë ushtruar kundër gjuhës dhe kulturës ukrainase ka të bëjë me vullnetin e Moskës që të shkëpusë lidhjet politike e kulturore të Ukrainës me Poloninë.

Përbashkësia e motiveve ideologjike midis pushtetit putinian dhe Kishës ortodokse ruse u manifestua edhe lidhur me qëndrimin ndaj Stalinit dhe politikës së tij. Emmanuel Grynspan rikujton se në nëntor të vitit 2015 në një tubim publik Putini dhe « Patriarku i të gjitha Rusive » Kirilli jo vetëm që i bënë elozhe Stalinit, por kërkuan « që të pushojnë kritikën kundër Stalinit, meqë ai ka merita të mëdha për modernizimin dhe zhvillimin e vendit. » Ndonëse Stalini brenda politikës së vet represive nuk e kishte kursyer as klerin e Kishës ortodokse ruse. Andrei Arkhanguelski cek se me këto deklarata Kirilli iu bashkua Putinit jo vetëm në legjitimimin e agresionit kundër Ukrainës, por edhe në *rivlerësimin e Stalinit*, regjimi i të cilit ka mbetur i regjistruar në historinë e njerëzimit me krimet masive kundër miliona qytetarëve të Bashkimit Sovjetik.⁸

Ish-presidenti rus Dmitri Medvedev, nënkryetar i Këshillit të sigurisë të Rusisë, më 3 nëntor deklaroi se Rusia zhvillon në Ukrainë « një konflikt të shenjtë me Satanin » dhe është kërcënuar se vendi i tij është në gjendje « t'i dërgojë të gjithë armiqtë e vet në ferr »; se qëllimi i Rusisë me këtë invazion është « ta ndalë prijesin suprem të ferrit, cilido që të jetë emri

⁸ *Esprit*, maj 2022, f.

të cilin ai e përdor -Satani, Luciferi apo Iblisi ». Ai kishte shtuar se Rusia i lufton në Ukrainë « nacistët e çmendur dhe toksikomanë » të mbështetur nga « perëndimorët e degjeneruar » (« Le Monde » dhe « Reuters »).

NJË ANALOGJI MIDIS PUTINIT DHE MILOSHEVIÇIT

Historia e ripushtimit dhe argumentimi historik mbi « djepin » e popullit është diktuar si pikë e përbashkët e Putinit dhe Milosheviçit. I pari i referohet Rusisë me Kievin si qendër midis shekujve IX dhe XIII. Milosheviçi në fjalimin e tij në Fushë Kosovë në qershor të vitit 1989 rizgjon ëndrrën e Betejës së « shenjtë » të vitit 1389. Në të dy rastet këta dy diktatorë fshijnë nga skema e tyre « historike » praninë e dy popujve të tjerë: ukrainasve dhe shqiptarëve.

Për ringjalljen e atyre skemave historike Putini dhe Milosheviçi përdorin tërë potencialin ushtarak për shkatërrimin dhe dëbimin e tyre (ukrainasve dhe shqiptarëve). Putini përdor më shumë metodën e rrethimit dhe bombardimit të qyteteve duke targetuar kryesisht civilët. Ndërkaq Milosheviçi synonte ta realizojë projektin e dëbimit radikal të shqiptarëve nga Kosova, përkatësisht spastrimin e saj etnik. Për realizimin e këtij plani edhe i dyti bombardonte fshatrat dhe masakronte civilët.

NIETZSCHE MBI RUSINË

Në librin *Njerëzor, tepër njerëzor*, II (1886), në fragmentin 231, filozofi i madh gjerman Nietzsche (Niçe) shkruan: “Emigrimi më i rrezikshëm.-Në Rusi ka një emigrim të inteligjencës: kufiri kalohet për të lexuar dhe për të shkruar libra të mirë. Mirëpo, kësodore transformohet gjithnjë e më shumë atdheu i braktisur nga mendja në një lloj çakalle e shtrirë e Azisë, e cila synon ta gllabërojë Evropën e vogël.”

Edhe ky fragment dëshmon për luciditetin e thellë të Nietzsches: aftësinë e tij që me disa fjali të shkoqitë një problem kompleks. Luciditeti i këtij fragmenti shpërfaqet në dy momente të realitetit të sotëm të Rusisë së Putinit: me mbyajtjen e mundësive për kërkime e mendime të lira, që ndëshkohen me burgim deri në 15 vjet; si edhe me një vizion të tij politik që u kundërvihet vlerave politike e kulturore evropiane.

Eseisti francez Michel Eltchaninov-i pat vënë në pah se Putini ka kërkuar mbështetje për projektet e veta politike edhe te rryma e euroaziz-

mit, e lindur në vitet 1920 tek autorët rusë të emigruar në Evropë, në veçanti, në Pragë dhe Sofje. Për përfaqësuesit e kësaj rryme “Rusia s’ka asgjë të përbashkët me Evropën Perëndimore, por ka afërsi me popullsitë aziatike, sllavët, myslimanët dhe popujt turkofonë që përbëjnë “një simfoni specifike”.

Autori mendon se për ta kuptuar luftën e Rosisë në Ukrainë duhet kuptuar « personazhi i Putinit, meqë kjo është luftë e tij ». Ndërkaq, në analizën e ideologjisë së presidentit rus ai veçon shpjegimin në sajë të despotizmit: « i mbyllur brenda atmosferës së gënjeshtreve të tij, autokrati, i bindur për superioritetin e vet intelektual, tani e tutje i dëgjon vetëm fantazmat e veta ». Ai dëshiron të jetë « cari i kohërave moderne », lideri që « do ta rimëkëmbë Rusinë në tërësinë e saj ». Edhe duke synuar që disa popuj të Azisë t’i përdorë si mjete për pushtimet e veta.⁹

KOSOVA NË KONTEKSTIN E LËVIZJEVE GJEOPOLITIKE

Brethanat e reja gjeopolitike që u krijuan nga agresioni i Rosisë kundër Ukrainës cilësohen me një përmbysje të madhe në raportet midis vendeve perëndimore (BE-së dhe SHBA-së, në veçanti) dhe Rosisë: u krijua një distancë e thellë ndaj Rosisë; risia e kësaj situatë u shfaq me definimin e Rosisë jo më si kundërshtar apo rival, por si *armik* i vendeve perëndimore; madje jo vetëm në rrafshin ushtarak, por edhe në atë politik. Ligjërimet politike të pushtetit të Kremlinit, në anën tjetër, u bënë gjithnjë e më agresive, të ngarkuara me urrejtje e mëni ndaj vendeve perëndimore. Ato ligjërimi zyrtare u shoqëruan me propagandën e medieve në *diabolizimin* e botës perëndimore, të kulturës dhe mënyrës së jetesës së saj. Vlen të theksohet këtu se një dallim i rëndësishëm midis Rosisë dhe vendeve perëndimore shfaqet te këto me diversitetin e vlerave, me hapjen ndaj kulturave joperëndimore, e që bëhen pjesë e traditës së kulturës evropiane. Ndryshe nga hapësira politike e kulturore e përcaktuar me traditën e regjimeve komuniste, brenda diturive dhe kulturave perëndimore u zhvilluan qëndrime e analiza kritike mbi shoqëritë perëndimore, e njëherësh edhe shqyrtime kritike të politikës koloniale ndaj Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine. Këto kritika u zhvilluan në qarqet intelektuale, në kërkimet shkencore, në botime, por edhe në krijimtarinë artistike, në veçanti në fushën e teatrit dhe filmit.

⁹ Friedrich Nietzsche, *Œuvres*, II, « Robert Lafont », Paris 1993.

Në anën tjetër regjimet komuniste në Evropë patën kultivuar gjatë decenieve ligjërime e përfytyrime të ngarkuara jo vetëm me paragjykime, por edhe me urrejtje e cila gjente shprehje në denigrimin e kulturës dhe politikës së vendeve perëndimore. Një version radikal i ligjërimeve të tilla u zhvillua nga makineria e propagandës së regjimit të Enver Hoxhës. Pas rënies së këtij regjimi filluan të shpalosen në shkrimet gazetareske, politike e letrare kritikët e para të ideologjisë së atij regjimi dhe të praktikave të dhunës së policisë së saj politike.

Mëria dhe urrejtja ndaj shteteve e shoqërive demokratike perëndimore u artikulua në hapësirën publike të këtyre vendeve edhe si mëri e urrejtje ndaj kulturës dhe dijes europaerëndimore. Njëra nga rrymat më agresive të këtyre orientimeve politike u artikulua më vonë, në ligjërimet e qarqeve majtiste « antiimperialiste » në Evropë e SHBA.

Në Francë këto konotacione ideologjike gjetën shprehje, fjala vjen, në mujoren « Le monde diplomatique ». Në njërën anë kjo gazetë kritikonte disa forma të përsundimit ekonomik të vendeve perëndimore në ish-kolonitë e tyre. Mirëpo, sa i takon çështjes së Kosovës « Le Monde diplomatique » për 20 -vjetorin e intervenimit të NATO-s kundër regjimit serb, kishte për kryeartikull të titulluar: « Gënjeshtra më e madhe e shekullit XX ». Ky artikull « shpjegon » se qarqet imperialiste të botës perëndimore bombarduan Serbinë e Milosheviçit, ngase ky i kundërvihet « rendit imperialist botëror ». Ky pohim shoqërohej me pohimin tjetër se « krimet e regjimit të Milosheviçit kundër shqiptarëve të Kosovës ishin « gënjeshtrë dhe shpifje e madhe ». Këtu shpërfaqet fryma dhe orientimi i kësaj politike « antiimperialiste »: shumë e ndryshme kjo nga kritika e imperializmit të Jean-Paul Sartre (*Të mallkuarit e botës*, Rilindja, Prishtinë, parathënia) ose sot, bie fjala, në librat dhe artikujt e Olivier le Cour Grandmaison në Francë. E ndryshme po kështu edhe nga kritika e socialdemokracisë serbe nga fillimi i shekullit XX mbi « politikën koloniale të Serbisë ». Tucoviç-i, Jovanoviç-i, Popoviç-i në studimet e tyre politike paralajmëruan para disa decenieve se ambicia koloniale e Serbisë « do të shkaktojë pasoja shkatërruese jo vetëm për Kosovën, por edhe për Evropën ». Këta autorë politikë dëshmuar një luciditet të thellë kur anticipuan agresionet ushtarake të Serbisë kundër Kroacisë, Bosnjës dhe Kosovës në decenien e fundit të shekullit XX. Kundër kësaj politike u mobilizuan pikërisht vendet perëndimore të BE-së dhe SHBA-ja. Intervenimi i tyre më i vendosur ushtarak u realizua më vitin 1999 kundër Serbisë dhe krimeve masive të saj kundër shqiptarëve.

Çlirimin e Kosovës nga Serbia Putini do ta paraqesë si lojë politike “djallëzore” kundër Serbisë dhe botës sllave në përgjithësi. Roli i vendeve

perëndimore ishte vendimtar jo vetëm për *çlirimin* e Kosovës, por edhe për *rindërtimin* dhe zhvillimin ekonomik, sikurse edhe në mbështetjen e shtetndërtimit dhe institucioneve të saj. Vendet e BE-së dhe SHBA-ja i bënë të mundur Kosovës ta realizojë pavarësinë e saj, të arrijë njohjen nga më se 100 shtete nga disa kontinente e njëherësh edhe anëtarësimin në një numër të konsiderueshëm të organizatave ndërkombëtare dhe në thurjen e bashkëpunimit ekonomik e kulturor me shumë vende në botë.

Shumica e madhe e partive politike dhe pjesa dërmuese e shqiptarëve të Kosovës e kishte kuptuar domethënien dhe rëndësinë e intervenimit të NATO-s dhe kishte shfaqur *mirënjohje* ndaj vendeve perëndimore për çlirimin e Kosovës, rindërtimin e saj, pavarësinë dhe krijimin e *lidhjeve të shumëfishta* me shumë vende të tjera në botë. Nuk ishte dukuri e rrallë kur shqiptarët e Kosovës, me rastin e rindërtimit të shtëpive që ua kishin djegur trupat serbe, mbi kulmin e shtëpisë së re vinin flamujt e SHBA-së dhe të BE-së. Këta shqiptarë nuk mendonin se me shprehjen e mirënjohjes ndaj vendeve aleate e humbnin « dinjitetin » e tyre. Përkundrazi, ata ishin të bindur se intervenimi i NATO-s kundër kundër Serbisë së Milosheviçit, si ngjarje e rrallë jo vetëm në historinë e shqiptarëve, meritonte *mirënjohjen* dhe respektin e nga ana e shqiptarëve.

Ndërkaq, *Lëvizja Vetëvendosje* shfaqti edhe në dokumentet partiake publike (*online*), gjatë viteve një qëndrim kundërshtues, të pakuptueshëm, ndaj këtij intervenimit të vendeve perëndimore. Disa vrojtues e analistë e kanë shpjeguar kundërvënien e saj ndaj intervenimit me ndikimin që ushtronin skemat ideologjike marksiste-leniniste të enverizmit dhe ato majtiste « antiimperialiste ».

Brenda tensioneve që i krijoi Serbia e Vuçicit muajve të fundit në veri të Kosovës, kryeministri Kurti ndonjëherë ishte i prirur që qëndrimet e veta, jo çdoherë bashkëpunuese me zyrtarët amerikanë e evropianë, t'i paraqesë si shprehje e brengës së tij për « sovranitetin » e Kosovës. Mirëpo, nuk mund të injorojmë faktin se rol vendimtar për *arritjen dhe mbrojtjen e sovranitetit* të Kosovës, përveç sakrificave të shqiptarëve të Kosovës, pati NATO-ja, përkatësisht aleanca veriatlantike, pra vendet perëndimore. Është e qartë qëmoti se ajo që i pengon ambiciet pushtuese të Serbisë ndaj Kosovës tani e 23 vjet është pikërisht kjo aleancë. Kjo u dëshmuar së voni edhe me *testimin* që presidenti i Serbisë Vuçiç i bëri NATO-s, tash së voni, kur u krijua një situatë e tensionuar lidhur me targat e veturave: ai e bëri publik mesazhin e tij se ushtria e Serbisë është në gjendje gatishmërie për të intervenuar në Kosovë me qëllim që « t'i mbrojë serbët e rrezikuar në Kosovë ». Mirëpo, përgjigja e qartë e NATO-s nuk vonoi: në një mesazh zyrtar kjo e njoftoi Shtatmadhorinë e ushtrisë së

Serbisë për planin dhe orarin operativ të ndërhyrjes së NATO-s, së pari ndaj vetë kreut të ushtrisë serbe nëse ai ndërmerr çfarëdo aksioni që do ta rrezikonte sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës. E përditshmja beogradase “Danas” botoi disa fragmente të mesazhit të NATO-s që shtatmadhuria e ushtrisë serbe ia dërgoi Vuçiç-it.

Së këndejmi, domosdoja e *kultivimit të marrëdhënieve të frytshme* me këto vende ka qenë evidente qëmoti për popullin e Kosovës dhe për zyrtarët e saj politikë. Kjo u bë aq më e qartë ngase shpresa dhe preokupimi kryesor i Serbisë është, që nga viti 1999, *si të dëmtohen* raportet e Kosovës me këto vende perëndimore.

Mu për këtë arsye, qeveria e Kosovës ka për obligim që të mos ndër-marrë qëndrime e veprime që mund të *dëmtojnë* raportet e Kosovës me vendet aleate dhe *interesat e saj themelore*. Në anën tjetër, vlen të ceket edhe rëndësia e përvetësimit të njohurive dhe praktikave të politikës ndërkombëtare nga qeveritarët; këto janë të domosdoshme pikërisht për mbrojtjen e sovranitetit dhe interesave jetike të Kosovës. Zaten, sovraniteti më së paku mbrohet me poza e gjeste që mëtojnë të duken si shprehje të « dinjitetit » dhe të « vetë-vendosjes » para militantëve të partisë.

PAVARËSIA PA NEGOCIATA?

Kufizimi i pozicionit të « vetëvendosjes » është shfaqur te parulla e cila doli në muret e Prishtinës, menjëherë pas çlirimit të Kosovës; e kam fjalën për parullën « Jo negociata, por vetëvendosje ». Parullë kjo që u formulua në kohën kur u bë e qartë se pavarësia e Kosovës do të jetë, në vitet që po vinin, një *proces kompleks* i ndërveprimit me diplomacitë dhe qeveritarët e vendeve të rajonit të Ballkanit dhe atyre perëndimore, e njëherit i bartur me projektin politik të ndërtimit të institucioneve të reja, krahas rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta. Të rikujtojmë se Kosova u çlirua në vitin 1999, ndërkaq pavarësia u shpall në Kuvendin e Kosovës më 2008: pra ishte fjala për një rrugëtim politik të ndërlikuar prej 9 vjetësh. Injorimi i kompleksitetit të këtij realiteti politik rajonal e ndërkombëtar shpërfaqet në parullën e cila na çliron nga mundi shumëvjeçar i negociatave.

Parulla « Jo negociata, por vetëvendosje » është frazë që përmban sa naivitetin politik, thjeshtëzimin e proceseve politike ndërkombëtare aq edhe patosin e afirmimit të një vullneti, i cili nuk është aq politik, ngase shpërfaq varfërinë politike; e kjo manifestohet edhe si një ekzaltim për një

« pavarësi » enveriste e simbolizuar me *bunkerin* si model i izolimit të thellë të një shteti e një populli.

Do ta ilustroja kufizimin e kësaj parulle me një fragment të një artikulli, të cilin e kam botuar në të përditshmen franceze « Le Monde » në kohën kur zhvilloheshin debate e diskutime për opsione të ndryshme të statusit të ardhëm të Kosovës. Fragmenti zë në gojën njëren nga vështirësitë që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare, më konkretisht me raportet të disa rrymave të fuqishme politike në Francë dhe në disa vende të tjera të BE-së ndaj Rusisë së Putinit: «... Së fundit, krerët e BE-së do të duhej të jenë të kujdesshëm që të mos përvetësojnë prizmin e Kremlinit në vlerësimin e situatës në Ballkan, e veçanërisht atë në Kosovë. Gjatë dhjetë vjetëve të luftërave në ish-Jugosllavi, veçmas disa qarqe diplomatike e politike franceze, me ngulm e ftonin Rusinë të jetë e pranishme në marrjen e vendimeve për ta dobësuar ndikimin e SHBA-së dhe Britanisë së Madhe në Ballkan. Kjo taktikë politike ishte e dëmshme edhe për Ballkanin edhe për BE-në. Mu për këtë, do të duhej evituar përsëritja e këtij gabimi. Putini, erdhi në pushtet, me rindezjen e luftës në Çeçeni, me shkatërrime të qyteteve dhe me masakra masive të popullsisë civile. Ai po mbahet në pushtet me vazhdimin e një politike të tillë. Këto fakte u rikujtuan në opinionin francez, edhe në manifestime protestuese, me rastin e ardhjes së fundit të Putinit në Paris. Pikërisht për të gjitha këto arsye, Putini nuk mund të jetë as këshilltar i mirë për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Sidomos kur vetë Putini i tërhoqi nga Kosova trupat e veta, ngase e kuptoi se aty nuk ka më ndonjë leverdi. Droja është se të njëjtat qarqe politike mund të kenë tundimin ta bindin Rusinë se mund të nxjerrë ndonjë dobi, nëse kundërshton propozimin për pavarësinë, që po kristalizohet në disa qarqe politike në Perëndim. Bashkësia Evropiane do të duhej të jetë në gjendje ta definojë qartë pozitën e vet e të mos ngashënjehet me propozime që mund ta kthejnë mbrapa e ta përkeqësojnë situatën në Ballkan, në afat të gjatë“.¹⁰

DOBËSITË E BE-së NË PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Duhet theksuar po kështu se aleatët e Kosovës, e në veçanti BE-ja manifestuan një varg dobësish në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, viteve të fundit. Në radhë të parë u bë e dukshme, tani e sa vjet, se asaj i mungonte zëri për të reaguar ndaj një politike gjithnjë e më agresive të presidentit të

¹⁰ Shih në *Çështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës*, ASHAK, Prishtinë, 2021.

Serbisë Vuçiç ndaj Kosovës. Ai nuk nguronte që në fjalimet e tij, drejtuar masave serbe, të bëjë elozhet e Milosheviçit (tek Ujmani, fjala vjen, si zonë kufitare me Kosovën). E njëherësh të kërcënojë për shkak të « rrezikimit permanent të serbëve të Kosovës nga shqiptarët ». Në fjalimet e tij ai përdorte skemat dhe « argumentet » e fjalimeve të Milosheviçit për gatishmërinë e tij që të ndërhyjë « për t'i mbrojtur » pakicat serbe në Kroaci, Bosnjë dhe në Kosovë. Në të njëjtën kohë ai kishte organizuar që më parë struktura paramilitare sebe, të cilat ishin të teledirigjuara nga Beogradi: agresionet ushtarake mbi ato vende do të shoqërohen me krime masive kundër civilëve joserbë, të cilat e tronditën botën.

Është e habitshme që zyrtarët e lartë të BE-së sot « harrojnë » zotimet që i morën paraardhësit e tyre ndaj Kosovës në vitin 1999, zotime që mbështeten në vlerat dhe parimet e saj. Të rikujtojmë se ishte presidenti i Francës Jacques Chirac, ai që shprehu fuqishëm arsyet e ndërhyrjes kundër regjimit serb: « Kemi marrë vendim t'i japim fund praktikave barbare të regjimit serb, spastrimeve etnike, masakrave dhe dëbimeve masive të shqiptarëve nga Kosova. Ai thekson se vendet perëndimore kanë vendosur t'i kundërvihen « vullnetit metodik » të regjimit serb « për ta zhdukur tërë një popull ». Këto praktika saktëson Chirac-u « rikujtojnë orët më të errëta të barbarisë. Sikur t'i pranohet këto praktika dëshmitarë të të cilave jemi, kjo do të thoshte të humbasim shpirtin tonë, të lejojmë që gangrena e të pathënshmes (« l'innommable ») të vendoset sërish në kontinentin tonë ».

Zyrtarët e sotëm të BE-së e kanë për obligim t'i kujtojnë angazhimet dhe qëndrimet që kanë marrë karshi Kosovës si shtet i pavarur dhe karshi perspektivës evropiane të Ballkanit. Nuk është mirë që dalin të prirur të fshihen mbrapa një roli thjesht « lehtësues » të dialogut. Përballë kërkesave dhe synimeve të hapura të presidentit të Serbisë për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës dhe ndryshimin e kufijve, zyrtarët e BE-së duhet ta artikulojnë një qëndrim të përgjegjshëm, i mbështetur në vlerat dhe parimet e saj të afirmuara. Aq më tepër pse BE-ja mblodhi guximin t'i kundërvihet këtë vit agresionit të Rusisë kundër Ukrainës; aq më tepër pse e dinë se rreth veriut të Kosovës është i pranishëm ndikimi i Rusisë në forma të ndryshme me qëllim të destabilizimit të Kosovës dhe Ballkanit.

ZVARRITJET PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES I KONVENOJNË VETËM SERBISË

Njëri nga konstatimet e shpeshta të vrojtuesve të raporteve Kosovë-Serbi sidomos në dy vitet e fundit, ishte se Serbia sistematikisht *kërkon*

situata që do ta prolongojnë së paku mundësinë e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse; pikërisht pse kjo marrëveshje do të implikonte anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe në organizata të tjera, pas njohjes që do të vinin nga pesë vendete e BE-së që nuk e kanë njohur ende Kosovën. Deputetja e Parlamentit Evropian e cila merret me Kosovën, zonja Von Cramon, ia tërhoqi vërejtjen qeverisë Kurti se duhet nxituar arritja e marrëveshjes me Serbinë, ngase brenda BE-së ka lëvizje e ndryshime politike, si rezultat i zgjedhjeve, dhe se këto mund të sjellin rrethana të pavolitshme për Kosovën. Të rikujtojmë se kryeministrja e sotme e Italisë, i takon një lëvizje postfashiste dhe se para disa vjetësh ajo kishte deklaruar se « Kosovën ia kishin vjedhur Serbisë disa vende perëndimore ». Është e qartë se Beogradi shpreson ndryshime të tilla politike në Evropë, nga të cilat do të dobësohej dukshëm mbështetja e vendeve perëndimore për Kosovën si shtet i pavarur dhe integrimin e saj në organizatat e tjera ndërkombëtare.

Milan Nic, ekspert i Evropës Juglindore në Këshillin Gjerman për Politikë të Jashtme me qendër në Berlin, në një intervistë për DW, vuri në pah situatën pozitive, të krijuar së voni me Procesin e Berlinit, në të cilin u arritën marrëveshjet e para midis Kosovës dhe Serbisë; njohja e letërnjoftimeve ishte më pas pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare të Tregut të Përbashkët Rajonal të Procesit të Berlinit, dhe pasi ajo të ratifikohet, do të bëhet e detyrueshme, pa u bojkotuar nga Serbia. « Tani, saktësoi Nic, është hapur një dritare për të gjithë rajonin, por veçanërisht për Kosovën, për t'u bërë pjesë e tij në nivel të barabartë me Serbinë përmes Procesit të Berlinit, përmes BE-së ».

Mirëpo, brenda kësaj situatë, z. Kurti krijoi krizën e targave të veturave, duke refuzuar kërkesën e përsëritur të vendeve aleate që zbatimin e masave për targat ta shtyjë për disa muaj; qëllimi i shtyrjes ishte që të krijohet hapësirë për bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë për planin franko-gjerman të një marrëveshjeje të përgjithshme midis Kosovës dhe Serbisë. Qeveria arsyetohej se vendimi i tij për targat ishte i ligjshëm. Diplomatat e vendeve perëndimore nuk e mohonin legjitimitetin e kërkesës për targa të Kosovës; por theksonin se në aspektin politik ky vendim do të shkaktojë një *përshkallëzim të situatës*, duke e marrë parasysh kontekstin konkret. Vuçiçi u përgjigj me tërheqjen e të gjithë serbëve nga institucionet e Kosovës e njëherësh edhe me vënien e ushtrisë serbe në gjendje gatishmërie. Nic-i vlerësoi, sikurse edhe disa diplomatë e zyrtarë të vendeve aleate se ky veprim i Beogradit ka për qëllim tani « ta shfrytëzojë çdo çështje që i mundëson atij të blejë kohë për të evituar një marrëveshje të përgjithshme me Kosovën » (nënvizimi ynë). Në anën tjetër, Beogradi

synonte që krizën e targave ta përdorë si shenjë alarmi, në sajë të mbështetjes së disa aleatëve të tjerë, që çështjen e serbëve të veriut të Kosovës ta rihapë në Këshillin e Sigurimit dhe ta krijojë mundësinë që OKB-ja ta marrë Veriun në juridiksionin e vet. Përballë këtij rreziku ishin diplomatët, ata që reagueshan në intervalin prej 48 orësh duke e penguar skenarin e Beogradit. Kosova ka nevojë për çdo marrëveshje diplomatike që avancon, shkon përpara, saktëson ekspertin gjerman. Ndërsa Serbia, shton ai, dëshiron të fitojë kohë dhe sipas kësaj formule, Kurti po i ofron asaj krizën e re në “një tabaka të argjendte”.

Së këndejmi, për interesat kyçe të Kosovës është që të mos zvarritet nënshkrimi i marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë, në mënyrë që të tejkalohet situata e pasigurisë në Ballkan, dhe që kjo zonë të orientohej në integrimin brenda BE-së. Kjo nënkupton që qeveria e Kosovës të mos ndërmarrë hapa politikë që mund t'i konvenojnë planit të Serbisë për izolimin e Kosovës. Aq më tepër pse edhe BE-ja në politikën e saj ndaj dialogut u shqua, gjatë disa vjetëve, me neglizhencë e zvarritje në përfundimin e procesit të dialogut Kosovë-Serbi; mu për këtë arsye përgjegjësia e qeverisë së Kosovës është edhe më madhe karshi situatës kur tani është sajuar një tekst i rëndësishëm i marrëveshjes gjithëpërfshirëse.

Mirëpo, lëvizja e fundit e kryeministrit Kurti me emërimin e z. Nenad Rashiç si ministër për Kthim në qeverinë e Kosovës doli të jetë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në fakt, pas vendimit të Kurtit, Vuçiç-i e anuloi pjesëmarrjen e vet në konferencën e Procesit të Berlinit në Tiranë. Kësisoj, ky dëshmoi sërish se i konvenon ta zvarritë, sa më shumë që është e mundur, arritjen e marrëveshjes me Kosovën. Bashkimi Evropian vlerësoi më 2 dhjetor se emërimi i Nenad Rashiçit – ministër për Kthim dhe Komunitete, një ditë më parë nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Ndonëse z. Rashiç është personalitet politik i cili ka kredibilitet në Kosovë. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në një konferencë për medie tha se është e rëndësishme që emërimet e ministrave të jenë në përputhje me aktin më të lartë juridik të Kosovës. Stano shtoi se vendet e BE-së vazhdojnë t'u bëjnë thirrje Kosovës e Serbisë « që të evitojnë veprimet që mund të çojnë në përshkallëzim të situatës në Kosovë ».

Në anën tjetër, u takon zyrtarëve të lartë të BE-së dhe SHBA-së që të bëjnë presion më të theksuar ndaj Serbisë dhe të frenojnë agresivitetin e saj ndaj Kosovës: siguria dhe paqja në Ballkan varen nga kjo.

RESUME

L'agression de la Russie sur l'Ukraine a provoqué un séisme géopolitique en Europe et en Occident plus généralement. Les dirigeants européens se sont réunis rapidement afin de réélaborer les principes de la souveraineté européenne ainsi que leur « autonomie stratégique ». Ils se sont mis d'accord de l'envoi urgent de l'aide militaire importante à l'Ukraine. Ils ont examiné également les mesures à prendre afin de faire face aux conséquences de l'agression russe pour la paix et la stabilité du continent européen; ainsi que celles qui concernent la conception d'une nouvelle stratégie énergétique. Ce qui a fait qu'on a assisté à un réveil brutal de l'Europe et de l'Occident en général face aux défis et menaces d'un régime autocratique et agressif. Le Président Macron et le Chancelier Scholz ont affirmé que par cette agression s'ouvre une ère nouvelle dans les rapports entre l'Occident et la Russie. Les pays occidentaux ont imposé à la Russie des sanctions sévères financières, commerciales, économiques et technologiques de l'Occident envers la Russie.

Dans l'analyse des mécanismes idéologiques du pouvoir autocratique de Putine, sont examinés les piliers du néosovjetisme, que devrait apporter une réponse à l'effondrement du pouvoir soviétique: la slavophilie, l'euroasiatisme, le conservatisme mais également l'orientation anti-occidentale. Cette agression massive sur un pays souverain européen ont rendu caduques les suppositions sur la « rationalité » des projets politiques du Kremlin envers l'Europe et l'Occident en général.

Dans cet article nous avons examiné les analyses des auteurs européens et américains sur les changements politiques en Ukraine, caractérisés par le caractère démocratique les dernières années et notamment: le pouvoir russe y voyait une contestation ouverte de la nature et de la logique de son système.

Nous avons examiné les conséquences que l'agression de la Russie sur l'Ukraine, et plus généralement des changements géopolitiques qui en ont été issus, pour les relations entre les pays des Balkans et plus particulièrement du Kosovo et de la Serbie.

D'une part ces changements ont secoué l'UE et provoqué plusieurs initiatives: la réaffirmation de l'idée de l'élargissement d'UE vers les Balkans occidentaux. Mais ceci exigeait une approche plus active sur de la question des relations entre la Serbie et le Kosovo: la Serbie qui considère la Russie comme allié traditionnel, a accepté de condamner l'agression

russe mais non pas pour autant d'établir des sanctions contre elle. Le Kosovo, par contre s'est solidarisé avec les mesures des pays occidentaux.

Mots clés: L'agression de la Russie, Ukraine, Souveraineté européenne, orientation anti-occidentale, l'accord Kosovo-Serbie.

Jean-Yves Tilliette

FACE AU MATIN DU MONDE: LES HOMMES DU MOYEN ÂGE DEVANT LA CRÉATION

Abstrakt

Në këtë artikull me titullin “TË ÇUDITURIT”, në sajë të disa krahasimeve që bazohen mbi etimologjinë kam dashur të vërë në pah se në çfarë shkalle të lartë të çuditurit për të moçmit ishte ngushtësisht i lidhur me vizionin. Për këtë vrojtim e kam gjetur frymëzimin në faqen e fundit të *Rrëfimeve* të Shën Augustinit. E tërë pjesa e fundit e kësaj vepre, refleksion i mrekullueshëm mbi vendin e njeriut në botë të cilin e mbanin gabimisht për një autobiografi, përbëhet nga komente të dendura të kaptinave të para të gjenezës së Dhjatës së vjetër. Ky zhvillim i vështirë analitik përmbillet me një përfundim, i mrekullueshëm letrarisht, mbi përsosmëritë e veprës hyjnore, të cilën e shënon anafora e foljes *videmus*, “ne shohim”. Është i njëjti shikim i drejtuar kah soditja dhe njohja e Zotit, pra e shpëlarë nga çfarëdo paragjykimi, që bartin mbi bukurinë e botës poetët e shekullit XI.

De façon bien maladroite, je vais commencer ce discours par une formule d'apparence cabalistique, que je ne suis pas sûr de bien prononcer ni même de bien comprendre:

L'alba par(t). umet mar. atra sol.

Poypas abigil. miracler tenebras.

Ces deux vers énigmatiques, qui ne sont plus tout-à-fait du latin, mais pas encore vraiment de l'occitan, ont fait couler des flots d'encre philologique, car, composés aux alentours de l'an mil, ils constituent l'un des tout premiers monuments de notre ancienne littérature. Je serais téméraire d'ajouter une traduction de mon cru à la vingtaine de celles qui ont été proposées par les savants, depuis la découverte en 1881 de ce refrain, accompagné d'une notation musicale, en queue d'un manuscrit du Vatican. On comprend qu'il y est question de l'aube qui point, de la mer qui s'enfle, du regard du veilleur qui voit le soleil dissiper les ombres de la nuit. Mais le contexte, profane ou sacré,

cosmique ou familier, échappe – ce qui prête à toutes sortes d'interprétations possibles. De façon plus rêveuse, je voudrais y faire résonner un mot, le verbe *miraclar*, où l'on entend admiration, clarté et, de façon étymologiquement plus solide, le miracle, *miraculum*. Pour certains lexicographes, *miraclar*, c'est « étonner », « troubler ». Ce mot, je voudrais qu'il serve d'emblème, ou d'enseigne, à un propos qui va concerner l'éveil du regard des hommes du moyen âge sur la merveille de l'univers créé.

Le siècle qu'inaugure le refrain de l'aube de Fleury, pour donner au chant dont sont tirés les vers que je viens de citer son titre conventionnel, à savoir le XI^e, passe aux yeux d'une ancienne et longue tradition historiographique pour faire suite à une période plutôt noire. Les dernières invasions barbares de l'Europe, la désorganisation politique consécutive au délitement de l'ordre carolingien, le marasme agricole générateur de famines, voilà ce que laisse entrevoir la plume des chroniqueurs du temps. Peut-être ce sombre tableau est-il à nuancer, si l'on considère que la plupart de ces écrivains sont des moines, qui ont décidé de s'abstraire du siècle où ils voient une constante menace de tentation, hanté comme il l'est par les forces multiformes du mal, physiques autant que morales. Une telle attitude se désigne elle-même comme de « mépris du monde » et s'en enorgueillit. Or, au tournant du millénaire, pour des raisons dans lesquelles il n'est pas utile d'entrer ici – retour d'un certain bien-être matériel, renouveau spirituel –, les regards paraissent se faire plus optimistes, et, oserais-je dire, naïvement étonnés sur un monde dont on s'avise qu'il n'est pas aussi intrinsèquement mauvais qu'on ne l'imaginait.

J'en prends pour premier témoignage un poème latin anonyme, composé semble-t-il vers le dernier quart du siècle dans le monde rhénan (il est difficile d'être plus précis). Pédant et mal bâti comme il l'est, ce texte, assez mystérieusement intitulé par les manuscrits *Quid suum virtutis* (on doit pouvoir traduire « Le propre de la vertu »), est loin d'être un chef d'œuvre. Mais il me paraît symbolique du retournement que je viens d'évoquer. Il se divise en effet en deux parties à peu près équivalentes. La première est pour déplorer le triomphe des vices, colère, envie, avarice et luxure, dont la littérature païenne de l'Antiquité a fourni trop d'exemples. Mais il existe aussi une bonne chanson, celle d'Orphée, dont les lettrés du temps font une figure de héros civilisateur. C'est lui le protagoniste de la seconde partie du poème, qui le met en scène en termes plutôt inattendus. L'anecdote en effet, la perte d'Eurydice, est expédiée en un distique. Ce qui retient

l'attention de notre versificateur, c'est le chant de deuil poignant et mélodieux qui va tenir sous son charme la nature entière. Tout le monde a vu ces mosaïques ou ces peintures figurant Orphée à la lyre entouré des bêtes sauvages que ses accents apaisent. Telle est la suggestion visuelle que va démesurément amplifier l'auteur du *Quid suum virtutis*. L'inventaire des êtres naturels, végétaux et animaux, tenus en respect par le chant d'Orphée se déploie sur près de mille vers. Quelques oiseaux, par exemple : « Et voici le coq de bruyère, le pélican, le francolin, le phénix sans égal, la mésange qui pullule (...), la grive, la chevêche, l'étourneau, le vautour au flair aiguïlé, le canard des rivières... » L'énumération se poursuit un bon moment, et fait peut-être encore plus d'effet en latin qu'en français : *Adveniunt ornix, onocrotalus, attagen, unicus et phenix, plurimus atque parix, turdela, nitedula, sturnus*... Au seul plaisir des sonorités, car je ne suis pas sûr que l'auteur ait une idée très précise de la réalité zoologique que recouvrent ces mots bizarres, voici l'entrée en poésie de vocables tirés des manuels d'histoire naturelle – singulier catalogue qui s'apparente peut-être à ce que l'abbé Bremond appelait la poésie pure. Tel l'Adam nomenclateur des commentaires à la Genèse, le poète appelle les êtres à l'existence en leur donnant un nom. Un siècle encore, et l'Occident va redécouvrir les traités d'Aristote sur les comètes et sur les animaux.

Je pourrais invoquer plusieurs autres exemples de cette poésie énumérative que j'appellerai édénique, car elle vise à reconstituer idéalement avec l'aide des mots le décor du jardin qui vit naître nos premiers parents. Les artefacts humains vont bientôt y trouver leur place eux aussi. Cela ressort notamment d'un texte, légèrement postérieur au précédent, dû à un certain Guy, chanoine d'Ivrée en Piémont, une des régions d'Europe les plus portées alors par l'essor de l'économie et des échanges. C'est un poème d'invitation. Et pour séduire sa bien-aimée, notre homme énumère sur plus de deux cents vers les cadeaux qu'il lui réserve si elle accède à ses désirs : les mets les plus choisis, les boissons les plus délicieuses, l'hospitalité de ses châteaux richement meublés, les plaisirs de l'esprit, grammaire et musique, ou encore, si elle préfère, un voyage en ville où le monde entier, en particulier le monde oriental, se donne rendez-vous pour y importer à son intention des biens de grande valeur, les tapis de Crète avec les toiles de Flandre, les bijoux de Phrygie et l'encens d'Arabie, des gemmes cueillies sur la tête d'un serpent (on est juste au moment où, avec la croisade, l'Europe renoue avec d'autres espaces).

Mon troisième exemple, datable lui aussi des environs de 1100, est d'un peu meilleure venue. On le doit en effet à un fin lettré, Baudri, abbé de Bourgueil en Anjou (une région accueillante aux « renaissances » littéraires), et il a servi de modèle à nombre de descriptions de demeures princières, y compris dans le roman de chevalerie en langue vulgaire. C'est un poème, toujours, adressé à une amie et protectrice, la comtesse de Blois Adèle, fille de Guillaume le Conquérant. Le prétexte à cette composition est la description de l'étonnant décor de la chambre de la comtesse : les murs sont couverts de tapisseries relatant l'histoire du monde, de sa création à la conquête de l'Angleterre par les Normands ; au plafond est peinte une carte du ciel, où ne manque pas une constellation ni une planète ; le pavement est couvert d'une mosaïque représentant les trois parties du monde, Asie, Europe et Afrique, chacune avec ses fleuves et ses montagnes, sa faune et sa flore ; enfin, le lit d'Adèle est entouré de statues d'ivoire et d'albâtre, figurant sous forme d'allégories féminines la philosophie et ses filles les sept sciences, ainsi que la médecine flanquée d'Hippocrate et de Galien. En quelque 1250 vers, c'est tout le savoir de l'époque sur le temps, le cosmos et l'espace, sur les nombres et sur le langage, sur les corps enfin qui se voit offert à la vue. Au moment où il franchit le seuil de la chambre, le poète s'exclame : « Je l'avoue, je fus abasourdi », *Obstupui fateor*. On le serait à moins...

Sous ces descriptions assez naïves, portées par des procédés littéraires plutôt rudimentaires, il me plaît de saisir – et voici que nous rejoignons notre sujet – le regard admiratif que recommence à fasciner l'enchanteresse diversité du réel, sur quoi le mépris du monde avait enseigné à fermer les yeux. Le premier trait qui caractérise pour moi ce que l'on appelle parfois la « renaissance du XII^e siècle », c'est la prise en compte, et la prise au sérieux, du verset final du premier chapitre de la Genèse, où Dieu, au soir du sixième jour, se retourne sur son œuvre, et en constate – oserai-je dire « en admire » ? – la bonté. *Vidit cuncta quae fecerat, et erant valde bona*, « Il vit toutes les choses qu'il avait faites, et elles étaient très bonnes ».

Dès lors, on commence à porter à celles-ci une attention passionnée. Et de préférence à toutes autres, à celles qui sortent de l'ordinaire. Le latin a un mot pour cela, le mot *mirabile*, que le français traduit « merveille », mais qui désigne d'abord, du point de vue de l'étymologie, ce qui est objet d'étonnement. Géographes et romanciers, philosophes et ethnographes partent alors en quête, chacun à sa manière, de *mirabilia*, et les offrent à leurs lecteurs. Au début du XIII^e

siècle, un de ces auteurs, Gervais de Tilbury, un des premiers laïcs à écrire en latin, propose ainsi, en tête d'une fort copieuse et fort hétéroclite collection de ce genre de phénomènes, dont il fait hommage à son maître, l'empereur germanique Otton IV, une définition assez précise du *mirabile* : par opposition au miracle, *miraculum*, qui s'exerce **contre** la nature, le *mirabile* est « ce qui échappe à notre compréhension, bien que naturel ; ce qui fait la merveille, c'est notre impuissance à rendre compte d'un phénomène », la salamandre qui vit dans les flammes sans être brûlée, l'imputrescibilité de la viande du paon, les fontaines pétrifiantes, les pierres qui guérissent, surtout si elles viennent de l'Inde... Le jour où l'on aura fini d'en rendre raison, le monde sera désenchanté. En un propos que l'on pourrait presque juger cartésien avant la lettre, Gervais conclut qu'à force d'être familière et quotidienne, la merveille finit par s'émousser et par perdre sa puissance d'étonnement. Aussi bien les contrées exotiques, où nous n'irons jamais, en sont-elles les plus grandes pourvoyeuses.

Si, selon la formule célèbre du *Théétète* de Platon, la philosophie est fille d'étonnement, le but de toute connaissance est-il donc de blaser cet étonnement, de fournir au bout du compte l'explication de tout ce qui défiait l'entendement ? Outre qu'un tel horizon d'attente est chimérique – nos confrères et consœurs de l'Académie des sciences nous le démontrent quotidiennement -, je ne suis pas sûr qu'une telle perspective soit celle où s'inscrit la pensée médiévale. L'étonnement suscite à la fois la curiosité **et** l'admiration, le désir de savoir **et** le besoin de louer. Je serais enclin à considérer que c'est pour cela que le moyen âge scolastique, qu'inaugure l'enseignement d'Albert le Grand, le maître de Thomas d'Aquin, un passionné de philosophie naturelle, lit Aristote avec tant d'enthousiasme : c'est en réalité qu'il en réoriente l'intention. Le but de la connaissance des êtres, à quoi introduit Aristote, est moins de finir par rendre compte de façon globale, à un horizon temporel indéterminé, de la structure et du fonctionnement de ces êtres, que de constater sur pièces et par l'observation la perfection multiple de l'œuvre divine.

Que nous dit en effet la merveille ? À cette question, Augustin, dont la pensée surplombe et informe toute la réflexion médiévale, apporte une réponse précise dans l'avant-dernier livre de la *Cité de Dieu*. Les objets naturels étranges sont là peut-être, expose-t-il, pour stimuler notre intelligence et notre volonté de comprendre la création – mais bien plus encore pour illustrer l'imagination prodigieuse du Créateur et en porter témoignage. En appelant à l'existence des êtres

qui paraissent offenser les lois de la physique, des objets dont la marche déroute et choque notre perception courante, Dieu offre la preuve irréfutable qu'il peut tout, même l'impossible ou ce qui nous semble tel, la pierre d'aimant, les sources qui bouillent à minuit, les juments de Cappadoce que le vent suffit à féconder. Dès lors, la distinction entre *mirabile* et *miraculum* à quoi tiennent tant les lexicographes (mais c'est leur métier de distinguer, on ne peut pas leur en vouloir) – cette distinction a quelque chose de forcé et de factice. Ainsi, plus que les êtres ordinaires, les monstres portent témoignage de la toute-puissance divine. Loin de constituer un accroc dans le tissu d'un univers que son créateur a organisé « en mesure, en nombre et en poids », comme le dit le livre biblique de la Sagesse, et qui est donc le lieu d'une harmonie géométrique parfaite, ils en sont le parachèvement. Les monstres montrent, comme le dit encore Augustin en conclusion du passage de la *Cité de Dieu* auquel je viens de me référer.

À partir de ce rapprochement fondé sur l'étymologie, je voudrais pour finir rappeler à quel point l'étonnement a pour les Anciens partie liée avec le visuel. C'est Augustin, encore, mais cette fois l'ultime page des *Confessions* qui m'inspire cette remarque. Toute la dernière partie de cet ouvrage, réflexion admirable sur la place de l'homme au monde faussement tenue pour une autobiographie, est constituée, je le rappelle, par le commentaire serré des premiers chapitres de la Genèse. Ce développement exégétique ardu s'achève par une récapitulation, littérairement superbe, des perfections de l'œuvre divine, que scande l'anaphore du verbe *videmus*, « nous voyons ». C'est le même regard orienté vers la contemplation et la connaissance de Dieu, donc lavé de toute prévention et de tout préjugé, que portent sur la beauté du monde mes poètes du XI^e siècle, en leurs vers parfois si médiocres.

Quelle que soit son origine étymologique réelle, au demeurant bien incertaine, le verbe latin *mirari*, d'où sortent « merveille » et « miracle », est perçu comme référant à la vision. Quand il passe en ancien français, « mirer » veut d'abord dire « regarder avec admiration », avant de signifier « regarder » tout court. Comme si l'admiration était inhérente à tout regard. Et le « miroir » qui sert de titre à bien des écrits médiévaux reflète souvent, on le sait, les réalités d'en-haut.

Le verbe grec qu'a traduit *mirari*, *thaumazein*, est chargé du même poids sémantique. On le fait découler du verbe homérique *théao-mai* / *théômai*, « contempler », « considérer ». Ainsi, c'est le regard porté sur les choses, le questionnement et l'émerveillement qu'il suscite, ce que notre confrère Michael Edwards appelle dans un beau livre «

thaumasie », qui, selon le mot de Socrate auquel j'ai déjà fait allusion, est à l'origine de la philosophie, de l'amour de connaître.

Mais de *théômai* procède également « théorème », l'évidence de la vérité, où peut-être on est en droit de deviner le chiffre de Dieu, l'équation parfaite qui, selon la théologie chrétienne, et déjà platonicienne, règle le mouvement harmonieux de l'univers. Du même verbe grec est enfin issu le « théâtre », conjonction du regard et du discours, le spectacle du monde et des hommes, le lieu par excellence où leur réalité essentielle se dévoile à nos yeux. Dans la dernière pièce de Shakespeare, *La Tempête*, le mage Prospero, déçu de la société des humains, en a soigneusement tenu à l'écart sa fille sur son île, Éden retrouvé. Celle-là, lorsque les circonstances de l'intrigue la mettent en présence des autres personnages, ne peut retenir à les voir l'exclamation naïve et extasiée :

« Merveille (*O wonder* – le mot anglais connote à la fois admiration et étonnement)! Que de gracieuses créatures sont ici assemblées !

Que l'Homme est beau ! Splendeur, le monde neuf (*brave new world*)
Qui contient de telles personnes ! »

Comme au poète de l'aube de Fleury, c'est l'enfance de l'univers qui se découvre à la jeune héroïne. Elle sait d'instinct reconnaître la beauté présente dans l'humain fait à la ressemblance de Dieu – celui-ci dût-il s'incarner, comme c'est le cas ici, dans de franches canailles. Est-ce un hasard si le poète lui a donné, à cette émerveillée, le nom de *Miranda* ?...

(Kumtesë e lexuar më 23 tetor 2018 në Paris, në konferencën e Pesë Akademive franceze, « L'étonnement »)

Jean-Yves Tilliette

Résumé

Dans cet article j'ai voulu mettre en lumière, à partir d'un rapprochement fondé sur l'étymologie, à quel point l'étonnement a pour les Anciens partie liée avec le visuel. C'est Augustin, encore, mais cette fois l'ultime page des *Confessions* qui m'inspire cette remarque. Toute la dernière partie de cet ouvrage, réflexion admirable sur la place de l'homme au monde faussement tenue pour une autobiographie, est constituée, je le rappelle, par le commentaire serré des premiers chapitres de la Genèse. Ce développement exégétique ardu s'achève par une récapitulation, littérairement superbe, des perfections de l'œuvre divine, que scande l'anaphore du verbe *videmus*, « nous voyons ». C'est le même regard orienté vers la contemplation et la connaissance de Dieu, donc lavé de toute prévention et de tout préjugé, que portent sur la beauté du monde mes poètes du XI^e siècle, en leurs vers parfois si médiocre.

Jens Oliver Schmitt, Vjenë

HYRJE NË DOKUMENTET ARKIVORE AUSTRO-HUNGAREZE PËR VILAJETIN E KOSOVËS 1870-1914

Kjo parathënie hyrëse e autorit është marrë nga botimi i dokumenteve austriake për Vilajetin e Kosovës: Politik und Gesellschaft im Vilayet Kosovo und im serbisch beherrschten Kosovo 1870–1914, Berichte der österreichisch-ungarischen Konsuln aus dem zentralen Balkan, Band 1, Oliver Jens Schmitt und Eva Anne Frantz (ed.) Wien 2020.

Raportet e konsujve të huaj, si nga fuqitë e mëdha ashtu edhe nga shtetet kombëtare ballkanike, kanë qenë prej kohësh ndër burimet më të përdorura për kërkime mbi epokën e vonë osmane në Ballkanin Perëndimor dhe Qendror. Meqë botohen katër vëllime të raporteve konsullore austro-hungareze nga Vilajeti i Prizrenit (1868–1874), Vilajeti i Kosovës (1877–1912) dhe për muajt e parë të administratës ushtarake serbe për periudhën nga 1870 deri në 1914, kjo ende kërkon një shpjegim. Së pari një vërejtje për kohën dhe hapësirën: sipërfaqja e raportimit të diplomatëve austro-hungarezë u bë sipas ndarjes administrative osmane, në këtë rast sipas vilajeteve në Ballkanin osman. Vilajeti i Kosovës përfshinte zona që dukshëm shkojnë përtej territorit shtetëror të Republikës së Kosovës sot. Në shtrirjen e saj të përcaktuar në vitin 1877, vilajeti përfshinte jo vetëm Kosovën e sotme, por edhe Novi- Pazarin, i cili sot i përket Serbisë dhe Malit të Zi, rajoni rreth Plavës dhe Gucisë, që sot i përkasin Malit të Zi, pjesë të Shqipërisë së sotme Verilindore dhe të Serbisë së sotme Jugore (rajoni i Preshevës), në veri dhe veriperëndim të Republikës së sotme të Maqedonisë dhe deri në vitin 1878 Sanxhakun e Nishit. Qyteti kryesor i vilajetit ishte fillimisht Prishtina, dhe që nga viti 1888 bëhet Shkupi.¹ Zona

¹ Në vitet 1874 deri në 1877 Sanxhaku i Prizrenit, Shkupit dhe Dibrës ishin pjesë e Vilajetit të Manastirit së bashku me Sanxhakun e Shkodrës dhe Manastirit. Përveç ndryshimeve të vogla territoriale dhe dhënies substanciale të territorit Serbisë në vitin 1878, vilajeti me këta kufij ekzistonte deri në Luftën e Parë Ballkanike. Krhs. për këtë Liman Rushiti, “Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878–1941”. Prishtinë 2004, 13–63; Hans-Jürgen Kornrumpf, Die Territorialverwaltung im östlichen

e raportimit mbulon kështu një zonë të madhe të pjesës kontinentale të Ballkanit osman, siç u paraqit pas ndryshimeve territoriale që u siguruan nga Kongresi i Berlinit (1878) në aspektin e së drejtës ndërkombëtare. Për sa i përket kohës, botimi lidhet me epokën e fazës së vonë të çështjes orientale, e cila përkoi me të ashtuquajturin imperializëm ekstrem, nga i cili nuk është rastësi që raportet austro-hungareze janë në dispozicion në një intensitet gjithnjë në rritje (1870–1913). Në përputhje me rrethanat, bëhet fjalë për përpjekjet e stabilizimit osman në periferinë veriperëndimore të Perandorisë, për konkurrencën bullgare-serbe për trashëgiminë e Perandorisë Osmane në rajon, reagimin e popullsisë kryesisht myslimane shqiptare, për formimin e identifikimeve etno-kombëtare, rreth një pranie masive të fuqive të mëdha evropiane dhe ndikimit joformal, përmes konsullatave, sistemit shkollor. Në këtë periudhë të raportimeve hyjnë ngjarjet e tilla si kriza e madhe në orient (1875–1878) dhe, në këtë kontekst, lufta serbo/malazeze-osmane në vitin 1876, zbatimi i dispozitave të Kongresit të Berlinit (1878–1881), lidhjet shqiptaro-myslimane të Prizrenit (1878–1881) dhe Pejës (1897), të cilat nga historiografia shqiptare konsiderohen si qendrore, si dhe lufta greko-osmane (1897). Pastaj pasojnë shfaqja e komiteteve sekrete maqedono-bullgare dhe Kryengritja e Ilindenit e shkaktuar prej tyre në vitin 1903, përpjekja për stabilizim nga fuqitë e mëdha pas marrëveshjes së Mürzstegut (1903, përmbysja xhonturke (1908), kryengritjet shqiptare të drejtuara kundër xhonturqve (1910–1912), dhe në fund rënia e sundimit osman në Luftën e Parë Ballkanike në vitin 1912 dhe vendosja e mëvonshme e sundimit serb deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Të gjitha këto pika kanë tërhequr për një kohë të gjatë interesimin për hulumtim brenda dhe jashtë rajonale.² Është edhe më befasuese që

Teil der europäischen Türkei vom Erlass der Vilayetsordnung (1864) bis zum Berliner Kongress (1878) nach amtlichen osmanischen Veröffentlichungen. Freiburg 1976, 183–184.

- ² Këtu janë të theksuara vetëm disa punime të përgjithshme; referencat për aspektet të veçanta mund t'i gjeni më poshtë dhe në bibliografinë në vëllimin 5. Botime të rëndësishme mbi historinë e Kosovës: Noel Malcolm, Kosovo. A Short History. New York 1998; Oliver Jens Schmitt, Kosovo. Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft. Wien, Köln, Weimar 2008. Mbi pikëpamjen shqiptare dhe serbe për historinë e Kosovës krhs. Dušan T. Bataković, The Kosovo Chronicles. Beograd 1992; Radovan Samardžić, Kosovo und Metochien in der serbischen Geschichte. Lausanne 1989; Jusuf Bajraktari u. a. (Hgg.), The Kosova Issue – A Historic and Current Problem (Symposium held in Tirana on April 15–16, 1993). Tirana 1996. Për përshkrimin e historisë së konfliktit shqiptaro-serb krhs. Konrad Clewing, Der Kosovokonflikt als Territorial- und Herrschaftskonflikt, 1878–2002. Chronologie und Beteiligte, në: Hermann Beyer-Thoma / Olivia Griesse / Zsolt Lengyel (Hgg.), Münchner Forschungen

kërkimet mbi Evropën Juglindore pothuajse nuk kanë nxjerrë ndonjë botim të raporteve konsullore në të kaluarën e afërt.³ Në fushën hulumtuese, që reagon fuqishëm përballë institucioneve financiare dhe intereseve të tyre, botimi i teksteve ka pasur pak vëmendje, veçanërisht në lidhje me historinë moderne. Përfjashtime të tilla, si botimi i dosjeve për Luftën e Krimesë, konfirmojnë rregullin.⁴ Burimet kryesore, siç janë raportet e diplomatëve të fuqive të mëdha evropiane, mund të merren me mend vetëm përmes filtrit të studimeve shkencore.⁵ Çdokush që dëshiron të kontrollojë këto rezultate duhet të shkojë në arkiv dhe të konsultohet me dokumentet origjinale. Kjo nuk vlen për projektet kërkimore brenda rajonit, pasi historianët shqiptarë dhe maqedonas kanë paraqitur vëllime të gjera të dokumenteve. Meqenëse këto kryesisht nuk riprodhojnë tekstet origjinale dhe ofrojnë vetëm përkthime, ato vështirë se mund të përdoren për kërkime jashtë një konteksti të ngushtë historiografik kombëtar, përveç pak kontrollueshmërisë së dyshimtë metodologjike të përkthimit.⁶ Duhet të

zur Geschichte Ost - und Südosteuropas. Werkstattberichte. München 2002, 181–214; Marco Dogo, Kosovo – Albanesi e Serbi. Le radici del conflitto. Lungro di Cosenza 1992; Miranda Vickers, Between Serb and Albanian. A History of Kosovo. New York 1998; Petrit Imami, Srbi i Albanci kroz vekove. Beograd 1998; Alex N. Dragnich / Slavko Todorovich, The Saga of Kosovo. Focus on Serbian-Albanian Relations. New York 1984. Për fundin e shekullit 19-të dhe fillimin e shekullit të 20-të krhs. Shukri Rahimi, Vilajeti i Kosovës më 1878–1912. Prishtinë 1969.

³ Një nga botimet e pakta është: Fatos Baxhaku / Karl Kaser (Hgg.), Die Stammesgesellschaften Nordalbaniens. Berichte und Forschungen österreichischer Konsuln und Gelehrter (1861–1917). Wien 1996. – Pothuajse fare të pa publikuara kanë mbetur gjitha dosjet gjermane në arkivin politik të Ministrisë së Jashtme gjermane (Politische Archiv des Auswärtigen Amtes). Një përjashtim dygjuhësor selektiv është bërë kohët e fundit (që në mënyrë domethënëse është në një nismë krejtësisht malazeze): Radoslav Raspopović / Konrad Clewing (Hgg.), Crna Gora i Njemački Rajh. Dokumenti iz Političkog arhiva Službe inostranih poslova u Berlinu, 1906–1914. Vëll. 1: 1905–1910. Podgorica 2016.

⁴ Winfried Baumgart (Hg.), Akten zur Geschichte des Krimkriegs. 4 Bde. München, Wien 1979–2001.

⁵ George Walter Gawrych, The Crescent and the Eagle. Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874–1913. London 2006; Nathalie Clayer, Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe. Paris 2007; Maurus Reinkowski, Die Dinge der Ordnung. Eine vergleichende Untersuchung über die osmanische Reformpolitik im 19. Jahrhundert. München 2005. Raportet e konsullatës serbe, ndër të tjera, përdorën në studimin: Miloš Jagodić, Srpsko-albanski odnosi u Kosovskom vilajetu (1878–1912). Beograd 2009.

⁶ Andrija Radenić (Hg.), Austro-Ugarska i Srbija 1903–1918. Dokumenti iz bečkih arhiva. 3 Bde. Beograd 1973; Marenglen Verli (Hg.), Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze (1877–1918): studime, analiza, dokumente. Tiranë 2014; i njëjti (ed.), Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912. 7 Bde. Tiranë 2012–2014; Muhamet Shatri (Hg.), Dokumente franceze për Shqipërinë dhe Shqiptarët më

theksohet në këtë pikë që raportet e konsullatës austro-hungareze për Vilajetin e Kosovës ofrojnë shumë më tepër sesa vetëm një pamje të kufizuar nga jashtë: në një rajon krize ku shtetësia osmane ishte shumë e kufizuar, konsullatat mbretërore dhe perandorake përfaqësonin një shkallë të gjendjes institucionale që tejkalonte produktivitetin dhe mbase edhe nivelin e informacionit të autoriteteve osmane. Për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me drejtuesit dhe përfaqësuesit politikë rajonalë, vetë konsujt nuk ishin vetëm vëzhgues, por edhe aktorë të mirinformuar dhe që informonin autoritetet e tyre në mënyrë adekuate.

Prandaj botimi i tanishëm e mundëson një qasje të drejtpërdrejtë në një koleksion thelbësor burimesh origjinale mbi Ballkanin Veriperëndimor osman të vonshëm. Megjithatë, ajo gjithashtu duhet të merret me rezervat që janë ngritur shpesh në lidhje me këtë lloj teksti, domethënë me pyetjen e anshmërisë së pikëpamjes konsullore. Çdo burim duhet të analizohet në mënyrë kritike në kërkimet historike. Është e qartë se raportet e konsullatës nuk përfaqësojnë një lloj të teksteve neutrale. Ato u krijuan në shërbim të shteteve të cilat, ashtu si Austro-Hungaria në rastin aktual, përfaqësonin interesat e veta të konsiderueshme në zonën e prekur dhe për këtë arsye përdorën burime të gjera për të mbledhur të dhëna mbi të cilat do të bazonin vendimmarrjen e tyre "vetjake" politike.⁷ Konsujt ishin të jashtëm, por ata ishin gjithashtu shpesh aktorë politikë me ndikim në një kontekst politik

1912. Prishtinë 2004; Ramiz Abdyli, Lidhja shqiptare e Prizrenit në burimet angleze (1878–1881). Prishtinë 2004; Skënder Rizaj (ed.), Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit (1877–1885) / English Documents on the Albanian League of Prizren and the Start of the Disintegration of the Balkans (1877–1885). 2 Bde. Prishtinë 1996 (këtu me një ribotim të dokumenteve origjinale britanike); Muhamet Shatri/Ramiz Abdyli (Hgg.), Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912. Prishtinë 2006; Cana Zekria (Hg.), Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912–1913. Dokumente. Prishtinë 1997; i njëjti. (ed.), Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe. Prishtinë 2008; Nevila Nika (ed.), Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910–1912). Prishtinë 2003.

⁷ Mbi politikën austro-hungareze të Ballkanit krh.: Hanns Dieter Schanderl, Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italiens 1877–1908. Wiesbaden 1971; Anna Hedwig Benna, Studien zum Kultusprotektorat Österreich-Ungarns in Albanien im Zeitalter des Imperialismus (1888–1918). Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs 7 (1954), 13–26; Franz-Josef Kos, Die politischen und wirtschaftlichen Interessen Österreich-Ungarns und Deutschlands in Südosteuropa 1912–1913. Die Adria-Hafen-, die Saloniki- und die Kavallafrage. Wien 1996; Emil Palotás, Machtpolitik und Wirtschaftsinteressen: der Balkan und Rußland in der österreichisch-ungarischen Außenpolitik 1878–1895. Budapest 1995; Jelena Milojković-Đurić, The Eastern Question and the Voices of Reason: Austria Hungary, Russia, and the Balkan States 1875–1908. New York 2002.

ndërkombëtar dhe rajonal. Shikimi i tyre fillimisht ishte drejtuar kryesisht nga jashtë mbi zonën e raportimit. Paragjykimet politike, përdorimi i kategorive të termave të definuar nga jashtë, mungesa e njohurive kulturore, të gjitha këto duhet të merren parasysh kur përdoren raporte të tilla. Prandaj ato, a duhet të përdoren vetëm në mënyrë dytësore në krahasim me burimet brendarajonale? Ky përfundim do të ishte i parakohshëm, veçanërisht në rastin konkret. Për Kosovën e vonë osmane, raportet e konsullatës austro-hungareze janë një burim i shkallës së parë. Kjo shpjegohet me faktet e mëposhtme: burimet osmane deri tani janë përdorur pak, pothuajse s'ka botime dhe vetëm në një masë shumë të kufizuar në kontekstin e punës kërkimore.⁸ Dhe edhe aty ku ishte bërë kjo, del e qartë se për sa i përket dendësisë së informacionit dhe cilësisë së analizës, diplomatët austro-hungarezë ishin dukshëm superiorë ndaj përfaqësuesve të shtetit osman. Kjo bëhet e qartë kur lexohet studimi i rëndësishëm i osmanistit Maurus Reinkowski mbi Shqipërinë Veriore osmane rreth mesit të shekullit XIX.⁹ Tani, perspektiva e autoriteteve osmane përfaqëson gjithashtu një perspektivë nga jashtë, ose të paktën nga gjysmë jashtë. Por kushdo që interesohet lidhur me burimet historike të teksteve brenda-rajonale, përkatësisht atyre që janë prodhuar nga komunitetet rajonale, në rastin e Kosovës do të hasë në pengesa të mëdha. Shkurt: nuk kemi pothuajse gati asnjë dëshmi të shkruar nga pala shqiptare. Në shekullin XIX nuk kishte asnjë shtyp rajonal shqiptar të qëndrueshëm në Vilajetin e Kosovës (as që mund të ekzistonte atje për shkak të kornizave të politikave osmane për gjuhët). Udhëheqësit politikë shqiptarë nuk lanë shënime të shkruara të kohës së re (disa nga kujtimet e pakta u shkruan pas një kohë të konsiderueshme pas ngjarjeve).¹⁰ Po të mos kishim

⁸ Krhs. për shembull veprat e Clayer dhe Gawrych të cituara tashmë. Botimet e përmendura: Dragi Ćorgiev (ed.), *Turski dokumenti za istorijata na Makedonija*. Popisi od XIX vek. 8 Bde. Skopje 1996–2015; Yusuf Sarıay u.a. (Hgg.), *Osmanlı arşiv belgelerinde Kosova vilayeti: Vilajeti i Kosovës në dokumentet arkivore osmane*. İstanbul 2007; H. Yıldırım Ağanoğlu (ed.), 1896 (hicri 1314) *Kosova Vilayeti salnamesi* (Üsküp, Prishtinë, Prizren, İpek, Yenipazar, Taşlıca). İstanbul 2000; Kujtim Nuro (ed.), *Dokumente osmane në arkivat shqiptare*. Tiranë 2000; Skënder Rizaj (Hg.), *Burimet turke (osmane) mbi luftën e shqiptarëve për pavarësi dhe humbje e Ballkanit (1908–1912)*. Prishtinë, İstanbul, Tiranë 1993; Kristaq Prifti (ed.), *Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878–1881*. Tiranë 1978.

⁹ Reinkowski, *Gjërat e rendit*.

¹⁰ Un interview avec Riza bey, *Albania A* (1897/98), 157–158; Bajazid Elmas Doda unter Mitwirkung von Franz Baron Nopcsa, *Albanisches Bauernleben im oberen Rekatat bei Dibra (Makedonien)*. Hg. Robert Elsie. Wien 2007; Fazli Hajrizi (Hg.), *Rexhep Mitrovica në lëvizjen kombëtare*. Mësues, publicist, ministër, kryeministër, reformator i arsimit, biograf, orator, letërkëmbës, patriot i kulluar. Prishtinë 2008; Elmas B. Plava,

të shënuara këtu protokollet e bisedimeve me liderët politikë shqiptarë (p.sh. III Nr. 164, 166), por edhe ankesat dhe peticionet (p.sh. II Nr. 45), do të dinim shumë më pak mbi reflektimet politike dhe shoqërore brenda shumicës shqiptare-myslimane të popullsisë. Gjithashtu duhet të kihet parasysh se përdorimi i shkrimit shqip prej myslimanëve u pengua dhe u shtyp nga qeveria osmane deri në vitin 1912 në shkallë të ndryshme intensiteti, në tërësi, ajo u pengua dhe përfundimisht u shtyp në një formë shumë të qëndrueshme (krhs. dok. IV Nr. 127) dhe se pala shqiptaro-myslimane në Vilajetin e Kosovës, veçanërisht pjesa veriore e saj, e cila në thelb përkon me Republikën e sotme të Kosovës, nuk tregoi pothuajse asnjë interes për t'u shprehur me shkrim në gjuhën amtare (krhs. dok. IV Nr. 27–29, 33).

Situata ishte më e mirë për ortodoksët, veçanërisht për popullsinë serbe:¹¹ Këta ngritën një sistem të veçantë shkollor dhe një sistem shtypi të vetin, megjithëse modest, që u mbështet nga "vendi amë" ose institucionet fetare lokale. Gazetat zyrtare osmane nga 1871 deri në 1888 u botuan në rajon në dy gjuhë; kjo do të thotë në gjuhën osmane dhe serbe.¹² Serbia mbante një rrjet të dendur misionesh diplomatike, raportet e të cilëve arrinin një dendësi të ngjashme të informimit me atë të diplomacisë austro-hungareze.¹³

Plava e Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Kujtime dhe dokumente historike. Hg. Marenglen Verli. 2. Aufl. Tiranë 2002; Tafil Boletini, Pranë Isa Boletinit (1892–1916) & Përballë sfidave të kohës (1916–1963). Hg. Marenglen Verli. 2. Aufl. Tiranë 2003; Hasan Prishtina, Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912. 2. Aufl. Tiranë 1995.

¹¹ Këtu ekziston gjithashtu një numër më i madh i burimeve vetjake. Kështu Janičije Popović, *Život Srba na Kosovu, 1812–1912*. Hg. Vladimir Bovan. Beograd 1987; Petar Kostić, *Crkveni život pravoslavnih Srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku* (sa uspomename pisca). Beograd 1928; i njëjti, *Prosvetno-kulturni život pravoslavnih Srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX i početkom XX veka* (sa uspomename pisca). Beograd 1933; Sima Andrejević Igumanov, *Sadanje nesretno stanje u Staroj Srbiji i Makedoniji*. Beograd 1882; Josif H. Kostić, *Oslobodenje grada Leskovca, Vlasotinca i okoline*. Hg. Dragoljub M. Trajković. Leskovac 1988.

¹² Në vitet 1871–1874 gazeta e vilajetit "Prizen" dhe nga 1877–1888 gazeta e vilajetit osman "Kosova", e cila atëherë dilte vetëm në gjuhën osmane. Që nga viti 1908 gazeta serbe "Vardar" doli në Shkup, organ partiak i "Organizatës së Popullit Serb në Perandorinë Osmane"

¹³ Krhs. botimet Milan Rakić, *Konzulska pisma 1905–1911*. Ed. Andrej Mitrović. Beograd 1985; Branko Peruničić (ed.), *Pisma srpskih konzula iz Prištine 1890–1900*. Beograd 1985; i njëjti (ed.), *Svedočanstvo o Kosovu 1901–1913*. Beograd 1988; i njëjti (ed.), *Zulumi aga i begova u Kosovskom vilajetu*. Beograd 1989; Jovan Pejić (ed.), *Milan Rakić na Kosovu. Zavet – pesma – čin*. Beograd 2006; Dokumenti o spoljnoj politici kraljevine Srbije, 1903–1914. Ed. Serbische Akademie der Wissenschaften und

Në krahasim me raportet diplomatike të fuqive të tjera të mëdha, analizat austro-hungareze janë të një rëndësie të veçantë. Fatkeqësisht raportimet ruse, në mungesë të një botimi, nuk mund të vlerësohen si duhet. Sidoqoftë, diplomacia e Monarkisë së Danubit kishte disa përparësi ndaj Britanisë së Madhe, Francës dhe veçanërisht Italisë.¹⁴ Diplomatat e saj u trajnuan në Akademinë Orientale posaçërisht për shërbim në Perandorinë Osmane.¹⁵ Monarkia kishte një traditë të specialistëve të trajnuar shumë mirë për Ballkanin, e cila u bë fusha qendrore diplomatike për ruajtjen e statusit si fuqi e madhe e të monarkisë tani të dyfishtë, veçanërisht pas largimit austriak nga Italia (1859/66) dhe Gjermania (1866). Një numër diplomatësh austriakë si Joseph von Hammer Purgstall, Anton Prokesch von Osten dhe Johann Georg von Hahn përfaqësojnë llojin e diplomatit që arrin suksese të larta shkencore qysh në gjysmën e parë të shekullit XIX.¹⁶ Diplomatat austro-hungarez luajtën një rol kyç në ngritjen e studimeve ballkanike.¹⁷ Por edhe diplomatët që nuk ishin aktivë

Künste. 7 Bde. Beograd 1980–2015; Gligor Todorovski, Srpski izvori za istorijata na makedonskiot narod 1890–1912. Skopje 1985; i njejt, Srpski izvori za istorijata na makedonskiot narod 1912–1914. Skopje 1979.

¹⁴ Krhs. botimet e dosjeve austro-hungareze, të cilat në një masë të vogël përfshijnë gjithashtu raporte nga Kosova: Actenstücke aus den Correspondenzen des kais. und kön. gemeinsamen Ministeriums des Äussern über orientalische Angelegenheiten, 1873–1881. 4 Bde. Wien 1878–1881; Österreich-Ungarns Außenpolitik von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914. Diplomatische Aktenstücke des österreichisch-ungarischen Ministeriums des Äußern. 9. Bde. Wien, Leipzig 1930

¹⁵ Akademia u themelua nga Maria Theresa në 1754 dhe fillimisht drejtohej nga jezuitët. Krhs. për këtë Oliver Rathkolb (Hg.), 250 Jahre – von der Orientalischen zur Diplomatischen Akademie in Wien. Innsbruck u. a. 2004; Erich Schlöss, Von den Sprachknaben zu den Anfängen der Orientalischen Akademie, Wiener Geschichtsblätter 56 (2001), 70–76.

¹⁶ Joseph von Hammer-Purgstall, Geschichte des osmanischen Reiches. Pesth 1833; Erinnerungen aus Ägypten und Kleinasien. 3 Bde. Wien 1829–1831; i njejt Denkwürdigkeiten und Erinnerungen aus dem Orient. 3 Bde. Stuttgart 1836–1837; i njejt Geschichte des Abfalls der Griechen vom türkischen Reich im Jahre 1821. 6 Bde. Stuttgart 1867.

¹⁷ Johann Georg von Hahn, Albanesische Studien. 3 Bde. Wien 1853; i njejt, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar im Auftrage der k. Akademie der Wissenschaften, unternommen im Jahre 1863. Wien 1869; i njejt, Reise von Belgrad nach Salonik nebst vier Abhandlungen zur alten Geschichte des Morawagebietes. 2. von der Kaiserliche Akademie der Wissenschaften genehmigte Aufl. Wien 1868; Theodor Anton Ippen, Novibazar und Kossovo (das alte Rascien). Eine Studie. Wien 1892; i njejt, Das Gewohnheitsrecht der Hochländer in Albanien, Zeitschrift für Ethnologie 33 (1901), 43–57, 352–363; Theodor Anton Ippen, Das religiöse Protectorat Österreich-Ungarns in der Türkei, Die Kultur 3 (1901/1902), 298–310; i njejt, Skutari und die nordalbanische Küstenebene. Sarajevo 1907; i njejt, Die Gebirge des nordwestlichen Albaniens. Wien 1908; i njejt, Beiträge zur inneren Geschichte Albaniens im XIX.

shkencërisht kishin njohuri për gjuhët orientale, ndonjëherë edhe për gjuhët rajonale, veçanërisht për shqipen. Kështu ata kishin qasje në sferën politike perandorake dhe rajonale që u ishte mohuar shumë vëzhguesve të tjerë të jashtëm. Sigurisht që shikimi i tyre vinte nga jashtë, por diplomatët austro-hungarezë shpesh arrinin një nivel të njohjes aq të dendur sa që antropologët sot do ta konfirmonin, edhe pse qëllimi i vëzhgimit ishte i menduar, natyrisht, për diçka tjetër. Prandaj, raportet e publikuara këtu shkojnë përtej një vrojtimi të thjeshtë nga jashtë dhe për më tepër mund të kompensojë pjesërisht edhe më shumë gjendjen e dobët të burimeve brenda rajonit. Në përputhje me rrethanat, ato jo vetëm që janë marrë parasysh nga hulumtimet për një kohë të gjatë për shkak të mungesës ose kufizimit të burimeve rajonale, por edhe për shkak të dendësisë dhe cilësisë së lartë të informacionit që përmbajnë. Prandaj botimi i tanishëm e ofron një qasje në burime qendrore jo vetëm në politikën e jashtme austro-hungareze, por edhe për administratën e vonë osmane dhe zhvillimin politik, shoqëror, fetar dhe gjithashtu ekonomik në periferinë veriperëndimore të Perandorisë Osmane.

Burimet gjithashtu fitojnë një vlerë shumë të veçantë për shkak të periudhës së gjatë të raportimit, e cila bën të mundur ndjekjen e ndryshimeve historike gjatë një gjysmë shekulli, dhe atë në një epokë që u karakterizua nga rritja e dinamizmit të rrethanave politike dhe më pak, më pak të atyre socio-ekonomike. Ky botim mund të përdoret në një sërë kontekstesh kërkimore. Por edhe në vetvete, edhe në këtë formë, paraqet një libër leximi të rrallë mbi Ballkanin e vonshëm osman. Dhe kjo lehtësohet edhe më tepër, se shumë nga konsujt posedonin gjithashtu aftësinë e një stili të gjallë dhe të qartë analitik që mund të jetë përfitues edhe për lexuesit që nuk kanë interesa të drejtpërdrejta kërkimore në këto tekste. Jo më pak të rëndësishme janë edhe tekstet gjithashtu të përshtatshme për mësim universitar, për të cilën periudhë të historisë së Evropës Juglindore të asaj

Jahrhundert, in: Ludwig von Thallóczy (Hg.), *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1. München, Leipzig 1916, 342–385; August Ritter von Kral, *Das Land Kamâl Atatürks. Der Werdegang der modernen Türkei*. Wien, Leipzig 1935; Alfred Rappaport, *Au pays des martyrs. Notes et souvenirs d'un ancien consul général d'Autriche-Hongrie en Macédoine (1904–1909)*. Paris 1927; i njejt, *Albaniens Werdegang*, *Die Kriegsschuldfrage* 5 (1927), 831; i njejt, *Die machtpolitischen Verschiebungen in Südosteuropa seit den Pariser Friedensverträgen 1919*. Berlin 1928; i njejt, *Montenegros Eintritt in den Weltkrieg*, *Berliner Monatshefte* 7 (1929), 948–949. Shikoni për më tepër monografinë gjithëpërfshirëse nga Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867–1918*. Wiesbaden 2018.

epoke aktualisht kemi në dispozicion vetëm disa botime të burimeve origjinale me një qasje të lehtë.

Së fundi, raportet e vëna në dispozicion këtu hapin një mori mundësish të reja për kërkime.¹⁸ Për herë të parë, është e mundur t'i hedhim një vështrim (analizë) politikës lokale, rolit të aktorëve lokalë në strukturën bazë të marrëdhënieve politike jo në nivelin perandorak. Pikëpamja rajonale e Perandorisë Osmane e hulumtuar nga osmanistët si Maurus Reinkowski - në këtë rast veçanërisht ajo e shumicës shqiptaro –myslimane, sidomos në pjesën veriore të vilajetit - mund të merret për më shumë se gjysmë shekulli. Dallimet e vogla rajonale shfaqen veçanërisht shumë qartë, për shembull midis rrafshinave dhe rajonit malor. Prizreni, për shembull, qyteti më i ndikuar nga osmanët në veri të Maleve të Sharrit, ishte gjithnjë i kërcënuar nga luftëtarët shqiptaro-myslimanë nga malësia e Lumës. Nga viti 1870, ashtu si edhe në vitin 1912, raportet e pushteteve ishte kryesisht të pandryshuara. Në rastin më të mirë, autoritetet osmane arritën t'i "kufizojnë" (Maurus Reinkowski) banorët luftarakë të malësisë. Kontrasti midis këtij qyteti më urban në pjesën veriore të vilajetit, i cili gjithashtu kishte një mirëqenie relativisht të konsiderueshme dhe zonave nganjëherë tejet të varfra malore, në të cilat grabitja ishte burim kryesor i jetesës, përplasen në rajonin e Prizrenit në një hapësirë shumë të vogël. Ndonjëherë lindin edhe kundërthënie midis qytetit të Gjakovës dhe maleve që e kufizojnë atë në perëndim, dikur për shkak të veprimtarisë grabitqare të banorëve malësorë, por veçanërisht kur fiset kodrinore katolike u mbështetën në Malin e Zi ortodoks për të ndërmarrë veprime kundër qytetit mysliman buzë malit. Por edhe brenda rrafshinave, dallimet midis qytetit dhe fshatrave ishin formësuese: që në vitin 1912 qyteti i Pejës dhe rrethina (kaza) mbajten një qëndrim të ndryshëm ndaj xhonturqve dhe kryengritësve shqiptarë që luftonin kundër tyre. Dikush mund të flasë – këtu e huazuar nga studimet mesjetare gjermane - për afërsinë dhe largësinë e Sulltanit, për praninë e përqendruar të Perandorisë Osmane në qytete me autoritete, poste xhandarmërie dhe, mbi të gjitha, garnizone ushtarake dhe për zona rurale në rrafshinat, të cilat vështirë se arriheshin nga institucionet perandorake. Një ndryshim tjetër që duhet theksuar është ai midis qyteteve. Aktualisht qendrat tradicionale urbane me ndërtesa qendrore tipike të kulturës urbane osmane, kryesisht nga koha e pushtimit

¹⁸ Krhs. Krahasoni kohët e fundit analizën e hollësishme të gërshetuar ngushtë me këtë botim, monografinë e cituar më sipër nga Eva Anne Frantz, përveç kësaj, veprat e cituara tashmë të Nathalie Clayer, Maurus Reinkowski wie auch bereits Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening, 1878–1912*. Princeton/NJ 1967, që i vlerësojnë raportet e konsullatës austro-hungareze.

ose shekullit të 16-të, ishin vetëm kryeqytetet e vilajetit, Shkupi dhe Prizreni. Peja, Gjakova, Mitrovica, Prishtina, Vuçitërna dhe Gjilani kishin vetëm një funksion lokal qendror të vogël rajonal si vende tregu me një pazar dhe vend të autoriteteve osmane, ku qytetet në Kosovën Lindore - Mitrovica, Prishtina dhe Ferizaji - lulëzuan në këtë periudhë të prekur nga botimi - për shkak të ndërtimit të hekurudhave. Të gjithë këto (qytete) u dominuan nga grupe sundimtarësh, të cilët konsujt i përshkruanin si të shquar (Notabel). Në shumë vende, këta udhëheqës kryesisht myslimanë shqiptarë bënë luftëra të ashpra të brendshme për pushtet, veçanërisht në Gjakovë dhe Prishtinë. Secili prej këtyre udhëheqësve të shquar kishte një trupë besnike të armatosur të veten. Ata ishin pronarë të tokave me ndikim me qasje në këshillat vendorë (meçlis) të ngritur gjatë reformave të tanzimatit, por edhe nga drejtues që udhëhiqnin ndjekësit që kishin forcuar interesat e tyre me forcën e armëve. Një shembull tipik të këtyre të fundit është Bajram Curri, udhëheqës i një grupi ndjekësish në Gjakovë, të cilin osmanët e caktuan si oficer të xhandarmërisë – kështu duke ndjekur një strategji të vjetër të kontrollit – dhe i cili për shumë vjet ndërmjetësonte mes organeve të Perandorisë dhe shoqërive lokale (IV Nr. 1), u pasurua personalisht përmes shantazheve dhe tatimeve qiradhënëse, gjë që tërhoqi vëmendjen e konsujve të huaj dhe në fund (1912) kalon te kryengritësit kundër qeverisë xhonturke.¹⁹ Aktivitetet politike të Haxhi Mulla Zekës gjithashtu mund të gjurmohen në shumë detaje, i cili më 1897 formoi një "lidhje" shqiptare në sfondin e luftës osmane-greke, e cila kishte karakter islamik dhe është parë me shqetësim nga austro-hungarezët. Një udhëheqës me përkrahësit e tij me më pak prestigj ishte Isa Boletini, njëherësh një grabitës, tani drejtues politik aktiv i grupit përkrahës të tij, i cili u financua përkohësisht nga Mali i Zi, para se t'u bashkohej kryengritjeve të mëdha shqiptare si Bajram Curri nga viti 1910 deri më 1912 që u bë hero i Lëvizjes kombëtare shqiptare përmes aftësive të tij organizative dhe guximit të konsiderueshëm personal në luftën kundër trupave osmane.²⁰ Në anën tjetër të spektrit të klasës së shquar qëndronte familja Draga në Mitrovicë, i cili jo vetëm që kishte përkrahës të fortë, por gjithashtu ndërtoi bizneset e saj, veçanërisht në industrinë e drurit, dhe madje e fusin edhe teknologjinë e kohës për këtë (shiko raportet IV Nr. 26, 28, 32–33, 53, 55, 69, 73, 75, 123, 132, 137, 147, 150–153). Përfaqësues të familjes Draga u zgjodhën në Parlamentin Osman pas vitit 1908, dhe ata

¹⁹ Burhan Çiraku / Muin Çami (Hgg.), Bajram Curri. Trajtesa e dokumente. Tiranë 1982; Skënder Drini, Bajram Curri. Tiranë 1984.

²⁰ Tafil Boletini / Marenglen Verli (Hgg.), Pranë Isa Boletinit (1892–1916) & Përballë sfidave të kohës (1916–1963). 2. Aufl. Tiranë 2003.

gjithashtu kishin kontaktet e tyre në politikën e jashtme, për shembull me Serbinë fqinje.²¹

Nga raportet e konsullatës mësohen shumë detaje lidhur me klasën e dytë dhe të tretë të politikanëve vendorë që janë të rëndësishme për të kuptuar këtë shtresë dhe në të njëjtën kohë vlerësimet e figurave që punojnë në prapavijë si Myftiu i Prishtinës, Mustafa Hamdi Efendi, i cili vdiq në vitin 1909 dhe i cili për dekada me radhë kishte vepruar si një personalitet me ndikim politik në mesin e shqiptarëve myslimanë (dok. IV Nr. 62). Këta politikanë lokalë jo vetëm që ishin në rivalitet me njëri-tjetrin brenda bashkësive të tyre urbane, por edhe qytetet ishin në rivalitet me njëri-tjetrin. Udhëheqësit politikë të shqiptarëve në rrafshina gjithashtu duhej të merreshin, siç u tregua, me strukturat e pushtetit në malësinë perëndimore, ku mbizotëronin strukturat fisnore; kjo do të thotë si bashkësi me prejardhje të njëjtë (duke e perceptuar veten si të tilla) me territorin e tyre, të përcaktuar qartë. Raportet e konsullore japin informacion në lidhje me këto struktura fisnore, veçanërisht kur bëhet fjalë për fiset katolike, të cilat ishin nën mbrojtjen e protektoratit kulturor austro-hungarez, sepse në këtë rast priftërinjtë vendas, por edhe argjipeshkvijtë katolikë vepruan si informatorë të diplomatëve të Monarkisë së Danubit (shih I Nr. 78, 110, 121, 125–126, II Nr. 119, III Nr. 5, 137, IV Nr. 171, 184). Për kohën prej gjysmë shekulli të paraqitur në këto vëllime, ndryshojnë pak strukturat e veprimit dhe të pushteteve midis udhëheqësve politikë në rrafshina dhe në male - besa, betimi për paqe mes shqiptarëve, u tregua si mjeti më efektiv për zgjidhjen e konflikteve. Bisedimet zhvilloheshin gjithmonë midis krerëve shqiptarë. Në rastet më të mira, përfaqësuesit e autoriteteve osmane punonin në prapavijë dhe shpesh ata nuk ishin fare pjesë e kontributit në zgjidhjen e konfliktit rajonal. Forca e besës si parim i rendit (dhe dobësia e parimit perandorak të osmanëve) provohet edhe si elastike veçanërisht në rastet në të cilat joshqiptarët, siç janë serbët ortodoksë, për shembull në Gjilan të Kosovës Lindore ose nga Mali i Zi i Shkupit, kërkonin besën për të zgjidhur konfliktet me shqiptarët myslimanë. Në vitin 1913 edhe administrata e pushtuesve serbë të Kosovës përdori gjithashtu besën për ta përvetësuar në anën e tyre popullatën e Malësisë së Gjakovës, për t'u bërë përshtypje fuqive të mëdha që negocionin në Londër për kufijtë shqiptarë, ku ishte e diskutueshme nëse (Malësia e Gjakovës) ishte pjesë e shtetit serb apo e shtetit të shpallur shqiptar në nëntor të vitit 1912, (IV Nr. 195).

²¹ Kujtim Nuro (Hg.), Hasan Prishtina (përmbledhje dokumentesh) 1908–1934. Tirana 1983.

Konsujt ishin të interesuar për të gjitha format e strukturimit politik në mjedisin e brendshëm shqiptar: besa, puna e këshillave të *meçlisit*, takimet joformale të njerëzve të shquar, mbledhjet e udhëheqësve të fiseve, tubimet e mëdha të shqiptarëve myslimanë të fushave dhe malesive në raste ngjarjesh vendimtare politike të viteve 1878, 1909 dhe në vitet e kryengritjes 1910/11 dhe 1912.²² Një histori politike e përqendruar tek aktorët politikë të shqiptarëve në Kosovën e vonë osmane, e cila ende nuk është shkruar, me këto raporte mund të arrijë një dendësi të konsiderueshme burimesh, për më tepër për shkak të shënimeve fjalë për fjalë që disponohen veçanërisht për fillimin e shekullit të 20-të të bëra për bisedimet midis konsujve dhe politikanëve kryesorë (si familja Draga në Mitrovicë apo edhe me drejtues në Shkup të cilëve nuk u ceket emri).

Raportet e konsullore gjithashtu trajtojnë në detaje aktorët e krishterë rajonalë. Nga njëra anë, kjo ndodhi në kuadrin e protektoratit të kultit, funksioni tradicional mbrojtës i Monarkisë së Danubit për katolikët në Ballkanin osman.²³ Sigurisht, raportet tregojnë se nuk kishte harmoni mes tyre dhe fuqisë mbrojtëse. Italia dhe Franca si fuqi mbrojtëse e katolikëve në Levant, bënë përpjekjet e tyre për të ndikuar, ku veprimet, në veçanti ato italiane, ndonjëherë i bënë telashe Monarkisë së e Danubit, pasi kjo e fundit kishte promovuar prej kohësh italishten si gjuhën e shkruar të katolikët (II Nr. 139).²⁴ Katolikët, megjithëse të paktë në numër, u përpoqën të vinin fuqitë e mëdha kundër njëri-tjetrit për përfitimet e tyre. Analiza e konsujve shkoi aq larg sa që një nga diplomatët më brilantë austro-hungarezë në vend, Alfred Rappaport, madje sugjeroi që Monarkia të heqë dorë nga protektorati fetar dhe të mbështesë plotësisht shqiptarët myslimanë - padyshim një nga mendimet më guximtare që i janë propozuar ndonjëherë një shkëlqesie apostolike, dhe kjo nga njëri prej diplomatëve të paktë në shërbimin austro-hungarez që ishte konvertuar nga judaizmi në katolicizëm. Katolikët dhe përfaqësuesit e tyre kishtarë, nga argjipeshkvi i Shkupit e deri te priftërinjtë e fshatit, megjithatë u drejttoheshin rregullisht konsujve për mbrojtje dhe ndihmë. Marrëdhënia u bë më e ngushtë, veçanërisht në prag të Luftës së Parë Ballkanike, kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e nxitur nga Monarkia e Danubit, gjithashtu mori tipare ndërfaqetare (jashtë fetare) – edhe pse me druajtje - në Vilajetin

²² Nathalie Clayer, Retour sur les « révoltes albanaises » de l'après 1908, Südost-Forschungen 73 (2014), 191–230.

²³ Engelbert Deusch, Das k.(u).k. Kultusprotektorat im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld. Köln, Weimar, Wien 2009.

²⁴ Schanderl, Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns.

e Kosovës, që do të thotë se shqiptarët myslimanë filluan t'i shohin shqiptarët katolikë si pjesë të një bashkësie kombëtare. Vilajeti i Kosovës gjithashtu përfshinte një bashkësi ortodokse shumë të fortë, veçanërisht në jug dhe lindje të Provincës së Madhe, me një shumicë në rritje drejt juglindjes. Mileti ortodoks nën Patriarkun e Kostadinopojës u nda gjatë viteve 1870 dhe 1913 në vija kombëtare dhe konsujt ndoqën nga afër këtë proces. Në vitin 1870 u krijua një njësi kishtarë bullgare me ekzarkatin. Çështja e përkatësisë në ekzarkat ose patriarkat shkaktoi konfliktin maqedonas,²⁵ i cili u shqyrtua në detaje në hulumtim, ku u përballën me njëri-tjetrin jo vetëm ekzarkistët dhe patriarkistët bullgarë. Situata u ndërlkua kur Serbia filloi brenda kampit patriarkist për të shtyrë ndikimin grek që mbante Patriarkana e Kostadinopojës dhe për të pushtuar metropolet në vilajet me kandidatë serbë.²⁶ Kjo shkaktoi një ndarje në patriarkistë midis serbëve dhe "grekëve", ku këta të fundit ishin arumunë, edhe në zonën e Kosovës së sotme (ku ndryshe për dekada të tëra nuk ka më gjurmë arumune të njohura), veçanërisht në Prizren, por edhe në Ferizaj (I Nr. 20, 24).²⁷ Propaganda kombëtare rumune që tërhoqte arumunët nuk depërtoi në pjesën veriore të vilajetit, nga ana tjetër për më tepër dallohet një ndikim i dobët i shteti kombëtar grek. Por edhe brenda grupit të shteteve sllave të interesuara në rajon kishte konkurrencë në lidhje me patriarkistët: Rusia e shihte veten si fuqi mbrojtëse e ortodoksëve, dhe jo përherë në koordinim me politikën e jashtme dhe kishtarë serbe. Kur në sfondin e ndikimit në rritje të Austro-Hungarisë dhe punës së suksesshme misionare të jezuitëve dhe françeskanëve në Ballkan, të cilët nxitën frikën brenda qarqeve ortodokse për konvertimin e mundshëm të popullsisë ortodokse në kishën katolike (uniata) greke, mitropoliti ortodoks i Rashkë-Prizrenit, Nićifor Perić, thirri murgjit rusë nga Manastiri Hilandar në kishën e Deçanit. Ata do duhej të marrin përsipër menaxhimin e manastirit dhe të mbështesin murgjit serbë atje në punën e tyre, si dhe të mbrojnë

²⁵ Fikret Adanır, *Die makedonische Frage. Ihre Entstehung und Entwicklung bis 1908*. Wiesbaden 1979; Vermund Aarbakke, *Ethnic Rivalry and the Quest for Macedonia, 1870–1913*. New York 2003; Basil C. Gounaris, *Steam over Macedonia, 1870–1912. SocioEconomic Change and the Railway Factor*. Boulder/CO, New York 1993; Stefan Troebst, *Das makedonische Jahrhundert. Von den Anfängen der nationalrevolutionären Bewegung zum Abkommen von Ohrid 1893–2001. Ausgewählte Aufsätze*. München 2007; Mehmet Hacısalıhoğlu, *Die Jungtürken und die Mazedonische Frage (1890–1918)*. München 2003. 27 Krhs. Jovan Hadži-Vasiljević, *Prosvetne i političke prilike u južnim srpskim oblastima u XIX v. (do srpsko-turskih ratova 1876.–78.)*. Beograd 1928.

²⁶ Krhs. Jovan Hadži-Vasiljević, *Prosvetne i političke prilike u južnim srpskim oblastima u XIX v. (do srpsko-turskih ratova 1876.–78.)*. Beograd 1928.

²⁷ Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 299–304; Kostić, Petar, *Cincarska naseobina u Prizrenu i crkva Sv. Spasa, Brastvo 19 (1925)*, 294–301

manastirin nga sulmet e grabitësve shqiptarë nga malet. Fraksioni rus i krijuar në Manastirin e Deçanit që nga viti 1904 u kundërshtua nga aktivistët kombëtarë serbë (III Nr. 88, 104, 120, 124). Rezistenca e ashpër nga serbët vendas nxiti gjithashtu përpjekjet për të instaluar malazezët ortodoksë në karriget metropolitane në vilajet (IV Nr. 126). Padyshim se më i dhunshmi ishte konflikti bullgaro-serb në rajon, veçanërisht në jug të maleve të Sharrit, me veprimtari të gjerë guerile nga të dy anët, të organizuar dhe të mbështetur nga shtetet kombëtare të Bullgarisë dhe Serbisë. Raportet e konsullore japin një pasqyrë në marrëdhënien e ndërlikuar midis aktivistëve kombëtarë ortodoksë rajonalë dhe shteteve të Ballkanit që qëndrojnë pas tyre dhe aktorëve osmanë. Perandoria Osmane tentonte të mbështeste elementin serb që ishte më i dobët kundër elementit bullgar, i cili dukej më kërcënues. Kjo aleancë e lidhur nën udhëheqjen e xhonturqve ishte bërë, se dëshironin t'i mbanin nën kontroll lëvizjet kombëtare shqiptare dhe bullgare. Në vitin 1912 kishte një bashkim shqiptaro-bullgar në fushatën zgjedhore osmane, veçanërisht në pjesën jugore të vilajetit kundër koalicionit elektoral xhonturko-serb, i cili u bë i pavlefshëm me sulmin e Serbisë në tetor të të njëjtit vit. Qasja e diplomatëve austro-hungarezë në punën e brendshme të organizatave aktiviste kombëtare bullgare dhe serbe ishte natyrisht më e vogël se në atë të mjedisit katolik. Ortodoksët gjithashtu rrallë kërkuan mbrojtje nga Monarkia e Danubit, veçanërisht pasi u krijua një rrjet përfaqësimi përkatësisht konsullor i dendur serb, bullgar dhe rus.²⁸ Ajo që është e jashtëzakonshme në këtë kontekst është ndoshta përpjekja në raste të rralla nga komunitetet ortodokse në pjesën veriore të vilajetit për të marrë mbështetje nga Monarkia e Danubit në prag të Luftës së Parë Ballkanike (IV Nr. 128). Për dallim të qasjes në mjedisin shqiptar, marrëdhëniet e ngushta personale me aktorët individualë, qofshin drejtues të kishës,

²⁸ Konsullatat serbe u hapën në Shkup më 1887 dhe në Prishtinë më 1889. Në 1889 u krijua një departament i veçantë i politikave kulturore në Ministrinë e Jashtme të Serbisë për zbatimin dhe koordinimin e "propagandës kombëtare". Në krye të saj u caktua Vladimir Karić, i cili në të njëjtën kohë filloi shërbimin e tij si konsull në Shkup. Krhs. Mihailo Vojvodić: Vladimir Karić, srpski konzul u Skoplju (1889–1892), Vardarski zbornik 1 (1999), 3–25; Đorđe Lopičić, Konzularni odnosi Srbije (1804–1918). Beograd 2007, 185–186. Russland eröffnete 1866 ein Vizekonsulat in Prizren, 1880 folgte ein Konsulat in Skopje und 1902 eines in Mitrovica. Krhs. Vladimir Boan, Jastrebov u Prizrenu (kulturno-prosvetne prilike u Prizrenu i rad ruskog konzula I. S. Jastrebova u drugoj polovini devetnaestog veka). Priština 1983; Vesna Sekulić, Otvaranje ruskog konsulata u Kosovskoj Mitrovici, Baština 19 (2005), 139–153. Përveç konsullatës në Shkup në Kosovën Bullgaria nuk kishte përfaqësimin e vet, por përmes ekzarkatit ajo pati këtu një ndikim të caktuar, të paktën në fund të shekullit 19. Krhs. Frantz, Gewalt und Koexistenz, 157–160.

udhëheqës apo anëtarët e parlamentit pas vitit 1908, ishin mjaft të rralla dhe mbizotëronte perspektiva e jashtme e të informuarit. Sidoqoftë në raporte vibron, veçanërisht nga fundi i shekullit të 19-të, një simpati e konsiderueshme për ortodoksët si të krishterë. Diplomacia austro-hungareze në Vilajet nuk ishte konsekuente me hezitime ndaj ortodoksëve.

Me interes të veçantë për diplomacinë austro-hungareze ishin tensionet brenda ortodoksisë në një mjedis kryesisht shqiptar, domethënë kryesisht në rajonin e sotëm të Republikës së Kosovës. Kjo pikëpamje e bën të qartë, për shembull, se edhe atje jo të gjithë sllavët ortodoksë të jugut rreth vitit 1870 duhet domosdoshmërisht të kategorizohen si serbë: ekzarkati i sapokrijuar bullgar shtrihet gjithashtu përtej maleve të Sharrit, dhe pa ndërhyrjen masive nga shteti serb - duke mbështetur sistemin shkollor, një rrjet konsullatash dhe një veprimtari bandash -, paqartësinë etno-kombëtare do të kishte përfshirë edhe popullsinë ortodokse sllave-folëse në veri të Maleve të Sharrit, që përndryshe është përdorur për popullsinë ortodokse sllave të Maqedonisë. Rënia e ndikimit ekzarkist rriti tensionet e përmendura tashmë brenda kampit patriarkist: veçanërisht midis arumunëve dhe serbëve, një konflikt që konsujt e ndoqën me saktësi nga afër (III Nr. 126). Jo vetëm në aspektin kishtar, por më së voni pas fitores së tyre në Luftën e Parë Ballkanike edhe politikisht, Serbia dhe Mali i Zi u bënë rivale me njëra-tjetrën në veri të Maleve të Sharrit. Mali i Zi sapo kishte krijuar lidhje të ngushta me fiset malore të veriut shqiptar dhe në mënyrë të përsëritur u referohej origjinës së përbashkët të fiseve shqiptare dhe atyre malazeze (III Nr. 143). Më herët dhe më me shkathtësi se Serbia, Mali i Zi i ofroi udhëheqësit shqiptarë nga vetja, të paktën përkohësisht, siç ishte Isa Boletini. Mali i Zi ishte veçanërisht aktiv në ato qytete relativisht afër kufirit që kufizoheshin me malet e larta, pra me Gjakovën dhe Pejën, të cilat diplomatët austro-hungarezë donin t'i frenonin në vend duke hapur një konsullatë në vitin 1897 (III Nr. 143-145). Konsujt vëzhguan fërkime midis shteteve sllave të jugut që nga vjeshta 1912, kur këto dy ishin të pranishme në rajon si fuqi pushtuese, për shembull në marrëdhëniet e tyre me popullsinë jo-ortodokse. Si Serbia ashtu edhe Mali i Zi u mbështetën në shtypjen masive represive kundër kryengritësve shqiptarë, por Mali i Zi ndryshoi nga Serbia në politikën e saj veçanërisht brutale të konvertimeve të detyruara të myslimanëve dhe katolikëve, prej të cilave u detyrua të heqë dorë vetëm më vonë dhe mbi të gjitha për shkak të presionit të Monarkisë së Danubit.

Natyrisht, konsujt austro-hungarezë ishin në kontakt të ngushtë me autoritetet osmane, qoftë me valiun (guvernator i përgjithshëm), mytesa-

rifët, anëtarë të këshillave të meçlis-it, por mbi të gjitha me oficerë komandues të ushtrisë osmane dhe gjeneralë të dërguar nga Stambolli posaçërisht për të zgjidhur çështjet politike. Numri i madh i protokolleve për bisedat e zhvilluara ofrojnë njohuri të çmuara në ato pjesë të të menduarit politik, që përfaqësuesit perandorakë osmanë donin t'ua komunikonin diplomatëve të huaj. Konsujt i plotësuan këto deklarata me mesazhe nga kanalet joformale, kështu që shfaqet një tablo shumë kuptimplote e aktiviteteve të qeverisë osmane në periferinë veriperëndimore të Perandorisë. Prandaj, dosjet mund të përdoren gjithashtu me interes për hulumtime mbi Perandoritë dhe krahasimi i perandorive, veçanërisht në çështjen e kufizimit dhe sundimit.

Edhe nëse konsujt ishin më pak të interesuar në detyrën e tyre të raportimit, me çfarë merret një "histori nga poshtë" sot, kështu që nga tekstet mund të përpunohen edhe elementet e rëndësishme të historisë shoqërore dhe ekonomike.

Ekziston ritmi sezonal i konflikteve politike - dimri si fuqi që i pushon luftimet e bandave, pranvera, e cila jo vetëm që vë në lëvizje bujqësinë, por shoqërohet edhe me shkëmbimet e para të zjarrit. Më të qarta bëhen prapavijat shoqërore të konflikteve rajonale, në veçanti pozita e fermerëve qiramarrës të krishterë të pronave të mëdha myslimane. Konsujt ndoqën nga afër ngjarjet në pazare, mbyllja e të cilave nënkuptonte një shprehje proteste dhe frike nga shpërthimet e dhunës. Por në përgjithësi, rëndësia e vogël e çështjeve ekonomike nuk duhet t'ju habit: në vitin 1870, si në 1914, bujqësia ushtrohej në nivelin më të thjeshtë në Kosovë; tregtia vështirë se bëhej përtej rajonit; përpunimi i produkteve me makineri ekzistonte vetëm në disa pika të caktuara (sharra e Dragës, disa mullinj). Ngecja e madhe ekonomike mund të nënkuptohet edhe nga heshtja e konsujve.

Në fakt *një* gjë që bie në sy gjatë leximit është një nga gjetjet mahnitëse: përsëritja e vazhdueshme e situatave të konfliktit pa ndryshime të rëndësishme strukturore gjatë një gjysmë shekulli të tërë. Autoritetet osmane nuk kishin qasje më të madhe në popullsinë rajonale në vitin 1912 sesa në 1870, pavarësisht nga fakti se ishte shterur një spektër i gjerë e instrumenteve të pushtetit. Zbatimi i juridiksionit perandorak, mbledhja e taksave, pohimi i monopolit shtetëror mbi përdorimin e forcës, rekrutimi i rekrutëve - këto ishin thelbi i grindjes midis autoriteteve osmane dhe besimtarëve myslimanë dhe armatosja praktikisht e papenguar e shumicës së privilegjuar të popullsisë së vilajetit. Reformat e Tanzimatit kishin depërtuar po aq pak në zonën e Vilajetit sa edhe në pjesën tjetër të provincave perëndimore osmane. Popullsia myslimane refuzoi deri në

shuarjen e Perandorisë të njëjte qytetarët e krishterë të sulltanit me të drejta të barabarta dhe ekuivalente. Edhe pse pjesëtarët e elitës që kishin frikë nga fundi i sundimit osman flirtuan me austro-hungarezët, popullsia myslimane në përgjithësi nuk e vuri në dyshim ligjshmërinë e sundimit të sulltanit, por vuri në dyshim legjitimitetin e veprimit të qeverisë osmane sapo kufizoi liritë tradicionale dhe privilegjet që kishin. Për qeverinë në Stamboll kishte një dilemë që kishte dalë në shesh më së voni që nga viti 1878: zbatimi i pushtetit qendror në rajonet periferike ishte pjesë e çdo reforme perandorake. Por kjo nënkuptonte ushtrimin e presionit masiv mbi popullsinë myslimane, e cila e perceptonte çdo reformë si një lojë në të cilën shumica e aksioneve, humbjeve dhe fitimeve është zero, veçanërisht kur Perandoria mëtonte të përmirësonte pozitën e të krishterëve. Ishte pikërisht kjo popullsi myslimane që i duhej qeverisë në Stamboll për të mbrojtur kufijtë kundër shteteve kombëtare të krishtera të Ballkanit, të cilat ishin qartë të rrezikuara më së voni që nga 1877/78, edhe në vetë rajonin më të ngushtë. Dukej qartë se Perandoria nuk mund të mbështetej në popullsinë e krishterë në këto rajone. Gjithashtu duhet kujtuar se, në veçanti, Sulltani Abdylhamidi krijoi lidhje personale besnikërie me shqiptarët sunitë të Vilajetit, të cilët shërbyen në truprojen e tij, si për të konsoliduar ndikimin e tij te shqiptarët po ashtu edhe për të mbrojtur veten nga sulmet nga mjediset e oborrit mysliman në Stamboll, prej të cilave ai gjithnjë kishte frikë.²⁹ Këto marrëdhënie të personalizuar dolën të ishin jashtëzakonisht të forta: prandaj xhonturqve iu desh të mashtronin masat besnike sunitë të Sulltanit në Fushë Kosovë në vitin 1908/9 në mënyrë që t'i mobilizonin ata në favorin e tyre për në mbledhjen e përgjithshme në Ferizaj.³⁰ Edhe në vitin 1912 kishte simpatizantë të konsiderueshëm të Sulltan Abdylhamidit ndër shqiptarët sunitë në veri dhe në jug të maleve të Sharrit, i cili ishte përmbysur nga xhonturqit. Bojkoti i Turqve të Rinj nga shumë myslimanë vendas u bë simbolikisht i qartë kur sulltani i ri nuk u kujtua në xhamitë e pjesës veriore të Vilajetit. Nga pikëpamja e Stambollit, ky veriperëndim i Vilajetit ishte një mbrojtje e vërtetë myslimane kundër Serbisë dhe Malit të Zi, pasi myslimanët përbënin

²⁹ Për Sulltan Abdülhamid II. krhs. Benjamin C. Fortna, *The Reign of Abdülhamid II*, in: Reşat Kasaba (Hg.), *The Cambridge History of Turkey*. Bd. 4: *Turkey in the Modern World*. Cambridge 2008, 38–61; François Georgeon, *Abdülhamid II. Le sultan calife (1876–1909)*. Paris 2003; Feroze A.K. Yasamee, *Ottoman Diplomacy. Abdülhamid II and the Great Powers, 1878–1888*. Istanbul 1996.

³⁰ Krhs. për këtë Kansu Aykut, *The Revolution of 1908 in Turkey*. Leiden, New York, Köln 1997; Peter Bartl: *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung (1878–1912)*. Wiesbaden 1968, 152–155; Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening, 1878–1912*. Princeton/NJ 1967, 343.

shumicën në Sanxhakun e Pazarit të Ri si dhe në zonën e Republikës së sotme të Kosovës. Kufiri me dy shtetet e Ballkanit ishte shumë i pasigurt. Grabitja e bagëtive ishte pjesë e jetës së përditshme, por nga fundi i shekullit të 19-të linja kufizuese midis bandave grabitëse dhe luftëtarëve të bandave politikisht aktive bëhet tejet e hollë. Pa mbështetjen e popullsisë lokale myslimane, perandoria nuk ishte në gjendje të qëndronte në zonën kufitare (III Nr. 153-155). Por në këto rajone kufitare u ruajtën veçanërisht strukturat arkaike shoqërore, sistemet fisnore dhe familjet komplekse si të shqiptarët myslimanë dhe tek ata katolikë,³¹ në Sanxhakun e Pazarit të Ri (si dikur në Bosnjë e Hercegovinë) mbizotërimi i pronarëve më të mëdhenj të tokave myslimane mbi fermerët qiramarrës ortodoksë.³² Gjërat ishin të ngjashme edhe në zonën e Mitrovicës. Perandoria Osmane nuk ishte në gjendje t'i zbuste këto tensione shoqërore, të cilat përkonin me ato fetare dhe, në rastin e shqiptarëve myslimanë dhe serbëve ortodoksë, gjithashtu me dallimet gjuhësore; nuk u tentua kurrë seriozisht për një përmirësim e pozitës së popullsisë së krishterë.

Por e njëjta popullatë myslimane, e cila, në thelb, mishëronte Perandorinë përballë shteteve të Ballkanit dhe nënshtetasve të krishterë të sulltanit, siç është përshkruar tashmë, kundërshtoi me rezistencë të vendosur ndaj çdo ndryshimi. Ndërsa e drejta zakonore shqiptare ishte praktikisht e vetmja që zbatohej në zonat e thella malore, pluralizmi ligjor ishte gjithashtu i zakonshëm edhe në rrafshina dhe në rajonet e tjera të Perandorisë Osmane. Këtu shpesh bashkëjetuan rregullat zakonore dhe shtetërore osmane gjatë gjithë gjysmëshekullit për cilin po flasim.³³ Nuk ishte rastësi që në kulmin e kryengritjeve shqiptaro-myslimane kundër xhonturqve në vitin 1912, kërkohej përdorimi i të ashtuquajturit Kanuni i Lekë Dukagjinit - ligji i maleve të veriut shqiptar qëndronte simbolikisht kundër çdo reforme si dhe kundër sistemit juridik osman të rrafshinës. Prania osmane në vilajet, e kuptuar si veprim i qeverisë në Stamboll, luhatet midis dështimit total të shtetit dhe ekspeditave të përgjakshme ndëshkimore, por rrallë u arrit një marrëdhënie e qëndrueshme midis autoriteteve dhe popullsisë rajonale. Perandoria ishte veçanërisht e pranishme

³¹ Krhs. Baxhaku / Kaser (Hgg.), *Die Stammesgesellschaften Nordalbaniens*, 12–22; Karl Kaser, *Hirten, Kämpfer, Stammeshelden. Ursprünge und Gegenwart des balkanischen Patriarchats*. Köln, Weimar, Wien 1992; Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 62–66

³² Për sanxhakun e Pazarit të Ri krhs. Mustafa Memić, *Poznat i Bošnjaci Sandžaka i Crne Gore*. Od Ahmed-paše Hercegovica i Vehbi Mehdi Šemsikadića do Rifata Burdžovića i generala Sefera Halilovića. Sarajevo 1998; i njëjti, *Bošnjaci (Muslimani) Crne Gore*. Podgorica 2003. Siehe auch Kenneth Morrison / Elizabeth Roberts: *The Sandžak. A History*. London 2013; Muhedin Fijuljanin, *Sandžacki bošnjaci*. Tutin 2010.

³³ Krhs. Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 103–104, 283–292.

përmes autoriteteve të sigurisë, ushtrisë dhe xhandarmërisë,³⁴ të plotësuar nga organizatat ndihmëse si fanët katolikë, emigrantët nga Shqipëria Veriperëndimore, të cilëve u lejohej të mbanin armët kundër shërbimit policor.³⁵

Nuk mund të nënvizohet sa duhet se shteti osman dështoi kur ishte fjala për politikën infrastrukturore dhe ekonomike. Jo më kot kryengritësit shqiptarë bënë kërkesa për zhvillim ekonomik në krahinë në vitet e fundit të sundimit osman. Për shumicën e banorëve të vilajetit, myslimanë e aq më pak të krishterë, Perandoria Osmane dukej si një institucion që kufizonte të drejtat zakonore dhe përpiquej të mbledhte taksa, por nuk ofronte në këmbim pak ose asgjë: siguria publike nuk u garantua kurrë në gjithë territorin për shkak të grabitjes endemike, rrugët ishin në gjendje rudimentare dhe linja hekurudhore nga Shkupi në Mitrovicë është ndërtuar për ushtrinë, jo zhvillimin ekonomik të rajonit. Dështimi i shtetit në arsim nuk ishte më pak i theksuar. Osmanët lanë pas një krahinë njerëzish analfabetë, në të cilën popullsia ushtronte bujqësinë pa ndonjë përparim teknik. Rezistenca e madhe e banorëve ndaj ndërhyrjes së shtetit mund të shpjegohet jo vetëm me tradicionalizmin e rrënjësor thellë, por edhe me paaftësinë e shtetit osman për t'i paraqitur një ofertë reformash edhe vetë popullsisë myslimane që do të kishte siguruar një ngritje në ekonomi dhe arsim. Jo kot Perandoria shfaqet përballë qytetarëve të saj në uniformë, pa futur respekt të qëndrueshëm të shtresa e madhe e popullatës së armatosur myslimane. Historia e Vilajetit të Kosovës, veçanërisht pjesa veriore e saj, në periudhën deri në vitin 1908 pati një luftë të vazhdueshme midis aktorëve myslimanë rajonalë - ata të krishterë u bënë pak më të rëndësishëm vetëm në fillim të shekullit të 20-të - dhe autoriteteve perandorake po ashtu myslimane. Këta nuk patën sukses në zbatimin e të drejtave shtetërore (tatim, monopol i pushtetit, zonë të njësuar ligjore,

³⁴ Vetëm gjatë reformave që nga mesi i shekullit të 19-të, shteti depërtoi në atë zonë më intensivisht, edhe këtu, rajonet rurale, veçanërisht ato malore u prekën shumë më pak. Krhs. Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 80, 108–112; Hasan Kaleshi / Hans-Jürgen Kornrumpf, *Das Wilajet Prizren. Beitrag zur Geschichte der türkischen Staatsreform auf dem Balkan im 19. Jahrhundert*, *Südost-Forschungen* 26 (1967), 176–238; Emin Pllana, *Kosova dhe reformat në Turqi (1839–1912)*. Prishtinë 1978. Për reformat në Perandorinë osmane krhs. Donald Quataert, *The Age of Reforms, 1812–1914*, in: Halil İnalcık / Donald Quataert (Hgg.), *An Economic and Social History of the Ottoman Empire 1300–1914*. Bd. 2: 1600–1914. Cambridge 1994, 759–943.

³⁵ Për fanët krhs. Eva Anne Frantz, *Catholic Albanian Warriors for the Sultan in Late Ottoman Kosovo. The Fandi as a Socioprofessional Group and their Identity Patterns*, in: Nathalie Clayer / Hannes Grandits / Robert Pichler (Hgg.), *Conflicting Loyalties in the Balkans: The Great Powers, the Ottoman Empire and Nation-Building*. London 2011, 182–201

rekrutim) për të siguruar vlefshmëri të përhershme. Ata zakonisht deshtuan për shkak të pengimit nga elitat urbane dhe rezistencës së armatosur në male, dhe kjo, edhe pse ata përdorën të gjitha kanalet e komunikimit, duke përfshirë tubimet tradicionale të udhëheqësve fisnorë dhe të shquar. Në vitin 1903, udhëheqësit politikë të pjesës veriore të Vilajetit, duke iu referuar ligjit zakonor shqiptar dhe ligjit fetar islam, refuzuan çdo reformë gjyqësore, pranimin e të krishterëve në gjyqësor dhe një monopol shtetëror, por në të njëjtën kohë theksojnë besnikërinë e tyre ndaj sulltanit dhe gatishmërinë e tyre për të siguruar vetë drejtësinë në vend (III Nr. 67, 69-71).

Banorët e malësisë, veçanërisht në rajonin e Lumës në perëndim të Prizrenit, madje sfiduan vazhdimisht kontrollin shtetëror mbi qytetet. Grabitjet nga luftëtarët e Lumës ishin pothuajse pjesë e jetës së përditshme në rajonin e Prizrenit: vetëm një ekspeditë ndëshkuese shkatërruese nga ushtria serbe në 1913³⁶ krijoi këtu një qetësi varri të përkohshme. Gjakovës i duhej t'i luftonte grabitjet nga malet aty pranë, prej fiseve Gashi dhe Bytyçi (III Nr. 144). Ndonjëherë garnizonet nuk ishin as në gjendje të parandalonin depërtimin e luftëtarëve fisnorë në qytete dhe luftimet në rrugë (III Nr. 25, 71-72). Edhe pse autoritetet osmane dërguan në mënyrë të përsëritur kolona trupash në male, ata duheshin përsëri të tërhiqeshin, gjë që dëmtoi përgjithmonë reputacionin e Perandorisë. Edhe kur kolonat arrinin në fshatrat në malësi para vitit 1908, ata nuk guxonin të shkatërronin bazën jetësore të fiseve kodrinore. Këtë e bëri Sulltani

³⁶ Krhs. për këtë dhe Luftën e Parë Ballkanike Leo Freundlich (Hg.), *Albaniens Golgotha. Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes*. Wien 1913, 9, 12–15; Dimitrije Tucović, *Serbien und Albanien: ein kritischer Beitrag zur Unterdrückungspolitik der serbischen Bourgeoisie*. Übersetzt von Amela Mirković. Beograd 1914; Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare, 1903–1913*. Prishtinë 2006, 434–452; Katrin Boeckh, *Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg. Kleinstaatenpolitik und ethnische Selbstbestimmung auf dem Balkan*. München 1996, 106–111; Liman Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore*, 13–80; Wolfgang Höpken, *Archaische Gewalt oder Vorboten des „totalen Krieges“? Die Balkankriege 1912/13 in der europäischen Kriegsgeschichte des 20. Jahrhunderts*, in: Ulf Brunnbauer / Andreas Helmedach / Stefan Troebst (Hgg.), *Schnittstellen. Gesellschaft, Nation und Konflikt in Südosteuropa*. München 2007, 245–260; Krisztián Csaplár-Degovics, *Der erste Balkankrieg und die Albaner. Ein Beitrag zur Geschichte der Unabhängigkeitsproklamation Albaniens (28. November 1912)*, *Südost-Forschungen* 67 (2008), 168–201. Für die serbische Sicht auf den Krieg siehe Vladimir Stojančević (Hg.), *Prvi balkanski rat. Okrugli sto povodom 75. godišnjice 1912–1987*, 28. i 29. oktobar 1987. Beograd 1991; Vladimir Stojančević (Hg.), *Prvi Balkanski rat 1912. godine i kraj Osmanskog carstva na Balkanu. Zbornik radova sa naučnog skupa održanog 27. i 28. novembra 2002. godine*. Beograd 2007; Bataković, *Kosovo Chronicles*

Mehmeti II në Shqipërinë e Mesme në vitin e largët 1466/67, sulltani i vetëm që kishte qetësuar të paktën përkohësisht malësinë shqiptare, por me koston e shkatërrimit dhe shpopullimit pothuajse total. 450 vjet më vonë, për arsyet e përmendura, qeveria në Stamboll në vend të kësaj përdori strukturat organizative shqiptare si ligat për të shmangur kërcenimet e jashtme (1878 dhe 1897) dhe ajo pranoi besën si parim për rend, sepse të dyja ishin elemente tradicionale shqiptare, por jo mjete apriori për përpjekjet e tyre kombëtare-shqiptare. Një konsull austro-hungarez gjithashtu konstaton në mënyrë faktike epërsinë e së drejtës zakonore mbi sistemin juridik osman (III Nr. 141).

Siç u tregua, sundimtarët myslimanë vendas vepruan si një rrip transmissioni midis Perandorisë dhe popullsisë myslimane. Ndryshon pak strategjia e vjetër e emërimit të "kontraktorëve të sigurisë" si oficerë policie (të llojit zhvatës dhe grabitës si Bajram Curri) dhe kufijve të lëngshëm midis grabitësve dhe xhandarëve. Në një rast, shefi i policisë së Gjakovës, i cili ishte i lidhur me grabitës, madje pushoi nga puna policët (I Nr. 81). Bajram Curri bëri që të zëvendësohet një polic korrekt në Prizren nga kushëririn e tij, një shantazhues famëkeq, (III Nr. 22). Udhëheqësit karizmatikë si Haxhi Mulla Zeka në kuadër të ashtuquajturës Lidhja e Pejës (1897) përmbushnin një funksion të ngjashëm (III Nr. 152). Abdylhamidi preferonte të qetësonte rebelët me poste, para dhe medalje (III Nr. 58, 219). Vetëm me xhonturqit, në radhët e të cilëve mbizotëronin oficerët, të cilët ishin shumë të frustruar nga dështimi i shtetit osman u përpoqën të thyenin çdo rezistencë ndaj politikave të tyre me përdorimin e forcës së madhe. Në vitin 1910 Shefqet Turgut Pasha bombardoi qindra kulla dhe dogji shtëpi, po ashtu depërtoi disa që nuk u bindën - por ai nuk guxonte ose nuk donte të ndiqte një politikë shfarosjeje si Mehmeti II ose, si do të bënin pas vitit 1912, ushtria dhe paramilitarët serbë (IV Nr. 82, 85). Kur Sulltani në vitin 1911 vizitoi Fushë Kosovën, ai shpërnda me dashamirësi kompensime për pronarët e shtëpive, duke pranuar kështu dështimin e politikës së shtypjes (IV Nr. 110).

Paratë për dhurata të tilla nuk mund të vinin nga rajoni. Për gati gjysmë shekulli të raporteve të shtypura këtu, shteti osman arriti vetëm pjesërisht të mblidhte taksa, dhe vetëm nëse zyrtarët e taksave e dinin që ata kishin mbështetje masive të trupave pas tyre. Kërkesat për trupa nga Vilajeti u refuzuan gjithashtu në Stamboll për shkak të besnikërisë së pa-sigurt të myslimanëve (III Nr. 31).

Nëse qeveria osmane vërtet donte të mobilizonte shumicën myslimane në veri të maleve të Sharrit, ajo e bënte këtë në emër të Islamit.

Strategjia e islamizmit³⁷ e promovuar nga Abdylhamidi në gjithë shtetin për të përfshirë myslimanët joturq në Vilajetin e Kosovës hasi në terren pjellor. Mobilizimi i rekrutëve u bë më herët, në vitet 1876/77, qartë me ndihmën e përkatësisë fetare dhe përmes përpjekjeve për të nxitur myslimanët kundër të krishterëve.³⁸ Pas pushtimit të Bosnjës e Hercegovinës nga Austro-Hungaria në vitin 1878, Vilajeti mori boshnjakë myslimanë si refugjatë, të cilët dolën të ishin myslimanë veçanërisht konservatorë dhe fillojnë të mendojnë të ktheheshin në atdheun e tyre të vjetër vetëm atëherë kur Perandoria Osmane u shemb në Ballkan. Njerëzit kryesisht shqipfolës myslimanët (muhaxhirë) që vërsuan drejt vilajetit në vitin 1877 nga rajoni midis Nishit dhe Vranjës, të pushtuar nga Serbia, intensifikuan një antagonizëm mysliman-ortodoks. Autoritetet osmane i vendosën në mënyrë specifike këto grupe në rajonet kufitare, gjithashtu për të dobësuar elementin ortodoks atje. Vetëmbrojtja lokale, frika e arsyetuar ekzistenciale kundër shteteve të krishtera dhe përvojat e shpërnguljes së myslimanëve çuan në faktin se myslimanët vendas me kënaqësi morën armët kundër shteteve fqinje të krishtera, nga 1876 kundër Serbisë ose gjithashtu 1897 kundër Greqisë (III Nr. 138, 139) - shërbimi ushtarak në Jemenin e largët, nga ana tjetër, ishte jopopullor. Gjatë luftës kundër Greqisë në veçanti, shtypi osman inkurajoi ndjenja të këtij lloji me kritika ndaj politikës koloniale britanike në Indi dhe Afganistan (III Nr. 144). Tashmë është referuar për lojalitetin ndaj Abdylhamidit edhe mbas largimit të tij. Ky mobilizim nën shenjën e Islamit funksionoi vetëm kundër armiqve të jashtëm ose popullsisë së krishterë; por nuk u mund të përdoret për zbatimin e reformave; përkundrazi, ajo pranoi nevojën për të forcuar forcat konservatore dhe sakrifikoi indirekt autoritetet vendore të orientuara pro reformës. Në rast të trazirave tatimore, zyrtarët tatimorë largoheshin nga zona (si në Sanxhak të Pazarit të Ri) ose duhej të fshiheshin në kazerma (në Pejë, III Nr. 14).

Një dështim i madh i Perandorisë është që nuk arriti të mbrojë popullsinë e krishterë nga sulmet e myslimanëve: në këtë situatë kontribuan pafuqia përballë sundimtarëve rajonalë dhe lokalë, por edhe indiferenca nga ana e anëtarëve të xhandarmërisë dhe të ushtrisë myslimane (III Nr. 23). Perandoria Osmane nuk bëri pothuajse asgjë, madje shumë vonë, për ta përvetësuar popullsinë e krishterë. Një nga këto pak

³⁷ Kemal H. Karpat, *The Politicization of Islam. Reconstructing Identity, State, Faith, and Community in the Late Ottoman State*. Oxford 2001; Quataert, *The Age of Reforms*, 766; Gawrych, *The Crescent*, 106–112.

³⁸ Shih për këtë Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 304–315.

përpjekje konsistonte në pranimin e të krishterëve në shërbimin e xhandarmërisë (III Nr. 92). Kjo ndezi protesta të zemëruara nga myslimanët të cilët e shihnin këtë si një poshtërim skandaloz. Në vitin 1903 pati incidente serioze midis rekrutëve myslimanë dhe xhandarëve të krishterë, të cilët u detyruan të strehoheshin në konsullatën ruse në Mitrovicë – në prapaskenën e tensioneve fetare dhe shoqërore të kryengritjes së Ilindenit të Maqedonisë në gushtin e vitit 1903 (III Nr. 78).³⁹

Katër vëllimet ofrojnë shumë materiale mbi historinë e dhunës në Ballkanin e vonshëm osman. Përshkrimi dhe analizimi i konflikteve ishte një nga detyrat kryesore të konsujve, kjo do të thotë se këto janë tekste në të cilat dhuna merr vëmendje të veçantë. Sidoqoftë, nuk është vetëm lloji i tekstit që kur e lexon të jep përshtypjen e dhunës së vazhdueshme. Deri në fund të sundimit osman, kishte forma të dhunës strukturore që ishin të natyrshme në sistemin osman: përkatësisht para së gjithash diskriminimi ligjor i ortodoksëve dhe katolikëve në sistemin juridik, por mbi të gjitha në jetën e përditshme. Siç u potencua, ato reforma që synonin trajtimin e barabartë të të krishterëve me myslimanët dominues nuk u zbatuan në Vilajetin e Kosovës, veçanërisht në pjesën veriore të saj. Myslimanët jo vetëm që gëzuan ato privilegje që ligji Hanefi u siguronte myslimanëve kundruall të krishterëve, por sundimi shekullor mysliman rezultoi në një habitus të caktuar superioriteti ndaj të krishterëve - veçanërisht ortodoksë – të cilët shiheshin dhe trajtoheshin si të nënshtruar, njerëz të klasës së dytë, të cilët në asnjë moment nuk kanë mundur të mbështeteshin në mënyrë konsistente në autoritetet perandorake myslimane. Dallimi vendimtar në jetën e përditshme, që përcaktonte pothuajse të gjithë marrëdhënien midis myslimanëve dhe të krishterëve, ishte privilegji i myslimanëve për të mbajtur armë. Duke pasur parasysh dobësinë dhe dështimin periodik të shtetit osman, kjo paraqiste një avantazh vendimtar për myslimanët. Posedimi legal i armëve ishte i pamundur për të krishterët, veçanërisht për ortodoksët në rrafshina. Edhe pse ortodoksët të paktën që nga vitet 1890 kishin armë në dispozicion duke i kontrabanduar nga Serbia dhe Mali i Zi, ata nuk guxonin t'i mbanin ato në publik. Vetëm fanët katolikë, që kishin emigruar nga malësitë e Mirditës Perëndimore shqiptare dhe, për të mbijetuar, nuk pranonin të dorëzonin armët në një mjedis kryesisht mysliman, u rekrutuan si policë ndihmës nga autoritetet osmane. Dhe ata gjithashtu duhej të mbroheshin në zonën e tyre të vendbanimeve veçanërisht kundër shumë sulmeve të rrethinës islamike-konservatore të regjionit të Gjakovës. Dhuna strukturore përshkoi marrëdhënien e tyre me

³⁹ Shih për këtë dhe për konfliktet e dhunshme gjatë rrjedhës së politikës reformuese osmane, Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 331–345.

Perandorinë Osmane si diskriminim i përhershëm si ndaj të krishterëve ortodoksë, ashtu edhe ndaj atyre katolikë. Rreziku për të rënë viktimë e dhunës fizike nga myslimanët ishte pjesë e jetës së përditshme për popullatën e krishterë. Pamundësia e lartpërmendur e Perandorisë Osmane për t'iu ofruar të krishterëve mbrojtje të përhershme dhe siguri ligjore në epokën e reformave ka diskredituar rëndë sistemin osman në sytë e nënshtrësve të saj të krishterë – pa e përmendur dështimin e saj edhe në ekonomi dhe infrastrukturë. Konsujt e Monarkisë së Danubit sipas detyrës zyrtare u morën edhe me dhunën e ushtruar kundër katolikëve. Ata përfshinin dhunën kundër ortodoksëve si pjesë të analizës së përgjithshme politike, por për këtë ishin përgjegjës Rusia dhe Serbia. Por edhe kur, nga fundi i shekullit të 19-të, Monarkia e Danubit u bëri thirrje shqiptarëve myslimanë si aleatë kundër përpjekjeve ekspansioniste serbe, diplomatët e tyre nuk i mbyllën sytë ndaj dhunës së shqiptarëve myslimanë kundër serbëve ortodoksë. Një konsull në mënyrë drastike e quante bezdisjen e të krishterëve si "sport kombëtar" të myslimanëve shqiptarë (IV Nr. 72). Konsujt kryesisht regjistruan raste të dhunës fizike, kjo do të thotë rastet e plagosjeve dhe vrasjeve, por më së shumti të rrëmbimeve, zhvatjeve, grabitjeve, punë të detyruar, poshtërimeve dhe frikësimeve të përditshme të të krishterëve nga myslimanët. Kjo ndodhni në zona të largëta nga prezenca e shtetit, me autoritete të njëanshme fetare, në një klimë të pandëshkueshmërisë së përhapur - dhuna endemike kundër të krishterëve është pjesë e dështimit të shtetit osman dhe arsyeja e rënies së sundimit osman në Ballkan. Kjo dhunë nuk ishte e motivuar krejtësisht nga pikëpamja fetare, ajo ishte vetëm pjesë e një zone të dhunës ku myslimanët përdorën gjithashtu dhunë kundër myslimanëve (duke filluar nga dhuna kriminale, kryengritjet kundër autoriteteve deri te represionet qeveritare). Sidoqoftë hendeku i cekur padyshim është i formuar nga kufijtë e grupeve fetar në aftësinë për të ushtruar dhunë dhe, nëse ishte e nevojshme, për t'iu përgjigjur asaj. Lakmia dhe nganjëherë edhe sadizmi i thjeshtë mund të ushtroheshin më lehtë përtej hendekut sesa brenda komunitetit mysliman vazhdimisht të armatosur. Aktorët e dhunës shpesh në situata anarkie vepronin si kundër kundërshtarëve myslimanë dhe atyre të krishterë, për shembull në vitin 1903, kur, gjatë një kryengritjeje në Lumë kundër një takse të re për bagëtinë, shqiptarët myslimanë ngacmuan fermerët ortodoksë serbë në rajonet fqinje në lindje, xhandarët e krishterë dhe trupat osmane (III Nr. 92). Diskriminimi kundër të krishterëve bëhet i qartë kur ata çarmatosen në vitet vijuese, po jo edhe myslimanët (III Nr. 114), gjë që

kishte rritur pamundësinë mbrojtjes së krishterëve, por që sigurisht nuk e kishte forcuar besimin e tyre tek autoritetet osmane.⁴⁰

Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme, çarmatimi i popullsisë myslimane ishte një provë e politikës perandorake osmane në Vilajetin e Kosovës: nuk kishte të bënte vetëm me një të drejtë të veçantë tradicionale, por, për më tepër, në zonat fisnore shqiptare me një atribut themelor të burrërisë dhe statusit shoqëror. Në këtë mjedis, çarmatimi nënkuptonte nderim, dhe me këtë edhe vdekje shoqërore. Osmanët nuk ishin në gjendje ta thyenin këtë kod kulturor. Përndryshe edhe të gjitha aksionet e tjera për çarmatim kishin dështuar, madje edhe ato me forcë brutale të bëra nga xhonturqit. Edhe këtu autoritetet osmane u përballën me dilemën se a do ishte dashur të çarmatosnin grupin më besnik në një rajon kufitar të ndjeshëm. Ata nuk ishin në gjendje ta bënin këtë në një kohë kur në mesin e ortodoksëve armët ishin të pakta, e aq më pak, kur nga fundi i shekullit XIX, gjithnjë e më shumë armë nga Serbia dhe Mali i Zi përfundojnë në duart e popullsisë ortodokse.⁴¹

Hulumtimi ka dashur të identifikojë spiralen e dhunës midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë që filloi me pushtimin serb të rajonit midis Nishit dhe Vranjës dhe dëbimit të myslimanëve shqiptarë (1877/78).⁴² Leximi i dosjeve tregon se kjo qasje është e shkurtër për sa i përket kohës: midis viteve 1870 dhe 1876 pati dhunë endemike nga myslimanët kundër të krishterëve dhe popullsia myslimane shkoi me entuziazëm në "luftën e shenjtë" kundër Serbisë në vitin 1876, jo pa kryer trazira masive kundër të krishterëve kur marshonin (I Nr. 31–36, 39–40).⁴³ Viti 1876 ishte një nga ato vite kur situata e sigurisë për të krishterët ishte më e pasigurt. Sunitët shqiptarë dhe ortodoksët serbë gradualisht u shfaqën si bashkësi konflikti, e cila ishte më pak e strukturuar nga një vetëdije kombëtare moderne, për më tepër përmestributeve të tilla si posedimi i armëve, feja, tradita ligjore, pozita në Perandorinë Osmane, edhe pse përkatësia gjuhësore luajti gjithashtu një rol. Shihet qartë se jo vetëm aspekti fetar, por edhe

⁴⁰ Shih për këtë edhe Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 105–106.

⁴¹ Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 149, 153–154; Popović, *Život Srba*, 168–169, 292; Vladimir Jovanović, Svetislav Simić i Makedonski komiteti, *Vardarski zbornik* 1 (1999), 53–68; Jovan Hadži-Vasiljević, *Četnička akcija u Staroj Srbiji i Mačedoniji*. Beograd 1928.

⁴² Sipas Clewing, *Der Kosovokonflikt als Territorial - und Herrschaftskonflikt*, 185–186, që vitin 1878 e përcakton fillim të konfliktit. Njëjtë edhe Dietmar Müller, *Staatsbürger auf Widerruf. Juden und Muslime als Alteritätspartner im rumänischen und serbischen Nationscode. Ethnonationale Staatsbürgerschaftskonzepte 1878–1941*. Wiesbaden 2005, 122, 128–138; Malcolm, *Kosovo*, 228.

⁴³ Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 304–315.

perceptime etnike për veten dhe të tjerët ishin efektive dhe u bënë të rëndësishme dhe mobilizimi i grupeve më të mëdha ishte i mundur duke iu referuar këtyre dy faktorëve.⁴⁴ Përderisa në rastin e serbëve, një sistem shkollor i tyre, i cili në thelb ishte ndërtuar nga Serbia, kishte një efekt kombëtarizues të paktën tek elitat, në rastin e shqiptarëve myslimanë, nuk mund të flitet për një kombëtarizim përmes konfliktit me Serbinë, Malin e Zi dhe serbët osmanë (për më shumë shih më poshtë). Në këtë drejtim, është e justifikuar klasifikimi i linjave të konfliktit në kategoritë e përkatësisë fetare, të cilat përshkruajnë kryesisht statusin shoqëror, jo dallimet në besim apo edhe veprimin e motivuar fetarisht në vetvete.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, raportet mundësojnë njohuri të thella në punën e rrjetit të konsullatës austro-hungareze dhe në politikën ballkanike të Monarkisë së Danubit. Interesi vetjak i Monarkisë, kryesisht për arsye prestigji për të ruajtur statusin e vet të fuqisë së madhe, ishte, siç u përmend, protektorati i kultit mbi institucionet e Kishës katolike dhe kështu edhe mbi popullsinë katolike që përbëhej nga shqiptarët, si dhe nga një pjesë e vogël sllave në lindje të Kosovës së sotme. Mbrojtja e kësaj të drejte të veçantë kalon si një linjë në raporte. Rastet më të vështira të sulmeve të drejtpërdrejta ndaj institucioneve katolike dhe personave të klerit katolik vinin nga autoritetet osmane, dhe nga vjeshta e vitit 1912 nga autoritetet serbe ose malazeze. Si një grup numerikisht i dobët, katolikët ishin gjithmonë të ekspozuar ndaj presionit të mjedisit të tyre, pavarësisht kush ishte në pushtet, myslimanët apo ortodoksët. Ndryshimin e besimit nga ana katolikëve në mënyrë të përsëritur e gjejmë të regjistruar para dhe pas tetorit 1912, dhe shpesh kjo bëhej me dhunë dhe detyrim. Në fakt, raportet tregojnë qartë se deri në prag të Luftërave Ballkanike ndihej pak toleranca fetare në Vilajet. Sidomos në zonat e thella malore, fshatrat katolike ishin kryesisht të pambrojtur kundër presionit të popullsisë me shumicë myslimane. Karakterin e një fushate e marrin konvertimet e detyruara vetëm nga vjeshta e viti 1912, dhe kjo nën sundimin e ri ortodoks, veçanërisht në veriperëndim të vilajetit, të cilin e kishte pushtuar Mali i Zi, por edhe në zonat nën sundimin serb.⁴⁵ Në vitin 1913 Austro-Hungaria u gjend veçanërisht e sfiduar nga konvertimet masive të katolikëve në ortodoksë, të detyruar

⁴⁴ Mbi raportet mes perceptimeve etnike dhe fetare krhs. Frantz, *Gewalt und Koexistenz*, 202–224.

⁴⁵ Krhs. Leo Trotzki, *Die Balkankriege 1912–13*. Essen 1995, 144–150, 297–303; Jaša Tomić, *Rat na Kosovu i Staroj Srbiji 1912. godine*. Novi Sad 1913; *Dokumenti o spoljnoj politici kraljevine Srbije, 1903–1914*. Hg. Serbische Akademie der Wissenschaften und Künste. Bd. V/Heft 3: 5/18. oktober–31. decembar 1912/13. januar 1913. Bearb. Mihailo Vojvodić. Beograd 1986, 245.

nga autoritetet malazeze, të cilat u bënë në prani të argjipeshkvit katolik të Shkupit, i cili nuk kishte mundësi të ndërhynte. Aktorët malazezë ishin gjithashtu të vetëdijshëm se me këtë po sfidonin Monarkinë e Danubit, kështu që kjo e fundit e festoi si një sukses të veçantë prestigji tërheqjen përfundimtare të Malit të Zi në këtë çështje. E parë nga sot, Monarkia e Danubit perceptohet si fuqia mbrojtëse e shqiptarëve, dhe në vjeshtën e vitit 1913 ishte në të vërtetë në prag të luftës me Serbinë për shkak të kufijve veriorë dhe lindorë të shtetit shqiptar. Megjithatë kjo pikëpamje është e kufizuar. Siç u përmend, as shqiptarët katolikë nuk dolën të ishin klientë vërtetë të besueshëm. Kjo vlente edhe më pak për myslimanët shqiptarë. Shumica dërmuese e tyre do të kenë parë një fuqi mbrojtëse në Austro-Hungari vetëm pas rënies së Perandorisë Osmane. Raportet e bëjnë të qartë se shumica dërmuese e myslimanëve, qofshin shqiptarë apo sllavë, ndiheshin besnikë ndaj Sulltan Kalifit në Stamboll. Austro-Hungaria u pa në mënyrë kritike nga myslimanët për shkak të politikës së saj në Bosnjë. Kur Monarkia e Danubit filloi forcimin e lëvizjes kulturore shqiptare në fund të shekullit të 19-të në mënyrë që të ndërtonte gradualisht kombin e vet shqiptar, ajo u ndesh me moskuptim dhe refuzim nga myslimanët kryesisht sunitë të vilajetit. Për dallim nga Shqipëria e Veriut (rajoni i Shkodrës), dështon krijimi i një sistemi të qëndrueshëm shkollor shqip, si dhe përhapja e shqipes si gjuhë e shkruar edhe pasi autoritetet osmane lejuan pjesërisht veprimtarinë përkatëse shqiptare nga viti 1908 deri pak para Luftës së Parë Ballkanike; gazetat shqiptare të shpërndara nëpër konsullatat e Monarkisë së Danubit nuk gjenin pothuajse asnjë lexues. Nga ana tjetër Monarkisë i bëhej presion kur qeveria osmane i bënte thirrje popullsisë për solidaritet fetar islamik. Gjithashtu nuk duhet anashkaluar se lëvizjet masive politike të shqiptarëve (1878, 1897, 1909) shpesh kishin një karakter konservator-sunit, edhe pse nga jashtë prezantoheshin si ndërfetare dhe ndikimi i Monarkisë Austro-hungareze ishte i kufizuar. Kjo është një qasje tjetër e rëndësishme kërkimore që prek çështjen e zhvillimit të identifikimit kombëtar në Kosovën e vonë osmane, si tek ortodoksët, katolikët po ashtu edhe te myslimanët. Tashmë i jemi referuar copëtimit të milletit ortodoks. Këtu vetëm duhet të thuhet edhe një herë se ndikimi bullgar në rajonin e Kosovës së sotme në vitet 1870 ishte më i fortë nga sa ishte supozuar më parë, që ortodoksët sllavishtfolës nuk duhet të nënkuptohen automatikisht si serbë. Por gjithashtu dhe veçanërisht për paraqitjet stereotipike të historisë kombëtare shqiptare, vëllimet në dispozicion përmbajnë shumë materiale, që mbështesin dhe kërkojnë riinterpretime. Sepse ato tregojnë se deri në fund të periudhës së paraqitur këtu, ideja kombëtare si një ideologji e veçantë, siç ishte zhvilluar nga aktivistët

shqiptarë toskë të jugut, gjeti pak mbështetje nga shqiptarët myslimanë të vilajetit (III Nr. 106; IV Nr. 27, 33, 39, 53, 75).⁴⁶ Ka raporte të shumta në të cilat konsujt theksojnë mungesën e përgjigjes nga shqiptarët myslimanë rajonalë ndaj propagandës kombëtare shqiptare. Nga pikëpamja e shumicës dërmuese të shqiptarëve myslimanë, por edhe katolikë, kjo ishte thjesht e panëvojshme; siç konstatojnë disa konsuj, shqiptar ishte ai që mbante armë, ishin myslimanë dhe flisnin shqip (I Nr. 2, II Nr. 36). Një ideologji e përpunuar kombëtare ishte e panevojshme kur tjetri rajonal ishte aq lehtë për ta njohur - ortodoks, i paarmatosur, sllavo-jugor. Rëndësia e islamit për vetëperceptimin e shqiptarëve myslimanë në Vilajet është e qartë, megjithëse kishte një lidhje mes islamit dhe të qenit shqiptar, po që kishte një lidhje mes islamit dhe të qenit shqiptar, e lidhur me gjuhën, të drejtën zakonore dhe zakoneve. Pikë fikse në nivelin lokal ishte fisi, familja e zgjeruar dhe rrjetet personale, por në aspektin politik, besnik ndaj Sulltan Kalifit në Stamboll. Paragjykimet kundër të krishterëve ishin të thella dhe lehtë mund të instrumentalizoheshin politikisht. Shqiptarët myslimanë në brendinë e Ballkanit ishin një shoqëri rajonale osmano-muslimane e cila vetëm me vështirësi e kuptoi ndryshimin e shpejtë të ekuilibrit të fuqive, në rastin më të mirë u rezistojnë ndryshimeve të çdo lloji dhe, në veçanti, nuk u ofrojnë të krishterëve osmanë as koncesionin më të vogël. Konstatimi i cituar më parë nga një konsull se torturimi i të krishterëve është një "sport kombëtar" shqiptaro-musliman (IV Nr. 72) vë gishtin në pengesën qendrore për reformën në Perandorinë e vonë Osmane: ndjenja e pakapërcyeshme e superioritetit të myslimanëve ndaj të krishterëve, e cila duke pasur parasysh dobësinë e autoriteteve potencialisht mund të shprehej në çdo kohë me forcë - dhe kryesisht pa sanksione. Modelet e perkatësisë fetare megjithatë mbivendosen gjithashtu me modelet e perceptimit etnik, social dhe raj

Në këtë sfond ideja kombëtare shqiptare e zhvilluar në diasporë dhe në ato pak qarqe intelektuale të Shqipërisë Adriatike që kërkonte integrimin në një tërësi kombëtare mbifetare, ofroi pak nxitje për shqiptarët myslimanë të Vilajetit. Shqiptarët katolikë dhe myslimanë nuk e përjashtuan politikisht Malin e Zi dhe Serbinë si partnerë të mundshëm – duke mos qenë ende në gjendje të dinë se regjimi pushtues malazez i viteve 1912–1914 do t'i trajtojë katolikët pjesërisht më keq se myslimanët, kështu që të parët i ofrohen përsëri më afër Austro-Hungarisë. Ajo që u përfshi në idenë kombëtare shqiptare në kuptimin e një ideologjie të përpunuar dhe të formuluar në Vilajet ishte e kufizuar në qarqe të vogla, në veri të Sharrit në teqenë e dervishëve të Gjakovës, në jug të maleve në disa aktivistë në Shkup. Idesë kombëtare shqiptare si ideologji i mungonte baza sociale dhe kulturore-mendore, me përjashtim të Hasan Prishtinës, nuk kishte ndonjë udhëheqës intelektual të shquar në pjesën lindore të zonave të vendbanimeve shqiptare. Mungesa e një personeli drejtues të shkolluar vlen për shqiptarët myslimanë në Kosovë në përgjithësi. Bëhej fjalë kryesisht për pushtetmbajtës rajonalë ose lokalë, të cilët ishin të prirur për korrupsion; prandaj, herë pas herë drejtuesit si Isa Boletini apo Idriz Seferi bashkëpunuan me Malin e Zi dhe Serbinë. Kjo elitë e armatosur kishte kryesisht mungesë interesimi dhe kuptimi për një çështje programore kombëtare; në rastin më të mirë, ata mund të bindeshin që të përfshinin mësimin në gjuhën shqipe dhe shkollave shqipe në katalogët e tyre të mëvonshëm të kërkesave, por kjo nuk e kishte kurrë vlefshmërinë përballë atyre kërkesave që përbënin thelbin e politikës shqiptaro-muslimane dhe të cilat për më shumë se gjysmë shekulli gjithmonë ritheksoheshin: jo taksës, jo monopolit të pushtetit shtetëror, jo gjyqtarëve të huaj, jo regjistrimit, ndërsa pro *home rule* sipas së

botim i ofron lexuesit, si dhe përdoruesit qasje të rëndësishme në kushtet politike, sociale dhe kulturore në zonën kryesore të Ballkanit Osman në një të tretën e fundit të shekullit XIX deri në Luftën e Parë Botërore, për konkurrencën midis të mëdhenjve dhe fuqitë rajonale dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, për një histori kulturore të diplomacisë austriake-hungareze.

Arsim Ejupi, Hivzi Islami, Prishtinë

GJEOPOLITIKA SI FUSHË SHKENCORE DHE INTERES TERRITORIAL DJE DHE SOT

Abstrakt

Artikulli përmban një vështrim mbi definimin dhe zhvillimin e gjeopolitikës si disiplinë shkencore, mbi objektin dhe kategoritë kryesore të studimit, si dhe rolin e pozitën e saj në kuadër të sistemit të dijeve dhe shkencave. Në mënyrë kronologjike përmenden autorët dhe teoricienët, disa prej të cilëve madje merren si nismëtarë dhe themelues, që kanë vendosur shtyllat konceptuale studimore të kësaj discipline. Sot jemi dëshmitarë të përdorimit të gjerë të nocionit të gjeopolitikës, i cili del përtej narracionit të ngushtë shkencor dhe merr përmasa popullarizuese, por shënon përdorim jo gjithëherë të drejtë dhe adekuat. Prandaj, duke shpjeguar nocionet themelore gjeopolitike synohet të mundësohet përdorimi i duhur dhe i drejtë i tyre. Në kuadër të procesit të gjatë të pavarësimit si disiplinë e veçantë shkencore, kishte periudha kur gjeopolitika ka shërbyer si doktrinë për ndërmarrjet ekspansioniste, të mbështetura në premisa racore të cilat kanë rezultuar me luftërat e përmasave botërore, me shumë viktima në njerëz dhe shkatërrimeve materiale, çfarë ishte ajo e Gjermanisë naziste në dekadat e para të shek. XX. Ambiciet gjeopolitike të fuqive të mëdha, që synojnë pushtimin dhe zgjerimin e territoreve në mënyrën më të vrazhdë, gjejnë terren në rajonin e Ballkanit, i cili, kryesisht për këtë arsye, sot e gjithë ditën mbeti i pastabilizuar dhe me tensione e konflikte ndëretnike. Ndërmarrjet e hapëta gjenocidale në rrafshin demografiko-territorial ndaj popujve të vegjël nxitën edhe një tip krejtësisht të ri të migrimeve, me përmbajtje specifike, të ashtuquajtur “spastrim etnik”, “migrim human” apo “këmbim popullat

Çështje thelbësore mbetet a do të trimërohen aleatët e Rusisë, para së gjithash Serbia në Ballkan dhe a do të mbështet Serbia nga Evropa sikurse deri tash!

Fjalët çelës: Gjeopolitika, pozita gjeopolitike, gjeostrategjia, hegjemonizmi serb, spastrimi etnik, Kosova, Ballkani, Rusia

Si për gjeografinë politike, që është shkencë amë, ashtu edhe për gjeopolitikën mund të thuhet se ka definicione të ndryshme, por që asnjëri në qarqet shkencore nuk është i pranuar dhe i plotë. Megjithatë, duhet nënvizuar që janë të pakët ata që e dinë me siguri të plotë kuptimin e nocionit të gjeopolitikës. Prandaj shpeshherë haset përdorimi jo i përshtatshëm dhe jokritik i këtij nocioni. Derisa shumë prej autorëve e shohin atë si disiplinë të pavarur në kuadër të shkencave gjeografike, ka të tjerë që e konsiderojnë atë si pjesë të shkencave politologjike, madje edhe në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Disa autorë e pranojnë pavarësinë, ndërkaq të tjerë mendojnë se ajo është vetëm doktrinë e cila ofron bazën hapësinore për shpjegimin e politikave shtetërore. Disa mendojnë se ajo në rrethanat aktuale nuk ekziston më, së paku jo në atë format në të cilën ka lindur. Ka konstatime se duhet dalluar nocioni i gjeopolitikës në kuptim të ngushtë dhe të gjerë. Kuptimi i ngushtë është më tepër determinist, ashtu siç e shpjegonin shkollat e vjetra gjeopolitike. Kuptimi i gjerë më tepër ka të bëjë me debatin se në cilën masë faktorët gjeografikë ndikojnë në vendimet politike.¹ Më poshtë do të japim disa definicione të gjeopolitikës.

I

Autori N. Pounds (1972) thotë se gjeopolitika hulumton ndikimin e mjedisit natyror në politikë. Sipas tij ajo është shtrembërim dhe keq-përdorim i fakteve gjeografike në interes të politikave agresive nacionaliste.² Sipas autorit kroat R. Pavić (1973) gjeopolitika është interpretim subjektiv i përmbajtjeve të rëndësishme politiko-gjeografike me qëllim të avancimit të interesave nacionaliste të shteteve ose blloqeve të caktuara, ndërsa Kristot (1972) thotë se gjeopolitika është hulumtimi

ndikimit të mjedisit natyror në politikë,³ kurse Pierre George nënvizon se “gjeopolitika nënkupton raportet midis faktorëve gjeografikë dhe veprimeve ose situatave politike”.⁴

Gjeopolitika është pjesë e nënsistemit antropogjeografik në kuadër të së cilës bën pjesë gjeografia politike. Si themelues i saj konsiderohet Friedrich Ratzel (1844-1904), ndërsa themelet e para teorike Ratzel-i i paraqit në veprën “*Antropogeographie*” (“Antropogjeografia”)⁵, e sidomos në veprën kapitale “*Politische Geographie*” (“Gjeografia Politike”),⁶ në të cilat përmes përdorimit të nocionit *Lebensraum* (hapësirë jetësore) vë në spikamë unitetin e njeriut dhe gjeohapësirës. Babai i gjeopolitikës është Rudolf Kjellen ((1864-1922) te mësimet e të cilit vërehet ndikimi i fuqishëm i Ratzel-it. Veprimtaria krijuese e Ratzel-it përkon me periudhën e kalimit nga shekulli XIX në shekullin XX. Metodologjia e tij bazohej në aplikimin e njohurive dhe përvojave që kishte nga shkencat e natyrës të cilat i përdor për të kuptuar dhe shpjeguar veprimet e njerëzve. Në veprën “*Gjeografia Politike*” ai zhvillon idenë që shteti është organizëm dhe sjellja e tij mund të kuptohet përmes ligjshmërive, të cilat përcaktojnë sjelljet e organizmave në natyrë. Sipas Ratzel-it shteti është shumë më tepër se një grumbull i individëve në një hapësirë të caktuar. Ai nuk ekziston vetëm në ndonjë farë hapësire, por është pjesë e pandashme e saj.

Gjeopolitika si disiplinë shkencore ka lindur si nevojë për të hulumtuar ndikimin e faktorëve gjeografikë në politikë, ndërkaq ajo sot është disiplinë e shkencave politike e cila hulumton raportin ndërmjet hapësirës, fuqisë dhe popullsisë. Përdorimi i fjalës gjeopolitikë shpesh shkakton reagime dhe merr konotacion përgjithësisht negativ. Kjo është pasojë e trashëgimisë negative të cilën gjeopolitika e bart nga kohërat

mbi shtetin si organizim gjeografik në hapësirë. Kjellen ishte një politolog me nam që veprimi në pjesën e parë të shekullit XX. Bashkë me Ratzel-in ishin themelues të shkollës gjeopolitike gjermane.

Kjellen te mësimet e të cilit vërehet ndikimi i fuqishëm i Ratzel-it, në vitin 1899 nxjerr në dritë veprën me titull “*Shteti si formë jetësore*”. Ky gjeopolitikën e ka konsideruar shkencë mbi shtetin si organizim gjeografik, duke spikatur rëndësinë e veçorive territoriale, çfarë janë sipërfaqja, kufijtë, forma, pozita, vetëmjaftueshmëria etj.⁸ Për të gjeopolitika ishte vetëm një kategori nga spektri i gjerë për analizën e shtetit. Edhe pse Kjellen merret si nismëtar i gjeopolitikës, si themelues i saj, megjithatë, konsiderohet britaniku Halford Mackinder (Halford John Mackinder), i cili në vitin 1900 ngrit shqetësimin për ndryshimin e baraspeshës së fuqive në nivel ndërkombëtar.⁹ Vepra e tij e titulluar “*Boshti gjeografik i historisë*” (1904) edhe sot e kësaj dite merret si pikë e pashmangshme reference dhe si vepra kryesore në historinë e kësaj disipline. Është botërisht e njohur Teoria e Hartlendit¹⁰ e Mackinderit (*Heartland Theory*), e cila paraqet një koncept të strategjisë globale. Mackinderi botën e koncepton si një ishull që përbëhet prej kontinentit euroaziatik dhe afrikan në të cilin mund të veçohet pjesa vështirë e qasshme ose *heartland* (*bërthama*). Bëhet fjalë për pjesën rrallë të banuar dhe tek e cila arrihet vështirë. Në të dyja anët e saj, përkatësisht përkaj oqeanëve ndodhet koustlendi evropian dhe monsunik.

Sipas teorisë së Mackinderit, koustlendet (*Coustlands*) kanë dendësi të madhe të banimit dhe përfshijnë pjesën më të madhe të popullsisë që ka kontakt me detin. Afrika nënsahariane ka “bërthamën” e vet, kurse Amerika dhe Australia si tërësi marginale janë

verilindjes (përmes Siberisë dhe Alaskës në Amerikë) dhe në drejtim të perëndimit (kah Evropa dhe Afrika). Me këtë teori Makinderi vendos postulatit themelor të gjeopolitikës, i cili thotë: “kush udhëheq me Evropën Lindore, sundon me bërthamën (zembrën) e kontinentit; kush udhëheq me zembrën e kontinentit, sundon me Ishullin Botëror dhe rrjedhimisht kush sundon me Ishullin Botëror, e sundon Botën”.

Gjeopolitika, qoftë ajo e Makinderit ose edhe ato të mëvonshmet, të cilat janë të ndikuara nga mësimet e Ratzel-it ose Kjellenit, kishin kritikët e saj. Në mesin e tyre duhet veçuar amerikano-holandezi Nikolas Spajkmen-i, i cili thotë se kontrolli mbi *Rimlandin* e Euroazisë e jo *Hartlendin* është më i rëndësishëm në planet për udhëheqjen e botës, kurse të tjerët e pohojnë se Amerika Veriore po bëhet një hapësirë me rëndësi globale gjeopolitike.¹¹

Nga vitet 30 të shek. XX në Gjermani paraqitet gjeopolitika naziste e cila në mënyrë pseudoshkencore arsyeton projektin e rikomponimit territorial dhe etniko-demografik të botës. Përfaqësues kryesor i këtij orientimi ishte Karl Haushofer (Karl Ernst Haushofer), i cili prezanton tezën se gjeopolitika duhet të koncentrohet në zgjidhjen e problemeve, të cilat lidhen me hapësirën jetësore (*Lebensraum*), e cila sipas tij u mungonte gjermanëve si një komb dhe shtet i ri.¹² Gjeopolitika në këtë periudhë më tepër shërben si doktrinë të cilën Gjermania naziste e shfrytëzon për realizimin e qëllimeve ekspansioniste. Për këtë arsye ajo edhe sot e kësaj dite stigmatizohet edhe pse disiplina të tjera në kuadër të progresit të tyre e kanë dëmtuar shumë më tepër shoqërinë njerëzore dhe botën në përgjithësi, çfarë janë për shembull zbulimet e fizikës nukleare, mjekësia apo edhe hulumtimet dhe gjetjet e reja shkencore në kimi dhe biologji, që kanë mundësuar shpikjen e armëve për shkatërrim masiv.

sonin si keqpërdorim të gjeografisë, një dogmë për realizimin e qelli-meve ekspansioniste, një pasqyrim të shtrembëruar të marrëdhënieve në botë, etj. Hartshorni thotë se ajo paraqet një “helm intelektual” (*“intellectual poison”*) prandaj si e tillë duhet anashkaluar.¹⁴ Interesimi i rishfaqur për gjeopolitikën dhe

teorike dhe metodologjike të hulumtimit. Në Francë vepron shkolla gjeopolitike në kuadër të së cilës veprojnë, Michel Foucher, Yves Lacoste dhe Jacques Levy. Në Britaninë e Madhe përfaqësues të shkollës gjeopolitike bashkëkohore janë John O'Loughlin, Geoffrey Parker dhe Peter Taylor. Shkolla britanike së bashku me atë amerikane të cilën e përfaqësojnë John Agnev, Richard Ashley, Simon Dalby etj., zhvillon qasjen

popujve dhe hapësirave, si dhe krijimin e identitetit kombëtar. *Gjeopolitika strukturore* hulumton kushtet bashkëkohore gjeopolitike, proceset globalizuese, tendecat dhe kundërthëniet.¹⁹

II

gjeokomunikative, kontestet kufitare dhe territoriale, forma e territorit, pozita e regjionit bërthamë dhe kryeqytetit etj.

Gjeostrategjia është nocion, kuptimin e të cilit e definojnë qartë fjalët greke: *gea* (Toka), *stratos* (ushtria,

Franca lehtë e ka përballuar humbjen e Kanadasë për të cilën Volteri kishte thënë se ajo vlen sa “dy grushta bore”, kurse lart i ka vlerësuar pronat territoriale në Karaibe. Rusët për çmim të lirë e kanë shitur Alaskën, në kohën kur Kongresi amerikan atë e ka quajtur “transaksion aventuresk” të një kongresmeni

gjenocidit” dhe atë si akt qëllimi për shfarosjen e plotë apo të pjesërishtme të një grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar.²⁹ Në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, shpërngulja e qëllimshme, e planifikuar, sistematike dhe e dhunshme e popullsisë së një etnikumi në sistemet juridike të shumë vendeve, duke përf

Turqia më 1922, kur u këmbyen rreth 1,5 milionë banorë)³² etj. Të veçanta janë spastrimet etnike që bëri Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit, në vitet 30 e 40 të shek. XX, me përzënien dhe deportimin e korelasve, të koreanëve, të kinezëve, të polakëve, të gjermanëve etj. dhe të

dhe në kohën e zgjerimeve të saj (1833, 1878, 1912), Serbia ka përzënë nga territori i saj popullatat islamike, turqit, shqiptarët dhe myslimanët sllavë, por nga viti 1912 ajo tentoi t'i asimilojë edhe maqedonasit prej kur bullgarët kishin nisur të grindeshin me të”.³⁷ Këtu edhe i gje

myslimanët e Bosnjës dhe shqiptarët e Kosovës në fund të shek. XX), me pasoja të mëdha. Në përmasa rajonale goditje më të mëdha pati kombi shqiptar në gjithë hapësirën e tij etnike, ku dallohet lufta institucionale serbo-jugosllave kundër faktorit demografik shqiptar në trojet etnike shqiptare jashtë Shqipërisë politike.

Hapësirat ballkanike, që nga kohët e lashta e deri vonë, ishin skenë e ngjarjeve dhe lëvizjeve të bujshme historike e politike, sociale, etnike dhe kulturore, e dominimeve të vendeve të huaja, e migrameve të popullsisë në kohën e forcimit dhe pushtimit të mbretërive të mëdha, që përcilleshin dhe me zgjerimet e tyre territoriale dhe ndryshimet etnike, gjuhësore dhe etnografike, ndërsa edhe sot e gjithë ditën Ballkani mbeti politikisht i pastabilizuar dhe i përshkuar nga tensionet dhe konfliktet ndëretnike. Brenda territorit të Ballkanit, ku u zhvilluan shumë luftëra dhe përlëshje në të gjitha kohët historike, ndodhën lëvizje migruese të popullsisë të popujve të ndryshëm, veçanërisht shtegtime të shqiptarëve dhe u bënë gërrshetime të kulturave të tyre, të dokeve, të zakoneve, të konfesioneve, të gjuhëve etj. Dallohet sidomos pjesa qendrore e tij, më saktësisht Kosova e sotme dhe viset e tjera etnike shqiptare përreth. Migrimet etnike, të njohura dhe si “migrime humane” ose “spastrime etnike”, për qëllime politike u intensifikuan në deceniet e fundit të shekullit XX, pas luftërave të përgjakshme në ish-Jugosllavi, të nxitura nga hegjemonizmi serbomadhi me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe. Me këtë rast u shkaktuan shpërngulje të dhunshme masive të popullatave kroate, boshnjake dhe shqiptare, por në fund edhe serbe, dhe tragjedi të mëdha njerëzore e materiale.⁴⁰

Serbia me pozitë natyrore kontinentale shumë herët ka shprehur ambiciet për t’u zgjeruar territorialisht dhe për të dalë në det. Luftërat e saj janë përcjellë me spastrime etnike e gjenocid, ndërsa më së shumti e ka pësuar populli shqiptar, i cili për shkak të karakteristikave gjeo-strategjike të truallit gjeoetnik ka qenë në shënjestër të këtyre pushtimeve. Përveç se me luftëra, qëllimet e veta hegjemoniste dhe ekspansioniste Serbia ka provuar t’i realizojë edhe përmes projekteve gjigante infrastrukturore, si hekurudha Beograd-Tivar dhe së fundi, përmes idesë së re (të vjetër) të hapjes së kanalit lundrues Danub-Moravë-Vardar-Porti i Selanikut. Edhe kjo projekt-ide sikurse shumica e projekteve të tjera parashihet të kalojë nëpër një pjesë të natyrshme të trungut gjeoetnik shqiptar, siç është Lugina e Preshevës. Serbia kishte etje të madhe për dalje në detin Egje përmes luginës së Moravës dhe të

⁴⁰ Më gjerë në: H. Islami, *Aspekti etnik i migrameve*, ASHAK, 2013, ff. 99-217.

Vardarit në gjiun e Selanikut dhe në detin Adriatik përmes luginës së Drinit dhe Matit që shpie në portet e Durrësit dhe Medovës.⁴¹ Për daljen në detin e fundit u angazhua shumë Jovan Cvijiçi, i cili edhe e zhvilloi idenë për realizimin e këtij projekti, duke uzurpuar territorin shqiptar.⁴² Ndërsa I. Andriqi, në elaboratin e tij në emër të Qeverisë serbe (të Millan Stojadinoviçit), kërkonte dalje në detin Adriatik edhe përmes hekurudhës dhe marrjes së Shkodrës me hinterlandin e saj për motive “ekonomike dhe morale”.⁴³

IV

Në dy shekujt e fundit Ballkani u cilësua si “fuçi baruti” dhe thuhej se Evropa dhe bota në tërësi sikur tashmë janë lodhur me këtë rajon dhe mentalitetin e tij. Sir W. Churchill (1874-1965), në kujtimet e tij kishte theksuar se “Ballkani prodhon më shumë probleme sesa që mund t’i zgjidhë”. Por Evropa mban faje të mëdha për konfliktet brenda-ballkanike dhe krizat gjeopolitike. Në përpjekjet për dominim këto dy shekujt e fundit Evropa vazhdimisht ka nxitur destabilizimin e përgjithshëm të Ballkanit, njësoj sikundër edhe Rusia për shkak të interesave të saj pansllaviste në këtë rajon. As pas përfundimit të luftës së ftohtë në fund të shekullit 20, Evropa sikur nuk e kuptoi realitetin politik, mbi të gjitha nuk u tregua e aftë që t’i zgjidhë problemet në truallin e vet, përfshirë këtu kryesisht Ballkanin. Kjo u dëshmuar në rastin e ish-Jugosllavisë, kur neohegjemionizmi dhe gjeopolitikat ekspansioniste serbe, me forcë ushtarake donte t’i nënshtronte dhe biologjikisht t’i zhdukte popujt joserbë, në veçanti shqiptarët.

Ruajtja me çdo kusht e ish-Jugosllavisë ishte një gabim i rëndë i Evropës dhe Perëndimit në përgjithësi, përfshirë SHBA-në, sikundër që pati përpjekje të ruhej edhe Unioni Serbi-Mal i Zi, disproporcional në madhësi territoriale dhe demografike, deri te disfunkcionalizimi dhe rrjedhimisht dekompozimi i tij. Kur Mali i Zi vendosi të dalë nga Unioni me Serbinë dhe të pavarësohet në vitin 2006 përmes referendumit, BE-

⁴¹ Më gjerë në: Ejupi, A., The idea of Morava-Vardar water canal and its long term geopolitical context, *GeoScape*, vol. 12, issue 2, Jan Purkyne University, Usti nad Labem, Degruyter Open, 2018, pp. 84-91; H. Islami-A.Ejupi, “Aspiratat shekullore serbe për dalje në det”, *Studime Shoqërore*, 6, ASHAK, 2019, ff. 7-40.

⁴² J. Cvijić, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, *Glasnik Srpskog geografskog društva*, God. 1, br. 2, Beograd, 1912, ff. 192-205.

⁴³ B. Krizman, “Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji iz 1939.godine”, *Časopis za suvremenu povijest*, II, Zagreb, 1977, f. 89.

ja i vuri kusht që duhet mbështetja jo e standardit 50+1, por validitetin e rezultatit e çoi në 55% të numrit të përgjithshëm të votuesve (!); referendumi ishte i suksesshëm nga se votuan pro 55,4%, ku roli i boshnjakëve dhe i shqiptarëve ishte vendimtar. BE-ja donte me çdo kusht ta pengonte shpëputjen e Malit të Zi nga Unioni edhe për shkak se nuk donte që Kosova të pavarësohej.

Kohët e fundit na dolën dy narrativa si dy projekte: “Bota ruse” dhe “Bota serbe”, që u bënë jo rastësisht edhe pjesë e diskursit aktual gjeopolitik. Edhe pse të veshura me “petkun kulturor”, këta narrativa janë eufemizma për “Rusinë e Madhe” dhe “Serbinë e Madhe”, që do të thotë se kanë qëllime hegjemoniste për zgjerim territorial dhe nënshtrim të popujve fqinj. Përpjekjet për realizimin e këtyre projekteve janë konsistente, si në Evropën Lindore, ashtu edhe në Gadishullin Ballkanik, madje me një shkallë të lartë të sinkronizimit.

Qëllimi i Putinit është që të ripërtërijë “Botën ruse” më tepër përmes zgjerimit territorial e më pak përmes ndikimit kulturor. Sikurse rusët që mendojnë se nuk ka “Botë ruse” nëse nuk arrihet të kthehet kontrolli ndaj Kostandinopojës, ashtu edhe qarqet radikale serbe thonë se nuk mund të ketë identitet serb, nëse shteti serb nuk udhëheq me Kosovën. Ambiciet hegjemoniste, siç pamë më parë, datojnë shumë herët dhe i hasim qysh në mesin e shek. XIX.

Projektin e “Botës serbe” në Serbi e proklamoi për herë të parë Aleksandar Vuçiçi (president i Serbisë) përmes Aleksandar Vulinit, ministër i Mbrojtjes dhe lider i Lëvizjes së Socialistëve dhe njeriu i afërt i Vuçiçit; Vuçiçi heziton ta elaborojë këtë ide për shkak të pasojave eventuale diplomatike. Nuk do mend se prapa sintagmës së “Botës serbe” qëndron pikërisht Vuçiçi, edhe pse mbështetjen më të madhe ideologjike ia japin qarqet intelektuale dhe fetare në Serbi. Bota serbe është një variant i sofistikuar serbomadh, duke iu përshtatur rrethanave bashkëkohore të fillimit të shek. XXI. Qëllim i këtij projekti është zgjerim i ndikimit të Serbisë në shtetet fqinje në të cilat jeton edhe popullsia serbe, në radhë të parë nëpërmjet kulturës, artit, sportit, ekonomisë dhe politikës. Bashkësitë serbe në këto shtete do të duhej të dëgjojnë politikën e Beogradit dhe të bëhen instrument i saj edhe nëse ato janë të kundërta me interesat e shteteve amë. Një relacion i tillë ndërmjet Beogradit dhe serbëve në shtetet fqinje në rrethanat e volitshme gjeopolitike si dhe me mbështetjen e Rusisë dhe Kinës do të sillnin ndryshime në dobi të Serbisë. Ajo do të bëhej shteti më i fuqishëm në Ballkanin Perëndimor, kurse do të cenonte sovranitetin e shteteve dhe

popujve fqinj. Përfundimisht kjo do të sillte deri te ndryshimet e kufijve në dobi të Serbisë ose krijimin e entiteteve të reja serbe.

Roli i Rusisë në Ballkan, në Evropë dhe tash në përmasa globale është çështje në vete. Tentativat për ta ndarë Kosovën, “Mini-Shengen” i vitit 2019 dhe tash “Ballkani i Hapur” i vitit 2021, me Serbinë e Vuçiçit, me Maqedoninë Veriore të Z. Zaevit dhe me Edi Ramën e Shqipërisë, pas zhvillimeve të fundit Rusi-Ukrainë, sikur po dalin të mbështetura nga Rusia e V. Putinit. “Ballkani i Hapur” do ta forconte hegjemoninë serbe, njëherë në përmasa ekonomike dhe pastaj edhe politike në Ballkan. Me këtë sjellje të Rusisë së Putinit ndaj Ukrainës dhe popullit të saj ndryshuan raportet SHBA-Rusi, BE-Rusi, Lindje-Perëndim, ndryshuan rendi botëror dhe raportet globale në përmasa planetare. Me shfaqjen e një Hitleri të ri, Putinit, por në kohë tjetër, në skenën politike botërore ndryshoi gjithçka në botë. Dallimi midis Putinit dhe Hitlerit është vetëm se Hitleri nuk posedonte armë bërthamore, që i preferonte aq shumë, ndërkaq Putini i posedon ato dhe me këtë po e shantazhon dhe kërcënon gjithë botën!

Lufta në Ukrainë, madje po cilësohet si luftë ndërmjet atlantizmit dhe euroazianizmit, dy blloqeve të kundërta ideologjiko-politike. Pas shpërbërjes së bllokut lindor (ish-Pakti i Varshavës), vazhdon zgjerimi i NATO-s në drejtim të lindjes me aderimin e shteteve të reja, ndërkaq në lindje të Evropës zhvillohet procesi paralel i euroazianizmit, që, në thelb, është shumë konservator dhe refuzues ndaj liberalizmit dhe demokracisë perëndimore. Prej përfundimit të Luftës II Botërore njerëzit janë përpjekur që të gjejnë analogji dhe të tërheqin paralele midis diktatorëve dhe figurave të tjera udhëheqëse me Hitlerin, duke u bazuar në metodat e veprimit dhe sundimit. Sipas historianit dhe profesorit të Universitetit të Oksfordit, Timothy Garton Ash, një krahasim është ai i Hitlerit të Luftës II Botërore dhe Vladimir Putinit të kohës së sotme. Në kontekstin e invadimit rus të Ukrainës profesori Garton Ash e bën krahasimin jo me Hitlerin e holokaustit por me atë të invadimit të Polonisë në vitin 1939.⁴⁴

Populli rus dhe populli ukrainas nuk kanë pasur asnjë urrejtje mes vete, as historikisht e as aktualisht. Por Rusia e Putinit, ndërmori një luftë agresive ndaj Ukrainës për t’i frikësuar dhe qëruar hesapet me SHBA-në, NATO-n dhe Evropën dhe në instancë të fundit për të rikthyer imperializmin rus dhe për të krijuar “Rusinë e Madhe”, të paktën

⁴⁴ Garton Ash (2022), Ukraine has earned a future in the European Union, Guardian, 4, March, 2022.

si në kohën e BRSS-së! Mirëpo, me këtë hapin e fundit, me hyrjen për një pushtim të shpejtë me qëllim të përmbysjes së udhëheqjes legjitime të Ukrainës dhe instalimin e një qeverie kukull proruse, ajo dhe hyri në një kurth, pa llogaritur në qëndresën e fortë të popullit ukrainas, i orientuar ta përqafojë një koncept krejtësisht tjetër nga ideologjia totalitare e Rusisë së Putinit, ta parapëlqejë një demokraci të tipit perëndimor dhe të jetë pjesë e Perëndimit, e Amerikës, NATO-s dhe Evropës. Rusia hyri në një pushtim agresiv fashist, duke nënvlerësuar rezistencën e udhëheqjes dhe popullit ukrainas; po lufton e gjithë shoqëria ukrainase. Mirëpo blickrigu (blitzkrieg⁴⁵) i Putinit nuk pati sukses meqenëse taktika ruse dështoi në disa fronte; nuk i ndihmoi as propaganda e mjeteve të informimit, të kontrolluara gati krejtësisht nga regjimi.

Është interesante se para invazionit rus në Ukrainë taktika dhe fuqia ushtarake ruse nuk u vlerësua drejt. Vetëm shërbimet amerikane të inteligjencës e vlerësuan me kohë faktin se Rusia do ta sulmojë Ukrainën, ndërsa të gjithë, përfshirë dhe qarqet ushtarake dhe të sigurisë amerikane e mbivlerësuan forcën ushtarake ruse, kurse nënvlerësuan qëndresën dhe heroizmin e popullit ukrainas. Tash hakmarria po vazhdon me një ritëm më të shpejtuar për arsye të mossuksesit të makinerisë ushtarake ruse dhe komprometimit para qytetarëve të vet dhe gjithë botës. Sot është vendi më i sanksionuar dhe regjimi më i urrejtur në botë. Pasojat e kolapsimit të jetës së përgjithshme në Rusi do të jenë afatgjate.

Putini vazhdon t'i bëjë thirrje ushtrisë së Ukrainës për një grushtshtet ushtarak, në mënyrë që të bëhet zëvendësimi i regjimit (regime change) dhe sjelljen e një qeverie proruse. Me këtë sjellje mendoi se do ta përçajë Perëndimin, në radhë të parë Amerikën me Evropën, vetë Evropën dhe NATO-n, por edhe t'i frikësojë ish-vendet e BRSS-së. Nuk

⁴⁵ Blickrig (gjerm: *blitzkrieg*) ose lufta e rufeshme është nocioni i cili na kujton ushtrinë gjermane në Luftën II Botërore. Megjithatë, termi blitzkrieg shfaqet katër vjet para fillimit të kësaj lufte. Nis të masovizohet si term tek pasi përmendet në gazetën britanike "Times", të datës 25 shtator të vitit 1939, do të thotë pas pushtimit nazist të Polonisë. Adolf Hitleri e pranon këtë term dhe fillon ta përdorë për qëllime propagandistike deri tek operacioni "Barbarosa" në vitin 1941 kur vjen deri te ndalimi i depërtimit të ushtrisë gjermane në Bashkimin Sovjetik. Ideja e blickrigut nuk ka lindur në Gjermani, por në Britani të Madhe, edhe pse janë gjeneralët gjermanë ata që e kanë popullarizuar më së shumti. Më saktësisht idenë e luftës së rufeshme e kanë inicuar dy ushtarakët britanikë, Frederick Charles Fuller dhe Basil Henry Liddell Hart. Për më tepër shih në: Vrbanić, L. Katalinić, I, Njemački blitzkrieg: evolucija ili revolucija, Essehst, Vol. 10, No 10, 2019 ff.101-109.

llogariti as në izolimin e saj nga e gjithë bota dhe në të gjitha fushat: ekonomike, politike, diplomatike, kulturore, sportive etj. Lufta në Ukrainë ka nxitur reagime jo vetëm të qarqeve politike, ekonomike dhe ushtarake, por edhe të botës së civilizuar perëndimore dhe shumë dijetarëve, filozofëve, medie etj. Në mesin e tyre vlen të zihet në gojë autori Francis Fukuyama, i njohur për librin e tij të njohur “*The end of History and the Last Man*”, të botuar në vitin 1992, kur për shkak të zhvillimeve të vrullshme gjeopolitike vjen deri te ndryshimi i rendit të ri botëror. Sipas tij, rënia e komunizmit ka sjellë deri te triumfi definitiv i liberalizmit dhe demokracisë, prandaj bota ka arritur shkallën më të lartë të evolucionit ideologjik të njerëzimit. Lidhur me zhvillimet aktuale gjeopolitike dhe luftën në Ukrainë Fukujama thotë se operacionet ushtarake të Rusisë në Ukrainë janë të destinuara të dështojnë për shkak të planifikimeve të gabuara ushtarake, ambicieve politike të Putinit, keqmenaxhimit të logjistikës etj.⁴⁶ Dëshmia më e qartë është pamundësia për ta marrë aq lehtë dhe shpejt kryeqytetin kombëtar, Kievin. Ushtrisë ruse i mungoi motivi dhe dimensionimi moral, duke qenë në terren edhe pa ushqim, veshmbathje dhe mjete luftarake. E mbivlerësoi vetveten, por e pa gjithë bota se u shemb miti për ushtinë “e pamposhtur” ruse!

Përmes refugjatëve regjimi i Putinit do ta bartë krizën edhe në vendet e tjera evropiane (mbi 10 milionë refugjatë ukrainas deri tash, ndërsa pritet që ky numër të rritet edhe më tepër). Ndër refugjatët dhe të dëbuarit dominojnë fëmijët, që do të ketë pasoja afatgjata demografike në të ardhmen nga se do të reduktohet në të ardhmen baza riprodutive e popullsisë. Është më se e qartë se një numër i madh i popullsisë së re nuk do të mund të kthehet në Ukrainë pas këtyre shkatërtimeve dhe tmerreve që la regjimi neofashist rus i Putinit!

Rusia më së shumti u forcua ekonomikisht në “epokën” e Angela Merkelit, duke përdorur energjinë si mjet lufte. Në kohën e Merkelit (16 vjet në pushtet si kancelare), Rusia e shkatërroi paqen në botë dhe Putini përmes gazit dhe naftës u shndërrua në kult të personalitetit, sikurse Stalini në kohën e tij; me Putinin bota hyri në një “luftë të ftohtë” të një natyre tjetër nga ajo që ishte deri në fund të viteve 80 të shek. XX. Kjo luftë mund të cilësohet si “Luftë e Dytë e Ftohtë Botërore”! Edhe Presidenti i Gjermanisë, Frank Walter Steinmeier, pas kritikave të brendshme dhe të jashtme, në veçanti nga Ukraina, pranoi gabimet në politikën ndaj Rusisë, duke thënë se “Këmbngulja ime për Nord Stream 2 ishte një gabim i qartë”. Ne u qëndruam besnik urave, të cilave Rusia

⁴⁶ <https://moderndiplomacy.eu/2022/03/22/fukuyamas-remarks-on-russias-war-in-ukraine-are-doomed-to-fail/>

nuk u besonte më, gjë për të cilat na kishin paralajmëruar partnerët tanë”! (11. 04. 2022). Në tentativën për të vizituar Kievin, bashkë me presidentët e Polonisë, Lituanisë, Estonisë dhe Letonisë, presidenti Steinmeier nuk ishte i mirëpritur nga Presidenti Zelenski dhe Ukraina (13.04.2022). Gjermania dhe Franca nuk donin të konfrontoheshin me Rusinë kur bëhej fjalë për anëtarësimin e Ukrainës në NATO! Ndërkaq, A. Merkel vërtet ishte kundër ndarjes së Kosovës si ide dhe objektiv afatgjatë serb, por Vuçiçin e mbështeste aq shumë sa që vetëm nuk e shpalli lider të Ballkanit Perëndimor!

Ndërkaq Evropa tradicionalisht antiamerikane, e paaftë t’i zgjidhë problemet në truallin e saj bënte “sehir”, duke mbështetur Rusinë. Ndaj okupimit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014 Evropa, por edhe SHBA-ja, patën një reagim fort anemik, kurse Kina heshtazi e miratoi agresionin rus në Krime. Duke marrë anën e Serbisë, si dje, ashtu edhe sot, qëndrimi i Evropës ndaj Kosovës dhe shqiptarëve nuk evoluoi. Në rastin e Kosovës Bashkimi Evropian ka sa vjet që i mbështet trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të Milosheviçit, kryetarin aktual të Serbisë, Aleksandër Vuçiç, në vitet 90 ministër i Informatave (si një Gebels i vogël, i cili në luftën e Bosnjës thoshte: ”Za jednog Srbina, stotinu Muslimana” - “Për një serb, njëqind myslimanë”!) dhe ish-nënkryetarin e Qeverisë, ish-ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë dhe kryetarin aktual të Parlamentit të Serbisë, Ivica Daçiç, në kohën e regjimit të S. Milosheviçit zëdhënës i Partisë Socialiste të Milosheviçit. Kur bisedohej me Hashim Thaçin dhe Edi Ramën për ndarjen e Kosovës në vitin 2018, Vuçiçi erdhi në Kosovë dhe i thuri lavde Milosheviçit, ndërsa në dhjetor të vitit 2019 e mohoi krimin dhe gjenocidin në Reçak! Prandaj, me Vuçiçët dhe Daçiçët është e pamundur Kosova të bëjë marrëveshje me Serbinë!

BE-ja i pengoi disa vende të Ballkanit Perëndimor që të jenë pjesë e saj, ndërsa Kosovën e injoroi në tërësi, duke mos i dhënë as të drejtën në lëvizjen e lirë (liberalizimin e vizave). Kosovën e futi në një karantinë të pakuptimtë, edhe pse i ka përmbushur kushtet para Serbisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Bullgarisë, Rumanisë etj. Hilet e BE-së ndaj Kosovës vazhduan edhe sot e gjithë ditën, ndërsa haptas po e mban anën e Serbisë, madje edhe në bisedimet e Kosovës me Serbinë. Nuk po angazhohet as për realizimin e të drejtave të shqiptarëve në Luginën e Preshevës si pakica më e diskriminuar në Evropë! BE-ja ka investuar në Serbinë e Vuçiçit disa miliarda euro, përfshirë Gjermaninë e Merkelit që kishte financuar shumë projekte industriale dhe infrastrukture (rreth 20.000 punëtorë). Edhe Kina ka shumë

investime, para së gjithash në infrastrukturë; ajo po e furnizon me armë Serbinë, duke i dërguar sisteme të sofistikuar kundërajror. (10.04.2022). BE-ja po hatrohet kur shqiptarët e Kosovës po rreshtohen në anën e SHBA-së, ndërsa po hesht kur Serbia zyrtare dhe serbët anojnë dhe haptas e mbështesin Rusinë agresore.

BE-ja dhe të tjerët e dinë se Rusia është mbështetësi më i madh në sferën ekonomike (mbi 50% e energjisë dhe afër 50% e naftës në Serbi vjen nga Rusia) dhe ushtarake të Serbisë (baza ushtarake ruse afër Nishit dhe një qendër tjetër në Cepotin, afër Bujanocit). Mosreagimi i vendeve euroatlantike ndaj pushtimit rus të Krimesë në mars të vitit 2014 e kurajoi Rusinë në përmbushjen e apetiteve ekspansioniste, ndërsa aneksimi i Doneskut dhe Luhanskut në shkurt të vitit 2022 e nxiti edhe më shumë pushtimin e gjithë Ukrainës. Pas aneksimit të Doneskut dhe Luhanskut askush nuk e besonte se Rusia do ta pushtonte Ukrainën, përfshirë vetë ukrainasit, por as shërbimet e huaja të inteligjencës. Të gjitha shërbimet, përfshirë ato amerikane e mbivlerësuan forcën ruse, ndërsa e nënvlerësuan forcën, kurajon dhe moralin e popullit ukrainas dhe udhëheqjes së tij në mbrojtjen e vendit.⁴⁷

Pas agresionit fashist të Ruisë ndaj Ukrainës, të paprovokuar dhe të pajustificuar, nga fundi i shkurtit 2022 nis një epokë e re gjeopolitike dhe bota nuk është më ajo që ishte. Lufta e Ruisë me Ukrainën duket se do të përfundojë me bllokimin e qasjes së Ukrainës në det (Deti i Zi dhe deti Azov), duke e marrë krahinën e Donbasit, të pasur me thëngjill, naftë, çelik, grafit etj. Pas rënies së Mariupolit, të cilin rusët e shkrumbuan, luftërat po zhvillohen në gjithë lindjen e Ukrainës (në maj dhe qershor 2022 sulme të mëdha të ushtrisë ruse po ndodhin në qytetin Severodonetsk, me rreth 100.000 banorë), ndërsa qëllimi përfundimtar i Federatës Ruse është bashkimi Mariupolit dhe gjithë Donbasit me Krimenë dhe Odesën, ndonëse kjo e fundit është interes praktik politik, ekonomik dhe gjeostrategjik i shumë palëve.

Çështje thelbësore mbetet a do të trimërohen aleatët e Ruisë destabilizuese dhe pansllaviste në botë, para së gjithash Serbia në Ballkan, që u rreshtua edhe tash pas Ruisë, në një anë, dhe a do të vazhdojë Evropa ta përkëdhelë Serbinë si destabilizuese afatgjate e Ballkanit sikurse deri tash? BE-ja duhet t'ia bëjë të qartë Serbisë: ose

⁴⁷ Duke dëshmuar në një seancë dëgjimore të Komitetit të Shërbimeve të Armatosura të Senatit të SHBA-së, shefi i Komandës Evropiane të Ushtrisë Amerikane, gjenerali Tod Wolters u pyet nga senatori Roger Wicker, një republikan e Misisipit, “nëse kishte një mungesë të Intiligjencisë Amerikane, që mbivlerësonte forcën e Ruisë dhe nënvlerësonte mbrojtjen e Ukrainës” (CNN, Tue March 29, 2022).

nga Fuqitë e Mëdha e kishte rolin dhe ndikimin e veçantë në situatën e krizës që u shkaktua nga Lufta Ballkanike, mirëpo Rusia kishte ndikim të madh në vendet që përbënin aleancën ballkanike. Ky ndikim i krijonte Rusisë një rol të veçantë dhe legjitimitet prej protektori edhe në kuadrin e Fuqive të Mëdha.

Shtetet dhe popujt ballkanikë të përfshirë në konflikt kishin të drejtë vetëm të paraqisnin mendimet e tyre, por jo të merrnin pjesë në vendimmarrje në Konferencë. Në këtë grup bënte pjesë edhe Shqipëria. Megjithatë ballkanasit e ruajtën të drejtën t'i paraqitnin Konferencës së Ambasadorëve kërkesat e tyre territoriale, kërkesë të cilën Shqipëria nuk kishte të drejtë ta bënte²¹, meqë ajo ende nuk e kishte fituar njohjen si shtet i pavarur dhe subjekt i të drejtës ndërkombëtare. Për Shqipërinë në fillim të Konferencës u diskutuan çështje të rëndësishme si: statusi i saj, organizimi i shtetit dhe shtrirja territoriale. Autonomia e garantuar dhe e kontrolluar nën sovranitetin apo suzerenitetin e Sulltanit ishte ndër diskutimet e para lidhur me statusin e Shqipërisë.²² Këta dy terma ishin koncepte të ndryshme në përmbajtjen e tyre që implikonin dy variante të autonomisë së Shqipërisë. “Sovraniteti” i Sulltanit mbi Shqipërinë nënkuptonte vartësinë e saj nga Porta e Lartë kurse “suzereniteti” nënkuptonte një shkallë të lartë të autonomisë me një vartësi formale nga autoritetet e Stambollit.²³ Krejt kjo vinte si shkak-pasojë e mungesës së gatishmërisë së Fuqive të Mëdha për ta njohur pavarësinë e plotë të shtetit shqiptar për shkak të interesave të tyre gjeopolitike dhe gjeostrategjike, si dhe ruajtjen e status quo-s, të cilën e vlerësonin si të rëndësishme për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan dhe Evropë.

RUSIA NË KRAH TË “ALEANCËS BALLKANIKE” DHE KUNDËRVËNIA E AUSTRO-HUNGARISË

Aspiratat e politikës pangjermane të përfaqësuara nga Gjermania dhe Austro-Hungaria, binin ndesh me platformën ruse për fuqizimin e shteteve sllave dhe ortodokse ballkanike. Austro-Hungaria nuk kishte marrë pjesë në kolonializmin përtej detit, prandaj politikanët austriakë e shihnin Ballkanin si një territor të natyrshëm për të realizuar ambiciet

Botërore (1914–1918).

²¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë 2007, f. 25.

²² Arben Puto, *Çështja shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit II*, Tiranë 1987, 188.

²³ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë 2009, f. 60.

e veta gjeopolitike. Mirëpo kjo politikë binte ndesh me Rusinë.²⁴ Misioni historik i Rosisë ishte çlirimi dhe fuqizimi i popujve sllavë dhe shkëputja totale e tyre nga vartësia e Perandorisë Osmane.²⁵ Në vitin 1912, shtete sllave të Ballkanit ishin konsoliduar dhe shpresën e tyre për zgjerim e kishin varur nga ndihma politike, ushtarake dhe diplomatike, që do ta merrnin nga diplomacia ruse. Pra popujt sllavë të Ballkanit e mbështetnin emancipimin e tyre politik e kombëtar në ndihmën e pakursyer të Perandorisë Ruse dhe të aleatëve të saj të grupuar në Paktin e Antantës. Madje edhe vetë ministri i Jashtëm Sazonov mendonte se shtetet ballkanike nuk ishin ende aq të forta që të mund të bënin pa ndihmën e Rosisë në rast të luftës kundër tyre nga gjermanizmi luftënxitës. Sazonov-i aludonte në Austro-Hungarinë e cila ishte e gatshme të ndërhynte ushtarakisht për të mbrojtur interesat e saj në rajon. Shteti më kërcënues për mbretërinë dualiste ishte Serbia përmes së cilës rusët dëshironin t'i kundërviheshin zgjerimit të ndikimit austro-hungarez në rajonin e Ballkanit.²⁶ Ministri Sazonov konstatonte se ishte e papranueshme për Rusinë që shtetet ballkanike që i ndihmuan të çliroheshin nga ana e saj të bien nën ndikimin e shteteve armike të Rosisë. Aleatët ballkanikë krahas luftës dhe pushtimit të territoreve të zotëruara nga Perandoria Osmane kishin bërë publik edhe interesat e tyre për njohjen e territoreve të pushtuara. Kështu sipas Sazonovit, Greqia, Serbia dhe Mali i Zi dëshironin ta ndanin Shqipërinë midis tyre. Serbia synonte që si plaçkë lufte të merrte Shqipërinë Veriore me përjashtim të rajonit të Shkodrës që i lihej Malit të Zi dhe pretendonte të shtrihej përgjatë bregdetit të Adriatikut nga Shëngjini deri te lumi Shkumbin, duke i lënë Greqisë jugun e Shqipërisë. Rusia nuk kishte asgjë kundër këtyre planeve sllave dhe ortodokse, por siç deklaronte Sazanov-i “ ky është një entuziazëm i tepëruar i Serbisë, sepse këto pretendime do të shkaktonin reagimin e menjëhershëm të Austro-Hungarisë dhe Italisë, interesat e të cilave ishin identike në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik”.²⁷

Shqipëria përveç që shihej si plaçkë lufte nga aleatët ballkanikë, ishte vendi ku gërshetoheshin interesat e të dy grupeve të mëdha dhe që në këtë kohë u bë fushë e ashpërsimit të kontradiktave midis tyre.

²⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia...* f. 138.

²⁵ Sergej Dimitrievič Sazonov, *Kujtime...* f. 69.

²⁶ www.britannica.com/topic/20th-century-international-relations/The-Balkan-crises-and-the-outbreak-of-war,1907-14,Growing-tensions-and-German-isolation, hulumtuar më 5.3.2022.

²⁷ Sergej Dimitrievič Sazonov, *Kujtime...* f. 100.

Krijimi i një shteti të pavarur shqiptar shikohej me simpati nga Aleanca Trepalëshe, e cila shpresonte që këtë vend ta tërhiqte në orbitën e saj për shkak të ndikimit që kishte Austro-Hungaria dhe Italia.²⁸ Këto dy shtete prej kohësh kishin shtuar prezencën e tyre në tokat shqiptare në forma të ndryshme duke përdorur këtu kryesisht elementin katolik shqiptar dhe duke hapur shkolla në lokalitete të ndryshme në trevat shqiptare. Përballë Vjenës dhe Romës qëndronte Rusia e cila e kishte institucionalizuar rolin e saj proteksionist të interesave sllave dhe ortodokse në rajonin e Ballkanit. Pra, interesat shqiptare ndodheshin në kuadrin e përplasjeve diplomatike dhe interesave gjeostrategjike të Austro-Hungarisë, Italisë që u angazhuan ta ndihmonin Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe Rusisë e cila territoret shqiptare i shihte si mundësi të zgjerimit malazez dhe atij serb me pretendime për dalje të përhershme në detin Adriatik.

Formimi i shtetit shqiptar nënkuptonte prishjen e planeve për Aleancën Ballkanike, e cila e konsideronte Shqipërinë si territor për të cilin kishin marrëveshje për ta ndarë midis tyre si rezultat i fitores kundër Portës së Lartë, pra ta ndanin në mes vete si trofe të luftës. Kjo ishte edhe arsyeja kryesore që shtetet e Aleancës Ballkanike nuk insistuan asnjëherë të krijonin partneritet me interesa të përbashkëta me shqiptarët ose t'i ftonin në luftë të përbashkët në mënyrë që pas fitores ndaj osmanëve secili nga popujt dhe shtetet ballkanike të realizonte ëndrrën e vet për shtet kombëtar, të zhvilluar dhe emancipuar siç ishte shembulli i shteteve të Evropës Perëndimore.

Për të evituar përhapjen e konfliktit dhe përplasjet e reja, Britania e Madhe kishte zhvilluar bisedime të shumta me aleatët e saj dhe fuqitë e tjera të interesuara mbi gjendjen në Ballkan. Por hapin konkret për zgjidhjen e çështjes e kishte ndërmarrë Edward Grey në takimin që pati me ambasadorin Gjerman në Londër, princin Lichnovsky. Në këtë takim, Edward Grey propozoi tre çështjet thelbësore që Fuqitë e Mëdha duhet t'i diskutonin dhe të arrinin një marrëveshje për ruajtjen e paqes në Ballkan dhe Evropë:

“1) Mundësia e krijimit të një shteti shqiptar autonom dhe kufijtë që duhet të ketë; 2) Metodrat dhe kushtet e sigurimit të daljes së Serbisë në Adriatik; 3) Çështja e ishujve të Egjeut”²⁹

²⁸ Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913*, Prishtinë 2017, f. 312.

²⁹ Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (më tej AIHT), Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 182, dok. Nr. 243

Pra konferenca filloi me diskutime për çështjen shqiptare, kërkesën për dalje të Serbisë në Adriatik dhe çështjen e ishujve të Bregdetit, kufirit në mes të Bullgarisë dhe Perandorisë Osmane në Traki. Diplomacia Austro-Hungareze u përball me faktin e ndryshimit të status quo-s në dëm të interesave të saj dhe në favor të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë të mbështetura me forcë nga Perandoria Ruse. Për këtë arsye Vjena vendosi t'i kundërvijë politikës pansllaviste dhe panortodokse duke përkrahur formimin e shtetit shqiptar në kufij sa më të gjerë me gjithëpërfshirje të etnisë dhe gjeografisë shqiptare brenda këtij shteti. Vjena mendonte se një shtet i pavarur dhe i konsoliduar shqiptar do të pengonte shtrirjen e interesave sllave të Ballkanit dhe të Rusisë, dhe me këtë rast do të ruheshin edhe interesat politike dhe gjeostrategjike të mbretërisë dualiste në rajonin e Ballkanit. Në seancën e parë të Konferencës, Edward Grey ftoi ambasadorin e Austro-Hungarisë për të shfaqur pikëpamjet e tij për zgjidhjen e konfliktit, posaçërisht për të paraqitur propozime për paqësimin e rajonit të Ballkanit tashmë të gjendur në luftë në mes të aleatëve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane.

Në deklarinë e ambasadorit Mensdorf në mes tjerash u bë i qartë qëndrimi i vendosur i Austro-Hungarisë për krijimin e një shteti autonom shqiptar si një zgjidhje e qëndrueshme. Vjena i shqyrtoi edhe kërkesat serbe për një shteg daljeje në Adriatik, por duke kundërshtuar me vendosmëri sovranitetin serb mbi ndonjë port shqiptar apo rrugë që do të lidhej me këtë port³⁰. Pra diplomacia e mbretërisë dualiste mund të pranonte vetëm dalje tregtare të Serbisë në Adriatik përmes Shqipërisë dhe asnjëherë asnjë formë të sovranitetit serb në territorin shqiptar. Kërkesa serbe për port me dalje të përhershme nga Shëngjini deri në Shkumbin nënkuptonte ndarjen praktike të Shqipërisë, dhe ky fakt do t'i krijonte lehtësira Malit të Zi për pushtimin e territoreve të Veriut dhe Greqisë për pushtimin e territoreve jugore shqiptare.

Pas Mensdorfit, Eduar Grey ia dhe fjalën ambasadorit rus kontit Benkendorf për të parashtruar pikëpamjen e Rusisë. Pritej që ai të paraqiste kërkesat për një port në Adriatik nën sovranitetin serb, për të cilin Rusia, kishte mbajtur deri në këtë kohë një qëndrim të vendosur, si dhe të një rruge hekurudhore që do të lidhte Serbinë me këtë port. Por ai pranoi si rrugë zgjidhje pikëpamjen e Mensdorfit për t'i siguruar Serbisë vetëm një shteg daljeje në Adriatik nëpërmjet një rruge hekurudhore ndërkombëtare dhe një porti të neutralizuar³¹.

³⁰ Po aty

³¹ AIHT, Dosja, A-IV-218

Qëndrimi i ambasadorit Benkendorf e lehtësonte gjer në një farë shkalle punën e vështirë të Edward Greyt për afrimin e pikëpamjeve midis dy grupeve kundërshtarë dhe për arritjen e kompromiseve reciproke. Në këto kushte ai bëri presione të shumta që të arrihej një marrëveshje të paktën mbi disa nga pikat ku pikëpamjet ishin më të afëruara. Shtensionimi i situatës dhe afrimi i pikëpamjeve ruse dhe austro-hungareze jepte shpresë që mund të gjendeshin rrugë kompromisi edhe për çështje të tjera që konsideroheshin të hapura, të rëndësishme dhe me interesa për palët.

Në mbledhjen e parë lindi edhe një problem shqetësues. Ambasadori rus, në formulimin mbi kufijtë e shtetit të ri shqiptar përdori fjalë që nënkuptonte aludim në revizionimin e kufijve në të ardhmen. Në këtë kuptim ai përmendi kufirin me Malin e Zi në veri dhe Greqinë në jug. Insistimi i diplomatit rus për rishikimin e kufijve të Shqipërisë në të ardhmen në favor të Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë u bë objekt diskutimesh të gjata dhe siç del edhe nga rezolutat përfundimtare nuk u arrit mirëkuptimi dhe kjo çështje u shty për t'u diskutuar në një nga seancat e tjera të Konferencës. Me propozimin për shtyrjen e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Edward Grey kishte për qëllim afrimin e pikëpamjeve dhe diskutimin në radhë të parë të atyre çështjeve ku mund të arrihej kompromisi. Grey si diplomat i rryer dhe me eksperiencë mendonte se renditja e çështjeve për t'u zgjidhur duhej bazuar në kompleksitetin e tyre dhe në rezultatet konkrete që mund të arriheshin për secilën veç e veç. Trajtimi në fillim i çështjeve të papajtueshme në mes palëve ishte humbje kohe dhe dështim i zgjidhjes së problemeve që mund të prodhonte efekte negative edhe për çështjet e hapura më pak të ndjeshme. Prandaj diplomati britanik ofronte palët rreth çështjeve që zgjidheshin më me lehtësi dhe kështu krijohej logjika pozitiviste e trajtimit dhe krijohej përshtypja se çështjet kishin filluar të zgjidheshin pavarësisht nga vështirësitë dhe kompleksiteti i tyre.

Konferenca arriti disa marrëveshje qysh në mbledhjen e parë të saj. Dakordimi i parë ishte për autonominë e Shqipërisë, marrëveshje e dytë për sigurimin e një dalje tregtare për në Adriatik për Serbinë dhe së fundi mbi të drejtën e Serbisë që të zgjidhte trasenë e rrugës hekurudhore që do të lidhte me portin e Durrësit.³²

Marrëveshjet e arritura ambasadorët ua përcollën qeverive respektive, të cilat i aprovuan brenda tre ditëve. Kështu më 20 dhjetor 1912, Edward Grey, i ngarkuar nga konferenca, shpalli komunikatën

³² Frasher Demaj, *Britania e Madhe...* f. 313.

zyrtare të aprovimit të vendimeve nga Fuqitë e Mëdha. Kjo datë konsiderohet si data që Fuqitë e Mëdha njohën në parim krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, për shtrirjen dhe kufijtë e të cilit ende nuk ishin marrë vendime, sigurisht për arsye të kompleksitetit dhe pengesave të vazhdueshme të shfaqura nga Rusia e cila në Konferencë luante rolin e protektorit pansllavist.

Diskutimet për kufijtë vazhduan bile me ashpërsi dhe vështirësi të shumta, por të gjitha këto diskutime duhet të plotësonin vendimin e 17 dhjetorit, i cili u aprovua më 20 dhjetor 1912 dhe që thoshte:

“Ambasadorët u rekomanduan qeverive të tyre aprovimin në parim të autonomisë së Shqipërisë, me propozim që t’i garantojë Serbisë një dalje në Adriatik. Të gjashtë fuqitë kanë rënë dakord nëpër të dy këto pika.”³³

Konferenca e ngarkoi ministrin Edward Grey që t’i bënte edhe një komunikim konfidencial të ngarkuarit me punë të Serbisë në Londër, lidhur me marrëveshjet e arritura për Serbinë për një rrugëdalje në Adriatik nëpërmjet një hekurudhe ndërkombëtare dhe një porti neutral³⁴. Në lidhje me këtë marrëveshje, ambasadori rus kërkoi që t’i njihet Serbisë e drejta për të zgjedhur territorin për trasenë e hekurudhës dhe të portit, si edhe për pjesëmarrjen e Serbisë në kontrollin ndërkombëtar dhe veprime të tjera që do ta fuqizonin prezencën serbe në territorin shqiptar.

Me këtë kusht kufizohej edhe më shumë sovraniteti i shtetit të ri shqiptar dhe lihej mundësia e përhershme për ndërhyrjen e Serbisë dhe cenimin e sovranitetit të një shteti të pavarur. Edward Grey bëri të gjitha përpjekjet tek ambasadorët e tjerë që të aprovonin kërkesën ruse duke arritur të sigurojë përkrahjen e ambasadorëve francez, gjerman, italian dhe britanik, ndërsa ambasadori austro-hungarez vendosi t’ia kalojë çështjen për shqyrtim qeveris së tij në Vjenë, pasi nuk ndjehej i sigurt në marrjen e vendimit pa u konsultuar me qeverinë e tij, meqë çdo propozim që vinte nga Rusia kishte tri qëllime kryesore. Qëllimi i parë ishte tendenca për të mos lejuar fuqizimin e Austro-Hungarisë në rajon, e dyta qëndrimi kundër formimit të shtetit shqiptar dhe përfshirjes së territoreve etnike brenda tij dhe qëllimi i tretë ishte realizimi i

³³ Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë (më tej AIHP), Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 302, dok. IV, Nr. 403

³⁴ AIHT, Dosja, A-IV-218

platformës së synuar bashkë me sllavët e Ballkanit për zgjerimin dhe fuqizimin e shteteve të tyre.

Megjithatë në mbarim të mbledhjes së parë u miratuan dy rezoluta: njëra ftonte qeverinë e Austro-Hungarisë dhe atë të Italisë, si iniciator të propozimit për një Shqipëri autonome që të paraqitnin pikëpamjet e tyre për organizimin e shtetit të ardhshëm autonom shqiptar dhe tjetra ftonte qeverinë ruse të paraqiste projektin për daljen e Serbisë në Adriatik³⁵.

Kontradiktat e mëdha që dolën në shesh gjatë mbledhjes së parë të konferencës, dhe mospajtimet për çështjet e kufijve të shtetit të ri shqiptar, ndikuan që konferenca të zgjasë punimet e saj dhe të vazhdojë konsultimet për gjetjen e kompromiseve të nevojshme. Në këtë mënyrë, projekti austro-hungarez dhe italian mbi organizimin e shtetit të ri shqiptar, si edhe projekti rus për daljen e Serbisë në Adriatik u paraqitën në konferencë më 8 maj 1913, domethënë për më se 5 muaj e gjysmë nga data që u aprovuan rezolutat.

Gjatë kësaj kohe, midis personaliteteve shtetërore të vendeve të interesuara ishin bërë shumë shkëmbime mendimesh mbi organizimin shtetëror të Shqipërisë. Në pikëpamjet që i kishte paraqitur ministri i Jashtëm Austro-Hungarez, Berhtoldi³⁶, kolegut të tij italian, San Xhuliano³⁷, mendonte që Shqipëria të kishte në krye një princ, por ky të mos ishte turk, pasi të krishterët e jugut do të afroheshin me Greqinë dhe katolikët me Malin e Zi. Gjithashtu ai kishte hequr dorë nga suzereniteti i sulltanit dhe thoshte se mund të kishte vetëm një suzerenitet nominal. Me këtë pikëpamje, dëshmohej se Austro-Hungaria ishte e vendosur që Shqipëria të drejtohet nga një princ i krishterë, emri i të cilit do të njoftohej pas konsultimeve me partnerë të interesuar për Shqipërinë.

Në një njoftim të ambasadorit Zhyl Kambo të datës 7 nëntor 1912 dërguar qeverisë franceze thuhej se markezi San Xhuliano në një takim me ambasadorin francez në Berlin kishte deklaruar se kishte një marrëveshje të fshehtë italo-austro-hungareze të vitit 1901 në të cilën thuhej se Austro-Hungaria dhe Italia janë të vendosura që ta mbajnë

³⁵ AIHT, Dosja, A-IV-218

³⁶ Konti Leopold Berchtold (1863-1942) ishte diplomat karriere. Kishte shërbyer në Paris, Londër dhe në Shën Peterburg. Në vitin 1912 u emërua ministër i Jashtëm i Mbretërisë Austro-Hungareze. Dha dorëheqje nga ky funksion në vitin 1915.

³⁷ Antonio Paterno, Markezi San Xhuliano (1852-1914) ishte politikan ambicioz dhe i kulturuar. Në moshën 27 vjeçare ishte zgjedhur kryetar i qytetit të tij të lindjes, Katanias. Në vitin 1906 emërohet ambasador i Italisë në Londër ku qëndroi tre vjet radhazi. Aty u dekorua me "honoris causa" nga Universiteti i Oksfordit. Ishte mik i Ismail Qemalit.

Shqipërinë të paprekur nën flamurin osman dhe në rastin kur ky flamur do të zhdukej, të garantojmë pavarësinë e Shqipërisë pa lejuar asnjë fuqi të futej aty.³⁸ Nga ky konstatim vërtetohet se dy fuqitë rajonale si Vjena dhe Roma në parim pajtoheshin për çështje thelbësore siç ishte pavarësia e shtetit shqiptar dhe autoriteti drejtues për të cilin do të vendosnin Fuqitë e Mëdha.

Pikëpamja ruse dallonte nga austro-hungarezët dhe italianët. Rusia ishte kundër emërimit të një princi, por për një guvernator të caktuar nga sulltani dhe të varur nga fuqitë e mëdha, të cilat duhet të ushtronin kontroll të gjithanshëm. Pra rusët dëshironin që shteti shqiptar të mos shkëputej nga vartësia osmane në mënyrë që të vazhdonte agonja e shqiptarëve në këtë marrëdhënie specifike me Stambollin, të mos mund të konsolidoheshin dhe të ndërtonin shtetin e tyre në mënyrë që në rastin e parë të shfrytëzohej rënia e Perandorisë Osmane dhe pafuqia e shqiptarëve për të realizuar ëndrrën e kahmotshme sllave për të vënë dorë mbi gjithë territorin shqiptar si në kohën e Perandorisë së Rashës. Këtë pikëpamje proruse e përkrahte edhe Franca.

Më 15 korrik ambasadorët e këtyre qeverive i paraqitën Konferencës një projekt të ri me pikëpamjet e tyre. Diskutimet rreth këtij projekti ishin nga më të ashprat dhe zgjatën gjer më 29 korrik 1913. Në diskutimin e këtyre kontradiktave Britania e Madhe luajti rolin kryesor. Edward Grey bëri përpjekje të pashembullta që të gjente rrugën e kompromisit midis palëve. Ai në mes të tjerash theksonte: “Unë propozoj që për arritjen e një marrëveshjeje të zgjidhet një princ për Shqipërinë për një kohë të caktuar dhe ndërkaq kontrolli mbi administratën e Shqipërisë t’i besohet një Komisioni ndërkombëtar, i cili do të raportojë në kohë të caktuar mbi zbatimin e porosive”.³⁹ Ky qëndrim më shumë përafrohej me konceptin e Vjenës dhe interesat e shqiptarëve e më pak me tendencat ruse për udhëheqjen dhe kontrollin ndërkombëtar të shtetit shqiptar. Grey për këto dy çështje kërkonte mirëkuptimin dhe përgjigjen urgjente të ministrit të Punëve të Jashtme të Rusisë sergej Sazonov meqë ky ishte autoriteti kryesor që dirigjonte qëndrimet ruse në Konferencë përmes ambasadorit Benkendorf.

Si rezultat i përpjekjeve të ministrit të Jashtëm Edward Grey u gjend rruga e afimit të pikëpamjeve dhe më 29 korrik të vitit 1913,

³⁸ Raymond Poincare, *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike dhe Konferenca e Londrës 1912-1913...* Telegram i Jules Cambon nr. 405, 7 nëntor 1912, f. 301.

³⁹ AIHP, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 908, dok. Nr. 1141

konferenca aprovoi projektin austro-hungarez dhe italian të ndryshuar me këtë përmbajtje:

1. Shqipëria bëhet principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme, sipas rendit të lindjes së parë, nën garancinë e 6 fuqive të mëdha. Princi do të caktohet nga të 6 fuqitë.
2. Çdo lidhje suzereniteti midis Shqipërisë dhe Perandorisë Osmane përjashtohet.
3. Shqipëria shpallej shtet asnjane, asnjansia e saj garantohet nga të gjashtë fuqitë e mëdha.
4. Kontrolli mbi shtetin shqiptar do të ushtrohej nga KNK⁴⁰-ja e përbërë nga delegatë të 6 fuqive dhe një delegati shqiptar.
5. Kompetencat e këtij Komisioni do të vazhdojnë 10 vjet dhe në rast nevojë mund të zgjatën.
6. Ky Komision do ta ngarkohet të përpunojë një projekt organizimi të hollësishëm për të gjitha degët e administratës së Shqipërisë. Ai do t'u paraqitet fuqive, në një afat prej 6 muajsh, një raport mbi rezultatin e punës së tij, si dhe përfundimet e tij në lidhje me organizimin administrativ dhe financiar të vendit.
7. Princi do të emërohet brenda një afati jo më vonë se 6 muaj. Duke pritur emërimin e tij dhe formimin e qeverisë kombëtare definitive, funksionimi i autoriteteve ekzistuese i vendit, si dhe i xhandarmërisë do të kontrollohet nga Komisioni ndërkombëtar.
8. Qetësia dhe rendi publik do të sigurohen nga organizata ndërkombëtare e xhandarmërisë. Kjo organizatë do t'u besohet oficerëve të huaj që do të kenë komandën eprore dhe efektive të xhandarmërisë.
9. Këta oficerë do të merren nga ushtria suedeze.
10. Misioni i oficerëve instruktorë të huaj nuk do të cenojë as uniformitetin e shërbimit as përdorimin e oficerëve, nënoficerëve dhe xhandarëve vendës⁴¹.

Aprovimi i këtij projekti nga Konferenca e ambasadorëve në Londër është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të afrimit të koncepteve të palëve antagonistë vendimmarrëse të cilat shpeshherë i betononin qëndrimet e veta pa i dhënë gjasë kompromisit dhe zgjidhjeve praktike.

⁴⁰ KNK- Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit

⁴¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë...* f. 31.

Kjo marrëveshje nuk i kënaqte interesat e popullit shqiptar dhe Qeverisë së Përkohshme të drejtuar nga Ismail Qemali sepse brenda këtyre pikave nuk përfaqësohet vullneti politik i shqiptarëve që kishin bërë përpjekje të pakompromis për përfshirjen e territoreve etnike të ndara në katër vilajete dhe shtetin e pavarur kombëtar.

PERPLASJET E DIPLOMACISË RUSE DHE AUSTRO-HUNGAREZE PËR ÇËSHTJEN E PËRFSHIRJES TERRITORIALE DHE KUFIJVE TË SHTETIT SHQIPTAR

Çështja e kufijve të shtetit të ri shqiptar ishte një nga preokupimet kryesore dhe qëndrimeve pro dhe kontra brenda Konferencës së Ambasadorëve. Interesat e shqiptarëve kërkonin që brenda këtij shteti të përfshiheshin territoret e banuara etnikisht me shqiptarë. Mirëpo fuqia politike dhe diplomatike e qeverisë së Ismail Qemalit në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare, për arsye të shumta, gati nuk ekzistonte fare. Gjithçka që mund të bëhej për këtë çështje ishte nga shqiptarët patriotë vullnetmirë përfshirë këtu edhe delegacionin e Qeverisë së Përkohshme që kishin udhëtuar në Londër, që në kthinat e ndërtesës ku mbahej konferenca, të mund të takonin direkt ose përmes lobimit ndonjë nga përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse për të kërkuar përkrahjen e tyre.

Ambasadori i Austro-Hungarisë Mensdorf kishte propozuar që të gjitha territoret e banuara me shqiptarë të përfshiheshin në shtetin e ri kurse Mali i Zi të mbetej me kufijtë që kishte pasur me Perandorinë Osmane. Ai propozoi një vijë kufitare që do të përfshinte brenda territorit shqiptarë qytetet si Peja, Gjakova, Prizreni, Shkodra, Dibra, Korça dhe Janina duke vazhduar kufirin me Greqinë deri në jug të Janinës dhe në Parga.⁴² Atij iu kundërpërgjigj menjëherë ambasadori rus Benkendorf, i cili kërkoi zgjerimin e kufijve, posaçërisht të Serbisë dhe Malit të Zi dhe tkurrjen e përfshirjes territoriale të shtetit shqiptar. Planin e zgjerimit të Serbisë dhe Malit të Zi ai kishte paraqitur qysh në fillim të dhjetorit duke dhënë edhe një hartë me hollësitë e projektit rus. Ky plan e kishte bindur edhe Greyn i cili ishte shprehur se “kjo hartë dukej e shkëlqyeshme”⁴³ dhe se Austria nuk kishte arsye të mos e pranonte. Sekretari i Jashtëm Grey përkrahu kërkesën e ambasadorit

⁴² Basil Kondis, *Greece and Albania 1908-1914*, Thessaloniki 1976, f. 94-95.

⁴³ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 278, dok. Nr. 374

Benkendorf, sipas të cilit kufiri verilindor i Shqipërisë do të vazhdonte vijën nga liqeni i Ohrit drejt rrjedhjes së Drinit të Zi, për t'i lënë Shqipërisë Dibrën dhe në fund të vazhdohej Drini i Bardhë gjer në Bunë e drejt në Adriatik. Pra plani rus i përfshinte gjithë Kosovën dhe krahinat e tjera përgjatë kufirit verior dhe verilindor.

Lufta më e ashpër në Konferencë u zhvillua mbi çështjen e Shkodrës. Kërkesa e Vjenës për t'ia lënë Shkodrën Shqipërisë ndeshi në kundërshtimin e Rusisë të përkrahur nga Franca dhe Britania e Madhe⁴⁴. Problemi i Shkodrës u lidh ngushtësisht me fatin e vijëzimit të kufirit verilindor e lindor të Shqipërisë dhe me debatet e ashpra të Austrisë dhe Rusisë si protagoniste kryesore të ndërlidhura ngushtësisht me interesat e tyre në përcaktimin e vijës kufitare që do të ndante Shqipërinë me vendet fqinje.

Diplomacia italian përkrahte qëndrimin e Austro-Hungarisë për krijimin e shtetit të ri shqiptar, por në çështjen e Shkodrës ajo paraqitej e lëkundur për disa interesa specifike të saj. Megjithëse e pranonte që Shkodra ishte qytet shqiptar, Italia ishte dakord t'i lihej Malit të Zi, duke e justifikuar këtë me heqjen dorë të Rusisë nga kërkesa për t'i dhënë Serbisë portin e Durrësit.⁴⁵ Pra italianët mbronin interesin e tyre që në këtë rast ishte vija e gjatë bregdetare dhe qyteti strategjik i Durrësit para Shkodrës që ishte më larg ndikimit dhe interesave të saj. Austria qëndronte e vendosur dhe pranoi të bënte lëshime vetëm në kufirin lindor, duke i dhënë Serbisë Prizrenin dhe Pejën që kish kërkuar ambasadori rus në mbledhjen e 17 dhjetorit⁴⁶.

Nga këto zhvillime shihej se fati i kufijve të shtetit etnik shqiptar po rrëshqiste gradualisht në terrenin e pakompromis të rivalitetit të Fuqive të Mëdha, të cilat duke shfrytëzuar fuqinë e tyre vendimmarrëse përfaqësonin interesat e veta pa e njohur të drejtën historike, etnike dhe shprehjen e vullnetit politik të shqiptarëve për shtet të pavarur me shtrirje në gjeografinë etnike.

Më 22 Janar 1913, u zhvillua një takim tjetër i ambasadorëve për shqyrtimin e çështjeve të kufirit lindor. Austria këmbëngulte dhe ishte e vendosur që të largohej nga konferenca në rast se do të kërkohej dorëzimi i Shkodrës Malit të Zi⁴⁷. Ky kërcënim ndikoi që ambasadori italian ndryshoi qëndrimin e tij duke përkrahur Austrinë. Me këtë rast

⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar III*, Tiranë, 2007, f. 23.

⁴⁵ *Po aty*

⁴⁶ AIHT, A-IV-218

⁴⁷ AIHP, Fondi: Dokumente Austro-Hungareze, Dosja nr.3.

ambasadorët u ndanë në dysh: Britania e Madhe, Rusia dhe Franca për projektin rus, ndërsa Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia kundër këtij projekti. Edward Grey e pa se pengesat ishin të pakapërcyeshme dhe vendosi t'i propozojë Konferencës pezullimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, për t'i lënë mundësi diplomacisë së fshehtë të kërkojë rrugët e zgjidhjes.⁴⁸

Që Shkodra banohej vetëm nga shqiptarët ky fakt ishte shumë i qartë edhe nga malazezët dhe rusët. Vetë ministri i Jashtëm Grey, më 14 janar të vitit 1913, në një bisedim që pati me ambasadorin rus e gjeti të vështirë të gjente qoftë edhe një argument për t'ia dhënë Shkodrën Malit të Zi.⁴⁹ Pra, Grey nuk kishte asnjë dilemë për përkatësinë kombëtare të Shkodrës dhe faktit se kujt do të duhej t'i takonte, mirëpo nevoja për kompromise, për gjetjen e zgjidhjeve dhe vendosjen e paqes ishin faktor determinues të pozicionimit e diplomacisë britanike karshi problemeve që ngriteshin nga diplomacitë rivale, e drejta historike e bazuar mbi elementin etnik dhe pretendimet shoviniste të bazuara mbi luftën dhe fitoren ndaj ushtrisë osmane. Edhe vetë ambasadori rus e pranoi që Shkodra është thjesht shqiptare, por këmbënguli që t'i mbetej Malit të Zi, dhe në qoftë se kjo do të ishte e pamundur, të krijoheshin mundësi për kompensim me territore të tjera⁵⁰.

Ambasadori austriak kishte pranuar që nga kufijtë e Shqipërisë, të hiqte dorë vetëm nga Prizreni, me kusht që t'i jepej përkrahje në pikat e tjera. Këtë qëndrim ai e ripërsëriti në të gjitha seancat e Konferencës në vazhdimësi. Por kur fuqitë e Antantës bënë presione për Shkodrën, duke hequr dorë nga kufijtë lindorë, Mensdorfi filloi të lëshojë një nga një distriktet e lindjes. Pas Prizrenit ai lëshoi edhe Pejën. Ambasadori rus Benkendorf i deklaroi Edward Greyt më 14 janar të vitit 1913 se nga Shkodra do të hiqej dorë vetëm në rast se do t'i jepej Serbisë satisfaksion i plotë në kufijtë lindorë.⁵¹ Rusët kërkuan që të paktën katër rrethet: Prizrenin, Pejën, Dibrën dhe Gjakovën t'i merrte Serbia dhe për këtë çështje të mos kishte asnjë zë kundërshtues.

Më 31 janar 1913, Grey zhvilloi një diskutim të gjatë me ambasadorin gjerman Lichnowski, ku i propozoi që Gjermania të pranonte

⁴⁸ TNA, Albania FO 195/2406

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Më gjerësisht për qëndrimin e Rusisë shih: Muhamet Shatri & Ramiz Abdyli, *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912*. Prishtinë 2006.

⁵¹ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 406, dok. Nr. 507

zgjidhjen me kompromis duke i dhënë Malit të Zi Bunën dhe rajonin e Kastratit, ndërsa Serbisë t'i jepej vetëm Prizreni dhe Peja".⁵²

Kompromisi i propozuar nga Edward Grey nuk u pranua nga Austria për shkak se vendet që do të përjashtoheshin nga kufijtë e shtetit shqiptar kishin jo vetëm rëndësi strategjike, por ishin të populluara nga katolikë ku shtrihej influenza austriake. Në këto kushte Edward Grey bëri një propozim tjetër, pikërisht atë propozim që kërkonte Rusia: t'i lihej Shqipërisë Shkodra duke ia kompensuar Serbisë Prizrenin, Pejën, Dibrën dhe Gjakovën. Diskutimet e ashpra diplomatike pro dhe kontra, sidomos ato ruse dhe austro-hungareze, ndikuan që paqja e Evropës për javë të tëra të varej nga fati i Pejës, Prizrenit, Dibrës dhe Gjakovës.⁵³

Propozimi i ri britanik u konsiderua si i pranueshëm edhe për Gjermaninë dhe Italinë, të cilët ushtronin influencën e vet mbi Austrinë. Por Austria nuk mund t'i pranonte njëherësh këto për shkak të përshtypjes që do të krijohej sidomos në opinionin publik shqiptar. Në këto kushte ajo pranoi të heqë dorë nga Prizreni, Peja dhe Dibra, ndërsa për Gjakovën deklaroi se nuk do të lejojë t'i shkëputej Shqipërisë.

Në muajin shkurt të vitit 1913, diskutimet midis fuqive të mëdha për territorin që do të përfshihej brenda kufijve të Shqipërisë kishin arritur kulmin. Ambasadori gjerman, në një takim që pati me Edward Grey, e njoftoi se qeveria e tij kishte bërë të gjitha përpjekjet për të bindur qeverinë austriake të hiqte dorë edhe nga Gjakova, por kjo nuk ishte e mundur. "Ajo mund të pranojë vetëm të lërë Gjakovën në shkëmbim me Dibrën, në rast se juve do të preferoni Gjakovën më shumë".⁵⁴ Koncesionet e reja austriake për Dibrën u shtruan edhe në mbledhjen e ambasadorëve të datës 6 shkurt 1913. Megjithatë kjo tregonte një hap përpara për arritjen e marrëveshjes, ambasadori rus nuk u kënaq dhe insistoi që Austria të hiqte dorë edhe nga Gjakova.⁵⁵ Pra rusët insistonin deri në fund që të shkëpusnin sa më shumë territore për aleatët e tyre Serbinë dhe Malin e Zi, kurse mbretëria dualiste ishte e përcaktuar dhe bënte përpjekje të pakompromis që sa më pak të përfitonin territorialisht aleatët rusë, kundërshtarë të politikës austro-hungareze.

⁵² AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 466, dok. Nr. 581

⁵³ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914...* f. 471.

⁵⁴ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 516, dok. Nr. 638

⁵⁵ AIHP, Fondi: Dokumente Austro-Hungareze, Dosja nr.3

Në fillim të muajit mars 1913, Edward Grey i bëri një propozim tjetër ambasadorit austriak që si shkëmbim për Shkodrën t'i lihej Shqipërisë Gjakova dhe Dibra, por ambasadori e kundërshtoi duke i thënë se për Shkodrën kemi bërë koncesione shumë të mëdha, duke i lënë Serbisë Dibrën, Pejën dhe Prizrenin dhe asgjë më shumë nuk do të pranohet nga qeveria e Vjenës.⁵⁶

Duke parë vështirësitë që i dilnin përpara, Edurd Grey i propozoi qeverisë ruse më 4 mars 1913, që të jepte pëlqimin për formimin e një "Komisioni Ndërkombëtar që të shqyrtonte problemin e Gjakovës"⁵⁷, meqë nuk po arrihej të gjendej një marrëveshje kompromisi

Edward Grey vazhdonte edhe presionet mbi Austrinë për të pranuar që edhe Gjakova, distrikti i fundit që kërkonte Rusia për kompensim të Shkodrës, të shkëputej nga shteti i ri shqiptar. Në të njëjtën kohë, i kërkoi qeverisë ruse që të deklaronte publikisht se "po të vendoset çështja e Gjakovës, Rusia do të pengojë trupat e Malit të Zi që të marrin Shkodrën dhe do të sigurojë tërheqjen e trupave serbo-malazeze nga territoret që do t'i lihen Shqipërisë".⁵⁸ Pra Grey ishte shumë i interesuar që duke gjetur rrugën e kompromisit t'i mbyllte çështjet e hapura që mund të prodhonin papajtueshmëri të përhershme dhe të mbeteshin konflikte të ngrira.

E ndodhur përballë presioneve të vazhdueshme, Austro-Hungaria u tërhoq nga qëndrimi i saj dhe më 10 mars 1913 u njoftua Edward Grey se: "Çështje kryesore për Austrinë është dhënia fund e përpjekjeve për pushtimin e Shkodrës, duke u tërhequr sa më parë trupat serbo malazeze. Ndërsa çështja e Gjakovës të zgjidhet veçmas nga një Komision Ndërkombëtar për të cilin ishte pajtuar më herët edhe diplomacia britanike"⁵⁹. Tërheqja e Vjenës nga pozicionet e saj të deriatëhershme u prit pozitivisht nga diplomacia ruse. Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë, Sazonov-i, në një bisedim që pati me ambasadorin austro-hungarez në Petersburg, përveç toneve pozitiviste që shprehu me rastin e gjetjes së kompromisit me Vjenën, shfaqti pajtimin e plotë që t'i besohet Edward Greyt krijimi i Komisionit për çështjen e Gjakovës.

⁵⁶ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 555, dok. Nr. 683

⁵⁷ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 522, dok. Nr. 646

⁵⁸ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 564, dok. Nr. 692

⁵⁹ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 564, dok. Nr. 691

Grey e kishte e qartë se Komisioni nuk mund të gjente asnjë argument apo shkas për t'i dhënë Serbisë Gjakovën, prandaj në telegramin e përgjigjes ambasadorit Bukanan i shkroi: “Për sa i përket emërimit nga ana ime të Komisionit që do të përcaktonte se kujt i përket Gjakova, Shqipërisë apo Serbisë, një gjë e tillë do të më ekspozonte mua, për shërbim të keq dhe të njëanshëm”.⁶⁰ Pra Grey e dinte se pa asnjë fije dyshimi Gjakova ishte qytet shqiptar dhe do të ishte padrejtësi t'i jepej Serbisë. Megjithatë ai kërkoi që Austro-Hungaria të pranojë dhënien e Gjakovës në shkëmbim me Shkodrën nëse për Vjenën ishte më e rëndësishme Shkodra.

Austro-Hungaria, pranoi që t'ia linte Gjakovën Serbisë me kusht që të caktoheshin menjëherë kufijtë veriorë dhe lindorë të Shqipërisë, të pushonin menjëherë luftimet nga ana e ushtrive serbo-malazeze në tokat shqiptare dhe të fillonte tërheqja e tyre. Më 22 mars 1913, Grey e thirri përsëri Konferencën e Ambasadorëve për të komunikuar akordin e arritur, i cili u ratifikua nga fuqitë e mëdha më 26 mars 1913⁶¹.

Mbi parimin e marrëveshjeve të arritura, sekretari i Jashtëm britanik, më 26 prill 1913 në emër të konferencës kërkoi nga Mali i Zi të lironte Shkodrën se ndryshe do të kishte përballë Fuqitë e Mëdha.⁶² Krahas kësaj, ai kërkoi ndërhyrjen e Rusisë për ta bindur Malin e Zi të hiqte dorë dhe të respektonte vendimet e Konferencës. Megjithatë Mbreti Nikolla hezitonte të hiqte dorë nga pushtimi i Shkodrës dhe synimet për ta përfshirë këtë qytet brenda kufijve të shtetit të tij dhe insistonte me kërkesa drejtuar Konferencës që ta njihnin sovranitetin malazez mbi Shkodrën.

Grey në notën e tij diplomatike të përgatitur për Konferencën deklaronte: “Në qoftë se qeveria malazeze do ta lirojë Shkodrën, ajo do të presë ndihma financiare nga Fuqitë e Mëdha. Në qoftë se nuk e liron Shkodrën, sigurisht ajo do të dëbohet me një mënyrë apo tjetrën, duke humbur edhe rastin për ndihma nga Fuqitë e Mëdha”.⁶³ Nota e Greyt u prit me reagime nga malazezët, të cilët kërkonin ndërhyrjen dhe këmbënguljen e Rusisë. Mirëpo këto thirrje ishin të kota meqë marrëveshja në mes fuqive dhe ratifikimi i saj nënkuptonte që kjo çështje

⁶⁰ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 607, dok. Nr. 741

⁶¹ AIHT, Fondi A-IV-218

⁶² TNA, Albania FO 195/2406

⁶³ AIHT, Fondi: Dokumente britanike-Foreign Office- London, British Documents on the origins of the war 1898-1914, f. 746, dok. Nr. 922

ishte e mbyllur pa asnjë mundësi rikthimi për revidim të vendimit për Shkodrën.

Më 4 maj 1913 Austria vuri në gatishmëri luftime forcat e saj dhe urdhëroi demonstrime navale të njëanshme në Tivar. Ky qëndrim i vendosur i Austrisë e tronditi qeverinë ruse dhe ndërhyri urgjent pranë mbretit të Malit të Zi, për të pranuar menjëherë kërkesën e Fuqive të Mëdha për lëshimin e Shkodrës. Diplomacia ruse druanë se në rast të ndërhyrjes ushtarake të Austro-Hungarisë ndaj Malit të Zi, ky i fundit do të mund të kishte reperkusione të reja, të humbte privilegjet e ofruara nga Konferenca dhe të cenonte interesat ruse të bazuara në vendimet e Konferencës së Londrës. Kurse Edward Grey mendonte se nëse Austro-Hungaria sulmon Malin e Zi, Rusia do ta sulmojë atëherë Austro-Hungarinë; Gjermania do ta sulmojë Rusinë; Franca do të sulmojë Gjermaninë; e gjithë kjo për llogari të Shkodrës. Shkodra është një bombë e kurdisur, e cila mund t'i vërë flakën Evropës, prandaj duhet parandaluar shpërthimi.⁶⁴

Në këto rrethana të komplikuar, perandori rus i kishte dërguar telegram urdhërues Mbretit Nikolla duke i kërkuar me urgjencë që të hiqte dorë nga mbajtja e Shkodrës dhe përballja ushtarake me Austrinë. Për kokëfortësinë e mbretit Nikolla, ministri i Jashtëm rus Sazonov shprehej: "ky (Mbreti Nikolla F.D) *deshiron t'i verë zjarrin gjithë botës për ta zier vezën e tij*".⁶⁵

I ndodhur përballë kësaj situate, Mbreti Nikolla, njoftoi telegrafisht Edward Grey se pranonte dorëzimin e qytetit forcave ndërkombëtare. Në këtë mënyrë dështoi plani malazez që përveç pretendimeve territoriale ndaj Shqipërisë, synonte që të pengonte projektin ndërkombëtar të Fuqive të Mëdha për një shtet shqiptar.⁶⁶ Kështu, sipas marrëveshjes që u arrit në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, nga flota ndërkombëtare u përgatit një detashment prej 500 oficerësh dhe ushtarësh për të marrë në dorëzim qytetin e Shkodrës nga ushtria malazeze. Dorëzimi i këtij qyteti u bë më 14 maj 1913, nën-admiralit Burney.⁶⁷ Mbi kështjellë u vendos me ceremoni flamuri i flotës ndërkombëtare. Statuti i qytetit u bë i njohur nëpërmjet një proklamate të botuar në gjuhën angleze dhe shqipe nga përfaqësuesit e flotës. Kështu përfundoi drama e Shkodrës që nga shumë politikanë të kohës

⁶⁴ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914...* f. 490.

⁶⁵ Raymond Poincaré, *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike dhe Konferenca e Londrës 1912-1913...*, f. 478; Libri i Verdhë, vëllimi II, nr. 199 dhe 204-205, 2 prill 1913.

⁶⁶ Norman Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914*, Tiranë 2006, f. 429.

⁶⁷ TNA, Albania FO 195/2406

u konsiderua edhe si mundësi për t'u shndërruar në pretekst të sulmit eventual ushtarak të Austro-Hungarisë ndaj Malit të Zi që do të sillte rreshtimin e aleatëve në anën e njërit dhe tjetrit, si dhe rrezikun e përfshirjes së Evropës në një luftë me përmasa të paparashikueshme.

Me qëllim që të përfundohej çështja e kufirit verior dhe lindor në hollësi, konferenca e ambasadorëve aprovoi më 16 maj krijimin e një komisioni kufitar, të përbërë nga oficerë specialistë nga të 6 fuqitë e mëdha. Komisioni filloi punën e tij në shtator të vitit 1913, por i ndërpreu punimet në dimër për shkak të vështirësive të mëdha atmosferike⁶⁸, në pamundësi për t'i vazhduar më tej.

Marrëveshja e arritur nga Fuqitë e Mëdha për kufijtë veriorë dhe verilindor të Shqipërisë ngjalli zemërimin më të madh dhe revoltat e armatosura të popullsisë shqiptare. Konferenca la jashtë trungut kombëtar më shumë se gjysmën e territoreve shqiptare duke shpërfillur interesat e një populli të vogël dhe të pambrojtur. Përplasja e dy kampeve politiko-ushtarake, Pakti Trepalësh dhe Pakti i Antantës me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në vend se të ndikonin në krijimin e një ambienti paqësor dhe të qëndrueshëm, me vendimet e marra komplikuan edhe më tepër marrëdhëniet edhe ashtu të acaruar midis shteteve të fuqishme evropiane dhe aleatëve të tyre ballkanikë. Secila nga Fuqitë e Mëdha me shkurtpamësinë e vet dhe mungesën e përgjegjësisë u treguan të pamatura, dhe kjo shkurtpamësi hyri në memorien kolektive evropiane e veçanërisht në kujtesën e popujve, të cilët pësuan më së shumti nga vendimet arbitrare të Konferencës.⁶⁹ Me këto vendime shtetet evropiane e kthyen ekuilibrin e forcës në një garë armatimesh pa e kuptuar se po krijonin një pretekst për një luftë të përmasave të papara deri atëherë që do të vinte në rrezik arritjet e qytetërimit evropian. Armiqësitë midis shteteve dhe popujve u shpërfaqën ende pa u bërë një vit i plotë nga përfundimi i punimeve të Konferencës së Londrës, me atentatin e Sarajevës dhe fillimin e Luftës së Parë Botërore.

⁶⁸ AIHT, Fondi A-IV-218

⁶⁹ Henry Kissinger, *Diplomacia...* f. 169.

Frashër Demaj

RUSSIA'S POSITION ON THE ALBANIAN QUESTION AT THE CONFERENCE OF AMBASSADORS IN LONDON (1912-1913)

Summary

The beginning of the 20th century found Europe with inherited problems and politically divided into two antagonistic blocs. On one side the Entente consisting of Great Britain, France and Russia and on the other side the Tripartite Pact dominated by Germany, Austria-Hungary and Italy which calculated politically sometimes linked to the Tripartite and sometimes remained neutral and cooperative with the Entente, naturally for its own political and geostrategic interests.

On the other hand, the situation in the Ottoman Empire and in the Balkans was very fragile and unstable, especially after the signing of the Balkan coalition aimed at expelling Turkey from the Balkans and dividing the territories occupied by this Empire among themselves. The situation escalated to the extreme after the attacks of the Balkan Alliance against the Ottoman troops. The Balkan states supported by Russia occupied most of the territories that were ruled by the Ottoman Empire, including Albania.

The Declaration of Independence of Albania questioned the territorial claims of Serbia, Montenegro and Greece, but despite the new circumstances, the Balkan monarchies did not give up the occupation of Albanian lands.

In the circumstances of war, with the aim of establishing peace, on December 17, 1912, the work of the Conference of Ambassadors began in London, where the Great Powers had the main say in decision-making. The biggest clashes occurred between Russian and Austro-Hungarian diplomatic representatives who had diametrically opposed positions.

The diplomatic representatives of these states would discuss and reach agreement on:

"1) The possibility of creating an autonomous Albanian state and the borders it should include; 2) The methods and conditions of securing Serbia's access to the Adriatic; and 3) The issue of the Aegean islands".

Austria-Hungary was for the creation of an autonomous Albanian state as a stable and necessary solution in the process of completing the

creation of national states in the Balkans. Vienna also considered Serbian requests for an exit path to the Adriatic, but firmly opposed Serbian sovereignty over any Albanian port or road that would connect to this port.

Whereas Russia insisted that, in addition to providing Serbia with an exit to the Adriatic through an international railway route and a neutralized port, it insisted that as much Albanian territory as possible be given to Serbia and Montenegro. So the Russian position was against the interests of the new Albanian state and in favor of Pan-Slavic interests and the strengthening of Russian allies in the Balkans, Serbia and Montenegro. In these positions, in most cases, the Russian empire was also supported by its strategic partners Great Britain and France, while Austria-Hungary was supported by Germany and Italy.

Gjyljeta Mushkolaj*, Prishtinë

KATËRMBËDHJETË VJET ME KËSHILLIN E EVROPËS DHE JASHTË TIJ

Abstrakt

Në këtë artikull trajtohet çështja e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës si element kyç në rrugën për integritet evropian, e që është bazament i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Një segment i veçantë i këtij kontributi u kushtohet pengesave që Federata Ruse i kishte shkaktuar në vazhdimësi procesit të dialogut duke e penguar bashkëpunimin e Kosovës me Këshillin e Evropës, pamundësinë e aderimit në traktate të Këshillit të Evropës dhe në mekanizmat e tjerë të rëndësishëm për jetësimin e vlerave evropiane, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Në artikull bëhet një krahasim i periudhës së suspendimit të Federatës Ruse nga Këshilli i Evropës, me rastin e aneksimit të Krimesë kur Kosova ishte anëtarësuar në Komisionin e Venecias dhe në Bankën e Këshillit të Evropës për Zhvillim, me zhvillimet e këtij viti, kur më në fund, Këshilli i Evropës e përjashtoi Federatën Ruse nga anëtarësia në Këshill, për shkak të luftës në Ukrainë. Në artikull trajtohet edhe rëndësia e samiteve të krerëve të shteteve të Këshillit të Evropës në ndryshime të rëndësishme për sigurinë demokratike në Evropë.

Fjalët çelës: Këshilli i Evropës; integritet evropian; siguria demokratike; demokracia; të drejtat e njeriut; sundimi i ligjit; traktatet; marrëveshjet e pjesshme; marrëveshjet e zgjeruara; Rezoluta e KS të KB; dialogu Kosovë-Serbi.

HYRJE

Këshilli i Evropës, si organizata më e vjetër politike në Evropë, e themeluar pas Luftës së Dytë Botërore me idenë për të parandaluar kthimin e regjimeve totalitare për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore, paqen dhe demokracinë, ende mbetet element i rëndësishëm i arkiteturës evropiane të sigurisë demokratike.¹ Edhe vetë selia e Këshillit të

* Anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

¹ Gjerësisht për Këshillin e Evropës dhe funksionit e tij, shih Winkler, Günther. The Council of Europe: Monitoring procedures and the constitutional autonomy of the

Evropës në Strasburg të Francës, që për shumë shekuj ishte qendër e konflikteve midis Francës dhe Gjermanisë e tregon në menyre simbolike rëndësinë e pajtimit evropian, me themel në vlerat evropiane.²

Që nga themelimi i Këshillit të Evropës e sidomos me përfundimin e Luftës së ftohtë dhe më tutje, pas përfundimit të luftërave të përgjakshme me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, e përfundimisht edhe këtë vit me përjashtimin e Federatës Ruse për shkak të agresionit në Ukrainë, anëtarësimi i një shteti në Këshill të Evropës konsiderohet si një shenjë dalluese e legjitimitetit evropian. Anëtarësimi në Këshill të Evropës perceptohet gjithashtu edhe si një hap i parë në procesin e integritetit më të plotë në Evropë, rezultat përfundimtar i të cilit do të duhet të jetë anëtarësimi në Bashkimin Evropian.³

Përparimi “*në rrugën drejt Bashkimit Evropian*” është edhe thelb i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, si i vetmi mekanizëm formal i pranuar nga Kombet e Bashkuara për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve.⁴ Çuarja përpara e dialogut, që po zvarritet më shumë se një dekadë, pengohet seriozisht me lënien e Kosovës jashtë ombrellës së Këshillit të Evropës, e me të edhe jashtë mundësisë për nënshkrim të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut⁵ (KEDNj), një e drejtë kjo e rezervuar vetëm për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo pengesë, jo vetëm që i vë në pozitë të pabarabartë qytetarët e Kosovës përgjithësisht, të gjitha komunitetet e saj, por është bërë barrierë e rrezikshme për stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor,

member states. Springer, 2006.

² Propozimin për ta bërë Strasburgun seli të Këshillit të Evropës e ka bërë Sir Ernest Bevin. <<https://www.cvce.eu/en/education/unit-content/-/unit/026961fe-0d57-4314-a40a-a4ac066a1801/a18e2f7e-b57b-471b-99e3-f7a26b8327ca>> (qasur me 01 tetor 2022).

³ Shih Peter L e u p r e c h t, *Innovations in the European System of Human Rights Protection: Is Enlargement Compatible with Reinforcement?* 8 *Transnat&apost; l L. & Contemp. Probs.* 313, 332 (1998).

⁴ Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë është në qendër të angazhimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe plotësisht i konceptuar, projektuar dhe udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Ai është lançuar pas miratimit të Rezolutës 64/298 (2010) të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të bashkë-sponsorizuar nga Serbia dhe Bashkimi Evropian me të cilin është pranuar Mendimi Këshillues i GjND-së, se pavarësia e Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe është përcaktuar si dialog i palëve të barabarta “për të nxitur bashkëpunimin, për të arritur përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve.” General Assembly of the United Nations. (2010, September 9). UNGA Resolutions. Qasur më 9 dhjetor 2021, nga <https://undocs.org/en/A/RES/64/298>.

⁵ 1950 Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, *CETS* 005, <http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/005.htm> (accessed on 1 March 2012).

sepse, siç thekson Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, KEDNj vazhdon të luajë rolin qendror “si një instrument kushtetues i rendit publik evropian, nga i cili varet stabiliteti demokratik i kontinentit.”⁶

“Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve,” e vitit 2013, e quajtur historike nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së,⁷ dhe e prezantuar nga Komisioni Evropian po ashtu si “marrëveshja historike” që hap rrugën për përparim vendimtar në perspektivat” e Kosovës dhe të Serbisë për në Bashkimin Evropian,⁸ në pikën 14 të saj, përfshin obligimin e ndërsjellë të Serbisë dhe të Kosovës se “asnjëra palë nuk do të bllokojë ose inkurajojë të tjerët të bllokojnë përparimin e palës tjetër në rrugën e tyre përkatëse në BE.”⁹ Se sa e afekton ky zotim i ndërsjellë i Kosovës dhe i Serbisë anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, çështje kjo e pandriçuar ende në literaturë, është thelb i pandriçuar studimit në këtë artikull.

I. KOSOVA DREJT KËSHILLIT TË EVROPËS – RRUGËTIM SUI GENERIS

Përkundër faktit gjeografik se Kosova është në Evropë dhe shumë faktorëve politikë dhe konstitucionalë që lidhen me shtetndërtimin e Kosovës si shtet unik i formësuar mbi parimet themelore të Këshillit të Evropës, Kosova ka mbetur jashtë regjimit më efektiv të të drejtave të njeriut në botë, dhe me këtë, vrimë e zezë e hapësirës së zbatimit të KEDNj¹⁰ me mekanizmin unik për zbatimin e saj, Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

⁶ Declaration “Ensuring the effectiveness of the implementation of the European Convention on Human Rights at national and European levels”, 114th session, 12 May 2004 <<https://rm.coe.int/16805dd12c>> (qasur me 10 tetor 2022)

⁷ “Statement Attributable to the Spokesperson for the Secretary-General on the EU-Facilitated Dialogue between Belgrade and Pristina Secretary-General,” United Nations (United Nations), accessed November 22, 2022, <https://www.un.org/sg/en/content/sg/-statement/2013-04-19/statement-attributable-spokesperson-secretary-general-eu-facilitated>.

⁸ “Press Corner,” European Commission - European Commission, April 22, 2013, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_13_347.

⁹ “Marrëveshja e Parë e Parimeve Që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve,” Ligji nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që RREGULLOJNË Normalizimin e Marrëdhënieve Mes Republikës së Kosovës dhe republikës së Serbisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, September 17, 2013), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8892>, Pika 14.

¹⁰ 1950 Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, CETS 005,

Në anën tjetër, KEDNj me të gjitha protokollet e saj, është e integruar plotësisht brenda rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Së bashku me tetë instrumente të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ajo e mbizotëron Kapitullin e Kushtetutës që garanton të drejtat e njeriut, duke iu dhënë prioritet instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në rast konflikti me “dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”¹¹ Për më shumë, Kushtetuta e Kosovës përcakton se të gjitha të drejtat dhe liritë themelore, interpretohen bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjENDNj).¹²

Kushtetuta e Kosovës e përcakton Republikën e Kosovës si shoqëri multietnike, udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit, e inkorporon plotësisht Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, si dhe e garanton zbatimin edhe të instrumenteve të tjera të Këshillit të Evropës të rëndësishme për të drejtat e pakicave drejtpërdrejt me Kushtetutë, por edhe nëpërmjet të legjislacionit tjetër vital krahas-kushtetues.¹³ Përpos kapitullit të veçantë për mbrojtjen e të drejtave themelore individuale, një kapitull të veçantë, Kushtetuta e Kosovës ia adreson garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve etnike jo-shumicë. Këto të drejta të komuniteteve joshumicë në Kosovë nuk janë vetëm deklarata në letër. Gjykata Kushtetuese e Kosovës me disa vendime të saj e ka bërë të qartë se Kushtetuta do të interpretohet, sipas shkronjës dhe frymës së vet për t’u mbrojtur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.¹⁴

Përveç kësaj, Kushtetuta përcakton mekanizma substancialë të përpjesëtimit të pushtetit për akomodimin e serbëve dhe komuniteteve të tjera joshumicë që i tejkalojnë standardet evropiane, e që ndodh shpesh edhe të abuzohen, për shkak të ndërhyrjeve nga ana e Serbisë, duke e keqpërdorur sistemin zgjedhor të Republikës së Kosovës dhe duke e penguar komunitetin serb që të votojë në mënyrë të lirë¹⁵ dhe të ndërtojë

<http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/005.htm> (qasur me 10 tetor 2022)

¹¹ “Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare],” KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, June 15, 2008), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

¹² Shih Nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave Për Të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës

¹³ Shih Nenin 81 [Legjislacioni me Interes Vital] të Kushtetutës.

¹⁴ Për shembull Kurtisi v. The Mun. Assembly of Prizren, Case No. KO 01/09 (Const. Ct. Kos. Mar. 18, 2010), http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ko_01_09_Ven_ang.pdf.

¹⁵ Shih *EU EOM Kosovo 2021 municipal elections - final report*. EU EOM Kosovo 2021 Municipal Elections - Final report | EEAS Website. (2022, February 3). Retrieved November 7, 2022, from <https://www.eeas.europa.eu/eom-kosovo-2021/eu-eom->

ardhmërinë evropiane bazuar në vlerat më të larta evropiane dhe mekanizmat më të fuqishëm evropian për mbrojtjen e të drejtave të tyre, të integruar në rendin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Me standarde të Këshillit të Evropës brenda rendit juridik të Republikës së Kosovës, por jashtë ombrellës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me gjithë përpjekjet për avancimin e sundimit të ligjit, është bërë detyrë tejet sfiduese për Kosovën edhe përmirësimi i sistemit gjyqësor. Gjyqtarët e Kosovës, nuk përballen me ndjenjën e trazimit, që e kanë gjyqtarët e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, nëse ndodh që vendimet e tyre të sfidohen në GJEDNJ.¹⁶ Një izolim i këtillë, nëse vazhdon edhe më tutje, do të vërë në pikëpyetje edhe projektet e rëndësishme të fazës së dytë të instrumentit horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë¹⁷, duke qenë se rezultatet sado të mira të projekteve, nxitësit e nevojshëm që i kanë shtetet e tjera përfituese nga një instrument i tillë, si shtete anëtare të Këshillit të Evropës dhe palë të konventave të Këshillit të Evropës, Kosovës i mungojnë.

Mbetja jashtë ombrellës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një pengesë serioze për investimet e huaja në Kosovë, si dhe një pengesë për bashkëpunimin e mirëfilltë ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor e që ka qenë një kohë e gjatë dhe vazhdon të jetë objektivi i Rusisë për ta mbajtur të trazuar Ballkanin Perëndimor.¹⁸ Fatkeqësisht, duke e lënë Kosovën jashtë Këshillit të Evropës, brishtësia e sigurisë në gjithë Ballkanin Perëndimor dhe me të edhe e gjithë kontinentit po thellohet gjithnjë e më shumë. Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës jo vetëm që do ta përmirësonte jetën e popullit të Kosovës dhe do të kontribuonte në paqen dhe prosperitetin në Ballkanin Perëndimor, por edhe do ta përmbushte misionin e vetë ekzistimit të kësaj organizate më të vjetër evropiane, së cilës, qysh në hapat e parë të transformimit të fuqishëm

kosovo-2021-municipal-elections-final-report_en

¹⁶ Më gjerësisht për ndikimin që e ka Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në gjyqtarët nacionalë në Francë, shih më gjerësisht Keller, Helen, and Alec Stone Sweet, eds. *A Europe of rights: the impact of the ECHR on national legal systems*. OUP Oxford, 2008 fq. 28.

¹⁷ Të gjitha informacionet rreth Fazës së dytë të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë gjenden në “Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey II,” accessed November 25, 2022, [https://www.coe.int/en/ëeb/ankara/horizontal-facility-for-the-ëestern-balkans-andturkey#{%2264218814%22:\[4\]}](https://www.coe.int/en/ëeb/ankara/horizontal-facility-for-the-ëestern-balkans-andturkey#{%2264218814%22:[4]}).

¹⁸ Stronski, Paul. “Russia in the Balkans after Ukraine: A Troubling Actor.” Carnegie Endowment for International Peace, September 20, 2022. <<https://carnegieendowment.org/politika/87959>>.

të bashkësive evropiane, në atë që sot është Bashkim Evropian, i është thënë në mënyrë pezhorative, “Bukuroshe e fjetur.”¹⁹

Vendi i lënë bosh në Këshillin e Evropës me përjashtimin e Rusisë, nuk e bën Evropën sot më të bashkuar e më të sigurt, nëse Kosova vazhdon të jetë e vetmja demokraci kushtetuese e papërfshirë si shtet anëtar i Këshillit të Evropës. Me gjithë sigurinë territoriale të ofruar nga NATO-ja dhe derës së mbyllur të Rusisë në Këshillin e Evropës, Këshilli i Evropës po mbetet organizata më e rëndësishme ku Rusia vazhdon të ndikojë, përmes elementëve të saj në Serbi, e që po përdoret si mashë për të penguar sundimin e ligjit në gjithë Ballkanin Perëndimor. Siguria demokratike e (ri)proklamuar në vitin 2015²⁰, pas pushtimit të Krimesë nga Federata Ruse në vitin 2014, e përsëri e harruar dhe e ritheksuar vetëm pas agresionit Rus në Ukrainë, nuk mund të arrihet derisa një demokraci kushtetuese është e përjashtuar nga të gjitha traktatet me të cilat promovohet demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit, e që janë bazament i sigurisë demokratike.

Për më shumë, vonesa në anëtarësim të Këshillit të Evropës, është shndërruar në zinxhir ngulfatës të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke e lënë Kosovën jashtë mundësisë së aderimit në mbi dyqind traktateve ndërkombëtare.

Zhvillimi i traktateve²¹ është një nga mjetet që përdor Këshilli i Evropës për të përmbushur qëllimin e tij statutor²² për arritjen e një

¹⁹ Gjenerali De Goll e kishte quajtur Këshillin e Evropës "ajo bukuroshe e fjetur në brigjet e Rajnës" Shih Fabio Liberti, "Why we need the Council of Europe," *Le Monde diplomatique*, September 1, 2012, <https://mondediplo.com/2012/09/18council>.

²⁰ Thorbjørn Jagland, "State of Democracy, Human Rights and the Rule of Law in Europe: A Shared Responsibility for Democratic Security in Europe," Council of Europe, 2015, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=SG%282015%291&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383>.

²¹ Termi "traktat" korrespondon me përkufizimin e dhënë në nenin 2, paragrafin 1.a të Konventës së Vjenës: "traktat" nënkupton një marrëveshje ndërkombëtare të lidhur midis shteteve në formë të shkruar dhe të rregulluar nga e drejta ndërkombëtare, qoftë e mishëruar në një instrument të vetëm ose në dy ose më shumë instrumente të lidhura dhe cilido qoftë emërtimi i tij i veçantë". Përndryshe, termi "traktat" përdoret vetëm në titullin e koleksioneve të konventave të Këshillit të Evropës. Në fakt, traktatet e lidhura nën kujdesin e Këshillit të Evropës përfshijnë "konventa", "marrëveshje", "karta", "kode" dhe "konventa kornizë ose kuadër". Sido që të quhen, titulli i zgjedhur nuk ka asnjë ndikim në karakterin e tyre juridik.

²² "CETS 001 - Statute of the Council of Europe," Council of Europe (European Treaty Series - No. 1, May 5, 1949), <https://rm.coe.int/1680306052>.

unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij me qëllim të ruajtjes dhe realizimit të idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi e përbashkët tyre. Sipas nenit 1 të Statutit, Këshilli i Evropës e ndjek këtë qëllim nëpërmjet organeve të tij statutore, ndër të tjera “me marrëveshje në çështjet ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore dhe administrative dhe në respektimin dhe realizimin e mëtejshëm të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Shtetet anëtare pritet të aderojnë në konventat e miratuara nga Komiteti i Ministrave, të përcaktuara në nenin 13 si “organ që vepron në emër të Këshillit të Evropës”.

Duke krijuar një zonë të përbashkët juridike, ato i bëjnë shtetet anëtare më kohezive – në kuptim demokratik, social dhe kulturor.

Ka relativisht pak traktate që janë “të mbyllura” për shtetet joanëtare të Këshillit të Evropës. Më të njohurat janë Konventa Evropiane për Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të 4 nëntorit 1950 (ETS Nr. 5), Karta Sociale Evropiane e 18 tetorit 1961 (ETS Nr. 35), Karta Sociale e rishikuar e 3 majit 1996 (ETS Nr. 163) dhe Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Çnjerëzore ose Trajtimi ose Ndëshkimi Degradues i 26 nëntorit 1987 (ETS Nr. 126).

Sot, Këshilli i Evropës luan një rol veçanërisht të rëndësishëm në drejtimin e së drejtës ndërkombëtare, me ndikim shumë përtej kufijve të Evropës. Pjesëmarrja në shumicën e traktateve të Këshillit të Evropës nuk kufizohet ekskluzivisht në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Traktatet e këtilla janë “të hapura” për aderim nga shtetet joanëtare, madje edhe ato joevropiane, me kusht që ato të jenë ftuar zyrtarisht për t’u anëtarësuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.

Tendenca e Këshillit tani është të hapë traktate të mbyllura më parë për shtetet joanëtare, e madje edhe ato joevropiane. Për shembull, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues është hapur për shtetet joanëtare kur Protokolli i saj i parë (ETS Nr. 151) hyri në fuqi më 1 mars 2002, dhe Konventa për Shtypjen e Terrorizmit ishte në mënyrë të ngjashme hapur nga Protokolli i 15 majit 2003 (ETS Nr. 190). Për më tepër, Këshilli nuk ka miratuar asnjë traktat “të mbyllur” që nga viti 1987 dhe po përpiqet në mënyrë aktive ta zgjerojë bashkëpunimin ligjor që ekziston midis shteteve anëtare edhe në shtetet joanëtare. Në të vërtetë, disa traktate do të ishin më pak efektive nëse do të mbulonin vetëm anëtarët.

Në të njëjtën kohë, shtetet joanëtare nuk kanë të drejtë pozitive për të aderuar traktatet e Këshillit të Evropës, por duhet të ftohet zyrtarisht për ta bërë këtë nga Komiteti i Ministrave – që u jep shteteve anëtare njëfarë

kontrolli mbi anëtarësimet. Neni C i "modelit të klauzolave përfundimtare" të vitit 1980 përshkruan procedurën si më poshtë:

Pas hyrjes në fuqi të (kësaj Marrëveshjeje) (kësaj Konvente)), Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të aderojë (në këtë Marrëveshje) (në këtë Konventë)), me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të drejtë për t'u ulur në Komision.

Pra, modalitetet e aderimit nga shtetet joanëtare përcaktohen në klauzolat përfundimtare të çdo traktati. Megjithatë, përgjithësisht, që një shtet joanëtar të ftohet të aderojë në një traktat të Këshillit të Evropës, kërkohet një marrëveshje unanime e palëve.²³

Disa konventa janë kështu të hapura për shtetet joanëtare të specifikuara paraprakisht, një shembull është ai Konventës për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet tatimore (ETS Nr. 127), e cila është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare dhe "vendet anëtare të OECD-së", dhe Konventa për Njohjen e Kualifikimeve në lidhje me Arsimin e Lartë në Rajonin Evropian (ETS Nr. 165), e cila është e hapur për anëtarët, shtetet e rajonit të Evropës të UNESCO-s dhe të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar ose ratifikuar Konventën Kulturore të Këshillit të Evropës dhe/ose Konventën e UNESCO-s, dhe që janë ftuar në konferencën diplomatike përgjegjëse për miratimin e Konventës.

Nga kjo del se Kosova, edhe pse, përgjithësisht e ka të harmonizuar sistemin kushtetues dhe ligjor me standardet më të larta të instrumenteve të Këshillit të Evropës, megjithatë, praktikisht, nuk ka mundësi që të aderojë në asnjë traktat të Këshillit të Evropës, dhe as në ato që janë të hapura për shtetet joanëtare dhe as ato joevropiane, sepse në secilën variant, nevojitet pëlqimi unanime i secilit shtet anëtar, që do të thotë, edhe i Serbisë.

Në këtë kontekst, do të ishte e pakuptimtë, që në këto rrethana konfuze, Kosova të humbte energji dhe kohë për të bërë përpjekje për të aderuar në traktate të Këshillit të Evropës. Në vend të kësaj, gjithë energjinë duhet përqendruar ekskluzivisht në anëtarësim. Anëtarësimi,

²³ Për informata mbi modalitetet specifike të aderimit në traktatet "të hapura" për shtetet joanëtare është i shih më gjerësisht në faqen e informacionit të çdo traktati përkatës, në faqen e internetit të Zyrës së Traktatit. "Participation of Non-Member States - Treaty Office - Publi.coe.int," Treaty Office, accessed December 5, 2022, <https://www.coe.int/en/eeb/conventions/participation-of-non-member-states>.

do t'i hapte dyert për aderim në të gjitha traktatet e Këshillit të Evropës dhe me këtë, edhe do të përfundonte getoizimi i shtetit të Kosovës dhe i të gjithë qytetarëve të saj, së bashku edhe me komunitetin jo-shumicë serb. Njëkohësisht, do të hapej edhe një horizont i ri, i pretenduar edhe nga Krerët e shteteve dhe të qeverive të Këshillit të Evropës, për Samitin e katërt, për të “ringjallur” ndërgjegjen e vet, tani, nën flakët e luftës në Ukrainë.²⁴

II. PËRPARIMI “NË RRUGËN DREJT BASHKIMIT EVROPIAN” PA ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS?

Bashkimi Evropian (BE) dhe Këshilli i Evropës janë fryt i një ideje të përbashkët, asaj të integritetit evropian. Të dyja organizatat lindën në të njëjtën kohë, pas Luftës së Dytë Botërore.²⁵ Që të dyja përputhen gjeografikisht,²⁶ janë të ndërtuara mbi të njëjtat vlera themelore,²⁷ ndajnë flamurin e Evropës²⁸ dhe himnin evropian.²⁹

²⁴ Council of Europe, “Summit in Reykjavik to Renew 'The Conscience of Europe' - Portal - Publi.coe.int,” Neësroom (Council of Europe, November 9, 2022), <https://www.coe.int/en/ëeb/portal/-/summit-in-reykjavik-to-renew-the-conscience-of-europe->.

²⁵ KiE u themelua më 5 maj 1949 nga Traktati i Londrës (CETs nr. 1), ndërsa Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (ESCs), paraardhësi i asaj që tani është BE, u propozua nga ministri i Jashtëm francez Robert Schuman më 9 maj. 1950. Traktati përkatës i Parisit u nënshkrua më 18 prill 1951 dhe hyri në fuqi më 23 korrik 1952.

²⁶ Që të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë anëtare të Këshillit të Evropës.

²⁷ Midis tyre janë në veçanti demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut; shih preambulat e traktateve themeluese të të dy organizatave dhe recitalin 1 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet KE-së dhe BE-së në “Memorandum of Understanding between the Council of Europe and the...,” accessed November 29, 2022, <https://rm.coe.int/16804e437b>.

²⁸ Flamuri u miratua nga Asambleja Konsultative e Këshillit të Evropës më 25 tetor 1955 dhe u miratua nga Komiteti i Ministrave më 8 dhjetor 1955. KiE inkurajoi organizatat e tjera evropiane që të përdorin flamurin për të promovuar idenë evropiane. Më 28 prill 1983, Parlamenti Evropian (PE) vendosi të miratojë flamurin. Shih “The European Flag,” The Council of Europe in brief (Council of Europe), accessed November 29, 2022, <https://www.coe.int/en/ëeb/about-us/the-european-flag>.

²⁹ Ideja për të përdorur versionin instrumental të Beethoven-it të 'Odës së Gëzimit' si himn evropian mund t'i atribuohet kontit Richard Nikolaus von Coudenhove-Kalergi, themeluesit të Unionit Ndërkombëtar Panevropian. Të inkurajuar nga Asambleja Konsultative, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e përzgjedhi atë si himn evropian më 19 janar 1972. I njëjti himn u miratua në vitin 1986 edhe nga Bashkimi Evropian si himn i Evropës. Shih më gjerësisht për historikun e himnit në “European Anthem,” Documents, Records and Archives, accessed November 30, 2022,

Roli i Këshillit të Evropës si shtyllë mbështetëse për integrimet evropiane të shteteve me regjime totalitare në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, ishte i një rëndësie të jashtëzakonshme. Rugëtimi për në Bashkimin Evropian për secilin nga këto shtete, ishte pashmangshëm i lidhur me anëtarësimin në Këshill të Evropës. Ky ishte realisht hapi më i rëndësishëm që shprehte "evropianizimin" e tyre në të tre fushat e përsosmërisë së saj: të drejtat e njeriut, demokracinë dhe në sundimin e ligjit.³⁰ Realisht, kriteret politike të Kopenhagës që duhet të plotësojnë shtetet aspiruese për t'u integruar në BE-së janë parimet bazë të vetë Këshillit të Evropës. Edhe takimi "katërpalësh" i 22 marsit 2004 e kishte theksuar rëndësinë e kontributit që Këshilli i Evropës si organizatë e kishte dhënë për zgjerimin e BE-së bazuar në Samitin e Vjenës në 1993, që të pranonte brenda ombrellës së tij, në baza të barabarta dhe në strukturat e përhershme, demokracitë evropiane të çliruara nga shtypja komuniste. Ky ishte dhe vazhdon të jetë, në fakt, roli më i rëndësishëm i Këshillit të Evropës, si organizatë në kuadër të së cilës zhvillohet procesi i përgatitjes paraprake të shteteve kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.³¹

Vetë fakti që Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian kanë ndërtuar një rrjet marrëdhëniesh bashkëpunimi tregon se sa është i ndërlidhur anëtarësimi në të dy organizatat e lartpërmendura. Sidomos, që nga maji 2007, kur është lidhur Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian është konfirmuar roli i Këshillit të Evropës si pikë referimi për të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracisë në Evropë.³²

Edhe sot, rruga e shteteve të Ballkanit Perëndimor që aspirojnë anëtarësimin në BE, është ngushtë e ndërlidhur me Këshillin e Evropës. Komisioni Evropian, në baza vjetore, publikon raporte duke detajuar

<https://www.coe.int/en/ëeb/documents-records-archives-information/european-anthem>.

³⁰ "Recommendation 1347 (1997) Enlargement of the European Union," PACE website (Parliamentary Assembly, November 7, 1997), <https://assembly.coe.int/në/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=16566>.

³¹ Shih Hanna Machińska, "The Significance of Co-Operation Between the Council of Europe and the European Union for Countries Preparing for Membership in the European Union," in *Laë in Greater Europe: Towards a Common Legal Area: Studies in Honour of Heinrich Klebes* (The Hague: Kluëer Laë International, 2000), pp. 294-309.

³² Shih EUR LEX Official Journal. (n.d.). <https://eur-lex.europa.eu/>. Retrieved November 15, 2022, from <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX%3A52019DC0343&-from=EN>.

progresin për secilin nga vendet në fjalë. Këto raporte mbështeten në një masë të madhe në gjetjet e mekanizmave monitorues të Këshillit të Evropës.

Ndërlidhja më e fuqishme e rrugëtimit për në Bashkimin Evropian, e me të cilën i bëhet shtytje Këshillit të Evropës që t'i rikthehet kuptimit të vet origjinal politik duke i mbledhur të gjitha shtetet demokratike të Evropës së bashku, me qëllim që të sjellin paqe, stabilitet dhe prosperitet në një kontinent, është (ri)theksuar edhe këtë vit nga Parlamenti Evropian, në mënyrë specifike për Kosovën. Me Rezolutën e Miratuar më 6 korrik 2022, e të propozuar nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, në Kapitullin e parë për zgjerim, në mënyrë eksplicite mbështetet anëtarësimi e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe iu bëhet thirrje shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që të “mbështesin kandidaturën e saj, si dhe kandidaturat e saj për t’iu bashkuar organizatave të tjera ndërkombëtare.”³³ E njëjta Rezolutë, për më tepër, e konfirmon “angazhimin e vazhdueshëm të Kosovës për të avancuar në reformat që kanë të bëjnë me BE-në dhe konsensusin shumë të gjerë midis partive politike dhe mbështetjen publike për integrimin evropian dhe përqafimin e një identiteti evropian.”³⁴

Një konfirmim i fuqishëm i rrugëtimit për në Bashkimin Evropian, bazuar në kontributin e Këshillit të Evropës është ritheksuar vazhdimisht në forumin më prestigjioz, Samitet e Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Evropës³⁵, si ngjarjet më të rëndësishme në jetën e Këshillit të Evropës si organizatë (regjionale) ndërkombëtare.

Samiti i parë, i mbajtur në Vjenë, e konfirmoi dhe qartësoi politikën e zgjerimit të Këshillit të Evropës dhe zhvilloi konceptin e sigurisë demokratike. Në këtë Samit, u miratuan nismat madhore, si reforma e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për të përsheptuar procedurat dhe për të forcuar karakterin gjyqësor të makinerisë mbikëqyrëse të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, në atë

³³ “P9_TA(2022)0285 - 2021 Report on Kosovo - Text Adopted” europarl.europa.eu (European Parliament, July 6, 2022), https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2022-0285_EN.html, pika 8.

³⁴ Njëjtë, pika 1.

³⁵ Të gjitha Deklaratat, planet e veprimit dhe dokumentet e tjera të miratuara në tri Samitet e krerëve të shteteve dhe të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës gjenden në faqen e internetit në vijim: “Summits of Heads of State and Government of the Council of Europe,” Committee of Ministers, accessed November 30, 2022, <https://www.coe.int/en/ëeb/cm/summit>.

Samit u udhëzua Komiteti i ministrave që pa vonesë të përgatiste një konventë për të mbrojtur të drejtat e pakicave kombëtare.

Samiti i dytë, ku morën pjesë krerët e shteteve dhe qeverive të dyzet shteteve anëtare, u mbajt në Strasburg më 10 dhe 11 tetor 1997, me ftesë të Presidentit Zhak Shirak. Në atë Samit u miratua një plan veprimi me katër thekse kryesore: demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, kohezionin social, sigurinë e qytetarëve dhe edukimin për demokracinë dhe diversitetin kulturor.

Këto parime hynë në programin e punës të Këshillit të Evropës dhe ndihmuan në përcaktimin e prioritetëve të tij në prag të mijëvjeçarit të tretë.

Samiti i tretë i krerëve të shteteve dhe qeverive të Këshillit të Evropës, i cili u mbajt në Varshavë më 16-17 maj 2005, përfundoi punën e tij duke miratuar Deklaratën politike dhe një plan veprimi të fokusuar në ngritjen e një niveli të ri të bashkëpunimit dhe dialogut politik me Bashkimin Evropian në fushat me interes të përbashkët. Në një aneks të Deklaratës, krerët e shteteve dhe qeverive i bënë thirrje Këshillit të Evropës që të 'forcojë marrëdhëniet e tij me Bashkimin Evropian në mënyrë që Bashkimi Evropian t'i përdorë në mënyrë më efikase instrumentet dhe institucionet e disponueshme të Këshillit të Evropës (Aneksi, IV, 1). Gjëja më e rëndësishme e Samitit të tretë është se krerët e shteteve dhe të qeverive ranë dakord për një sërë udhëzimesh (Udhëzimet mbi Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian), të cilat në veçanti theksojnë:

6. Këshilli i Evropës, në bazë të ekspertizës së tij dhe nëpërmjet organeve të tij të ndryshme, do të vazhdojë të ofrojë mbështetje dhe këshilla për Bashkimin Evropian në veçanti në fushat e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore, demokracisë dhe të sundimit të ligjit.

7. Bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe organeve të specializuara të Këshillit të Evropës duhet të përforcohet. Bashkimi Evropian në veçanti do të përdorë plotësisht ekspertizën e Këshillit të Evropës në fusha të tilla si të drejtat e njeriut, informacioni, krimi kibernetik, bioetika, trafikimi dhe krimi i organizuar, ku kërkohet veprim brenda kompetencës së tij.

8. Agjencia e ardhshme e të Drejtave të Njeriut e Bashkimit Evropian, pasi të krijohet, duhet të përbëjë një mundësi për të rritur më tej bashkëpunimin

*me Këshillin e Evropës dhe për të kontribuar në koherencë më të madhe dhe komplementaritet të shtuar.*³⁶

Samiti i katërt në historinë e Këshillit të Evropës do të mbahet në Islandë më 16-17 maj 2023. Kjo është konfirmuar nga kryeministrja Katrín Jakobsdóttir më 9 nëntor 2022, menjëherë pas marrjes së kryesimit të Komitetit të Ministrave nga ana e Islandës.³⁷

“Këshilli i Evropës ka të bëjë me vlerat thelbësore të shoqërive tona: me demokracinë, të drejtat të njeriut dhe shtetin e së drejtës. Pushtimi i Ukrainës, pandemia dhe vështirësitë ekonomike paraqesin sfida për këto vlera thelbësore dhe për këtë arsye nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme për liderët evropianë të ripërtërijnë angazhimin e tyre dhe të bashkohen rreth mbrojtjes së këtyre vlerave. Islanda do ta marrë seriozisht rolin e saj kryesues, pasi ne po e marrim këtë detyrë në kohë të vështira”, tha.

Vlera ligjore e Deklaratave përfundimtare të miratuara në tri Samitet e para ngre disa pyetje. Definitivisht jo të detyrueshme, ato janë më shumë në natyrën e teksteve të politikave dhe detyrimet që ua imponojnë shteteve janë vetëm morale. Në të njëjtën kohë, nuk mund të mohohet se ato kanë disa implikime ligjore. Së pari, shtetet nuk mund t'i injorojnë lehtësisht tekstet që janë nënshkruar solemnisht ose janë miratuar me konsensus në nivelin më të lartë të mundshëm. Mandej, tekstet e politikave mund të shërbejnë si precedentë dhe të ndihmojnë për të gjeneruar ligjin zakonor, ose për të përshpejtuar, madje edhe krijimin e tij. Ato gjithashtu mund të shndërrohen në ligj zakonor apo edhe të shkruar, për shembull duke i futur ato në traktate ose kushtetuta, qoftë edhe në formë referimi. Kështu, Deklarata e Vjenës, e cila përmbylli Samitin e parë të Këshillit, përmban një paragraf veçanërisht të rëndësishëm, i cili përcakton dispozitat relativisht të paqarta të nenit 3 të Statutit, në lidhje me anëtarësimin në Këshillin e Evropës.³⁸

³⁶ “Guidelines on the Relations between the Council of Europe and the European Union,” Council of Europe, accessed November 30, 2022, https://www.coe.int/t/dcr/summit/20050517_plan_action_en.asp.

³⁷ Council of Europe, “Summit in Reykjavik to Renew ‘The Conscience of Europe’ - Portal - Publi.coe.int,” Newsroom (Council of Europe, November 9, 2022), <https://www.coe.int/en/web/portal/-/summit-in-reykjavik-to-renew-the-conscience-of-europe>.

³⁸ Florence Benoît-Rohmer and Heinrich Klebes, “Constitutional Sources,” in *Council of Europe Law towards a Pan-European Legal Area* (Strasbourg: Council of Europe, 2005), p. 32.

Sipas këtij paragrafi, një vend aplikues presupozohet “*të ketë sjellë institucionet dhe sistemin e tij ligjor në përputhje me parimet bazë të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Përfaqësuesit e popujve duhet të jenë zgjedhur me anë të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të bazuara në të drejtën e votës universale. Liria e garantuar e shprehjes dhe veçanërisht e medias, mbrojtja e pakicave kombëtare dhe respektimi i parimit të së drejtës ndërkombëtare duhet të mbeten, sipas mendimit tonë, kritere vendimtare për vlerësimin e çdo aplikimi për anëtarësim.*”

Gjithashtu, Deklarata e Vjenës³⁹ më tutje kishte përcaktuar se “*një angazhim për të nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për të pranuar makinerinë mbikëqyrëse të Konventës në tërësi brenda një periudhe të shkurtër është gjithashtu thelbësore*” (për anëtarësim). Që nga viti 1993, asnjë shtet anëtar apo aplikues nuk e ka kundërshtuar këtë paragraf të Deklaratës së Vjenës.

Kosova është tashmë shtet anëtar i një marrëveshjeje të pjesshme të Këshillit të Evropës, Bankës së Këshillit të Evropës për Zhvillim (CEB) dhe një marrëveshjeje të zgjeruar, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit. Anëtarësimi në këta dy mekanizma të rëndësishëm të Këshillit të Evropës ishte bërë vetëm atëherë ku Federata Ruse ishte e suspenduar nga Këshilli i Evropës, për shkak të Aneksimit të Krimesë nga ana e Rusisë.

Me të dy këta mekanizma, Kosova ka bashkëpunim të ngushtë, që është edhe një dëshmi e fuqishme për përkushtimin e Kosovës në demokraci kushtetuese bazuar në vlerat evropiane.

Kuptohet, marrëveshje të pjesshme dhe të zgjeruara nuk janë traktate ndërkombëtare, kështu që getoizimi i Kosovës nuk eliminohet pa anëtarësim të plotë në Këshillin e Evropës.

Bashkëpunimi i Kosovës me Këshillin e Evropës është tashmë shumëdimensional. Përveç instrumenteve për të drejta të njeriut të parashikuara fillimisht në Kushtetutë, në vitin 2020, Kuvendi i Kosovës e ka amendamentuar Kushtetutën për t'i dhënë efekt që i jep efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e

³⁹ “Declaration of the Council of Europe's First Summit (Vienna, 9 October 1993),” CVCE.EU by UNI.LU, accessed December 5, 2022, https://www.cvce.eu/en/obj/declaration_of_the_council_of_europe_s_first_summit_vienna_9_october_1993-en-d7c530b5-a7c9-43f9-95af-c28b3c8b50d3.html.

Stambollit), duke e zgjeruar kështu listën e traktateve të të drejtave të njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës, gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe një delegacion i tij merr pjesë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës me të drejtë të fjalës, e pa të drejtë vote. Më tutje, Asociacioni i Komunave të Kosovës gëzon statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Komiteti Këshilldhënës i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kom-bëtare e bëjnë monitorimin në Kosovë bazuar në marrëveshjet e nënshkruara me UNMIK-un në vitin 2004.

Viteve të fundit, Këshilli i Evropës ka bërë vlerësime të përafrimit të legjislacionit dhe praktikës së Kosovës edhe me konventa dhe standarde të tjera të Këshillit të Evropës, duke e përdorur metodologjinë e organeve përkatëse monitoruese të Këshillit të Evropës. Së fundi, janë bërë edhe monitorime lidhur me respektimin e Konventës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Zyra e Këshillit të Evropës është në vitet e fundit shumë aktive në Kosovë dhe në bashkëpunim me Bashkimin Evropian janë duke zhvilluar një sërë programesh rreth respektimit të Konventave të Këshillit të Evropës, përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejta e Njeriut e ka pjesë të vazhdueshme të punës monitorimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe i mbështet institucionet e Kosovës në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

III. KEQKUPTIMI I REZOLUTËS 1244 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË

Edhe pse shtet i njohur nga më shumë se njëqind shtete, e njohur nga më shumë se dy të tretat e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kosova çështje thelbësore të anëtarësimit e ka një keqkuptim serioz rreth Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe dialogut aktual me Serbinë. Më shumë se keqkuptim, ishte dhe vazhdon të jetë presion i Federatës Ruse për keqkuptim, e që tanimë përcillet përmes elementëve të saj në Republikën e Serbisë, me qëllim të destabilizimit

të tërë rajonit të Ballkanit, që vazhdon të mbahet fragjil, përmes bllokimit të Kosovës në integritime evropiane.

Derisa shtetet e bllokut postkomunist po i bënin hapat e parë të ndërtimit të sistemeve demokratike, populli mbi 90% shqiptar i Kosovës pa të drejtë pune, pa të drejtë shkollimi, pa të drejtë në shëndetësi dhe i përballur me dhunë sistematike të regjimit serb të Milosheviçit kishte rënë në katastrofë humanitare. Derisa përpjekjet diplomatike për të respektuar të drejtat e njeriut në Kosovë zbeheshin, regjimi i Milosheviçit e kishte filluar spastrimin të heshtur etnik. Lufta ishte bërë e pashmangshme dhe popullsia civile ishte bërë cak i sulmeve të të gjitha forcave serbe, armatës jugosllave, milicisë dhe grupeve paramilitare të udhëhequra nga shteti, Në fund të vitit 1998, më shumë se 300,000 qytetarë ishin dëbuar me forcë nën breshëri armësh dhe nga shtëpitë e tyre dhe ishin zhvendosur. Marrëveshjet e ndryshme të armëpushimit po shkeleshin sistematikisht dhe negociatat kishin deshtuar për shkak të shpërfilljes së tyre nga regjimi i Milosheviçit.

Pas dështimit të dy raundeve të bisedimeve të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht, në Rambuje në shkurt dhe në Paris në mars 1999 për shkak se Regjimi i Milosheviçit e kishte refuzuar marrëveshjen e negociuar, NATO-ja e kishte filluar fushatën ajrore për të ndalur gjenocidin që bëhej në Kosovë edhe gjatë ditëve që zhvilloheshin negociatat.⁴⁰

Operacioni i Forcave Aleate filloi më 24 mars 1999 dhe përfundoi më 10 qershor, pasi NATO-ja e kishte bërë Marrëveshjen Tekniko-ushtarake me Republikën Federale të Jugosllavisë. Të njëjtën ditë u miratua nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së Rezoluta 1244, me të cilën u mirëprit pranimi nga Republika Federale e Jugosllavisë i parimeve për një zgjidhje politike, duke përfshirë një fund të menjëhershëm të dhunës dhe një tërheqje të shpejtë të forcave të saj ushtarake, policore dhe paraushtarake dhe vendosjen e një pranie efektive ndërkombëtare civile dhe të sigurisë, me pjesëmarrje të konsiderueshme të NATO-s.⁴¹

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244⁴² e kishte autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së që të krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë dhe e kishte ngarkuar atë me zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, si dhe në fazën përfundimtare, mbikëqyrjen e transferimit të pushtetit nga

⁴⁰ Weller, Marc. *Peace Lost: The failure of conflict prevention in Kosovo*. Brill, 2009.

⁴¹ NATO. "NATO's Role in Relation to the Conflict in Kosovo." (1999).

⁴² SC Res. 1244 (1999).

institucionet e përkohshme tek institucionet që do të dalin si rezultat i zgjidhjes politike.

Që nga nëntori 2003, UNMIK-u është fokusuar kryesisht në ndihmën e autoriteteve lokale në përmbushjen e standardeve të qeverisjes dhe të drejtave të njeriut në tetë fusha: funksionimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit, lirinë e lëvizjes, kthimin dhe riintegrimin e refugjatëve, ekonominë, të drejtat pronësore, dialogun me Beogradin dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të emërtuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së si "standarde para statusit".⁴³

Raportit⁴⁴ rreth përmbushjes së "Standardeve," e ktheu përfundimisht vëmendjen e Këshillit të Sigurimit dhe të organizatave rajonale evropiane kah domosdoja e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës. Menjëherë pas Raportit, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Annan e ka emëruar ish-presidentin finlandez Martti Ahtisaari si të dërguarin e tij të posaçëm për të udhëhequr procesin e zgjidhjes së statusit të ardhshëm për Kosovën dhe emërimi i tij është miratuar nga Këshilli i Sigurimit më 10 nëntor 2005.⁴⁵

Në cilësinë e të dërguarit special, z. Ahtisaari e udhëhoqi një proces të gjatë negociator politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës pas një procesi negociatash me Serbinë rezultoi me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Pavarësisht nga pjesëmarrja intensive në negociata, nën patronazhin e Federatës Ruse, Serbia nuk e pranoi propozimin. Madje, nuk e pranoi asnjë propozim tjetër të emisarëve të tjerë të OKB-së.

Kosova, nga ana tjetër e pranoi propozimin e Presidentit Ahtisari dhe bazuar në të, e shpalli pavarësinë e saj nga Serbia më 17 shkurt 2008.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, përmes Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Serbia e dërgoi çështjen e shpalljes së pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me Mendimin Këshillimor për Kosovën⁴⁶ konkludoi në termat më të qartë se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e shkel të drejtën ndërkombëtare. Për më tepër, ajo ofroi një interpretim të fortë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila

⁴³ S/PRST/2003/26

⁴⁴ S/2005/635

⁴⁵ S/2005/709

⁴⁶ Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo (Advisory Opinion) [2010] ICJ Rep 403 at 442.

kishte krijuar praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë pas ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999. GJND-ja pohoi se Rezoluta 1244 (1999), "është e dizajnuar në thelb për të krijuar një regjim të përkohshëm për Kosovën, me synim që të kanalizojë procesin afatgjatë politik për të vendosur statusin e saj përfundimtar" dhe "nuk përmban asnjë dispozitë që ka të bëjë me statusin përfundimtar" të Kosovës ose me kushtet për arritjen e saj."

Interpretimi i Rezolutës 1244 (1999) luajti një rol qendror në Mendimin Këshillimor të Kosovës. Sipas GJND-së "objekti dhe qëllimi i Rezolutës 1244 (1999) ishte krijimi i një regjimi juridik të përkohshëm e të jashtëzakonshëm, i cili, përveç hapësirës që qartazi e ruajti, e zëvendësoi rendin juridik serb, dhe i cili synonte stabilizimin e Kosovës, dhe se ishte krijuar për ta bërë këtë mbi një bazë të përkohshme."⁴⁷

GJND-ja e trajtoi gjithashtu çështjen nëse shpallja e Deklaratës së pavarësisë ishte në kundërshtim me ndonjë ndalesë të përfshirë në Rezolutën 1244 dhe pas një 'leximi të kujdesshëm' të saj, ajo konkludoi se Rezoluta 1244 ishte nxjerrë me qëllim të krijimit të një regjimi të përkohshëm për Kosovën dhe jo për zgjidhjen përfundimtare të statusit të saj.

GJND fillimisht vuri në dukje se Rezoluta 1244 "ishte dizajnuar në parim për ta krijuar një regjim të përkohshëm për Kosovën, me qëllim që ta kanalizojë procesin afatgjatë politik për të vendosur për statusin e saj përfundimtar. Rezoluta nuk përmbante asnjë dispozitë lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës ose me kushtet për arritjen e tij"⁴⁸. Për arritjen e këtij përfundimi, Gjykata krahasoi Rezolutën 1244 (1999) me 'praktikën bashkëkohore të Këshillit të Sigurimit', për shembull, atë lidhur me Qipron, duke thënë se për dallim nga Rezoluta për Qipron, Këshilli i Sigurimit nuk e kishte rezervuar për vete përcaktimin përfundimtar të statusit të Kosovës, si dhe kishte heshtur edhe për kushtet për statusin përfundimtar të Kosovës.⁴⁹ Në fund, rreth interpretimit të Rezolutës 1244, GJND-ja qartazi thekson se "Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit nuk ua ndaloi autorëve të Deklaratës së 17 shkurtit 2008 që ta shpallnin pavarësinë nga Republika e

⁴⁷ Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion [2010] icj Rep 403, at 422, para. 50

⁴⁸ Ibid. para. 104

⁴⁹ Ibid. para. 114

Serbisë” dhe konkludoi se “shpallja e pavarësisë nuk e shkeli Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit.”⁵⁰

Me propozimin e përbashkët të Serbisë dhe BE-së, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me konsensus e pranoi Mendimin Këshillimor të GJND-së për Kosovën dhe përshëndeti “gatishmërinë” e BE-së për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet palëve, “për të promovuar bashkëpunimin, për të arritur përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve”, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi.

Më 19 prill 2013 në Bruksel, nën kujdesin e Bashkimit Evropian dhe shefes së politikës së jashtme të BE-së, baronesha Catherine Ashton, liderët e Serbisë dhe të Kosovës ranë dakord që asnjëra palë nuk do të bllokojë ose inkurajojë të tjerët të bllokojnë përparimin e palës tjetër në vendin e tyre përkatës në rrugën drejt BE-së.

Përsëri, me mbështetjen e Rusisë, Serbia arriti jo vetëm të bllokojë rrugën e Kosovës drejt BE-së, por ta shndërrojë Kosovën në një vrimë të zezë për të drejtat e njeriut, duke penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Bisedimet e udhëhequra nga BE-ja fillimisht u fokusuan në masat teknike për të mundur lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe njerëzve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. BE-ja shpresonte se fillimi me masa praktike do të ndërtonte besimin midis palëve dhe do të krijonte bazat për çështje më të ndjeshme. Në vitin 2012, dialogu u ngrit në nivel politik dhe me gjithë arritjen e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Drejtojnë Normalizimin e Marrëdhënieve (Marrëveshja e Brukselit) ka mbetur në rrugë pa krye. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja është proces midis palëve të barabarta për normalizim të marrëdhënieve midis tyre. Çështja e Pavarësisë së Kosovës nuk është objekt i dialogut.

Megjithatë, dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është duke ngecur, mu për faktin se Kosovës është duke iu mohuar realizimi i bazamentit të Dialogut, si dhe i Marrëveshjes së Vitit 2013, mundësia për integritet evropian. Siç u argumentua, integritet evropian, i kanë themelet në Këshillin e Evropës. Çdo vonesë e anëtarësimit të Kosovës në Këshill të Evropës, është njëkohësisht pamundësim i sigurisë demokratike në Evropë dhe vazhdimi i agonisë për forcimin e paqes në Ballkanin Perëndimor.

⁵⁰ Ibid. para. 119.

SUMMARY

The Council of Europe, as the oldest political organization in Europe, which was founded after World War II based on the idea of preventing the return of totalitarian regimes and for the protection of human rights and fundamental freedoms, peace, and democracy, still remains an important element of the European architecture of democratic security. The very headquarters of the Council of Europe, situated in Strasbourg, France, as the center of centuries of conflicts between France and Germany, is a symbol of European reconciliation.

Since its establishment, and especially after the fall of totalitarian systems with the end of the Cold War and the end of the bloody wars with the dissolution of former Yugoslavia, and finally, this year, with the exclusion of the Russian Federation due to Ukraine's occupation, the membership of a state in the Council of Europe is considered a distinctive sign of European legitimacy. Membership in the Council of Europe is also perceived as the first step in the process of a greater level of integration in Europe, the final result of which would be EU membership.

Progress "on the road to the European Union" is also the essence of the dialogue between Kosovo and Serbia, mediated by the European Union, as the only formal mechanism accepted by the United Nations for normalizing relations between the two countries. The progress in dialogue, which has been dragging on for more than a decade, is seriously hindered with Kosovo being left outside the Council of Europe umbrella and is thus left without the possibility of signing the European Convention on Human Rights (ECHR), which is a right reserved only for Council of Europe member states. This impediment not only puts the citizens of Kosovo in an unequal position in general, together with all its communities, but it has also become a dangerous barrier to the stability of the Western Balkans region because, as the Committee of Ministers of the Council of Europe points out, the ECHR continues to play a central role "as a constitutional instrument of European public order, on which the democratic stability of the continent depends."

The "First Agreement on the Principles that Governing the Normalization of Relations" of 2013, which was deemed historic by the UN Secretary-General, and was later presented by the European Commission as a "historic agreement" that paves the way for decisive progress in Kosovo and Serbia's EU perspectives, under item 14,

includes the mutual obligation of both Serbia and Kosovo, stating that "neither party will block nor encourage others to block the progress of the other party on their respective path to the EU. "

How this mutual commitment of Kosovo and Serbia affects Kosovo's membership in the Council of Europe has not yet been explained in the literature and represents the very core of this article's study.

However, the role of the Council of Europe as a pillar for supporting the European integration of former states with totalitarian regimes from Central, Eastern, and South-Eastern Europe, was inevitably linked to their path toward the European Union. Their membership in the Council of Europe was really the most important step, as it expressed their "Europeanization" in the three areas of its excellence: human rights, democracy, and the rule of law. This role of the Council of Europe continues to be, in fact, its most important role as an organization within which the process of the preliminary preparation of candidate states for membership in the European Union takes place.

Therefore, Kosovo's exclusion from the Council of Europe and the delay in decision-making regarding its application in this organization makes the claim of the Council of Europe as a unique organization guided by its values questionable.

pasluftës (HC Ujman, 1983, HC Lumbardhi Deçan, 1956 (2006), HC Dikanci, 1957 (2013), HC Radavc 1934 (2010) dhe HC Burimi 1948 (2011). Së voni, nga ana e operatorëve privatë janë ndërtuar edhe disa të reja, e ka pasë edhe projekte për hidrocentrale të tjera ose për zgjerimin e kapaciteteve të atyre ekzistuese, por duket se janë bërë në mënyrë jotransparente, pa përfillur kriteret mjedisore dhe procedurat ligjore. Këso përpjekjesh janë bërë në Lumbardh të Deçanit, në perëndim të vendit, një tentim tjetër është bërë edhe në Lumbardh të Pejës, d.m.th në Grykën e Rugovës, që praktikisht është pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, por që është kundërshtuar vullshëm nga komuniteti dhe shoqëria civile, si dhe nga vetë kryetari i komunës, kurse një i tretë është nisur në jug të vendit, në lumin Lepenc, i cili po ashtu është kundërshtuar fuqishëm nga shoqëria civile dhe komuniteti.

Kundër këtij të fundit, disa herë kanë protestuar së bashku banorët e disa fshatrave të komunës së Shtërpçës, edhe të komunitetit shqiptar edhe të atij serb. Duke qenë se si pasojë e luftës së viteve 1998-1999, akoma ekziston ndarja mes shqiptarëve dhe serbëve, por protestat e përbashkëta tregojnë se çështjet mjedisore janë bërë shumë të rëndësishme sa që arrijnë t’i tejkalojnë edhe ndarjet etnike e politike. Shkatërrimi i lumit për të ndërtuar hidrocentral, për banorët e komunitetit lokal, natyrisht se është shqetësim, sepse rrezikon bazën ekzistenciale të tij, mënyrën e jetesës të ndërtuar me shekuj. Ndërtimi i hidrocentralit do të thotë dëmtim i shumanshëm: prishje e ekosistemit, “vdekje” e lumit dhe pamundësi e shfrytëzimit të ujit për ujtjen, pra degradim i tokës bujqësore, por edhe shkatërrim i peizazhit.

Roli i shoqërisë civile në këtë rast ka qenë në organizimin e protestave, artikullimin e kërkesave të komunitetit, angazhimin e ekspertëve për publikimin e raporteve analitike, ku shpjegohet në mënyrë konkrete gjendja në lidhje me projektet për ndërtimin e hidrocentraleve, sensibilizimin e çështjes për opinionin publik, jo vetëm përmes protestave, por edhe përmes shkrimeve dhe nxitjes së debateve mediale, pastaj në ushtrimin e presionit mbi pushtetin dhe në fund edhe në ngritjen e padive gjyqësore për operatorët ose pronarët e hidrocentraleve. Si rezultat i aktivizmit mjedisor dhe protestave të komunitetit, Qeveria bëri një moratorium për të mos ndërtuar hidrocentrale të reja, derisa të bëhet një analizë e plotë shkencore e gjendjes dhe kapaciteteve ujore në Kosovë, si bazë e një masterplani që do të rregullonte ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve në vend.

Sidoqoftë, Kosova, si edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, për prodhimin e energjisë së pastër duhet të jetë në linjë me politikat e

BE-së. Komunikata e Komisionit Evropian për planin e investimeve në Ballkanin Perëndimor thekson: “Përdorimi i shtuar i energjisë së ripërtitshme duhet të mbështetet në përputhje me potencialet e rajonit dhe planit për përshtatje në ndryshimet klimatike. Kjo përfshin edhe investimet mjedisore në burime ujore, solare, të erës dhe gjeotermale.”¹⁴ Në këtë aspekt, Kosova duhet ta përmbushë objektivin për vitin 2030 për prodhimin e energjisë së pastër, prandaj edhe njëra prej rekomandimeve të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) është që Kosova sa më parë të miratojë Ligjin për Energjinë e Ripërtitshme.

“Kosova do të duhej të kishte Ligjin për Energjinë e Ripërtitshme. Ky ligj do ta rriste përdorimin e energjisë së ripërtitshme në Kosovë dhe rregullonte prodhimin dhe furnizimin me energji të ripërtitshme. Një ligj i tillë do të mbështeste dhe rregullonte mënyrën si do të prodhohej energjia nga burimet energjetike të ripërtitshme, si energjia solare, energjia e erës, hidrocentralet, energjia gjeotermale dhe energjia e biomasës. Është me rëndësi të veçantë që ai ligj të miratohet sa më shpejt që është e mundur, sepse, veç të tjerash, edhe do të mundësonte organizimin më të mirë të tregut. Një ligj i tillë i veçantë do të inkurajonte përdorimin e burimeve energjetike të ripërtitshme, që do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm për Kosovën.”¹⁵

Kësisoj, sa i përket prodhimit të energjisë dhe ruajtjes së mjedisit, mund të themi se Kosova gjendet në një situatë trefish kontraverse: E para, nga njëra anë ka rezerva të mëdha linjiti, e nga ana tjetër nuk mund t’i shfrytëzojë ato, për shkak të pasojave për mjedisin; e dyta, nga njëra anë e ka të rëndësishme ngritjen e kapaciteteve gjeneruese të energjisë së bazuar në burime të ripërtitshme, e nga ana tjetër kundërshtimet e shoqërisë civile dhe aktivistëve mjedisorë për ndertimin e hidrocentraleve, praktikisht e kanë bërë thuajse të pamundur këtë, ndonëse njëra ndër objektivat e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, është “plotësimi i caqeve dhe obligimeve në efikasitet të energjisë, burime të ripërtitshme të energjisë dhe mbrojtje

¹⁴ European Commission, *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee of the Regions. An Economic and Investment Plan for Western Balkans*, Brussels, 6.10.2020, f.8, https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:d32825b0-08ad-11eb-a511-01aa75ed71a1.0002.02/DOC_1&format=PDF (qasja, shkurt 2022).

¹⁵ Institut for Development Policy (INDEP), Fridrich Ebert Stiftung, *The Role of Renewable Energy in Achieving the 2030 Target*, 2021, Prishtinë.

të mjedisit”.¹⁶ Kontraversa e tretë ka të bëjë me atë se nga njëra anë Marrëveshja për Stabilizim Asocim e nënshkruar mes Kosovës dhe BE-së, kërkon zhvillimin e kapaciteteve për energji të ripërtitshme dhe për mbrojtje të mjedisit, por nga ana tjetër, në dokumentin e Strategjisë për energjinë thuhet:

“Shumica e hidrocentraleve të vogla ekzistuese dhe ato të planifikuara gjenden në brendi të zonave me rëndësi të veçantë natyrore si parqe kombëtare, rezervate strikte të natyrës, zona të veçanta të mbrojtura dhe zona me veçori të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit, faunës, habitateve natyrore, bimore dhe shtazore. Kjo paraqet rrezik të madh që këto zona të dëmtohen përgjithmonë dhe të degradohen peizazhet natyrore e burimet ujore të vendit, sikurse në rastin e ndërtimeve të hidrocentraleve në Grykën e Deçanit.”¹⁷

Të ndërtohen hidrocentrale në zonat e mbrojtura ose parqet kombëtare, të dëmtohet mjedisi, ekosistemi deri në shkallë të pariparueshme, është diçka e paimagjinueshme dhe e papranueshme për aktivistët mjedisorë dhe shoqërinë civile, por edhe për qytetarët dhe komunitetin lokal, prandaj edhe kundërshtimet janë të ashpra. Në të vërtetë, aktivistët mjedisorë dhe shoqëria civile e Kosovës janë treguar shumë të ndjeshëm në raport me hidrocentralet, sepse përveç aktiviteteve kundërshtuese në Kosovë, kanë bërë protesta edhe në Shqipëri, kundër projekteve për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Vjosa, në jug të Shqipërisë, si dhe atyre në lumin Valbonë në veri.

NATYRA DHE BIODIVERSITETI

Kosova ka një sipërfaqe prej 11.887 km katror dhe një popullatë afër 1.8 milionë banorëve. Nga të gjitha anët është e rrethuar me male, kurse në mes janë dy fushëgropa: në lindje është Fusha e Kosovës dhe në perëndim është Rrafshi i Dukagjinit. Malet më të larta dhe më të bukura nga vështrimi i turizmit malor janë Malet e Sharrit që shtrihen në jug të vendit, në kufi me Maqedoninë e Veriut dhe Bjeshkët e Nemuna që janë në perëndim, në kufi me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Të

¹⁶ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2017), *Strategjia e Energjisë 2017-2026*, Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26.pdf, f. 7.

¹⁷ Po aty, f. 5.

dy këto masive malore janë parqe nacionale¹⁸ dhe janë të rëndësishme edhe nga aspekti gjeologjik, ekologjik, ekonomik, turistik dhe kulturor. Këto dy parqe kombëtare padysim se paraqesin destinacionet më të preferuara turistike në Kosovë, si për turistët vendorë ashtu edhe për ata të huaj, si në sezonën verore ashtu edhe atë dimërore. Përveç këtyre dy parqeve kombëtare, Kosova i ka mbi 200 zona të mbrojtura, dhe në total sipërfaqe e mbrojtur është 11.55% e territorit të vendit.¹⁹

Në aspektin gjeografik, përveç maleve të larta dhe fushave pjellore, Kosova shquhet edhe me gjeomonumente, shpella, kanione, pastaj me atraksione të tjera natyrore, si: liqenet glaciale, ujëvarat, e duke qenë e pasur me miniera, shquhet edhe për 60 lloje mineralesh vetëm në lokalitetin e Trepçës, ku 20 lloje janë në Muzeun e Kristaleve.²⁰ Një fenomen i veçantë natyror që gjendet në Kosovë, që i përket hidrologjisë është bifurkacioni në lumin Nerodime, që gjendet afër qytetit të Ferizajit, një degë e të cilit, pasi bashkohet me Lepencin në Kosovë, pastaj me Vardarin në Maqedoninë e Veriut, derdhet në detin Egje; kurse dega tjetër, bashkohet me Sitnicën dhe Ibrin në Kosovë, pastaj me Moravën dhe Danubin në Serbi dhe derdhet në Detin e Zi. Në këtë rast, ne nuk do t'i përshkruajmë të gjitha vlerat natyrore të Kosovës, por do të paraqesim kontributin e organizatave të shoqërisë civile, me fokus në rolin e organizatave të bjeshkatarëve dhe alpinistëve, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të veçantë në njohjen dhe promovimin e natyrës dhe të biodiversitetit në Kosovë.

Jo vetëm për shkak të natyrës së bukur, por edhe për shkak të popullsisë së re, e gjithësesi edhe për shkak interesit dhe atraksionit që ofrojnë bjeshkataria dhe alpinizmi, në Kosovë janë formuar shumë shoqata të bjeshkatarëve dhe alpinistëve²¹. Organizimi i ekspeditave malore në Kosovë, është aktivitet rregullt që bëhet në baza javore. Për

¹⁸ Parku Kombëtar i Maleve të Sharrit (1986) i ka 39.000 hektarë; dhe Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna (2013) me 62.488 hektarë. <https://www.ammk-rks.net/?page=1,121> (qasja, shkurt 2022).

¹⁹ Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Agjensia për Mbrojtjen e Mjedisit, *Mjedi e Kosovës 2020. Raporti i treguesve mjedisor, 2020*, f.68.

²⁰ Bedri Durmishaj, Sylejmani Hyseni, Ferat Shala, *Atlas i mineraleve të Trepçës*, Mitrovica, 2010, f.42.

²¹ Ndërsa sot ka një numër të madh të shoqatave që merren me këtë aktivitet, derisa ekziston edhe Federata Bjeshkatarë Alpiniste e Kosovës (FBAK). Ndër shoqatat më aktive janë "Hiking Njeri", Prishtinë; Klubi Alpin Prishtina; Shoqata e Bjeshkatarëve "Gjeravica" Pejë; Shoqata e Bjeshkatarëve "Sharri" Prizren; Shoqëria Bjeshkatarë Alpiniste "Lybeteni" Ferizaj; Shoqëria Bjeshkatarë Alpiniste "Pashtriku" Gjakovë; Shoqata Bjeshkatarë Alpiniste "Rrasa e Zogut" Junik etj.

çdo fund javë, në të gjitha stinët e vitit, kuptohet në pajtim me kushtet atmosferike, organizohen ekspedita të ngjitjes në male të ndryshme. Shoqatat i bëjnë ftesat nëpër rrjetet sociale dhe aty tregojnë për kohën dhe vendin e nisjes, për kushtet e udhëtimit dhe ngjitjes, për pajisjet dhe ushqimin, si dhe për pamjet që do t'i shohin. Një këshillë që nuk e harrojnë ta japin, është: mos hudsoni mbeturina në mal! Kjo këshillë e mirë me karakter edukativ krijon te të rinjtë shprehinë e kujdesit dhe mirëmbajtjes së natyrës. Kësisoj, për çdo javë, secili i interesuar mund të zgjedhë se në cilën majë mali do të ngjitet. Të rinjtë organizohen në grupe të vogla, si nxënës shkollash, studentë kolegësh apo universitetesh, kolegë pune, fqinjë, miq, të njohur e të panjohur, kosovarë dhe të huaj, dhe në një atmosferë mjaft miqësore me njëri-tjetrin, kalojnë një ditë të bukur e cila do t'u mbetet në kujtesë, jo vetëm për fotografitë e shumta që i bëjnë, por edhe për eksperiencën, humorin, solidaritetin, socializimin, lodhjen fizike, relaksimin psikik, dijet e reja mbi relievën, gjeologjinë, gjeografinë dhe ekologjinë, lidhjet e reja miqësore, e mbi të gjitha, miqësinë me natyrën. Një fotografi e përbashkët me flamurin e organizatës dhe fotografi të panumërta individuale hudhen nëpër rrjetet sociale, dhe kjo pastaj i nxit edhe të tjerët që t'u bashkëngjiten në ekspeditat e tjera. Sipas njërit prej drejtuesve të një organizate bjeshkatore, plasimi i fotografive në rrjetet sociale, e së fundmi edhe pandemia COVID-19 ka ndikuar shumë në popullarizimin e këtij sporti ose rekreacioni.²² Me iniciativën e shoqatave malore, janë ndërtuar edhe disa *via ferrata*, e kjo ka ndikuar pastaj edhe në tërheqjen e turistëve të huaj për të vizituar Kosovën, sidomos malet e saj. Sipas drejtuesit të Environmentally Responsible Action (ERA), promovimi që i ka bërë shoqëria civile sidomos Rrjeti i Organizatave Regjionale ka bërë që Parku i Bjeshkëve të Nemuna në Kosovë, Mal të Zi dhe Shqipëri të futet në top listën e vendeve më të vizituara në botë.²³

Disa prej atyre shoqatave, si Klubi Alpin "Prishtina", organizojnë ekspedita edhe jashtë vendit, pra në vendet e rajonit, si: Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci, Serbi, Maqedoni e Veriut, Greqi, Turqi, Bullgari, Francë, madje edhe në kontinente të tjera, si Afrikë dhe Azi. Tashmë tre alpinistë kosovarë, dy prej të cilëve femra, janë ngjitur në majen më të lartë në botë - Mount Everest.²⁴ Në gusht të vitit 2022, alpinistët e

²² Intervistë me A.Gacaferri, menaxher i Wilderess of Balkan, shkurt 2022.

²³ Intervistë me F.Lajçi, menaxher i ERA group, qershor 2021.

²⁴ Herën e parë, në vitin 2017, në majën e Everestit është ngjitur Uta Ibrahim dhe po në atë vit janë ngjitur edhe alpinistët Arineta Mula dhe Nazmi Hasanramaj nga Klubi Alpin "Prishtina".

Klubit Alpin “Prishtina” së bashku me disa pjesëtarë të FSK-së u ngjitën në Mont Blank.



Foto Ertrit Xani: Klubi Alpin “Prishtina”, Ekspedita ne Mont Blanc, gusht 2022

Natyrisht se për zhvillimin e këtij pasioni, e kësaj kulture të re mjedisore, mund të ketë ndikuar shumë faktorë, por gjithsesi edhe lodhja nga përditshmëria, nevoja për t’u shkëputur nga TV ose PC monitori, nevoja për t’u liruar nga stresi i punës dhe ai i papunësisë, e sidomos nevoja për të ruajtur shëndetin, për të forcuar kondicionin fizik, e mbi të gjitha nevoja për të shijuar ajrin e pastër të bjeshkës dhe qetësinë. Në sensibilizimin në raport me natyrën kanë ndikuar edhe dinamikat zhvillimore në hapësirat urbane. Dëshira për të dalë në natyrë, në hapësirë jashtë vendbanimeve, është edhe nevojë për relaksim. Kjo pastaj bëhet edhe shprehi, bëhet edhe mënyrë jetese, botëkuptim, identitet personal dhe profesional. Në intervistat që kemi bërë me disa bjeshkatarë, kemi konstatuar lidhjen e tyre emocionale shumë

të fortë me natyrën. Nga disa të intervistuar, natyra konsiderohet si “nëna që nuk vdes kurrë”, si diçka që duhet “ruajtur si sytë e ballit”.²⁵



Foto Sh.Krasniqi: Bjeshkatarët e HikingNjeri duke u kthyer nga Maja e Shigjetës, Kopaonik, 2017

Ecjet në natyrë shërbejnë edhe për të njohur më mirë gjeografinë e vendit. Këtë e shprehin edhe të intervistuarit, që pranojnë se prej se e praktikojnë ecjen në natyrë e njohin dhe e duan më shumë Kosovën. Disa prej tyre madje thonë se natyra e Kosovës është më e bukura në Ballkan. Pra njëra prej efekteve të drejtpërdrejta që i krijon ecja në natyrë, alpinizmi dhe bjeshkataria është dashuria për vendin, për natyrën e tij të bukur, për fushat e gjera dhe malet e larta.²⁶ Duke njohur pasionin për natyrën, iritimimin në raport me ndotjen, kritikën në raport me institucionet publike që nuk ndërmarrin masat e nevojshme për mbrojtjen e natyrës, bjeshkatarët e intervistuar porosisin që të kujdesemi dhe mirëmbajmë natyrën – “nënë e cila nuk vdes kurrë”.²⁷

²⁵ Shemi Krasniqi, Artan Krasniqi, *Bjeshkatarët dhe bjeshkataria në Kosovë*, Departamenti i Sociologjisë, Praktikum i sociologjik, PPT prezantim në Institutin Albanologjik, “Java e albanologjisë”, maj 2017.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

Përjetimi i natyrës dhe bukurive të saj është frymëzim, magjepsje, kënaqësi shpirtërore, është eksperiencë e veçantë, të cilën ta dhuron vetëm ecja në natyrë. Prandaj, jo vetëm prej të dhënave të mbledhura me intervista, por edhe prej observimeve direkte, observimeve me pjesëmarrje, mund të konstatojmë se organizatat bjeshkatarëve dhe alpinistëve, janë duke ndikuar jo vetëm në ngritjen e vetëdijes për mjedisin, por në krijimin e një ekokulture moderne, e cila krahas aspektit racional dhe praktik, përfshin edhe aspektin spiritual, etik dhe emocional, të lidhjes me natyrën. Elemente të etikës mjedisore dhe spiritualizmit ekologjik kemi gjetur edhe në kulturën tradicionale shqiptare dhe ato i kemi përmbledhur në librin *“Ekokultura. Natyra në kulturën tradicionale shqiptare”*. Aty, ndër të tjera kemi analizuar konceptin e “aftit”, i cili sipas besimeve popullore nënkupton ndëshkimin hyjnor që vjen për shkak të një dëmtimi që i bëhet ndonjë vlere natyrore, si vrasja ose torturimi i ndonjë kafshe, prishja e foleve të zogjve, prerja e lisave të vjetër ose pemëve frytnore, pastaj dëmtimi i ndonjë resursi ose të mire publike, si burimet e ujit, lumejtë, vendpushimet në natyrë, apo ndonjë objekti sakral.²⁸

Një kontribut të madh në njohjen, promovimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit kanë bërë edhe OJQ-të mjedisore. Ndër më të njohurat në këtë aspekt është Environmentally Responsible Action (ERA) group, e cila më së shumti vepron në Bjeshkët e Nemuna, më saktësisht në Rugovë. ERA Group ka punuar shumë në monitorimin dhe mbrojtjen e specieve të rrezikuara që jetojnë në Kosovë. Ata përmes kamerave kurth të vendosura nëpër habitatet e kafshëve, kanë zbuluar rrëqebullin (*Lynx lynx Balcanicus*) në Rugovë, për të cilin mendohej se ishte zhdukur dhe e cila sipas klasifikimit të IUCN konsiderohet skajshmërisht e rrezikuar edhe në Evropë.²⁹ Ata së fundi kanë lidhur një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit për të zhvilluar Konceptin e Monitorimit të Botës së Egër në Kosovë dhe kështu për të kontribuar në realizimin e Strategjisë së BE-së për biodiversitetin.

²⁸ Shemsi Krasniqi, *Ekokultura. Natyra në kulturën popullore shqiptare*, ASHAK, 20216, f.55-59.

²⁹ [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf)



Foto Sh.Krasniqi: Bjeshkatarët e HikingNjeri në Majën e Koritnikut, tetor 2017

Kontribut tjetër është edukimi i të rinjve për biodiversitetin. Janë organizuar trajnime të ndryshme, kampingje, ekspedita në terren, seminare dhe aktivitete të tjera. ERA grup punon në rrjet me organizata të tjera të shoqërisë civile, por ata bashkëpunojnë edhe me komunitetin, me institucionet komunale dhe qeveritare për të mbrojtur natyrën dhe biodiversitetin e Kosovës. Ata publikojnë imazhe të kafshëve të kapura nga kamerat kurth dhe ato fotografi i plasojnë në rrjetet sociale. Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e kafshëve gjithnjë e më tepër po bëhet më i madh. Megjithatë, duke pasur parasysh se disa specie janë të rrezikuara, siç është rasti i Rrëqebullit (*Lynx lynx*), për hirë të mbrojtjes nga gjuetia e egër, informacionin mbi koordinatat se ku gjendet e mbajnë të kontrolluar, por në anën tjetër e promovojnë me anë të fotove dhe dokumentarëve³⁰ – thotë drejtuesi i Grupit ERA.

Një grup tjetër aktivistësh dhe dashamirësh të natyrës, fotografësh të botës së egër, të fokusuar në faunën shqiptare, po ashtu bëjnë kontribut të madh në sensibilizimin për natyrën dhe biodiversitetin. Ata bëjnë fotografi të zogjve, fillimisht në regjionin lindor të Kosovës, në territorin e Kamenicës, dhe pamjet e fotografuara po ashtu ndikojnë në zhvillimin e njohurive për biodiversitetin, por edhe të sensibilitetit për speciet, për jetën dhe për natyrën përgjithësisht. Fotografitë e tyre

³⁰ Intervistë me F. Lajçi, ERA group, Jun 2021.

artistike nuk janë vetëm të cilësisë së lartë, por janë edhe një burim njohje për ekzistencën e disa zogjve, për të cilët nuk është ditur se jetojnë në Kosovë, si shqiponja golden eagle.³¹

PËRFUNDIME

Roli i shoqërisë civile në Kosovë ka qenë i ndryshëm në periudha të ndryshme të historisë. Në vitet 90 kur Kosova sundohej nga regjimi serb, shoqëria civile ishte “aleate” e forcave demokratike dhe lëvizjes paqësore të asaj kohe. Aktivizmi mjedisor brenda shoqërisë civile nuk ka qenë në nivel të lartë edhe pse ka pasur iniciativa të ndryshme. Menjëherë pas luftës dhe në kohën e administrimit ndërkombëtar, shoqëria civile në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, fillimisht angazhohej për çështjet emergjente, mirëqenien sociale, sundimin e ligjit, dhe ndërtimin e demokracisë. Aktivizmi mjedisor në këtë faze vjen duke u shtuar, por edhe sfidat mjedisore janë shumë të mëdha. Gërryerja e shtretërve të lumenjve ishte tepër shqetësuese në atë kohë, e po ashtu edhe prerja e pyjeve, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave etj. Pas shpalljes së pavarësisë, shoqëria civile në Kosovë, si një “opozitë” permanente, ushtron rolin e monitoruesit, hulumtuesit, njohësit, ekzaminuesit, kritikuesit dhe kundërshtuesit të politikave publike që nuk janë në përputhje me ligjin. Roli i saj është i përqendruar në konsolidimin e demokracisë, në vendimmarrje dhe shtetndërtim, por edhe pastrimit të Kosovës nga mbeturinat, ngritjes së kulturës mjedisore në shkallë shumë të lartë, mbrojtjes së natyrës dhe kultivimit të dashurisë dhe pasionit për të.

Kosova është një vend i pasur me resurse natyrore dhe me biodiversitet, por fatkeqësisht mjaft i ndotur, si nga ndotjet industriale, ashtu edhe nga menaxhimi jo i duhur i mbeturinave. Aktivistët mjedisorë dhe shoqëria civile me punën e tyre, me gjithë ndarjet etnike në vend, ka ndikuar shumë në krijimin e një kulture mjedisore, në ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit, e sidomos në luftën kundër degradimit të lumenjve.

Roli i shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e vlerave të natyrës së Kosovës është dëshmuar jo vetëm nëpërmjet trajnimeve të rinjve, publikimeve të raporteve, aksioneve mjedisore,

³¹ <https://a-z-animals.com/animals/location/europe/kosovo/>

kampingut, ecjes në male, kampanjave sensibilizuese, hartimit të legjislaturave, por edhe përmes kundërshtimit me protestë, siç ishin aksionet kundërshtuese ndaj ndërtimit të hidrocentraleve dhe ushtrimit të presionit mbi pushtetin për t'i ndryshuar politikat publike në raport me zhvillimet që kanë të bëjnë me degradimin e natyrës dhe ndotjen e mjedisit.

Duke qenë një vend me strukturë të popullsisë të dominuar nga grupmosha e re, aktivitetet si bjeshkataria dhe alpinizmi janë popullarizuar shumë. Këto e kanë rritur frymëzimin e të rinjve me natyrën dhe krijimin e një relacioni etik dhe emocional me të. Por Kosova duhet t'i zgjerojë edhe më tepër hapësirat rekreative, si parqet urbane, zonat rurale, parqet kombëtare dhe zonat e tjera të mbrojtura, por edhe t'i rregullojë dhe mirëmbajë ato ekzistueset për të qenë të qasshme edhe për grupmoshat e tjera.

RESUMÉ

La société civile au Kosovo a joué différents rôles à différentes périodes de l'histoire. Dans les années '90, lorsque le Kosovo était sous la domination serbe, la société civile était une « alliée » des forces démocratiques et de la résistance pacifique de l'époque. Malgré la pollution qui était énorme, l'activisme écologique à cette époque était presque invisible.

Dans le Kosovo d'après-guerre et pendant l'administration de MINUK, la société civile en coopération avec d'autres organisations internationales, s'était principalement engagé dans le domaine d'assurer les conditions de bien-être de la population qui, en dehors de la pauvreté, n'y avait même pas de logement. L'activisme environnemental de cette période se développe chaque jour, mais les défis environnementaux deviennent de plus en plus sérieux. La dégradation de rivières, due à l'exploitation des graviers, était un phénomène très inquiétant à cette époque, de même que la déforestation, puis la mauvaise gestion des déchets etc.

Après la déclaration d'Indépendance, la société civile est devenue une « opposition » permanente exerçant le rôle du contrôleur, de chercheur, d'évaluateur, de critique aux politiques publiques.

Le Kosovo est un pays riche en ressources naturelles et en biodiversité, mais malheureusement il est assez pollué, tant par la pollution

industrielle que par une mauvaise gestion des déchets. Malgré aux divisions ethniques du pays, les militants écologistes et la société civile par leur engagement ont influencé à la création d'une culture environnementale et ils ont été particulièrement importantes dans la lutte contre la dégradation des rivières.

Le rôle de la société civile dans la protection de l'environnement et la promotion des valeurs naturelles du Kosovo a été prouvé non seulement par diverses activités telles que: la formation des jeunes, la publication de rapports, la réalisation d'actions environnementales, le camping, la randonnée en montagne, les campagnes de sensibilisation, rédaction de législatures etc.; mais aussi par protestation, comme était le cas d'opposition contre la construction de centrales hydroélectriques, et la pression exercée sur le gouvernement pour qu'il change les politiques publiques dans le domaine d'environnement.

Ayant une structure démographique dominée par les jeunes, les activités telles que la randonnée en montagnes et l'alpinisme sont très populaires au Kosovo. Ceux-ci ont inspiré et ont influencé les jeunes d'avoir une relation éthique et émotionnelle à l'égard de la nature.

L'envie de sortir dans la nature, d'aller aux montagnes, est aussi un besoin de détente. Cela devient alors une habitude, un mode de vie, une vision du monde, une identité personnelle et certainement professionnelle. Dans les entretiens que nous avons menés avec certains alpinistes, nous avons constaté leur lien affectif très fort avec la nature. D'après certains interviewés, la nature est considéré comme « une mère qui ne meurt jamais », comme quelque chose qui doit être « préservé comme nos propres yeux ».

Marcher dans la nature sert aussi à mieux connaître la géographie du pays. C'est aussi ce qu'expriment les interviewés qui avouent que depuis qu'ils pratiquent la marche dans la nature, ils connaissent et aiment davantage le Kosovo. Certains d'entre eux disent même que la nature du Kosovo est la plus belle des Balkans. Ainsi, l'un des effets directs créés par la marche dans la nature, l'alpinisme et la randonnée est l'amour pour le pays, pour sa belle nature, pour les vastes champs et les hautes montagnes.

Mais le Kosovo devrait développer encore plus d'espaces récréatifs, tels que les parcs urbains, les zones rurales, les parcs nationaux et autres zones protégées; mais aussi préserver et protéger ceux existants.

BURIMET DHE LITERATURA

- [1] Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Anketa e fuqisë punëtore*, <https://ask.rks-gov.net/-media/6354/afp-tm1-2021.pdf>, 2021.
- [2] Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, *Raporti për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë*, Prishtinë, 2020.
- [3] Balkan Green Foundation dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, <https://indep.info/hidrocentralet-ne-kosove-problemet-dhe-potenciali-i-tyre-real/> (qasja, shkurt 2022), 2019.
- [4] Bedri Durmishaj, Sylejmani Hyseni, Ferat Shala, *Atlas i mineraleve të Trepçës*, Mitrovica, 2010.
- [5] European Commission, *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee of the Regions. An Economic and Investment Plan for Western Balkans*, Brussels, 6.10.2020, https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:d32825b0-08ad-11eb-a511-01aa75ed71a1.0002.02/DOC_1&format=PDF (qasja, shkurt 2022).
- [6] Luan Shllaku, *Antologjia e shoqërisë civile, Mjediti Kosovar. Globalizmi dhe Shoqëria Civile: Sfidat e këtij Shekulli*, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile Prishtinë, 2001.
- [7] Institut for Development Policy (INDEP), Fridrich Ebert Stiftung, *The Role of Renewable Energy in Achieving the 2030 Target*, 2021, Prishtinë.
- [8] Intervistë me A. Gacaferri, udhëheqës i Wilderess of Balkan, shkurt 2022.
- [9] Intervistë me F. Lajçi, udhëheqës i ERA group, qershor 2021.
- [10] KFOS, RIINVEST, *Spektori i energjisë në udhëkryq: Termocentrali i ri një ide e vjetër?*, 2019.
- [11] Mentor Agani, *Shoqëria civile në Kosovë prej vitit 1999*, Regional Research, Promotion Programme Western Balkan & Center for Political Courage (CPR), Prishtinë, 2012.
- [12] Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*, Prishtinë, 2016.
- [13] Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, *Mjediti i Kosovës 2020. Raporti i treguesve mjedisorë*, https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjediti_i_Kosovës_2020_Raport_i_treguesve_mjedisore_-SHQIP.pdf, 2020 (qasja, shkurt 2022).
- [14] Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, *Rapor. Gjendja e ujërave në Kosovë*, Pristina, 2010. https://www.ammk-rks.net/repository/docs/-raporti_ujrave%202010_shq.pdf (qasja, shkurt 2022).
- [15] Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2017), *Strategjia e Energjisë 2017-2026*, Marrë nga: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energji_2017-2026.pdf. (qasja, shkurt 2022).
- [16] Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, *Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023*.
- [17] Shemsi Krasniqi, *Ekokultura. Natyra në kulturën popullore shqiptare*, ASHAK, 20216.
- [18] Shemsi Krasniqi, Artan Krasniqi, *Bjeshkatarët dhe bjeshkataria në Kosovë*, Departamenti i Sociologjisë, Praktikumi sociologjik, PPT prezantim në Institutin Albanologjik, “Java e albanologjisë”, maj 2017.
- [19] Taulant Hoxha, *Raporti Analitik për Kosovë i Indeksit të Shoqërisë Civile*, Kosovo Fondation for Civic Society & CIVICUS, 2011.

Liburn Jupolli, Prishtinë

KRONOLOGJI GJITHËPËRFSHIRËSE E KONTRIBUESVE KOMPOZICIONALË NË SFERËN E MUZIKËS KLASIKE NË KOSOVË - PËRMBLEDHJE LEKSIKOGRAFIKE DHE ANALIZË E ELEMENTEVE STILISTIKE

“Përveç muzikës popullore, na tjetër muzikë nuk kemi, por jemi më se të bindun që edhe muzika artistike, do të krijohet. Ajo do të krijohet pa tjetër, se një popull kaq i pasun me muzikë popullore do të mundet me dhanë kompozitorë. Muzika artistike e kohës s'ardhëme do të ushqehet prej motiveve të shumta të muzikës popullore, prej ritmit interesant dhe harmonisë së pasun.

Vetëm na duhet të bajmë përgatitien. Fëmijve tanë që kane aq shumë vullnet dhe prirje për muzikë, tu japim një kulturë muzikore.....Ketë proces sigurisht ka për ta shpejtësuar shkolla e muzikës në Prizren”.

Lorenc Antoni, 1951

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim vënien e bazave të një dokumenti gjithëpërfshirës të kontribuesve në fushën e kompozimit të muzikës serioze/klasike në Kosovë dhe një pasqyrë të përgjithësuar të stileve prezente në veprimtarinë e këtyre kompozitorëve.

Punimi synon në këtë mënyrë duke përmbledhur të gjithë kontribuesit e ndryshëm brenda dhe jashtë Kosovës, të të gjitha moshave, nga kompozitori i parë Lorenc Antoni e deri te kompozitorët më të rinj të identifikojë një kohështrirje më të plotë në bazë të të dhënave kuantitative dhe të vazhdojë punën e filluar nga muzikologët e tjerë të Kosovës dhe Shqipërisë rreth identifikimit më të detajuar të stileve, teknikave dhe zhanreve të shkruara nga kompozitorët kosovarë.

Punimi nuk ka natyrë vlerësuese dhe kategorizuese për kompozimet as për kompozitorët, një punë që patjetër duhet të bëhet pas identifikimit nga ky dokument dhe të tjerët që pasojnë, por synimi kryesor është të shihet kapaciteti kuantitativ që ka ofruar Kosova me kompozitorë që kanë studiuar apo janë duke studiuar brenda dhe jashtë Kosovës që janë nga Kosova, që nga Lorenc Antoni e deri në kohërat e tanishme.

Kriteri kryesor i këtij lloji të dokumentimit është të përmbledhet në formë qendrore një punim shkencor, i cili mund të shërbejë si themel për vazhdim në dokumentim, kritikë dhe shtjellim të këtij fondusi të veprave kompozicionale dhe të vetë kontribuesve.

Fjalët çelës: Kompozitorët kosovarë, dokumentimi muzikor, stilet e kompozimit, ekosistemi muzikor në Kosovë

1. HYRJE - FILLET E EKOSISTEMIT MUZIKOR NË KOSOVË

Kosova ka një histori të zhvillimeve muzikore moderne që datojnë nga fillimi i shekullit 20, me përpjekjet e shumta për institucionalizimin dhe organizimin e mirëfilltë të aktivitetit muzikor.

Këto përpjekje dhanë fryte të shumta me gjeneratën dhe kontributin e kompozitorit të parë Lorenc Antoni, i cili e themeloi shkollën e parë të muzikës në Prizren, vuri hapat e parë të kompozimit në Kosovë si kompozitori i parë kosovar dhe publikoi artikullin e parë shkencor për trashëgiminë tonë muzikore folklorike si themel i studimeve dhe hulumtimeve në muzikë në Kosovë.

Të tre këto shtylla të lartpërmendura mundësuan fillesat dhe zhvillimin që e shohim sot në tërë ekosistemin muzikor në Kosovë.

Ky ekosistem sot përmban mbi 43 festivale me karakter muzikor, 8 festivale të muzikës klasike, mbi 800 burime njerëzore të angazhuara në muzikë klasike, 10 shkolla fillore/të mesme, mbi 20 shkolla fillore/të mesme publike dhe private të muzikës të të gjitha niveleve dhe llojeve, 2 fakultete shtetërore me nivel bachelor dhe master në profile muzikore, 2 fakultete private me nivel bachelor dhe master në profile muzikore, produksion të shtuar muzikor dhe një rritje të dokumentimit muzikor që 5 vjet e tutje.

Ashtu siç parafrazohet në fillim të shkrimit të Lorenc Antoni-t, pra muzika artistike në Kosovë i mori këmbët mjaft shpejt me gjeneratat e reja nga mesi i dytë i shekullit 20 dhe bëri hapa progresivë me gjithë sfidat politike-shoqërore dhe falë punës së pandërprerë të kontribuesve zhvilloi veprimtarinë muzikore në çdo nivel institucional dhe të pavarur.

Kompozitorët luajnë një rol qendror në disa fusha në këtë ekosistem, ku në Kosovë tani rangohen mbi 52 kompozitorë.

Kjo shtresë e kompozitorëve është kontribuese jo vetëm në repertorin e Kosovës, por prej 22 vjetësh edhe në zhvillimin e estetikave dhe veprimtarisë kompozitoriale në rajon, Evropë, SHBA dhe më gjerë.

Kontributi i gjeneratave të para me institucionalizimin e muzikës në Kosovë, shkollave të reja të kompozimit, hapja e Kosovës me veprimtari përmes garave të ndryshme të fituara nga kompozitorët e gjeneratave pas vitit 2000, të cilët kanë hapur dhe vazhdojnë të hapin mundësi të reja për kontribut ende më të gjerë të Kosovës me veprimtari kompozicionale në botë, e ka sjellë Kosovën në vëmendje të re dhe të frytshme në rajon dhe Evropë. Të gjitha këto aktivitete janë bartur në shumë nivele nga këta kompozitorë, të cilët kanë qenë dhe janë pjesë kyçe e organizimit dhe zhvillimit të muzikës në Kosovë.

2. LISTË KRONOLOGJIKE SHE LEKSIKOGRAFIKE E KOMPOZITORËVE DHE KONTRIBUESVE KOMPOZICIONALË SIPAS DATËS SË LINDJES

Kultura kompozicionale në Kosovë që prej kompozitorit të parë Lorenc Antoni është pasuruar me estetika të reja dhe me teknika kompozicionale bashkëkohore.

Organizimi i një liste kronologjike i ndarjes së gjeneratave mund të bëhet në mënyra të ndryshme dhe një material të tillë në rrafsh muzikologjik e kemi në disa formate nga “Zhvillimi i stileve të kompozitorëve kosovarë” nga akademiku Engjëll Berisha, nga punimet e ndryshme të kompozitorit dhe studiuesit Rafet Rudi dhe nga punimet e ndryshme nga muzikologia dhe profesoresha Rreze Kryeziu Breznica.

Kjo listë më poshtë paraqet një përpjekje të re për t’i sintetizuar në një vend të gjithë kontribuesit e të gjitha niveleve dhe gjeneratave që kanë prapavijë profesionale në kompozicion apo veprat, të cilat i kanë kompozuar, janë të mbikëqyrura nga profesionistë të kompozimit dhe është vazhdimësi e studimit tim që prej botimit “Antologji e kompozitorëve të rinj kosovarë-2000-2020” ku janë përmbledhur më shumë se 50% e kompozitorëve të Kosovës.

Ashtu siç tha Lorenc Antoni më 1951 ku Kosova kishte vetëm një grusht kompozitorësh, kurse tash pas 70 vjetësh Kosova kuantitativisht ka 54 kompozitorë me shkollim të përfunduar dhe në proces të shkollimit apo në mbikëqyrje profesionale në kompozim.

Pasqyra e mëposhtme fillon nga Lorenc Antoni dhe vazhdon kronologjikisht në bazë të datave të lindjes deri te gjeneratat më të reja që janë të angazhuara profesionalisht në studim të kompozimit muzikor.

1. Lorenc Antoni - 1909-1991
2. Rexho Mulliqi - 1923-1982
3. Kristë Lekaj - 1935-2021
4. Vinçenc Gjini - 1935 - 2022
5. Esat Rizvanolli - 1936-2006
6. Fahri Beqiri - 1936 - 2021
7. Akil Mark Koci - 1936 -
8. Halit Kasapolli - 1937-1959
9. Gjergj Kaçinari - 1939 - 2019
10. Zeqirja Ballata - 1943 -
11. Rauf Dhomi - 1945 -
12. Rafet Rudi - 1949 -
13. Gjon Gjevelekaj - 1951 -
14. Bashkim Shehu - 1952 -
15. Mendi Mengjiqi - 1958 -
16. Bahri Mulliqi - 1959 -
17. Baki Jashari - 1960 -
18. Valton Beqiri - 1967 -
19. Ilir Bajri - 1969 -
20. Trimor Dhomi - 1976 -
21. Arta Zeqiraj - 1980 -
22. Artan Hasani - 1981 -
23. Donika Rudi - 1982 -
24. Kreshnik Aliçkaj - 1982 -
25. Kushtrim Gashi - 1984 -
26. Dafina Zeqiri Nushi - 1984 -
27. Arbenita Lubishtani - 1985 -
28. Lyra Kastrati - 1985 -
29. Memli Kelmendi - 1986 -
30. Korab Shaqiri - 1986 -
31. Drinor Zymberi - 1987 -
32. Fati Fehmiju - 1989 -
33. Liburn Jupolli - 1989 -
34. Florent Shasivari - 1989 -
35. Muhamed Bislimi - 1990 -
36. Ardian Halimi - 1990 -

37. Vedat Lushtaku - 1991 -
38. Hajrullah Sylja - 1991 -
39. Arbër Salihu - 1991 -
40. Rron Karahoda - 1992 -
41. Yllnor Kurti - 1993 -
42. Anda Kryeziu - 1993 -
43. Valton Kuqi - 1994 -
44. Bardh Dubovci - 1994 -
45. Blond Krasniqi - 1995 -
46. Ylli Daklani - 1998 -
47. Diar Zasella - 1998 -
48. Leutrim Sahiti - 1999 -
49. Ersan Januzi - 2000 -
50. Lum Hallabaku - 2000 -
51. Fjolla Gashi - 2001 -
52. Fitim Bytyqi - 2001 -
53. Besart Elezi - 2002 -
54. Dea Ahma - 2003 -

3. VEÇORI DHE GJETJE TË REJA NË PËRMbledhjen e kompozitorëve

Prej kërkimeve kuantitative dhe kualitative që prej vitit 2019, në këtë listë janë identifikuar disa gjetje të reja që prej vitit 2000 ku përfshihen: -

3.1. Pjesëmarrje e re dhe e shtuar e femrave kompozitore. Aktualisht në Kosovë ka 8 kompozitore femra, një trend që filloi me kompozitoren e parë të regjistruar në klasë të prof. Rafet Rudi, Arta Zeqiraj. Në krahasim me shekullin e 20-të vitet pas 1999 deri tash në total pjesëmarrja e femrave është rreth 15.38%, numër ky që nuk është i madh, por në retrospektivë duke krahasuar me shekullin e 20-të është një rritje e konsiderueshme që mund të përmirësohet dhe do të duhej të jetë e barabartë me pjesëmarrjen e meshkujve.

3.2. Identifikim i kompozitorëve të rinj që jetojnë në diasporë (USA, Japoni, etj), kuadro të reja të kompozitorëve të Kosovës që janë identifikuar gjatë hulumtimit janë Rron Karahoda në SHBA dhe Fati Fehmiu në Turqi/Japoni.

3.3. Nivel i shtuar i performancave të kompozimeve jashtë Kosovës,

3.4. Nivel më i ngritur i çmimeve të fituara nga kompozitorët vendorë në gara të kompozimit në vend dhe jashtë vendit.

4. LLOJET E ESTETIKAVE MUZIKORE TE KOMPOZITORËT KOSOVARË

Zhvillimet e ndryshme stilistike te kompozimet e kompozitorëve kosovarë janë të llojllojshme duke llogaritur fillimisht që secili kompozitor ka zhvillim të veçantë gjatë karrierës dhe mund të kalojë shumë lehtë nga një stil në tjetrin në periudha të ndryshme.

Andaj duke pasur parasysh këtë fakt, një studim më i thellë i dedikuar për secilin kompozitor do të mund të bënte prerje më të saktë kuantitative se sa për qind është zhvilluar një stil në krahasim me të tjerët.

Po ashtu në mungesë të studimeve të tilla nënkuptohet që një prerje e fortë në një lloj të stilit nuk mund të bëhet, ngase shkolla kompozicionale në Kosovë sikurse para institucionalizimit para viteve 70 dhe njëjtë sikur pas formimit të klasës kompozicionale dhe pas viteve 99 nuk ka pasur ndarje të rreptë për një stil dhe kompozitorët kanë zhvilluar gjuhën e tyre në mënyrë origjinale.

Përveç kësaj në rrethet e kompozitorëve gjithkund nga post-modernizmi e tutje prerjet e rrepta stilistike janë më të rralla e kjo sidomos në veprimtarinë e kompozitorëve kosovarë ku shpeshherë çdo stili apo teknike kompozicionale i shtohet ndonjë element i një stili tjetër apo elemente të muzikës folklorike shqiptare.

Analiza dhe lista e mëposhtme nuk ka karakter kategorizues, por është dokumentim dhe shtjellim i shkurtër i llojeve të zhanreve dhe stileve që kanë qarkulluar që prej shekullit XX deri më sot.

1. Lorenc Antoni - 1909-1991 - Pandiatonikë, elemente folku
2. Rexho Mulliqi - 1923–1982 - Pandiatonikë, Neoromantizëm, Neoklasicizëm, elemente folku
3. Kristë Lekaj - 1935-2021 - Pandiatonikë,elemente folku
4. Vinçenc Gjini - 1935 - Pandiatonikë, elemente folku

5. Esat Rizvanolli - 1936-2006 - Serializëm, Dodekafoni
6. Fahri Beqiri - 1936 - 2021 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
7. Akil Mark Koci - 1936 - Ekspresionizëm, Fluxus, Serializëm
8. Halit Kasapolli - 1937–1959 - Pan diatonikë, elemente folku
9. Gjergj Kaçinari - 1939 - 2019 - Pan diatonikë, elemente folku
10. Zeqirja Ballata - 1943 - Serializëm dhe forma të ndryshme dodekafonike, ekspresionizëm, elemente folku
11. Rauf Dhomi - 1945 - Neoromantizëm, Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
12. Rafet Rudi - 1949 - Neoklasicizëm, postmodernizëm, elemente folku
13. Gjjon Gjevelekaj - 1951 - Pan diatonikë, elemente folku
14. Bashkim Shehu - 1952 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
15. Mendi Mengjiqi - 1958 - Muzikë modale, sonoristikë, postromantizëm, postmodernizëm, elemente folku
16. Bahri Mulliqi - 1959 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
17. Baki Jashari - 1960 - Serializëm, Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
18. Valton Beqiri - 1967 - Neoklasicizëm, element jazz-i, element pop-i, elemente folku
19. Ilir Bajri - 1969 - Minimalizëm, elektronikë, postminimalizëm, elemente jazz-i, elemente folku
20. Trimer Dhomi - 1976 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
21. Arta Zeqiraj - 1980 - Serializëm, Neoklasicizëm, postmodernizëm
22. Artan Hasani - 1981 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë
23. Donika Rudi - 1982 - Elektronikë, muzikë mikst
24. Kreshnik Aliçkaj - 1982 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, neoimpresionizëm, elemente folku
25. Kushtrim Gashi - 1984 - Serializëm, Neoklasicizëm, postmodernizëm, muzikë modale, elemente folku
26. Dafina Zeqiri Nushi - 1984 - muzikë modale, postmodernizëm, serializëm, elemente folku, extended techniques

27. Arbenita Lubishtani - 1985 - Serializëm, Neoklasicizëm
28. Lyra Kastrati - 1985 - Muzikë modale, post-modernizëm
29. Memli Kelmendi - 1986 - Neoklasicizëm, muzikë modale, post-modernizëm, elektroakustikë
30. Korab Shaqiri - 1986 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, elemente folku
31. Drinor Zymberi - 1987 - Muzikë modale, sonoristikë, postimpresionizëm, neoklasicizëm, postmodernizëm, elemente folku
32. Fati Fehmiju - 1989 - postmodernizëm, muzikë mikst, muzikë me kompjuter, elektroakustikë, polistilistikë, extended techniques
33. Liburn Jupolli - 1989 - post-modernizëm, muzikë mikst, muzikë me kompjuter, elektroakustikë, polistilistikë, neoklasicizëm, muzikë mikrotonale, extended techniques
34. Florent Shasivari - 1989 - Neoklasicizëm, post-impresionizëm, Pandiatonikë
35. Muhamed Bislimi - 1990 - Neoklasicizëm, Pan-diatonikë
36. Ardian Halimi - 1990 - postmodernizëm, extended techniques
37. Vedat Lushtaku - 1991 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, serializëm
38. Hajrullah Syla - 1991 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, postmodernizëm, elemente folku, serializëm
39. Arbër Salihu - 1991 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, postmodernizëm, elemente jazz-i, elemente pop-i, elemente folku
40. Rron Karahoda - 1992 - Neoklasicizëm, Pandiatonikë, postmodernizëm
41. Yllnor Kurti - 1993 - Neoklasicizëm, postmodernizëm
42. Anda Kryeziu - 1993 - postmodernizëm, muzikë mikst, muzikë me kompjuter, elektroakustikë, extended techniques
43. Valton Kuqi - 1994 - Neoklasicizëm, neoimpresionizëm
44. Bardh Dubovci - 1994 - Neoklasicizëm, postmodernizëm, extended techniques
45. Blond Krasniqi - 1995 - Neoromantizëm, Neoklasicizëm
46. Ylli Daklani - 1998 - postmodernizëm, extended techniques
47. Diar Zasella - 1998 - postmodernizëm, muzikë elektroakustike, muzikë mikst, extended techniques
48. Leutrim Sahiti - 1999 - postmodernizëm, neoklasicizëm

49. Ersan Januzi - 2000 - postmodernizëm, neoklasicizëm
50. Lum Hallabaku - 2000 - neoklasicizëm, elemente folku, muzikë kinematografike
51. Fjolla Gashi - 2001 - postmodernizëm, extended techniques
52. Fitim Bytyqi - 2001 - neoklasicizëm, pandiatonikë
53. Besart Elezi - 2002 - neoklasicizëm, pandiatonikë
54. Dea Ahma - 2003 - postmodernizëm, extended techniques

5. GRUPIMET STILISTIKE

Një grupim paraprak më gjithëpërfshirës mund të bëhet nëse u qasemi periudhave më të mëdha të zhvillimeve estetike dhe filozofike në Evropë, të cilat kanë afektuar kompozitorët tanë.

Grupimi i parë është periudha moderne e cila në permutacionet e veta në Kosovë përfshin:

- Neoklasicizmin (me ose pa elemente të traditave muzikore folklorike), neoromantizmin (me ose pa elemente të traditave muzikore folklorike), serializmin dhe shkollat e ndryshme dodekafonike të shekulli të 20-të dhe muzika pandiatonike.

Grupimi i dytë përfshin zhvillimet pas viteve 80-90 me postmodernizmin në permutacionet e veta:

- Muzikën modale, spektralizmin, postmodernizmin polak, minimalizmin dhe postminimalizmin, polistilisticizmin, muzikën elektroakustike, muzikën mikst, muzikën elektronike me sintezë, muzikën me teknologji të reja dhe instrumente të reja (shih. Instrumenti Octo dhe paisje të tjera) dhe mikrotonalitetin.

6. MODERNIZMI

6.1. Neoklasicizëm dhe neoromantizëm

Stili neoklasik në Kosovë është prezent që nga pjesa e dytë e shekullit të 20-të dhe është një stil që ende përqafohet edhe prej kompozitorëve të rinj, por edhe prej kompozitorëve, të cilët nuk e kanë neoklasicizmin si shprehje kryesore.

Po ashtu, neoklasicismi në Kosovë si në shumë stile të tjera shumë shpesh gërshetohet me elemente të përpunuara me kujdes të trashëgimisë së muzikës folklorike të Kosovës.

Elementet e folklorit tonë po ashtu mund të jenë motivet nga i cili bazohet gjithë vepra neoklasike në këtë rast.

Format e tilla të neoklasicismit i vërejmë në permutacione të ndryshme që prej veprave të Fahri Beqiri, duke përfshirë këtu veprën antologjike “Skënderbeu”, ku brenda kësaj poeme simfonike ka elemente të folklorit tonë të gërshetuar me një gjuhë moderniste.

Kompozitorë të tjerë që e përdorin këtë gjuhë kompozicionale në kompozimet e tyre në periudha të ndryshme të veprimtarisë së tyre janë Rexho Mulliqi, Rafet Rudi, Kreshnik Aliçkaj, Valton Beqiri, Artan Hasani, Rauf Dhomi, Mark Kaçinari, Blond Krasniqi, Rexho Mulliqi etj.

6.2. Muzika pandiatonike

Kompozimi në Kosovë në momente të ndryshme që prej veprave të para nga Lorenc Antoni kanë elemente të ndryshme diatonike, të cilat nuk janë as në spektrin neoklasik apo neoromantik, por me një përdorim të lirë të diatonikës.

Si formë e shprehjes kompozicionale e cila po ashtu paraqitet në SHBA në shekullin e 20-të dhe më tutje, kjo shprehje përdoret nga kompozitorët Mark Kaçinari, Bashkim Shehu, Gjon Gjevelekaj, Halit Kasapolli, Kristë Lekaj, Vinçenc Gjini.

Por mund të konsiderohet se në mungesë të shkollës apo shkollave nacionale të kompozimit pandiatonika është modaliteti më i përdorur kompozicionalisht jo vetëm te gjeneratat e para, por edhe te kompozitorët e tjerë më vonë.

6.3. Serializmi dhe shkolla dodekafonike

Serializmi si teknikë kompozicionale ka pasur efekt te kompozitorë të ndryshëm kosovarë që prej gjysmës së dytë të shekulli XX. Si një prej personaliteteve që kanë propaganduar në periudhën më afatgjate permutacione të ndryshme të serializmit është akademiku Zeqirja Ballata.

Si estetikë dhe teknikë kompozicionale përdoret edhe në vepra të kompozitorëve të tjerë, por shumë më rrallë dhe, përveç akademikut prof. Zeqirja Ballata, si teknikë e gjejmë shumë më pak edhe te kompozitorët e tjerë në krahasim me stilet e tjera.

7. POSTMODERNIZMI

Ndonëse me zhvillim me hapa shumë të shpejtë si shumë prej stileve të tjera në Kosovë, postmodernizmi u paralajmërua nga vepërimitaria e hershme e kompozitorit Mendi Mengjiqi dhe me elemente në disa prej veprave të Rafet Rudit.

Postmodernizmi me permutacionet e veta si muzikën minimaliste, mikrotonalitetin, spektralizmin dhe polistilistikën paraqiten në vepra të ndryshme të disa prej kompozitorëve të shkollës së Mendi Mengjiqi.

7.1. Muzika modale

Elemente të këtij stili vërehen në vepra të ndryshme të studentëve të shkollës së Mendi Mengjiqit. Kompozitorët që kompozojnë me këtë gjuhë më shumë janë Dafina Zeqiri Nushi, Kushtrim Gashi, Drinor Zymberi, etj.

7.2. Muzika spektrale

Elemente të muzikës spektrale mund të gjejmë te disa kompozitor duke përfshirë kompozitorët Ardian Halimi, Anda Kryeziu, Liburn Jupolli, Fati Fehmiju etj.

Ndonëse si stil fillesat i ka në Francë spektralizmi është shpërndarë dhe përdoret gjerësisht në Evropë dhe si pasojë po ashtu ka arritur të prekë shkollat dhe të marrë vëmendjen e kompozitorëve kosovarë.

Megjithatë sikurse stilet e tjera spektralizmi në veprat e këtyre kompozitorëve është element dhe jodefinues i stilit të këtyre kompozitorëve e ende më pak si element qendror i veprave ku përdoren elementet e këtij stili.

7.3. Minimalizmi dhe postminimalizmi

Minimalizmi paraqitet për herë të parë në mënyrë më eksplicite nga kompozitori dhe pionieri i Jazz-it në Kosovë Ilir Bajri.

Veprat e ndryshme për piano, piano elektrike, sintisajzere, instrumente të ndryshme softuerike dhe elektronikë me aplikim të efekteve nga Ilir Bajri pëmbajnë elemente të repeticionit dhe minimalizmit dhe janë performuar në festivale të muzikës së re më shumë se dy dekada.

Rruga e kompozimit më eksperimental dhe minimalist pastaj fillon prej 1997 ku Ilir Bajri shkruan veprën “Beyond”.

Veprat më stil minimalist dhe postminimalist më të njohura janë cikli i “Re-Piano” për disa piano softuerike dhe efekte *delay*.

Estetikë të ngjashme postminimaliste me më shumë influencë nga minimalizmi post John Adams mund të vërehet edhe te veprat e kompozitorit të ri nga Kosova që jeton në Bronx, Ron Karahoda.

Veprimtaria e kompozitorit Liburn Jupolli po ashtu përmban estetikë minimaliste dhe postminimaliste me vepra të plota të këtij stili dhe si stil, brenda veprave polistilistike apo elemente minimaliste brenda veprave posi-stilistike.

Veprat me këtë stil janë “Corridors of the castle surrounded by water”, “Dead soul searching the sky in the sea”, “Prelud”, Pr-el-ud, “Rising ground, rise”,

Elemente të muzikës minimaliste mund të gjenden në mënyrë sporadike në vepra të izoluara estetikisht nga Dafina Zeqiri Nushi, Drinor Zymberi, Kushtrim Gashi, etj.

7.4. Polistilistika

Polistilisticizmi shfaqet në forma të ndryshme përmes citimeve muzikore, përzierjes së teknikave të ndryshme të kompozimit në një vepër dhe zhanreve të ndryshme në një kompozim.

7.5. Elektroakustika, muzika mikst, muzika kompjuterike, muzika elektronike me sintezë dhe me teknologji të reja bashkëkohore

Kompozitorët kosovarë kanë filluar t'u qasen teknologjive të reja në forma të ndryshme që nga vitet 80-90.

Ndër veprat e para të muzikës elektroakustike janë veprat nga Rafet Rudi, Mendi Mengjiqi, të cilat kanë pasur elemente të inçizimeve të instrumenteve folklorike apo të burimeve të tjera tingullore si në veprën "Contact" nga Mendi Mengjiqi.

Vepër tjetër pioniere e muzikës eksperimentale elektronike dhe me sintezë është vepra e viti 1997 "Beyond" e Ilir Bajrit.

Ky profil i kompozimit pas vitit 2000 zhvillohet nga kompozitorja Donika Rudi, e cila është kompozitorja e parë e diplomuar në këtë drejtim dhe kompozitore që gati ekskluzivisht punon me elektroakustikë dhe teknologji të reja duke përfshirë edhe muzikë mikst.

Kompozitorë të tjerë si Memli Kelmendi po ashtu përdorin e kompozojnë vepra elektroakustike dhe mikst dhe përgjatë dekadës së dytë të shekullit XXI vërejmë interesim të shtuar me kompozitorë të tjerë të rinj që studiojnë dhe kompozojnë vepra elektroakustike dhe mikst.

Këtu përfshihet edhe një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë time me vepra të shkruara elektroakustike, me live electronics vepra mikst për instrumente dhe efekte, për instrumente elektronike dhe për instrumente të shpikura nga unë.

Pastaj është kompozitorja Anda Kryeziu, e cila po ashtu aktivisht merret me teknologji të reja, me augmentim të instrumenteve përmes amlifikimit dhe teknikave të tjera, sintezës dhe teknikave të muzikës.

Kemi vepra të shkruara nga kompozitorë të ndryshëm të gjeneratës post 2000 me elemente të muzikës ambientale, elektroakustike ku përfshihen Drinor Zymberi, Trimor Dhkomi, Ylli Daklani, Memli Kelmendi etj.

Diar Zasella është një prej kontribuesve të rinj me studime në Francë me vepra të ndryshme elektroakustike.

Një interesim i shtuar vërehet te gjeneratat e reja për teknologji muzikore dhe si lloj i muzikës mbetet të zhvillohet ende në Kosovë duke investuar po ashtu në kapacitetet infrastrukturore të nevojshme për

elektroakustikë dhe stilet të tjera që kanë lidhje me teknologji muzikore bashkëkohore.

7.6. Mikrotonaliteti

Duke marrë parasysh fondusin e folklorit në Kosovë mikrotonet kanë qenë gjithnjë prezente në shumë prej këngëve dhe pjesëve të zhanreve të ndryshme brenda shkallëve muzikore që janë përdorur në Kosovë nga rapsodët, instrumentistët dhe krijuesit e ndryshëm brenda muzikës folklorike.

Trashëgimia muzikore folklorike në Kosovë duke përfshirë dhe vetë instrumentet muzikore përmban në vetvete përdorim të qerek-toneve në variante të ndryshme dhe mikrotoneve e glisandove mikrotonale që i rastisin në shumë prej materialit muzikor që nga shekulli XVIII-XIX e tutje.

Andaj natyrisht dhe veprimtaria e kompozitorëve kosovarë që në shumë raste përdor elemente nga folklori ynë në një mënyrë apo tjetër përmban elemente mikrointervalore.

Që nga veprat e para të kompozitorëve të gjeneratës së parë ku reprezentohen shkallët dhe disa prej instrumenteve tona folklorike mund të shihen elemente indirekte të aspekteve mikrointervalore në kompozimet e kompozitorëve kosovarë.

Kurse në dekadën e parë të shekullit XXI me gjeneratën e re të kompozitorëve të klasës së Mendi Mengjiqi, duke përfshirë edhe vepra të caktuara të vetë profesorit, vërejmë përdorim më të drejtpërdrejtë të mikrotoneve të ndryshme.

Përdorimi i mikrotoneve vërehet edhe te gjeneratat edhe më të reja, ku edhe glisandot dhe lëvizjet e ndryshme të ngjashme intervalore përdoren në vepra ku ka instrumente me harqe dhe me instrumente të tjera.

Veprat e tjera përfshijnë edhe veprat ku në formacion kamertal apo orkestral përdoren instrumentet tona folklorike, si: kavalli, fyelli, çiftelia, lahuta etj. mund të dallojmë përdorim të mikrotoneve.

Po ashtu në muzikë elektroakustike dhe në vepra ku ka incizim të instrumenteve folklorike të Kosovës mund të vërehet përdorimi i shkallëve me elemente të mikrotonalitetit.

Si kompozitor në veprat e të cilëve vërehet përdorimi më eksplisit i mikrotoneve janë kompozitorët e ndryshëm të gjeneratës pas vitit 2000.

8. EMËRUESI I PËRBASHKËT STILISTIK

Ka një element në hyrje të qasjes së Lorenc Antonit që e kam cekur më lart, që si frymë është përçar te gjeneratat siç thotë ai në lidhje me folklorin dhe kompozitorët.

Emërues kryesor i përbashkët stilistik duket të vazhdojë të jetë elementi i përdorimit të folklorit në forma të ndryshme dhe në masë e shpërfaqje indirekte e direkte.

Duke u bazuar në listën e më lart shohim se prej 54 kompozitorëve, 26 prej tyre e kanë elementin folklorik si pjesë përbërëse në një mënyrë apo tjetër në disa ose shumicën e veprave të tyre dhe si i tillë elementi i folklorit në këtë rast mund edhe të konsiderohet i përdorur si lloj identiteti muzikor stilistik kosovar.

Një tjetër prerje stilistike, e cila bën një dallim nga shekulli XX dhe shekulli XXI është përdorimi i teknikave të zgjeruara të instrumentit i cili prej 54 kompozitorëve vërehet që përdoret nga 7 kompozitorë më shpesh dhe në disa vepra te të tjerët.

Një grupim tjetër mund ta shohim në listën e mëposhtme në bazë të analizës nga lista paraprake e stileve:

1. Kemi rreth 24 kompozitorë me elemente apo qasje pandiatonike.
2. Një numër të konsiderueshëm i kemi me 33 kompozitorë me vepra që kanë elemente të neoklasicizmit.
3. Kemi po ashtu celula të reja të polistilistikës në vepra pas vitit 2005 e tutje në më shumë se 22 kompozitorë.
4. Dallojmë edhe celula të reja të elektroakustikës me 7 kompozitorë, përdorimit të teknologjive të reja dhe mikrotoneve.
5. Rikthim dhe rimendim i të gjitha elementeve stilistike përfshirë dhe përdorimin e teknikave moderne dhe postmoderne.

9. PËRMBYLLJE

MUNDËSITË E REJA TË VEPRIMIT PËR ZHVILLIM

Nga shkrimi i Lorenc Antonit më 1951 ku thotë që Kosova do të japë kompozitorë ku ishte veç ai, sot kemi 56 kompozitorë që janë zhvilluar brenda 71 vjetësh.

Kosova ka zhvilluar një kulturë evropiane të cilën e ka përqafuar shumë shpejt, pa përgatitje të forta, me shumë mundime për shkak të situatës politike dhe në pjesën më të madhe realisht pa një shkollë të definuar kompozicionale.

Kjo i ka dhënë kompozimit kosovar një liri dhe hapësirë të veprimit ku janë zhvilluar hibride të ndryshme stilistike dhe formate kompozimi që nuk i shohim ngjashëm në shumë vende në botë.

Kompozitorët jo vetëm se kanë përqafuar të gjitha ato që u kanë pëlqyer si mjete pune, por edhe nuk kanë pasur barriera stilistike prej fillimit të klasës së kompozimit në vitet 70 edhe nga kompozitorët dhe shkolla e re e Mendi Mengjiqit, kryesorja ka qenë dhe është aftësia e kompozimit, kurse stili dhe përzgjedhja mbetet zgjedhje e kompozitorit.

Fusha e kompozimit në Kosovë siç shihet nga lista leksikografike më lart ka pasur interesim të shtuar që nga 2 dekadat e fundit dhe një ngritje në aktivitete për t'i mbështetur kompozitorët dhe veprimtarinë e tyre është më se e nevojshme për të mbajtur këtë fushë në elanin zhvillimor që është duke e përjetuar dhe për të katalizuar më tutje këtë veprimtari.

Ka nevojë për një strukturë më të qëndrueshme që e zhvillon sistematikisht botimin, incizimin, performimin dhe promovimin e kësaj fushe fillimisht në Kosovë, në rajon dhe më tutje në botë.

Një element pozitiv është se tashmë janë krijuar dhe shkolla të reja të kompozimit dhe po ashtu ka ngritje në njohje të teknologjive të reja muzikore, të cilat i ndihmojnë zhvillimit të kompozitorëve, por nevoja më e madhe është që të ketë iniciativa më të mëdha sa i përket aktivitetit performues dhe dokumentues jo vetëm për kompozitorët e rinj, por edhe për kompozitorët e gjeneratave më të vjetra, kompozimet e të cilëve nuk i kemi dëgjuar më herët, gjë që gjen shprehje edhe nevoja e hulumtimit të thellë të materialit muzikor të të gjithë kompozitorëve duke filluar Lorenc Antonin dhe gjeneratën e tij e deri më sot.

Si përfundim, një ansambël i cili performon rregullisht do të mund ta katalizonte këtë kërkesë të kahmotshme dhe do të mund të kemi më shumë dokumente në formatet audio të veprave.

Tani në ekosistem muzikor kemi platformat e ndryshme të festivaleve, kapacitetet njerëzore në profile të ndryshme dhe me pak bashkëpunim dhe ekspertizë me instrumentistët dhe dirigjentët me përvojë në muzikë të re kjo kërkesë do të mund të përmbushej.

Me këto masa potenciale kompozimi në Kosovë do të mund ta shtyjë eleantin e vet më tutje dhe të njihet edhe me shumë në Kosovë dhe më gjerë.

Potenciali zhvillimor pozitiv për kompozitorët në Kosovë ekziston siç mund ta verifikojmë në numra më lart dhe vazhdon të ngritet.

Një përmbushje e këtyre masave do ta bënte edhe më atraktive studimin e kompozimit dhe të sjellë ende më shumë talent të rinj që do të mund të ngrisin numrin, por edhe më me rëndësi do të ngriste nivelin profesional kualitativ të kompozitorëve dhe po ashtu eksperiencës kompozicionale në tërësi.

SUMMARY

Kosovo has seen an array of developments in its cultural ecosystem with various waves of massive contribution by its artists and intellectualls since the first half of the 20th century with the institutionalization of culture and art, the second wave of the end of modernism in the second half of the 20th century with the various tumultuous periods in its political instability with the Serbian government repression and war and the waves coming after the end of the war post 1999, with more than 22 years of massive exansion of its cultural sector, a unrecedented level of cultural production an increase in its cultural structures and more than 3000 human resources working in all fields of the cultural sector.

One very important contribution to the musical ecosystem is the contribution of the Kosovar composers.

The Kosovar composers since the 20th century have been a driving force in change in the development of music, starting with Lorenc Antoni and his generation, continuing with the second and third generations and the enrichment of this sector through the new schools

post 1999, where for 20 years we see a very rapid rise and many new successes with the coming of new composers.

The lack of documentation in music has gradually started to be mended with new publications and writing coming each year and this article also strives to help in the direction of having more writings about composers and a wider and more all encompassing view of the different composer generations, the types of compositions and a general view of the developments.

LITERATURA DHE REFERENCAT

- [1] Dr.Liburn Jupolli - Antologji e kompozitoreve te rinj Kosovar
- [2] Dr.Liburn Jupolli - Octo-Instrumenti i ri inovativ bashkekohor
- [3] Dr.Liburn Jupolli - For Chopin - Vepra të frymëzuara nga Chopin
- [4] Drinor Zymberi - Moving Landscapes
- [5] Rreze Kryeziu - Breznica - Goca e Kaçanikut - Opera e parë nacionale në Kosovë - Aspektet estetike - sociologjike
- [6] Rreze Kryeziu Breznica - The history of art music of Albanians in Kosovo
- [7] Engjëll Berisha - Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997
- [8] Rafet Rudi - Sprova estetike e shek.XX
- [9] Zeqirja Ballata - Gjurmeve te muzes (1987)
- [10] Zeqirja Ballata - "Mbi disa veçori të kompozitorëve shqiptarë të Kosovës, të shekullit XX-të.
- [11] Rreze Kryeziu-Breznica: Kompozitorët e muzikës artistike në Kosovë - Ndarja historike sipas muzikologjisë kosovare
- [12] Rreze Kryeziu Breznica: Muzika artistike në Kosovë: Vështrim i përgjithshëm mbi literaturën ekzistuese

Muhamet Mala*, Prishtinë

KONVERTIMI DHE TOLERANCA FETARE TE SHQIPTARËT GJATË SUNDIMIT TË PERANDORISË OSMANE

Abstrakt

Punimi trajton çështjen e konvertimit fetar te shqiptaret duke e ndjekur vertikalen historike që nga koha apostolike e krishterimit e deri te pranimi i islamit në mënyrë masovike në shek. XVI-XVII. Ky proces i ka specifikat e veta në kohë të ndryshme dhe dallon për nga rëndësia dhe vendi. Së pari islami ndër shqiptarët ishte pranuar individualisht, kryesisht nga individë të shtresave të larta e pas dy shekujve ky fenomen zgjerohet te pjesa më e madhe e popullsisë. Nga shekulli XVII mund të flitet për shqiptarët që u takojnë tri religjioneve, por e përbashkëta e tyre mbeti gjuha dhe ndjenja e përkatësisë së njëjtë etnike që rezultoi me një tolerancë dhe bashkëjetesë të shkëlqyer fetare në mes tyre.

Fjalët çelës: Perandoria Osmane, shqiptarët, krishterimi, islami, toleranca etj.

Në periudha të ndryshme historike Ballkani në përgjithësi e Shqipëria në veçanti ka shërbyer si pikëtakim i kufijve të rëndësishëm politik, kulturor e fetar. Në fillim aty takoheshin kufijtë e Perandorisë Romake të Lindjes me atë të Perëndimit, më pastaj aty u takuan ortodoksia me katolicizmin dhe së fundi islami me krishterimin.¹ Shqipëria duke qënë e kushtëzuar nga ndikimet e jashtme rivalizuese qysh herët përjetoi ndarjen brendakrishtere. Derisa shtetet e tjera të Ballkanit si tërësi politike, kulturore e fetare u orientuan ose me Lindjen ortodokse ose me Perëndimin katolik, Shqipëria mbajti në vete këto të dyja duke krijuar kështu parakushtet që ta pranojë edhe religjionin e tretë, islamin. Duhet potencuar fakti i mirënjohur se iliro-arbërorët duke qënë pjesë e rrjedhave kulturore në antikën e vonë predikuan, e pranuan dhe ndikuan në përhapjen e krishterimit që nga koha apostolike.²

* Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik

¹ Jelavich. B. "Historia e Ballkanit". Tiranë, 1999, f. 9

² Mirdita. Z. "Krishterizmi ndër shqiptarët", Prizren-Zagreb, 1998, f. 145

Duke ndjekur vertikalen historike të këtyre proceseve arrijmë edhe te shekulli XV dhe depërtimi i Perandorisë Osmane në trevat e Ilirikut antik përkatësisht Ballkanit mesjetar. Pavarësisht nga theksi mbi luftën fetare, synimi i Perandorisë Osmane veçmas në fazën e parë të zgjerimit në Evropë nuk ishte përhapja e fesë islame. Bie fjala, nëse një qytet apo krahinë nënshtrohej pa rezistencë atëherë popullsia mund ta ruante sipas dëshirës fenë dhe autonominë e gjerë lokale. Kthimi në fenë islame sipas Perandorisë Osmane për popujt e pushtuar ishte i dëshirueshëm, por në këtë periudhë jo i detyrueshëm. Kështu shqiptarët edhe pse u pushtuan nga osmanët vetëm pas dy shekujsh pushtimi mund të bëhet fjalë për islamizimin në masë të tyre. Fenomeni i islamizimit kishte karakteristika dhe arsye të ndryshme në kohë të ndryshme dhe vende të ndryshme në Perandorinë Osmane. Derisa në fillim procesi ishte i dëshirueshëm dhe pa imponime direkte në shekujt e mëvonshëm veçanërisht gjatë shekullit XVII në kohën e dekadencës së Perandorisë Osmane fenomeni i kriptokatolicizmit te shqiptarët dëshmon për imponimin e dhunshëm të fesë islame.

Shikuar nga ky këndvështrim edhe pyetja e shtruar shpesh në opinionin e gjerë shqiptar se cili ishte roli i islamizmit te shqiptarët, na del tejet i komplikuar dhe e pamundur të jepet përgjigje vetëm përmes një fjalie, duke thënë se ishte pozitiv ose negativ. Në fakt, ky proces nuk ka rol të njëjtë në raport me çështjen kombëtare shqiptare në kohëra dhe hapësira të ndryshme, andaj për t'u qartësuar ky fenomen duhet ndarë dhe analizuar në kohë dhe hapësirë ku i njëjti proces mund t'i ketë të dyja përgjigjet në vetvete, përkatësisht i njëjti proces në një kohë pati rol pozitiv, ndërsa në rrethana të tjera roli i tij ishte krejtësisht ndryshe.

Një kohë të gjatë popujt e nënshtroar nga Perandoria Osmane të një feje tjetër kishin një pozitë të caktuar nën drejtimin e autoriteteve të tyre fetare të organizuara në formën e milletit. Perandoria Osmane nuk u përpoq të vendoste marrëdhënie të drejtpërdrejta me individin apo qytetarin, por ajo parapëlqeu ndërmjetësimin si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë fetar. Pushteti osman nuk interesohej për jetën e zakonshme apo bindjet e popullatës së krishterë. Masa e fshatarësisë së krishterë veçmas ajo ortodokse në kuadër të Perandorisë Osmane kontrollohej nga Kisha ortodokse përmes sistemit të milletit, në nivelin më të lartë, ndërsa në nivelin lokal kontrollohej nga autoritetet e zgjedhura në bazë të traditës, si p.sh i pari i fisit apo i vendit apo ndonjë famullitar lokal përgjegjës për ushtrimin e riteve fetare. Megjithatë për një barazi të vërtetë fetare nuk mund të bëhet fjalë. Jomyslimanët paganin taksa shtesë dhe kishin disa kufizime. Ndarja e parë përbrenda

Perandorisë Osmane ishte fetare, kurse tjetra ndarje ishte nga pozita shoqërore, individuale dhe funksioni në kuadër të Perandorisë Osmane. Islami, në përgjithësi, ofronte dhe krijonte kushtin e parë që jepte mundësinë apo oportunitetin për t'u ngjitur në majë të piramidës shtetëror osmane pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe pozitën shoqërore të familjes nga e cila rridhte. Perandoria Osmane nga pikëpamja organizative përbënte një sistem të ndërlikuar dhe kompleks, i cili nuk qëndroi çdo herë i njëjtë.

Në këtë kontekst nuk ishte i njëjtë as në qëndrimin ndaj çështjes fetare. Në historiografinë nacional-romantike të Ballkanit veçmas në atë sllave Perandoria Osmane e shekullit XVI kur ishte në kulmin e fuqisë së vet dhe kishte një strukturë dhe qëndrim tjetër ndaj të nënshtruarëve, pikturohet me ngjyra të njëjta sikur perandoria e shekullit XIX kur kishte marrë epitelin "i sëmuari i Bosforit". Gabimi në vlerësimin e Perandorisë Osmane qëndron në gjeneralizimin apo përgjithësimin, duke mos e dalluar se ajo nuk ishte e njëjtë në fillim dhe fund. Kështu tejkalohet periudha e hershme e zhvillimit osman ku kishte një trajtim liberal ndaj të krishterëve në periudhën e mëvonshme ku gjërat ndryshojnë esencialisht e në këtë edhe çështja ndaj fesë. Po ashtu e shohim të nevojshme të potencojmë faktin se qëndrimi i Perandorisë Osmane ndryshonte edhe brenda vetë trajtimit të krishterëve, pra nuk ishte i njëjtë ndaj krishterëve ortodoksë si ndaj atyre katolikë. Ortodoksët kishin një lloj aleance me osmanët që nga koha e rënies së Kostandinopojës dhe ata gëzonin një trajtim me liberal dhe inkorporim në strukturat e Perandorisë aq sa lejonin rregullat e një shteti islam. Ndryshe qëndronte puna me të krishterët katolikë, të cilët konsideroheshin të ndikuar nga papati si armik i Perandorisë Osmane, andaj edhe trajtimi i tyre ishte fare tjetër dhe mbahej një qëndrim dyshues dhe më rigoroz ndaj katolikëve.

Menjëherë pas pushtimit të Kostandinopolit Mehmeti II Pushtuesi duke qenë i vendosur në ruajtjen e qetësisë në radhët e popullsisë së krishterë dhe duke dashur ta kishte nën kontroll Kishën ortodokse që ishte e përçarë rreth çështjes së ribashkimit me Romën vendosi Jorg Skolariosi më emrin fetar Genadi, si patriarkun e Kostandinopolit³. Si kreu i komunitetit ortodoks patriku i Kostandinopolit mori mbi vete detyra dhe përgjegjësi të mëdha. Patriarkët ortodoksë tradicionalisht rallëherë i kundërviheshin politikës osmane. Patriarkana ushtronte kontroll të plotë mbi kishat ortodokse dhe pasuritë e tyre. Klerikët ishin

³ Jelavich, B. vep e cit. f.58

nën juridiksionin e gjyqtarëve të tyre dhe ishin të liruar nga taksat. Si zyrtar i lartë i qeverisë osmane patriarku gëzonte tagrin e emblemës me dy bishta kali që ishte analog me postin e vezirit apo ministrit të Perandorisë Osmane. Sa për krahasim një guvernator apo gjeneral kishte tre ndërkaq Sulltani gjashtë tuga kali. Nga një qëndrim i tillë i Perandorisë Osmane ndaj Kishës ortodokse, shqiptarët edhe pse i takonin në një masë relativisht të madhe ortodoksisë, ata nuk patën përfitime të tilla. Kishat ortodokse ishin të organizuara në baza nacionale dhe mbrojnë interesat e kombësisë që i takonin. Shqiptarët në mungesë të kishës nacionale ishin të privuar nga këto të drejta. Madje ishin të rrezikuar nga nacionalizmi fetar, i cili bartej në planin etnik qoftë ai grek apo serb. Në fakt, Patriarkana e Kostandinopolit identifikohet me interesa greke, ndërsa krahas saj në Ballkan ekzistonin edhe dy kisha autoqefale, ajo bullgare me qendër në Ohër dhe ajo serbe me qendër në Pejë e që fillimisht e kishte pasur qendrën në Zhiçë të Serbisë së sotme, por për shkaqe të sulmeve të fiseve kumane të ardhur nga Azia Qendrore kishte bartur selinë në Pejë për ta shpëtuar. Pra, përfitues real nga pushteti osman një kohë të gjatë, që nga shekulli XV e deri në shekullin XVII ishin pikërisht ortodoksët, ndërkaq mendimet mbi përfitimet e shqiptarëve gjatë kalimit në islam të propaganduara nga historiografia serbe janë pjesërisht të vërteta dhe kanë të bëjnë kryesisht me individët apo klasën sunduese e jo gjithsesi me tërë popullatën.

Shqiptarët katolikë nga ana tjetër jo vetëm që ishin të rrezikuar nga islami, por falë pozitës së lartpërmendur të Kishës ortodokse ata rrezikoheshin edhe nga nacionalizmi ortodoks serb apo grek ose bullgar. Sipas një raporti të relatorit Gjergj Bardhi drejtuar Romës me 1638, ai njofton lidhur me bisedimet që kishte pasur me patrikun serb në Pejë rreth situatës kritike dhe kërkonte nga Roma që të sigurohen mjete për famullitarët katolikë se për ndryshe katolikët e Trepçës dhe Letnicës do të kalojnë në fenë ortodokse.⁴ Gjergj Bardhi si shqiptar dhe misionar i Papës ishte shumë i shqetësuar për këtë fenomen. Po ashtu me datën 10 gusht 1670 në një shkresë drejtuar Kongreacionit Argjipeshkvi i Shkupit, shqiptari Andrea Bogdani ankohet për vuajtjet e katolikëve shqiptarë nga shkizmatikët ortodoksë.⁵ Kisha Ortodokse, brenda Perandorisë Osmane deri në paraqitjen e lëvizjeve nacionaliste

⁴ Rizaj, S. Kosova gjatë shek. XV, XVI, XVII, Prishtinë, 1982 f. 470, Radonic, J. Rimska kurija... f.109

⁵ Radonic, J. Rimska kurija... f.347, Rizaj, S. Kosova... f.471

e mbajti të pandryshuar profilin e bashkësisë së krishterë, por edhe bashkësive nacionale duke e penguar islamizimin e serbëve, bullgarëve apo grekëve. Juridiksioni i Kishës ortodokse mbi çështjet familjare bëri që përzierjet e kombeve dhe e feve të ishin të pakta. Ndryshe qëndronte puna me Kishën katolike së cilës po ashtu i përkiste një pjesë e madhe shqiptarësh nën sundimin e Perandorisë Osmane. Kisha perëndimore konsiderohej armiku më i madh i osmanëve, madje edhe për opinionin ortodoks sundimi osman ishte më i përshtatshëm sesa ai i ndonjë fuqie katolike. Ashtu si për Perandorinë Osmane ashtu edhe për Patriarkanën, shteti i Papës, Perandoria Habsburge dhe Venediku katolik ishin armiqtë kryesorë. Franca si fuqi katolike ishte në anën e osmanëve, por për shkak të interesave kolonialiste dhe largësisë nuk shërbeu si fuqi për ruajtjen e katolicizmit në Ballkan. Ortodoksia ndryshoi qëndrimin ndaj Perandorisë Osmane vetëm atëherë kur Rusia në shekullin XVIII paraqitet si fuqi ortodokse e madhe me interesa kundër Perandorisë Osmane.

Në kushte të tilla të fërkimeve katolike dhe ortodokse brenda trevave shqiptare u pamundësua unifikim fetar i shqiptarëve dhe u krijuan parakushtet edhe për përhapjen e mëvonshme të islamit.

Sado që ekzistojnë tendenca që pretendojnë për përhapjen e islamit në Shqipëri dhe Ballkan para sundimit osman, mendojnë se historia nuk jep ndonjë provë bindëse dokumentuese që vërteton se islami ishte përqafuar para se në Shqipëri të vendosej pushteti osman.⁶ Apo mund të flitet me hamendje për raste individuale të islamit misionarik pa ndikim në rrjedhat shoqërore të vendit.

Kur hynë në Shqipëri, ushtritë osmane u përballën së pari me krerë të fuqishëm feudalë siç ishin Balshajt dhe Dukagjinët në veri, Topiajt në Shqipërinë e Mesme apo Zahariajt, Muzakajt, Arianitët në jug duke mos harruar gjithsesi Kastriotët në veri dhe pjesën qendrore të vendit. Në fazën e parë të depërtimit osman, feudalët lokalë hynë nën vartësinë e Perandorisë Osmane dhe u njohën si vasalet. Vasaliteti u konsiderua si hap i mjaftueshëm në fazën e parë të zgjerimit osman. Më pas veçmas pas Betejës së Angorës më 1402 disa feudalë vendas i dhanë fund pozitës së vasalit duke shkaktuar veprime të Perandoria Osmane që t'i riktheheshin pushtimit me forcë dhe regjistrimeve në defter të pronave ekonomike dhe popullsisë që u bënë bazë për vendosjen e sistemit Timar. Kësisoj elementet e parisë vendore të cilëve iu dhanë timare u bënë pjesë e kastës drejtuese, por e ruajtën fenë e krishterë

⁶ Jaques, E. Shqiptarë, Tiranë (pa vit botimi) f.240

njëkohësisht duke i përmbushur detyrat ndaj sulltanit. Pra në atë kohë u aplikua një politikë kompromisi në mes të pushtetit osman dhe interesave të feudalëve vendorë. Në fazën e hershme të shtrirjes së Perandorisë Osmane në trevat shqiptare, osmanët u detyruan të marrin në konsideratë interesat politike, ekonomike të shqiptarëve dhe jo politikën e drejtpërdrejtë të islamizimit të dhunshëm, gjë që nuk ndodhi në etapat e mëvonshme të sundimit osman. Shteti osman ndonëse ishte një formacion politik islam, nuk krijoi ndonjë problem fetar për popullatën shqiptare që jetonte në një zonë ku përplasej katolicizmi me ortodoksinë.⁷ Meqenëse aristokracia shqiptare ishte e para që ra në kontakt me pushtetin osman dhe filloi integrimin në sistemin e timarit, realisht ajo edhe e para filloi procesin e islamizimit. Sido që të jetë mund të themi se deri në shekullin XVII islamizimi i shqiptarëve si proces nuk ishte rezultat i një politike direkte islamizuese nga shteti osman. Si një argument përmendim feudalët vendas të krishterë që u pranuan, si timari, por u lanë të lirë në ushtrimin e fesë së tyre.⁸ Me kalimin e shqiptarëve në islam, mund të themi se rezultatet politike ishin shumë më të dukshme se ato sociale. Islamizimi nuk e humbi traditën e hershme dhe mënyrën e të jetuarit të shqiptarët. P.sh islami nuk e prishi traditën shqiptare të martesës me vetëm një grua, edhe pse normat islame pranorin një gjë të tillë. Për më tepër me kalimin nga krishterimi në islam, si rrugë e mesme në Shqipëri u praktikua bektashizmi që linte anash formalizmat në përmbushjen e riteve fetare. Përhapjes së bektashizmit i kontribuoi edhe institucioni i jeniçerëve ku shqiptarët përfaqësoheshin në një numër të madh. Islamizimi i shqiptarëve ishte një proces relativisht i gjatë që filloi individualisht aty ka shekulli XV dhe përfundoi masovikisht në fund të shekullit XVII. Duke qenë i tillë ky fenomen i ka edhe specifikat e veta në kohë dhe hapësirë. Kësisoj, islamizimi i shqiptarëve të Kosovës i ka specifikat e veta që lidhen me ekzistencën e popullsisë sllave me të cilën shqiptarët historikisht nuk patën raporte të mira. Rreziku i asimilimit sllav nga kisha kombëtare serbe bëri që ndikimi mysliman-turk të rritej dhe si pasojë procesi i islamizimit gjithashtu. Në këtë drejtim islamit në Kosovë së pari e pranuan shqiptarët e besimit ortodoks që ishin më të rrezikuarit nga ndikimi sllav, pastaj katolikët e më vonë pjesëtarët e

⁷ Skendi, S. Religion in Albania during dhe otoman rule. Syd- Ost-forchung, vol, XV, Munchen 1956, f.313

⁸ Inalcik, H. Arnavutluk'ta osmanli Hakimi yetimin, f.170; Bozborra N. Shqiperia dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorin Osmane, Tiranë, 2002, f.56

grupeve të tjera etnike që ishin në pakicë, si jevgjitë,vllehtë etj.⁹ Për Kosovën, si dhe viset e tjera kufitare me Serbinë dhe Malin e Zi, islamizimi mund të kuptohet si një mbrojtje nga sllavizimi, por ky fenomen nuk duhet gjeneralizuar si emërues i përbashkët, por që vlen vetëm për zonat e caktuara. P.sh në Mal të Zi fisi shqiptarë i Kuqve përmes ortodoksisë u sllavizua, kurse pjesa e këtij fisi që u islamizua mbeti shqiptare. Sikur ta gjeneralizonin këtë proces nuk do të kishin përgjigje në faktin se përse atëherë edhe shqiptarët ortodoksë të Jugut mbetën shqiptarë me gjithë fenë e tyre të krishterë apo katolikë të Veriut. Pra islamizimi luajti rolin e vet në mbrojtjen e identitetit të shqiptarëve në viset që ishin periferike dhe nën goditjen direkte të ortodoksisë sllave.

Në përhapjen e islamit te shqiptarët si faktor kyç shpesh përmendet edhe organizimi fisnor i tyre.¹⁰ Edhe pse ky ishte një faktor i islamizimit, por gjithsesi jo i dorës së parë, për faktin se edhe malazezët, bie fjala, patën një organizim të tillë apo shqiptarët toskë të Jugut nuk e njohin organizimin fisnor, e megjithatë u islamizuan. Po ashtu përpjekjet që islamizimi te shqiptarët ta kuptojnë si një faktor që ishte i ndikuar nga karakteri materialist i shqiptarëve apo shpirti luftarak i tyre, janë sipërfaqësore, naive dhe pa bazë shkencore.¹¹ Nga ana e ortodoksëve shqiptarë mungesa e një kishe nacionale ortodokse shqiptare që nuk mundi të formohet në kushtet e një fërkimi të fuqishëm katolik dhe ortodoks në këto treva, ishte faktori vendimtar që favorizoi islamizimin. Ndërkaq te katolikët shqiptarë u pa mundësia e ushtrimit të juridiksionit të gjerë të ipeshkvijve katolikë, veçmas pas armiqësismit të shqiptarëve me osmanët që nga koha e Skënderbeut i dhanë shkas islamizimit të katolikëve. Mungesa e ekzistimit të klasës së priftërinjve shqiptarë katolikë, të cilët migruan jashtë atdheut, bënë që të shkactohej dekadencia e krishterimit katolik te shqiptarët. Relatori Pjetër Mazreku në relacionin e tij të vitit 1633 tregon se si u islamizua popullsia e Hasit dhe Prizrenit. Sipas tij ata u bënë turq (myslimanë M.M) duke e ndërruar vetëm emrin *pa e pasë mendimin me e mohu fenë me zemër*.¹² Në Prizren thekson se në atë kohë kishte 50 familje katolike nën kujdesin e një famullitari dhe në një territor me rreth 4000 frymë gjendeshin nën kujdesin e dy priftërinjve. Nga mungesa e priftërinjve

⁹ Rizaj,S. Kosova gjatë shekujve...f.467

¹⁰ Shih, Bozboran,N. Shqiperia dhe nacionalizmi shqiptar, f.45-69

¹¹ Shih, Jaques, E.Shqiptarët, f.240-267

¹² Zamputi,I. Relacione I, f.445, Rizaj,S. Kosova...f.468

janë bërë turq (myslimanë M.M) popujt e 45 famullive të tjera¹³. Karakteristikë e rezistencës së qetë ndaj këtij procesi ishte mbajtja e emrit arnaut që e distancoi etnikisht shqiptarin nga turku ashtu siç e kishte distancuar nga serbi apo greku dikur mbiemri arbanas apo arvanitas. Priftërinjtë e huaj katolikë nuk kishin njohuri mbi doket, zakonet dhe gjuhën shqipe duke i hapur rrugë kësaj islamizimit në masë të shqiptarëve. Ajo që është me rëndësi të ceket në tërë procesin e islamizimit, shqiptarët nuk e humbën as gjuhën e as doket e tyre edhe pse u ndikuan nga kjo pikëpamje. Ajo që është me interes të ceket me këtë rast, konsiston në faktin se madje as klasa aristokrate shqiptare, bejlerët dhe agallarët tjerë nuk u asimiluan sado që ndikimi osman në jetën e përditshme të tyre nuk mund të mohohet. Ndër myslimanët e parë të Pejës, bie fjala, pa mëdyshje është Mahmut Beu i vëllai i Ahmet pashë Dukagjinit, i cili më të përqaftuar islamit bëhet Sanxhakbeu i parë i Sanxhakut të Dukagjinit (1462) dhe krijues i dinastisë së Mahmutbegollajve të Pejës. Siç dihet Mahmutbegollajt edhe sot janë të gjithë shqiptarë dhe kontribues të çështjes shqiptare në etapa të ndryshme historike. Në fakt, qysh herët në mendjen e shqiptarëve ishte ndezur shkëndija e kuptimit të kombësisë. Skënderbeu në një letër drejtuar princit italian Antoni Gjovani Orsini në tetor të vitit 1461 përmend përkatësinë etnike epirote të tij që ishte analoge me termin arbër.¹⁴ Apo shqiptar në periudhën e mëvonshme. Po ashtu edhe në shekullin XVI populli shqiptar mbështetej në fuqinë e traditës historike të Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Në organizimet politike shqiptare të Shqipërisë së Veriut më 1593 përmendet “nostro principe Giorgio Skanderbeg” apo më 1595 përmendet vula (sigillum) “regni Macedonije at Albanie” apo më 1595 Mark Gjini flet mbi “la mia nazione Albanese”¹⁵

Derisa islamizimi në fazat e para e veçmas deri në shekullin XVIII nuk paraqiste ndonjë ndikim me rëndësi për shqiptarët, puna ndryshoi kur me dobësimin e Perandorisë Osmane në skenë u paraqitën nacionalizmat ballkanikë të sponsorizuar nga fuqitë e krishtera. Në këtë kohë u aktualizua njësimi i kombësisë me fenë, përkatësisht nacionalizmi fetar grek, arbëreshët filloi t'i quajë grekë, ndërsa termi mysliman filloi të bëhet identik me termin turk. Shqiptarët duke qenë me shumicë myslimanë nga propaganda sllave dhe disa fuqi evropiane në sajë të fesë bënë që dyshimi ndaj përkatësisë së vlerave evropiane të

¹³ Po aty, f.451, Rizaj,Kosova...f.468

¹⁴ Burime te zgjeura per historinë e shqiperisë,Tiranë 1962, vell.II,Tiranë 1962, f.331

¹⁵ Shufly,M. Serbët dhe Shqiptarët,Tiranë,2002,f.160

shqiptarëve të jetë më i lehtë. Edhe pse nuk thuhet botërisht, vendimet e Fuqive të Mëdha në konferencat e shekulli XIX dhe fillimit të shekullit XX, nënkuptonin, në vetvete, aspektin mysliman përkatësisht turk të shqiptarëve duke ndikuar në defaktorizimin e tyre dhe krijimin e opinionit të moskompaktibilitetit të tyre me vlerat kulturore e politike evropiane. Në fakt, shqiptarët edhe pse u ndikuan nga islamizimi, ata nuk ndryshuan as nga pushtimi as nga konvertimi, dhe me këtë u duhej bërë e qartë të gjithëve. Lidhur me çështjen e islamizimit është me interes të përmendet fakti se ilirët si paraardhës të shqiptarëve ashtu si edhe dy civilizimet e tjera të Ballkanit, grekët dhe romakët u identifikuan të gjithë se bashku në aspektin fetar me politeizmin antropomorf. Ndërkaq më vonë me transformimin e një pjese të ilirëve në arbër këta të fundit apo shqiptarët e mesjetës u identifikuan me krishterimin pa mohuar këtu edhe ndarjen në katolicizëm dhe ortodoksi, ata ishin arbër dhe njëherësh të krishterë. Futja e islamit në mesin e tyre rrezikonte ndarjen jo vetëm në baza fetare, por edhe etnike. Emri *arbër* që ishte i përbashkët për të gjithë shqiptarët derisa ata ishin të krishterë tani me islamizim e humbte vlerën, sepse do të vlente vetëm për gjysmën, për ata që kishin mbetur të krishterë. Për t'i ikur kësaj ndarjeje së pari me emër e më vonë edhe me shumëçka tjetër nevojitej një emër i përbashkët i ri që do të ishte emëruar për të gjithë shqiptarët, si për ata të krishterë ashtu edhe për ata të islamizuar. Kemi të bëjmë me paraqitjen e emrit *shqiptar* që e zëvendësoi emrin *arbër* apo *arbëresh*. Ky emër, edhe pse i dëshmuar në burime historike më herët (del në qytetin e Drishtit si emër familjar Schibudar, Schebudar, Schabudar, Scopuder, 1368-1402)¹⁶, nuk është i njohur për shqiptarët që u shpërngulën në Greqi dhe Itali. Ata si të krishterë e ruajtën emrin *arbër*, *arbëresh*. Paraqitja e emrit *shqiptar* korrespondon me të njëjtën kohë me konvertimin, me islamizimin në masë të shqiptarëve. Derisa tani feja u bë e ndryshme, për shqiptarët e përbashkët mbeti gjuha. Prandaj edhe në aspektin kuptimor sipas interpretimit të albanologut G. Mayer fjala *shqiptar* shënon njeriun që e merr vesh gjuhën. Në rrethanat e reja të krijuara feja mund të impononte ndarje për *arbrin* e islamizuar dhe atë të krishterë, e përbashkët mbeti gjuha dhe u krijua emri *shqiptar* që shprehte këtë përbashkësi. Kësisoj për shqiptarët referenca e identitetit mbeti mbifetare, mbiregjionale, mbeti referenca e të qenit shqiptar, apo siç shprehet Ismail Kadare për shqiptarët fe ishin tri, ndërkaq atdheu një.¹⁷ Fetë u bënë të ndryshme por gjuha mbeti një duke i krijuar

¹⁶ Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, Tiranë 1962, vëll.II, Tiranë 1962

¹⁷ Kadar, I. Identiteti evropian i shqiptarëve, f.15

shqiptarët si komb me tri fe, por me një identitet çfarë jemi me të vërtetë edhe sot. Mund të themi se identiteti shqiptar e me këtë edhe islamizimi ishte një proces që lidhej me kushte ekonomike, sociale e politike specifike dhe vetëm të gjitha këto kuptohen së bashku atëherë e kuptojmë drejt edhe procesin e islamizimit. Duke i kuptuar drejt këto procese, kuptojmë edhe aspektin e tolerancës fetare te shqiptarët. Duke pranuar islamin në gjirin e gjysmës së familjes shqiptari mbeti tolerant ndaj gjysmës tjetër të krishterë. Lufta eventuale fetare ndërshtetërore nuk do të ishte vetëm luftë brendafetare, por edhe luftë brenda familjes, brenda vëllezërve që kishin mbetur të krishterë me ata që e kishin pranuar islamizimin. Shikuar nga aspekti historik Gjergj Kastrioti-Skënderbeu mund të merret si shembull apo modelues i tolerancës fetare te shqiptarët. Ai së bashku me babanë, Gjon Kastriotin, dërgonte dhurata nëpër manastire e kisha katolike njësoi sikur në ato ortodokse. Madje, Skënderbeu kishte kujdes dhe respektonte bindjet fetare të luftëtarëve që i kishte të dy religjioneve të krishtera. Nga ana tjetër, edhe në titullacionin e tij mbajti emrin islam Skënderbeu edhe pse pas islamizimit iu kthye sërish fesë së krishterë.

Edhe një burrë tjetër shqiptar me famë, Ali Pashë Tepelena, në luftë për jetë e vdekje me turqit i porosi rabinët hebrej, hoxhollarët muhamedanë, baballarët bektashinj dhe priftërinjtë ortodoksë të luteshin për shpëtimin e tij. Ky rast nuk mund të kuptohet si dobësi momentale e individit, por shprehje e tolerancës tradicionale shqiptare ndaj feve. Nëse për shqiptarët besa në të kaluarën ishte element i vlerave shoqërore morale shqiptare e njohur botërisht edhe toleranca fetare, te shqiptarët duhet të popullarizohet e të njihet edhe nga të tjerët si shenjë e një vlere që shqiptarët e kishin shumë herët e që tani e kërkon bota e civilizuar demokratike. Në aspektin shtetformues shteti shqiptar nuk mund të bëhej vetëm me të krishterë apo ndaras vetëm me myslimanë. Andaj programi i një Shqipërie evropiane dhe i identitetit shqiptar evropian, të krishterë dhe myslimanë është i pandashëm.

Procesi i islamizimit krijoi traditën osmane te shqiptarët, e cila u strehua pas fesë duke i krijuar themelet e lidhjeve shqiptaro-osmane që do vazhdojnë shekuj me radhë. Por tradita kulturore, gjuhësore dhe ajo e krishterë e mbetur ende prezente bënë që lidhjet me Evropën të mbeten shumë të forta te shqiptarët edhe pas islamizimit, duke i bërë ata të mbesin me fenë islame por me identitetin e fuqishëm evropian.

RESUME

CONVERSION AND RELIGIOUS TOLERANCE AMONG
ALBANIANS DURING THE RULE OF THE OTTOMAN EMPIRE

Albanians in their historical development processes accepted three religions, two Christian ones and the Islamic religion, but they preserved their ethnic identity without being greatly influenced by these divisions. Moreover, they strongly cultivated the feeling of inter-religious tolerance not only within the Albanian ethnic group but in a broader spectrum as well. Albanians or Arbers of the Middle Ages had been identified with Christianity since the apostolic times and had a long Christian tradition both in the construction of cult buildings and in other religious and cultural aspects related to Christianity. The examples mentioned in this paper in an argumentative and resourceful way prove this tradition. Meanwhile, the Islamization of the Albanians was a relatively long process that began individually in the 15 th century and ended massively at the end of the 17 th century. Being such, this phenomenon also has its own specifics in time and space.

Islamization in the first stages and particularly until the 18 th century did not have any significant impact on the Albanians. Things changed at the time of weakening of the Ottoman Empire, when Balkan nationalisms sponsored by Christian powers appeared on the scene. However, despite the acceptance of Islam alongside the existing Christianity among Albanians, the identity reference remained above the religious one, the reference of being Albanian remained above the regional one. The religions became different, but the language remained one, creating the Albanians as a nation with three religions but with one identity and with exemplary tolerance, what they really are even today.

Hasan Kaleshi

NDIKIMET TURKE NË LETËRSINË SHQIPE*

Përktheu nga turqishtja: MA. Blerim Halili

Të nderuara zonja dhe zotërinj!

Nga ne që jemi mbledhur këtu në sajë të Institucionit të Gjuhës Turke, i themeluar nga i pavdekshmi Ataturk, është e ditur se ndikimi turk në jetën kulturore dhe të komunitetit të popujve të Ballkanit është i madh, ku në periudhën osmane jeta kulturore nën udhëheqjen e shkollarëve nga popuj të ndryshëm e kryesisht shqiptarë e boshnjakë, ishte shumë e zhvilluar, ku shkollat, medresetë dhe bibliotekat ishin në një gjendje shumë aktive dhe në gjuhën turke, arabe e perse janë shkruar e botuar vepra shkencore dhe letrare mbi tema të ndryshme.

Sidoqoftë, sipas mendimit tonë, në Ballkan nuk i është dhënë rëndësia e duhur ndikimit të ndërsjellë në këtë çështje,- nga njëra anë dhe ndikimit kulturor turk, e përmes tij edhe atij arab e pers, nga ana tjetër.

Në këtë drejtim këtu do të përpiqemi ta definojmë në përgjithësi çështjen e ndikimeve turke në letërsinë shqipe, që është një nga temat që kemi vënë në pah më lart.

Përgjatë tërë shekujve që përfshijnë periudhën që nga kontakti i parë turko-shqiptar që ndodhi në vitin 1381 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e një), përkatësisht që nga arritja e Timurtash Pashës në Nard e deri në vitin 1912 (një mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë) shihet se pati një lidhje të fortë ndërmjet fatit të turqve dhe atij të shqiptarëve.

Vihet re se që nga gjysma e parë e shekullit të pesëmbëdhjetë feja islame filloi të përhapet te shqiptarët, dhe bashkë me këtë shqiptarët merrnin pjesë aktivisht në administratën turke. Shumë shqiptarë kishin marrë detyrën e vezirit të madh, duke filluar nga çliruesi** i Shqipërisë Jugore dhe Bejlerbeu i Rumelisë, Gedik Ahmet pashë Vlora, veziri i madh Ajaz Pasha, Lutfi Pasha, Koxha Sinan Pasha dhe Qypërlinjte e deri në vitin 1905 kur Ferid pashë Vlora merr detyrën e Vezirit të madh,

pa numëruar shumë zyrtarë të rangut të lartë.¹ Një situatë e ngjashme mund të shihet edhe në fushën e shkencës dhe letërsisë. Janë të shumtë shqiptarët që kanë dhënë kontribut në letërsinë turke, duke filluar nga poeti i parë i famshëm i periudhës së Kanunit që krenohej me prejardhjen e tij nga Bejlerët e Dukagjinit, Jahja Bej², shkollari i madh i emërtuar si “Montesquieu turk”, Koçi Bej, poeti lirik prishtinas, Mesihi, shkollari Hoxhë Tahsini, një nga gjuhëtarët më të mëdhenj turq, Sami Frashëri, e deri te poeti i madh Mehmet Akif Ersoj. Duke hulumtuar këtë temë, identifikuam se në kohën e Perandorisë Osmane vetëm nga Prizreni janë trembëdhjetë shkrimtarë që kanë shkruar vepra në gjuhën turke dhe atë arabe.³ Me shumë gjasë mund të hasen edhe të tjerë që ne nuk i dimë. Evlija Çelebiu kishte regjistruar se në Gjirokastër kishte shumë poetë, ndërsa qyteti i Elbasanit ishte djep i shumë poetëve, shkollarëve e mjeshtërve.⁴ Prizreni, Manastiri dhe Shkodra po ashtu numëroheshin si fole të poetëve.

Fakti se shqiptarët për më tepër se katër shekuj gjendeshin nën sundimin e osmanëve, që gëzonin një organizim të fuqishëm politik e fetar, tregon se ata, në të gjitha fushat e jetës e veçanërisht në gjithë jetën kulturore, iu ekspozuan ndikimit turk. Tema e kumtesës sonë, që është ndikimet turke në letërsinë shqipe, mund të trajtohet në tri grupe:

1. Ndikimet turke në letërsinë shqipe të shkruar me shkronja arabe;
2. Ndikimet që hasen fuqishëm edhe sot e kësaj dite në letërsinë popullore në trajtë të poezisë dhe prozës;
3. Ndikimet në letërsinë artistike që nuk hasen diku tjetër vetëm në fjalorë dhe në disa motive.

Është e ditur në ardhjen e parë të turqve, shqiptarët gjendeshin në dy fronte fetare, pra ishin katolikë dhe ortodoksë në kuadër të fesë së krishterë dhe se më pas në mesin e tyre filloi të përhapet feja islame. Veprat e para letrare të shqiptarët bartin një karakter kryekëput fetar. Këto ishin shkruar me shkronja latine të katolikët, ndërsa me alfabetin grek tek ortodoksët. Dhe veprat letrare islame shqiptare që u zhvilluan më pas ishin shkruar me shkronja arabe. Kjo që si rezultat i zhvillimit

¹ Shih: E. J. W. Gibb. *History of Ottoman Poetry*, volume III, London, 1904.

² Vetëm në shekullin e kaluar në letërsinë turke përmenden 15 poetë me prejardhje shqiptare. Shih: İbnülemin Mahmud Kemal İnal: *Son asır Türk Şairleri* Fasikül I – XII.

³ Shih: Hasan Kaleşi, *Prizren kao kulturni centar za vreme Turskog perioda*. Recharches Albanologiques Nr. 1, Prishtinë 1961.

⁴ *Siyataname*, VIII, 680.

të shpejtë të fesë islame, dhe kjo ua kishte mundësuar studentëve që mësonin nëpër këto vatra të shumta kulturore ta njihnin edhe kulturën turke, arabe e perse. Kështu doli në pah një shtresë intelektualësh që njihnte gjuhën dhe kulturën e lindjes. Një pjesë e këtyre që kishin mbetur nën ndikimin e burimeve letrare lindore filluan të shkruanin vepra në gjuhën e tyre amtare. Menjëherë këtu duhet të theksojmë se kjo letërsi haset në të gjitha zonat ku jetojnë shqiptarët myslimanë, - madje në Kosovë – Metohi dhe Maqedoni. Kjo letërsi që u emërua si *Alhamiada* ia mundësoi letërsisë shqipe ta zgjerojë fushën e botëkuptimit dhe duke dalë nga mjediset fetare me botëkuptime të ngushta e pasuroi atë më forma dhe shprehje të reja. Fatkeqësisht kjo lëvizje letrare ka filluar të studiohet vetëm kohëve të fundit.⁵

Kjo letërsi shqipe *Alhamiada* është e dyanshme:

1. Letërsi laike që tek shqiptarët është letërsia e parë laike;
2. Letërsi fetare dhe morale.

Poezia e njërit nga poetët e njohur me emrin Muçizade dihet si vepra më e vjetër. E shkruar në vitin 1724 tema e kësaj poezie është mbi kafënë. Edhe pse sipas mendimit tonë, është e mundur të haset ndonjë vepër e shkruar para kësaj, megjithatë një gjë e tillë nuk është zbuluar ende deri më sot. Kjo poezi e thurur në shtatëmbëdhjetë strofa, në çdo strofë ka vargje të rimuara sipas stilit AAAB. Vargu i secilës strofë përsëritet njëjtë. Kjo është një metodë e ditur në letërsinë turke dhe perse. Mirëpo përfaqësuesi më i famshëm i këtij stili të poezisë është Ibrahim Nezim, i njohur si Nezim Berati, i cili ka vdekur në vitin 1760. Ai përveç divanit shqip, ka shkruar edhe dy divane turqisht. Teksa veten e quan si Sadi dhe Hafiz, ai vë në dukje se poezitë që ka shkruar në shqip, janë të të njëjtit nivel me poezitë e Nefiut të letërsisë turke. Ndërsa divani shqip përbëhet nga kaside dhe gazele dhe është shkruar në gjuhën popullore shqipe, por janë përvetësuar (huazuar) fjalë edhe nga turqishtja, arabishtja e persishtja. Ky divan, përveç disa përshkrimeve realiste të natyrës që i përkasin vendit të lindjes së poetit dhe shqipes së përdorur, nuk shquhet për ndonjë veçori tjetër specifike të komunitetit: motivet, botëkuptimi, metrika, ndërtimi i poezisë është krejtësisht turk dhe, për më saktë, ai bart theks lindor. Në këtë drejtim është e pamundur ta ndash atë nga poetët turq të divanit. Madje edhe pjesa hyrëse e divanit shqip është e shkruar në persisht. Për të ilustruar

⁵ Për më shumë të dhëna lidhur me këtë letërsi, shih: O. Myderizi, *Letërsija shqipe me alfabetin arab*, Buletin Shk. Shoq. Tirane 1955 Nr. 2; Hasan Kaleshi, *Prilog poznavanju arbanaske književnosti iz vremena preoporoda*, Godišnjak Balkanološkog instituta, knj. 1 Sarajevo 1957, f. 352 – 388.

këtë ndikim turk po japim dy strofa të Nezimit dhe përkthimet e tyre në turqisht:

Shqip:

Une ashik ti je dildar

Une bylbyl ti je gjylzar

Une çemen ti je behar

Ti m'je boj une sham.

Ti je Lejla une Mexhnun

Ti je tabib une zabun

Ti je kimja une altun

Une dava ti je nizam.

Turqisht:

Ben âşıkım sen dildar

Ben bülbülüm sen gülzar

Ben çemenim se bahar

Sen boy çiçeğisin ben şam (koklayan).

Sen Leylâsın ben Mecnun

Sen Tabipsin ben zebun

Sen kimyasın ben altun

Ben dâvayım sen nizam.

Edhe ata që nuk dinë shqip, madje me një vështrim, mund ta shohin se shumica e fjalëve që janë përdorur në këtë divan përbëhen nga fjalët turke, arabe e perse të përdorura në letërsinë turke të divanit.⁶

Nuk e shohim të nevojshme të përmendim strofat e rëndësishme që janë përdorur nga Nezimi apo nga poetët e tjerë. Le të ndalemi te vepra e Muhamed Kyçykt, të njohur si Muhamed Çami, që ka vdekur në vitin 1844. Ky poet ka përkthyer nga arabishtja në gjuhën shqipe “Kasidetu’l-Burda”-në dhe ka shkruar pesë vepra epike. Këto vepra

⁶ Për më shumë të dhëna lidhur me Nezim Beratin, shih: Johann Gerog Hahn, *Albanesische Studien, II* (1854); Camarda, *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Pratto 1866; Ettore Rossi, *Notizia su un masnscritto del Canzoniere di Nezim (secolo XVII-XVIII) in caratteri arabi e lingua albanese*, *Revista degli Studi orientali*, Roma 1946, f. 219-246; Osman Myderizi, *Nezim Frakulli*, *Buletin Shk. Shoq. Nr. 4*, Tirane 1954.

epike janë: “Erveheja”, “Jusufi dhe Zylehaja”, “Çlirimi i Misolongut”, “Gurbetlitë” dhe “Bekriu” dhe kanë karakter moral. Ervehaja dhe Jusufi e Zylehaja janë prej tregimeve të para poetike laike të letërsisë shqipe. Temën e veprës “Erveheja” që përbëhet nga tetëqind e pesëdhjetë e tetë (858) vargje, autori vë në dukje ta këtë marrë nga një libër në gjuhën turke me titull “Revza” (*Kopshti*). Origjinali në turqisht është në formë të prozës. Mirëpo Jusufi dhe Zelihaja ka dymijë e katërqind e tridhjetë (2430) vargje. Është e vështirë të verifikohet se nga cila vepër ka marrë modelin për këtë epikë, sepse ka shumë vepra të shkruara në turqisht e persisht për këtë temë.

Në fillim të shekullit XIX në teqetë bektashiane u shfaq një formë letrare që bartte të njëjtin emër dhe trajtoheshin tema nga historia islame, përkatësisht filluan të shkruheshin vepra mbi jetën e Imam Hasanit dhe Hysenit. Ndër to më të njohurat janë vepra epike e Dalip Frashërit me emrin “Hadika” (*Kopshti i të mirëvet*) dhe ajo e vëllait të tij Shahin Frashërit që quhej ‘Muhtarname’ (*Myhtarnameja*). Vepra epike “Kopshti i të mirëvet” (*Kopshti i të mirëve*) përmban gjashtëdhjetë e pesë mijë (65 000) vargje dhe është shkruar duke u bazuar në “Hadikatü’s-süeda” të Fuzulit. Tema kryesore e veprës është tragjedia e Qerbelasë. Ndërsa motivi i Myhtarnamesë është pothuajse i njëjtë. Veçse me një dallim të atillë që heroi kryesor bart emrin e njërit prej heronjve të ngjarjes së Qerbelasë, Muhtarit. Veçanërisht është shumë interesant divani i Sheh Maliqit nga qyteti i Rahovecit të Kosovës. Teksa ky divan bart shpirtin letrar, formën poetike të fillimshkullit tonë, ai u përngjan veprave të Junus Emresë dhe të poetëve të tjerë të sufizmit (*tasavvuf*) turk.⁷

Ajo që është në interes më të madh për ne në letërsinë shqipe të shkruar me shkronja arabe, janë fjalorët turqisht-shqip të shkruar në vargje. Fjalori i parë i këtij lloji është shkruar nga një autor anonim shkodran në vitin njëmijë e tetëqind e tridhjetë e pesë (1835).⁸ Ndërsa tjetri është fjalori i shkruar nga Hafiz Ali Ulqinaku në fund të shekullit të kaluar.

Është i ditur fakti se kësi lloj fjalorësh janë shkruar nga turqishtja dhe persishtja në arabisht dhe nga këto gjuhë në turqisht. Ky lloj i fjalorëve haset edhe te boshnjakët. Madje Evlija Çelebiu duke folur rreth qytetit të Sarajevës në veprën e tij kishte shënuar edhe emrin e një

⁷ Për më shumë, shih: Hasan Kaleši, op. cit.

⁸ Bk. Ettore Rossi, Un inedito lessico rimato turco-albanese composto a Scutari nel 1835. Revista degli Studi Orientali, XXVI (1951), f. 114-123.

fjalori të tillë. Sipas mendimit tonë të gjithë këta fjalorë në vargje përbëjnë modelin e fjalorit të Shahidit. Edhe këta dy fjalorë turqisht-shqip janë shkruar në të njëjtën formë. I pari është në metrikën remel. Ky fjalor fillon kështu:

Tanrı-ya *Zot*, var dolu *plot ka*, bugün *sot*, ty sana
Göz yaşı *lot*, bihude *kot*, oynuyor *lot*, düştü *ra*.

Në letërsinë shqipe *Alhamiado* një vend të rëndësishëm zënë mevludet. Mevludi i parë në shqip që dihet deri më sot, është mevludi i shkruar nga Hasan Zyko Kamberi që kishte jetuar në gjysmën e dytë të shekullit tetëmbëdhjetë. Përveç mevludit, ky autor ka shkruar edhe poezinë me titull “Sefer-i hümayun” (*Lufta mbretërore*). Këtu përshkruhet lufta turko-austriake që ndodhi në vitin 1789 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) në Smederevë.⁹ Ekzistojnë edhe dy mevlude, njëri i shkruar nga korçari Ismail Floqi dhe tjetri nga Abdullah Konispoli. Mirëpo janë shumë interesante edhe dy mevludë të tjerë të shkruar me shkronja arabe, të shtypur në Stamboll. I pari nga është ai i shkruar nga Hafiz Ali Ulqinaku që njihet me emrin “Tergüme-i mevlud ala lisan-i arnavud” dhe është shtypur në Stamboll në vitin 1878 (një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë). Ky mevlud është përshtatje e mevludit të Sylejman Çelebiut. Ndërsa i dyti është ai i shkruar nga vushtriasi Tahir Popova dhe ka titullin “Menzumetu’l-mevlud fi efdali’l-mevcud bilisani -l arnavud”. Ky mevlud është përkthim i mevludit të Sylejman Çelebiut. Të dy janë shkruar në stilin e Mesneviut dhe në metrikën remel, si dhe janë shkruar pikërisht si mevludi i Sylejman Çelebiut.¹⁰ Me qëllim të përcaktimit se sa ishin të suksesshëm autorët në përdorimin e metrikës, më poshtë po japim si ilustrim nga dy vargje origjinale në turqisht dhe përkthimin e tyre në shqip:

Turqisht:

Allah adın zikredelim evvela

Vacib oldur cümle işte her kula.

Shqip:

Allah emnin a purmendim daima

Me nis punen me to xhith kush borxh e ka.

⁹ Për të dhëna më të gjera mbi Hasan Zyko Kamberin shih: O. Myderizi, *Hasan Zyko Kamberi*, Buletini Shk. Shoq. Nr. 1 Tirane 1955.

¹⁰ Për më shumë të dhëna shih: Hasan Kaleši, *Mevludi kod Arbanasa*, Zbornik Filozofskog fakulteta, knjiga IV-2, Beograd 1950.

Përkthimi i Hafiz Ali Ulqinakut, i përmendur më sipër, “Huda rabbim” është realizuar në të njëjtën formë.

Duhet të përmendim njërën nga figurat e rëndësishme të kësaj letërsie, tetovarin Rexhep Xhudi Voka i cili në vitin 1908 ishte myfti i Manastirit. Ai kishte shkruar disa vepra shqip me shkronja arabe. Tri nga ato, “Mendime”, “Elifbaja shqip” dhe “Arnavutça mufassal ilmi-hal” na kanë rënë në dorë. Hasen edhe artikuj turqisht që ky autor ka shkruar në revistën e njohur të kohës “Beyanü’l-hakk”. Voka, me të parë se gjuha arabe nuk përshtatej tërësisht me sistemin shkronjor shqip të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, duke u shtuar atyre shenja (simbole) të veçanta, kishte ndryshuar edhe disa shkronja arabe. Kështu ai kishte krijuar një lloj të ri alfabeti shqip të bazuar në alfabetin arab dhe atë e kishte botuar. Në këtë alfabet të ri gjenden shenjat (simbolet): c, ë, gj, ll, nj, o, rr, y, x. Edhe pse ishte i përshtatshëm për gjuhën shqipe, ky alfabet i Vokës nuk kishte gjetur hapësirë për t’u aplikuar, sepse në vitin 1908, pra dy vjetësh para kësaj prurjeje (shpikjeje), intelektualët shqiptarë në Kongresin e Manastirit kishin pranuar alfabetin latin.¹¹

Është veçanërisht interesant të hulumtohet ndikimi turk në letërsinë popullore. Këtë ta fillojmë nga poezia popullore. Së pari le t’i shqyrtojmë poezitë që trajtojnë tema historike në lidhje me disa persona dhe ngjarje. Motivi më i vjetër i kënduar në poezinë popullore shqipe përkon me “Betejën e Kosovës” apo sulltan Muratin. Në këtë poezi janë idealizuar sulltan Murati dhe turqit. Kjo poezi fillon me nga një ëndërr, njëra e keqe e Car Lazarit, ndërsa tjetra e mirë e sulltan Muratit. Sipas kësaj poezie, pasi Sulltani bëri bismilah dhe fali dy rekate namaz, deti i Stambollit u hap dhe ai kaloi në anën tjetër. Së pari merr Selanikun pa luftë dhe aty vendos një administratë (qeverisje) të drejtë. Poeti popullor shqiptar, me qëllim për të theksuar drejtësinë e administratës turke, poezinë e vazhdon në këtë mënyrë:

Kur sulltan Murati kishte ardhur në Ferizaj kishte luftuar tri orë, mirëpo nuk kishte mundur të lëvizë as tre hapa përpara. Sërish kishte luftuar tri ditë dhe prapë nuk kishte mundur të ecë as tre hapa. Me këtë rast ai iu kishte drejtuar ushtarëve dhe i kishte pyetur se cili nga ta kishte zgjatur dorën në haram (kishte bërë gjëra të ndaluara). Një ushtar i ri, duke dalë para Padishahut rrëfen se në njërin nga kopshtet në Shkup, kishte marrë një mollë dhe një qepë. Sulltani menjëherë kishte urdhëruar që pronarit të kopshtit t’i jepet një sasi e madhe ari, mirëpo

¹¹ Për më shumë të dhëna lidhur me Rexhep Xhudin shih: Hasan Kaleši, *Arbanaska knjizevnost na arapdkom alfabetu*.

kopshtari kishte refuzuar të pranojë këtë shumë (dëmshpërblimin) dhe kishte kërkuar nga Sulltani që atë ta emëronte si vezir të madh, ndërsa vajzën e tij të verbër ta merrte ushtari që kishte vjedhur mollën dhe qepën në kopshtin e tij. Sulltani kishte njoftuar se do të jepte pëlqimin e tij për këtë, por me kushtin që kopshtari dhe vajza të merrnin abdes dhe të shqiptonin shehadetin. Pasi kishin çuar në vend urdhrin e Sulltanit, vajzës së kopshtarit i ishte shtuar një bukuri engjëlllore dhe për një çast të dy sytë e saj kishin arritur ta shohin dritën. Ndërsa kopshtari ishte caktuar si vezir kryesor i Sulltanit. Atëbotë Sulltani kishte filluar të çlironte toka pa u ballafaquar fare me asnjë vështirësi. Sipas kësaj poezie shqipe, në fund të luftës sulltan Murati kishte rënë dëshmor (shehid). Poezitë popullore me tema historike pas kësaj, në të cilat i thurej lavde Skënderbeut, si hero kombëtar, i ishin kushtuar luftës së tij kundër turqve.

Ekziston një grup i veçantë poezish që kanë si temë luftërat e turqve kundër austriakëve, venedikasve dhe tokave të tjera, në të cilat morën pjesë edhe shqiptarët. Kështu mund të hasen poezi që trajtojnë çlirimin e Budas (Budinit) dhe luftën turko-venedikase ndërmjet viteve 1716-1718 si dhe luftëra të tjera. Nga këto poezi mund të identifikohet marrëdhënia ndërmjet Perandorisë Osmane dhe shqiptarëve. Për shembull, në njërën prej këtyre poezive, njëri me emrin Mehmet Bej, të cilin veziri kishte dashur ta vrasë, thotë kështu:

Ç'ka veziri qi m'vret mue?

Ke m'ka çue e kam nnigüe

Nner në More i kam shkue

E me Grekët unë kam luftue

Dy tri herë un jam plague

Me heqima jam mjekue

E ylyfen s'm'a ka pague.¹²

Një grup të veçantë të poezive popullore me tematikë historike përbëjnë ato që flasin për Ali Pashë Tepelenën dhe Bushatlinjtë. Edhe poezitë për periudhën e Tanzimatit mund t'i përmbledhim në këtë grup. Në këto poezi mund të pasqyrohet qartë qëndrimi i shqiptarëve ndaj Tanzimatit, aplikimit të reformave, centralizmit, mbledhjes së ushtarëve të rregullt dhe sistemit të pagesës së taksave. Në këto poezi përcillen në mënyrë të detajuar të gjitha këto ngjarje dhe posaçërisht

¹² P. Vinçenc Prennushi, *Kangë popullore gegnishte*. Sarajevo 1911, f. 16.

ngjarjet ndërmjet vitit 1830 dhe 1845.¹³ Për shembull, në njërën nga këto poezi mund të hasen këto të dhëna për një ngjarje:

Kurvelesha krye të ngrini

Gra e burra armë vini

Nizam Turqis mos ipni!

Nga poezitë e Shkodrës mund të hasen edhe këto të dhëna:

Une haraçin nuk e jap

Sa te bahem vaj e gjak.¹⁴

Grupin e fundit dhe më të madhin të poezive popullore përbëjnë temat mbi ngjarjet që zënë vend në Lidhjen e Prizrenit dhe në lidhje me këtë shihet se në një pasazh janë përmendur emrat e personave si: Shemsi Pasha, Hafiz Pasha, Maxhar Ali Pasha, Ali pashë Gucia, Der-vish Pasha, Vesel Pasha dhe të tjerë.

Kur vijmë te poezia popullore lirike, shohim se këtu mund të flasim për ndikimin e drejtpërdrejtë turk, posaçërisht kjo mund të haset më shumë në poezinë lirike qytetare. Poezia lirike qytetare shqipe është shfaqur nën ndikimin oriental turk, dhe ky stil i poezisë është quajtur “Kangët e ashikëve” (*Aşık şîirleri*). Në disa poezi është përshkruar në një mënyrë ideale bukuria e femrës e në disa të tjera ajo e mashkullit. Vargjet e këtyre poezive janë quajtur bejte (beyit), ndërsa poetëve u thuhet bejtexhinj (beyitçi). Nga këta bejtexhinj kanë dalë rapsodë profesionalë, dhe këto poezi i lexonin në kafene e dasma. Këtyre poetëve në Shkodër u thoshin ahengxhi. Më poshtë po japim disa mostra nga ky lloj i poezisë:

Origjinali:

Ashik tu bana n’nurin tand

Nuri yt s po m’len rahat.

Ndërsa në një tjetër strofë thuhet kështu:

Origjinali:

Asaman moj sy filxhane

Dije hallin fukaras

¹³ Për më shumë të dhëna shih: Qemal Haxhihasani, *Kryengritja e 1847-tës më poezin tonë popullore*. Nendori Nr. 9, Tirane 1954; Disa ngjarje të viteve 1830-1845 dhe ushtrimi e tyre në folklor, Nendori, Nr. 9, Tirane 1955.

¹⁴ Ibidem.

Kena ndodhë dynja jallane

Çajre s'i gjindet sevdas.¹⁵

Në një tjetër strofë:

Origjinali:

Ëptida due me fillue

Aman se m'ka xanë i ziu marak

Në m'a daç moj hatrin mue

Oh! Tjetër kend mos kqyr aspak.¹⁶

Në poezitë e shkruara më sipër, përveç shumë motiveve e fjalëve orientale ndihet edhe shpirti i orientales. Kur këto poezi këndohen në formë të këngës popullore shoqërohen edhe me saze. Në praninë e tyre ndihet qartë rendi dhe melodia lindore.

Kështu ekzistojnë shumë poezi lirike të shkruara kundër sistemit të ushtrisë së rregullt. Në këto poezi këndohet lamtumira dhe malli e mërzia e shkaktuar nga shkuarja në shërbimin ushtarak që zgjaste disa vjet.

Me këtë rast duhen përmendur edhe ilahitë (poezi/këngë me motive fetare) në numër shumë të madh. Këto janë shkruar në shqip nga shehlerët e më pas janë shpërndarë në popull.

Në poezitë popullore të kënduara nga gratë, këto ndikime lindore janë më të pakta, sepse gruaja atëbotë kishte mbetur shumë më larg nga jeta e komunitetit (bashkësisë). Në epikën e famshme të trimërisë "Muja dhe Halili" sado që motivi kryesor përbën ngjarjen e luftës së komandantëve turq, pra myslimanë kundër mbretërve të krishterë, megjithatë këtu ndikimi turk është relativisht i paktë.

Ndikimi lindor-turk në letërsinë popullore të formës prozaike, pra në tregime, proverba, anekdota, vjersha e të ngjashme është në të njëjtin nivel të lartë.

Në një pjesë prej tyre tema e trajtuar janë kadinjtë dhe për ta flitet në mënyrë kritike. Ndërsa në një pjesë të anekdotave përshkruhet se si janë mashtruar kadinjtë, si puna e Nastradin Hoxhës.

¹⁵ Ernesto Koliqi, *Influenze orientali sulla letteratura albanese*. Oriente Moderno, Nr. 1 gennaio 1954, f. 31.

¹⁶ Pjetër Dungu, *Lyra shqiptare*, Kange popullore të mbledhuna nën kujdesin e Radio Tiranës.

Një grup tjetër shumë i rëndësishëm e vë Nastradin Hoxhën në rolin e heroit kryesor. Ky filozof popullor dhe satirik është personaliteti më i njohur i letërsisë popullore shqipe. Pak më parë në Prishtinë është botuar një libër me tregime dhe anekdota popullore nga një zonë shumë e largët e Kosovës, Drenica.¹⁷ Këtu gjenden njëzet e një anekdota të Nastradin Hoxhës. Një element që tërhoqi vëmendjen tonë në këtë libër është se disa nga këto anekdota nuk i përngjajnë asnjërës nga anekdotat e Nastradin Hoxhës të botuara deri më sot. E nga ana tjetër disa anekdota që i përkasin Nastradin Hoxhës i janë atribuuar dikujt tjetër në mesin e shqiptarëve. Nga ana tjetër ani pse tema e një anekdote me titull “Një provë” në librin “Anekdota të zgjedhura nga Nastradin Hoxha”¹⁸ të Mahmut Yurterit është e njëjtë me temën e anekdotës me titull “Mullixhiu dhe mbreti” në librin e përmendur më sipër të anekdotave shqipe, Nastradin Hoxha nuk përmendet fare.

Në një grup tjetër të tregimeve flitet për pashallarët dhe vezirët. Ja titujt e disa tregimeve nga ky libër: “Fëmija që kishte parë ëndërr se u bë pasha”, “Vajza e zgjuar dhe tre vezirë”, “Pashai ujk”, “Pashai luan dhe gjakovari Kamber Kuka”, “Mund të bëhesh pasha, por s’mund të bëhesh burrë”, “Sulltani që kishte ndërruar rrobat me Sinan Çobanin” e që ky është tregim për Koxha Sinan Pashën.

Edhe tregimet me karakter fetar mund të shqyrtohen në një grup të veçantë. Në mesin e popullit tregimeve të shkurtra u thuhet *mes’ele*, ndërsa atyre të gjata hikaje.

Mendoj se shumë proverba shqiptare janë bartur drejtpërdrejt nga turqishtja në letërsinë popullore shqipe. Më poshtë le të shohim si shembull disa nga këta proverba me ndikim:

1. Dağ dağa kavuşmaz, insan insana kavuşur
Mali me malin s’piqet, njeriu me njeriun piqet.
2. İki karpuz bir koltuğa sığmaz
Dy sharqij nuk bahen nin një sjetull.
3. İyilik et de denize at
Balık bilmezse Halik bilir.
Bane një të mirë e qite në det
Po s’e diji peshku do ta dijë zoti vetë.
4. Araba kırılınca yol gösteren çok olur
Kur thehet kerri udhë gjen boll.

¹⁷ Anton Çetta, Tregime popullore I, Drenicë, Prishtinë, 1963.

¹⁸ Mahmut Yürter, Nasrettin Hoca’dan seçme fıkralar, Varol Matbaası, İstanbul, 1958, f. 66-67.

5. Balık baştan kokar
Peshku qelbet prej kres.

Disa proverba kanë kaluar në popull drejtpërdrejt nga turqishtja dhe domethënia e tyre dihet nga të gjithë. Për shembull:

Eski tas – eski hamam.

Sabr-ı selamet

Sanaat – kanaat

Hane Şam – hane Bagdad

Selam verdim – bela buldum.

Në fund duhet të flasim për ndikimin turko-lindor në letërsinë artistike shqipe. Meqenëse këtu nuk kemi mundësi të hyjmë në detaje, dua të flas shkurtimisht në lidhje me veprat e letrarit të madh shqiptar, vëllait të dijetarit të madh Sami Frashëri (Şemsediin Sami), themeluesit të letërsisë artistike shqipe dhe figurës më të madhe të Rilindjes shqiptare, Naim Frashërit.

Naim Frashëri i përkiste tarikatit bektashi, madje ai shkroi një libër të vogël për këtë. Përveç kësaj, në një vepër poetike me titull “Qerbelaja” ai trajton si temë ngjarjet e Qerbelasë. Kjo vepër është shkruar duke u frymëzuar nga “Hadikatü’s-süeda” (*Kopshti i të mirëve*) e Fuzuliut. Nga ky letrar deri te ne, ka ardhur edhe libri lirik poetik “Lulet e verës”. Në të vërtetë, të gjitha këto janë poezi sufiste (tasavvufi) lirike. Një poezi të quajtur fyelli e fillon kështu:

Origjinali:

Pa dëgjo fyellin ç’thotë

Tregon mërgimet e shkreta

Qahet nga e zeza botë

Me fjalë të vërteta

Që kur se më kanë ndarë

Nga shokë e nga miqësia

Gra e burra kanë qarë

Nga ngashërimet e mia.

Kraharor e kam shpuar

E kam bërë vrima-vrima

Dhe kam qarë e kam rënkuar

Me mijëra psherëtime.¹⁹

¹⁹ Naim Frashëri, “Lulet e verës”, botim i katërt, Tiranë 1993, f. 29.

Këto vargje të Naimit ngjasojnë me vargjet hyrëse të mesnevisë së Mevlanës. Le ta përcjellim (vështrojmë) këtë në përkthimi në turqisht i Mevlanës nga Asaf Halit Çelebiu:

“Dëgjo fyellin ç’tregon dhe si ndarjen qan:

“Prej se më ndanë nga kallami, burra e gra lotojnë nga rënkimet e mia”.

Dua një zemër të thyer për ta rrëfyer dertin e mallin tim”.

I mbetur larg nga rrënja e vet, ai kërkon sërish kohën e bashkimit. “Kam qarë në çdo shoqëri, u bëra mik me ata që janë mirë dhe me ata që janë në derte”.

Teksa lexon këto poezi të Naimit, të zgjohet përshtypja sikur je duke lexuar veprat sufiste të Muhjiddin Arabiut apo të Rumit. Këto vargje të tij përbëjnë një shembull të mirë të kësaj. Për shembull, poezinë me titull “Perëndia” e fillon në këtë mënyrë:

Ç’sheh është Zot’i vërtetë

C’degjon është zer i tia

Se ç’ka e s’ka në jetë

Eshtë vetë Perëndia.²⁰

Nuk duhet të ketë fare dyshim se një analizë në mënyrë të zgjeruar e poezive të Naim Frashërit neve do të na ndriçonte shumë çështje. Por kjo mund të shqyrtohet në ndonjë rast tjetër.

Sado që pas Naimit ndikimi lindor në letërsinë artistike shqipe të jetë dobësuar, prapëseprapë aty-këtu hasim disa motive. Në këtë kumesë të shkurtër qëllimisht nuk u ndalëm në analizën e fjalëve turke, arabe e perse në letërsinë popullore dhe artistike shqipe. Veçse deshirojmë të kujtojmë se nuk ka fare dyshim se, sado që këto fjalë në letërsinë artistike kanë humbur, prapëseprapë në letërsinë popullore dhe në gjuhën popullore kanë ruajtur praninë e tyre edhe sot e kësaj dite. Madje sipas mendimit të disave këto fjalë përbëjnë një të pestën e fjalëve të fjalorit të të folurit të përditshëm.²¹ Sipas meje ky përfundim është i ekzagjeruar.

Si përfundim është e mundshme të nxirren këto konkluzione:

Jemi dëshmitarë të zhvillimit të lidhjes së fuqishme kulturore turko-shqiptare përgjatë disa shekujve.

²⁰ Ibid, f. 53.

²¹ Bk. Ettore Rossi, *Saggio sul domino turco e l'introfuzione dell' islam in Albania*, Albania, Anno III, Fascicolo IV, Dicembre 1942, f. 14.

Tërë letërsia shqipe *Alhamiado* është zhvilluar nën ndikimet turke, arabe e perse.

Tërë poezia lirike qytetare, përkatësisht poezia erotike, është zhvilluar nën ndikimin turko-lindor.

Ndikimi turk haset më shumë në qytete, më pak në fshatra; më shumë në poezitë popullore të burrave, më pak në poezinë e grave.

Në anekdotat shqiptare personaliteti më i rëndësishëm është Nastradin Hoxha. Madje shqiptarët atë e numërojnë si të vetin.

Shumë motive të tregimeve popullore shqiptare kanë burime lindore.

Teksa ndikimi turk-lindor në letërsinë artistike është i fuqishëm, kohëve të fundit pothuajse ka humbur.

Krejt në fund mund të thuhet se studimi i kësaj mërrëdhënieje kulturore është ende në fazën fillestare.

* *Burimi: X. Türk dil kurultayında okunan bilimsel bildiriler 1963 (Türk Dil Kurumu yayınlarından – Sayı: 233), Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara 1964, s. 61-74. [Kumtesat shkencore të lexuara në Kongresin e X të gjuhës turke 1963 (Nga botimet e Institutit të Gjuhës Turke – Numër 233), Shtypshkronja e Institutit Turk të Historisë, Ankara, 1964, f. 61-74].*

** Termi *fetih* në fjalorin turk ka domethënien e marrjes së një qyteti apo vendi nëpërmjet luftës. Por përtej leximit teknik, në kontekstin e ngjarjeve të cilat i përmend teksti, ky term nuk mund të shihet i ndarë nga karakteri fetar islam, sipas të cilit është definuar lufta dhe zgjerimi territorial në shtetin osman. Prandaj termi *fetih* bart edhe një kualifikim tjetër kuptimor, atë të çlirimit, hapjes, etj. Rëndom nga këndvështrimi osman-turk përdoret si *çlirim/çlirues* (apo e kundërta e *işgal/işgal etmek*- pushtim/të pushtosh – B.H.).

Rexhep Gashi, Prishtinë

TRAFIKIMI I FËMIJËVE: ASPEKTE JURIDIKO-PENALE, KRIMINOLOGJIKE DHE VIKTIMOLOGJIKE

Abstrakt

Trafikimi i fëmijëve është një ndër format e rrezikshme të krimit të organizuar me pasoja të shumta, afatgjate dhe mjaft të rënda për viktimat fëmijë dhe shoqërinë në tërësi. Kjo dukuri kriminale është mjaft e përhapur në vendet e shoqërisë bashkëkohore dhe është shkelje e rëndë dhe sistematike e shumë të drejtave dhe lirive të fëmijëve të trafikuar, të cilat janë të garantuara me instrumentet e njohura ndërkombëtare dhe me ligjet e shteteve nacionale. Po ashtu ajo konsiderohet edhe një ndër format mjaft fitimprurëse për organizatat kriminale.

Në këtë punim paraqiten dhe analizohen disa aspekte juridiko-penale, kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të fëmijëve siç janë: kuptimi dhe karakteristikat themelore të trafikimit të fëmijëve, prania e kësaj dukurie në përmasa globale dhe rajonale, format e paraqitjes së saj, rrugët apo linjat e trafikimit të fëmijëve, shkaqet e trafikimit të fëmijëve, karakteristikat themelore të viktimave të trafikimit të fëmijëve, si dhe analizohen edhe masat e parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie kriminale.

Fjalët çelës: trafikimi i fëmijëve, mbrojtja e fëmijëve, krimi i organizuar, organizatat kriminale, skllavëria moderne, viktimat fëmijë të trafikimit.

VËSHTRIME HYRËSE

Trafikimi i qenieve njerëzore, e veçmas i femrave dhe fëmijëve si dhe aktivitetet e tjera ilegale që janë të lidhura ngushtë me të, konsiderohet formë e rrezikshme e krimit të organizuar në shoqërinë bashkëkohore me pasoja të shumta dhe mjaft të rënda për viktimat e saj dhe shoqërinë në tërësi. Kjo dukuri kriminale është shkelje e rëndë dhe sistematike e shumë të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me konventat ndërkombëtare dhe me ligjet e shteteve nacionale që rregullojnë ndalimin dhe luftimin e aktiviteteve lidhur me trafikimin, andaj me të drejtë ajo konsiderohet edhe si një ndër format moderne të skllavërisë

njerëzore.¹ Trafikimi i qenieve njerëzore është mjaft i pranishëm në shoqërinë bashkëkohore. Sipas disa të dhënave të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (*International Labour Organisation*) dhe Shoqata “Ecje e Lirë” (*Walk Free Foundation*) del se rreth 40.3 milionë njerëz ishin viktimat të skllavërisë moderne në vitin 2016.² Po ashtu, shikuar sipas viteve në përmasa globale dhe sipas shteteve, numri i njerëzve që trafikohen është mjaft i lartë. Sipas raporteve të Departamentit Amerikan të Shtetit, vlerësohet se në përmasa ndërkombëtare, shikuar sipas viteve, për çdo vit mesatarisht trafikohen ndërmjet 600.000 deri në 900.000 persona, ndërsa vetëm në SHBA ky numër arrin ndërmjet 14.500 deri në 50.000 persona.³ Edhe sipas disa vlerësimeve të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) rreth 500.000 gra trafikohen çdo vit për në tregjet e prostitucionit në Evropë, kurse OSBE-ja ka vlerësuar se 1.2 milionë fëmijë (nën moshën 18 vjeç) trafikohen në të gjithë botën çdo vit, blihen ose shiten për t’u shfrytëzuar në punë shtëpiake apo ferma, në miniera dhe në industrinë e seksit, ose për t’u shfrytëzuar si lypsarë apo edhe për krime të tjera.⁴ Ndërkaq, edhe pse mungojnë të dhëna të sakta, sipas vlerësimeve të disa OJQ-ve që punojnë në këtë fushë, deri në 30% të viktimave të trafikuar në Evropën Juglindore janë fëmijë.⁵ Madje, sipas shumë parashikimeve, pritet që këto shifra të rriten akoma në të ardhmen, pasi trafikantët përpiqen që të sigurojnë vajza të reja për shfrytëzim seksual.

Prandaj, nisur nga këtë shifra të larta të prezencës së kësaj forme të krimit të organizuar, me të drejtë mund të konstatohet se kjo veprimtari kriminale konsiderohet si formë mjaft fitimprurëse për organizatat kriminale të krimit të organizuar. Në këtë fushë janë të përfshira shumë organizata kriminale transnacionale, të cilat kultivojnë një bashkëpunim

¹ Sipas një liste të hartuar nga Grupi i Punës i Kombeve të Bashkuara, si forma të skllavërisë moderne konsiderohen: Shitja e fëmijëve, prostitucioni i fëmijëve, pornografia për fëmijë, puna e fëmijëve, turizmi seksual, përdorimi i fëmijëve në forcat e armatosura, shfrytëzimi i punëtorëve migrantë, birësimi i paligjshëm, trafikimi i njerëzve, Trafikimi i organeve njerëzore, shfrytëzimi i prostitucionit të të tjerëve, dhuna ndaj grave, martesat e detyruara, skllavëria e borxhit dhe puna e detyruar. (Shih: United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC), *Combating Trafficking in Persons: A Handbook for Parliamentarians*, Vienna, 2009, fq.18.

² Sipas: S. Massey, G. Rankin, *Exploiting People for Profit (Trafficking in Human Beings)*, Palgrave Macmillan, London, 2020, fq.7.

³ Sipas: J.S. Albanese, *Transnational Crime and the 21st Century (Criminal Enterprise, Corruption and Opportunity)*, Oxford University Press, New York-Oxford, 2011, fq.51.

⁴ Shih: *Raporti mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore*, Strasburg, 2006, fq.38.

⁵ *Ibid.*

të ngushtë ndërmjet tyre rreth çështjeve që kanë të bëjnë me organizimin dhe kontrollimin e trafikimit me qenie njerëzore, e veçmas të vajzave të reja dhe fëmijëve. Sipas disa të dhënave të publikuara rezulton se trafikimi me qenie njerëzore rangohet në vendin tretë, për nga fitimet që sjell, menjëherë pas trafikimit të drogave dehëse dhe kontrabandës së armëve, duke gjeneruar të ardhura vjetore prej rreth 150 miliardë dollarë, ndërsa prej kësaj shume eksploatimi seksual është pjesa më e profitabile e saj me 99 miliardë dollarë në vit.⁶

Në këtë punim do të paraqiten dhe analizohen disa aspekte juridiko-penale, kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të fëmijëve, si një ndër format e krimit të organizuar. Gjatë paraqitjes dhe trajtimit të kësaj dukurie kriminale kryesisht do të shërbehemi me disa burime të kësaj fushe siç janë: aktet juridike ndërkombëtare dhe ato nacionale lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe luftimin e trafikimit të tyre, si dhe në librat, monografitë, punimet shkencore, të dhënat statistikore dhe burimet e tjera relevante të kësaj fushe.

1. KUPTIMI DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Trafikimi i fëmijëve është një krim i rëndë dhe me pasoja të shumta për viktimat e saj. Ky trafikim e privon fëmijën viktimë nga një numër i madh të drejtash, përfshirë të drejtën për ruajtjen e identitetit të vet, të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, pushim e kohë të lirë si dhe të drejtën për të mos rënë pre e torturave, apo trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese ose ndëshkimeve e që të mos i privohen liritë në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare. Nisur nga fakti se kjo formë e krimit të organizuar është dukuri e rrezikshme kriminale, atëherë edhe në fushën e parandalimit dhe luftimit të saj janë miratuar një numër i konsiderueshëm i instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me përkufizimin e trafikimit të fëmijëve, parandalimin dhe luftimin e saj, trajtimin e fëmijëve viktimë, bashkëpunimin ndërmjet shteteve, si dhe shumë çështje të tjera me rëndësi të kësaj fushe. Po ashtu, janë miratuar edhe shumë dispozita ligjore të shteteve nacionale që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, si dhe parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie kriminale. Sipas *Protokollit të Kombeve të Bashkuara për*

⁶ Sipas: Human Trafficking by the Numbers, *Human Rights First*, Fact Sheet, shtator, 2017, (Shih linkun: <https://www.humanrightsfirst.org/sites/default/files/TraffickingbytheNumbers.pdf>).

*parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional të vitit 2000, shprehja “trafikim i personave”, ku bëjnë pjesë edhe fëmijët si viktimë të trafikimit, nënkupton: “rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël (lehtësisht e cënueshme) ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikën e ngjashme me skllavërinë, robërim ose heqjen e organeve”.⁷ Në pajtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989, me termin “fëmijë” kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.⁸ Edhe sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës shprehja “fëmijë” nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç. Madje, me *Ligjin për mbrojtjen e fëmijës* të Kosovës pasurohet edhe më tej ky term, ku përveç që në tërësi citohet neni i përmendur më lart i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, aty shtohet edhe teksti si vijon: “Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht”.⁹ Sipas këtij ligji, termi “trafikim i fëmijës” nënkupton: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin, marrjen e fëmijëve për qëllime shfrytëzimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës, apo me forma të tjera të*

⁷ Shih nenin 3 të *Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën nr.55/25, të datës 15 nëntor 2000.

⁸ Shih nenin 1 të *Konventës për të Drejtat e Fëmijës*. Kjo Konventë është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën nr.44/25 të datës 20 nëntor 1989 dhe ka hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.

⁹ Shih nenin 3, pika 1.1 të *Ligjit nr.06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës*. Ky ligj është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës më 12.07.2019, dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.14, datë 17 korrik, 2019. Ai ka hyrë në fuqi një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

shtrengimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme, ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit”.¹⁰ Nga ky përkufizim rezulton se elementet e trafikimit me fëmijë janë: 1. rekrutimi, 2. transportimi, 3. transferimi, 4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrengimit, 5. rrëmbimit, 6. mashtrimit, 7. Lajthimit, 8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe 9. dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër për qëllim të shfrytëzimit.

Procesi i trafikimit të fëmijëve zakonisht kalon nëpër disa faza. Kryesisht dallohen tri faza kryesore të trafikimit të fëmijëve: *rekrutimi i viktimave; transportimi dhe transferimi*; si dhe *destinacioni*. *Faza e rekrutimit* të viktimave fëmijë ka të bëjë me shumë aktivitete të trafikuesve për t’i vënë në shënjestër dhe tërhequr viktimat e mundshme në mënyrë që të përfshihen në skemën e trafikimit. Ky rekrutim bëhet më së shpeshti përmes disa metodave dhe mënyrave të caktuara siç janë: detyrimi i plotë, marrja me forcë ose rrëmbimi; përmes mashtrimit me anë të premtimeve për punë të ligjshme; mashtrimit me gjysmë të vërteta se do të punësohen në ndonjë lokal dëfrimi apo kërcimi, premtim për martesë, kërcënim për jetën e familjeve të tyre etj. *Faza e transportimit dhe transferimit* nënkupton strehimin dhe pritjen e viktimës së trafikimit nëpër një numër pikash gjatë gjithë procesit, me ç’rast kjo nuk nënkupton zhvendosjen e domosdoshme të viktimës përtej kufijve ndërkombëtarë, pasi trafikimi i fëmijëve mund të jetë edhe i brendshëm për qëllimet e shfrytëzimit brenda territorit të të njëjtit shtet. Ndërkaq, gjatë *fazës së destinacionit* realizohet në tërësi synimi i trafikuesit, e që është shfrytëzimi i viktimës, ku tashmë viktimat e trafikimit e gjejnë veten në kushtet e një jete skllavëruese, qoftë duke përfunduar në industrinë e seksit, apo edhe duke punuar punë të rënda skllavëruese, heqje organesh, përshtirë edhe forma të tjera të shfrytëzimit.

Trafikimi i fëmijëve si dukuri kriminale ka qenë dhe është i pranishëm në vende të ndryshme, e veçmas në ato regjione dhe shtete të cilat janë përfshirë me ndryshime të mëdha politike, sociale, ekonomike etj., siç janë shtetet e bllokut socialist, shtetet e Evropës Lindore dhe Juglindore, si dhe disa vende të tjera në Azi, Afrikë, Amerikën Latine etj. Kjo formë e krimit të organizuar, mjerisht, ka përfshirë edhe vendet e

¹⁰ Neni 3, pika 1.33 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës.

regjionit të Ballkanit, si Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe disa vende të tjera. Në paraqitjen dhe ekzistimin e kësaj forme të krimit të organizuar ndikojnë faktorë të shumtë dhe të ndryshëm. Në këtë drejtim, në paraqitjen e saj, ndikim të fuqishëm kanë luftërat e armatosura dhe konfliktet civile, luftërat lokale, konfliktet etnike dhe religjioze, gjendjet e krijuara pas konflikteve dhe luftërave të armatosura, gjendjet e krijuara pas transformimeve të mëdha politike, tronditjet dhe çrregullimet shoqërore-ekonomike, trazirat politike, recesionet dhe krizat e mëdha politike etj., gjendje dhe faktorë të cilët shfrytëzohen me mjeshtëri të rrallë nga grupet kriminale të organizuara për zgjerimin e aktiviteteve të tyre kriminale. Zakonisht viktimat e një trafikimi të tillë janë në të shumtën e rasteve fëmijët e gjinisë femërore të niveleve të ndryshme arsimore, kulturore, sociale etj. Sipas disa të dhënave të publikuara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogat dhe krimin (UNODC) lidhur me faktorët me ndikim në trafikimin e qenieve njerëzore, përfshirë edhe trafikimin e fëmijëve në përmasa globale, rezulton se në vitin 2018 si faktorë më të shpeshtë që kanë ndikuar në këtë drejtim ishin: nevojat ekonomike (51%); fëmijë nga familjet e dezo-rganzuara (20%), partneri intim si trafikant (13%), çrregullimi mendor i sjelljes apo neurologjik (10%), statusi i imigrantit (10%), fëmijë të privuar nga kujdesi prindor (9%), edukimi i kufizuar apo i njohjes së gjuhës së huaj (6%), aftësia e kufizuar fizike (3%).¹¹

Trafikimi i fëmijëve ka qenë dhe mbetet një biznes mjaft fitimprurës dhe i parapëlqyer edhe i grupeve kriminale shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë. Kësisoj, në Shqipëri ky trafikim më i përhapur ka qenë nëpërmjet skafeve, që ka sjellë një numër të madh të viktimave në det për shkak kushteve të rënda atmosferike, mbingarkesës së skafeve ose edhe të përplasjeve me rojat bregdetare italiane. Përveç rrugëve detare, për trafikim janë shfrytëzuar edhe shfrytëzohen edhe rrugët ajrore dhe tokësore. Ndërsa Kosova konsiderohet si vend tranzit, por edhe destinacion për viktimat e huaja të trafikimit të fëmijëve, me një numër të vogël të trafikimit të brendshëm të femrave dhe vajzave të reja. Në periudhën e pasluftës në Kosovë, duke filluar nga qershori i vitit 1999, ka pasur një rritje të numrit të viktimave të trafikimit të fëmijëve, rritje që ka qenë e kushtëzuar nga disa faktorë dhe rrethana të caktuara, duke mos e përjashtuar edhe faktorin e prezencës së madhe të forcave ushtarake ndërkombëtare dhe rritjen e klientelës së brendshme. Ndërsa, struktura e grupeve kriminale të organizuara të përfshira në këtë trafikim, në masën

¹¹ Sipas: United Nations Office on Drugs and Crime, *Global Report on Trafficking in Persons 2020*, New York, 2020, fq. 71.

më të madhe kanë të bëjnë me ato grupe që kishin lidhje me grupet kriminale të vendeve furnizuese.

Viktimat e trafikimit të fëmijëve, e veçmas viktimat femra të kësaj forme të trafikimit, në të shumtën e rasteve trafikohen për shfrytëzim seksual, si dhe për disa forma të tjera të shfrytëzimit. Në bazë të të dhënave nga literatura dhe publikimeve të tjera në shtypin e përditshëm dhe atë periodik, fëmijët viktimë kryesisht rrjedhin nga ambientet sociale të varfra ose të shtresave të mesme, prej zonave rurale dhe të varfra ose ata rrjedhin edhe nga familjet e degraduara me probleme dhe konflikte të vazhdueshme. Zakonisht në familjet e tilla janë prezente dukuri të ndryshme socio-patologjike (p.sh., konsumimi i tepërt i alkoolit, konsumimi i drogave dehëse, varësia nga bixhozi etj.), apo ato janë familje të shthurura, të varfëra, familje me shumë anëtarë, në të cilat atmosfera familjare është e atillë që në mënyrë direkte apo edhe indirekte ndikon që ata fëmijë dhe vajza të reja të jenë viktimë potenciale të trafikimit.

2. FORMAT KRYESORE TË TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Trafikimi i fëmijëve realizohet në forma të ndryshme në shoqërinë bashkëkohore. Sipas të dhënave nga literatura dhe burimeve të tjera kërkimore-shkencore, si forma më të njohura dhe më të shpeshta të trafikimit të fëmijëve janë:

- Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzimi seksual, pornografi të fëmijëve dhe pedofili;
- Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim të punës së tyre;
- Trafikimi i fëmijëve për lypje;
- Trafikimi i fëmijëve për kryerje të aktiviteteve kriminale;
- Trafikimi i foshnjave të sapolindura;
- Trafikimi i fëmijëve për lidhje të martesës;
- Trafikimi i fëmijëve për pjesëmarrje në konfliktet e armatosura;
- Trafikimi i fëmijëve për shitje të organeve trupore;
- Trafikimi i fëmijëve për adoptim;
- Trafikimi i fëmijëve për qëllime mjekësore dhe shkencore.¹²

Të dhënat nga literatura na bëjnë me dije se të gjitha këto forma të trafikimit të fëmijëve janë të pranishme në masë të madhe në disa vende

¹² Cf. S. Vuković, N. Radović, *Prevenција organizovanog kriminala*, Beograd, 2012, fq.72-73.

të shoqërisë bashkëkohore. Kështu p.sh., sipas disa të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) vlerësohet se rreth 8.4 milionë fëmijë të cilët janë viktimë të trafikimit punojnë punë të ndryshme, janë të përfshirë në konfliktet e armatosura, janë të detyruar në ushtrimin e prostitucionit, pornografisë dhe aktivitete të tjera ilegale, si dhe rreth 30.000 fëmijë ushtarë janë të përfshirë në më tepër se 30 rajone të konflikteve në mbarë botën, disa prej të cilëve edhe më të rinj se 10 vjet.¹³ Ndërkaq, sipas një hulumtimi empirik që ka të bëjë me origjinën dhe format e trafikimit të fëmijëve, i realizuar gjatë vitit 2004 në vendet e Evropës Juglindore, format e trafikimit të fëmijëve shprehur në përqindje kanë pasur ecurinë si vijon: Shqipëria (shfrytëzim seksual: 23.6%, për punë, lypje dhe aktivitete kriminale: 93.2%); Bosnja dhe Hercegovina (shfrytëzim seksual, punë dhe lypje: 60.7%); Bullgaria (shfrytëzim seksual: 5.7%, punë: 0%, lypje dhe aktivitete kriminale: 50%, adoptim: 100%); Kroacia (shfrytëzim seksual, punë dhe lypje: 0%); Kosova (shfrytëzim seksual, punë dhe lypje: 58.9%); Maqedonia (shfrytëzim seksual: 25%); Moldavia (shfrytëzim seksual: 10.3%, punë: 15%, lypje dhe aktivitete kriminale: 39.1%); Mali i Zi (shfrytëzim seksual, punë dhe lypje: 80%); Rumania (shfrytëzim seksual: 26.8%, punë: 50%, lypje dhe aktivitete kriminale: 88.9%); dhe Serbia (shfrytëzim seksual, punë dhe lypje: 65%).¹⁴ Nga këto të dhëna shihet qartë se në vendet e Evropës Juglindore, si forma më të shprehura të trafikimit me fëmijë ishin për shfrytëzim seksual, për punë, lypje dhe për aktivitete kriminale. Ndërkaq, në kuadrin e këtyre formave, në të shumtën e rasteve fëmijët si viktimë të trafikimit ishin femrat e trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual. Edhe hulumtimet dhe të dhënat e publikuara në përmasa globale dëshmojnë se në të shumtën e rasteve kanë dominuar format e trafikimit për shfrytëzim seksual, ku ishin të përfshirë edhe fëmijët. Kësisoj, sipas disa të dhënave të publikuara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogat dhe krimin (UNODC) lidhur me të gjitha format e trafikimit në përmasa globale, rezulton se në vitin 2018, rreth 50% të viktimave ishin të trafikuar për shfrytëzim seksual, 38% për punë të detyruar, 6% për aktivitete kriminale, rreth 1, 5% për lypje, 1% për martesë të detyruar, kurse rastet e tjera në numër tejet të vogël kishin të bënin për forma të tjera të trafikimit (p.sh., shitje të fëmijëve, heqje të organeve etj.).¹⁵ Në

¹³ *Ibid.*, fq.73.

¹⁴ Sipas: R. Surtees, *Child Trafficking in Southeastern Europe: Different Forms of Trafficking and Alternative Interventions*, Tulane Journal of International and Comparative Law, publikuar në online database: LexisNexis, 2006, fq.3.

¹⁵ Sipas: United Nations Office on Drugs and Crime, *Global Report on Trafficking in Persons 2020*, New York, 2020, fq.10-11.

mesin e këtyre viktimave të trafikimit një pjesë të konsiderueshme e përbëjnë fëmijët viktimë të trafikimit, e veçmas femrat e reja.

Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzimi seksual, pornografi të fëmijëve dhe pedofili pa dyshim se është një ndër format më të shpeshta të trafikimit të fëmijëve. Kjo formë e trafikimit të fëmijëve ndalohej rreptësisht me aktet më të njohura ndërkombëtare, si dhe me ligjet e shteteve nacionale. Sipas nenit 34 të *Konventës për të drejtat e fëmijës*, “Shtetet palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe keqtrajtimit seksual. Për këto qëllime, shtetet palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të parandaluar që: (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen të përfshihen në veprimtari të paligjshme seksuale; (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose për praktika të tjera seksuale të paligjshme; (c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike”.¹⁶ Po ashtu, edhe me *Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë*, është paraparë shprehimisht se shtetet palë do të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë.¹⁷ Mbrojtjes së fëmijëve nga format e tilla të trafikimit i kushtohet një rëndësi e madhe edhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Kësisoj, në nenin 47 të *Ligjit për mbrojtjen e fëmijës* shprehimisht thuhet: “Fëmija mbrohet nga rrembimi, trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi”.¹⁸ Me këtë ligj jepen edhe përkufizimet e termave: “prostitucion me fëmijë” dhe “pornografi me fëmijë”. Shprehja “prostitucion me fëmijë” nënkupton “[...] përdorimin e fëmijës për veprimtari seksuale, me ç’rast në këmbim të përfshirjes në veprimtari seksuale të fëmijës ofrohen ose premtohen si pagesë para ose çdo formë tjetër shpërblimi ose kompensimi, pavarësisht nëse ajo pagesë, ai premtim ose shpërblim i

¹⁶ Neni 34 i *Konventës për të Drejtat e Fëmijës*.

¹⁷ Shih nenin 1 të *Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë*, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 25 maj, 2000. Me këtë protokoll jepen edhe përkufizimet e termave: “shitje e fëmijëve”, “prostitucion me fëmijë” dhe “pornografia me fëmijë”.

¹⁸ Neni 47, paragrafi 2 i *Ligjit për mbrojtjen e fëmijës*.

bëhet fëmijës ose një pale të tretë”.¹⁹ Ndërkaq, shprehja “pornografi me fëmijë” konform dispozitave këtij ligji nënkupton: “[...] çfarëdo pamje vizuale apo shfaqje ose pasqyrim vizual, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh, ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyrë elektronike, mekanike apo me mjete të tjera, që paraqet ose pasqyron: gjenitalet [...] apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale; një fëmijë të vërtetë, i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose pamje realiste të një fëmije jo ekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar”.²⁰

Trafikimi i fëmijëve për shfrytëzimi seksual, pornografi të fëmijëve dhe pedofili pa dyshim se është një ndër format mjaft të përhapura të trafikimit të fëmijëve në shumë vende të shoqërisë bashkëkohore. Ajo konsiderohet si veprimtari mjaft fitimprurëse për organizatat kriminale. Si rrugë apo linja të trafikimit të fëmijëve femra me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion, pornografi dhe pedofili janë kryesisht ato rrugë që përdoren edhe për trafikimin e qenieve njerëzore në përgjithësi. Kryesisht si vende të origjinës së femrave të reja si viktime të trafikimit konsiderohen vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, vendet e Evropës Juglindore, vendet e Azisë, vendet e Afrikës dhe të Amerikës Qendrore dhe Jugore. Ndërkaq, si vende të destinacionit të këtyre femrave të reja janë kryesisht vendet e Evropës Perëndimore, e në veçanti vendet e Bashkimit Evropian.²¹ Si një ndër faktorët që po ndikon në rritjen e trafikimit të fëmijëve me qëllim të shfrytëzimit seksual është edhe organizimi i të ashtuquajturit seks-turizëm, i cili ka marrë formën e një biznesi shumë të preferuar dhe mjaft fitimprurës për grupet e organizuara kriminale dhe biznes që po organizohet në disa vende në Evropë, Azi, Afrikë, Amerikën Latine dhe vende të tjera ekzotike, për nevoja të pedofilistëve nga vendet e pasura. Trafikimi i fëmijëve femra për qëllime të shfrytëzimit seksual është prezent edhe në Kosovë. Në bazë të disa të dhënave dhe kërkimeve del se për në Kosovë ose nëpërmjet saj për destinim në vende të tjera, kryesisht kanë funksionuar deri më tani dy linja apo rrugë të trafikimit të

¹⁹ *Ibid.*, neni 3, pika 1.30.

²⁰ *Ibid.*, neni 3, pika 1.31.

²¹ Për më tepër për trafikimin e fëmijëve me qëllim të shfrytëzimit seksual në vendet e Bashkimit Evropian shih punimin: I. Staiger, *Trafficking in Children for the Purpose of Sexual Exploitation in the EU*, European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice, Vol. 13/4, fq.603-624, 2005, publikuar në online database HeinOnline 13. (<http://heinonline.org>).

femrave të reja: njëra që vjen nga ish shtetet socialiste, si Rusia, Ukraina, Moldavia, Rumania, Bullgaria etj., dhe rruga tjetër që vjen nga vendet e Lindjes së Largët, Lindjes së Mesme, nga Kurdistan, nga Afrika e Veriut, Turqia, Greqia, Maqedonia e Veriut etj., e të cilat në mënyrë ilegale bartin femra për tregjet e prostitucionit që ushtrohet në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Serbi, Shqipëri etj.²² Mirëpo, pjesa më e madhe e tyre transportohet në mënyrë ilegale për nevojat e tregjeve të prostitucionit për në vendet e Evropës Perëndimore. Kurse, në dekadën e parë pas çlirimit të Kosovës, si viktimat të trafikimit të femrave në Kosovë kryesisht ishin femrat dhe vajzat e reja që vinin nga vendet e varfra të ish- shteteve sovjetike dhe të disa vendeve të tjera të Evropës Juglindore. Metodat e rekrutimit dhe të trafikimit të vajzave të reja janë të ndryshme, duke filluar nga rekrutimet individuale që kërkojnë të gjejnë meshkuj nëpër bare, kafene, klube dhe diskoteka, e deri te rekrutimi nëpërmjet formave të ndryshme joformale, përmes miqësive dhe familjarëve, si dhe përmes rrjetit të internetit.

Trafikimi i fëmijëve me qëllim të shfrytëzimit të tyre për punë, lypje dhe aktivitete kriminale, po ashtu është mjaft prezent në disa vende të shoqërisë bashkëkohore. Dispozitat e akteve juridike ndërkombëtare, si dhe ato të shteteve nacionale e ndalojnë rreptësisht shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve. Në këtë drejtim, edhe Ligji për mbrojtjen e fëmijës i Kosovës ia kushton një kapitull të posaçëm mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Sipas dispozitave të këtij ligji, ndalohet punësimi i fëmijës në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës. Ndërkaq, fëmija nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë në punë të rrezikshme, siç janë: [...] të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, robëria dhe bujkrobëria për shkak të borxheve dhe puna e detyruar apo e detyrueshme, duke përfshirë rekrutimin e detyruar apo të detyrueshëm të fëmijëve për t'i angazhuar në konflikt të armatosur”.²³ Të dhënat nga literatura shkencore dhe publikimet e tjera dëftojnë për një numër të madh të fëmijëve të trafikuar me qëllim të shfrytëzimit të tyre për punë të rënda fizike. Sipas një hulumtimi të televizionit amerikan CNN, vetëm në liqenin “Volta” të

²² Sipas: *Raporti i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) me seli në Prishtinë (periudha: shkurt-15 tetor 2000)*, fq.1. (Cituar në: R.Halili, *Disa karakteristika kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të femrave*, E drejta, nr.1-4, Prishtinë, 2000, fq.34.).

²³ Neni 51, paragrafi 1, pika 2.1 e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës.

Ganës konsiderohet se punojnë punë të rënda fizike rreth 20.000 fëmijë duke peshkuar nën rrezet përcëlluese të diellit ekuatorial.²⁴ Sipas Organizatës Botërore të Punës, këta fëmijë punojnë punë skllavëruese për pronarët e tyre, fëmijë që janë blerë nga trafikantët për jo më shumë se 250 dollarë për secilin prej tyre. Po ashtu, janë të shpeshta edhe rastet e trafikimit të fëmijëve me qëllim të ushtrimit të lypjes, apo edhe të detyrimit të tyre në kryerjen e disa veprave të tjera penale, e veçmas të atyre kundër pasurisë. Sipas disa të dhënave të “*Terre des Hommes*”, gjatë periudhës 1999-2001, në qytetet greke të Selanikut dhe Athinës gjendeshin afro 3000-4000 fëmijë shqiptarë, të cilët afër pikave turistike kërkonin lëmoshë ose edhe kryenin punë duke larë xhamat e makinave, si dhe punë të tjera.²⁵ Ndërkaq, në një publikim të realizuar nga ana e OSBE-së me prezencë në Shqipëri gjatë vitit 2020 rezulton se një pjesë e konsiderueshme e viktimave fëmijë të trafikimit janë shfrytëzuar nga trafikantët për veprimtari të ndryshme kriminale, e në rend të parë për kryerjen e vjedhjeve dhe shpërndarjen e drogave dehëse.²⁶ Raste të tilla të trafikimit të fëmijëve për punë, lypje dhe aktivitete kriminale janë shënuar edhe në disa regjione të Republikës së Kosovës. Viktimat fëmijë të kësaj forme të trafikimit kryesisht rrjedhin nga ambientet familjare me probleme të ndryshme, ku në pjesën më të madhe ato janë familje të varfra, me gjendje të rëndë materiale, familje të degraduara dhe në të cilat janë të pranishme dukuri të ndryshme sociopatologjike.

Në disa vende dhe regjione të caktuara është i pranishëm edhe trafikimi i fëmijëve për të shërbyer si ushtarë në konfliktet e armatosura apo edhe në format e tjera të luftës. Kjo formë e përfshirjes së fëmijëve ushtarë në konfliktet e armatosura është e ndaluar me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, si dhe me ligjet e shteteve nacionale të kësaj fushe. Sipas *Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura*, kërkohet që shtetet palë të këtij protokollit të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që të gjithë anëtarët e forcave të tyre të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjeç, të mos marrin pjesë direkt në veprime luftarake.²⁷ Ndërkaq në nenin 4 të këtij protokollit shprehimisht

²⁴ Sipas shkrimit me titull: *20 mijë fëmijë të skllavëruar rrezikojnë jetët për ta pasuruar “të zotin”*, Koha Ditore, datë 2 mars, 2019, fq.8.

²⁵ Cf. N. Tota, *Trafikimi i qenieve njerëzore: Aspekte penalo-juridike, krahasuese dhe kriminologjike*, Tiranë, 2018, fq.176.

²⁶ Shih publikimin e OSBE-së me titull: *Tipologjia e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri*, Tiranë, 2020, fq.23-24.

²⁷ Neni 1 i *Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura*. Ky protokoll është miratuar nga

thuhet: “1. Në asnjë rrethanë grupet e armatosura, të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, nuk do të rekrutojnë ose përdorin në veprime luftarake persona nën moshën 18 vjeç. 2. Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar një rekrutim dhe përdorim të tillë, duke përfshirë edhe masat ligjore të nevojshme për ndalimin dhe penalizimin e praktikave të tilla”.²⁸ Edhe me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë ndalohet pjesëmarrja e fëmijës në konfliktin e armatosur.²⁹ Trafikimi i fëmijëve për të shërbyer si ushtarë në konfliktet e armatosura ka qenë dhe është akoma mjaft prezent në disa vendet të shoqërisë bashkëkohore. Edhe pse është e vështirë të përcaktohet numri i saktë i fëmijëve ushtarë, megjithatë disa shifra të publikuara në këtë drejtim nga ana e organizatave dhe asociacioneve që merren me mbrojtjen e fëmijëve flasin për një gjendje mjaft alarmante. Kësisoj, sipas një raporti të publikuar nga Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) në vitin 2007 bëhet e ditur se në gjithë botën më shumë se 250.000 fëmijë janë të përfshirë në luftime.³⁰ Sipas këtij raporti shtetet afrikane prijnë në botë për nga numri i ushtarëve fëmijë, siç janë: Republika Demokratike e Kongos, Sudani, Somalia, Uganda etj. Po ashtu, aty përmenden edhe disa shtete të Azisë dhe vende të tjera. Edhe sipas disa të dhënave të publikuara që kanë të bëjnë me konfliktin në Kongo, dëshmohet se të gjitha palët ndërluftuese kanë rekrutuar fëmijë për luftime. Vlerësohet se më tepër se 40% e 15.000 ushtarëve në zonën e Iturit në verilindje të Kongos janë fëmijë.³¹ Ky rekrutim i fëmijëve si ushtarë ka pasoja të rënda dhe afatgjata për shëndetin e fëmijëve, pasi ata ngelin me shumë trauma dhe stresse për tërë jetën e tyre.

Si forma të tjera të trafikimit të fëmijëve konsiderohen edhe trafikimi i fëmijëve për shitjen e organeve, për adoptim, trafikimi i foshnjave të porsalindura si dhe trafikimi i fëmijëve për qëllime mjekësore dhe shkencore. Në kuadrin e formave të trafikimit, gjatë kohëve të fundit gjithnjë e më shumë është e pranishme edhe dukuria e trafikimit të

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 25.05.2000.

²⁸ *Ibid.*, neni 4, paragrafi 1 dhe 2.

²⁹ Në nenin 59 të këtij ligji shprehimisht thuhet: “Ndalohet pjesëmarrja e fëmijës në konfliktet e armatosura, si dhe në çfarëdo lloji forme të grupit të armatosur të rregullt apo jo të rregullt, siç parashihet në Protokollin Fakultativ të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës në përfshirjen e Fëmijës në Konflike të Armatosura”.

³⁰ Sipas shkrimit me titull: “Një çerek milioni fëmijë – ushtarë”, publikuar në gazetën “Koha ditore”, datë 1 gusht 2007, fq. 22.

³¹ Sipas: N. Cahn, *Poor Children: Child “Witches” and Child Soldiers in Sub-Saharan Africa*, Ohio State Journal of Criminal Law, 2006, publikuar në online database WestlawNext 413, 2011, fq.4.

fëmijëve me qëllim të shitjes së organeve të tyre për njerëzit që kanë nevojë. Kjo formë e trafikimit pothuaj se është prezente në të gjitha vendet e botës. Trafikimi i organeve njerëzore është veprimtari e re kriminale e cila u sjell fitime të mëdha grupeve të organizuara kriminale, pasi njerëzit e pasur dhe në nevojë janë në gjendje të paguajnë shuma të mëdha të mjeteve financiare për shëndetin e tyre. Ky trafikim zakonisht është i zhvilluar dhe organizohet në shtetet në të cilat mungojnë organet e tilla për transplantim në tregun legal dhe në të cilat janë të zhvilluara spitalet private, në të cilat kryhen këto transplantime dhe spitale që kontrollohen në masë shumë të vogël nga shteti. Kësisoj, përmes këtij trafikimi sigurohen organet siç janë: veshkat, mëlçia, zemra dhe organet e tjera, të cilat më pas transplantohen duke bërë të mundur që një numër tejet i madh i njerëzve të vazhdojnë jetën me organe të huaja. Sipas të dhënave nga literatura, bëhet e ditur se një numër i madh i operimeve në fushën e transplantimit të organeve realizohet përmes sigurimit të organeve të huaja njerëzore në tregun e zi. Kësisoj, në bazë të disa të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) që kanë të bëjnë me vitin 2007 vlerësohet se deri në 10% e të gjitha transplantimeve që ndodhin në rruzullin botëror, realizohen përmes sigurimit të organeve në tregun e zi, ku si donatorë përveç personave madhorë janë edhe një përqindje e vogël e fëmijëve.³² Gjatë dekadave të fundit janë publikuar mjaft shkrime dhe të dhëna statistikore, të cilat flasin edhe për trafikimin e foshnjave të porsalindura. Kësisoj, nuk janë të rralla rastet e përfshirjes së organizatave kriminale në organizimin, ndërmjetësimin apo edhe në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në shitjen ilegale të foshnjave të sapolindura për çiftet bashkëshortore pa fëmijë. Këto janë rastet kur vetë prindërit pajtohen që foshnjën e tyre ta shesin me një pagesë të caktuar, apo edhe situatat e tjera që janë më të rrezikshme, kur foshnjat vidhen dhe shpallen si të vdekura dhe më pas ato u shiten palëve të interesuara përmes organizatave kriminale të krimit të organizuar.³³

³² Y. Shimazono, *The State of the International Organ Trade: A Provisional Picture Based on Integration of Available Information*, Bulletin of the World Health Organization 85(12), 2007, fq. 955.

³³ Cf. M. Bošković, *Transnacionalni organizovani kriminalitet*, Beograd, 2003, fq.161.

3. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Duke u nisur nga fakti se trafikimi i fëmijëve konsiderohet si formë e rrezikshme e krimit të organizuar me pasoja të shumta dhe afatgjate për viktimat e saj, atëherë kjo doemos shtron nevojën e ndërmarrjes së masave preventive dhe represive me qëllim të parandalimit dhe luftimit të suksesshëm të kësaj dukurie kriminale. Parandalimi i suksesshëm i kësaj forme të trafikimit të qenieve njerëzore nuk është i mundur pa evitimin dhe çrrënjosjen e faktorëve dhe rrethanave me ndikim në paraqitjen dhe ekzistimin e saj në nivel ndërkombëtar dhe nacional. Si masa të karakterit preventiv me ndikim në parandalimin e kësaj dukurie kriminale mund të jenë: zbutja e shkallës së varfërisë, krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e shkallës së edukimit, rritja e shkallës së sigurisë, vetëdijesimi i viktimave potenciale fëmijë për rrezikun e shfrytëzimit nga trafikantët, fuqizimi i mëtejme i shtetit ligjor, miratimi i legjislacionit adekuat dhe përsosja e mëtejme e legjislacionit ekzistues, rritja e efikasitetit të punës së organeve në drejtim të zbulimit, të ndjekjes dhe gjyqimit të kryesve të trafikimit të fëmijëve, rritja e shkallës së bashkëpunimit ndërmjet organeve të shteteve të ndryshme, shtimi i kontrollit të kufijve shtetërorë etj. Po ashtu, duhen zbatuar edhe masa të ndryshme për të ulur ndjeshmërinë e fëmijëve ndaj trafikimit përmes krijimit të mjediseve të sigurta dhe me perspektivë për fëmijë, si dhe të punohet edhe më tej në zbatimin e mirëfilltë të programeve dhe fushatave të edukimit dhe shkollimit të gjeneratës së re.

Në fushën e parandalimit dhe luftimit të trafikimit të fëmijëve një rol të rëndësishëm e kanë edhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare, të cilat kanë si mision të tyre identifikimin e fëmijëve të trafikuar, ndihmën, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Veçmas në këtë drejtim një rol i rëndësishëm i përket Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Fondit të Emergjencës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), duke mos përfshiruar edhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Po ashtu, një rol i rëndësishëm u përket edhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare të shteteve nacionale, të cilat merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në procesin e parandalimit të trafikimit me fëmijë një rol i madh i takon edhe familjes dhe shkollës, të cilat si mikrogrupe shoqërore duhet të ofrojnë kushte për zhvillim dhe edukim të drejtë të fëmijëve. Veçmas duhet potencuar roli i shkollës në këtë drejtim, e cila duhet ta ketë si mision të saj edhe pajisjen me informacione dhe njohuri të shumta

brezin e ri lidhur me dukurinë e trafikimit me fëmijë dhe pasojat e saj, duke transmetuar brez pas brezi vlera universale dhe edukative mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, në mënyrë që fëmijët të mos bien pre e premtimeve dhe mashtrimeve të trafikantëve.

Nisur nga rrethana se trafikimi i fëmijëve është shkelje e rëndë dhe sistematike e shumë të drejtave të fëmijës të garantuara me konventat ndërkombëtare dhe me ligjet e shteteve nacionale, si dhe bazuar në faktin se kjo formë e krimit të organizuar ka marrë karakter transnacional, e cila është e përhapur në tërë botën me pasoja të shumta dhe mjaft të rënda për viktimat e saj në të gjitha vendet e botës, atëherë edhe për luftimin, kontrollin dhe parandalimin e saj janë të interesuara të gjitha shtetet e botës. Në këtë drejtim një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë dhe po japin Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës, si dhe disa organizata të tjera joqeveritare dhe humanitare. Deri më tani në këtë fushë janë miratuar një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare, protokolleve dhe akteve të tjera juridike në nivel ndërkombëtar dhe nacional. Ndër konventat dhe dokumentet më të njohura që janë miratuar nga Lidhja e Kombeve, Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Evropës në fushën e luftimit dhe parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, përfshirë edhe trafikimin e fëmijëve janë:³⁴ *Marrëveshja ndërkombëtare për luftimin e trafikimit me robër të bardhë* (18 maj, 1904); *Konventa ndërkombëtare për luftimin e trafikimit me robër të bardhë* (4 maj, 1910); *Konventa ndërkombëtare për luftimin e tregtisë me gra dhe fëmijë* (30 shtator, 1921); *Konventa ndërkombëtare mbi robërinë* (25 shtator, 1926); *Konventa për luftimin e trafikimit me njerëz dhe shfrytëzimin për prostitucion nga të tjerët* (2 dhjetor 1949); *Konventa shtesë për ndërprerjen e robërisë, tregtisë me skllavër dhe praktikave të tjera të ngjashme me skllavërinë* (7 shtator, 1956); *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës* (20 nëntor, 1989); *Rezoluta për trafikimin e femrave* (4 tetor, 1993); *Rezoluta për trafikimin e qenieve njerëzore* (5 shkurt, 1996); *Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë* (25 maj, 2000); *Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me*

³⁴ Për më tepër lidhur me konventat dhe aktet e tjera juridike, si dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë në fushën e luftimit dhe kontrollit të trafikimit të fëmijëve, si dhe të trafikimit të qenieve njerëzore në përgjithësi shih punimin: M. Cherif Bassiouni et al., *Addressing International Human Trafficking in Women and Children for Commercial Sexual Exploitation in the 21st Century*, Revue Internationale de Droit Pénal, Volume 81, AIDP, Toulouse (France), 2010, fq.434-491.

përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (25 maj, 2000); *Protokolli i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional* (15 nëntor, 2000); *Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore* (16 maj, 2005) etj.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës e ka paraparë veprën penale të trafikimit me njerëz në kuadrin e kapitullit “*Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare*”. Kjo vepër penale është paraparë në nenin 165 të këtij kodi me gjithsej 6 paragrafë të tij. Sipas paragrafit 1 të nenit 165 të këtij kodi, “Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet”. Ndërsa në paragrafët 2-5 janë paraparë format e rënda të kryerjes së kësaj vepre penale, për forma të cilat janë paraparë edhe dënime me burgim me lartësi më të gjatë kohore. Kësisoj, në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë forma e rëndë e kryerjes së kësaj vepre penale nëse ajo kryhet ndaj fëmijës, përkatësisht ndaj personit nën moshën 18 vjeç, formë për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. Ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni është paraparë formë e posaçme e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet me faktin se ndokush e ka organizuar, përkatësisht ka themeluar një grup personash për të kryer këtë vepër penale, formë për të cilën është paraparë dënimi me gjobë deri në pesëqind mijë (500,000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet.³⁵ Ndërkaq, si formë më e rëndë e veprës penale të trafikimit me njerëz, sipas këtij kodi, konsiderohen rastet kur kjo vepër penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, formë për të cilën janë paraparë edhe dënimet më të rënda, përkatësisht kryesi i kësaj forme të trafikimit me njerëz dënohet me burgim jo më pak se dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.³⁶ Në Republikën e Kosovës janë miratuar edhe disa ligje tjera në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë. Me *Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit*³⁷ i kushtohet një kapitull i posaçëm parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë. Ndërkaq, me *Ligjin për mbrojtjen e*

³⁵ *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, neni 165, paragrafi 3.

³⁶ *Ibid.*, neni 165, paragrafi 5.

³⁷ Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 31 korrik 2013 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.34, 4 shtator, 2013.

fëmijës në mënyrë më detaje rregullohen shumë çështje me rëndësi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë edhe parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve.

Në luftimin dhe parandalimin e suksesshëm të trafikimit të fëmijëve një rol i rëndësishëm i takon edhe politikës ndëshkimore në kuptimin e gjerë të fjalës. Kjo qasje e politikës ndëshkimore nënkupton procesin e inkriminimit të sjelljeve kriminale që kanë të bëjnë me trafikimin me fëmijë, zbulimin dhe ndjekjen e rasteve të trafikimit të fëmijëve dhe kryesve të tyre, shqiptimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryesve, si dhe ekzekutimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryesve të saj. Në bazë të të dhënave nga literatura dhe analiza e legjislacioneve penale të vendeve të ndryshme mund të konstatohet se politika ndëshkimore ligjvënëse e shteteve veç e veç është në një masë të caktuar adekuate dhe në pajtim me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj forme të kriminalitetit. Por, nisur nga prezenca e madhe e rasteve të trafikimit të fëmijëve në përmasa nacionale dhe ndërkombëtare, rrezikshmëria shoqërore e madhe e saj, pasojat e shumta dhe mjaft të rënda që manifeston kjo formë e krimit të organizuar për viktimat e saj etj., jemi të mendimit se politika ndëshkimore në përmasa globale në fushën e zbulimit, të ndjekjes si dhe të shqiptimit të dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryesve të trafikimit me fëmijë duhet të jetë më e ashpër në mënyrë që të luftohet dhe të parandalohet me sukses kjo formë e krimit të organizuar. Edhe në Kosovë, në bazë të të dhënave statistikore, politika ndëshkimore ndaj trafikimit të fëmijëve është joadekuate në raport me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj dukurie kriminale. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me numrin e personave të arrestuar, të personave të akuzuar si dhe të personave të dënuar për veprën penale të trafikimit me njerëz, përfshirë edhe trafikimin me fëmijë, që nga periudha e pasluftës e deri më tani. Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit lidhur me trafikimin e personave për vitin 2021 Kosova dhe Shqipëria renditen në nivelin e dytë, nivel në të cilin rangohen vendet dhe territoret, qeveritë e të cilave nuk përputhen plotësisht me standardet minimale, por që po bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të ardhur në përputhje me to. Në këtë raport thuhet se Qeveria e Kosovës nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, por po bën përpjekje të konsiderueshme për një gjë të tillë. Po ashtu, aty theksohet se ajo demonstroi përpjekje të përgjithshme në rritje krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit.³⁸ Këto përpjekje përfshinin miratimin e

³⁸ US Department of State, *Trafficking in Persons Report*, June 2021, fq.337-339.

procedurave të reja standarde për të rritur efikasitetin e ndjekjeve penale dhe caktimin e një pike kontakti trafikimi në të shtatë zyrat themelore të prokurorisë. Qeveria rriti burimet për mbrojtjen e viktimave, përfshirë fondet për strehimoret antitrafikim të drejtuara nga OJQ-të dhe ato nga shteti.

Megenëse dukuria e trafikimit të fëmijëve ka të bëjë me të gjitha shtetet e botës, një rol i rëndësishëm në luftimin dhe parandalimin e saj i përket edhe koordinimit të formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërmjet shteteve, si dhe të shtimit edhe më të madh të përpjekjeve në nivel ndërkombëtar në këtë drejtim. Lidhur me këtë, është mjaft inkurajues edhe mesazhi i Sekretarit Amerikan të Shtetit, *Antony Blinken*, i cili është shprehur si vijon: *“u bëhet thirrje qeverive të bashkohen me Shtetet e Bashkuara në përmirësimin e përpjekjeve kolektive për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse trafikimin e qenieve njerëzore”*.³⁹ Veçmas në këtë drejtim duhet të punohet edhe më tej në intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve për zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare; vënien në shënjestër të kriminelëve që përpiqen që të përfitojnë nga viktimat e trafikimit të fëmijëve; mbrojtjen e viktimave të trafikimit të fëmijë; dhënien e ndihmës institucionale për përfshirjen e viktimave të fëmijë të trafikimit në programet e rikthimit të tyre në vendet përkatëse, si dhe të ashpërsohet edhe më tej politika ndëshkimore ndaj kryesve të kësaj forme të krimit të organizuar.

PËRFUNDIMI

Nga kjo paraqitje dhe analizë e shkurtër e disa aspekteve juridikopenale, kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të fëmijëve, del e qartë se kjo formë e krimit të organizuar manifeston shumë veçori të posaçme të cilat e bëjnë atë si formë të posaçme të manifestimit të krimit të organizuar. Kjo dukuri e rrezikshme kriminale është paraparë dhe rregulluar me një numër të konsiderueshëm të instrumenteve juridike ndërkombëtare, si dhe me aktet juridike të shteteve nacionale. Me këto instrumente ndërkombëtare dhe akte juridike parashihen shumë dispozita, të cilat kanë të bëjnë me përkufizimin e trafikimit të fëmijëve, parandalimin dhe luftimin e saj, trajtimin e fëmijëve viktimë, bashkëpunimin ndërmjet shteteve në fushën e parandalimit dhe luftimit të saj, si dhe shumë çështje të tjera me rëndësi të kësaj fushe. Edhe në

³⁹ Shih: US Department of State, *Trafficking in Persons Report (Message from the Secretary of State)*, June 2021.

Republikën e Kosovës janë miratuar disa akte ligjore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë.

Ky punim vuri në dukje se trafikimi i fëmijëve është shkelje e rëndë dhe sistematike e shumë të drejtave dhe lirive të fëmijëve viktimat të trafikimit, të garantuara me konventat ndërkombëtare dhe me ligjet e shteteve nacionale që rregullojnë ndalimin dhe luftimin e aktiviteteve lidhur me trafikimin e fëmijëve. Ky lloj i trafikimit është i pranishëm në masë të madhe në shumë shtete të shoqërisë bashkëkohore dhe si i tillë ka pasoja të shumta, të rënda dhe afatgjata për viktimat e saj dhe shoqërinë në tërësi. Po ashtu, nisur nga prania e madhe e kësaj forme të krimit të organizuar, ky trafikim me të drejtë po konsiderohet si një veprimtari tejet fitimprurëse për organizatat kriminale të shoqërisë bashkëkohore. Në këtë fushë janë të përfshira shumë organizata kriminale, të cilat në të shumtën e rasteve e organizojnë dhe kontrollojnë këtë veprimtari kriminale, pasi ajo gjeneron fitime të mëdha për anëtarët e tyre.

Nga studimi dhe analizimi i disa aspekteve kriminologjike dhe viktimologjike të trafikimit të fëmijëve, mund të veçohen disa karakteristika themelore në këtë drejtim. Mund të konstatohet me të drejtë se, trafikimi i fëmijëve si formë e krimit të organizuar ka qenë dhe është i pranishëm në vende të ndryshme, e veçmas në ato regjione dhe shtete të cilat janë përfshirë me ndryshime të mëdha politike, sociale, ekonomike etj., siç janë shtetet e bllokut socialist, shtetet e Evropës Lindore dhe Juglindore, si dhe disa vende të tjera në Azi, Afrikë, Amerikën Latine etj. Ajo, mjerisht, ka përfshirë edhe vendet e regjionit të Ballkanit, si Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe disa vende të tjera. Ndërkaq, si forma më të njohura të trafikimit të fëmijëve janë: trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim seksual, për punë, lypje dhe për aktivitete kriminale. Po ashtu, ky punim vë në dukje se në paraqitjen dhe ekzistimin e kësaj forme të krimit të organizuar ndikojnë faktorë të shumtë dhe të ndryshëm të natyrës objektive dhe subjektive.

Trafikimi i fëmijëve si dukuri e rrezikshme kriminale dhe si formë e krimit të organizuar transnacional duhet të parandalohet dhe luftohet. Parandalimi i suksesshëm i kësaj dukurie kriminale nuk është i mundur pa evitimin e faktorëve dhe rrethanave favorizuese me ndikim në paraqitjen e saj. Po ashtu, në luftimin dhe parandalimin e suksesshëm të trafikimit të fëmijëve një rol i rëndësishëm i takon edhe zbatimit të politikës ndëshkimore adekuate në këtë fushë. Kjo qasje e politikës ndëshkimore nënkupton procesin e inkriminimit të sjelljeve kriminale që kanë të bëjnë me trafikimin me fëmijë, zbulimin dhe ndjekjen e rasteve

të trafikimit të fëmijëve dhe kryesve të tyre, shqiptimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryesve, si dhe ekzekutimin e dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale ndaj kryesve të saj.

Rexhep Gashi

CHILD TRAFFICKING: LEGAL-CRIMINAL, CRIMINOLOGICAL AND VICTIMOLOGICAL ASPECTS

Summary

This paper presents and analyzes various legal-criminal, criminological and victimological aspects of child trafficking. Child trafficking is a severe form of organized crime with numerous, serious and long-term consequences for both victims and society. This criminal phenomenon is foreseen and regulated by a considerable number of international legal instruments as well as by the national legal acts. Many provisions pertaining to the concept of child trafficking, its prevention and combat, the treatment of child victims, inter-state cooperation, and other critical concerns in this field are included in these legal acts. Even in the Republic of Kosovo, several legal acts have been adopted in the area of children's rights protection, prevention and combating child trafficking.

Child trafficking is a serious and systematic violation of many of the rights and freedoms of child victims of trafficking, guaranteed by international conventions and the laws of nation-states prohibiting and combating activities related to child trafficking. This criminal phenomenon is present to a large extent in many states of contemporary society, and is rightly regarded as a highly lucrative activity for criminal organizations of contemporary society. In this industry, there are numerous criminal organizations involved, that in most circumstances, organize and control these criminal activities.

Child trafficking manifests certain criminological and victimological characteristics, that set it apart as a distinct form of organized crime. This dangerous criminal phenomenon is present in a number of countries, particularly in those regions and countries that are undergoing major political, social, economic changes, etc., such as the countries of the socialist bloc, the countries of Eastern and Southeastern Europe and a number of countries in Asian, African, and Latin American etc. It has, unfortunately, included the countries of the Balkan region, such as

Serbia, Albania, Northern Macedonia, Kosovo and some other countries. Child trafficking for sexual exploitation, labor, begging and criminal activities are the most common forms of child trafficking. Meanwhile, its emergence and existence is influenced by many different factors.

Trafficking in children as a form of transnational organized crime must be prevented and combated. Without avoiding favorable elements and circumstances that influence the occurrence of this criminal phenomena, it is impossible to successfully prevent it. In addition, the implementation of adequate punitive policies in this area plays a vital part in its successful combat and prevention. This approach to punitive policy implies the process of incriminating criminal behaviors related to child trafficking, detecting and prosecuting cases of child trafficking and their perpetrators, imposing sentences and other criminal sanctions on perpetrators, and executing sentences and other criminal sanctions against its perpetrators.

Krenare Shahini Gollopeni¹, Abdylmenaf Bexheti², Donat Rexha³

THE EFFECTS OF THE FISCAL STIMULUS ON THE INCREASE OF EMPLOYMENT IN KOSOVO AFTER THE PANDEMIC (COVID 19)

Abstract

The rapid spread of COVID-19 and the restrictive measures are causing concern about the economic impacts. To ease the financial problems of citizens and businesses, the Government of Kosovo took measures to grant subsidies. The crisis has affected everyone, but especially the informal workers were unprotected in this situation. To understand the situation in more detail, the study aims to investigate the effect of the fiscal stimulus on the economic recovery in response to the challenges posed by the pandemic by reducing loss of jobs, informal employment and increasing the youth employment in Kosovo. The econometric model was built by regression analysis. The data collected were systematized and analyzed in the STATA program.

In accordance with the findings of our study is also the study by (Aliu, 2020) where he states that despite the fact that the institutions of Kosovo have approved the emergency package, as well as the package for economic recovery in response to the challenges posed by the pandemic, according to the participants in the study, it seems that the institutions not have done enough to support them during the pandemic, in terms of job loss and employing new staff. The questionnaire was conducted with employees in the private sector in Kosovo, who did not have employment contracts at the beginning of the pandemic. The results show that fiscal stimulus have a positive impact on the increase of formal employment.

The focus should be on the professional education of young people who are ready for the labor market, to subsidize small and medium-sized enterprises up to various tax exemptions in order to sustain them, as well as to monitor the black labor market (Gollopeni, 2015).

Keywords: Fiscal stimulus, employment, COVID-19, Kosovo

¹ Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia Veriore
E-mail: krenare.shahini@gmail.com

² Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia Veriore
E-mail: a.bexheti@seeu.edu.mk

³ Kolegji AAB, Kosovë
E-mail: donat.rexha@universitetiaab.com

1. INTRODUCTION

The Covid-19 pandemic has caused major economic shocks throughout the world. This shock has also attacked the economy of Kosovo. The impact of the pandemic and especially the closures to prevent the spread of the pandemic in the country have caused an unfavorable situation for everyone, especially for informal workers. In such situations, fiscal policy plays an important role in coping with the crisis, where through fiscal gaps it helps to pass the pandemic with less damage.

The COVID-19 crisis tests the sustainability of the rules-based fiscal framework. During the pandemic, governments have responded quickly and forcefully to save lives and avoid a sharper contraction (Davoodi, 2022).

In the context of economic growth and development policies, fiscal policy occupies a special place. The importance of this aspect is related to the fact that economic policy is directly or indirectly related to elements such as price stability, unemployment, investments, budget deficit and public debt, which occupy a central place in any academic debate about economic policies growth and development (Bexheti, 2017).

The (ILO, 2021) defines the "informal economy" (also known as the "gray" or "shadow" economy) as all economic activities carried out by workers and economic entities that are - in law or in practice – uncovered or insufficiently covered, covered by formal arrangements. Work in the informal economy is often associated with low wages and insecure working conditions. By definition, workers lack representation, the right to organize in associations and the right to be covered by social security (ILO, 2021). To formalize informal employment, time is needed, additional interventions or strategies are needed, which are a stimulus for improving the needs of workers.

The questions raised in this paper are:

Q1: Have the Government's fiscal packages positively influenced the increase in formal employment in Kosovo?

Q2: Are these contracts expected to be terminated after the end of the stimulation by the Government?

2. LITERATURE REVIEW

For workers who cannot find work in the formal sector, the informal economy acts as a shock absorber and provides alternative means of devising livelihood strategies (Khambule, 2020). Informality in the labor market has been researched by many authors such as: (Webb, 2022), (GOTO, 2021) (Khambule, 2022). There are estimates, but there are no data that show the size of the informal economy in Kosovo. For a short time, many researches have been carried out regarding the effect of the pandemic on the economy, specifically on the effect of the pandemic on the informal economy as well as on informal employment, but there is no measurable quantitative analysis on the effect of fiscal stimulus.

Informal employment is concentrated in countries with lower per capita income compared to countries with higher per capita income. Therefore, informality is a more widespread phenomenon in developing countries (Narula, 2020). Williams points out that the informal economy is not a remnant or remnant that exists in a few peripheral enclaves, but is a vast, omnipresent realm that employs the majority of the workforce in developing and transition economies (Williams, 2017). In addition to human suffering and loss of life, the pandemic generated a major global economic downturn, affecting every economy to varying degrees (Baldwin, 2020). The COVID-19 pandemic has negatively affected development trends in all the countries of the world that have been affected (Mehmeti, 2022). This pandemic has had a greater impact on those countries that have undeveloped economies and are not well financially, one such case where the economy is in transition is Kosovo and other countries of the Western Balkans, therefore in all these countries the COVID- 19 has had consequences on sustainable economic development. The COVID-19 pandemic has direct negative effects on the economy in various ways. Elgin conducted a comprehensive review of various economic policy measures adopted by 166 countries in response to the COVID-19 pandemic and created a large database including fiscal, monetary and exchange rate measures (Elgin C. W.-Y., 2022). In an economic crisis, countries with a higher share of informality face a much more challenging task with their fiscal policy (Estupinan, 2020). The COVID-19 pandemic is negatively affecting the health and economic sectors as well as social welfare. Thus, in developing countries, such as Kosovo, the COVID-19 pandemic has increased the stress of people, especially those who are

employed in the private sector due to their insecurity about their work and their salaries (Ziberi, 2021). In the study (Khambule, 2022) have pointed out that workers in the formal sector have greater ability to withstand economic shocks due to higher levels of social security and government interventions, while those in the informal economy and without social security face the greatest risk of falling in poverty and extreme poverty. Financial assistance from the government would be the most efficient method to provide greater relief to poor families during the COVID-19 lockdown. To mitigate the negative effects of public health controls on the economy and to support public welfare, governments have generally adopted expansionary economic packages, including fiscal, monetary/financial, and exchange policy measures (Elgin C. B., 2020). Highly indebted economies find it much more difficult to recover their long-term productivity losses – a function of the constraints on their fiscal and monetary policies due to high debt (Kose, 2020). Fortunately, Kosovo has a low level of public debt in relation to GDP and has sufficient flexibility in financing, and this enables it to have a favorable package for economic recovery (Shabani, 2021). According to the study (Sekiraqa, 2021) the government's policies regarding the financing of employee salaries have had an impact on the macroeconomic aspect by raising the income from pension contributions as well as the microeconomic aspect by ensuring the financial stability of families. Business entities have been urged to be more transparent as a result of the financing of employee salaries, and in order to take advantage of tax incentives, they have provided correct staff count disclosures. Study results from (Elgin C. W.-Y., 2022) demonstrate that countries implemented a much lesser fiscal policy package than those with a comparably bigger proportion of the informal economy.

2.1. Fiscal stimulus from Kosovo institutions in support of informal employment

Governments around the world implemented lockdowns to stop the spread of the coronavirus. According to the World Economic Forum, the Covid-19 pandemic could cause the worst economic meltdown since the Great Depression of the 1930s (Ayub, 2022).

Due to the COVID 19 pandemic and its social, political, economic, health effects and in order to prevent losses and harmful effects

in Kosovar society as a result of the restrictive measures to prevent the virus, the Government of Kosovo, on March 30, 2020, took a decision for the approval of the Fiscal Emergency Package with 15 measures.

Government assistance programs are designed to stimulate the growth of formal employment.

Measure 14 provides financial support of 130 euros for two months for commercial companies which, during the period of the public health emergency, register workers with a work contract of at least one year. This measure has a financial value of up to six million euros (Kosoves). In order for the employer to benefit from this measure, the contract must be signed after the beginning of the pandemic in Kosovo and be for a duration of not less than one year (Ministria e Financave dhe Transfereve). According to the Ministry of Finance and Transfers, nearly 15,000 workers have applied for benefits from Measure 14. The workers who applied to benefit from Measure 14 were mostly male and of young age, 15-24 years old (5,054), 40-54 years old (2,791), and over 55 years old (875).

3. METHODOLOGY

3.1. Sample and sampling

This study is based on data collected through a questionnaire (N=146). The sample was random and was carried out with the private sector, the informal economy. The questionnaire was implemented through Google Forms and shared with all those who stated that before the start of the COVID-19 pandemic in Kosovo, they did not have a regular employment contract or were not registered as a formal worker.

The questionnaire is designed in two sections, where in the first part, general demographic questions are included, and in the second part, questions that use a Likert scale with four statements: "Strongly agree", "Agree", "Disagree" and "Do not agree at all" related to the purpose of the study. Respondents were assured of their anonymity and confidentiality.

Table 1. Description of respondents' demographic data

Question	Frequency	Percentage
Gender	N	%
Man	116	20.55
Female	30	79.45
Age	N	%
18-30	87	59.59
31-40	44	30.14
41-50	15	10.27
Education	N	%
Primary	1	0.68
Secondary	64	43.84
University	81	55.48
What is the main source of income?	N	%
Wages	112	76.71
Business	20	13.70
Other	14	9.59

The table above presents the demographic data of the respondents participating in the research. According to the data presented, the majority of respondents (79.45%) belong to the male gender and to the age group of 18 to 30 years (59.59%). The same is explained for the unemployment rate from (Bellaqa, 2021) which is mainly the youth unemployment rate. The level of education of the respondents is mainly with a bachelor's degree (76.71%) and the main source of income is salary.

3.2. Instruments, data collection procedures and analysis

In order to have a clearer picture of the current situation, primary data were used through the questionnaire, which after completion was analyzed using econometric methods. The data were processed using the STATA program and then we continued with the comparative, analytical, correlational and regression analyses. In order to find the impact that fiscal stimulus have on the increase in formal employment, we took six variables: the increase in employment as a dependent variable, as well as five other independent variables, which are: business, fiscal stimulus, continued employment, informal employment and conditions of work which are created as indexes based on the questions of the questionnaire.

3.3. Econometric models

From the data we have in the research, the econometric model takes this form:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + \mu$$

When we substitute the variables we used in our model, we create the following equation:

$$\begin{aligned} \text{Increase in employment} = & \beta_0 + \beta \text{ (Business)} + \beta \text{ (Fiscal stimulus)} \\ & + \beta \text{ (Continuation of employment)} + \beta \text{ (Informal employment)} + \beta \\ & \text{(Work conditions)} + \mu_i \end{aligned}$$

3.4. Cronbach's alpha

In our analysis (Table 2), it can be seen that Cronbach's alpha is 0.8427, which expresses a high level of internal consistency of the variables.

Tabela 2. Cronbach's alpha

Cronbach's alpha	No. of items
0.8427	16

4. RESULTS

Regarding the question "During the pandemic I signed a work contract with employers" where, in addition to the results, a division was made according to the level of education and the chi-square test was presented to identify significant statistical differences and based on the result there is no significant difference statistical difference regarding the level of education with the signing of the contract during the pandemic, while there is a significant statistical difference regarding the level of education and the continuation of the contract after the cessation of stimulus by the government. For female workers with a medium level of education (56.25%), their work contracts will continue even after the cessation of stimulus, while 43.75% are skeptical that their contracts will continue after the termination of the fiscal stimulus by the government, while workers with high level of education 82.72% affirm that the contracts will not be terminated while only 17.28% think that the work contracts will not continue after this period.

Table 3. Results by level of education

Question	Primary	Secondary	University	Significant differences
During the pandemic, I signed the employment contract with the employers	N	N	N	Chi-square
I completely agree	0	22	35	P=0.389
Agree	1	14	12	
I do not agree	0	15	20	
I do not agree at all	0	13	14	
The employment contract with the employer will continue even after the cessation of subsidies	N	N	N	Chi-square
I completely agree	0	28	40	P=0.001
Agree	0	8	27	
I do not agree	1	21	7	
I do not agree at all	0	7	7	

The strength of the linear relationship between two variables is assessed by correlations. From -1.0 (a perfect negative correlation) to 1.0, the correlation coefficients (a perfect positive correlation). Between -1.0 and 1.0 are the values for close correlation coefficients; the closer the value is to 1.0, the stronger the correlation. The relationship between two variables becomes weaker as a correlation coefficient approaches zero.

Table 4. Correlation analysis

	Incr ease in employment	Business	Fiscal stimulus	Continuation of employment	Informal employment	Work conditions
Increase in employment	1					
Business	0.7385	1				
Fiscal stimulus	0.6219	0.6129	1			
Continuation of employment	0.5987	0.7442	0.5786	1		
Informal employment	0.4654	0.3429	0.5105	0.1718	1	
Work conditions	0.2714	0.3227	0.6226	0.1245	0.4229	1

Correlation analysis, based on the coefficients presented in this table, show that we have a positive relationship of all independent variables with the dependent variable (increase of employment). In order to see the impact of these five factors on the increase of formal employment, then in the following we will present the regression analysis. Based on the presented analysis of the coefficient of determination (R-squared), the increase in employment is explained by 63.21% of the independent variable.

Of the five independent variables, four of them are significant since the P value of these four variables is less than 0.05, while the variable of continued employment does not show a statistically significant impact on the increase in employment since the P value is more higher than 0.05.

Table 5. Regression analysis

Prob>F=0.0000

R-squared=0.6321

Adj R-squared=0.6189

Increase in employment	Coef.	Std. Err.	t	P>t	95% Coef. Interval	
Business	0.515	0.082	6.28	0	0.353	0.677
Fiscal stimulus	0.163	0.054	3.01	0.003	0.056	0.271
Continuation of employment	0.023	0.065	0.35	0.725	-0.106	0.152
Informal employment	0.324	0.097	3.34	0.001	0.132	0.517
Work conditions	-0.086	0.038	-2.26	0.026	-0.162	-0.01
Cons	-0.143	0.38	-0.38	0.708	-0.896	0.609

Interpretation of coefficients: (Ceteris Paribus)

For every 1 additional value in the business index, the employment growth index increases by 0.51 units on average.

For every 1 additional value in the fiscal stimulus index, the employment growth index increases by 0.16 units on average.

For every 1 additional value in the employment continuation index, the employment growth index increases by 0.23 units on average.

For every 1 additional value in the informal employment index, the employment growth index increases by 0.32 units on average.

For every 1 additional value in the working conditions index, the employment growth index decreases by 0.86 units on average.

Table 6. Testing for multicollinearity

Variables	VIF	1/VIF
Business	3.2	0.312
Fiscal stimulus	2.93	0.340
Continuation of employment	2.69	0.372
Informal employment	1.96	0.510
Work conditions	1.46	0.686
Mean VIF	2.45	

The VIF test is presented in order to test the data for multicollinearity, according to the data, multicollinearity exists between the variables, but it is within the allowed norms since the mean of the VIF is less than 10.

5. DISCUSSIONS

The main focus of the study is to highlight the effect of the fiscal stimulus on the increase in formal employment in Kosovo after the pandemic period.

Young workers without work experience cannot find formal companies willing to hire them, they are employed in the informal sector as they gain experience.

Based on the findings of the study that made us understand that a large percentage in our country, regardless of their education, have not been able to find an adequate job based on their profession, but are forced to work regardless of whether or not they have a contract work. The focus should be on the professional education of young people who are ready for the labor market, to subsidize small and medium-sized enterprises up to various tax exemptions in order to sustain them, as well as to monitor the black labor market (Gollopeni, 2015). In accordance with the findings of our study is also the study by (Aliu, 2020) where he states that despite the fact that the institutions of Kosovo have approved the emergency package, as well as the package for economic recovery in response to the

challenges posed by the pandemic, according to the participants in the study, it seems that the institutions not have done enough to support them during the pandemic and that most of them have not benefited from the measures of the emergency package as well as the economic recovery package. The study contributes to the assessment of the increase in formal employment through emergency measures by the government in the time of covid 19. According to the findings of this study, all dependent variables have a positive impact on the increase in formal employment, so the study shows that the government's financial assistance plays a role important in increasing formal employment in Kosovo.

(Igan, 2022) They point out that overall, the evidence shows that fiscal stimulus packages are more effective than other policies during the COVID-19 pandemic.

6. CONCLUSIONS

Apart from the health sector, the Covid-19 pandemic had an impact on all spheres of life. The closure of many sectors of the economy has the effect of creating insecurity among all employees in the country, and it is obvious that non-formal workers were among the most affected due to the insecurity of the workplace. Economic activity was deliberately reduced during the pandemic to slow the spread of the virus and ease the burden on public health services. During this time, fiscal stimulus packages were put in place to help businesses and people.

Because the informal economy is characterized by hindering access to accurate and reliable data about it, its measurement or evaluation is one of the biggest challenges and difficulties faced by economists and researchers in various fields.

This action could have influenced the formalization of the labor market. Therefore, a more thorough consideration of this action could result in a long-term strategy that encourages private businesses to register their staff.

Informal workers face several obstacles in their transition to a new normal, such as socio-economic circumstances and socio-emotional conditions, it is essential to reassess how equipped the current structure of the informal sector is for future situations and obstacles.

From the findings of the study, we understood that the Government's fiscal stimulus has a positive impact on the increase of formal employment and that the steps adopted by Kosovo's institutions can

become long-term government policies with a current assessment of the financial cost.

RÉSUMÉ

La propagation rapide du COVID-19 et les mesures restrictives suscitent des inquiétudes quant aux impacts économiques. Afin de soulager les problèmes financiers des citoyens et des entreprises, le gouvernement du Kosovo a pris des mesures pour accorder des subventions. La crise a touché tout le monde, mais ce sont surtout les travailleurs informels qui n'ont pas été protégés dans cette situation. Pour comprendre la situation plus en détail, l'étude vise à examiner l'effet de la stimulation fiscale sur la reprise économique en réponse aux défis posés par la pandémie en réduisant la perte d'emplois, l'emploi informel et l'empreinte des jeunes au Kosovo. Le modèle économétrique a été construit par analyse de régression. Les données collectées ont été systématisées et analysées dans le programme STATA.

En accord avec les résultats de notre étude est également l'étude par (Aliu, 2020) où il affirme que malgré le fait que les institutions du Kosovo ont approuvé le paquet d'urgence, ainsi que le paquet pour la reprise économique en réponse aux défis posés par la pandémie, selon les participants à l'étude, il semble que les institutions n'ont pas fait assez pour les soutenir pendant la pandémie, en termes de perte d'emploi et l'embauche de nouveaux employés. Le questionnaire a été réalisé auprès d'employés du secteur privé au Kosovo, qui n'avaient pas de contrat de travail au début de la pandémie. Les résultats montrent que les mesures de relance budgétaire ont un impact positif sur l'augmentation de l'emploi formel.

L'accent devrait être mis sur l'éducation professionnelle des jeunes qui sont prêts pour le marché du travail, pour subventionner les petites et moyennes entreprises jusqu'à diverses exonérations fiscales afin de les soutenir, ainsi que pour surveiller le marché noir du travail (Gollopini, 2015).

Mots clés: Stimulation fiscale, emploi, COVID-19, Kosovo.

Abstrakt

Përhapja e shpejt e COVID-it dhe masat restriktive kanë nxitur shqetësime sa i takon impaktit ekonomik. Për t'i zbutur problemet financiare të qytetarëve dhe ndërmarrjeve, qeveria e Kosovës ka marrë masa për dhënien e subvencioneve. Kriza i ka prekur të gjithë, por sidomos punëtorët joformalë, të cilët kanë mbetur të pambrojtur brenda kësaj situate. Për ta kuptuar më hollësisht situatën, studimi mëton të ekzaminojë efektin e stimulimit tatimor mbi rimëkëmbjen ekonomike si përgjigje ndaj sfidave që janë nxitur nga pandemia duke reduktuar humbjet e vendeve të punës. Modeli ekonometrik ka qenë i ndërtuar me analizën e regresionit. Të dhënat e mbledhura janë sistematizuar dhe analizuar në programin STATA.

Në pajtim me rezultatet e studimit tonë nga (Aliu, 2000) ku ai pohon se me gjithë faktin se institucionet e Kosovës e kanë aprovuar pakon urgjente sikurse edhe pakon për rimëkëmbjen ekonomike si përgjigje ndaj sfidave që i ka nxitur pandemia, sipas pjesëmarrësve të studimit, duket se institucionet nuk i kanë mbështetur sa duhet gjatë pandemisë. Pyetësi është realizuar me të punësuarit e sektorit privat në Kosovë, të cilët nuk kishin kontratë pune në fillim të pandemisë. Rezultatet tregojnë se masat e rimëkëmbjes buxhetore kanë një impakt pozitiv mbi rritjen e punësimit formal.

Fjalët çelës: Stimulimi fiskal, punësimi, covid-19, Kosova.

REFERENCES

- [1] Aliu, Y. T. (2020). COVID-19 AND LABOUR MARKET IN KOSOVO4. *Group [WBG]*, 19-24.
- [2] Ayub, M. S. (2022). The Impact of Government Stimulus Packages Towards Business Survival During Covid-19 Among Small and Medium Enterprises in Sabah. *Asian Journal of Research in Business and Management*, 4(1), 98-109.
- [3] Baldwin, R. &. (2020). In *Economics in the time of COVID-19*. VOX CEPR Policy Portal, 2-3.
- [4] Bellaqa, B. &. (2021). YOUTH EMPLOYMENT AND UNEMPLOYMENT RATES IN KOSOVO. *Corporate Governance and Organizational Behavior Review*, 212-224.
- [5] Bexheti, A. (2017). *Financat Publike*. Tetovë.
- [6] Davoodi, H. E. (2022). *Fiscal Rules and Fiscal Councils: Recent Trends and Performance during the COVID-19 Pandemic*. International Monetary Found.
- [7] Elgin, C. B. (2020). Economic policy responses to a pandemic: Developing the COVID-19 economic stimulus index.. *Covid Economics*, 40-53.
- [8] Elgin, C. W.-Y. (2022). Fiscal stimulus packages to COVID-19: The role of

- informality.. *Journal of International Development*., 861-879.
- [9] Estupinan, X. &. (2020). Job and wage losses in informal sector due to the COVID-19 lockdown measures in India.. *SSRN* 3680379.
 - [10] Gollopeni, B. K. (2015). Demographic characteristics of the unemployed in Kosovo, in the first decade of the XXI century. (pp. 46-50). Proceedings of the 4-th International Multidisciplinary Conference on Integrating Science in New Global Challenges.
 - [11] GOTO, K. (2021). Labor Markets in asia and the inforMaL econoMy during the coVid-19 PandeMic. *Major Issues in the Asia-Pacific Region*.
 - [12] Igan, D. M. (2022). *stimulus packages and firm performance during Covid-19*. Bank for International Settlements.
 - [13] ILO. (2021). *Vlerësimi i Masave të Sigurimeve Shoqërore në Përgjigje të Covid-19: Mësim nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë*. Budapest: ILO.
 - [14] Khambule, I. (2020). The effects of COVID-19 on the South African informal economy: limits and pitfalls of government's response. *Loyola Journal of Social Sciences*, 34(1), 95-109.
 - [15] Khambule, I. (2022). COVID-19 and the informal economy in a small-town in South Africa: governance implications in the post-COVID era.. *Cogent Social Sciences*, 8(1), 2078528.
 - [16] Kose, M. A. (2020). Caught by a cresting debt wave: Past debt crises can teach developing economies to cope with COVID-19 financing shocks. *Finance & Development*.
 - [17] Kosoves, Q. e. (n.d.). *Pakoja Emergjente Fiskale*. Retrieved from <https://bit.ly/35Zj9cW>
 - [18] Mehmeti, I. a. (2022). Economic trends in times of Pandemics: Kosovo case. *International Journal of Business Ecosystem and Strategy* (2687-2293), 77-86.
 - [19] Ministria e Financave dhe Transfereve, M. 1. (n.d.). Retrieved from <https://bit.ly/2M8QCZA>
 - [20] Narula, R. (2020). Policy opportunities and challenges from the COVID-19 pandemic for economies with large informal sectors. *J Int Bus Policy* 3, 302-310.
 - [21] Sekiraga, A. S. (2021). The impact of COVID-19 on Collecting of Tax Revenues in Kosovo. *EDP Sciences*.
 - [22] Shabani, H. &. (2021). IMPACT OF SARS-COV-2 ON THE ECONOMY OF KOSOVO. *KNOWLEDGE-International Journal*, 46(5), 737-741.
 - [23] Webb, A. M. (2022). Employment in the informal economy: implications of the COVID-19 pandemic.. *International Journal of Sociology and Social Policy*, 1005-1019.
 - [24] Williams, C. C. (2017). Tackling employment in the informal economy: A critical evaluation of the neoliberal policy approach.. *Economic and Industrial Democracy*, 38(1), 145-169.
 - [25] Ziberi, B. R. (2021). THE IMPACT OF COVID-19 ON THE CONSUMERS'BEHAVIOUR: THE CASE OF REPUBLIC OF KOSOVO ECONOMY.. *Journal of Governance and Regulation*/Volume, 10(2).

Gjergji Shuka, Paris

NËNSHTRESA NË TRI KËNGË TË CIKLIT TË KOSOVËS

Abstrakt

Objekti i këtij studimi janë tri këngë të ciklit epik të Kosovës, të lëndëve serbe, hercegovinase dhe shqiptare, informacionet e të cilave i kam seleksionuar dhe krahasuar me tekstet historike mesjetare relative ndaj Betejës së parë të Fushë Kosovës në vitin 1389 dhe historisë bizantine të kalimshekujve VI-VII. Paralelet e paraqitura në numër të lartë, me historinë bizantine janë shpjeguar me hipotezën e ekzistencës së një procesi transpozimesh mes të dhënave, përgjithësisht të rrafshit onomastik, në raport me konfliktin e fundshekullit XIV dhe një strukturë të mëhershme epike të ndërtuar për transmetimin e historisë së rënies nga pushteti të dinastisë së justinëve. Njëkohësisht përmbajtja nënshtresore bizantine mundëson shpjegimin e të gjitha pasaktësive historike dhe motiveve irracionale prezente në të tri këngët.

Fjalët çelës: Beteja e Kosovës, epika, car Lazari, Murik Tiberi, historia bizantine, studim krahasues.

Cikli¹ epik i Kosovës i referohet betejës së 15 qershorit 1389 në Fushë Kosovë, në të cilën u përballën një koalicion të krishterësh ballkanikë nën drejtimin e princit serb Lazar Hrebeljanoviç (Lazar Hrebeljanović; r.1329-1389) dhe ushtritë osmane të sulltan Muratit I (Murad I; 1326-1389). Deri në shekujt XIX-XX, periudhën e transkriptimit të epikës sllavojugore dhe shqiptare, në kujtesën orale popullore janë ruajtur një numër i lartë të dhënash me zanafillë në ngjarjet dhe kontekstin e fundshekullit XIV, por njëkohësisht mes vargjeve ndeshen informacione të shumta që paraqesin paralele me historinë e perandorit Murik Tiberi (Mauricius Tiberius; - 602), sundimtarit të fundit të dinastisë bizantine të justinëve.

Për të kuptuar relacionet intertekstuale me historinë bizantine janë studiuar nëpërmjet metodës së analizës krahasuese tre këngë:

¹ Ky studim është zhvilluar prej një baze më të kufizuar, botuar në: SHUKA, Gjergji. *Tridhjetë Këngë Dhe Legjenda Ballkanike: Studim Mbi Origjinën Historike*. Tiranë: Naïmi, 2015, ff. 527-555.

serbja „Rënia e perandorisë serbe“ („Propast carstva Srpskoga“)², hercegovinasja „Car Lazari dhe caresha Milica“ („Car Lazar i carica Milica“)³ dhe kënga shqiptare „Kënga e Luftës së Kosovës“⁴. Për të lehtësuar krahasimin, tekstet orale dhe historike i kam ndarë fillimisht në fraza të shkurtra përcjellëse të minimumit të informacioneve⁵ dhe më tej, duke u mbështetur në rezultatet e mëparshme të folkloristikës ballkanike⁶, është propozuar: origjina e nënshtresës së këngëve dhe disa përfundime relative ndaj evoluimit të informacioneve në kontekstin e transmetimit oral përgjatë shekujve.

KËNGËT

Studiuesit e epikës ballkanike kanë dalluar se cikli epik i Kosovës ka nisur të zhvillohet në një kohë jo të largët prej ngjarjeve të betejës⁷ dhe njëkohësisht kanë vënë re ndryshime të konsiderueshme mes grupeve shqiptare dhe sllavojugore, ndaj është arritur në përfundimin se janë kënduar veçmas prej një kohe gjithashtu të hershme.⁸ Dy rrëfenjat sllavojugore janë mjaft të njohura, të dashura dhe pjesëza të rëndësishme të kulturës sllavojugore. Gjatë shekujve të sundimit osman përmes transmetimit të gjesteve të heronjve që luftuan në vitin 1389 në Fushë Kosovë, lahutarët kanë transmetuar njëkohësisht kujtesën e një shteti të pavarur serb duke frymëzuar kryengritjet antiosmane dhe duke

² KARADŽIĆ Vuk. S. *Srpske narodne pjesme, knjiga II*. Vienna: Stamparija Jermenskoga Manastira, 1845. n. 46. Një përkthim në gjuhën angleze mund të konsultohet në: HOLTON, Milne; MIHAILOVICH, Vasa D. *Songs of the Serbian People From the Collections of Vuk Karadzic*. Pittsburgh: University of Pittsburgh Press, 2014, ff. 147-150.

³ KARADŽIĆ, 1845, n. 45. Për një përkthim në gjuhën angleze: HOLTON and MIHAILOVICH, 2014, ff. 140-146.

⁴ HAXHIHASANI, Qemal. *Epika Historike, vëllimi I*. Tiranë: Instituti i Kultures Popullore, 1983, ff. 61-65.

⁵ Frazat u seleksionuan sipas shembullit të mitemave të dalluara nga Claude Lévi-Strauss. LÉVI-STRAUSS, Claude. « *La structure des mythes* » in: *Anthropologie structurale*. Paris: Plon, 1958.

⁶ Veçanërisht kërkimet e studiuesve Milman Parry dhe Albert Lord, në: LORD, Albert. B. *The Singer of Tales*. Cambridge: Harvard University Press, 1971.

⁷ FINE, John. V. A. *The late medieval Balkans: a critical survey from the late twelfth century to the Ottoman Conquest*. Ann Arbor: University of Michigan Press, 1987, ff. 408-9.; MALCOLM, Noel. *Kosovo: A Short History*. New York: New York University Press, 1998, ff. 69.

⁸ FOLEY, John. M. *The Theory of Oral Composition: History and Methodology*. Bloomington: Indiana University Press, 1988, ff. 54.

ndihmuar në lindjen e formacioneve shtetërore moderne sllavojugore. Në këngën më pak të njohur shqiptare ngjarjet shihen prej perspektivës myslimane: heroi qendror është sulltan Murati, ndërsa narrativa mbetet relativisht e paanshme, pa ngarkesa negative për personazhet kundërshtarë.

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e tre këngëve.

Rënia e perandorisë serbe

Vargjet e para nisin me rrëfimin, në formën e antitezës sllave, për mbërritjen e një letre drejtuar perandorit Lazar. Ajo është dërguar nga qyteti i Jerusalemit prej Hyjlindëses (Bogorodica) dhe sillet prej Shën Elisë të krahasuar metaforikisht me një sokol që mban mbi krahë një dallëndyshe. Në letër Lazarit i kërkohet të zgjedhë nëse dëshiron të jetojë dhe të vijojë sundimin mbi mbretërinë serbe apo dëshiron jetën e përjetshme në Mbretërinë e Qiejve. Nëse zgjedh jetën atëherë duhet të sulmojë i pari me kalorësinë dhe në këtë mënyrë do ta fitojë betejën që po afron në Fushë Kosovë (Kosovo Polje); nëse zgjedh shenjtërimin dhe Mbretërinë e Qiejve perandori duhet të ndërtojë një kishë me themele mëndafshi të kuq, të bekojë dhe të rreshtojë ushtrinë. Luftëtarët serbë do të humbasin betejën dhe jetën, por shpërblimi i sakrificës ekstreme është pranimi mes shenjtoreve.

Përgjatë luftimeve të zhvilluara në shkallë të parët përballen me turqit fisniku Bogdan dhe nëntë djemtë e tij. Nëntë vëllezërit Jugoviç (Jugović) drejtojnë nëntë formacione të përbëra secila prej nëntë mijë ushtarësh ndërsa Bogdani - dymbëdhjetë mijë luftëtarë. Princat krahasohen me nëntë sokola gri. Ata mposhtin ushtritë e shtatë pashallarëve turq, por nuk ia dalin kundër pashait të tetë dhe vriten bashkë me luftëtarët e tyre. Pas Jugoviçëve vriten tre vëllezërit Mrnjavçeviç (Mrnjavčević): Vukashini (Vukašin) Ugljesha (Uglješa) dhe Gojko. Ushtria e tyre, e kompozuar nga tri formacione me tridhjetë mijë ushtarë secila, ka arritur të mposhtë tetë ushtri turke. Ndryshe nga sa ndodh me heronjtë e tjerë për Vukashinin transmetohen informacione mbi mënyrën e vdekjes: sundimtari serb është plagosur rëndë dhe më pas është shkelur nën këmbët e kuajve turq. Në vijim lufton dhe vritet dukë Stefani (Erceže Stepane) me ushtrinë e tij prej gjashtëdhjetë mijë luftëtarësh. Përpara se të humbë jetën Stefani ka mposhtur ushtri të shumta pashallarësh kundërshtarë. I fundit hyn në betejë dhe vritet perandori Lazar me shtatëdhjetë e shtatë mijë luftëtarë. Turqit e mposhtin dhe fitojnë

Betejën e Kosovës falë ndihmës së tradhtarit Vuk Branković (Vuk Branković). Kënga përfundon me një mallkim për Vukën dhe informacionin për shenjtërimin e perandorit.

Car Lazari dhe caresha Milica

Në fillim të këngës „Car Lazari dhe caresha Milica“ përshkruhet një skenë banketi, gjatë së cilës perandoresha i kërkon të shoqit, të emërtuar me metaforën *kurorë e artë e Serbisë*, që t'i ndalojë pjesëmarrjen në luftë njërit prej nëntë vëllezërve të saj. Si të gjithë burrat e kështjellës së Krushevacit (Kruševac) nëntë Jugoviçët do të nisen të nesërmen në mëngjes drejt Fushë Kosovës dhe Milica kërkon që të paktën njërit prej tyre të mos i rrezikohet jeta. Lazarit i thotë se i duhet një vëlla i gjallë për të cilin do të betohet dhe një arsye e dytë, ose një justifikim, është nevoja për një lajmëtar që do të dërgojë dhe sjellë letrat e perandorit në Krushevac. Lazari pranon, e shoqja zgjedh Boshkon (Boško) dhe të nesërmen, *kur dita agon dhe dielli bie poshtë*, ajo vendoset ta presë anës portave të qytetit. Boshkua iu prin trupave serbe hipur mbi një kalë të mbuluar me një cohë e artë. Teshat e heroit janë po ashtu të praruara. Mbi to janë qëndisur kryqe të arta dhe ai mbulohet nga një flamur me kryq, emblema e të cilit është një mollë e artë. Prej mollës dalin kryqe të tjerë me theka që i bien mbi shpatulla. Milica i mban frerët e kalit, i hedh krahun në qafë dhe i lutet që të mos shkojë në Kosovë. Vetë perandori i përcjell bekimin nëpërmjet saj dhe i kërkon që t'ia lërë flamurin dikujt tjetër. Boshkua nuk e dëgjon: nëse ai e braktis fushatën serbët do të mendojnë që ka frikë të derdhë gjakun për Krishtin dhe për nderin e Kryqit. Gruaja e pafuqishme sheh të kalojnë portën pa e përfillur edhe i ati, Jug Bogdani, bashkë me shtatë prej nëntë vëllezërve. Larg pas tyre dallon vëllanë e vogël, Vojinin, tek tërheq kuajt e veshur në ar të perandorit. E ndal Vojinin dhe i kërkon të qëndrojë me të në Krushevac. Sa për kuajt, - për ta le të kujdeset dikush tjetër. Përgjigja është e njëjtë: Vojini preferon të vdesë për Krishtin dhe nuk ka ndërmend t'i braktisë vëllezërit. Ndërsa ai kalon portën e qytetit, perandoresha bie pa ndjenja *në gurin e ftohtë*. Lazari e sheh, përletot dhe urdhëron shërbyesin e tij, Golubanin, ta marrë në krahë dhe ta çojë në *kullën e bardhë*. Shërbyesi përletot kur kupton se qëndrimi pranë perandoreshës do t'i ndalojë pjesëmarrjen në betejë. Zbaton vetëm pjesërisht urdhrin; pasi shoqëron Milicën në pallat shalon kalin dhe niset drejt Fushë Kosovës.

Të nesërmen në agim dy korba të zinj janë ulur mbi kullën e Lazarit. Milica i pyet nëse vijnë prej Kosovës dhe nëse kanë parë atje një betejë mes dy ushtrive të mëdha. Zogjtë pohojnë dhe i tregojnë se beteja që kanë parë ishte mjaft e ashpër. Në të kanë humbur jetën shumica e luftëtarëve dhe vetë dy prijësit kundërshtarë. Pas korbave lajmin e keq vjen ta konfirmojë shërbyesi Milutin. I plagosur rëndë dhe i mbuluar në gjak, ai po mban në dorën e majtë krahun e djathtë të prerë. Milica e pyet fillimisht nëse e ka tradhtuar carin dhe më pas për fatin e familjarëve të saj dhe të fisnikëve serbë. Shërbyesi nuk i përgjigjet. Perandoresha e ndihmon të zbresë nga kali, i jep verë të kuqe dhe i pastron plagët. Atëherë Milutini i tregon se të gjithë fisnikët dhe shumica e luftëtarëve kanë humbur jetën. Lazari prehet mes heshtave të shumta të thyera; i ati i perandoreshës dhe tetë vëllezër të saj janë vrarë gjatë luftimeve të para, së bashku, pa u ndarë dhe pa e tradhtuar njëri-tjetrin; ndërsa Boshkua i mbetur vetëm ka shkatërruar radhët e ushtrive turke, si një një sokol që shpërndan tufa të trembura pëllumbash. Pas Jugoviçëve janë vrarë Ban Strahinja dhe Milloshi (Miloš). Trupi i Miloshit prehet pranë lumit Sitnica, mes të të rënëve të shumtë turq. Përpara se të humbë jetën Miloshi ka vrarë sulltan Muratin dhe dymbëdhjetë mijë kundërshtarë. Milutini e bekon Miloshin, kujtimi i të cilit do të mbetet gjithnjë i lavdishëm për serbët dhe mallkon Vukun, paraardhësit dhe trashëgimtarët e tij, pasi Vuku dhe dymbëdhjetë mijë luftëtarë të zemëruar kanë tradhtuar perandorin.

Kënga e Luftës së Kosovës

Në variantin shqiptar është sulltani që lajmërohet prej hyjnive për sakrificën dhe shenjtërimin. Murati sheh në ëndërr sesi dielli dhe hëna bien në det, ndërsa yjet bien në tokë. Ai ngrihet i frikësuar dhe megjithëse është mesnatë kërkon t'i sjellin: kryeklerikun, komandantin e rojeve të pallatit, kryevezirin dhe dinetakbixhinë (interpretuesin e ëndrrave). Të katërt nxitojnë për te dhoma mbretërore. Sulltani ua tregon ëndrrën dhe i pyet nëse dikush ia di kuptimin. Zyrtarët qëndrojnë kokulur për një kohë të gjatë, derisa heshtja thyhet nga dinetakbixhia. Ëndrra është një ogur i keq: rënia e diellit paralajmëron rënien martir të Muratit (nëse sulltani humb jetën dielli nuk bën më dritë), ndërsa rënia e hënës, - vrasjen e kryevezirit. Të nesërmen në agim Murati nisat prej Shqipërisë në krye të një ushtrie prej tridhjetë mijë vetash dhe pushton qytetet e Selanikut dhe Shkupit. Pas sukseseve të para turqit pësojnë humbje dhe ndalen për tri ditë në grykën e Kaçanikut. Mes të vrarëve

është vetë kryeveziri. Turqit arrijnë të kalojnë në ditën e katërt dhe pushtojnë qytetin e Ferizajt. Ndalesa e dytë treditore ndodh në Prishtinën e përshkruar si një vend me shtatë kulla në kodra. Aty njihemi me kundërshtarët: shtatë bajlozë dhe prijësi i tyre, Miloshi. Nëpërmjet një letre sulltani i kërkon Miloshit të pranojë dorëzimin pa luftuar ose përndryshe Kosova do të shkatërrohet. Prijësi armik i përgjigjet, nëpërmjet një letre, me kërkesën për tri ditë kohë gjatë së cilave do të këshillohet me njerëzit e tij. Pas tri ditësh vendos përfundimisht të luftojë, mbledh ushtarët dhe i pozicionon në malin Kuka. Fillimisht kosovarët kanë sukses dhe përpjekjet e turqve për të kaluar qafën e malit përfundojnë me humbje të shumta. Sulltani mallkon bjeshkët duke i kërkuar Zotit që t'i shkretojë dhe që në të ardhmen në to të mos dëgjohet më as kënga e zogjve. Mallkimi realizohet: Zoti dërgon një vetëtimë e cila rrëzon lisat, shkreton vendin dhe vret ushtarët kundërshtarë.

Miloshi i veshur me një pancir të papërshkrueshëm nga armët kalëron mes radhëve turke dhe arrin përpara sulltanit, të cilin e qëllon fillimisht me shkelm dhe më pas e vret me një goditje hanxhari në këmbë. Më pas ai do të rrethohet dhe sulmohet nga të gjitha anët, por turqit nuk arrijnë ta mposhtin. Një grua shkinë (fjalë polisemike e cila ka në shqipe kuptimet: sllave, shërbyese, skizmatike⁹) e quajtur Babinosha i këshillon turqit të vendosin kosa në sokak në mënyrë që t'i plagosin këmbët e kalit. Dhe ndodh siç e kishte parashikuar gruaja: kalit i priten këmbët, heroi armik bie prej tij, por edhe ndërsa lufton në këmbë arrin të jetë sërish i suksesshëm. Babinosha këshillon t'ia hapin armaturën me një çelës të fshehur në përkrenare dhe nëpërmjet kësaj gjetjeje zihet më në fund rob. Miloshi kërkon të flasë me gruan për t'i lënë një amanet. Pasi Babinosha afrohet ai hakmerret duke ia prerë fytyrën me dhëmbë. Kënga mbyllet me rrëfimin për vdekjen e luftëtarëve të tjerë të shumtë, shkatërrimin e Kosovës dhe ndërtimin e varrit monumental të sulltanit.

Historia dhe legjendat

Me zhvillimin e studimeve moderne mbi historinë mesjetare ballkanike janë vënë re mospërputhje mes një pjese të motiveve të këngëve

⁹ DEMIRAJ, Bardhyl. “Kur etnikët tregojnë: Shqa-u ndër shqiptarë”, në: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. *Studime*, 16-17. Prishtinë, 2009-2010, ff. 233; 240-241.

dhe dëshmime të shkruara bashkëkohore me betejën. Fillimisht prej klerikut dhe studiuesit Ilarion Ruvarac (1832 - 1905), themelues i shkollës kritike të historiografisë serbe, i cili do të kundërshtonte doktrinën dominante të kohës së tij të mbështetur gjerësisht në traditën orale duke konstatuar se ndryshe nga çfarë rrëfëhet prej këngëve: dy personazhe të ciklit të Kosovës, mbreti Vukashin Mrnjavčević (Vukašin Mrnjavčević; r., 1320 -1371) dhe i vëllai despoti Ugljesha Mrnjavčević (Ugljesa Mrnjavčević; -1371), nuk mund të kenë qenë në Kosovë në vitin 1389; se nuk ka asnjë provë historike për tradhtinë e princit Vuk Branković (Vuk Branković; 1345-1397); se sundimtari serb Lazar Hrebeljanović nuk kishte titull perandori; dhe se personazhet e Jug Bogdanit dhe nëntë djemve të tij nuk janë historikë.¹⁰ Pas Ruvarac, studiuesi malazez Nikola Banašević ka dalluar se motive të tjera të këngëve të Ciklit të Kosovës paraqesin paralele me motive të poemave epike të lëndës së Francës; përkatësisht të Epit të Rolandit dhe të “Chançon de Willame” të ciklit të Guillaume d'Orange.¹¹ Dy poemat franceze janë tekstualizuar mes shekujve XI-XII ndaj informacionet korrespondente nuk mund të jenë veçse më të hershme se ngjarjet e vitit 1389.

Beteja e parë e Kosovës

Nëse një pjesë e rëndësishme e informacioneve të transmetuara oralisht nuk e ka origjinën në historinë e konfliktit të vitit 1389, një pjesë tjetër relevante korrespondon me të dhënat historike. Siç rrëfëhet prej kujtesës popullore vendi i betejës ndodhej pranë bashkimit të rrjedhave të lumenjve Sitnica dhe Llap, në Fushë Kosovë, në veriperëndim të

¹⁰ RUVARAC, Ilarion. *O knezu Lazaru*. Стражилово, No. 3, 1887.

¹¹ Afërsi me traditën franceze paraqet episodi i darkës përpara betejës gjatë së cilës prijësi ngre dollari për nderimin e tradhëtarit dhe fyen heroin e vërtetë. Është e njëjta ide e ndeshur në vargjet 90-97 të “Chançon de Willame”, dhe në dy këngë serbe: atë „Kur Princi Lazar dhe Millosh Obiliçi vdiqën në Kosovë“ (“Кад је погинуо кнез Лазар и Милош Обилић на Косову”); dhe në një këngë të prej së cilës folkloristi Vuk Karadžić ka mbajtur mend nga fëmijëria vetëm një pjesë, të transkriptuar bashkë me fragmente të tjera këngësh të Ciklit të Kosovës nën titullin „Pjesë të këngëve të ndryshme të Kosovës“ (“Komadi od razliĉnijeh Kosovskijeh pjesama”). Për Banasević një paralele e dytë mes lëndëve epike franceze dhe sllavojugore është motivi i *kërkesës për ndihmë prijësit përpara se heroi të vritet*, i cili dallohet njëkohësisht në këngën „Kur Princi Lazar dhe Millosh Obiliçi vdiqën në Kosovë“ dhe në Poemën e Rolandit. BANAŠEVIĆ, Nikola. “*Le cycle de Kosovo et les chansons de geste*” in: *Revue des Etudes Slaves*, tome 6, 3-4. Paris: Imprimerie nationale, 1926, ff. 224-44.

kryeqytetit të Prishtinës.¹² Lazar Hrebeljanoviçi nuk e ka pasur titullin e perandorit, por zotërimi i tij - i shtrirë në territoret e sotme të Serbisë Qendrore dhe Jugore, me kryeqendër qytetin e Krushevacit - ishte shteti më i fuqishëm dhe më i pasur serb i kohës. Në Fushë Kosovë i ishte bashkuar dhëndri, princi Vuk Brankoviç dhe një kontigjent boshnjak i dërguar prej mbretit Tvërko I (r. 1338-1391) dhe i drejtuar nga gjenerali Vlatko Vukoviç (Vlatko Vuković; -1392/93). Pjesa kryesore e luftëtarëve ishin serbë dhe boshnjakë. Përveç tyre burimet e kohës përmendin formacione aleate popujsh të tjerë si: shqiptarë, hungarezë, grekë, rumunë, bullgarë, çekë, gjermanë dhe evropiano-perëndimorë të emërtuar në mënyrë të përgjithshme *frankë*.¹³ Ushtria osmane drejtohej personalisht nga sulltani, i shoqëruar nga dy djemtë: Jakup Çelebiu (Yakup Çelebi; 1359-1389), dhe Bajaziti (Bayezid I; -1403). Nën urdhrat e Muratit përveç myslimanëve kishte trupa të krishtera mes të cilëve me shumë gjasa kontingjente të dëguara nga perandori bizantin Johan V Palaeologu (Ιωάννης Παλαιολόγος; 1332- 1391) dhe nga dy sundimtarët serbë: Kostandin Dragashi (Konstantin Dragaš; - 1395), dhe Marko Kraljeviçi (Marko Kraljević; -1395). Të tre ishin të detyruar prej obligimeve që sillte gjendja e tyre e vasalitetit ndaj Muratit I. Përndryshe luftëtarët nën urdhrat e Lazarit kishin të përbashkët faktin se ishin të gjithë të krishterë. Numri i ushtarëve në dy kampet vlerësohet sot midis 15 000 dhe 25 000 për serbët dhe aleatët e tyre, përballë 27 – 40 000 osmanëve.¹⁴ Një vepër bashkohëse osmane, e ruajtur e përkthyer në gjuhën katalane „Historia e Jakup Çelebiut“ („Història de Jacob Xalabín“) përcjell, mes të dhënave relativisht të sakta, shifrën e 30 000 luftëtarëve (26000 këmbësorë dhe 4000 kalorës) për koalicionin e krishterë.¹⁵

Sipas rrëfimit në këngën shqiptare, përpara se të mbërrinin në Kosovë, turqit pushtuan qytetet e Selanikut dhe Shkupit, dhe më pas do të përballen me kosovarët në grykën malore të Kaçanikut. Siç është e mirëditur osmanët i kanë pushtuar të dy qytetet, veçse jo gjatë kësaj fushate. Vetëm Selaniku u mor gjatë sundimit të Muratit I, në muajin

¹² Mbi zhvillimin e betejës: FINE, 1987, ff. 408-414; MALCOLM, 1998, ff. 58-81; MIHALJČIĆ, Rade. *The Battle of Kosovo in History and in Popular Tradition*. Belgrade: Beogradski Izdavacko-Graficki Zavod, 1989, ff. 42-51; EMMERT, Thomas A. *Serbian Golgotha: Kosovo, 1389*. New York: Columbia University Press, 1990, ff. 42-78.

¹³ MALCOLM, 1998, ff. 62.

¹⁴ EMMERT, 1990, ff. 56.

¹⁵ MALCOLM, 1998, ff. 71.

prill të vitit 1387¹⁶, ndërsa Shkupi dhe vendbanimet e tjera janë push-tuar kohë pas betejës, prej ushtrive të sulltanëve pasardhës.¹⁷ Për të shkuar në Fushë Kosovë ushtritë osmane kaluan në territoret fushore të Maqedonisë Lindore, të cilat ndodheshin mes Kosovës dhe zotërimeve osmane dhe ishin nën sundimin e vasalit Konstandin Dragashi.¹⁸

Luftimet kanë zgjatur një pjesë të mirë të ditës së 15 qershorit 1389 dhe kanë përfunduar me të humbje të rënda në të dy kampet. Mes të vrarëve ishin dy kryeprijësit e dy ushtrive kundërshtarë, sulltan Murati dhe Lazar Hrebeljanoviçi. Pak kohë pas Muratit në konfliktin e trashëgimtarëve për fronin osman humbi jetën edhe djali i tij i madh, Jakupi. Prej sundimtarëve të rëndësishëm të krishterë në betejë është vrarë princi Teodor II Muzaka, i cili i ishte bashkuar koalicionit anti-osman me fisnikë të tjerë shqiptarë dhe një trupë të gjerë luftëtarësh.¹⁹

Janë ruajtur disa dëshmi mbi episodet e vrasjes së Lazarit dhe Muratit²⁰, por mospërputhja mes tyre e vështirëson kuptimin e realitetit të ngjarjeve. Sipas një pjese të mirë të burimeve perëndimore dhe osmane princi serb u kap rob në momentet e fundit të luftimeve dhe u vra: me urdhër të Bajazitit; ose me urdhër të Muratit të plagosur rëndë nga njëri prej fisnikëve të krishterë, të robëruar prej osmanëve.²¹ Sipas një varianti të dytë transmetuar në „Historinë e Jakup Çelebiut“ Lazari është vrarë duke luftuar kundër kalorësisë anadollase të pozicionuar në krahun e majtë osman.²²

Po ashtu mbi ngjarjen e vrasjes së sulltan Muratit ndeshen disa kategori dëshmish. Varianti kryesor i burimeve osmane është se u vra nga një *i pafe* i panjohur, i cili dergjej i plagosur dhe i mbuluar në gjak mes të rënëve në betejë. Në fund të luftimeve, ndërsa trupat osmane po ndiqnin kundërshtarët dhe sulltani kishte mbetur pas tyre me pak luftëtarë, i krishteri arriti t'i afrohet dhe e qëllloi për vdekje me një thikë.²³ Sipas variantit të dytë, - vrasësi shkoi i vetëm në kampin osman

¹⁶ FINE, 1987, ff. 407.

¹⁷ Shkupi u pushtua në janar të vitit 1392 kur drejtuesi osman ishte Bajaziti I, ndërsa vendbanimet dhe rajonet në veri të Shkupit janë pushtuar akoma më vonë (cf. Fine, 1987, ff.412), ose nuk kanë ekzistuar në shekullin XIV.

¹⁸ MIHALJČIĆ, 1989, ff. 45.

¹⁹ HOPF, Carl. *Chroniques Gréco-Romanes Inédites Ou Peu Connues, Publiées Avec Notes Et Tables Généalogiques Par Charles Hopf*. Berlin: Weidmann, 1873, ff. 273.

²⁰ Për dëshmitë e hershme mbi betejën dhe vrasjen e Muratit: EMMERT, 1990; MALCOLM, 1998, ff. 58-81.

²¹ EMMERT, 1990, ff. 58.

²² MALCOLM, 1998, ff. 75.

²³ Për një përmbledhje të dëshmive osmane: EMMERT, 1990, 88-97.

ku pretendoi se dëshironte t'u bashkohej këtyre të fundit, ose se dëshironte t'i bënte homazhe sulltanit, dhe kur u soll në prani të tij e sulmoi me një armë të fshehur.²⁴ Për Beltram Minianelli-t, qytetar sienez që kishte jetuar në territorin osman deri në vitin 1402, Murati u vra nga njëri prej robërve të krishterë të kapur gjatë betejës.²⁵ Sipas variantit të katërt, të përfutur prej kryqëzimit të disa burimeve të afërta në kohë me ngjarjet dhe që mund të jetë më afër të vërtetës²⁶, një grup kalorësish hungarezë dhe gjermanë, ose serbë, arritën të tejkalojnë tri rreshta devesh të lidhura me zinxhirë njëra me tjetrën (mbrojtja më e mirë kundër kalorësisë së rëndë evropiane që osmanët kishin mundur të formonin) dhe gjatë konfuzionit njëri prej tyre përparoi deri te Murati dhe e goditi me shpatë fillimisht në fyt e më pas në bark,²⁷ ose, sipas tekstit katalan,²⁸ kalorësi, i përshkruar si *një hungarez trupmadh*, arriti në galop deri te tenda e sulltanit dhe e qëllloi atë me një goditje heshte kaq të fuqishme sa arma përshkoi mburojën dhe parzmoren dhe i shkaktoi një plagë vdekjeprurëse. Kalorësi ra pas pak çastesh i mbuluar nga një re shigjetash, disa prej të cilave e kishin plagosur më parë se të arrinte te viktima e tij.

Emri i vrasësit në traditën popullore ballkanike është “Miloš”-“Milosh”. Edhe pse burimet e para mbi betejën, të krishtera dhe osmane, kanë të përbashkët faktin e mospërmendjes së këtij emri, megjithatë kalorësi mund të jetë quajtur vërtet Milosh, ose mund të ketë pasur një emër të përafërt. Për historianin Noel Malcolm nëse ka qenë një fisnik hungarez atëherë forma e saktë e emrit të tij duhet të ketë qenë ajo Miklos.²⁹ Trajta Miloš” transmetohet për herë të parë rreth 30 vjet pas betejës në një kronikë bullgare³⁰ e cila konfirmon versionin e vrasjes së sulltanit nga një goditje heshte; ndërsa për dëshmitë e para mbi epitetin legjendar “Kobilić”-“Kopili” duhet pritur rreth një shekull.³¹

Me vdekjen e dy drejtuesve luftimet u ndalën dhe të dy ushtritë u tërhoqën nga Fushë-Kosova. Fillimisht trupat e krishtera pasi mësuan për vdekjen e Lazarit dhe pas tyre osmanët për arsyet se Bajazitit i duhej

²⁴ Në tekstin e Muzakës shpjegohet se bëhej fjalë për një kalorës hungarez të quajtur Lazar, të cilin osmanët e vranë pak çaste pas vdekjes së sulltanit. HOPF, 1873, ff. 322-23.

²⁵ EMMERT, 1990, ff. 58.

²⁶ Sipas analizës së Noel Malcolm, në: MALCOLM, 1998, ff. 71-74.

²⁷ EMMERT, 1990, ff. 46.

²⁸ Dëshmi e tekstit katalan, në: MALCOLM, 1998, ff. 71.

²⁹ MALCOLM, 1998, ff. 73-74.

³⁰ MALCOLM, 1998, ff. 72.

³¹ Përmendet për herë të parë në 1480 si *Biliş Kub-ila* nga autori osman Aşıkpaşazade. Emmert, 1990, ff. 91.

të konsolidonte pushtetin mbretëror të sapofiturar dhe se ushtria e tij e decimuar nuk mund të përparonte drejt veriut dhe as të qëndronte në vend. Të krishterët luftuan mirë dhe është e vështirë të thuhet nëse pati tradhti në radhët e tyre.³² Vetë Vuk Brankoviçi, i akuzuari prej traditës orale si tradhtar, ishte ndër të fundit që është larguar nga fushëbeteja, ndërsa trupat boshnjake ishin tërhequr më parë dhe nuk mund të bëhej më asgjë për të ndryshuar rrjedhën e luftimeve.³³ As gjestet e mëpasshme të Vukës nuk tregojnë se kishte pasur ndonjë marrëveshje me osmanët.³⁴ Në vitet që pasuan princat serbë ranë në gjendje vasaliteti ndaj Portës së Lartë, por e rifituan shumë shpejt pavarësinë. Humbja e vërtetë e pushteti serb do të ndodhë 70 vjet më vonë, në 1459, me pushtimin e fortesës së Smederevës.

Pas betejës, duke qenë se osmanët u tërhoqën prej Kosovës dhe se sulltani ishte vrarë në luftime, të krishterët shpallën fitoren dhe morën urime prej qendrave perëndimore të kohës, por historiografia e sotme konsideron se beteja nuk ka rezultuar me një fitues të qartë dhe se mund të flitet për një të tillë vetëm në terma afatgjatë.³⁵ Prej saj përfituan më tepër osmanët, të cilët kishin mundësi të riformonin ushtri të reja në një kohë shumë më të shkurtër se prijësit kundërshtarë ballkanikë.³⁶

Rënia e dinastisë së Justinëve

Perandori Murik Tiberi ka sunduar mbi Bizantin në vitet 582-602. Përpara kurorëzimit, gjatë sundimit të perandorit paraardhës Tiber Kostandini (Tiberius Constantinus; -582), dëshmohej si një gjeneral i suksesshëm në luftën kundër Mbretërisë Perse. Duke mos pasur trashëgimtarë meshkuj Tiberi e birësoi dhe i dha për grua të bijën, e cila fillimisht quhej Augusta ndërsa më pas si perandoreshë mori emrin zyrtar Aelia Konstandina (Aelia Constantina; -605).³⁷ Prej martesës lindën nëntë fëmijë: gjashtë djem dhe tri vajza. Gjatë periudhës njëzetvjeçare të sundimit të tij Muriku i dha fund konfliktit të gjatë

³² FINE, 1987, ff. 413.

³³ Ibid.

³⁴ MIHALJČIĆ, 1989, 113-125.

³⁵ Fine, 1987, ff. 410; MALCOLM, 1988, ff. 76.

³⁶ Ibid.

³⁷ Për emrin e perandoreshës dhe për historinë e saj: MARTINDALE, John. R., et al. *The prosopography of the Later Roman Empire, volume III*, AD 527-641. New York: Cambridge University Press, 1992, 2 vol, ff. 337-9.

bizantino-pers duke ndihmuar shahun sasanid Kosro II (per., Khusrow; -628) të rimarrë pushtetin e humbur nga kryengritja e gjeneralit Bahram Çubin (per., Bahrām-i Chūbīn; -591). Kosro mori për grua një princeshë bizantine, e cila është dalluar prej specialistëve të gjenealogjive mesjetare evropiane se ishte e bija e perandorit dhe e një gruaje të tij të mëparshme, përndryshe të padëshmuar.³⁸

Burimi kryesor mbi jetën e Murikut është historiani bizantin Teofilakt Simokata (Θεοφύλακτος Σιμοκάτης; - shek. VII).³⁹ Të dhëna të tjera transmetohen: në disa fragmente të mbijetuara prej kronikës të historianit Johan i Antiokisë (Ιωάννον Αντιοχεως; shek. VII)⁴⁰; në Kronografinë (Χρονογραφία) e klerikut Teofan Rrëfyeti (Θεοφάνης ὁ Ὁμολογητής; - r., 818)⁴¹; në tekstet më të shkurtra të autorëve të mëvonshëm bizantinë dhe orientale, mes të cilëve dallohen kronikat e Gjergj Hamartolit (Γεώργιος Ἀμαρτωλός; shek IX)⁴² dhe Simeon Logoteti (Συμεών τον Λογοθέτη; shek X)⁴³; dhe prej një hagiografie të ruajtur në gjuhën e vjetër arameene mbi jetën e perandorit Murik,⁴⁴ i cili së bashku me familjen e tij është shenjtëruar prej Kishës bizantine. Burimi

³⁸ Sipas studiuesit të gjenealogjive bizantine dhe orientale Christian Settipani, - Muriku ishte 43 vjeç kur u martua me Aelia Konstandinën dhe ka pasur disa fëmijë të tjerë nga një martesë e mëparshme, ose nga një lidhje e pakurorëzuar, mes të cilëve ishte edhe gruaje e shahut Kosro II e quajtur Maria ose Miriam. SETTIPANI, Christian. *Continuité des élites à Byzance durant les siècles obscurs: Les princes caucasiens et l'empire du VIe au IXe siècle*. Paris: De Boëard, 2007, ff. 194-6.

³⁹ Theophylactus Simocatta, ed. C. de Boor, revised by P. Wirth. *Theophylacti Simocattae Historiae*. Stuttgart: B.G. Teubner, 1972.; Theophylactus Simocatta, ed. M. Whitby. *The History of Theophylact Simocatta*. Oxford: Clarendon Press, 1986, III, 18. Më tej Teofilakti.

⁴⁰ Për fragmentet mbi perandorin Murik dhe pasardhësin e tij Fokën: ROBERTO, Umberto. *Ioannis Antiocheni Fragmenta ex Historia chronica. Texte und Untersuchungen zur Geschichte der altchristlichen Literatur, Band 154*. Berlin: Walter de Gruyter, 2005. ff. 547-555.

⁴¹ Theophanes, ed. C. de Boor. *Theophanis chronographia*. 2 Vol. Leipzig, 1883-1885.; Theophanes Confessor, ed. C. A. Mango. *The Chronicle of Theophanes Confessor: Byzantine and Near Eastern history AD 284-813*. Oxford: Clarendon Press - New York: Oxford University Press, 1997. Më tej Teofani.

⁴² Georgius Monachus, ed. J. P. Migne. *Chronicon breve: quod ex variis chronographis et expositoribus decerpit concinnavitque Georgius Monachus cognomine Hamartolus*. Paris: Apud J.-P., 1863. Më tej Hamartoli.

⁴³ Simeon Metafraste, ed. S. Wahlgren. *Symeonis Magistri et Logothetae Chronicon*. Berlin: Walter de Gruyter, 2006; WAHLGREN, Staffan. *The Chronicle of the Logothete*. Liverpool: Liverpool University Press, 2019. Më tej Logoteti.

⁴⁴ NAU, François. *Les Légendes Syriaques D'Aaron De Saroug, De Maxime Et Domèce, D'Abraham, Maitre De Barsoma Et De L'empereur Maurice*. Turnhout: Brepols, 1981, ff. 774-775.

i tekstit arameen dhe i një pjese të informacioneve të teksteve të sipërcituara bizantine është dalluar se ka qenë një hagiografi në gjuhën greke,⁴⁵ sot e humbur.⁴⁶ Hagiografia besohet se transmetonte informacione mbi konfliktin bizantino-avar, mbi mëkatet e perandorit, oguret hyjnore, pendimin dhe shenjtërimin e tij.⁴⁷ Kjo është edhe përmbledhja e linjave të gjera të historisë në tekstet më të shkurtra të Hamartolit dhe Logotetit, me ndryshimin se në fjalitë e para dy kronikanët japin informacione mbi veprat publike, veçanërisht ato me karakter fetar, që perandori bëri të ndërtohen në Kostadinopojë. Mes tyre ndër më të rëndësishmet ishin ndërtimet për zgjerimin dhe përmirësimin e kompleksit të kishës së Nënës së shenjtë të Zotit (υπεραγίασ θεοτόκου) në zonën Blakherne (Βλαχέρνας).⁴⁸

Ndërsa në tekste mesjetare gjeorgjiane⁴⁹ ruhet kujtimi i ndërtimit porositur prej perandorit të kishës së Shën Marisë në zonën e Gethseman-it në Jerusalem, vendin ku besohet se Hyjlindësja ishte varrosur.

Në fillimet e dhjetëvjeçarit 590 Muriku vendosi të drejtojë personalisht fushatën kundër avarëve, edhe pse dinjitarët, Patriarku, e shoqja dhe fëmijët e tij, iu lutën që të qëndronte në Kostadinopojë dhe t'ia linte drejtimin ndonjërit prej gjeneralëve.⁵⁰ Ndërkohë ushtria përgatitej për t'u nisur në front ndodhi një eklips i gjatë i diellit, i shoqëruar me erëra shumë të forta dhe stuhi, të cilat për autorët bizantinë ishin ogure që paralajmëronin fatkeqësi.⁵¹ Për të siguruar mbështetjen e Hyjnive, perandori vendosi të kalojë një natë duke u lutur në katedralen e Shën Sofisë. Të nesërmen u lut së bashku me ushtarët në kishën e Hyjlindësës së Blakhernës dhe pjesa e fundit e ditës u mbyll me

⁴⁵ WHITBY, Michael L. "Theophanes' chronicle source for the reigns of Justin II, Tiberius and Maurice (A.D. 565-602)" Byzantion, vol. 53, no. 1, 1983, ff. 318-345.

⁴⁶ Bashkë me të është humbur pothuajse çdo kujtim mbi shenjtërimin e perandorit në Konstandinopojë. Studiuesi francez Venance Grumel ka arritur, jo pa vështirësi, të dallojë se dita e përkujtimit të Murikut ka qenë 28 nëntori. GRUMEL, Venance. « *La mémoire de Tibère II et de Maurice dans le synaxaire de Constantinople* », *Annalecta Bollandiana*, 84, 1-2, 1966, ff. 249.

⁴⁷ WHITBY, Michael. *The Emperor Maurice and his historian: Theophylact Simocatta on Persian and Balkan warfare*. Oxford: Clarendon Press, 2002, ff. 105-6.

⁴⁸ LOGOTETI, 107, 2; HAMARTOLI 554, 3-4.

⁴⁹ GARITTE, Gérard. *Le calendrier polestino-géorgien du Sinaiticus 34 (Xe siècle)*. Bruxelles: Société des Bollandistes, 1958, ff. 250.

⁵⁰ TEOFILAKTI, V, 16, 1-2; TEOFANI, viti 6093, kol. 269.

⁵¹ TEOFILAKTI, V, 16, 5.

ceremoninë e Kungimit të Shenjtë.⁵² Trupave që niseshin prej Kostadinopojës drejt frontit avar u printe, e vendosur mbi një kolonë të artë, relika e shenjtë e një pjese prej kryqit të Krishtit. Pas saj kalëronte perandori, vijonin truprojat e tij dhe në një radhë të gjatë të gjithë luftëtarët e tjerë bizantinë.⁵³ Pasi ishte kryer një pjesë e rrugës kali i preferuar i Murikut u rrëzua në tokë pa jetë. Kronistët shkruajnë se ishte i mbuluar me stoli dhe veshje të arta që ndriçonin.⁵⁴ Për shkak të ogureve⁵⁵ ose për arsye se duhej të takonte emisarë persë⁵⁶ perandori e braktisi fushatën dhe u rikthye në Kostadinopojë. Drejtimi i ushtrisë iu la gjeneralit Priskus (Priscus; - 613), i cili vendosi të fortifikojë qafat e maleve Ballkan (shtigjet “Proklianë” - “Προκλιανής”, në tekstet bizantine⁵⁷) dhe u pozicionua pas tyre në pritje të kundërshtarëve. Për dy ditë avarët u përpoqën të kalonin pa pasur sukses dhe duke pësuar humbje të shumta. Ditën e tretë, për shkak se numri i kundërshtarëve të pozicionuar përballë ishte shumë i lartë, oficeri Salvianus braktisi vendin që i ishte caktuar të mbronte dhe iu bashkua trupës së Priskusit.⁵⁸ *Khagani pasi harxhoi tri ditë përballë pikave të fortifikuara, të katërtën zbuloi se romanët kishin ikur.*⁵⁹ Avarët përparuan dhe mposhtën ushtrinë bizantine në një betejë të luftuar pranë vendbanimit Perinthus, pak kilometra larg Kostadinopojës. Kryeqyteti, i pambrojtur u shpëtua nga njëri prej truprojave të perandorit, i cili u maskua si korrier që transmetonte një letër të rreme drejtuar Priskusit dhe e la veten të kapej rob. Në letër Muriku kishte shkruar se flota bizantine po nisej të sulmonte vendbanimet avarë në veri-perëndim të Detit të Zi, çfarë e detyroi Khaganin të ndalte sulmin ndaj Kostadinopojës dhe të rikthehej në mbretërinë e tij.⁶⁰

Konflikti do të vijojë përgjatë të gjithë dhjetëvjeçarit 590. Në vitet 598-599 një trupë bizantine nën drejtimin e gjeneralit Komentiolus (Comentiolus; -602) e nisur nga Konstandinopoja për të përforcuar ushtrinë e Priskusit u përball me trupa avarë në provincën e Trakisë. Bizantinët u përpoqën fillimisht të evitonin betejën duke u tërhequr, por

⁵² TEOFILAKTI, V, 16, 7-8.

⁵³ TEOFILAKTI, V, 16, 11.

⁵⁴ TEOFILAKTI, VI, 2, 1; TEOFANI, viti 6093, kol. 269.

⁵⁵ LOGOTETI, 107, 4; HAMARTOLI 555, 9.

⁵⁶ TEOFILAKTI, VI, 3, 5; TEOFANI, viti 6093, kol. 269.

⁵⁷ TEOFILAKTI, VI, 4, 7-8.

⁵⁸ TEOFILAKTI, V, 4, 12; TEOFANI, viti 6084, kol. 270.

⁵⁹ “ο δε Χαγάνος ημέρας τρεῖς ἀνά τον χώρον τον προ των έχρωμάτων ενδιατρίψας τεταρταίος διέγνω το Ρωμαϊκόν αποδράσαν”. TEOFILAKTI, VI, 5, 1.

⁶⁰ TEOFILAKTI, VII, 5, 8-16; TEOFANI, viti 6092.

avarët i ndoqën pas derisa në afërsi të fortesës Jatrus⁶¹ Komentiolusi i urdhëroi ushtarët të armatoseshin, pa u shpjeguar se kishte vendosur të pranonte konfrontimin. Sipas kronistëve⁶² gjenerali ishte marrë vesh tradhtisht me Khaganin dhe kishte zgjedhur të humbte betejën, ndaj fillimisht i rreshtoi trupat e tij në mënyrë të gabuar ndërsa më pas gjatë luftimeve i çrregulloi radhët e tyre me urdhra kontradiktorë. Luftimet përfunduan me fitoren e avarëve dhe robërimin e një numri të madh bizantinësh. Për Teofanin, ishte vetë perandori që e dëshironte humbjen, për arsyen se kishte vendosur të ndëshkonte ushtarët të cilët ishin të padisiplinuar dhe i kishin sjellë probleme më parë.⁶³ I njëjti informacion jepet nga Logoteti dhe Hamartoli, së bashku me numrin *dymbëdhjetë mijë*⁶⁴ për robërit.

Gjatë përparimit drejt Kostadinopojës avarët dogjën kishën e Shën Aleksandrit pranë qytetit Drizipera⁶⁵ dhe plaçkitën varrin e pasur të shenjtit. Ngjarja u pasua nga një epidemi e rëndë murtaje, e cila, për kronistët⁶⁶, ishte ndëshkimi hyjnor për mëkatin e shkatërrimit të varrit të shenjtit. Si pasojë, humbën jetën një numër i lartë ushtarësh avarë dhe mes tyre shtatë prej njëmbëdhjetë djemve të Khaganit. Muriku dërgoi ambasadorë me dhurata në kampin kundërshtar për të propozuar një traktat paqeje dhe kërkesa e tij nuk u kundërshtua. Përpara se të rikthehej në territoret e Mbretërisë Avare Khagani ofroi t'i lironte dymbëdhjetë mijë robërit kundrejt një shume jo të lartë. Por perandori nuk pranoi të paguajë dhe avarët vendosën për vrasjen e tyre.⁶⁷

Në pranverën e vitit 599 Muriku, që nuk kishte ndërmend t'i përmbahej traktatit të paqes, urdhëroi Priskusin të kalonte lumin Danub dhe të sulmonte brendatokën e Mbretërisë Avare. Fillimisht bizantinët mposhtën pa vështirësi trupat kufitare kundërshtare në afërsi të qytetit Viminacium⁶⁸ dhe më pas do të përballeshin me dy ushtri avare: e para e drejtuar prej katër djemve të mbetur gjallë të Khaganit dhe e dyta nga vetë ky i fundit. Sipas rrëfimit të Teofilaktit katër ditë pas fitores së parë ushtria e Priskusit e ndarë në tri formacione do të fitonte kundër një ushtrie të ndarë në pesëmbëdhjetë njësi dhe të drejtuar nga katër princat avarë. Bizantinët vranë katër mijë kundërshtarë. Pas tri ditësh u luftua

⁶¹ Krivina, në Bullgari.

⁶² TEOFANI, viti 6084, kol. 270.

⁶³ TEOFANI, viti 6092, kol. 279.

⁶⁴ LOGOTETI, 107, 4; HAMARTOLI, 557, 5.

⁶⁵ Afër Luleburgaz-it të sotëm në Turqinë europiane.

⁶⁶ TEOFILAKTI, VII, 15; TEOFANI, viti 6092, kol. 280.

⁶⁷ TEOFANI, viti 6092, kol 280; LOGOTETI, 107, 4.

⁶⁸ Vendbanim në Serbinë Perëndimore, afër qytetit Kostolac.

sërisht dhe avarët humbën kësaj here një numër më të lartë, prej nëntë mijë luftëtarësh. Dhjetë ditë më pas, në përballjen e fundit kundër të njëjtës ushtri avarë, luftëtarët e Priskusit arritën të vrasin pesëmbëdhjetë mijë vetë, mes të cilëve edhe katër djemtë e mbretit avar. Në ditën e tridhjetë, ose tridhjetë ditë më pas,⁶⁹ bizantinët u sulmuan nga një ushtri e re e ndarë në dymbëdhjetë formacione dhe e drejtuar nga vetë Khagani. Pasi e fituan betejën, një formacion prej katër mijë bizantinësh, kaloi lumin Tisus⁷⁰ dhe sulmoi vendbanimet gepide nën sundimin e Mbretërisë Avare. Prej këtij sulmi u vranë tridhjetë mijë kundërshtarë. Përballja e fundit ndodhi njëzetë ditë më pas. Luftëtarët e Priskusit fituan sërish dhe robëruan tetë mijë sllavë, tre mijë avarë dhe gjashtë mijë e dyqind luftëtarë të popujve të tjerë.⁷¹

Ndërkohë brenda Perandorisë Bizantine ishte përhapur lajmi i vrasjes së dymbëdhjetë mijë robërve dhe i mospagesës së shumës së kërkuar për lirinë e tyre, njëkohësisht bashkë me urrejtjen në popull ndaj perandorit.⁷² Vetë ky i fundit nuk e kishte ndërgjegjen të qetë. Sipas Kronografisë:

“Muriku që kishte reflektuar brenda vetes dhe e dinte se asgjë nuk i shpëton shikimit të Zotit, por ai shpërblen çdonjërin sipas veprave të tij dhe duke konsideruar fajin e mospagesës për robërit mendoj se do të ishte më mirë të vuante për mëkatet e tij në këtë jetë sesa në tjetrën dhe pasi shkroi lutje në disa letra i dërgoi ato te të gjithë fronët patriarkalë dhe te të gjithë komunitetet nën sundimin e tij dhe në manastire, te të gjitha ato në shkretëtirë dhe Jerusalem dhe në laura⁷³ me dhurata në monedha, në qirinj dhe incens, që të luteshin për të dhe në këtë mënyrë të paguante për mëkatet e tij këtu dhe jo në kohën që do të vijë. Ai gjithashtu u zemërua me Filipikusin, kunatin e tij, pasi i fillonte emri me germën “P”. Por Filipikusi u betua në shumë mënyra se ndjenjat e tij ndaj Murikut ishin të pandryshuara dhe se nuk kishte komplotuar.”⁷⁴

⁶⁹ Kronika e Teofilaktit nuk është e qartë në pjesën e konfliktit bizantino-avar.

⁷⁰ Lumi Tisza, degë e Danubit.

⁷¹ TEOFILAKTI, VIII, 2-3.

⁷² TEOFANI, viti 6092, kol. 280.

⁷³ Manastire ortodoksë ku murgjit jetojnë në vetmi, të izoluar edhe prej njëri tjetrit në shumicën e kohës.

⁷⁴ „ὁ δὲ Μαυρίκιος ἐν ἑαυτῷ γεγόμενος καὶ εἰδώς, ὅτι οὐδὲν τὸν θεὸν λανθάνει, ἀλλὰ πᾶσιν ἀποδίδωσι κατὰ τὰ ἔργα αὐτῶν, καὶ ἐπιλογισάμενος τὸ σφάλμα, ὃ ἐποίησεν εἰς τὴν αἰχμαλωσίαν μὴ ἐξαγοράσας αὐτήν, συμφέρειν ἔκρινεν ἐν τῷ βίῳ τοῦτο ἀπολαβεῖν τὴν ἁμαρτίαν, καὶ μὴ ἐν τῷ μέλλοντι· καὶ ποιήσας δεήσεις ἐγγράφους ἀπέλυσεν εἰς πάντας τοὺς πατριαρχικοὺς θρόνους καὶ πάσας τὰς πολιτείας τὰς ὑπ’ αὐτὸν καὶ εἰς τὰ μοναστήρια τὰ ἐν τῇ ἐρήμῳ καὶ ἐν Ἱεροσολύμοις καὶ εἰς τὰς λαύρας χρήματα καὶ κηροὺς καὶ

Sipas profecive që qarkullonin në Bizant, Muriku do të rrëzohej nga froni nga dikush që e kishte fonemën e parë të emrit “f”.⁷⁵ Një natë ndërsa ai po lutej në pallat, dëgjoi një zë të ardhur nga portreti i Krishtit, i cili iu drejtua dhe e pyeti nëse dëshironte të gjykohej në këtë botë apo në Mbretërinë e Ardhme. Përgjigjja e perandorit ishte se zgjidhte gjykimin në këtë botë. Krishti i tregoi se ai dhe familja e tij do të vriteshin dhe do të pranoheshin mes shenjtoreve.⁷⁶

Një rrëfim i përafërt transmetohet prej pasazhit vijues të Hagio-grafisë Arameene:

“ai kishte shqetësimin t’i kërkonte Zotit ta dënonte këtu (poshtë) për dëmet që kishte kryer dhe të mos e privonte atje (lart) prej shpërblimit perfekt. (Një ditë) ndërsa ende nuk ishte lodhur duke (bërë) këtë lutje për tri orë, një engjëll iu shfaq nën një pamje të lavdishme dhe paqesore. (Engjëlli) e pa ndërsa po kryente shërbesat dhe i tha: “Ti e ke lodhur Zotin me lutjet e tua prej kohësh. Ti i kërkon Zotit dhe insiston që të vuash këtu (poshtë) dënimin e mëkatit për shkak të të cilit nuk do të ishte i denjë të fitoje shkallën perfekte dhe që të mos privohesh për shkak të tij nga e mira e përsosur. Unë mund të të dëshmoj se mëkati yt është i tillë që të privon nga shkalla më e lartë, megjithatë ti do të kesh vendin mes shenjtoreve. Nëse dëshiron të ruash mbretërinë tënde dhe jetën e fëmijëve të tu për një kohë të gjatë ndalu së kërkuari këtë gjë, dhe në ringjallje shpërblimi yt do të jetë ai i Të Drejtëve. Nëse dëshiron shpërblimin më të lartë dhe të dënohesh këtu poshtë, ja cili do të jetë dënimi yt: ti do të privohesh nga mbretëria, bijtë e tu do të vriten përpara syve të tu dhe në fund armiq të tu do të të djegin. Zgjidh çfarë dëshiron. Pas njëzet ditësh do të kthehem të të shoh dhe ajo që do të zgjedhësh, do të ndodhë.”⁷⁷

θυμιάματα, ὅπως εὔζωνται ὑπὲρ αὐτοῦ, ἵνα ἐνταῦθα ἀπολάβῃ, 285 καὶ μὴ ἐν τῷ μέλλοντι αἰῶνι. ἔσκανδαλίζετο δὲ καὶ εἰς Φιλιππικόν, τὸν γαμβρὸν αὐτοῦ, ὡς εἰς τὸ φῖ γράμμα ὀνομαζόμενον. ὁ δὲ Φιλιππικός διαφόρως ἐπώμνυτο τῷ βασιλεῖ, ὡς καθαρὸς ἐστὶν εἰς τὴν δουλείαν αὐτοῦ καὶ οὐκ ἔχει παρ’ αὐτῷ δόλον. “TEOFANI, kol. 285.

⁷⁵ LOGOTETI, 107, 6.

⁷⁶ TEOFANI, kol. 285; LOGOTETI, 17, 7; HAMARTOLI, 557, 7.

⁷⁷ „il avait la préoccupation de demander à Dieu de le châtier ici (-bas) pour ses prévarications et de ne pas le priver là(-haut) de la récompense parfaite. (Un jour) qu'il ne s'était pas lassé de (faire) cette prière l'espace de trois heures, un ange lui apparut sous un aspect glorieux et pacifique. (L'ange) le vit tandis qu'il faisait l'office et lui dit « Tu as fatigué Dieu par ta prière depuis longtemps. Tu demandes à Dieu et tu requiers de souffrir ici(-bas) la punition du péché à cause duquel tu ne serais pas digne du degré parfait, et de ne pas être privé à cause de lui du bien parfait. Je puis te témoigner que tu as tel péché qui te prive du degré supérieur; tu auras cependant part avec les saints. Si tu veux conserver ton royaume et la vie de tes enfants pendant longtemps, cesse d'adresser cette demande, et, à la résurrection, ta récompense sera celle des justes. Si

Njëzet ditë më pas perandori i konfirmoi engjëllit se dëshironte shenjtërimin. Sipas Kronografisë së Teofanit pas shfaqjes së vegimit Muriku dërgoi komandantin e rojeve të pallatit, parakoimómenon-in (παρακοιμώμενον), që të thërriste gjeneralin Filipikus. Ky i fundit, i frikësuar prej kërkesës të pazakontë në mesnatë, ndërkohë që akuzohej se po komplotonte, ngriti nga gjumi të shoqen, Gordia-n (njëkohësisht e motra e Murikut), për t'i dhënë lamtumirën dhe u nis drejt pallatit perandorak. Muriku e qetësoi dhe i tregoi se e kishte thirrur për t'i kërkuar falje për akuzat e mëparshme. Sipas vegimit, ose ëndrrës, ishte një ushtarak i quajtur Foka (Φωκάς) që do ta tradhtonte dhe do ta vriste:

“Dhe i tregoi Filipikusit shpjegimin e ëndrrës. Atë natë u shfaq në qiell një yll, i cili quhet kometë. Ditën tjetër u kthyen të dërguarit që kishin shkuar tek etërit e shenjtë në shkretëtirë dhe sollën përgjigjen e cila ishte: “Zoti e ka pranuar pendimin tënd, të ka shpëtuar shpirtin dhe të ka vendosur ty dhe familjen tënde mes shenjtorëve, por ti do të rrëzohesh nga fronin në fatkeqësi dhe rrezik.””⁷⁸

Përveç Teofanit, autorë të tjerë bizantinë shkruajnë për « astrologë » të cilët pasi panë: «*një yll që ishte shfaqur në qiell, interpretuan se ky yll fliste për vdekjen e perandorit*». ⁷⁹

Në vjeshtën e vitit 602 Muriku urdhëroi trupat ballkanike që të kalonin Danubin dhe të dimëronin në territoret sllave, me qëllimin për t'i ekonomizuar shpenzimet e furnizimit të ushtrisë dhe për mbrojtjen më të mirë të kufirit në dimër kur ngrirja e lumenjve iu lehtësonte popujve veriorë kalimin në trojet bizantine. Ushtarët fillimisht kundërshtuan, pastaj gradualisht pakënaqësia e tyre u kthye në revoltë. Ata

tu veux la récompense la plus élevée et être puni ici-bas, voici quelle sera ta punition: tu seras privé de ton royaume, tes enfants seront massacrés sous tes yeux et, à la fin, tes ennemis te brûleront. Choisis donc ce que tu veux. Dans vingt jours je reviendrai te voir et ce que tu auras choisi t'arrivera”. NAU, 1981, ff. 774-75.

⁷⁸ “καὶ ἐζήγεῖτο τῷ Φιλίππικῳ τὴν τοῦ ὀνείρου ἀποκάλυψιν. τῇ δὲ νυκτὶ ἐκεῖνῃ ἐφάνη ἀστὴρ ἐν τῷ οὐρανῷ, ὁ λεγόμενος κομήτης. τῇ δὲ ἐπιούσῃ ἡμέρᾳ ἔφθασε καὶ ὁ ἀποστολαῖς μαγιστριανὸς πρὸς τοὺς ἐν τῇ ἐρήμῳ ἁγίους πατέρας φέρων παρ' αὐτῶν ἀπόκρισιν τοιαύτην, ὅτι “ὁ θεὸς δεξάμενος τὴν μετάνοιάν σου σώζει τὴν ψυχὴν σου καὶ μετὰ ἁγίων κατατάττει σε πανοικίᾳ, τῆς δὲ βασιλείας μετὰ ἀτιμίας καὶ κινδύνου ἐκπίπτεις.” TEOFANI, viti 6094, kol. 286.

⁷⁹ «il arriva qu'un magistrat qui connaissait l'astrologie, et un autre, nommé Léon le logothète ayant observé une étoile qui avait aparé au ciel, affirmaient que cette étoile indiquait l'assassinat de l'empereur. Ils allèrent trouver l'impératrice Constantine, ... » Jean Eveque de Nikiu, ed. H. Zotenberg. *Chronique de Jean évêque de Nikiou: texte éthiopien*. Paris: Impr. nationale, 1883, ff. 405.

zgjodhën për t'i udhëhequr centurionin Foka (Φωκάς; -610). Lajmi i kryengritjes arriti në Kostadinopojë ku një pjesë e banorëve vendosën ta kurorëzonin patricin Germanus Anici (550-605), pasardhës i familjeve të Justinit dhe të mbretërve ostrogotë të Italisë, dhe vjehrrin e princit Teodos (-602), djalin të madh të Murikut. Më pas banorët e kryengritur hapën portat e kryeqytetit duke i mundësuar hyrjen brenda mureve ushtrisë së Fokës. Muriku, familja e tij dhe njerëzit e afërm u përpoqën të largohen drejt një vendi më të sigurt, por u kapën robër gjatë rrugës dhe në ditët e fundit të muajit nëntor 602 Foka urdhëroi vrasjen e të gjithë meshkujve të familjes perandorake. Muriku u vra bashkë me djemtë dhe të vëllanë në brigjet aziatike të Kostadinopojës, në një vend që autorët bizantinë e emërtojnë Porti i Eutropit në Kalkedoni (ἐν Χαλκηδόνι εἰς τὸν Εὐτροπίου λιμένα)⁸⁰. Vrasësve u shpëtoi përkohësisht princi Teodos, i cili ishte nisur për të kërkuar ndihmë në Mbretërinë Perse. Mbi udhëtimin e tij u krijuan legjenda të shumta, por mendimi dominues i autorëve bizantinë është se humbi jetën në një kohë të afërt me atë të familjarëve të tjerë. Për Teofilaktin, burimin më të hershëm mbi ngjarjet, Muriku pasi kishte pranuar gjykimin e Zotit, dërgoi njerëz që ta kthenin në Kostadinopojë dhe Teodosi u vra në të njëjtin vend, në Kalkedoni⁸¹; ndërsa sipas teksteve të kronistëve të mëvonshëm ai vdiq gjatë rrugës për në Mesopotami.⁸² Kosro deklaroi se princi ndodhej në Oborrin Pers dhe sulmoi territoret bizantine me justifikimet e hakmarrjes për vrasjen e Murikut dhe fronëzimin e Teodosit.

Në tekstet gjysmë-legjendare arameene⁸³ dhe bizantine⁸⁴ rrëfëhet se edhe djali më i vogël iu shpëtoi përkohësisht vrasësve. Princi i ri - i emërtuar Konstandin⁸⁵ në traditën ballkanike - u fsheh prej mëndeshës

⁸⁰ TEOFANI, viti 6094, kol 290.

⁸¹ TEOFILAKTI, VIII, 11, 1.

⁸² TEOFANI, viti 6095, kol. 291.

⁸³ NAU, 1981, ff. 777.

⁸⁴ TEOFILAKTI, VIII, 11, 5.

⁸⁵ Një dorëshkrim rumun i shekullit XVIII në të cilin gjendet një miniaturë me subjekt historinë e perandorit Murik e emërtion djalin më të vogël me emrin Konstandin. PĂUN, Radu G. « Pour la loi des ancêtres: Sources bibliques et traditions littéraires des récits sur la mort de Constantin Brancovan » in. BILIARSKY, Ivan; PĂUN, Radu G. (éds.). *Les cultes des saints souverains et des saints guerriers et l'idéologie du pouvoir en Europe Centrale et Orientale*. Actes du colloque international, New Europe College, Bucarest, 17 janvier 2004, ff. 268. I njëjti emër, Konstandin, ndeshet në baladat e shumta legjendare shqiptare dhe greke që përmbajnë motivin ballkanik të vrasjes së nëntë vëllezërve. Po ashtu në kronikën e Paul Diakonit një prej princave quhet Konstandin. Paul the Deacon, ed. Edward Peters. *History of the Lombards*. Philadelphia: University of

e cila u solli kryengritësve djalnin e saj me synimin që të shpëtonte të paktën njërin prej trashëgimtarëve të familjes perandorake. Kur e mësoi Muriku nuk pranoi që dikush tjetër të humbte jetën në vend të të birit, falënderoi gruan dhe e detyroi që të kërkonte Konstandinin.

Vrasësit i hodhën në det trupat e Murikut dhe të tiberëve,⁸⁶ por Gordia arriti t'i merrte dhe i varrosi në manastirin e Shën Mamasit.⁸⁷ Në të njëjtin vend, në Portin e Eutropit, u vranë tre vjet më pas me urdhër të Fokës edhe perandoresha dhe tre vajzat e saj. Pasi kishin dëgjuar lajme se Teodosi ishte gjallë Aelia Kostandina dhe patrici Germanusi komplotuan kundër Fokës, por komunikimi i tyre u zbulua nga një shërbyese e perandoreshës, e quajtur Petronia.⁸⁸ Trupat e Kostandinës dhe princeshave patën të njëjtin fat si burrat e familjes: Foka urdhëroi që të hidheshin në det, ndërsa në tekstet bizantine dëshmohej se varret e tyre ishin në manastirin e Shën Mamasit, pranë Murikut dhe djemve.⁸⁹

Në të njëjtën kohë Foka urdhëroi edhe vrasjen e Germanusit dhe vajzës së tij. Rrëfimi për patricin Germanus zë një vend të vogël në ngjarjet e fundit të rënies së dinastisë dardane, por përndryshe historia e familjes së ngushtë të tij - familjes Anici - është mjaft e rëndësishme për të kuptuar origjinën e eposit të përbashkët shqiptaro-sllav. I ati i patricit Germanus, gjenerali Germanus Anici (-550) është i vetmi që ka pasur një vijimësi të gjatë mashkullore prej të gjithë trashëgimtarëve biologjikë dhe të birësuar, të dinastisë justiniane ndaj mund të besohet se veçanërisht për shkak të dimensionit gjenealogjik Anicët janë vendosur në qendër të rrëfimeve mesjetare, të cilat janë transformuar në rrjedhën e kohës në epikën e përbashkët shqiptaro-sllave.⁹⁰ Emrat dhe historia e disa prej heronjve të ciklit shqiptar dhe boshnjak të kreshnikëve lidhen me Germanus Anicin,⁹¹ ndërsa specifikisht në epikën sllavojugore informacionet e transmetuara oralisht mbi Gojko

Pennsylvania Press, 2013, Book IV, 26. Përndryshe sipas kronikës *Chronicon Paschale*, emrat e djemve të Murikut dhe Aelia Konstandinës ishin: Theodosius, Tiberius, Petrus, Paulus, Iustinus dhe Iustinianus, ndërsa të vajzave: Anastasia, Theoctista dhe Cleopatra. MARTINDALE, 1992, ff. 856.

⁸⁶ TEOFILAKTI, VIII, 12, 1.

⁸⁷ MARTINDALE, 1992, ff. 543, Gordia 2.

⁸⁸ TEOFANI, kol. 295.

⁸⁹ MARTINDALE, 1992, ff. 339.

⁹⁰ Më shumë në: SHUKA, 2015, ff. 139-222.

⁹¹ Përkatësisht emrat dhe një pjesë e motiveve relative ndaj heronjve: Gjergj Elez Alia / Alija Đerzelez / Geg Lazi dhe Halil Hrnjica (SHUKA, 2015, ff. 159-163).

Mrnjavčević-in përmbajnë analogji të shumta me historinë e patricit Germanus.⁹²

Foka sundoi për tetë vjet, prej fundit të nëntorit 602 deri në vitin 610, kur kryengritja e gjeneralit Heraklius (Ἡράκλειος, r. 575-641) do ta rrëzonte nga fronin. Autorët bizantinë, të cilët ndjekin versionin e historisë shkruar nën sundimin e dinastisë heraklite - kritike ndaj Fokës deri në emërtimin e tij me epitelin "i mallkuari"⁹³ dhe të favorshme ndaj Herakliut dhe Murikut - shkruajnë se gjatë tetë vjetëve të sundimit të tij në Bizant do të ndodhnin fatkeqësi, shkatërrime dhe humbje të panumërta jetësh.⁹⁴ Prej të gjithë trupës që kishte marrë pjesë në kryengritjen e vitit 602 në momentin e marrjes së pushtetit prej Herakliut kishin mbetur vetëm dy ushtarë të gjallë.⁹⁵ Të tjerët ishin vrarë në betejat me persët dhe avarët ose në luftërat civile. Mes fatkeqësive të shumta, një tekst i shekullit VII shkruar në Egjiptin atëkohë bizantin dëshmon se ishin edhe vetë ilirët që sulmonin vendbanimet bizantine.⁹⁶ Përgjatë sundimit të dinastisë së Justinit ata kishin qenë zotërit e vërtetë të Kostadinopojës dhe i kishin dhënë asaj perandorë, gjeneralë dhe administratorë të shquar. Bashkë me Murikun edhe ilirët e kishin humbur pushtetin mbi Bizantin.

Fundi i Fokës ishte po ashtu mjaft tragjik. Kur e sollën të lidhur te Herakliu, ky e qëllloi me shkelm⁹⁷ dhe urdhëroi që t'i pritshin

⁹² Veçanërisht rrëfimi në këngën "Uroshi dhe Mërnjavčevićët" ("Uroš i Mrnjavčevići"), mbi përpjekjet, jo të sakta historikisht, të tre Mërnjavčevićëve për të uzurpuar perandorinë serbe, paraqet paralele me historinë e përpjekjeve historike të tre vëllezërve Anici për të uzurpuar pushtetin perandorak në Konstandinopojë (SHUKA, 2015, ff. 498-519). Po ashtu një pjesë e madhe e fiseve malazeze e konsiderojnë Gojko Mërnjavčevićin si paraardhësin legjendar, të tyre dhe të fiseve veriore shqiptare, ndërkohë që për malësorët shqiptarë paraardhësi i njëjtë i përbashkët emërtohet Geg Lazi. MILANI, Mark, përkth. L. Radi. *Jeta dhe zakonet e shqiptarëve: si dhe pjesë të tjera nga vepra e tij*. Tiranë: Veizi, 1995, ff. 191. Për sa i përket origjinës së emrit Gojko, - mund të ketë qenë fillimisht një epiteli epik që ka shoqëruar emrin e heroit. Në epikën sllavojugore ndeshet epiteli *gojani*, veçanërisht për heroin Halil Hrnjica. Fjala nuk përdoret më, por më parë ka pasur kuptimin *elegant*, sipas: SKENDI, Stavro. *Albanian and South Slavic Oral Epic Poetry*. Philadelphia: American Folklore Society, 1954, ff. 104. Të vihet re se edhe vetë emri Halil është dalluar si një epiteli, me origjinë prej osmanishtes dhe me kuptimin "I pashëm / elegant". Akademia Shqiptare e Shkencave. *Historia e Popullit Shqiptar*. Tiranë: Botimet Toena, 2002, ff. 304.

⁹³ LOGOTETI, 108, 7.

⁹⁴ TEOFANI, viti 6094, kol. 290; LOGOTETI, 108, 4.

⁹⁵ TEOFANI, viti 6094, kol. 290.

⁹⁶ Jean Eveque de Nikiu, ed. H. Zotenberg, ff. 430.

⁹⁷ IOANNIS ANTIOCHENI, ed. Umberto, ff. 555.

këmbët, duart deri te supet dhe gjenitalet. Më pas dora e djathtë e prerë u ekspozua e ngulur mbi një shpatë pranë trupit.⁹⁸

Përveç të dhënave të veçanta që ruajnë tekstet mesjetare bizantine dhe arameene, informacione të tjera historike me paralele në tri këngët kanë qenë më të përgjithshme dhe të mirënjohura në vijimësi. I tillë është informacioni për emblemën në flamurin e Boshkos, dhënë në këngën “Car Lazari dhe caresha Milica”. Emblema, e vështirë për t’u përfytyruar, është një mollë e artë prej së cilës dalin kryqe me theka që bien deri në shpatulla. Në imazhet e perandorit Murik - të ruajtura ende sot esencialisht në monedhat bizantine⁹⁹ - shohim gjithnjë të mbajtur në dorën e djathtë një *globus cruciger* të artë, emblemë e pushtetit perandorak, i cili emërtohej prej bizantinëve “molla” (μῆλον).¹⁰⁰ Prej pjesës së sipërme të globit del një kryq i artë. Ndër kronistët e hershëm që kanë shkruar mbi Murikun, emërtimin e globit me fjalën “molla”- “μῆλον” e ndeshim te Logoteti,¹⁰¹ por jo specifikisht në pjesën relative ndaj historisë së Murikut.¹⁰² Për sa i përket idesë të *thekave që bien mbi shpatullat e heroit*, po ashtu në portretet e perandorit Murik në monedhat bizantine¹⁰³, ose në përgjithësi në imazhet e shumicës së perandorëve bizantinë, dallohen pa vështirësi thekat (pendilia) e zbukuruara me gurë të çmuar ose perla që kapeshin në dy anët e kurorës, pranë veshëve dhe binin deri në afërsi të shpatullave. Funkcioni i tyre ishte të dallonte kurorat perandorake prej kurorave të mbajtura nga dinjitarët e tjerë të lartë. Megjithëse në rrjedhën e kohës kurorat perandorake bizantine kanë ndryshuar, ose ka pasur disa të tilla njëkohësisht të mbajtura në funksion të ceremonive, thekat kanë qenë pjesë përbërëse e të gjithave deri në shekullin XV.

Një informacion tjetër me interes ndeshet në “Kënga e luftës së Kosovës” te përshkrimi i qytetit të Prishtinës, i cili sipas rrëfimit (por

⁹⁸ LOGOTETI, 108, 8; HAMARTOLI, 563, 12.

⁹⁹ BELLINGER, Alfred R. *Catalogue of the Byzantine Coins in the Dumbarton Oaks Collection and in the Whittemore Collection, Volume One*, 1966, ff. 291-375; LXVI-LXXX.

¹⁰⁰ KAŽDAN, Alexander P., et al. *The Oxford Dictionary of Byzantium*. Oxford - New York: Oxford University Press, 1991, ff. 1936.

¹⁰¹ LOGOTETI 104. 10.

¹⁰² Ndërsa Logoteti përshkruan statujën e Justinianit të Madh në Konstandinopjë, ai përmend *mollën* e vendosur në dorën e majtë të perandorit. *Molla* simbolizon për kronistin botën nën sundimin e perandorit bizantin. Statuja ka qenë një nga monumentet më të njohura dhe madje ishte më e larta në Bizant deri në kohën e shkatërrimit në shekullin XVI. BERGER, Albrecht. *The Statues of Constantinople*. Cambridge University Press: Cambridge, 2021, 15-18.

¹⁰³ BELLINGER, 1966, ff. 291-375; LXVI-LXXX.

jo në realitet) formohet nga shtatë kulla mbi shtatë kodra. Në fakt, është Roma e lashtë dhe më pas vetë Konstandinopoja të cilat konsideroheshin në Mesjetë si të ndërtuara mbi shtatë kodra. Për Kostandinopojën ky informacion transmetohet në tekstet bizantine jo më herët se shekulli VIII.¹⁰⁴

Konvergjenca e narrativave

Këngët e “Ciklit të Kosovës” rrëfejnë së pari ngjarjet e Betejës së vitit 1389 por njëkohësisht transmetojnë, të ndërthurura, informacione të shumta me burimin në historinë e Mesjetës së hershme bizantine. Rrëfimi në të cilin perandori vendoset përpara zgjedhjes mes vazhdimit të sundimit në krye të mbretërisë ose vdekjes dhe shenjtërimit dhe në të cilin për shkak të tradhtisë së një personazhi të quajtur Vuka vriten nëntë princa, të afërm të perandoreshës, natyrisht nuk është ai i Milicës dhe Lazarit, të cilët nuk kishin tituj perandorakë dhe as nuk kanë pasur fatkeqësinë e humbjes së nëntë të afërmve për shkak të një tradhtie të pandodhur. Informacione të tilla nuk ndeshen në asnjë histori tjetër përveç asaj të perandorit Murik, Aelia Konstandinës, nëntë fëmijëve të tyre dhe gjeneralit Foka. Dhe natyrisht këto nuk janë paralelet e vetme. Për t’i kuptuar të gjitha analogjitë e shumta mes teksteve historike dhe rrëfenjave orale informacionet korrespondente janë paraqitur të sintetizuara në dy tabelat e mëposhtme.

¹⁰⁴ LØNSTRUP, Gitte. "Normativity and memory in the making: The seven hills of the old and new Rome." in: JACOBSEN Anders-Christian (ed.). *"Discursive Fight Over Religious Texts in Antiquity: the Discursive Struggle Over Religious Texts in Antiquity."* Aarhus: Aarhus University Press, 2009, ff. 85-106.

Analogjitë me historinë e Betejës së Kosovës

HISTORIA E BETEJËS SË KOSOVËS	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Heroi është një sundimtar i rëndësishëm i serbëve. Emri i heroit është Lazar. Gruaja e tij quhet Milica. Kryeqendra e shtetit të tij është Krushevaci. Kundërshtarët janë turqit. Prijësi i turqve është sulltan Murati. Turqit pushtojnë qytetin e Selanikut. Betejë mes turqve dhe serbëve. Vendi ku ndodhin ngjarjet është “Fushë Kosova” - “Kosovo Polje” Numri i ushtrive të vëllezërve Mërnjavçević është tridhjetë mijë vetë. Sulltani vritet në betejë.	Heroi është një perandor. I serbëve. Emri i heroit është Lazar. Gruaja e tij quhet Milica. Kundërshtarët janë turqit. Betejë mes turqve dhe serbëve. Vendi ku ndodhin ngjarjet është “Fushë Kosova” - “Kosovo Polje” Numri i ushtrive të vëllezërve Mërnjavçević është tridhjetë mijë vetë.	Heroi është një perandor. I serbëve. Emri i heroit është Lazar. Gruaja e tij quhet Milica. Kryeqendra e shtetit të tij është Krushevaci. Kundërshtarët janë turqit. Prijësi i turqve është sulltan Murati. Betejë mes turqve dhe serbëve. Vendi ku ndodhin ngjarjet është “Fushë Kosova” - “Kosovo Polje”. Fushëbeteja ndodhet pranë lumit Sitnica. Sulltani vritet në betejë. Vrasësi i tij quhej Millosh.	Heroi është një sultan. Njëra palë janë turqit. Prijësi i turqve është sulltan Murati. Turqit pushtojnë qytetin e Selanikut. Betejë mes turqve dhe kosovarëve. Vendi ku ndodhin ngjarjet është Kosova. Numri i ushtrisë turke është tridhjetë mijë vetë. Sulltani vritet në betejë. Vrasësi i tij quhej Milosh. Ishte një kalorës i veshur me pancir të

HISTORIA E BETEJËS SË KOSOVËS	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Vrasësi i tij mund të ketë pasur emrin Milosh. I përkiste elitës së kalorësisë të rëndë të krishterë. Kalorësi nuk ndalet prej gjuajtjeve të armëve të kundërshtarëve. Kalorësi do të vritet. Lazari vritet në betejë. Dhe shenjtërohet. Në betejë merr pjesë Vuk Brankoviç. Beteja përfundon me të vrarë të shumtë në dy kampet. Në Kosovë ndërtohet një tyrbe për sulltanin.	Lazari vritet në betejë. Dhe shenjtërohet. Në betejë merr pjesë Vuk Brankoviç. Beteja përfundon me të vrarë të shumtë në dy kampet.	Kalorësi do të vritet. Lazari vritet në betejë. Dhe shenjtërohet. Në betejë merr pjesë Vuk Brankoviç. Beteja përfundon me të vrarë të shumtë në dy kampet.	papërshkrueshëm nga armët. Kalorësi nuk ndalet prej gjuajtjeve të amëve të kundërshtarëve Kalorësi do të vritet. Sulltani bëhet martir fetar. Beteja përfundon me të vrarë të shumtë në dy kampet. Në Kosovë ndërtohet një tyrbe për sulltanin.

Analogjitë me historinë e Murik Tiberit

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Heroi është një perandor. Heroi është i birësuar. Heroi kryen ndërtime kishtare. Vendi i ndërtimeve dhe shumicës së ngjarjeve është Konstandinopoja. Ndërtimet janë veçanërisht për kishën e Nënës së Zotit. Në kishën ku perandori kryen ndërtime kungohen ushtarët. Përpara nisjes për në luftë. Një eklips i diellit, shoqëron përgatitjet për luftë. Dhe stuhi e erëra të forta.	Heroi është një perandor. Heroi kryen ndërtime kishtare. Vendi i ndërtimeve dhe shumicës së ngjarjeve është Kosovo Polje (toponim i afërt me Kostadinopojë). Kisha, e paemëruar, ndërtohet sipas kërkesës së Nënës së Zotit. Në kishën ndërtuar prej perandorit bekohen dhe kungohen luftëtarët. Përpara nisjes për në luftë.	Heroi është një perandor. Vendi i ndërtimeve dhe shumicës së ngjarjeve është Kosovo Polje (toponim i afërt me Kostadinopojë). Në agimin e ditës së nisjes për luftë «dielli bie poshtë». Lutje për perandorin që njëri nga vëllezërit të mos shkojë në	Heroi është një sultan. Epiteti i heroit kundërshtar është Kopili. Përpara nisjes në luftë hero i sheh në ëndërr se dielli dhe hëna bien në det. Pak vargje më tej ndeshim fjalinë: “dielli drit nuk bën” Manifestim hyjnor që rrëzon lisat dhe shkretot vendin. Interpretuesit e ogureve paralajmërojnë fatkeqësi.

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Interpretuesit e ogureve paralajmërojnë fatkeqësi. Lutje për perandorin që të mos shkojë në luftë, - nga e shoqja, fëmijët dhe dinjitarët. Dhe detyrën e tij t'ia lërë dikujt tjetër. Perandori nuk pranon. Ai kalëron në krye të ushtrisë. Kali i preferuar i perandorit është mbuluar me veshje të arta. Një pjesë e drurit të kryqit të Krishtit vendosur mbi një kolonë të artë i prin ushtrisë. Perandori mban në dorë një mollë të artë, simbol i pushteti bizantin, në imazhet e tij. Mbi mollë është vendosur një kryq i artë. Mbi supet e perandorit bien		luftë, - nga e shoqja. Dhe detyrën e tij t'ia lërë dikujt tjetër. Vëllai i perandoreshës nuk pranon. Ai kalëron në krye të ushtrisë. Kali i tij është mbuluar me veshje të arta; kuajt e perandorit janë mbuluar me veshje të arta. Një kalorës i mbuluar me kryqe të arta i cili lufton për kryqin dhe për Krishtin i prin ushtrisë. Emblema në flamurin e heroit është një mollë e artë. Prej mollës dalin kryqe të arta. Mbi supet e heroit bien thekat e kryqeve të mollës.	Sulltani u prin ushtarëve. Ushtria vendase pozicionohet në gryka malore në pritje të kundërshtarëve. Ushtria sulmuese bllokohet për tri ditë pa mundur të kalojë më tej.

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
thekat e kurorës bizantine. Ushtria vendase pozicionohet në gryka malore në pritje të kundërshtarëve. Ushtria sulmuese bllokohet për tri ditë pa mundur të kalojë më tej. Përpyekjet për të kaluar rezultojnë me humbje të shumta. Pas tri ditësh ushtria sulmuese përparon drejt kryeqendrës. Që është një qytet i ndërtuar mbi shtatë kodra. Ndëshkimi i armiqve prej Hyut, pas dhunimit të varrit të shën Aleksandrit, sjell vdekjen e një numri të lartë ushtarësh. Prej sëmundjes vdesin shtatë djemtë e Khaganit. Luftimet vijohen në shkallë dhe ushtria	Viktimat e para turke janë shtatë pashallarë. Luftimet vijohen në shkallë dhe ushtria kundërshtarë ndërtohet në formacione. Progresioni fillestar i numrave të të vrarëve vendas është: Nëntë mijë; dymbëdhjetë mijë; tridhjetë mijë. Dymbëdhjetë mijë ushtarë vendas do të vriten. Shkaktari i vrasjes së tyre është perandori (i cili vepron sipas	Dymbëdhjetë armiq do të vriten Vrasësi i tyre është Milloshi.	Përpyekjet për të kaluar rezultojnë me humbje. Pas tri ditësh ushtria sulmuese përparon drejt kryeqendrës. Që është një qytet me shtatë kulla në kodra. Ndëshkimi i armiqve prej Hyut, pas mallkimit të sulltanit (pasi ushtria e tij ka pësuar humbje) sjell vdekjen e një numri të lartë ushtarësh. Kundërshtarët e parë të osmanëve janë shtatë përbindës.

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
kundërshtare ndërtohet në formacione. Progresioni i numrave të të vrarëve kundërshtarë është: Nëntë mijë; pesëmbëdhjetë mijë; tridhjetë mijë. Dymbëdhjetë mijë ushtarë vendas do të robërohen dhe do të vriten. Shkaktari i vrasjes së tyre është perandori. Vrasja vjen pas rreshtimit qëllimisht të gabuar. Dymbëdhjetë mijë ushtarët paraqitnin rrezik për pushtetin perandorak. Perandori ka një vegim, ose sheh një ëndërr gjatë natës. Një ëngjëll i sjell një mesazh.	udhëzimeve hyjnore). Perandori rreshton ushtrinë dhe e gjithë ushtria vritet. Shën Elia i sjell një letër. Që është dërguar prej Nënës së Zotit. Në letër i kërkohet perandorit të zgjedhë nëse dëshiron një jetë të gjatë dhe mbretërinë e tij ose të vritet dhe të shenjtërohet në Mbretërinë e Qiejve. Sipas mesazhit së bashku me perandorin do të vriten dhe shenjtërohen edhe luftëtarët e tij. Perandori ka një letërkëmbim me Hyllindësen në	Dymbëdhjetë mijë ushtarë të zemëruar e tradhtojnë perandorin (së bashku me Vukën).	Sulltani sheh një ëndërr gjatë natës. Milloshit i sillet një letër. Që është dërguar prej sulltanit. Në letër i kërkohet të zgjedhë nëse pranon sundimin turk ose dëshiron luftën dhe shkatërrimin e vendit. Në ëndërrën e Sulltanit së bashku me të do të vritet edhe kryeveziri. Sulltani këshillohet me kryeklerikun

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Që është dërguar prej Zotit. Ëngjëlli i kërkon perandorit të zgjedhë nëse dëshiron një jetë të gjatë dhe mbretërinë e tij ose të vritet dhe të shenjtërohet në botën që do të vijë. Sipas mesazhit së bashku me perandorin do të vriten dhe shenjtërohen edhe familjarët e tij. Perandori ka një letërkëmbim me Klerin e qytetit të Jerusalemit mbi këtë zgjedhje. Ëngjëlli i lë perandorit njëzetë ditë kohë që të mendohet. Perandori zgjedh vdekjen dhe pranimin mes shenjtoreve. Ndodh shfaqja e një ylli ose komete. Pas vegimit ose ëndrrës perandori thërret	Jerusalem mbi këtë zgjedhje. Perandori zgjedh vdekjen dhe pranimin mes shenjtoreve. Vritet perandori. Dhe shenjtërohet. Vriten nëntë princa, të afërm të perandoreshës.	Vritet perandori. Vriten tetë princa, vëllezër të perandoreshës. Njëri prej vëllezërve duhet të shpëtojë për të dërguar mesazhe për perandorin. Paqartësi mbi fatin e tij, - ndërsa të vëllezërit vriten ai lufton ende. Perandoresha përpiket të shpëtojë vëllanë e vogël. Vëllai i vogël do të vritet.	pas shfaqjes së ogurit. Sulltani i lë Milloshit tri ditë kohë të konsultohet mbi zgjedhjen. Milloshi zgjedh të luftojë. Përpara nisjes së luftës heroit sheh në ëndërr (mes të tjerave) yje që bien në tokë. Pas ëndrrës sulltani thërret komandantin e rojave. Dhe kryevezirin, kryeklerikun dhe dinetakbixhinë. Megjithëse është mesnatë. Dinetakbixhia i shpjegon sulltanit dhe dinjitarëve se ëndrra paralajmëron vrasjen e sulltanit.

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
komandantin e rojave. Dhe gjenearin Filipikus. Megjithëse është mesnatë. I shpjegon atij vegimin, i cili paralajmëron vrasjen e perandorit; njëkohësisht astrologët shpjegojnë të njëjtën gjë. Oguri realizohet. Vritet perandori. Dhe shenjtërohet. Vriten nëntë fëmijët e tij dhe të perandoreshës. Vëllai i madh dërgohet nga perandori me një kërkesë për ndihmë në Persi. Paqartësi mbi fatin e tij. Mëndesha përpiqet të shpëtojë djalin e vogël. Vëllai i vogël do të vritet. Vritet perandoresha.	Vritet më i vogli i tre vëllezërve Mrnjavçeviç, të cilët në këngë të tjera sllavojugore zëvendësojnë vëllezërit Anici. Tradhtia e Vukës, sjell vrasjet dhe humbjen e pushtetit. Vdesin edhe pothuajse të gjithë luftëtarët serbë.	Perandoresha bie pa ndjenja mbi <i>gurin e ftohtë</i>. Në “Portat e Qytetit” Golubani do të marrë në krahë perandoreshën dhe do ta çojë të prehet në kullë. Tradhtia e Vukës, sjell vrasjet dhe humbjen e pushtetit. Vdesin edhe pothuajse të gjithë luftëtarët serbë.	Oguri realizohet. Vritet sulltani. Dhe bëhet martir. Në ëndrrën që paralajmëron vdekjet, trupat qiellorë, personifikime të sundimtarit dhe vezirit, bien në det. Vrasje e ndodhur pas rrëfimit të një

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Në vendin e quajtur „Porti i Eutropit“. Trupat e familjes perandorake hidhen në det. Gordia do të nxjerrë trupat e familjes perandorake dhe do t’i varrosë në manastir. Vritet (të paktën) më i vogli prej tre vëllezërve Anici. Vrasja e tij ndodh pas rrëfimit të një shërbyeseje. Tradhtia e Fokës, sjell vrasjet dhe humbjen e pushtetit. Vdesin edhe pothuajse të gjithë luftëtarët bizantinë që morën pjesë në kryengritjen e Fokës.	Vukashini shkelet nën këmbët e kuajve përpara se të vritet. Bardët e mallkojnë Vukun në vargjet e fundit të këngës.	Një personazh, i akuzuar se ka tradhtuar perandorin, ka dorën e prerë. Dora e tij e prerë mbahet në dorën tjetër. Vuka mallkohet prej Milutinit.	shkine (fjalë polisemike që ka edhe kuptimin shërbyese). Vriten shumë luftëtarë. Kosova bëhet “fet”. Sulltani qëllohet me shkelm prej Milloshit përpara se të vritet. Ide e mallkimit.

HISTORIA E MURIK TIBERIT	RËNIA E PERANDORISË SERBE	CAR LAZARI DHE CARESHA MILICA	KËNGA E LUFTËS SË KOSOVËS
Perandoria pëson fatkeqësi e shkatërtime të shumta. Foka vritet në një mënyrë makabre: Herakliu e qëllon me shkelm dhe më pas i priten këmbët dhe duart deri te supet. Dora e tij u ekspozua e vendosur mbi një shpatë. Foka emërtohet me epitelin “i mallkuar” prej kronistëve bizantinë.			

Për sa i përket përmbajtjes bizantine paralelet me të dhënat e këngëve janë në pjesën kryesore: informacione që prekin të gjithë historinë e perandorit Murik dëshmuar në tekstet bizantine dhe arameene prej konfliktit me avarët deri në episodin e ndëshkimit të vrasësit Foka; informacione me karakter fetar relative ndaj ndërtimeve kishtare dhe ndërhyrjeve hyjnore; dhe të dhëna të përgjithshme mbi paraqitjen e perandorit dhe mbi Kostadinopojën. Këto pjesë përputhen me përmbledhjet e shkurtra të informacioneve të historisë së Murikut që autorët e mëvonshëm bizantinë, siç Hamartoli, Logoteti apo krijuesit e Hagio-grafive, kanë përzgjedhur për të ruajtur në veprat e tyre, ndaj mund të shihen si më të pëlqyerat e autorëve mesjetarë apo si të gjykuara më të vlefshmet për t’u transmetuar, por përndryshe është e mundur që edhe pjesë të historisë së mëparshme të Murikut të jenë transmetuar e të ruhen ende sot mes këngëve të panumërta epike ballkanike.

Dallohet më tej fakti se këngët kanë një numër më të lartë informacionesh paralele - tri herë më shumë - me historinë e rënies së dinastisë justiniane sesa me atë të Betejës së Kosovës. Në këtë aspekt, ato

korrespondojnë shumë më tepër me historinë e perandorit Murik sesa me ngjarjet e fundshekullit XIV.

Është për t'u përmendur se rrëfimet janë transmetuar oralisht për një kohë mjaft të gjatë ndaj çdo informacion - qoftë edhe detajet e shumta thuajse të pamundura për të qetë rastësore - nëse studiohen veçmas nuk mund të ketë siguri për origjinën prej një ngjarjeje të caktuar, por përndryshe kur të gjitha paralelet vlerësohen së bashku probabiliteti i kushtëzuar i korrelacionit të bashkësive të të dhënave korrespondente rritet progresivisht. Në këtë rast, duke e konsideruar suitën e gjatë të paraleleve dhe faktin se përfaqësojnë shumicën e informacioneve të rrëfimeve të krahasuara atëherë probabiliteti tenton drejt sigurisë së plotë.

Tipologjia e korrespondencave është e ndryshme. Nëse këngët paraqesin analogji të shumanshme me historinë e perandorit Murik, ndërkohë ato kanë të përbashkët me ngjarjet e Betejës së Kosovës emrat e personazheve, emrat e popujve dhe toponimet. Vërehet qartë se bardët kanë mbivendosur onomastikën e historisë së konfliktit të vitit 1389 mbi një strukturë të mëhershme epike, e cila transmetonte rrëfimin e viteve të fundit dhe rënien nga pushteti të dinastisë justiniane.

Për më tepër historia bizantine e ndeshur në nënshtresë shpjegon pikëpyetjet e shumta ngritur prej krahasimeve studimeve të deritashme të epikës sllavojugore mbi divergjencat mes informacioneve të historisë orale dhe atyre të teksteve të shkruara relative ndaj Betejës. Kuptohet origjina e motivit të nëntë princave të vlarë, i cili siç është dalluar prej historiografisë serbe nuk e ka burimin në ngjarjet e shekullit XIV. Milica nuk ka pasur vëllezër të vlarë në Fushë Kosovë, dhe as i ati - i quajtur në realitet Vratko Nemanjić - nuk ka marë pjesë në betejë. Të dhënat e rrëfenjave në raport me nëntë princat i përkasin pjesës bizantine të këngëve dhe akoma më parë historisë së nëntë fëmijëve të Murikut dhe Aelia Konstandinës. Në këtë kontekst personazhi legjendar i Jug Bogdanit i referohet atij të perandorit Murik. Në vetvete antroponimi sllav *Bogdan* ka afërsi fonetike me titullin turkik *Khagan* dhe episodet e vdekjeve të njëmbëdhjetë princave avarë janë transmetuar prej bardëve, ndaj personazhi epik i Jug Bogdanit mund të besohet se është përfutur prej ndërthurjes së të dhënave mbi dy personazhet historike, Murikut dhe Khaganit, të cilët kanë pasur në këtë pjesë një histori të afërt.

Motivi i tradhtisë së princit Vuk Branković është rezultat i mbivendosjes së emrit dhe të dhënave rreth princit mesjetar serb në narrativën nënshtresore relative ndaj prijësit kryengritës Foka. Megjithatë

sjellja e Vukës gjatë betejës ishte e paqortueshme, madje heroike,¹⁰⁵ personazhit të tij i janë transpozuar aktet e centurionit Foka, me emrin e të cilit emri i Vukës ka afërsi fonetike. Në kohën e krijimit të këngëve të para të “Ciklit të Kosovës” këto afërsi tentonin drejt homonimisë së plotë: folësit e Mesjetës së Hershme të gjuhës shqipes në fjalët që kishin një zanore të dytë /o/, e asimilonin këtë në /u/¹⁰⁶. Në zanafillë të informacionit mbi titullin *car* dhënë për Lazarin është titulli perandorak i Murikut, heroit të rrëfimit fillestar të zëvendësuar së pari prej personazhit të Lazarit. Informacionet në sekuencën e përshkrimit të Boshkos mbi flamurin dhe emblemat e pakuptueshme, shpjegohen prej ruajtjes së vargjeve të vjetra, të cilat përshkruanin perandorin Murik ndërsa nisej në krye të ushtrisë drejt frontit avar. Paqartësitë e këngës hercëgovinase reflektojnë mangësitë, siç edhe njëkohësisht vështirësitë, e përshtatjes nga bardët e historisë së trashëguar dhe marrin kuptim vetëm nëse njohim simbolet e pushtetit perandorak bizantin. Për sa i përket pikërisht aktit të zhvendosjes së pozicionit të thekave, prej kurorës drejt mollës, arsyeja mund të jetë në faktin se Boshkua, hero i zëvendësues, nuk mund të mbante një kurorë mbretërore. Episodi i zgjedhjes mes jetës dhe shenjtërimit imponuar perandorit Lazar nuk arsyetohet në Ciklin e Kosovës. Nuk është dhënë asnjë shpjegim se përse Hyjnitë kanë vendosur përpara dilemës të zgjedhjes mes jetës apo pranimit në Mbretërinë Qiellore një sundimtar të paqortueshëm, të devotshëm, hero të Betejës së Fushë Kosovës. Në tekstet bizantine dhe arameene kjo pjesë kulmore e rrëfimit pason mëkatet dhe veprimet e dënueshme të perandorit Murik dhe vetë ndërhyrja hyjnore arsyetohet me përgjegjësinë e tij në ngjarjet e vrasjes së dymbëdhjetë mijë ushtarëve bizantinë. Në këngën “Rënia e perandorisë serbe” ndeshet informacioni i kërkesës së Hyjlindëses ndaj perandorit për të rreshtuar ushtarët në mënyrë që të humbasin betejën dhe të vriten, ndërsa në “Car Lazari dhe caresha Milica” ndeshet informacioni se dymbëdhjetë mijë ushtarë të zemëruar tradhtojnë carin, ndaj mund të arrihet në përfundimin se rrëfimi, jo fort i sigurt, i kronistëve bizantinë për rreshtimin qëllimisht të gabuar urdhëruar nga Muriku ka qenë i njohur dhe është transmetuar nga krijuesit e epikës mbi dinastinë dardane, së bashku me rrëfimin mbi fajin e vërtetë të mospagesës për lirimin e robërve. Këto janë njëkohësisht arsyet kryesore që do të sjellin zhvillimin e mëtejshëm të subjektit: ndërhyrjen hyjnore, vrasjet, shenjtërimin. Itinerari i ushtrisë turke përmes

¹⁰⁵ Fine, 1987, ff. 413.

¹⁰⁶ Shih: TOPALLI, Kolec. *Fonetika Historike E Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria, 2007, ff. 92.

qafës së Kaçanikut - që është një vend malor vështirë i kalueshëm larg në perëndim prej rrugëve fushore që lidhnin Fushë Kosovën me zotërimet osmane - shoqëruar me rrëfimin për marrjen e qyteteve dhe ndalesat treditore, shpjegohen prej sekuencës së narrativës burimore relative ndaj etapave të përshkruara gjatë përparimit të ushtrive avare drejt Kostadinopojës: ndalesat në qafat e maleve Ballkan; betejat dhe fitoret avare pranë qyteteve të ndryshme bizantine; pushtimin e vendbanimeve, mes të cilave më i rëndësishmi për përmbajtjen bizantine është Drizipera. Informacioni për letërkëmbimin mes perandorit dhe Jerusalemit - po aq i pagjasë në epikën ballkanike sa edhe në historinë mesjetare serbe - e ka zanafillën në episodin e letërkëmbimit të perandorit Murik me qendrat e rëndësishme fetare të Bizantit, prej së cilave Teofani përmend pikërisht vetëm Jerusalemin. Njëlloj informacioni legjendar mbi vëllanë e tretë, Gojkon, personazh i gojëdhënave të shumta, mund të shpjegohet prej përdorimit të historisë bizantine. Nëse gjatë procesit të përshtatjes së këngëve të vjetra për historinë e Betejës së Kosovës bardët mesjetarë nuk kanë pasur kujdesin e nevojshëm për t'i evituar Vukut gjestet e perandorit Foka apo për të saktësuar titullin e Lazarit dhe inkoherenca të tjera, ata janë kujdesur përndryshe të përmendin një vëlla të tretë, Gojko Mrnjavčevićin, i cili nuk ka ekzistuar në realitetin historik. Arsyeja e ruajtjes së informacionit është fakti se lahutarët janë përpjekur të mos humbasin këtë pjesë të këngës së vjetër, pasi Gojkua, dhe më herët familja Anici, konsideroheshin si paraardhës të bashkësive të tyre.

Dallohet kujdesi i lahutarëve për ruajtjen e sa më shumë prej të dhënave fillestare, edhe kur përshtatja e këngëve ndaj historisë së re impononte mbivendosje të personazheve të cilët kishin një histori dhe karakteristika të ndryshme nga heronjtë e zëvendësuar. Përveç informacioneve që i referoheshin Murikut, familjes së tij, Fokës apo Germanusit, është ruajtur epiteti legjendar *kopili* i cili ka kuptimin *fëmijë i gjetur* dhe si i tillë është fyes e i çuditshëm për identifikimin e një heroi pozitiv. Tekstet historike e përcjellin mbiemrin *Kopili* shumë kohë pas Betejës së Kosovës, ndërsa ato ishin influencuar gjerësisht prej legjendave dhe ndërkohë në këngët e studiara vetë emri i Miloshit ka zvendësuar shpesh atë të mëparshëm të Murikut, ndaj mund të deduktohet se fjala *kopili* është një epitete formulaik, i cili e ka origjinën në pjesën bizantine të Ciklit. Një fakt më shumë që tregon se epitete dhe personazhi i Miloshit janë ndërtuar duke përdorur të dhëna mbi personazhin e Murikut është emri Jela¹⁰⁷ i traditës orale sllavojugore për gruan e Miloshit, emër që është mjaft i afërt me atë Aelia, të gruas së perandorit Murik. Heroi i të

¹⁰⁷ Emmert, 1990, ff. 111-2.

krishterëve që vrau Muratin I në Fushë-Kosovë mund të ketë pasur vërtet emrin Milosh, ose ndoshta kishte një emër të afërt siç ai Miklos, por për sa i përket epitetit të tij legjendar ky është qartësisht një mbijetojë e nënshtresës. Ndërsa kryenin procesin e mbivendosjeve lahutarët e kanë gjykuar si një mundim të panevojshëm heqjen dhe zëvendësimin e epitetit të mëparshëm të perandorit bizantin.

Kujtimi i emrit të Goridës po ashtu është ruajtur. Veprimi që Gordia kryen, varrosja e familjarëve të saj të vrarë në manastir është konsideruar si më i përshtatshëm të kryhej nga një burrë, ndaj emri Gordia është transformuar në atë Goluban, emrin më të afërt mashkullor që lahutarët kanë njohur.

Dallohet më tej se informacionet relative ndaj një personazhi të mëparshëm të zëvendësuar mund t'u caktohen heronjve të rinj të ndryshëm. Jo të gjitha informacionet që në zanafillë i referoheshin Fokës i janë caktuar personazhit të Vuk Brankoviçit. Ngjarjet e vrasjes makabre të urdhëruar prej Herakliut iu janë transpozuar personazheve të tjerë: mbretit Vukashin, emri i të cilit ka afërsi me atë të Fokës në këngën *Rënia e perandorisë serbe*; shërbyesit Milutin në këngën hercëgovinase; apo Muratit në këngën shqiptare. Vuk Brankoviçi ka jetuar edhe tetëmbëdhjetë vjet pas Betejës së Kosovës, dhe ky fakt mund të dihej në kohën e krijimit të këngëve që, siç është përmendur, është dalluar se ka ndodhur jo shumë kohë - ndoshta veç disa dhjetëvjeçarë - pas vitit 1389.¹⁰⁸ Po ashtu informacioni për vrasjen e nëntë fëmijëve të Murikut nuk i është transpozuar personazhit të car Lazarit, heroit kryesor të zgjedhur për zëvendësimin e personazhit të perandorit bizantin, por një të dyti, Jug Bogdanit, të paraqitur me dy emra të cilët mund t'u përkisnin në një stad të mëhershëm dy personazheve të ndryshëm të epikës. Arsyeja e moszgjedhjes së Lazarit mund të jetë njëllor fakti se historia e trashëgimtarëve të prijësit serb ka qenë e mirënjohur për një kohë të gjatë pas betejës: dy djemtë e tij nuk janë vrarë në vitin 1389 në Fushë Kosovë dhe djali më i madh në moshë, Stefani (1377-1427), ishte një ndër sundimtarët më të rëndësishëm ballkanikë në gjysmën e parë të shekullit XV.

Vendi ku perandoresha rrëzohet në tokë, *Portat e Qytetit (Otvore na Gradu)*, emërtohet në historinë e Aelia Konstandinës si *Porti i Eutropit*. Transformimi kuptimor ka ndodhur për shkak të homonimisë së dy fjalëve në gjuhën shqipe ose në latinishten ballkanike, - në gjuhët

¹⁰⁸ Në fillimin e shekullit XVI tekstet historike mbi Betejën e Kosovës paraqiten të influencuara nga legjendat orale. EMMERT, 1990, ff. 95-100.

sllavojugore konceptet “portat e qytetit”-“otvore na gradu” dhe “port detar” – “luka” identifikohen me fjalë të ndryshme nga njëra-tjetra. Këngët e vjetra mbi heronj bizantinë dhe dardanë të shquar në luftën kundër avarëve dhe sllavëve nuk mund të jenë krijuar nga popullsitë sllavishtfolëse. Ato janë përkthyer prej bashkësive ballkanike mbartëse të eposit, paraardhëse të shqiptarëve si edhe të vetë popullsive sllavojugore dhe procesi mund të ketë ndodhur në të njëjtën kohë që bashkësitë zëvendësonin gjuhën e tyre të mëparshme me gjuhët sllavojugore.

Nëse krahasojmë historinë e perandorit Murik me atë të princit Lazar, vihet re se të dyja përmbajnë në vetvete analogji. Subjekti i të dyjave është humbja e pushtetit dhe dy personazhet kryesorë janë sundimtarë të rëndësishëm të shenjtëruar pas vdekjes nga kishat ortodokse të Bizantit dhe Serbisë. Afërsi paraqesin edhe emrat e dy personazheve negative, Fokës dhe Vukës, si edhe toponimet Kostadinopojë dhe Kosovo Polje. Pikëtakimet e shumta mes dy narrativave janë faktori që ka sjellë konvergjencën dhe më pas ndërthurjen e dy rrëfimeve në një të vetëm. Për të ndërtuar ciklin epik të Kosovës lahutarët kanë përdorur këngët me subjekt rënien e dinastisë dardane për arsyen se mes tyre dhe historisë së Betejës së Kosovës ekzistonin prej zanafillës afërsi të shumanshme.

Procesi i konvergjencës dhe gërshetimeve dallohet edhe brenda të dhënave të të njëjtës këngë, kur këto ishin të afërta me njëra-tjetrën. Dy heronjtë kryesorë në këngët sllavojugore, Lazari dhe Miloshi paraqiten si një i vetëm në atë shqiptare, në të cilat nuk ndeshim personazhin e Lazarit, gjestet e të cilit i pranëvendosen atyre të Miloshit. Shifra më e rëndësishme për historinë e dymbydhjetë mijë luftëtarëve të vararë bizantinë dhe shifra e pesëmbëdhjetë mijë luftëtarëve avarë të vararë janë gërshetuar dhe kanë rezultuar në vetëm shifrën dymbëdhjetë mijë. Personazhi legjendar i Jug Bogdanit u referohet dy personazheve të ndryshëm historikë, të cilëve u kishte ndodhur e njëjta fatkeqësi. Po ashtu episodet e ogureve në dy sekuenca të ndryshme të historisë nënshtresore (në etapat e para të konfliktit me avarët dhe përpara vrasjes së familjes perandorake) janë gërshetuar në një episod të vetëm.

Shkurtimisht procesi i krijimit të këngëve mbi Betejën e Kosovës mund të përshkruhet me frazën: pak humbje, pak krijim, shumë zëvendësime. Është dalluar edhe më parë në rrafshin e studimeve epike se gjatë procesit të modifikimit të teksteve orale ekziston një tendencë për të ruajtur sa më shumë prej ideve të trashëguara, edhe atëherë kur këto nuk

kanë ndonjë rol esencial në narrativë.¹⁰⁹ Ishte në interesin e lahutarëve që kënga e deklamuar të dëgjohej, të pëlqehet dhe në fund të performancës ata të merrnin një pagesë të kënaqshme, por cilado të ishte zotësia e tyre është e vështirë të kompozohet një këngë e re po aq cilësore sa këngët e mëparshme, të krijuara dhe përmirësuara prej një kohe të gjatë nga breza lahutarësh dhe pëlqimi i të cilave është konfirmuar. Nëse lahutari vendos të përshtatë një këngë të vjetër të repertorit të tij për ngjarjet e kohës nuk është njëkohësisht i lehtë modifikimi apo krijimi i vargjeve të reja të cilat duhet të vendosen brenda këngës së vjetër duke respektuar një metrikë dhe stilistikë të caktuar dhe duhet të kenë një cilësi poetike po aq të mirë sa vargjet e tjera. Këto vështirësi e më përgjithësisht pragmatizmi i lahutarëve janë një nga arsyt kryesore të ruajtjes së të dhënave, apo madje vargjeve dhe grupvargjeve të plota prej rrëfimeve fillestare. Një arsye e dytë është dëshira për të mos humbur informacionet mbi heronjtë të cilët bashkësitë e malësorëve i kanë nderuar ndër shekuj.

Në vend të mbylljes: indikacione për kërkime të tjera

Në këngët e “Ciklit të Kosovës” nuk ndeshen emrat e perandorit Murik dhe Aelia Konstandinës. Të dy janë zëvendësuar prej emrave të personazheve të shekullit XIV, por njohësit sado sipërfaqësorë të epikës shqiptare do të dallojnë afërsinë e madhe mes dy emrave perandorakë bizantinë me ato të kryeheroit të Ciklit të Kreshnikëve, Gjeto Mujit dhe gruas së tij Ajkunës, ose Kunës sipas varianteve.¹¹⁰ Emri i Mujit është

¹⁰⁹ Një shembull domethënës është ai i konstatuar te regjistrimet e rapsodit Sulejman Fortić, i cili recitoi për Parry dhe Lord të njëjtën këngë në vitin 1934 dhe më pas në 1950. Mes kësaj periudhe Fortić ishte zgjedhur kryetar i Frontit Popullor të Pazarit të Ri dhe, sipas Lord, si zyrtar i shtetit socialist të Jugosllavisë e kishte gjykuar të papërshtatshme, ose jo të mençur, përmendjen e një episodi ku rrëfehej një mbledhje në xhaminë e qytetit, ndaj në recitim të dytë ai e kishte hequr këtë pjesë. Në variantin e parë, një lajmëtar shkon te shtëpia e heroit të rrëfimit, Alisë, dhe aty nëna i thotë se i biri ndodhej me burrat e tjerë në xhami, ndërsa në të dytin rapsodi është përpjekur të ruajë idenë e një ndërmjetësi ndaj e dërgon lajmëtarin më parë diku, përkatësisht te Muji dhe Halili në Kladushë, dhe më pas dy kreshnikët do ta shoqërojnë për te shtëpia e Alisë. LORD, 1971, ff. 119.

¹¹⁰ Në Ciklin shqiptar të Kreshnikëve ekzistojnë këngë të cilat ruajnë motive prej jetës së perandorit Murik, por nuk ka të tilla që transmetojnë një numër të lartë motivesh prej pikërisht ngjarjeve të fundit të jetës së tij. Ruhen vetëm informacione të përgjithshme të shpërndara në rrëfime të ndryshme mbi vrasjen e tetë djemve të Mujit dhe Ajkunës, tetë omerëve (emërtim që mund të ketë origjinën në mbiemrin Tiberius ose prej fjalës „amir“) në të cilat vrasësi emërtohet me sintagmën Vuka Harambasha. Ky emër i fundit është i afërt me atë të Fokës, ndërsa epiteti harambasha ka kuptimin kryemallkuari. E

menduar më parë si diminutiv i atij Mustafa,¹¹¹ ndërsa për emrin e Ajkunës nuk është gjetur ndonjë shpjegim. Por rregullat e evoluimit të huazimeve të vjetra latine në gjuhën shqipe konfirmojnë përndryshe origjinën e trajtave *Muj* dhe *Ajkuna* prej *Mauricius* dhe *Aelia Constantina*.¹¹² Për sa i përket epitetit *gjeto*, ai është dalluar se ka kuptimin “fëmijë i gjetur”¹¹³ dhe në këtë aspekt është i njëjtë me epitetin e Miloshit.

Përveç epikës shqiptare, edhe në atë malazeze ndeshim një personazh me të njëjtin epitë, Nahod Momir (Momir fëmija i gjetur), motivet rreth të cilit kanë afërsi me historinë e perandorit Murik.¹¹⁴ Në epikën boshnjake ekziston një personazh sintagma emër-epitë e të cilit,

vetmja këngë e Ciklit të Kreshnikëve që paraqet një suitë analogjish, jo të gjatë, me historinë e vrasjes së familjes perandorake dhe me këngën “Car Lazari dhe caresha Milica” është kënga “Ajkuna kjan Omerin”. Përveç manifestimeve hyjnore dhe paralajmërimit të fatkeqësive nëpërmjet eklipsimit të trupave qiellorë, rrëfimi për humbjen e ndjenjave të Milicës ndërsa sheh të kalojë portën e qytetit vëllai i fundit dhe marrjen e saj në krahë prej Golubanit për ta çuar në kullë, korrespondon me rrëfimin për humbjen e jetës së Ajkunës pas vrasjes së djalit të fundit dhe lutjeve që gruaja u ka bërë Hyjnive të vdesë dhe të varroset afër tij. Hyjnitë ia ndalin zemrën dhe e marrin në krahë (literalisht vetë e bajnë) për ta çuar në Jutbinë. Për këngën “Ajkuna kjan Omerin”: PALAJ, Bernardin; Kurti, Donat. *Visaret e Kombit*, vëll II. Tiranë: Shtypshkronja Nikaj, 1937, ff. 218-223. Fjala *amir*, e përdorur nga rapsodët me kuptimin *emirët* ose *princat*, dallohet në këngët e mbledhura prej Parry dhe Lord. Shih: Milman Parry Collection of Oral Literature. Lord Albanian Collection. LAN 28. PLUMBI, Gjergj. *Kangen e Musa Qeshexhisë dhe Vlla Bergjanine Gjemi*. Theth, September 13, 1937.

¹¹¹ ELSIE, Robert. *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture*. London: Hurst, 2001, ff. 183.

¹¹² Emrat e vjetër shqiptarë kontraktohen pothuajse gjithnjë në forma një ose dyrrrokëshe. Për sa i përket atij *Constantina* kur huazimet e vjetra latine kishin një fonemë të dytë /o/, folësit e hershëm të shqipes e asimilonin në /u/. TOPALLI, 2007, ff. 92. Për sa i përket emrit *Mauricius*, - kur në huazimet e hershme latine të shqipes zanorja e dytë ishte /i/, atëherë i gjithë grupi midis dy zanoreve reflektuhej si /y/”. *Mauricius* ka dhënë formën **Muy*, dhe - për të lehtësuar artikulimin - më tej *Muj*, siç fjala *jūdicāre* ka evoluuar në *gjykoj* apo *cīvitātem* në *qytet*. Cf: OREL, Vladimir E. *A Concise Historical Grammar of the Albanian Language: Reconstruction of Proto-Albanian*. Leiden - Boston - Köln: Brill, ff. 36. Forma korespondente e *Mauricius* e ndeshur sot ndër shqiptarë është *Murik*, por në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për një huazim të Mesjetës së Hershme por për një rihuazim më të vonë.

¹¹³ Kuptimi *fëmijë i gjetur* për emrin *Gjeto*, është dalluar prej studiuesi Shaban Sinani në studimin e një kënge shqiptare me subjekt një personazh të birësuar. SINANI, Shaban. *Tradita gojore si etnotekst: Studime per etno-folkloristike krahasimtare*. Tiranë: Naimi, 2012, ff. 327

¹¹⁴ Vuk II, n. 30.

Muio Tsarevitch (Mujo djali i perandorit),¹¹⁵ është po ashtu domethënëse. Në kujtesën popullore rumune - është dalluar tanimë - se janë ruajtur motive legjendare prej historisë së perandorit Murik. Në gojëdhënat rreth princit rumun Konstantin II Brâncoveanu (1654-1714) ndeshim motivin e vjetër bizantin të zëvendësimit të djalit të Murikut nga mëndesha për ta shpëtuar prej vrasësve.¹¹⁶

Në “Kënga e Luftës së Kosovës” transmetohet ideja mjaft e veçantë mbi shtrirjen e qytetit të Prishtinës në shtatë kodra, ide që ndeshet vetëm pas shekullit të VIII në tekstet bizantine që i referohen Kostadinopojës. Autorët e mëhershëm që kanë shkruar mbi qytetin nuk e përmendin - për arsyen se ai nuk kishte arritur ende shtrirjen e shekullit VIII - prandaj informacioni nuk mund të ketë hyrë në tekstet epike ballkanike më herët se shekulli VIII. Në të njëjtën linjë, emri i princit më të vogël që sipas traditës ballkanike është Konstandin¹¹⁷ dëshmohet, gabimisht¹¹⁸, për njërin nga djemtë e Murikut vetëm në kronikën “Historia Langobardorum” të diakonit benediktin Paul (Paulus Diaconus; -r.,799), shkruar në vitet e fundit të dhjetvjeçarit 780.¹¹⁹ Pra këto indicie - natyrisht të pamjaftueshme - tregojnë se poetët e parë mund të kenë përdorur tekste të shkruara për krijimin e poemave me subjekt rënien e dinastisë dardane dhe se koha e krijimit nuk është më e hershme se fundi i shekullit VIII.

Një fakt tjetër i dallueshëm është modifikimi i skajshëm i elementëve të historisë bizantine në “Këngën e luftës së Kosovës”. Megjithëse në të ruhen detaje të vështira për t’u memorizuar, në anën tjetër disa sekuenca ndër më të rëndësishmet dhe më tërheqëset, siç është episodi i zgjedhjes mes dy mbretërive imponuar prej hyjnive dhe komunikimit nëpërmjet letrave me Klerin e qytetit të Jerusalemit, paraqiten të transformuara në një rrëfim letërkëmbimi trivial mes sulltanit dhe Milloshit. Arsyet e modifikimit lidhen me faktin se lahutarëve u është dashur ta përshtatin këngën me kulturën e bashkësive të tyre, në të cilën referencat e fesë së krishterë nuk bënin më pjesë. Fatmirësisht për këtë rast vendosja e paraleleve me historinë bizantine mundësohet me ndërmjetësimin e variantit serb në të cilin këto të dhëna janë ruajtur mirë, por në raste të

¹¹⁵ Dozon A. Poésies populaires serbes. Paris: E. Dentu, 1859, ff. 238.

¹¹⁶ FOCHI, Adrian. *Cîntecul Epic Tradițional Al Românilor: Încercare De Sinteză*. Bucharest: Editura Științifică și Enciclopedică, 1985, ff. 104-105.

¹¹⁷ Shih shënimin 86.

¹¹⁸ Sipas Chronicon Paschale - burim më i afërt në kohë dhe hapsirë dhe më i besueshëm sesa Historia Langobardorum - emrat e djemve të Murikut ishin Theodosius, Tiberius, Petrus, Paulus, Iustinus dhe Iustinianus, ndërsa të vajzave: Anastasia, Theoctista dhe Cleopatra. MARTINDALE, 1992, ff. 856.

¹¹⁹ Paul the Deacon, ed. Edward Peters, 2013, Book IV, 26.

tjera¹²⁰, atëherë kur nuk ndeshen variante të huaja më rezistente ndaj modifikimeve, mund të kemi veç dyshime dhe të presim studime të reja mbi tekste epike me motive të afërta dhe me të njëjtin burim. Nëse ky studim mundëson kuptimin e një pjese prej procesit të krijimit të tri këngëve të Ciklit të Kosovës dhe shpjegon arsyet e inkoherencave të ndeshura në to, ai njëkohësisht sjell ngritjen e pikëpyetjeve të reja, të shumta, përgjigjet ndaj të cilave, të shpresojmë, nuk do të vonojnë.

RÉSUMÉ

L'objet de cette étude sont trois chansons du Cycle épique de Kosovo, des matières serbe, herzégovinienne. J'ai sélectionnés et comparés ces informations avec les textes historiques médiévaux relatifs à la première bataille du Kosovo en 1389 et l'histoire byzantine des siècles VI-VII. Les parallèles que j'ai présenté dans l'article avec l'histoire byzantine je les ai expliqués par l'hypothèse de l'existence d'un processus de transpositions entre des données, généralement de l'ordre onomastique, en relation avec le conflit de fin XIVe siècle et une structure antérieure épique construite pour la transmission de l'histoire de la chute du pouvoir de la dynastie justinienne. Le contenu byzantin sous-jacent permet d'expliquer conjointement toutes les inexactitudes historiques et les motifs irrationnels présents dans les trois chansons.

Mots-clés: Bataille de Kosovo, épopée, tsar Lazare, Maurice Tibère, histoire byzantine, étude comparée.

¹²⁰ Është e mundur që informacione të tjera, më pak të qarta, të të tri këngëve të kenë origjinën në historinë e Murikut. Ideja e themeleve prej mëndafshi të kuq të kishës në të cilën do të kungohen luftëtarët, që në rrëfimin burimor ishte kisha e Shën Marisë së Blankhernës, mund të ketë origjinën në faktin se në këtë kishë, të konsideruar prej bizantinëve si më e shenjta e Kostandinopojës, ndodheshin reliket mbrekullibërse të veshjeve të Hyjlindës. Nuk janë ruajtur të dhëna mbi materialin dhe ngjyrën e tyre, por ngjyra e veshjeve të Shën Marisë në ikonat e kishës së Blankhernës është pikërisht e kuqja. Po ashtu është mjaft interesant fakti i përmendjes së zogjve, veçanërisht dallëndysheve, pasi e njëjta ide e dallëndysheve ndeshet edhe në baladat legjendare shqiptare me motivin e nëntë vëllezërve të vrarë. Burimi i motivit mund të jetë në faktin se fjala “dallëndyshe” në greqishten e kohës “χαλιδών”, ishte mjaft e afërt fonetikisht me toponimin Kalkidon (Χαλκηδών), të vendit ku sipas kronikave bizantine u ekzekutuan me urdhër të Fokës perandori, Aelia Konstandina dhe tetë prej nëntë fëmijëve të vrarë. Në të njëjtën linjë ideja e zogjve mund të jetë zhvilluar prej toponimit të fushëbetejës: Fjala “kos” ka kuptimin “mëllënjë” në gjuhët sllavojugore.

Muhamedin Kullashi, Prishtinë

KULTI I MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE ZHBËRJA E FILOZOFISË

Abstrakt

Në këtë artikull kemi shtruar pyetjen se çka ka ndodhur me filozofinë dhe në veçanti me filozofinë e Marksit brenda marksizëm-leninizmit si ideologji zyrtare e regjimeve komuniste. Është Stalini ai që do ta radikalizojë versionin më dogmatik të marksizmit në vitin 1924, duke e kanonizuar leninizmin si “marksizëm i epokës së imperializmit dhe revolucionit proletar”. Materializmi dialektik dhe ai historik bëhen bërthamë konceptuale e ortodoksisë staliniste; kjo bëhet normë në gjirin e Internacionales Komuniste. Për Stalinin, materializmi dialektik u jep “të gjitha dijeve një metodë absolute”.

Kemi vënë në pah se kulti i marksizëm-leninizmit, si pjesë e rëndësishme e sistemit partiak-shtetëror në regjimet komuniste, me aktivizmin dhe me parimin e vigjilencës së shërbyesve të vet, është kujdesur gjatë decenieve, që të mënjanojë nga manualët dhe ligjërimet, gjithë atë që e bën të gjallë e kritik të menduarit filozofik. Që në manuale lë vend vetëm për një mendim “të mineralizuar, një rrasë varri”, siç shkruante Sartri, në të cilën duhen ngulfatur përsiatjet, dyshimet, kërkimet, duke lënë të veprojë vetëm një pasion, ai i frikës. Duke e varfëruar të menduarit, pushtetmbajtësit e regjimeve komuniste kishin parasysh dobësimin dhe varfërimin e veprimeve të njeriut, reduktimin e tyre në reagime të automatizuara, në nënshtrim e përkorje. Pa harruar se regjimet komuniste, siç vë në pah Claude Lefort, synonin përvetësimin, jo vetëm të formave të caktuara të dijes, po edhe atë të “njohjes së parimeve dhe qëllimeve të fundit të jetës sociale”.¹

Në ish-Jugosllavi, nga vitet 1970 zhvillohen brenda shkollës filozofike të Universitetit të Zagrebit dhe revistës “Praxis” konceptione filozofike të thella e të begatshme. Petrović-i dhe Kangra, me gjithë dallimet që kanë (bie fjala, me stilin e të filozofuarit), e kuptojnë njeriun përmes kategorisë praxis, e sajuar me rimendimin e disa aspekteve të filozofisë antike greke dhe të filozofisë klasike gjermane. Ndryshe nga qasjet jo vetëm të marksizëm-leninizmit, por edhe të atyre pozitiviste e pragmatiste, praxis emërton, për ata, një mënyrë të veçantë të qeniesimit, specifike për njeriun: e lirë, universale dhe krijuese. Kjo mënyrë e qeniesimit shikohet si unike e njëherazi e diferencuar në aktivitete të shumta, duke tejkaluar po kështu ndarjet e të menduarit-aksioni, trupi-shpirti etj.

Fjalët çelës: kulti i marksizëm-leninizmit, regjimet komuniste, shkolla filozofike e Zagrebit, Sartre dhe Lefort

¹ Claude Lefort, *L'invention démocratique*, Fayard, Paris, 1994, f.174.

MARKSIZËM-LENINIZMI SI IDEOLOGJI SUNDUESE

Çështjen me të cilën do të merrem në këtë artikull do ta formuloja kështu: çka ndodhi me filozofinë e Marksit, në veçanti dhe me filozofinë në përgjithësi, brenda marksizëm-leninizmit si ideologji zyrtare e regjimeve komuniste? Do t'i kem këtu parasysh disa procese politike e ideologjike në Bashkimin Sovjetik (BS), në Francë dhe në ish-Jugosllavi. Marksizëm-leninizmi u sajua si ideologji zyrtare e regjimeve komuniste, e kanonizuar që nga vitet 20 të shekullit të kaluar në BS. Kjo shprehje emërton së pari interpretimin e marksizmit nga Lenini e më vonë edhe të leninizmit, të cilin Stalini dhe stalinizmi e ngritën në nivelin e *të vetmit botëkuptim të mirëfilltë shkencor*. Marksizëm-leninizmi u bë ideologjia sunduese jo vetëm në Bashkimin Sovjetik por edhe në Internacionalen Komuniste dhe, pas Luftës së Dytë Botërore, në regjimet e tjera komuniste, me gjithë disa dallime ideologjike midis tyre. Mizanskëna e ceremonive të larta shtetërore e partiake komuniste përmbante doemos sloganet “Lavdi marksizmit-leninizmit” si lutje rituale.

Në këtë artikull kemi shtruar pyetjen se çka ka ndodhur me filozofinë dhe në veçanti me filozofinë e Marksit brenda marksizëm-leninizmit si ideologji zyrtare e regjimeve komuniste? Do t'i kem këtu parasysh disa procese politike e ideologjike në Bashkimin Sovjetik (BS), në Francë dhe në ish-Jugosllavi. Është Stalini ai që do ta radikalizojë versionin më dogmatik të marksizmit në vitin 1924, duke e kanonizuar leninizmin si “marksizëm i epokës së imperializmit dhe revolucionit proletar”, leninizmin si “teori dhe taktikë e revolucionit proletar në përgjithësi”; kjo nënkupton suprimimin jo vetëm të multi-partizmit, por edhe të rrymave brenda kësaj partie-shtet, si, fjala vjen, këshillat e punëtorëve, në emër të të cilëve u bë Revolucioni i Tetorit. Stalini do të punojë që kjo doktrinë të bëhet *e obligueshme* për të gjitha partitë e regjimet komuniste. Leninizmi e stalinizmi u ngritën në rangun e *ideologjisë shtetërore*. Materializmi historik e dialektik bëhen gjithnjë e më të varfër teorikisht në këtë përpunim të partisë-shtet. Gradualisht, debatet filozofike eliminohen në BS dhe detyrohen t'u nënshtrohen linjës së Partisë për këto çështje, formave të kanonizuara si marksizëm-leninizmi dhe materializmi dialektik. Materializmi dialektik dhe ai historik bëhen bërthamë konceptuale e ortodoksisë staliniste; kjo bëhet *normë* në gjirin e Internacionales Komuniste. Për Stalinin, materializmi dialektik u jep “të gjitha dijeve një metodë absolute”.

Lenini kishte definuar rolin prijës të një partie mbi shtetin dhe shoqërinë, si avangardë e klasës punëtore për ta zhvilluar luftën e klasave qysh në tekstin *Ç'të bëjmë?* në vitin 1902². Për Leninin, në rrafshin filozofik, materializmi dialektik është botëkuptim i përgjithshëm në filozofi, shkenca e lëmenj të tjerë. Në *Materializmi dhe empirio-kriticizmi* (1909) ai afirmon “frymën e partisë në filozofi”. Konceptimi leninist i organizimit politik supozon ndarjen në kampin revolucionar, i cili shtrihet edhe mbi idetë. Materializmi dialektik është në gjendje të kapë “të vërtetën absolute, e cila del si një shumë e të vërtetave relative”. Teza themelore “ontologjike” e materializmit dialektik pohon epërsinë e natyrës ndaj shpirtit, të materies ndaj vetëdijes, të fizikës ndaj psikikës. Kjo tezë mbi raportin e qeniesimit me të menduarit kuptohej si çështje themelore e çdo filozofie, sipas së cilës të gjithë filozofët ndahen në dy taborre të mëdha, në idealistë, që mbrojnë epërsinë e shpirtit ndaj natyrës, dhe në materialistët që mendojnë se primati i takon natyrës; afirmohej karakteri “reaksionar” i rrymës së parë dhe karakteri “përparimtar” i të dytës.

Në kongresin X të Partisë Komuniste, Lenini imponon rezolutën sipas së cilës “marksizmi na mëson se vetëm partia politike e klasës punëtore, pra Partia Komuniste, është në gjendje të tubojë e të organizojë avangardën e proletariatit dhe të gjitha masave punonjëse”³. Është Stalini ai që do ta radikalizojë këtë qëndrim në vitin 1924, duke e kanonizuar leninizmin si “marksizëm i epokës së imperializmit dhe revolucionit proletar”, leninizmin si “teori dhe taktikë e revolucionit proletar në përgjithësi”; kjo nënkupton suprimimin jo vetëm të multi-partizmit, por edhe të rrymave brenda kësaj partie-shtet, si, fjala vjen, këshillat e punëtorëve, në emër të të cilëve u bë Revolucioni i Tetorit. Stalini do të punojë që kjo doktrinë të bëhet *e obliqueshme* për të gjitha partitë e regjimet komuniste. Leninizmi e stalinizmi u ngritën në rangun e *ideologjisë shtetërore*. Materializmi historik e dialektik bëhen gjithnjë e më të varfër teorikisht në këtë përpunim të partisë-shtet. Gradualisht, debatet filozofike eliminohen në BS dhe detyrohen t'u nënshtrohen linjës së Partisë për këto çështje, formave të kanonizuara si marksizëm-leninizmi dhe materializmi dialektik. Materializmi dialektik dhe ai historik bëhen bërthamë konceptuale e ortodoksisë staliniste; kjo bëhet *normë* në gjirin e Internacionales Komuniste. Për Stalinin, materializmi dialektik u jep “të gjitha dijeve një metodë absolute”. Materializmi historik, ndërkaq, imponohet si zbatim i parimeve të materializmit

² Labica dhe Bensoussan 1982: 567.

³ Po aty: 716.

dialektik mbi jetën sociale, e dialektika si metodë e hulumtimit për të verifikuar nëse njëra apo tjetra shkencë i respekton këto parime. Stalini e heq, fjala vjen, parimin e mohimit të mohimit, si thjesht hegelian. Zhvillohet një literaturë ortodokse për të komentuar këtë konceptim të materializmit dialektik, i cili supozohet të jetë një *tërësi e parimeve më të larta dhe si burim i çdo diturie*. Vizioni i kodifikuar nga Stalini i materializmit dialektik sundon në Bashkimin Sovjetik, e pas vitit 1945 në regjimet e bllokut të Lindjes – si tërësi e filozofisë; specialistët e kësaj filozofie janë në funksione udhëheqëse të institucioneve shkencore. Edhe pas vdekjes së Stalinit mbetet në fuqi roli i marksizëm-leninizmit si ideologji e shtetit-parti ose partisë-shtet, si shkencë mbi shkenca, si shkencë e vërtetë etj.⁴ Marksizëm-leninizmi mbetet në fuqi edhe në kohën e *perestrojkës* së Gorbaçovit.

Boris Souvarine, familja e të cilit kishte emigruar nga Rusia në Francë në fillim të shekullit XX, qysh nga vitet 1920 zhvilloi një kritikë të Stalinit dhe stalinizmit. Në vitin 1924 ai përjashtohet nga Partia Komuniste Franceze (PFK) për shkak të këtyre qëndrimeve. Souvarine theksonte se marksizëm-leninizmi ishte një shprehje e rreme, e krijuar nga Stalini “për të maskuar veprimet monstruoze”, sinonim i Stalinizmit, antitezë e marksizmit dhe karikaturë e vetë leninizmit”. Materializmi dialektik dekretohet si filozofi e obligueshme për çdo komunist dhe konsiderohej si doktrinë së cilës edhe vetë shkencat duhet t’i nënshtrohen: metoda “e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit”, e ligjëruar në universitetet sovjetike dekretohet si “e vetnja metodë shkencore që ekziston”⁵. Pascal Charbonnat, autor i një historie të filozofive materialiste, e shikon materializmin dialektik si “një vegël ideologjike e vetë justifikimit të diktaturës”; për Stalinin, proceset e njohjes janë një “raport hierarkik midis instancave të ndryshme”, gjë që shpie te qëndrimi se shkencat duhet të jenë të nënshttruara ndaj “një qendre të vetme të komandimit, rol që Stalini ia jep materializmit dialektik”. Në shkrimet e tij, Charbonnat, e cilëson mendimin stalinist si një “çnatyrim” të materializmit dialektik, “krejt i shurdhër dhe i verbër ndaj konceptcionit dialektik të Marksit dhe Engelsit”, me ndërhyrje arbitrare në kërkimet edhe të shkencave natyrore, rezultat i të cilave ishte edhe sharlatanizmi i Lisenkos në biologji.⁶

⁴ Po aty.

⁵ Souvarine 1981: 72.

⁶ Charbonnat 2007: 462. Kurse Alexandre Zinoviev në *Rrëfimet e një njeriut të tepërt* shkruante se transformimi i marksizmit në ideologji zyrtare shpie tek ajo që dialektika të bëhet “një metodë për topitje të mendjes dhe mashtrim ideologjik” (1990: 510).

Karl Korsh, filozof i Universitetit të Jenës në Gjermaninë e viteve 1920-1930, autor i libri të çmuar *Marksizmi dhe filozofia* (1930), afirmoi dimensionin filozofik të mendimit të Marksit e njëherazi kritikoi versionin stalinist të marksizmit, kurse në rrafshin politik vuri në pah rëndësinë e diversitetit të rrymave politike, në veçanti të këshillave të punëtorëve. Ai kritikoi Leninin pse e ka kthyer filozofinë në një periudhë *parakantiane*, pra para çështjes së *kushteve që bëjnë të mundur njohjen a priori*, pavarësisht nga objektet empirike. Për Kantin, kësisoj, njohja nuk mund të jetë kurrësi një “pasqyrim subjektiv i objekteve”, ngase për të nuk ka njohje imediate e pasive. Korsh angazhohej për një filozofi refleksive kritike, pikënisje e së cilës do të ishte kritika e themeltë e marksizmit stalinian.

Megjithëkëtë, në *Fletoret filozofike*, që ishin shënime të Leninit gjatë dy viteve të studimit të disa teksteve filozofike në Bibliotekën e Bernit në Zvicër (1908-10), e gjejmë këtë konstatim: “Nuk mund të kuptohet *Kapitali* i Marksit pa *Logjikën* e Hegelit”. Nëse vepra më spekulative e idealizmit klasik gjerman bëhet kriter për të kuptuar *Kapitalin* e Marksit, atëherë bëhet problematike ndarja e historisë së filozofisë në dy rryma antagoniste e me këtë edhe epitetet “përparimtare” për njërën” dhe “reaksionare” për tjetrën. Mirëpo, këto refleksione e problematizime nuk do të bëjnë pjesë në korpusin zyrtar të marksizëm-leninizmit. Por as, fjala vjen, *Tezat e Marksit mbi Fojerbahun*. Dhe jo rastësisht, ngase teza e tretë, fjala vjen, thotë: “E meta kryesore, deri më tani, e materializmit të të gjithë filozofëve – përfshirë edhe atë të Fojerbahut është se objekti, realiteti, bota e ndjeshme kapen aty vetëm në formën e objektit apo të intuitës, por jo si aktivitet konkret si praktikë”. Duke shtuar se këtë aspekt të aktivitetit e gjejmë brenda filozofisë idealiste. Njëherazi, në një tekst tjetër kushtuar filozofisë së Hegelit, Marksit shkruante se ajo që është e madhe në *Fenomenologjinë e frymës* së Hegelit është se autori shpjegon se me aktin e veprimit mbi natyrën, njeriu ndryshon jo vetëm natyrën, por edhe veten. Kësodore, del se njëra nga veprat më spekulative të Hegelit trajton veprimtarinë praktike të njeriut dhe lidhjen e teorikes me praktikën. Marksizëm-leninizmi e cilësonte filozofinë e Hegelit si një idealizëm, i kuptuar si iluzion apo si ideologji reaksionare. Te Marksit gjejmë, ndërkaq, që nga teza e doktoratës së tij (lidhur me dallimin midis filozofisë së Demokritit dhe Epikurit mbi natyrën) një dialog kritik, sa me filozofinë antike greke aq edhe me filozofinë klasike gjermane në përgjithësi dhe me filozofinë e Hegelit në veçanti. Kësodore, në *Kritikën e filozofisë së të drejtës së Hegelit* Marksit formulon një varg vërejtjesh kritike, por

asnjëra nga këto nuk artikullohet me termat, qëndrimet dhe horizontin e marksizëm-leninizmit.

Marks i shpjegon shtetin, veç të tjerash, edhe me kategorinë e tëhuajsismit. Këtë term ai e merr nga Hegeli, por i jep domethënie tjetër, më komplekse. Derisa te Hegeli, çdo *jashtësim* (i të menduarit, i vullnetit, i veprimt) është *tëhuajësim*, për Marks tëhuajësimi ndodh brenda rrethanave të caktuara historiko-politike e sociale. Në këtë tekst, shteti, ndonëse i prodhuar nga njerëzit, del si forcë e tëhuajësuar e cila i shtyp. Më vonë, ai do ta zhvillojë konceptin e domosdoshmërisë së shuarjes së shtetit brenda një shoqërie të prodhuesve të lirë, pa institucione që i shtypin, pikërisht pse e shihte si forcë të tëhuajësuar. Kriteri kryesor me të cilin Marks i vlerëson shtetin në shumë tekste të tij është shkalla e realizimit të lirisë. Ky kriter është fort i rëndësishëm edhe për Hegelin. Derisa disa kritikë të Hegelit mendonin se *Filozofia e së drejtës* e bën apologjinë e shtetit prusian, leximi i vëmendshëm, fjala vjen, i paragrafit 260 nga kjo vepër, ndoshta ofron mundësinë për një vlerësim tjetër: “Shteti është realitet në akt (ose i aktualizuar) i lirisë konkrete... Parimi i shteteve moderne e ka këtë fuqi dhe këtë thellësi të skajshme që e lë *principin e subjektivitetit* të përmbushet deri te *skajshmëria e veçantisë personale autonome* dhe njëherazi ta shpjerë te uniteti substancial dhe kështu ta mbajë këtë unitet brenda vetë këtij parimi”.⁷ Ky qëndrim, mendoj se na e bën të mundur të zhvillojmë kritikën jo vetëm të shteteve-parti komuniste, por edhe të shteteve bashkëkohore demokratike.

KRIKA E MARKSIZËM-LENINIZMIT NË FRANCË

Në mënyrë paradoksale, ndikimi i interpretimit stalinist të filozofisë marksiste dhe në përgjithësi të filozofisë u hetua edhe në Francë, ndonëse nuk ishte në fuqi një regjim komunist. Megjithatë, PKF-ja kishte ndikim jo vetëm te intelektualët që ishin anëtarë të saj, por edhe mbi ata jashtë saj, si p.sh. te Sartri. Do të marr shembullin e filozofit Henri Lefebvre, i cili një kohë ishte anëtar i PKF-së. Në librin e tij *Materializmi dialektik* (1947), gjejmë këtë formulim: “Kurrfarë shprehjeje e materializmit dialektik nuk mund të jetë definitive: por në vend se të jenë të papajtueshme dhe të kundërvihen, këto shprehje ndoshta do të mund të integrohen në një tërësi të hapur që zhvillohet, duke u

⁷ Hegel 1972: 277-278.

tejkualuar vazhdimisht”.⁸ Ndonëse e përvetëson sintagmën e “materializmit dialektik”, është e qartë se ai i kundërvihet, së paku në mënyrë implicite, pikëpamjes së kanonizuar si e vërtetë e përkryer dhe si kriter për vërtetësinë e të gjitha dijeve. Ai supozon këtu një shumësi të interpretimeve e në anën tjetër ndryshueshmërinë tyre përgjatë kohës. Njëherazi, në librin e tij *Mendimi i Karl Marksit* (1955), duke shtjelluar teorinë e “objektivitetit të thelluar”, ai thekson se formimi i njohjes dhe i vetëdijes është një proces i ndërlikuar dhe kundërthënës, i cili nuk duhet ndarë nga tërësia e aktiviteteve të njeriut. Lefebvre-i nuk është i prirë ta kuptojë esencën e vetëdijes dhe të njohjes si pasqyrim ngase mendon se “njeriu gjatë zhvillimit të tij historik prodhon botën e vet dhe vetveten” dhe për shkak se “nëse vetëdija që synon njohjen e qeniesimit, do të ishte pasive, atëherë jeta e vetëdijshme do të ishte një ëndërr”.⁹ Lefebvre-i u kritikua ashpër nga zyrtarët e ideologët e PKF-së, e cila ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të stalinizmit, porsa u botua libri i tij *Logjika formale. Logjika dialektike*.¹⁰ Në këto sulme nuk kishte vend për diskutime filozofike rreth përcaktimit të raportit të logjikës formale me atë dialektike në librin e tij. Vërejtja kryesore që i bëhej këtij libri ishte se ai “ringjalli mbetjet e superstrukturës së formacioneve të mëparshme shoqërore”, se injoron dallimin midis shkencës “proletare” dhe asaj “borgjeze” dhe se në këtë mënyrë nuk i kontribuon zhvillimit të ideologjisë proletare e revolucionare. Pas këtij sulmi këta zyrtarë e urdhëruan Lefebvre-in që ta ndërpresë punën e mëtejshme në këtë “drejtim të gabuar” dhe të ndërmernte përpilimin e një “logjike proletare”. Ideologët që e zhvilluan këtë teori mbi shkencën proletare dhe shkencën borgjeze, pohonin se atë e arsyetonte situata botërore dhe “domosdoshmëria e bartjes së luftës politike në rrafshin teorik”. Vetëdija empirike e proletariatit u ngrit në nivel të realitetit autonom historik, me gjithë historinë dhe traditën kulturore dhe u prezantua si burim i së vërtetës. Qëndrimi klasor dhe e vërteta klasore i kundërviheshin “objektivizmit shkencor mikroborgjez”. Logjika formale ishte stigmatizuar si një “instrument” i klasave sunduese të formacioneve të mëparshme.

Si anëtar i PKF-së, Lefebvre-i përpiquej të ishte i disiplinuar dhe të mendonte e të vepronte në të mirë të interesave të proletariatit, por nuk arrinte dot të kuptonte se në ç’mënyrë mund të zëvendësohet, fjala

⁸ Lefebvre, 1947:105.

⁹ Lefebvre 1977: 113.

¹⁰ Lefebvre 1947: 105.

vjen, parimi i identitetit në logjikë me një “të vërtetë proletare”. Në librin *Shuma dhe mbetja*,¹¹ Lefebvre-i shkruan lidhur me këtë:

Sa i takon vetë idesë mbi “shkencën proletare dhe socialiste”, tallësit le të kenë mirëkuptim, sepse madhësia e saj e pamatur bënte që të dukej disi e mundshme. Nuk kisha kurrfarë kriteri për të gjykuar. Rrethi i të mundshmes dhe të pamundshmes ndonjëherë mbyllet; skajshmëritë preken. Logjikë proletare? Jo më pak e pabesueshme se sa ishte para dhjetë vjetëve bomba hidrogjenike apo *Sputniku*... Fuqia e absurdit, kur mbështetet në një tërësi kaq të madhe (aparati politik, propaganda, prestigji, elementet morale) është gati e papërballueshme. Këtë dëshmi timen po ua bashkëngjit shumë fakteve, që në të kaluarën apo në të tashmen vërtejtonë këtë fuqi.¹²

Nën presionin e ideologëve të Partisë, Lefebvre-i botoi në revis-tën partiake *Nouvelle critique* një artikull me titullin “Vetëkritika” në të cilin hoqi dorë pjesërisht nga disa mendime të veta; më vonë këtë artikull do ta kujtojë si “një njollë në nderin e tij filozofik”. Mirëpo, pikërisht në atë kohë thjesht u mënjana teoria mbi shkencën proletare dhe mbi shkencën borgjeze, sepse Stalini e botoi artikullin e tij mbi çështje të linguistikës, ku mbronte tezën se nuk ka gjuhë klasore, se kultura mund të jetë borgjeze apo socialiste, porse gjuha është mbi-klasore dhe se i përket popullit në përgjithësi. Përfaqësuesit e marksizmit zyrtar, të cilët mbronin në mënyrë aq militante tezën mbi shkencën proletare, nuk e panë të arsyeshme asokohe të shpjegojnë përse hidhej poshtë ajo teori, gabueshmërinë e së cilës e vuri në pah “mësuesi i tyre i urtë”, sikurse që as më parë nuk mërzhiteshin ta argumentonin pranimin e saj.

Teoria mbi “shkencën proletare” dhe “shkencën borgjeze” ishte vetëm një pjesë e një pikëpamjeje më të gjerë zyrtare mbi filozofinë paramarksiste (veçanërisht mbi drejtimet jomaterialiste) dhe mbi filozofinë bashkëkohore jomarksiste, e që është pjesë përbërëse dhe e pandashme e *interpretimit stalinist* të marksizmit. Nga ky pikëvështrim, mendimi marksist kuptohej si absolutisht i ri, kurse lindja dhe zhvillimi i tij shpjegohej si shkëputje radikale nga të gjitha arritjet mendore. Theksohej se për ruajtjen e “pastërtisë ideologjike” dhe “të vërtetësisë absolute” është i domosdoshëm “distancimi i rreptë nga të gjitha orientimet jomarksiste bashkëkohore”. Kështu, fjala vjen, njëri nga

¹¹ Lefebvre 1960: 199.

¹² Po aty.

përfaqësuesit zyrtarë të marksizmit në Francë, Jacques Milhaud, shkruante në librin *Kronika filozofike*:

Kurrë para Marksit nuk ka pasur njohje shkencore të realitetit shoqëror, madje as në kohën e revolucionit borgjez në Francë, kur mendimi i revolucionarëve u nënshtrohej plotësisht tëhuajsimi të shoqërisë dhe të mendimit borgjez. Problemi i vërtetë për Marksit nuk ishte ta tejkalonte ideologjinë gjermane, e as të kthehej mbrapa, por të dinte të lexonte përmbajtjen objektive të një shoqërie, mendimtarët e së cilës arrinin të kapnin vetëm dukjet mistifikuese... Polemika jonë do të mbetet *vigjilente ndaj revizionizmit filozofik*, i cili fut ide borgjeze në lëvizjen punëtore dhe bëhet propagandist i të gjitha elementeve teorike që shkaktojnë *degjenerimin e marksizmit* [nënvizimi ynë].¹³

Së këndejmi, kërkimet filozofike që dilnin jashtë suazave të marksizëm-leninizmit të regjimeve komuniste doemos duhej të stigmatizoheshin si të rrezikshme, ngase përkufizoheshin si shkatërrimtare për marksizmin. Për përpjekjet e Lefebvre-it që t'i kundërvihej qëndrimit të tillë militant e “vigjilent” ndaj konceptimeve filozofike jomarksiste dhe të përcaktonte rëndësinë dhe vlerën e tyre dëshmojnë edhe librat e tij nga kjo periudhë: *Nietzsche* (1939), *Descartes* (1947), *Diderot* (1949) dhe *Pascali* (1956).

Pikërisht në kohën kur nacional-socialistët e glorifikonin Niçen si ideolog të tyre, ndërsa komunistët ose nuk e përmendin fare ose pajtoheshin me këtë përvetësim, Lefebvre-i botoi librin e tij për Niçen, në të cilin orvatet të vërë në pah peshën filozofike dhe origjinalitetin e tij. Ai e kupton Niçen para së gjithash si filozof e poet, i cili zhvilloi konceptime të fuqishme mbi parimin apolonian dhe atë dionizian, duke e kritikuar figurën e njeriut vetëm teorik, përkatësisht të intelektualizmit dhe të racionalizmit abstrakt, dhe duke vënë në pah thellësinë e konceptimeve të tij kozmologjike. Në librin për Niçen ai kritikon në mënyrë implicite edhe ideologjinë zyrtare komuniste mbi filozofinë jomarksiste. Lefebvre-i konstaton me admirim se te Niçe i gjen të gërshetuara të menduarit dhe imagjinatën, konceptin me imazhin, sensualitetin dhe sensibilitetin, si dhe kritikën e përbuzjes së vlerave tokësore, përbuzje kjo që ishte shprehje e nihilizmit. Ai synon këtu të vërë në pah pamundësinë që arti dhe kultura të reduktohen në rrethana brenda të cilave janë zhvilluar. Kësisoj ai thekson:

¹³ Jacques Milhaud, *Chroniques philosophiques*, Editions Sociales, 1972, Paris, f.105.

Krahas shkencës edhe arti ka një fushë të pavarur, meqë një studim i shpirtit dhe një përjetim i jetës kanë kuptim. Socializmi nuk i zgjidh të gjitha problemet e njeriut; ai, përkundrazi, inauguron periudhën në të cilën njeriu mund të shtrojë në mënyrë vendimtare problemet njerëzore të njohjes, të dashurisë dhe të vdekjes. Një kulturë e mirëfilltë është njëherazi një mënyrë e të jetuarit, të menduarit dhe të vepruarit. Ajo është një ndjenjë e jetës e përfshirë në një bashkësi njerëzore. Ajo kulturë përmban një raport të njeriut ndaj vetes dhe ndaj botës. Kultura e ardhshme e madhe duhet të ngërthejë kozmiken brenda njerëzores, instinktin brenda vetëdijes. Ajo synon të jetë kulturë e njeriut total.¹⁴

Refleksionet rreth *Mbinjeriut* të Niçes gërshetohen me ato të Marksit mbi njeriun total. Këto formulime, ide e mendime jo vetëm që zhvillohen jashtë suazave të marksizëm-leninizmit, por ato përmbajnë, njëherazi, kritikën e pikëpamjeve mbi njeriun, kulturën dhe dijen ashtu si imponoheshin nga aparati partiak-shtetëror, si *norma* të mendimit e jetesës. Jacques Milhaud në librin e tij *Kronika filozofike* kritikon ashpër jo vetëm këto qëndrime të Lefebvre-it, por madje edhe synimin për një vështrim kritik të qëndrimeve zyrtare mbi marksizmin. Kjo kritikë, sipas tij, do të thotë t'i japësh borgjezisë armën më të rrezikshme të cilën ajo e kërkon: kjo do të thotë të provosh të shkatërrosh unitetin e mendimeve të lëvizjes punëtore dhe t'ia hapësh rrugën dezorganizimit të saj të brendshëm, të hapësh rrugën kah obskuratizmi edhe më i madh.¹⁵

Këto akuza e jo thjesht opinione, në vendet e sunduara nga regjimet komuniste shpinin në burgje e kampe. Ndërkaq, në Francë, ato kishin për qëllim që, së paku brenda hapësirës së kontrolluar nga PKF-ja, të bënin të pamundur qarkullimin e ideve dhe mendimeve që ishin të ndryshme dhe që dilnin jashtë suazave të marksizëm-leninizmit, si kuadër për formimin e mendimeve dhe të veprimeve. Më vonë, në vitet 70 të shekullit të kaluar, Lefebvre-i në librin *Hegeli-Marksi-Niçe* (1975)¹⁶, zhvillon një analizë shumë më komplekse të veçorive kyçe të konceptimeve të këtyre mendimtarëve për botën bashkëkohore, për historicitetin, për raportet midis diturisë dhe pushtetit, si dhe për trajta të ndryshme të krijimtarisë.

Në vitet 70, u zhvillua në Francë një polemikë lidhur me çështjen e *periodizimit të mendimit të Marksit*. Njëri nga aspektet e periodizimit

¹⁴ Henri Lefebvre, *Nietzsche*, Syllepse, Paris, 2003, f.180.

¹⁵ Jacques Milhaud, *Chroniques philosophiques*, Editions Sociales, Paris, f.105.

¹⁶ Henri Lefebvre, *Hegel-Marx-Nietzsche*, Casterman, Paris, 1975.

lidhej me ndarjen e mendimit marksist në shkrime që kanë ndikimin e theksuar të filozofisë idealiste të Hegelit dhe në ato që dëshmojnë për “pjekurinë e tij shkencore”, veçanërisht në vëllimet e *Kapitalit*. Në veçanti Louis Althusser në veprën *Për Marks*, në sajë të “prerjes epistemologjike” të huazuar nga G. Bachelard, bën ndarjen midis Marksit të ri dhe Marksit të moçëm, midis punimeve të *hershme të Marksit* (si *Dorëshkrimet* ekonomiko-filozofike të viteve 1844-45, *Kritika e filozofisë së Hegelit mbi të drejtën dhe shtetin* etj.), që i përkasin periudhës “idealiste e hegeliane” të tij (me konceptet e tëhuajsimit e humanizmit në veçanti, si koncepte “ideologjike”), dhe veprave shkencore (*Kapitali* në radhë të parë). Në anën tjetër Henri Lefebvre-i në veprën *Ideologjia strukturaliste*, duke kritikuar ndarjen e mendimit të Marksit në periudhën “ideologjike” dhe në atë “shkencore”, nxjerr në pah *vazhdimësinë* midis çështjeve filozofike në të dy periudhat. Kësodore, temat e tëhuajsimit, humanizmit dhe ajo e lirisë janë të pranishme në veprat e të dy periudhave. Fetishizmi i mallit, dallimi midis “mbretërisë së domosdoshmërisë” dhe “mbretërisë së lirisë” në *Hyrje të kritikës së ekonomisë politike*, dhe te *Kapitali* zhvillohen si pikëpamje filozofike. Fundja, nëntitulli i *Kapitalit* sikurse edhe në tekste të tjera nga “periudha shkencore” shpaloset si “kritikë e ekonomisë politike”, e cila te Marksi nuk e ka statusin e një ekonomie politike “më shkencore”, por është një analizë kritike, e cila frymëzohet dhe gjen shprehje me pikëvështime e konceptime para së gjithash filozofike. Althusser-i, ndërkaq, me *shkencizmin* e vet, ishte orvatur ta “çlirojë” mendimin e Marksit nga disa tema kyçe filozofike.

Ndonëse gjatë disa viteve Sartri kishte koketuar me regjimin komunist të BS-së, ndërhyrja e trupave sovjetike në Budapest me 1956 dhe, sidomos, ajo në Çekosllovakë më 1968 e kishin shtyrë ta shikojë me sy kritik këtë regjim. Në tekstin e tij “Socializmi që erdhi nga i ftohti” (1968), gjejmë një kritikë të qartë të stalinizmit si ideologji dhe si praktikë politike. Aty ndriçohen mekanizmat e sundimit të regjimit komunist, mënyra e funksionimit të tij e veçmas rrjedhojat që i prodhoi ai në jetën e njerëzve (në Çekosllovakë), përmes analizës së rrëfimeve të shkrimtarëve çekë e sllovakë në librin e Antonin Liehm *Tri gjeneratat* (Paris, 1968). Teksti i Sartrit ishte, në fakt, parathënie e këtij libri. Sartri analizon këtu stalinizmin si “sistem i verbër dhe i shurdhër për dimensionet e mirëfillta njerëzore”, sistem që e redukton njeriun në një sistem mekanik: jo vetëm në teori, por edhe në praktikën e përditshme. Sistemi stalinist “është i detyruar t’i përdorë njerëzit, por nuk ka besim tek ata, i përbuz dhe i urren: ai vepron në atë mënyrë që

mosbesimi, përbuzja dhe urrejtja t'i përcaktojnë marrëdhëniet e njerëzve ndërmjet vete dhe individit me vetveten". Ideologjia staliniste, e maskuar me një humanizëm të zbehtë marksian, në vend se ta ndihmojë të kuptuarit kritik të shoqërisë, të pozitës së njeriut brenda saj, i mjegullon dhe i mistifikon raportet shoqërore. Ajo është për Sartrin një "mendim i mineralizuar" të cilin e vendosin si "një rrasë varri në një kokë të shqetësuar, ai mbetet aty, i rëndë, inert, qetësues, duke i ndrydhur përsiatjet dhe dyshimet, duke i kufizuar lëvizjet spontane të jetës në një gumëzhitje të parëndësishme insektesh". Në atë masë sa të menduarit dhe vetëdija përkufizohen te Sartrei me *transparencën* dhe fluiditetin, "minerali" dhe "rrasa" prej guri janë *mohim* i natyrës së të menduarit. Atë që nuk e gjejmë në analizat sociologjike dhe politologjike për stalinizmin, Sartri na e ofron këtu me procedimet dhe me mjetet e veta letrare e filozofike, aspekte të një realiteti social. Ai e ndriçon përjetimin e atij realiteti nga shkrimtarët çekë e sllovakë, edhe në këtë mënyrë: "ata e ndienin veten jorealë në një shoqëri joreale dhe ceremoniale e të trishtueshme, si viktimë, dëshmitarë apo bashkëfajtorë të një farse monumentale dhe të ankthshme, valëviteshin si marioneta absurde në një mjedis të strukturuar nga një absurditet i thellë, në atë mënyrë që çdo orvatje për t'iu adaptuar asaj situatë apo për ta ndryshuar atë, ishte që nga fillimi e absurdizuar".¹⁷

KRIKA E MARKSIZËM-LENINIZMIT NË JUGOSLLAVI

Në ish-Jugosllavi, PK e kishte ngritur në kult marksizëm-leninizmin në të gjitha dokumentet e veta të Partisë-Shtet, në Konferenca, në rituale publike të manifestimeve politike e shtetërore, në të gjitha fjalimet e zyrtarëve. Interpretimi marksist-leninist i filozofisë u imponua si normë e pakontestueshme në manuale shkollore, në të gjitha nivelet. Mirëpo, ndryshimet në Jugosllavi nisin me daljen e saj nga « kampi socialist », me shkëputjen e marrëdhënieve politike me BS dhe njëherësh me hapjen kah vendet perëndimore dhe me zhvillimin gradual të marrëdhënieve në të gjitha lëmenjtë, përfshirë edhe kulturën e shkencën. Emancipimi i mendimit filozofik nga tutorati i PK-së nis me këtë ngjarje dhe shkon duke u thelluar me botime dhe konferenca në Zagreb, Beograd e Lubjanë, por edhe në Sarajevë, si dhe në Konferenca ndërkombëtare. Pa harruar se emancipimi nga marksizëm-leninizmi

¹⁷ Sartre 1986: 171-218.

dhe kritika e kultit të tij zhvillohet publikisht edhe në fushat e tjera të kërkimit shkencor dhe në letërsi e arte (filmi, teatri etj.)

Në fillim të viteve 60 të shekullit të kaluar, në ish-Jugosllavi u zhvillua një ballafaqim midis përfaqësuesve të një varianti stalinist të interpretimit të mendimit të Marksit (Boris Ziherl, D. Nedeljkovic, A. Stojkovic) dhe filozofëve që afirmnin mëvetësinë filozofike të mendimit të Marksit, si edhe të mendimit filozofik në përgjithësi (G. Petrovic, R. Supek etj) në Konferencën e Bledit (në Slloveni, 1961). Ballafaqimi u zhvillua rreth një çështjeje që kishte të bëjë me njohjen dhe vetëdijen, përkatësisht me teorinë e pasqyrit, si pjesë e rëndësishme e doktrinės zyrtare të marksizëm-leninizmit. Përfaqësuesit e kësaj doktrine kishin humbur mbështetjen e partisë-shtet për interpretimin e tyre pasi Jugosllavia doli nga blloku sovjetik në vitin 1948 dhe gradualisht vendosi marrëdhënie me vendet perëndimore dhe me ato të botës së tretë. Gajo Petrović, Milan Kangrga, Danko Grlić, Ivan Focht dhe Rudi Supek zhvilluan një kritikë të shumëfishtë të teorisë së pasqyrit. Kjo teori nuk reduktohej vetëm në çështje gnoseologjike, por kishte implikime për konceptimet mbi njeriun dhe veprimtarinë e tij, si edhe raportet e tij me të tjerët dhe me botën. Dihet se kjo teori përdorej nga stalinistët (Andija Stojkovic, Boris Ziherl, Dushan Nedeljković etj.) edhe në fushën e vlerësimit të krijimtarisë letrare e artistike. Nga shkrimtarët dhe artistët kërkohej që ta pasqyronin si duhet realitetin e socializmit, që nënkuptonte të mbështesnin interpretimin zyrtar të “realitetit” social e politik. Teoria e pasqyrit, sipas Petrović-it, nuk mund të shtrohet si teori mbi vërtetësinë e të jetuarit të njeriut, e as si teori mbi esencën e vetëdijes, por as si teori mbi vërtetësinë të menduarit tonë, sepse ajo nuk mund të pajtohet as me fenomenet e vetëdijes, as të njohjes e as të vërtetës. Ajo teori nuk mund të shpjegojë përse dhe në ç’mënyrë të gjitha aktet tona të vetëdijshme “pasqyrojnë” realitetin, e as nuk mund të shpjegojë në ç’mënyrë shumë nga gjykimet (prej gjykimeve negative ekzistenciale, e deri te gjykimet mbi të kaluarën, të ardhmen dhe mundësinë) pasqyrojnë çfarëdo. Pasqyrimi vlen vetëm në fushën e mekanikës dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë (e jo vetëm etimologjike) me mospërputhjen.

Kangrga ndërkaq e trajton këtë çështje duke problematizuar pozicionin gnoseologjik si të tillë. Ai kritikon rënien e Engelsit në pozitën e materializmit të moçëm *kontemplativ*, duke vënë në pah se qasja materialiste e ka të vështirë të bashkojë atë që është e ndarë që në fillim: natyra dhe mendja. Së këndejmi, ai nuk mund ta kapërcejë as ndarjen midis njohjes dhe objektit të njohjes, nëse uniteti i botës kuptohet si që

më parë i përcaktuar me materialitetin e saj, kështu që të menduarit, njohja, shpirti, fryma paraqiten si diçka që është *jashtë* këtij uniteti. Për shkak të kësaj vështirësie shtrohet kërkesa që të përafrohen dy anët e ndara, në mënyrë që ana e dytë t'i afrohet të parës, që të jetë adekuate me të, të përputhet me të, përkatësisht që të njihet e vërteta – që është supozim i çdo pozicioni gnoseologjik. Kjo vlen sidomos për teorinë e pasqyrimin e cila e kupton njohjen si “*pasqyrim subjektiv i realitetit objektiv*”. Engelsi në librin *L. Fojerbahu dhe fundi i filozofisë klasike gjermane* e koncepton teorinë e së vërtetës nga një pozicion i *metafizikës parakantiane*, ku del i mbyllur qarku i refleksionit të arsyes abstrakte e kontemplative, pozicion ky që mbetet nën nivelin e pikëpamjes së Marksit. Për Kangrgen, qeniesimi i njeriut është vepër e njeriut, kurse natyra bëhet objekt i njohjes vetëm nëse mohohet fakticiteti i thjeshtë i saj dhe nëse bëhet natyrë njerëzore (e ndërmjetësuar me shikimin dhe veprimin e njeriut).

Kurse për Grlicin, subjektit brenda teorisë së pasqyrimin i mohohet veçoria e objektivitetit, dhe ai i kundërvihet tërë “realitetit objektiv” si pasqyrë e thjeshtë. Kësisoj, subjekti reduktohet në diçka joreale dhe absurde. Supek, në kritikën e teorisë së pasqyrimin përmend edhe njohuritë e reja të fizikës teorike, fjala vjen ato që i zhvillon fizikani gjerman W. Heisenberg në librin e tij *Fizika dhe metafizika*. Aty bëhet fjalë për *ndërveprimin* e shikimit me qelizat më të imta të objektit kur i kundrojmë me mikroskope të sofistikuara. Ivan Focht, ndërkaq, thekson se ajo teori nuk mund të shpjegojë veprat artistike dhe aktivitetin artistik të njeriut. Mirëpo, vlen të theksohet se asnjëri nga këta autorë nuk e konteston teorinë e pasqyrimin me argumentin se ajo nuk është në pajtim me pikëpamjen e Marksit.¹⁸

Në manualët e marksizëm-leninizmit, në anën tjetër, nuk ka fare vend për mëvetësinë e konceptimit etik të Kantit. Ndryshe nga morali komunist ose socialist, të cilin e predikon dhe e imponon partia-shtet, Kanti e përkufizon *burimin* e etikës me *autonominë vullnetit*, me të cilën individi duhet t'i *zbulojë* ose t'i *krijojë gjithherë sërish* me të menduarit dhe vetë vullnetin e vet, e jo t'i gjejë të gatshme në *urdhëresat e jashtme* (të mësuesit, priftit apo mbretit) *maksimat* e veprimeve të veta. Mbi të gjitha, etika e Kantit na cyt të *problematizojmë përmbajtjen dhe domethënien* e veprimin tonë, të pyesim *në emër të kujt një veprim mund të cilësohet si veprim etik*. Ajo supozon *invencionin mendor* të subjektit, i cili duhet të gjejë vetë përgjigjen se në ç'mënyrë mund ta ngrejë

¹⁸ Gao Petrovic, *Sabrana djela*, Zagreb, Naprijed, I, 1986, f.172.

veprimin e vet në nivelin e universalitetit (imperativi kategorik) etik brenda situatave të veçanta, kundërthënëse e komplekse. E në veçanti, etika sipas Kantit bëhet e mundur vetëm në sajë të mendimit dhe veprimit të vullnetit të lirë të njeriut.

Petrović-i dhe Kangra, me gjithë dallimet që kanë (bie fjala, me stilin e të filozofuarit) e kuptojnë njeriun përmes kategorisë *praxis*, e sajuar me *rimendimin* e disa aspekteve të filozofisë antike greke dhe të filozofisë klasike gjermane. Ndryshe nga qasjet jo vetëm të marksizëm-leninizmit, por edhe të atyre pozitiviste e pragmatiste, *praxis* emërton, për ata, një *mënyrë të veçantë të qeniesimit*, specifike për njeriun: e lirë, universale dhe krijuese. Kjo mënyrë e qeniesimit shikohet si unike e njëherazi e diferencuar në aktivitete të shumta, duke tejkaluar po kështu ndarjet të menduarit-aksioni, trupi-shpirti etj. Të menduarit përkufizohet aty si aktivitet praktik i njeriut. Ky unitet i teorikës me praktikën mund të ilustruhet, fjala vjen, me punën e artistit: aktiviteti i një skulptori apo i një piktori është po aq teorik (spiritual) sa edhe praktik (material).

Petrović-i me termin *praxis* nuk mendon vetëm anën praktike dhe joteorike të aktivitetit të njeriut. Duke dashur të vejë në pah peshën që i jep teorikës dhe spirituales në konceptimet e veta, ai kritikon tezën 11 të Marksit mbi Fojerbahun, e cila supozon se një interpretim teorik sikur mbetet pa rrjedhoja praktike: “Filozofët deri më tani janë marrë me interpretimin e botës, tani është fjala si të ndryshohet ajo”. Mirëpo, siç thekson Petrović-i, “duke e interpretuar botën, njeriu ndryshon së paku pikëpamjen e vet mbi botën, e me këtë edhe *raportin e vet ndaj botës*; e njëherësh ai ndikon kësisoj edhe në pikëpamjet e tij dhe raportet e tij me të tjerët”. Në një artikull tjetër, ai shkruan se të menduarit është “njëra nga format e ndryshimit dhe krijimit të botës” dhe se “brenda krijimtarisë spirituale, njeriu është ndoshta më krijues sesa gjithkund tjetër”.¹⁹ Ky koncept i *praxis*-it është i ndryshëm, jo vetëm nga marksizëm-leninizmi, por edhe nga ai që zhvillohet brenda disa rrymave *filozofike*, qofshin tradicionale apo bashkëkohore.

Për Petrović-in, ajo që përbën *njerëzinë e njeriut*, nuk është ndo një karakteristikë e veçantë e tij e as shuma e karakteristikave (tipareve, cilësive) dhe aktiviteteve të tij, por “struktura e përgjithshme, mënyra e tij e qeniesimit”, mënyra më autentike e qeniesimit të tij, e cila zbulon vetë *kuptimin* e qeniesimit. Ndryshe nga Heidegger-i, i cili e shikon kuptimin e qeniesimit të njeriut te kohësia apo temporaliteti i njeriut,

¹⁹ Po aty, f. 216.

Petrović-i e gjen atë te mënyra më autentike e qeniesimit, e cila zbulon *kuptimin e qeniesimit*. Ky koncept i *praxis*-it përjashton *vullnetin për përsundim* dhe shtypje, ngase e shikon esencën e lirisë jo në përsundimin e asaj që është e dhënë, por në krijimin e së resë, në zhvillimin e mundësive krijuese të njeriut, në begatimin e njerëzisë së tij. Për ta theksuar dallimin midis këtyre dy koncepteve, Petrović-i gjen një mbështetje te një koncept i Niçes, i cili rëndom injorohej nga filozofët marksistë. Në një tekst ku merr në shqyrtim raportet midis vullnetit për fuqinë dhe humanizmit, Petrović-i vë në pah njërën nga aspektet e konceptit të fuqisë të Niçe, i cili shpesh është lënë në harresë. Është fjala për fuqinë si “aftësi dhe mundësi (*Vermögen, Fâhigkeit*), aftësi për të ndërë dhe për të jetuar, për të dashur dhe për t’u çuditur, për të zbuluar dhe për të dhënë, për të sjellë në jetë të renë”.²⁰

Në një tekst tjetër Petrović-i zhvillon një pikëpamje të re mbi humanizmin, i ndryshëm nga humanizmi klasik dhe ai i Iluminizmit, pikëpamje që synon të ballafaqohet me sfidat e botës bashkëkohore. Në këtë shkrim, Petrović-i merr në shqyrtim edhe tekstin *Letër mbi humanizmin*, ku Heidegger-i mbështet tezën se “çdo metafizikë është humaniste dhe çdo humanizëm është metafizik”. Në të njëjtën kohë, në këtë tekst Heidegger-i i pranon Marksit meritën se ka arritur një dimension thelbësor të historisë, të cilin, siç shkruan ai nuk e ka arritur as Sartri e as Husserl-i. Marksi e ka arritur këtë dimension me konceptin e tij të “tëhuajsimi”, i cili ia ka bërë të mundur të kapë në rrënjët e tij konceptin e *Geworfenheit*-t, që shpreh hedhjen dhe braktisjen në botë të njeriut modern. *Dasein*, njeriu si qeniesim-aty, i hedhur dhe i braktisur në botë, vazhdimisht ikën nga vetvetja përpara dhe kurrë nuk koïncidon me esencën e vet. Në anën tjetër, Heidegger-i konstaton se përpjekja e Marksit për ta kapërcyer metafizikën nuk ka pasur sukses, sepse ai ka mbetur peng brenda suazave të saj, pasi e ka bërë vetëm *përmbysjen* e saj. Ajo që e ka penguar Marks-in ta realizojë këtë ndërmarrje, sipas Heidegger-it, është pikërisht fakti se ai ka provuar ta tejkalojë metafizikën me *humanizmin*. Ndërkaq, humanizmi, për shkak të origjinës së vet metafizike, nuk e shtron dhe nuk e kupton çështjen e raportit të qeniesimit ndaj njerëzisë së njeriut.

Mirëpo, Petrović-i synon të vërë në pah se në ç’mënyrë Marksi ka arritur dimensionin thelbësor të historisë pikërisht përmes konceptimit të vet të humanizmit, ngase ky konceptim implikon

²⁰ Po aty, f.358.

kapërcimin e tëhuajësimit. Në fakt, Heidegger-i kishte futur një ndërprerje dhe një kundërvënie midis dy koncepteve të Marksit, tëhuajësimit dhe humanizmit. Sipas Petrović-it, kjo ndarje është e paqëndrueshme, ngase ai nuk ka mundur ta mendojë tëhuajësimin veçse duke u nisur nga kritika e tëhuajësimit dhe nga ideja e kapërcimit të tij, pra duke u mbështetur te koncepti i humanizmit dhe *praxisit*. Në anën tjetër, do të rikujtoja se Heidegger-i në *Letër mbi humanizmin* thekson se “të menduarit vepron në atë masë sa mendon” dhe se “ky veprim është ndoshta më i thjeshti, por njëherazi më i larti, ngase i përket relacionit të qeniesimit ndaj njeriut”. Mëvetësia e konceptimit filozofik të Marksit mbi tëhuajësimin shpërfaqet edhe në dallimin e tij me konceptin e Hegelit mbi këtë çështje, ndonëse që të dy përdorin të njëjtin term, *Entfremdung*. Ky koncept u zhvillua në shek. XIX (si *Sebstentfremdung*, *vetëhuajsim*) kurse në shek. XX u përvetësua në veçanti nga filozofët e Shkollës së Frankfutit. Derisa për Hegelin çdo *jashtësim* e *objektivim* i forcave të njeriut (bie fjala, duke punuar), që nënkupton veprimin mbi natyrën dhe gjërat është *tëhuajsim*, për Marksit tëhuajësimi lind brenda raporteve të caktuara socio-ekonomike. Thënë me dy fjalë, në *Dorëshkrime ekonomiko-filozofike 1844* të Marksit, gjejmë analiza të thella mbi aspekte të ndryshme të tëhuajësimit, e në veçanti të punës së tëhuajësuar, e cila shpaloset në këtë tekst në katër aspekte: njeriu bëhet i huaj ndaj prodhimit të punës së vet, ndaj aktivitetit të vet vital, ndaj qenies së vet dhe, si rrjedhojë e këtij procesi, ai bëhet i huaj edhe ndaj njeriut tjetër por edhe ndaj vetë *njerëzisë* së vet. Puna është e tëhuajësuar, ngase gjatë ushtrimit të saj njeriu nuk zhvillon as fuqitë e veta fizike, as ato intelektuale (vullnetin, imagjinatën, të menduarit, por edhe ndijimet). Duke e *degraduar në rangun e mjetit*, aktivitetin e vet si *aktivitet i lirë e krijues* (të cilin ai e emërton me termin *praxis*), puna e tëhuajësuar bëhet vetëm *një mjet* për ekzistencën e tij.²¹ Megjithatë, analizat kritike të Marksit në *Dorëshkrimet e vitit 1844*, si dhe te *Kapitali*, mbi raportin teknika-njeriu (si raport mjeti-qëllimi) shkojnë përtej kësaj problematike, ngase hulumtojnë mundësitë e transformimit të një bote të kapluar me *teknicizimin* dhe *automatizimin* e veprimeve e mendimeve.

Një aspekt i këtyre refleksioneve kritike të Marksit mbi praktikën historike, ka të bëjë me nxjerrjen në shesh të tendencës që të zhvillohet te njeriut shtytja për të poseduar, *të kesh* në dëm të *të jesh*. Këtë pikëpamje, e kishte paralajmëruar në modernitet Rusoi në analizat e tij mbi historinë universale të njeriut. Kurse më vonë edhe filozofi dhe

²¹ Karl Marx, *Manuscripts 1844*, Flammarion, Paris, 1999, f.117.

psikanalisti amerikan Erich Fromm, nën ndikimin e Marksit, në veçanti në librin *Të kesh apo të jesh. Një zgjedhje nga e cila varet ardhmëria e njeriut*²². Fromm mendon se *mbijetimi* i njeriut varet se në ç'masë ai do t'i *përkushtohet* dimensionit « të jesh » të vetes, si mënyrë e të jetuarit, duke reduktuar prirjet e veta për posedim e shfrytëzim, që mund ta shpijnë njeriun te katastrofa sa psikologjike e tij aq edhe ajo ekologjike. Në *Dorëshkrime*, Marksit thekson: « Njeriu përvetëson qenien e vet universale në një mënyrë universale, pra si njeri total. Çdonjëri nga raportet e tij njerëzore me botën, të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, prekja, të menduarit, meditimi, ndjenja, vullneti, aktiviteti, dashuria, shkurt të gjitha organet e individualitetit të tij, si organe që, në formën e tyre janë drejtpërsëdrejti organe sociale (pasiqë zhvillohen brenda një shoqërie dhe në raport me njerëzit tjetër), në veprimin e tyre objektiv apo në raportin e tyre ndaj objektit janë *përvetësim* (e jo posedim) i këtij objekti, përvetësim i realitetit njerëzor; *raporti i tyre ndaj objektit është manifestim i realitetit njerëzor*²³. Në manualët e marksizëm-leninizmit nuk mbeti asnjë thërmijë e këtyre mendimeve të Marksit. Rojtarët vigjilentë të « pastërtisë » ideologjike e dinin se çfarë dëmi mund të dalë nga pikëpamje dhe përsiatje të tilla.²⁴

Shkolla filozofike e Zagrebit ka zhvilluar një bashkëpunim intensiv e të frytshëm, veç të tjerash, edhe me Shkollën e Frankfurtit. Filozofët e Zagrebit kanë ligjëruar dhe kanë marrë pjesë në konferencat filozofike dhe ligjëratat në Universitetin e Frankfurtit. Po kështu edhe filozofët e Shkollës së Frankfurtit, sidomos Habermasi, Fromm-i dhe Marcuse kanë marrë pjesë në konferencat filozofike në Zagreb dhe Korcula. Filozofët e Zagrebit kanë botuar në shtëpitë botuese gjermane, kurse filozofët gjermanë në ato të Zagrebit, Beogradit e Sarajevës. Në kërkimet filozofike të dy shkollave, filozofia e Marksit zë vend të

²² Erich Fromm, *Avoir ou Etre*, Laffont, Paris, 1993.

²³ Po aty, f. 135-137.

²⁴ Para një viti, një kolege e Universitetit të Tiranës, në një bisedë më tha: « A mund ta merrni me mend se në Bibliotekën Kombëtare, në kohën e Enverit, kishte vetëm dy kopje të veprës “Shteti i Platonit”. Por edhe ato mund të mirreshin në përdorim vetëm me një leje të veçantë ». Kjo mund të na duket sot e pakuptueshme mirëpo, kam përshtypjen se rojtarët e « pastërtisë ideologjike » edhe aty ishin të orientuar me një « instikt » të sigurt të syrvejimit. Në fakt, edhe nga leximi i faqeve të para të *Shtetit*, mund të hetohet fryma dhe natyra e mendimit dhe kërkimit filozofik. Ky kërkim zhvillohet këtu përmes ballafaqimit të pikëpamjeve të ndryshme, me dialogun kritik midis disa personazheve, me vërjen në pah graduale të të metave dhe epërsive të argumentimeve të ndryshme për një aspekt ose një tjetër të problemeve që trajtohen e zhvillohen hollësisht aty. Imagjinoni, për një çast, që kjo qasje të përdorej në shqyrtimet mbi regjimet komuniste.

rëndësishëm. Ka disa pika të përbashkëta midis filozofëve gjermanë dhe atyre kroatë, por ka edhe dallime të konsiderueshme, varësisht nga autori. Pika e përbashkët e qasjes ndaj mendimit të Marksit në të dy shkollat është dallimi thelbësor *nga qasjet dhe interpretimet marksiste-leniniste të regjimeve komuniste*. Një ngjashmëri midis interpretimeve të dy shkollave mbi mendimin filozofik të Marksit shquhet edhe me faktin se ato mbajnë lidhje të frytshme me kërkimet filozofike mbi filozofinë antike-greke dhe, në anën tjetër, me filozofinë klasike gjermane. Mirëpo, këta mendimtarë njëherazi i vejnë në sprovë konceptimet Marksit përballë ngjarjeve historiko-politike të periudhës bashkëkohore dhe konceptimeve të reja që janë zhvilluar në shek. XX.

Mirëpo, bashkëpunimi i frytshëm midis dy shkollave ka qenë i përshkuar edhe me kritika reciproke mbi temat filozofike që kanë zhvilluar. Fjala vjen, Petrović-i në kumtesën e vet, në konferencën e Ludwigsburg-ut, me titull “Domethënia e Shkollës së Frankfurtit sot” (dhjetor 1984) thekson se me përjashtim të Marcuse-s, Shkolla e Frankfurtit ka punuar për “shpërbërjen pozitiviste të filozofisë brenda shkencave shoqërore”. Për ta argumentuar pohimin e vet Petrović-i citon ligjëratën inauguruese të Horkheimerit me titull “Situata aktuale e filozofisë sociale dhe objektivat e Institutit për Kërkime Sociale” (1931). Duke marrë si shembull të mirë bashkëpunimin e filozofëve të natyrës me shkencat e natyrës, Horkheimeri cek aty domosdoshmërinë që “të studiohen çështjet themelore filozofike me ndihmën e metodave shkencore më të holla, e riformulimit dhe saktësimit të çështjeve, zbulimin e metodave të reja gjithnjë duke pasur parasysh atë që është e përgjithshme”. Për Petrović-in, “metodat shkencore më të holla” nuk mundën të aplikohen mbi çështjet filozofike fundamentale, si, fjala vjen, ato të kuptimit të qeniesimit dhe esencës së njeriut ose ato të kuptimit dhe mundësisë së njohjes. Ai pajtohet me Horkheimerin se filozofia sociale ka për bazë një koncept të paqëndrueshëm, por i bën vërejtje se nuk e saktëson se çfarë koncepti të ri të filozofisë dhe disiplinave të saj propozon. Petrović-i e merr në shqyrtim edhe kumtesën e Habermasit “Tri teza mbi historinë e veprimit të shkollës së Frankfurtit”. Habermasi pranon këtu se ka pasur një dështim në përpjekjen e tij që ta realizojë një program multidisiplinar për kërkimet sociale. Ishte fjala për një teori mbi shoqërinë, që duhej të unifikonte dhe integronte qasje të ndryshme empirike brenda sociologjisë, antropologjisë kulturore, psikologjisë sociale dhe psikologjisë së zhvillimit. Petrović-i i bën vërejtje Habermasit se në këtë program madje as nuk e ka përmendur filozofinë. Mirëpo, duhet rikujtuar, me këtë rast, se kritika

që Shkolla e Frankfurtit zhvillon ndaj konceptcionit mbi progresin e teknologjisë dhe racionalizmit instrumental, e tejkalon dukshëm qëndrimin e pozitivizmit.

Në fund, të cekim se kulti i marksizëm-leninizmit, si pjesë e rëndësishme e sistemit partiak-shtetëror, me aktivizmin dhe me parimin e vigjilencës së shërbyesve të vet, është kujdesur, gjatë decenieve, që të mënjanojë nga manualët dhe ligjërimet, gjithë atë që e bën të gjallë e kritik të menduarit filozofik. Që në manuale lë vend vetëm për një mendim “të mineralizuar, një rrasë varri”, siç shkruante Sartri, që duhej të ndrydhte përsiatjet, dyshimet, kërkimet, duke lënë të veprojë vetëm një pasion, ai i frikës. Duke e varfëruar të menduarit, pushtetmbajtësit e regjimeve komuniste kishin parasysh dobësimin dhe varfërimin e veprimeve të njeriut, reduktimin e tyre në reagime të automatizuara, në nënshtrim e përkorje. Pa harruar se regjimet komuniste, siç vë në pah Claude Lefort, synonin përvetësimin, jo vetëm të formave të caktuara të dijes po edhe atë të “njohjes së parimeve dhe qëllimeve të fundit të jetës sociale”.²⁵

Muhamedin Kullashi

KULTI I MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE ZHBËRJA E FILOZOFISË

Résumé

Dans cet article nous nous sommes interrogé du sort de la philosophie et plus particulièrement de celle de Marx dans les régimes communistes en Europe de l'Est. C'est Staline qui va radicaliser, à partir de 1924, la version la plus dogmatique du marxisme-leninisme comme idéologie officielle de ces régimes. Le matérialisme dialectique et celui historique deviennent des noyaux conceptuels de l'orthodoxie stalinienne qui devient la norme au sein de l'Internationale communiste. Pour Staline le matérialisme dialectique offre “à tout les savoirs une méthode absolue”.

Nous avons examiné l'apparition des conceptions philosophiques riches et profondes au sein de l'Ecole philosophique et autour de la revue philosophique internationale Praxis de Zagreb à partir des années 70. Ainsi Petrovic et Kangrga développent à partir du concept

²⁵ Claude Lefort, *L'invention démocratique*, Fayard, Paris, 1994, f.174.

philosophique de la praxis une conception de l'homme et de l'histoire, à l'appui de la philosophie antique grecque et de la philosophie classique allemande; cette conception est différente non seulement de l'approche marxiste-léniniste mais également de celles positivistes et pragmatistes.

Nous avons montré dans notre analyse que le culte du marxisme-léninisme comme partie intégrale du système parti-Etat dans les régimes communistes, par son activisme et sa vigilance idéologique s'est employé des manuels et des discours tout ce qui fait que la pensée philosophique soit vivante et critique. Ce culte ne laissait de place qu'à une pensée "minéralisée, une pierre tombale" (Sartre) en étouffant les questionnements, les doutes, les recherches, en laissant de l'espace que pour une passion, celle de la peur. En appauvrissant la pensée, les détenteurs du pouvoir étatique communiste visaient l'appauvrissement des actions de l'homme, leur réduction à des réactions automatisées et à la soumission. Sans oublier le fait que les régimes communistes, comme l'avait montré Claude Lefort, voulaient s'approprier non seulement certaines formes du savoir mais également ceux "des connaissances des principes et des finalités dernières de la vie sociale."

Mots clés: le culte du marxisme-léninisme, les régimes communistes, l'école philosophique de Zagreb, Sartre, Lefort

REFERENCAT

- [1] Pascal Charbonnat, *Histoire des philosophies matérialistes*, Syllepse, 2007, 462.
- [2] Hegel, *Principes de la philosophie du droit*, Gallimard, Paris, 1972, f.277-278.
- [3] Georges Labica dhe Gérard Bensoussan, *Dictionnaire critique du marxisme*, 1982, Paris, PUF, f.567.
- [4] H.Lefebvre, *La pensée de Karl Marx*, Bordas, 1977, f. 113.
- [5] Lefebvre, *Logique formelle. Logique dialectique*, Paris, 1947, Editions sociales, f. 105.
- [6] H.Lefebvre, *La somme et le reste*, Anrhropos, Paris, 1960, f. 199.
- [7] Henri Lefebvre, *Matérialisme dialectique*, PUF, Paris, 1990, f. 105.
- [8] Jacques Milhaud, *Chroniques philosophiques*, Editions Sociales, Paris, f.105.
- [9] Jean-Paul Sartre, *Situatat*, Rilindja, Prishtinë, 1986, (zgjedhi dhe përktheu M. Kullashi, f.171-218.
- [10] Boris Souvarine, *Autour du Congrès de Tours*, Champ libre, 1981, 72
- [11] Alexandre Zinoviev në *Rrëfimet e një njeriut të tepërt (Confessions d'un homme en trop*, Olivier Orban, 1990, f 510)

PROMOVIME

MUHAMEDIN KULLASHI: Anton Berishaj, *Në botën e përbashkët*,
ASHAK, Prishtinë, 2022.

Të rikujtojmë në fillim se akademik Anton Berishaj është studiues dhe autor i afirmuar në Kosovë dhe në disa vende të tjera, me libra autorialë e bashkautorialë nga fusha e sociologjisë. Në ASHAK ka botuar deri më tani librat *Shoqëria pa shtet* (2014), *Virgjërat e përbetuara – jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëflijimit* (2016) dhe vitin e kaluar librin *Në botën e përbashkët. Tradita, tranzicioni, anomia* më 2021. Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore në Kosovë, në vendet e rajonit, në disa vende evropiane dhe në SHBA. Ai ka botuar një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore në revista të Kosovës dhe në revista të vendeve të tjera në disa gjuhë botërore.

Libri i fundit i akademik Anton Berishës me titull *Në botën e përbashkët* është një studim kompleks sociologjik i disa rrjedhave e fenomeneve shoqërore që kanë prodhuar modele të veçanta të organizimit shoqëror brenda botës së përbashkët: është fjala këtu për një koncept që është bërë i pranishëm në sociologjinë bashkëkohore, në veçanti në deceniet e fundit, edhe me temën e mondializimit.

Autori ka për qëllim të ndriçojë këtu një varg faktorësh objektivë e subjektivë që kanë ndikuar në strukturimin e brendshëm të kësaj *bote të përbashkët* kryesisht të shqiptarëve në Ballkan dhe fqinjëve të tyre. Analizat e begatshme të këtij studimi shpalosen brenda kornizës metodologjike dhe asaj historike e sociologjike.

Përbashkësia si koncept, në këtë studim, nënkupton një histori të tërë kontaktesh dhe ndikimesh të ndërsjella, me karakter historik, kulturor, politik e ekonomik.

Kësodore nga perspektiva historike autori i shikon raportet e ndërsjella midis shqiptarëve, turqve, maqedonasve, serbëve, malazezëve e grekëve të cilësuar kryesisht me luftëra, pushtime e paragjykitime reciproke e më pak me raporte të fqinjësisë së mirë.

Pjesa e dytë fokusohet në traditën, si një realitet historik e shoqëror, si pasuri shpirtërore e materiale (mite, legjenda, vlera, pikëpamje, besime, zakone, stile jete). Ndërkaq pjesa e tretë merr në shqyrtim *tranzicionin*, ndriçimin e ndryshimeve ideologjike, të mentalitetit dhe të stilit të organizimit të jetës.

Pjesa e tretë, *tranzicioni*, trajton kahet e proceseve që lidhen me raportet me të tjerët : përkatësisht me komunikimin, fqinjësinë, politikat

për krijimin e hapësirës për jetë më dinjitoze në botën e përbashkët. Korniza ideore dhe metodologjike e këtij libri e vendos në fokus fazën tranzicionale postdiktatoriale të aktorëve të *botës së përbashkët*, me theks të veçantë në realitetin e mjediseve të parcializuara shqiptare. Brenda retrospektivës historike të tranzicionit, autori do të nxjerrë në shesh ngecjet dhe vonesat në shumicën e proceseve që lidhen me ritmin e zhvillimit shoqëror e kombëtar.

Pjesa e katërt ndërkaq bën çështje *anominë* dhe synon proceset tranzitore që mëtojnë t'u largohen disa elementeve të traditës. Autori ndriçon këtu fazën anomike të traditës së heshtur dhe boshllëkun insti-tucional, të cilin e shfrytëzojnë aktorët e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Së këndejmi, kërkimet e Anton Berishës ndriçojnë sa qëndrue-shmërinë e traditës aq edhe proceset që shpërfaqin ndryshimet shoqërore gjatë shtjellimit të tranzicionit dhe anomisë, përkatësisht transformimet e thella që kanë të bëjnë me orientimin e politikave zhvillimore dhe ristrukturimet institucionale, e po aq edhe me mënyra të reja të të men-duarit rreth organizimit shoqëror për shtetndërtim.

Në këtë libër autori fokusohet në disa pasoja shoqërore e politike brenda *botës së përbashkët*, kryesisht prej themelimit të shtetit të pavarur shqiptar. Ai hulumton me vëmendje të jetuarit bashkë me të tjerët në fqinjësi e simbiozë, por edhe nëpërmjet konfrontimeve dhe shkatërrimeve. Ai vë në pah edhe kontrastin historik të raporteve të shqiptarëve me të tjerët si robër e vasalë, kurse në deceniet e fundit me ndërkombëtarët si miq e përkrahës. Traditën Berishaj e kupton si kompleks historik dhe kulturor, si mentalitet dhe si shprehi, si strategji e mbrojtjes, por edhe si vegël pune dhe ekonomizim, si politikëbërje dhe si sistem vlerash, si histori përplasjesh e konfliktesh. Ai njëherësh vijëzon traditën, brenda analizës së ngjarjeve konkrete, si kujtesë kolektive fitoresh e disfatash, që mbulohen shpesh me koloritin e imagjinatës triumfuese të miteve dhe të legendave.

Studimet *mbi traditën* analizojnë edhe rolin e saj specifik brenda *shoqërisë pa shtet* përmes prizmit të interkulturalizmit, ashtu si është zhvilluar në sociologjinë bashkëkohore. Autori merr në shqyrtim ndikimet në sferën sociokulturore, gjuhësore, ekonomike, etnopsikologjike etj., ndikime këto që kanë tendencë të përvetësohen, të ruhen si pjesë e traditës. Nëse, p.sh., nisemi nga gjuha, ajo që nga gjeneza e saj e stërlashtë ndan origjinë me gjuhët indoevropiane.

Ajo që po ashtu vlen të nënvizohet me këtë rast është se – përveç kuptimit të gjenealogjisë së amzës, secila kulturë ka edhe një kuptim tjetër, të tërthortë që i dedikohet kontaktit, komunikimit, marrëveshjes,

bashkëpunimit dhe këmbimit me të tjerët. Në sajë të këtij fakti, janë të mundshme edhe alternime të mëdha dhe ndërrime të kuptimeve në vetë gjuhën primordiale të amzës. Brenda kësaj “qenie e dytë e kulturës” Berisha dikton dispozitat krijuese të njerëzve: shembuj të ndërndikimit midis gjuhëve të Ballkanit, edhe në mbështetje të studimeve të Rexhep Ismajlit.

Njëherësh, autori evokon studimet e Gani Bobit mbi stoicizmin greko-romak, si burim i refleksioneve mbi kulturën dhe traditën, vetë-kulturën dhe zotërimin e vetes si pikëmbështetje për rezistencë brenda situatave të terrorit të skajshëm (Në vorbullën e jetës së shqiptarëve, në “Konteksti i vetëkulturës”).

Në suazë të analizave mbi anë të ndryshme të proceseve të tranzicionit Berishaj shqyrton edhe shkaqet dhe format e shembjes së regjimeve komuniste në Ballkan. Në këtë kontekst, ai u bën vërejtje disa studiuesve që në ndryshimet e shkaktuara nga këto ngjarje, kanë lënë anash dimensionin sociokulturor, ngase kanë absolutizuar një model të caktuar ekonomik, më së shpeshti atë neoliberal.

Në këto hulumtime autori vë në pah disa pika të ngjashme midis procesit të shthurjes së vendeve të bllokut komunist dhe ish-Jugosllavisë: në të parin ai nënvizon se çlirimi nga komunizmi ishte i lidhur me çlirimin nga hegjemonizmi rus, kurse në ish-Jugosllavi i njëjti proces lidhej me çlirimin nga pesha e hegjemonizmit serb. Autori ndriçon këtu aspekte të rëndësishme të procesit të shthurjes së ish-Jugosllavisë.

Më pastaj ai trajton në mënyrë lucide anë të ndryshme të bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe komunikimit ndërkonfesional në Kosovë e njëherësh edhe raportet midis përkatësisë fetare dhe identitetit etnik te shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë.

Në pjesën në të cilën merret me trajtimin e çështjes së anomisë brenda botës së përbashkët Berishaj operacionalizon, veç të tjerash analizat pertinente të filozofit dhe sociologut *Jean Marie Guyau*. Arsye kryesore për këtë zgjedhje ai e shpjegon me bindjen se koncepti i tij për *anominë* shfaq një distancim nga botëkuptimet dominante të *anomisë e vlerësuar me tone negative*, siç janë: *gjendjet e padëshiruara shoqërore* (të nënsistemeve sociale dhe të individëve), por *anojnë kah një ngjyrim pozitiv i saj*, si parakusht dhe pjesë përbërëse e modernizimit dhe të demokratizimit, si dhe të barazuara me fleksibilitetin, aftësinë e adaptimit dhe gatishmërinë e individit për ndryshime. Në klimën e atëhershme, cek Berishaj, Guyau mbështetet në rrymimet e frymës së spiritualizmit dhe të voluntarizmit, me një refuzim të qartë të pozitivizmit të A. Comtes. Botëkuptimin e vet mbi etikën ai e mbështet te *individi* dhe aksioni e

vullneti i tij individual, aty ku ai u kundërvihet autoriteteve kolektive të jashtme, si dhe secilit pushtet, e sidomos atij religjioz.¹ Me këtë interpretim Guyau nuk e trajtoi anominë si të keqe dhe si sëmundje të shoqërisë moderne.

Anton Berishaj në këto hulumtime të thelluara mbi anominë në botën e përbashkët gjen mbështetje edhe te disa elemente themelore strukturale të teorisë së *anomisë* e Robert Merton-it, sociolog i shquar amerikan: objektivat e definuara kulturalisht të suksesit; mjetet për realizimin e këtyre objektiveve të cilat çështje themelore është niveli i përshtatjes me normat institucionale dhe struktura sociale me pozitën përkatëse stratifikative që janë të lidhura me "*strukturën e mundësisë*" dhe me mjetet e disponueshme legjitime për realizimin e objektiveve të definuara kulturore.

Ajo që vlen të nënvizohet – jo vetëm si veçori, por si vlerë shqiptare që as jeta e mundimshme në botën e përbashkët nuk arriti që ta lëkundë as zymtësojë, e që në këtë libër zë vendin qendror, është ruajtja e komunikimit simbiotik ndërkonfesional ndërmjet shqiptarëve. Derisa retrospektiva (e largët a krejt e afërt historike), pikërisht në *botën e përbashkët*, vazhdon të ofrojë skena dhune, përndjekje e shpërngulje, deri në spastrim etnik e shfarosje të pjesëtarëve me origjinë e të një gjuhe, por të besimeve të ndryshme, shqiptarët gjithandej rajonit, e gjetën formulën e tejkalimit të ndryshimeve, duke fuqizuar kombin dhe gjuhën si elemente kryesore identitare, para të gjitha përkatësive të tjera.

Në këtë botim, në sajë të njohurive teorike të autorit nga një varg disiplinash me karakter antropologjiko-sociologjiko-etnografik dhe eksperiencën nga kërkimet e gjata empirike në shoqërinë që deri vonë për shumëçka u përkiste bashkësive paraindustriale, janë arritur rezultate solide shkencore. Është një vepër objektive, me origjinalitet të posaçëm për nga struktura dhe qasja metodologjike. Një vlerë tjetër për të cilën shquhet ky studim qëndron në studimin e strukturave dhe dukurive komplekse shoqërore të tipit tradicional, si edhe në faktin se rezultatet e arritura hapin një varg çështjesh për studime të mëtutjeshme nga hulumtuesit e tjerë.

Botimi që është i mbështetur në aparaturë moderne shkencore dhe është realizuar brenda një kornizë metodologjike adekuate për natyrën e studimeve të këtilla, i ilustruar dhe i begatë me të dhëna, paraqet një burim reference për problematikën që i kushtohet.

¹ Po aty, fq. 11-12.

Libri studimor “*FSHEHJA E KRIMIT*” – *Politika serbe e mashtrimeve të mëdha*” e dr. Anton Vukpalaj¹ paraqet një tablo të qartë të politikës serbe të fshehjes sistematike të masakrave, të paraqitjes së civilëve të masakruar si luftëtarë dhe të krimeve gjenocidale në vitet 1998 dhe 1999. Këto praktika ishin përdorur nga regjimi serb edhe më parë në Kroaci dhe Bosnjë. Në vargun e krimeve të luftës, të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve gjenocidale serbe kundër shqiptarëve shquhet një veprim i tmerrshëm, dhe ky është fshehja e krimeve, specifikisht zhvarrosja e kufomave në Kosovë dhe varrosja në varrezat masive në Serbi.

Krimi dhe gjenocidi në Kosovë dhe kundër shqiptarëve ishin të paramenduar dhe planifikuar një kohë të gjatë nga shteti serb dhe të inspiruara nga strukturat intelektuale e krijuese dhe fetare, pastaj nga mediet etj. Vrasjeve dhe varrezave masive në Kosovë dhe pastaj zhvarrosjeve të kufomave dhe bartjes së tyre në Serbi për t’i rivarrosur në baza ushtarake, nën objekte ndërtimi, nën ura, për t’i hedhur në ujëra dhe djegur në miniera etj. -, i ka paraprirë në vitet 80 e 90 represioni i egër policor dhe ushtarak, diskriminimi dhe krimet kundër shqiptarëve si kolektivitet, torturat dhe arrestimet arbitrare, bastisjet dhe ekspeditat

¹ Autori (1971) studioi në Sorbonë të Parisit, në Universitetin Paris 10 dhe në Institutin e Shkencave Sociale të Politikës (Institut des Sciences Sociales du politique). U specializua në shkencat politike, në sociologjinë politike dhe në politikat komparative dhe të integritimeve evropiane. Nuk munguan edhe hulumtimet e tij nga Drejtësia Tranzicionale në Evropën JL dhe ballafaqimi i shoqërive postautoritare dhe postkonfliktuale me të kaluarën. Mori pjesë në shumë tubime shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe në cilësi të vizitorit dhe profesorit të ftuar mbajti ligjërata në disa institucione shkencore dhe akademike prestigjioze evropiane. Ka botuar disa libra shkencorë dhe shumë artikuj dhe trajtesa, ndër të cilat shquhet teza e tij e doktoratës “Ex-Yougoslavie, de la guerre à la justice (Ish-jugosllavia: nga lufta te drejtësia)” në rreth 400 faqesh, të publikuar nga Shkolla Doktorale e Parisit 10 dhe Instituti i Shkencave Sociale të Politikës. Në vitet shkollorë 2018 dhe 2019 ishte angazhuar si ligjërues në Universitetin e Friburgut në Zvicër në programin Master në studimet e Evropës Lindore, duke ligjëruar lëndët “Shtetet e brishta në Evropën Lindore dhe JL” dhe “Politikat Krahaskimtare të Ballkanit”. Ndër shumë publikime nga fusha e “Drejtësisë tranzicionale në Evropën JL”, veçohen publikimet e tij të fundit shkencore: “Drejtësia Tranzicionale”, e botuar nga Konrad Adenauer Stiftung dhe “Formësimi i Kosovës ndërmjet varësisë, pavarësisë dhe ndërvësisë”, e botuar te Peter Lang në Bern në cilësinë e koautorit.

ndëshkuese, rrënimi i bazës ekonomike përmes plaçkitjes së teknologjisë dhe pronës private me masa policore, përjashtimet e shqiptarëve nga puna dhe institucionet e pushtetit, mbyllja e shkollave dhe ndjekja e arsimtarëve sikundër dhe kolonizimi i Kosovës si aspiratë shekullore për ndërrimin e përbërjes kombëtare të popullsisë, dëbimi masiv i popullatës shqiptare dhe spastrimi etnik i saj etj.; intervenimi i NATO-s shërbeu vetëm si pretekst për të përmbushur qëllimin e kahmotshëm të spastrimit etnik të shqiptarëve, sikurse në Bosnjë.

Varrezat masive dhe tentimi që të fshihen dhe shkatërrohen kuformat e viktimave civile, paraprakisht të masakruara dhe të varrosura në varreza masive, tregon se ky operacion paraqet një nga ndërmarrjet më të mëdha të fshehjes së kufomave nëpërmjet “grabitjes” së tyre për t’i fshehur krimet. Vrasjet dhe fshehja e krimeve dhe praktikat “spastrimit” dhe “shkatërrimit” shërbyen si mjet për të përmbushur qëllimet. Përmes zbatimit të operacionit **Asanacija** regjimi përpiqej të pamundësonte zbulimin e krimeve dhe rrjedhimisht dënimin e personave që do të akuzoheshin para Tribunalit të Hagës nga se do të mungonin provat dhe në këtë mënyrë do të demantoheshin pretendimet se ishin kryer krimet. Krimet ishin kryer para se të instaloheshin misionet civile dhe ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, sepse prania e tyre do ta pengonte një gjë të tillë, ndërkaj në Serbi nuk kishte mundësi të zbuloheshin kufomat.

Në libër analizohen dinamikat politike dhe proceset që kishin çuar në fshehjen e krimeve dhe mohimin e tyre. Rezultatet e hulumtimit identifikuan elemente që mundësojnë të kuptohen rrënjët dhe konsekuencat e politikës së tillë serbe. Analiza e akuzave, e proceseve gjyqësore dhe e aktgjykimeve të udhëheqjes serbe në Hagë, si dhe rruga e gjatë që u ka paraprirë këtyre proceseve dëshmon për *natyrën institucionale të organizimit të krimeve e veprimeve gjenocidale dhe dimensionin kolektiv të kryerjes së tyre në Kosovë*, konstaton autori.

Pas hulumtimit të materialeve të qarqeve politike e shtetërore, gjyqësore e ushtarake serbe etj. që ishin në anglisht, frëngjisht, serbisht etj., të cilat autori i flet dhe i shkruan, dr. Vukpalaj e hartoi studimin “FSHEHJA E KRIMIT”. E bëri një punë që nuk e kishte bërë as Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë i themeluar nga një qeveri qysh në vitin 2011 për të mbledhur, përpunuar, klasifikuar dhe arkivuar informacionet për krimet e kryera gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Autori vetë i mblodhi, i klasifikoi dhe i analizoi dhe në fund i studioi dhe rezultatet i kumtoi në botimin “Fshehja e krimit – Politika serbe e mashtrimeve të mëdha”. Botimi përfshin disa pjesë dhe disa kaptina e nënkaptina. Qëllimi i studimit është që përtej tmerit dhe

dënimit të tij, të kuptohet strategjia e pushteti serb në kontekstin e luftës në Kosovë për të stimuluar, organizuar dhe vënë në lëvizje ato që mund të quhen praktika të “spastrimit” dhe të “shkatërrimit”.

Për ta shpjeguar, sqaruar dhe kuptuar gjithë këtë proces të ndërlikuar të krimit gjenocidal, autori përveç literaturës dhe burimeve relevante, është mbështetur edhe nga provat e dala nga aktgjykimet e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavi dhe në materialet e tjera që janë shqyrtuar gjatë proceseve gjyqësore të lidhshpimit serb. Këto materiale përbëjnë një platformë për veprim shoqëror, pasi përveç për juristë, ato janë burim i çmuar i informacionit për studiuesit, viktimat dhe familjet e tyre, të cilët mund të mbështeten në njohuritë e prodhuara nga Tribunali për të zbardhur të vërtetën. Për këtë arsye, materialet e vërtetuara në këto procese gjyqësore paraqesin një burim të pafund të informacionit i cili shkon në kundërshtim me ndërmarrjen e forcave serbe që të zhdukin çdo lloj prove të mundshme të krimeve të tyre. Për të kuptuar më mirë këtë operacion, Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavi do të luajë një rol kyç, jo vetëm në gjykimin e lidhshpimit serb, por edhe duke i bërë publike krimet kundër civilëve. Tribunali i Hagës do të jetë pengesa kryesore në luftën e regjimit të Milosheviçit kundër civilëve dhe kamuflimin e krimeve. Aktakuzat kundër zyrtarëve më të lartë serbë në krye me Milosheviçin, në maj të vitit 1999 dhe në proceset gjyqësore të Hagës, do ta bëjnë të pamundurën që këto krime kundër civilëve të mbeten dhe trajtohen si “dëm kolateral” i asaj që ai e kishte paraqitur si “luftë kundër terrorizmit” e që në realitet kishte për qëllim stigmatizimin e kundërshtarëve si vrasës të personave të pafajshëm.

Autori i shpjegon kronologjikisht dhe në hollësi veprimet fashioide të regjimit serb, që kulminuan me vrasjet dhe varrezat masive dhe “vjedhjen” e kufomave për t’i fshehur krimet në Kosovë, ashtu siç bëri më parë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në maj të vitit 2001 u bë publik informacioni mbi ekzistencën e disa varrezave masive të shqiptarëve të Kosovës në Serbi. Mbetjet mortore të cilat do të zbulohen në këto varreza masive, ishin ato të viktimave civile shqiptare, të vrara në Kosovë, në vitin 1999. Ato ishin transportuar atje në mënyrë të organizuar nga fundi i marsit deri në fillimin të qershorit të vitit 1999 dhe ishin fshehur në disa lokacione në Serbi. Ekzistenca e këtij operacioni do të bëhet publike pas rënies së regjimit të Milosheviçit dhe arrestimit të tij në fund të prillit të vitit 2001. Pas zbulimit të këtij operacioni, Qeveria e Serbisë kishte krijuar një grup punues për ta hetuar atë. Grupi punues do të dalë me dy raporte (më 25 maj dhe më 26 qershor 2001) në të cilat flitet për dy lokacione ku ishin rivarrosur civilët shqiptarë të Kosovës:

Batajnica në periferi të Beogradit dhe Petrovo Selo afër Kladovës, në Serbinë Lindore. Një muaj më vonë, Qeveria e Serbisë do të japë informacion edhe për një varrezë tjetër masive afër digës së Liqenit Peruçac te Bajina Bashta, në kufi të Serbisë me Bosnjën dhe Hercegovinën. Në vitin 2013 do të zbulohet varreza e katërt masive, në vendin e quajtur Rudnica, afër kufirit të Serbisë me Kosovën. Numri më i madh i mbetjeve trupore të shqiptarëve të Kosovës do të zbulohen në Batajnicë, në një terren të Forcave Speciale të Policisë së Serbisë.

Në vitet 2001-2002, nën mbikëqyrjen dhe asistencën e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, si dhe të hetuesve të Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavi, në këtë lokacion u gërmuan gjithsej tetë varreza masive. Aty u zhvarrosën dhe u gjetën mbetjet mortore të – jo më pak se 741 personave. Nëse kësaj ia shtojmë edhe gjetjet e trupave të viktimave të zbuluara në Petrovo Selo, në Liqenin Peruçac dhe në Rudnicë, atëherë ky numër shkon në 944 veta. Në një studim të Fondit për të Drejtën Humanitare të publikuar në vitin 2017 janë identifikuar masakrat nga të cilat kanë rezultuar kufomat e zhvarrosura në Serbi. Në këtë raport thuhet se këto mbetje trupore rezultonin nga 40 masakra të ndryshme të civilëve në Kosovë. Megjithatë, kjo nuk është e gjitha. Një pjesë tjetër e kufomave të zhvarrosura supozohet se janë djegur në së paku në katër shkritore minierash në Serbi dhe në Kosovë.

Zhvarrosja e trupave të viktimave shqiptare të Kosovës është organizuar nga nivelet më të larta të regjimit serb në Beograd, gjë që bën të kuptohen edhe strukturat udhëheqëse, personat e implikuar dhe modus operandi-n e tyre. Kjo na mundëson ta kuptojmë se cilat kanë qenë shkaqet të cilat e kanë shtyrë Milosheviçin që ta realizojë një operacion të tillë dhe çka fshihej pas shprehjes “asanacija”, e cila është përdorur si term për të përshkruar vetë operacionin.

Ushtrimin e dhunës politike ndaj popullsisë civile si qëllim lufte, autori Benjamin Valentino e konsideron si “perspektivë strategjike” të regjimeve si ai i Milosheviçit. Ai sugjeron se “vrasjet masive shihen më saktë si një politikë instrumentale - një strategji brutale e dizajnuar për të realizuar objektivat më të rëndësishëm ideologjikë ose politikë të liderëve, si dhe për të kundërshtuar ato që i shohin si kërcënimet e tyre më të rrezikshme”. Valentino thotë se vrasjet masive të popullsisë civile janë “mjet i fuqishëm politik dhe ushtarak”. Edhe pse vrasjet masive të civilëve janë veprime që janë në kundërshtim me rregullat e luftës, rasti i Bosnjës dhe më pas, edhe i Kosovës tregojnë se ato kishin qenë qëllim i luftës.

Fshehja e krimeve, sipas autorit, është komponent i rëndësishëm i luftës kundër civilëve dhe qëllimi i saj është, përveç të tjerash, edhe mohimi i krimeve. Regjimi i Milosheviçit ka tentuar t'i mohojë krimet, t'i paraqesë civilët e vrarë si luftëtarë të UÇK-së, t'i djegë kufomat e viktimave në vendin e ekzekutimit ose në shkretore të minierave në Kosovë dhe në Serbi dhe deri në "grabitjen" e varrezave masive në Kosovë dhe fshehjen e tyre në më shumë se 400 kilometra larg vendit të krimeve, duke e bërë Batajnicën varrezën masive më të madhe të shqiptarëve të Kosovës. Imazhet e kamionit frigorifer të mbushur me kufoma civilësh shqiptarë të Kosovës, i cili kishte dalë në sipërfaqe të Danubit, do të jetë ballafaqimi i parë i Serbisë më të kaluarën e luftës në Kosovë dhe ka paraqitur një përvojë edhe vizuale e cila ka ofruar qasje të vërtetë në të kaluarën. Verdery thotë se mbetjet trupore të viktimave janë simbole efektive, sepse ato janë konkrete dhe mundësojnë të shikohet e kaluara. Ajo i konsideron ato si argument i fuqishëm kundër tendencave revizioniste dhe manipuluese të historisë.

Autori në vazhdim analizon rolin e Tribunalit të Hagës në fazat e para të implikimit të tij në Kosovë. Deklaratat e para të Tribunalit për Kosovën i gjejmë në fillim të marsit 1998. Fokusimi i tij do të jetë pikërisht në krimet e kryera nga forcat serbe kundër civilëve. Në këtë mënyrë, Tribunali do të kontribuojë që kjo dhunë masive të mos mund t'i shërbejë "qëllimit strategjik" të Serbisë në Kosovë. Paralajmërimi i regjimit serb se vrasja e civilëve përbënte shkelje të rregullave të luftës do të bëhet përmes letrave të cilat prokuroria e Hagës do t'ia dërgojë Milosheviçit, përmes deklaratave për shtyp të prokurorisë dhe kryetarëve të Tribunalit, por edhe përmes kërkesave për bashkëpunim në hetimin e krimeve. Në këtë kapitull janë analizuar disa momente kyçe të këtij ballafaqimi të Tribunalit të Hagës me regjimin e Milosheviçit para se të shpallen aktakuzat. Masakra e Reçakut është një nga ato. Kjo masakër përmban të gjitha elementet e natyrës së luftës së Serbisë në Kosovë. Paraqitja e civilëve të vrarë nga regjimi serb si luftëtarë të UÇK-së, përdorimi disproporcional i forcës ushtarake gjatë sulmit, që kishte për qëllim të provokonte një numër sa më të madh të vdekjeve civile, inskenimi i vendit të krimit për të fshehur gjurmët dhe për ta kontestuar versionin e observatorëve të OSBE-se, ndalimi i hyrjes së kryeprokuores së Tribunalit të Hagës për të hetuar krimin etj.

Ky ballafaqim i Tribunalit të Hagës do të përfundojë me shpalljen e dy aktakuzave kundër zyrtarëve më të lartë serbë. Aktakuza e parë është ajo e bërë publike më 24 maj 1999 kundër Slobodan Milosheviçit dhe katër zyrtarëve më të lartë serbë. Në tetor 2003 do të shpallet një

aktakuzë e dytë kundër vartësve të grupit të parë e që ishin krerët e tjerë ushtarakë dhe policorë të RFJ-së dhe Serbisë.

Në një pjesë të dorëshkrimit trajtohen fillimisht aktakuzat e lëshuara nga Tribunali i Hagës kundër lidërshipt politik, ushtarak dhe policor serb për krimet e kryera në Kosovë. Aktakuzat të cilat në masë të madhe do të vërtetohen gjatë proceseve gjyqësore, do ta qartësojnë se cilët kanë qenë urdhërdhënësit e krimeve, duke përfshirë këtu edhe operacionin e fshehjes së kufomave të civilëve shqiptarë. Në këtë pjesë të dorëshkrimit do të analizohet përgjegjësia e secilit zyrtar të lartë serb, si dhe roli i tyre individual në kuadër të hierarkisë politike, ushtarake dhe policore të RFJ-së dhe Serbisë. Të dënuarit për krime në Kosovë do të jenë: Nikola Shainović, Dragoljub Ojdanić, Nebojsa Pavković, Sreten Lukić, Vlastimir Gjordjević dhe Vladimir Lazarević. Një analizë paraprake të këtyre rasteve është e rëndësishme për shkak se shumë pak është shkruar për këta persona në Kosovë dhe për shkak se, përveç Miloshevićit, ka shumë pak njohuri se cilët kanë qenë ata, cili ka qenë roli i tyre brenda regjimit, cilat kanë qenë akuzat për të cilat janë akuzuar dhe për cilat krime janë dënuar. Këto gjykime kanë kaluar në Kosovë të pashpjeguara. Kjo analizë na mundëson ta kuptojmë më mirë rolin e këtyre personave për shkak se viktimat dhe dëshmitarët të cilët kanë dëshmuar në proceset gjyqësore në Hagë nuk ishin ballafaquar me këta persona ndonjëherë për shkak se ata kishin qenë larg vendeve të krimeve. Kjo është edhe arsyeja pse këta persona nuk kanë arritur të hyjnë në memorie kolektive në Kosovë.

Më tutje autori analizon doktrinën gjyqësore të “Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale” (NPK) në bazë të së cilës është akuzuar dhe dënuar lidërshipti serb. Kjo doktrinë gjyqësore i ka mundësuar Tribunalit t’i dënojë eprorët serbë në bazë të “qëllimit të përbashkët” që ka qenë dëbimi masiv i popullsisë shqiptare të Kosovës me qëllim të ndryshimit të strukturës së popullsisë e që në dimensionin afatgjatë kishte për qëllim mbajtjen nën kontroll të Kosovës. Analizohet edhe dalja në sipërfaqe e operacionit të grabitjes së varrezave masive. Bërja publike e këtij operacioni është e lidhur ngushtë me ndryshimet politike në Serbi dhe me dorëzimin e Miloshevićit në Hagë. Miloshevići ishte arrestuar në prill 2001 dhe për të legjitimuar dorëzimin e tij në Hagë, Qeveria e Serbisë në krye me Zoran Gjingjiqin do të bëjë fillimisht publike daljen në sipërfaqe të kamionit frigorifer në Danub dhe më pas edhe në lokacionet e tjera ku kishin përfunduar kufomat e shqiptarëve të Kosovës në Serbi. Operacioni i nxjerrjes së kamionit frigorifer nga Danubi i njohur si “Thellësia 2” (Dubina 2) është qartësuar gjatë

proceseve gjyqësore në Hagë, në veçanti gjatë gjykimit të ish-zëvendësministrit serb, Vllastimir Djordjeviç.

Në një kapitull është analizuar planifikimi dhe kryerja e operacionit “*Asanacija*”. Mungesa e provave të shkruara kishte qenë sfida më e madhe e prokurorisë së Hagës për të vërtetuar këtë operacion. Mungesa e urdhrave të shkruar është karakteristikë e veprimit të forcave serbe në Kosovë. Për ta vërtetuar këtë operacion, deshmitarët do të luajnë rol kyç duke ia filluar nga shoferët e kamionëve të cilët i kishin transportuar kufomat deri te bageristët të cilët i kishin hapur varrezat masive me makineri të rëndë dhe i kishin ngarkuar në kamionë. Në këtë kapitull analizohen edhe lokacione të tjera të kufomave të zhvarrosura, që supozohet se janë djegur në së paku katër shkritore minierash në Serbi dhe në Kosovë.

Ndërkaq në kapitullin pasues prezantohet natyra e krimit të fshehtës së kufomave të viktimave civile nga aspekti krahasues. Krahasimi me operacionin e ngjashëm në Srebrenicë, ku nga gushti deri në nëntor 1995 serbët e Bosnjës u ishin kthyer varrezave masive, duke i zhvarrosur mbetjet trupore të viktimave boshnjake dhe duke i rivarrosur ato në 24 varreza “sekondare” përgjatë lumit Drina, na mundëson ta kuptojmë më mirë operacionin e ngjashëm në Kosovë. Në Bosnjë ishte proceduar me “spastrim” të terrenit para se të shkohet në Dejtון, në nëntor dhe dhjetor 1995. Në Bosnjë, ky operacion mban emrin e njëjtë si në Kosovë, “*Asanacija*”. Serbët e Bosnjës kishin kalkuluar se në rast se do të zbuloheshin krimet e tyre, ata do të dobësoheshin në Dejtון. Ngjashëm edhe në Kosovë, Milosheviçi kishte menduar se me fshehtësinë e kufomave të shqiptarëve të Kosovës në Serbi, do të mund të mohonte se në Kosovë kishte pasur krime masive, dhe këtë do të mund ta kapitalizonte politikisht në negociata që parashihej të zhvilloheshin. Mohimi i krimeve figuron në agjendën e njërit nga bashkëpunëtorët më të afërt të tij, gjeneralit të policisë së Serbisë, Obrad Stevanoviç, i cili në një takim në Presidencë kishte shkruar në agjendën e tij: “Nuk ka kufoma-nuk ka krime” (“Nema leševa-nema zločina”). Në këtë kapitull është analizuar edhe mohimi i krimeve nga aspekti i fushës së drejtësisë tranzicionale. Sipas Anstett dhe Dreyfus, “mohimi i ekzistencës së viktimave përmes shkatërrimit të aspekteve të tyre njerëzore, u mundëson autorëve ta lënë derën hapur të kryerjes së vazhduar të krimeve përmes mohimit të tyre”. Për këtë arsye, qellimi i këtij studimi është që fati i njerëzve të vrarë në masakra të mos mbetet “objekt spekulimi, thashethemesh dhe mohimi.”

Nuk ka dyshim se ky botim paraqet një referencë të rëndësishme për problematikën që i kushtohet.

HIVZI ISLAMI: Muhamedin Kullashi,
“Çështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës”, ASHAK, 2021.

Libri i Muhamedin Kullashit *ÇËSHTJA E KOSOVËS NË HAPËSIRËN PUBLIKE TË FRANCËS*” (me 261faqe) përmban analizat, studimet dhe debatet mbi çështjen e Kosovës në hapësirën publike të Francës, në nivele të ndryshme të opinionit publik: në revista shkencore, në konferenca shkencore, në medie, në qarqet shtetërore e politike, në Parlament dhe në Senat e njëherësh në mjedise të ndryshme të shoqërisë civile franceze. Periudha e studimit kap ngjarjet midis viteve 1991-2001, ndërsa autori i botimit vetë është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i analizave dhe debateve në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe në pasqyrimin e të vërtetës për Kosovën dhe shqiptarët në opinionin publik francez.

Koncepti i hapësirës publike me të cilin operon autori këtu është koncept i filozofisë politike (i Habermasit dhe Arendt në radhë të parë), i frymëzuar nga disa analiza të Kantit. Hapësira publike kuptohet si hapësirë e formimit të opinionit dhe vullnetit politik e jo si skenë e paraqitjes së një publiku të spektatorëve pasivë. Theksi në shqyrtimet e autorit në veçanti të *ndërveprimet* midis niveleve të ndryshme të shoqërisë ku trajtohet çështja e Kosovës dhe konfrontimit publik të argumenteve që shpijnë të *vendimet* e rëndësishme politike të Qeverisë dhe Presidencës franceze.

Brenda këtyre debateve publike në Francë autori vë në pah prarinë e ndikimeve brenda interpretimeve politike e historiografike të cilësuar me qasje të theksuara proserbe: kjo vlen sa për kërkimet dhe botimet shkencore mbi Kosovën po aq edhe për ato politike, në nivele të ndryshme. Midis këtyre interpretimeve shquhen, veç të tjerave, pikëpamje e paradigma mbi Kosovën si “djep i serbizimit”, të shoqeruara me një varg paragjykimesh mbi shqiptarët, mbi historinë dhe kulturën e tyre.

Depërtimin e disa elementëve të situatës në Kosovë brenda hapësirës publike të Francës M. Kullashi e trajton, në kreun I, brenda shqyrtimeve dhe debateve që u zhvilluan në disa konferenca shkencore ndërkombëtare të cilat janë mbajtur në Francë. Së këndejmi, në konferencën me titull “Republika, Evropa dhe Universalja” në vitin 1991, morën pjesë filozofë, sociologë e politologë, por edhe disa ministra nga Franca dhe nga disa vende të tjera. Përballë këtij auditori autori në kumtesën e vet ka theksuar që në fillim se ajo që po ndodh në

ish-Jugosllavi, shpërthimi i luftimeve të armatosura, përbën një sfidim për Evropën. Autori ka vënë në dukje se si lëvizja populiste-nacionaliste serbe i ka futur në dorë gradualisht dhe duke instrumentalizuar disa probleme në Kosovë, me ndërmjetësimin e Partisë komuniste institucionet e Serbisë dhe ato federative, sidomos policinë dhe armatën federative (JNA), të cilat i vuri në shërbim të konceptit të vet të *ristrukturimit* të Jugosllavisë. Ai ka saktësuar se merita kryesore për elaborimin e programit ultranacionalist u takon megjithatë intelektualëve serbë, para së gjithash Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë (SANU) dhe Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë.

Autori analizon dhe zbërthen debatet në dy konferenca të tjera shkencore që janë mbajtur në gjysmën e parë të vitit 1992 në Paris, në *École des Hautes Études en Sciences Sociales* dhe në *École Normale Supérieure*. Në këto konferenca kanë marrë pjesë profesorë nga Parisi, por edhe nga Beogradi, Zagrebi, Sarajeva dhe Prishtina. Janë trajtuar shkaqet dhe rrjedhat e luftërave në Kroaci dhe Bosnjë. Në këtë pjesë të dorëshkrimit autori vë në dukje edhe rëndësinë e themelimit të Komitetit të Kosovës në Paris pranë revistës presitigjioze për shkencat shoqërore “*Esprit*”. Rëndësia e këtij Komiteti shpjegohet sa me peshën intelektuale e morale të filozofëve e sociologëve francezë (Claude Lefort, Edgar Morin, Pierre Hasner, Olivier Mongin, André Glucksmann, Alain Finikelkraut etj.) aq edhe me veprimtarinë e tyre të shumëfishtë gjatë më se një dekade në Francë. Autori thekson këtu se shpërthimi i luftës në Bosnjë do të krijojë një hapësirë edhe për çështjen e Kosovës. Disa intelektualë dhe veprimtarë të të drejtave të njeriut në Francë që zunë të interesohen për shkaqet e shpartallimit të ish-Jugosllavisë, hetuan se nisma e këtij shpartallimi kishte filluar në fillim të viteve 80 në Kosovë.

Më tutje zbërthehen anët e ndryshme të tipareve të konflikteve, ashtu si shpërfaqen në analizat dhe debatet e autorëve francezë në konferencën e “*Collège international de philosophie*” dhe në librin “*Vukovar*”, Sarajevo – Paris, 1993. Kësisoj politologu P. Hassner në artikullin e tij mbi hezitimet dhe kundërthëniet e bashkësisë ndërkombëtare, duke analizuar debatet mbi *përgjegjësinë* e vendeve perëndimore evropiane dhe SHBA-së për “katastrofën jugosllave”, vë në pah se ato zhvillohen në nivele të ndryshme që gërshetohen dhe janë të kundërthënshme: por ai njëherësh merr në shqyrtim edhe përgjegjësitë e aktorëve politikë e ushtarakë në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Të kuptuarit adekuat të veçantisë së problemit të Kosovës brenda opinionit francez e pengonin paragjykimet e akumuluar gjatë viteve të

kaluara, të cilat ishin përhapur kryesisht nga mekanizmat e propagandës së fuqishme proserbe në Francë. Filozofi Patrick Canivez, profesor i filozofisë në Universitetin Lille II, *Franca karshi luftës në ish-Jugosllavi* zhvillon një kritikë të politikës së Francës ndaj agresioneve të Serbisë ndaj Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës. Ai kritikon në veçanti qëndrimet e presidentit F. Mitterand në këtë kontekst; qëndrime këto që thelbësisht favorizonin vetëm interesat e Serbisë.

Autori në shkrimin e tij “Kosova dhe shpërbërja e Jugosllavisë” zhvillon rekonstruktimin e konflikteve politike e ideologjike që do të kenë si “laborator” të eksperimentimit Kosovën, nga i cili mund të diktohet *gjenealogjia* e këtyre konflikteve që marrin edhe forma të luftërave të armatosura. Njëherësh vë në pah se aty ngjizen edhe elementet e një *tipi të ri të pushtetit*. Ky pushtet do t’i ripërvetësojë disa struktura politike e shtetërore dhe do të rikomponojë një ideologji populiste, nga përpunimi i elementeve të së kaluarës, e cila do të veprojë mbi masat me një orientim nationalist gjithnjë e më ekstrem.

Në Kreun II, përveç të tjerash, autori analizon edhe kumtesat e pjesëmarrësve të konferencës shkencore “Mbi dështimet e demokracive në procesin paqësor në ish-Jugosllavi”, e mbajtur në *Ecole Normale Supérieure* në Paris me 1995. Këto kumtesa u botuan dy vjet më vonë në librin *Ish-Jugosllavia në Europë (L’Ex-Yougoslavie en Europe, L’Harmattan, Paris, 1997)*. Shquhen këtu analizat e P. Hassner mbi përgjegjësitë e organizatave ndërkombëtare (OKB, OSBE etj), si dhe të shteteve dhe të shoqërive civile në dështimin e botës perëndimore karshi luftërave dhe krimeve në Kroaci dhe Bosnjë. Ai shton pastaj se po kështu “mund të inkriminohen interesat egoiste apo të kundërtëhënshme të këtyre shteteve”. Mirëpo, saktëson ai, “prapa këtij nocioni abstrakt, aq shpesh i shpalosur me gjoja urti, thuajse ai përbën shpjegimin përfundimtar, i cili nuk duron përgjigje, shtrohet pyetja: për cilat interesa është fjala, elektorale, ekonomike apo strategjike? Janë ato interesa të qeveritarëve, të regjimeve, të të qeverisurve, apo ato të forcave ndërkombëtare?”. Kësisoj ai rikujton se ky nocion abstrakt i “interesit” duhet të sqarohet ndopak ngase, shton ai, jemi të detyruar të kemi parasysh “një analizë të normave dhe strukturave, të ideve dhe forcave që udhëheqin politikën ndërkombëtare”.

M. Kullashi në kumtesën e vet “Heshtja rreth Kosovës në Dayton” vë në pah se në analizat gjeopolitike që shpaloseshin nga mesi i viteve 90 të shekullit të kaluar, qoftë nga zyrtarët e shteteve të mëdha, qoftë nga ekspertët vënin në pah “*kundërshtitë* midis integritetit territorial të një shteti dhe të drejtës për vetëvendosje”, midis të drejtave

individuale dhe atyre kolektive të pakicave dhe të drejtave të njeriut, midis aspiratave politike të popujve dhe interesave gjeostrategjike të bashkësisë ndërkombëtare. Kësisoj, në disa tubime publike, zyrtarë të BE-së ishin të bindur se afirmonin si duhet parimet e të drejtave të njeriut, kur thoshin se ato duhet të trajtohen si të drejta të individëve, duke evituar që të kolektivizohen, “kolektivizim” ky që shpinte tek “etnicizimi” i problemit në Kosovë. Kundrejt këtyre qëndrimeve autori ka reaguar duke vënë në pah kufizimin thelbësor të kësaj *qasjeje*: “pamundësinë, duke u nisur nga kjo, për të kuptuar karakterin e problemit, realitetin e ngjarjeve dhe natyrën e aksioneve të qeverisë serbe karshi Kosovës”.

Në konferencën shkencore ndërkombëtare mbi kampet dhe gjenocidet në Universitetin e Sorbonës IV, kanë marrë pjesë 35 profesorë dhe hulumtues të shquar nga vende të ndryshme të Evropës Perëndimore dhe SHBA-së. Në vitin 1999 kumtesat e kësaj konference u botuan në librin voluminoz me titull “*Parler des camps, penser les génocides*” (Të flasësh për kampet, të mendosh gjenocidet) (f.1-669) nga shtëpia botuese prestigjioze *Albin Michel* në Paris. Autori këtu shohit thekse pertinente nga kumtesat e pjesëmarrësve. Në artikullin e tij me titull “*Spastrimi etnik dhe gjenocidi në ish-Jugosllavi*”, ai analizon hollësisht ngjizjen e praktikave gjenocidale të regjimit serb në ish-Jugosllavi me tërësinë e formave të terrorit shtetëror që është zhvilluar nga viti 1981 kundër shqiptarëve të Kosovës.

Në kreun III autori shqyrton kompleksitetin e debateve në hapësirën publike të Francës në veçanti në vitet e fundit të viteve 90 kur hapet çështja “për apo kundër” intervenimit të NATO-s kundër caqeve ushtarake të Serbisë. Ai analizon edhe dy takimet e anëtarëve të Komitetit Kosovës në Paris me Presidentin Jacques Chirac, qëndrimet e tij etiko-politike karshi ngjarjeve tragjike në Kosovë, ashtu si shpallosen në opinionin publik francez, në fjalimet dhe shkrimet e tij. Kullashi vë në pah rëndësinë e takimit të Presidentit Chirac me Ibrahim Rugovën në pallatin Elysée në maj të vitit 1999.

Autori e zhvillon njëherazi një analizë të debateve dhe polemikave në opinionin francez lidhur me interpretimet mbi *realitetin apo shpifjen* e ngjarjeve - spastrimi etnik i institucioneve dhe i territorit të Kosovës – apo ato që flasin për “mbrojtjen legjitime të sovranitetit të shtetit serb”. Është fjala për analiza kritike të një spektri të gjerë të qëndrimeve politike në Francë lidhur me anë të ndryshme të çështjes së Kosovës në momentet më dramatike të atyre viteve. Autori merr në shqyrtim, veç të tjerash, ballafaqimet e interpretimeve që synojnë të

mohojnë realitetin e krimeve masive të regjimit serb mbi shqiptarët e Kosovës në mbarim të viteve 90 me ato që nxjerrin në shesh vërtetësinë e tyre. Në opinionin publik francez shpalohen në vitet 1998 dhe 1999, por edhe më vonë, versione të ndryshme të *revizionizmit* dhe *negacionizmit* të krimeve serbe në Kosovë, që synojnë të *zhbëjnë realitetin* e atyre krimeve.

Pjesa përfundimtare e analizave të Kullashit u kushtohet debateve mbi perspektivën evropiane të Kosovës, pas çlirimit. Në fakt, çështja e perspektivës evropiane të Kosovës është shtruar pas çlirimit të Kosovës në hapësirën publike të Francës në nivele të ndryshme: brenda qarqeve politike, intelektuale e shkencore, si edhe në medie. Në vitin 2000 u mbajt një konferencë shkencore në Paris e organizuar nga Komiteti i Kosovës në të cilën morën pjesë hulumtues nga shkencat shoqërore dhe intelektuale që janë marrë me çështje të Ballkanit dhe të Kosovës në veçanti. Orientimi kryesor i debateve në këtë konferencë kishte parasysh ardhmërinë politike të Kosovës pas çlirimit të saj. Më së shpeshti evokohej perspektiva evropiane e Kosovës përkatësisht mundësitë që Kosova të bëjë pjesë në Bashkimin Evropian.

Autori i trajton debatet dhe shqyrtimet mbi këtë aspekt të çështjes së Kosovës në Francë brenda debateve më të gjera për integrimin e vendeve të Ballkanit brenda BE-së. Ai i vë në qendër të analizave këtu, në veçanti hulumtimet e Pierre Hassner-it dhe të Jacques Rupnick-ut të zhvilluara në fillimi të viteve 2000.

JUSUF BAJRAKTARI: Frashër Demaj, *Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918*

Botimi “Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918” i autorit Frashër Demaj, botuar nga ASHAK-u, vjen si rezultat i hulumtimeve të vazhdueshme shkencore në dokumentet arkivore të proveniencës britanike. Në këtë studim, autori trajton pozicionin gjeografik dhe gjeostrategjik, politik, social, demografik, religjioz, ekonomik, diplomatik dhe aspekte të tjera të shoqërisë shqiptare midis viteve 1912-1918, nga perspektiva e burimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, pa lënë anash edhe burime të tjera relevante dhe literaturën përkatëse.

Autori, për të qenë sa më argumentues dhe për të krahasuar faktet ka shfrytëzuar edhe dokumente arkivore austro-hungareze, italiane, osmane, gjermane, franceze, ruse, serbe dhe malazeze. Mirëpo baza e këtij botimi janë fondet arkivore të hulumtuara në Arkivin Nacional (The National Archive) në Londër në vitin 2017.

Në kuadrin gjithëpërfshirës autori ka shfrytëzuar edhe fonde dokumentare në Arkivin e Kosovës si: Fondin e Londrës, Fondin e Stambollit, Fondin e Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, Fondin e dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, Arkivin e Shtetit Shqiptar, Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë (Fondin e Londrës dhe të Vjenës), dokumente të proveniencës sllave nga Državni Arhiv Crne Gore-Cetinje (DACG) dhe ato serbe të Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranih Poslova- Beograd (DASSIP).

Autori ka shfrytëzuar edhe burime të botuara nga studiues të njohur si: Skender Rizaj (tri vëllime), Ramiz Abdyli (dy vëllime), Valentina Duka (dy vëllime), Idriz Lamaj, Kristaq Prifti, Muhamet Shatri, Gjyltekin Shehu, Zekeria Cana, Iliaz Rexha, Ferit Duka, Marenglen Verli, Beqir Meta, Nevila Nika si dhe Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Aktet ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit nga Arben Puto, dokumente britanike të botuara nga autori i këtij botimi në vitin 2019 etj.

Autori Demaj, në përgatitjen dhe botimin e kësaj monografie është mbështetur në metodologjitë bashkëkohore të vlerësuara në shkencat shoqërore dhe humane. Ka bërë analiza, krahasime, vlerësime, qëndrime pa lënë anash këtu edhe vështrimin kritik për çështje të caktuara gjatë mbarështimit të materialit të vjelë nëpër arkiva dhe biblioteka. Botimi

“Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918” bazohet në qasje multidisiplinare të trajtimit të problemeve nga perspektiva historike.

Në këtë studim trajtohen aspekte të ndryshme dhe qëndrime zyrtare të politikës britanike për pozitën gjeografike dhe gjeostrategjike, për situatën politike, ekonomike, sociale, për shtetin shqiptar, Konferencën e Ambasadorëve në Londër, pozitën e shqiptarëve në Luftën e Parë Botërore dhe fenomene të tjera të shoqërisë shqiptare brenda viteve 1912-1918.

Studimi është i ndarë në pesë kapituj:

Në kapitullin e parë të titulluar Pozita gjeografike DHE POLITIKE E SHQIPËRISË SIPAS SEKTORIT TË EKSPERTËVE NË MINISTRINË E JASHTME TË BRITANISË SË MADHE flitet për pozicionin dhe kufijtë, sipërfaqen, shtrirjen etnike, bregdetin dhe sistemet lumore për klimën dhe kushtet sanitare.

Në kapitullin e dytë me titull POPULLSIA, GJUHA, FEJA DHE SHOQËRIA

Autori trajton popullsinë shqiptare (gegë dhe toskë), rrethanat shoqërore, pozitën e gruas, sidomos në rajonet e Veriut, rrethanat shoqërore në Toskëri, komunitetin vllah në jug të Shqipërisë dhe disa statistika të bazuara ekskluzivisht nga burimet britanike që flasin për shpërndarjen e popullsisë shqiptare në 1912-13.

Kapitulli tretë NGJARJET KRYESORE TË ZHVILLIMEVE POLITIKE TË VLERËSUARA NGA MINISTRIA E JASHTME BRITANIKE, autori trajton ngjarje dhe zhvillime të ndryshme të shënuara nga grupi i ekspertëve britanikë të Ministrisë së Jashtme që sipas këtij grupi, përcaktuan fatin historik të shqiptarëve dhe i kanë paraprirë Shpalljes së Pavarësisë, Konferencës së Ambasadorëve e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore. Këto ngjarje fillojnë me shfaqjen e Krizës Lindore në hapësirat ballkanike të pasuara nga Lufta Ruso-Turke, 1877-78, Lidhja Shqiptare, Kongresi i Berlinit, Revolucioni i turqve të rinj, Kryengritjet Shqiptare 1910-1912, Luftërat Ballkanike, kërkesat e shqiptarëve për shtet autonom drejtuar qeverisë osmane, koncesionet turke të propozuara për kryengritësit veriorë, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Komiteti shqiptar në Londër (1912-1913), Caktimi i kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, kufiri me Greqinë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit 1913 dhe qëndrimin e diplomacisë britanike për secilën nga ngjarjet e vlerësuara nga seksioni historik që punonte për diplomacinë britanike.

Në Kapitullin të katërt titulluar SITUATA E PËRGJITHSHME, QEVERISJA E SHTETIT DHE LUFTA E PARË BOTËRORE 1914-1918 autori e fillon me dorëheqjen e Qeverisë së Ismail Qemalit, ardhjen në pushtet dhe qeverisjen e Princ Vidit, fillimin e Luftës së Parë Botërore, politikën e jashtme britanike gjatë Luftës, Traktatin e Fshehtë të Londrës duke e përmbyllur me qëndrimin e Britanisë dhe disa fuqive të tjera ndaj shqiptarëve në periudhën midis viteve 1914-1918.

Ndërsa në kapitullin e pestë dhe të fundit të titulluar ZHVILLIMI EKONOMIK, INDUSTRIA DHE TREGTIA autori jep informacione të fragmentarizuara për kushtet ekonomike, rrugët dhe hekurudhat, lumenjtë, portet dhe linjat e transportit detar, bujqësinë dhe blegtorinë, pronësinë e tokës ujitjen dhe pyjet, pasuritë minerale dhe prodhimin, tregtinë e brendshme e ndërkombëtare, si dhe monedhat dhe bankat që ushtronin veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Këto të dhëna janë të mbështetura në dokumentet britanike të hartuara nga Komisioni profesional që punonte në kuadër të Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar.

Grupi i ekspertëve britanikë të angazhuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar sipas autorit Demaj, kishte për qëllim njohjen deri në detaje të situatës dhe rrethanave të përgjithshme në Shqipëri dhe pozicionimin e politikës dhe diplomacisë britanike karshi Shqipërisë dhe shqiptarëve. E gjithë kjo përpjekje ndodhi në kohën e ndryshimeve të gjeografisë evropiane, gjeopolitikës dhe gjeostrategjisë ballkanike, ekuilibrit të forcave e partneritetit, si dhe ndarjes së thellë të Fuqive të Mëdha në dy kampe politike dhe ushtarake ku secili prej të “mëdhenjve” kishte për qëllim që të tërheqë sa më shumë aleatë në përpjekjet e tyre për të zgjeruar sferën e ndikimit dhe mbrojtur interesat e veta ekonomike, politike dhe ushtarake.

Zonja dhe zotërinj,

Konsideroj se botimi “Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918” i autorit Frashër Demaj hyn në radhën e botimeve të rëndësishme në historiografinë kombëtare që trajton pa subjektivizëm dhe anim një pjesë të historisë së popullit tonë nga perspektiva e njëres nga Fuqitë e Mëdha siç ishte Britania e Madhe.

KRONIKA

DEMARKACIONI DHE IZOLIMI I KOSOVËS

Kufijtë midis vendeve të pavarura dhe sovraane janë problem shtetëror dhe ndërkombëtar, një materie shumë e koklavitur, por edhe emocionale. Është i njohur fakti se kufijtë i bëjnë forca ushtarake e diplomatike dhe marrëveshjet. Për zgjidhje të drejtë dhe pa tensione, kufijtë negociohen në terren dhe në tavolinën e bisedimeve. Gjatë gjithë historisë së formimit të shteteve moderne, normale ka qenë që kufijtë shtetërorë t'i respektonin rrethanat gjeografike, ekonomike, historike, familjare dhe të shkonin me vija etnike dhe natyrore - lumi, lugina, gryka, qafa, majat e maleve, kurorat e maleve etj., por në praktikë në rrethana të imponuara e të dhunshme kjo nuk ka ndodhur dhe fatkeqësisht padrejtësitë historike nuk kanë mundur të korrigjoheshin, ngase në terren e në marrëdhëniet ndërkombëtare është krijuar një gjendje faktike krejtësisht tjetër, ku në të gjitha konferencat paqësore ndërkombëtare të shekullit XX, p.sh. gjendja e imponuar e ka marrë legjitimitetin. Në rastin e shqiptarëve në Ballkan, por edhe të shumë popujve të tjerë në botë, të gjitha këto rrethana “normale” janë anashkaluar dhe dhuna e brutaliteti i kanë vënë kufijtë, ndërsa populli më i ndarë në Ballkan janë shqiptarët.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran më 17 shkurt 2008 u hapën probleme të ndryshme, përfshirë detyrimet kushtetuese dhe ndërkombëtare për zgjidhjen e shumë çështjeve, midis të cilave edhe zgjidhjen e kufijve me fqinjët, në këtë rast me Malin e Zi. Për këtë qëllim Qeveria e Republikës së Kosovës më 21. 3. 2012 kishte ngritur Komisionin Shtetëror për shënimin e vijës kufitare midis Kosovës dhe Malit të Zi. Me Maqedoninë çështja e vijës kufitare me Kosovën ishte zgjidhur më herët me pak kundërshtime nga forcat e brendshme politike të Kosovës (ndonëse Kosova humbi pak territor) pasi Plani Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës i dt. 2. 2. 2007 i Presidentit M. Ahtisaari (aneksi VIII), tashmë përmbante zgjidhjen. Debatet rreth demarkacionit midis Kosovës dhe Malit të Zi në dekadën e fundit u politizuan deri në skajshmëri sa që argumentimi shkencor dhe gjykimi racional humbën tashmë çdo kuptim. Në këto debate, që cilësoheshin madje si “shkencore-profesionale”, kishte vetëm joprofesionalizëm, militantizëm ekstrem politiko-partiak të grupeve dhe individëve, irracionalitet dhe injorancë. Mbaheshin edhe

tubime, me pretendime të nivelit të “Kongresit Shqiptar të Berlinit”, të vetëmandatuar të vizatonin dhe rivizatonin harta në Ballkan (!).

Qasjet emocionale-folklorizante ndaj kufijve nuk janë produktive dhe kujtesa historike e realiteti juridik dhe pastaj edhe faktik qëndrojnë larg njëra-tjetrës. Sot kufijtë bëhen kryesisht me marrëveshje e jo me dhunë. Konferenca e Helsinkit (1975) ka vënë pikë në këtë çështje. Deri në ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare për demarkacionin në Parlamentin e Kosovës më 21 mars 2018 midis Kosovës dhe Malit të Zi ende nuk kishte kufi ndërkombëtar. Nga kjo datë Kosova ka fqinj jo vetëm Malin e Zi, por edhe NATO-n, që është një siguri e madhe për Kosovën dhe gjithë rajonin. Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO e irritoi shumë Serbinë dhe veçanërisht Rusinë, ndërsa sjelljet e pamatura të instancave partiake-politike kosovare ndaj Malit të Zi lidhur me kufirin shkuan në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Të dhënat zyrtare tregojnë se kufiri Kosovë–Mali i Zi është vijëzuar para 15 shkurtit 1947 kur Mali i Zi kishte 13.812 km², aq sa ka sot. Në ndryshimin territorial dhe riorganizimin territorial-administrativ në hapësirën e Kosovës Veriore, komuna e Leposaviqit gjithnjë u rrit me sipërfaqe dhe numër të vendbanimeve (më 3 prill 1952 kishte vetëm 26 vendbanime, sot ka 74 vendbanime, të gjitha të tipit rural, përveç Leshakut, që i përket tipit xehetaro-agrar), duke marrë vendbanime nga disa rrethe dhe komuna si jashtë Kosovës, ashtu edhe brenda saj. Sipërfaqen prej 13.812 km², kjo Republikë e referonte në ish-Entin Federativ të Statistikës nga viti 1945 dhe pas pavarësisë në vitin 2006 të njëjtën e deklaronte edhe në Eurostat dhe në Seksionin për Demografi edhe në OKB. Ndërsa kufijtë e Kosovës me Serbinë (në veri) janë kornizuar për herë të fundit në vitin 1959 kur vetë Serbia ia mori rrethit të vet të Studeniçanit 197 km² dhe ia dha rrethit të Zveçanit (Kosovë) dhe që nga atëherë Kosova ka 10.887 km²; e gjithë sipërfaqja prej 197 km² i shkoj komunës së vogël, tashmë ekzistuese, të Leposaviqit. Ndërkaq, pas matjes së territorit të Kosovës (me teknologji të re) nga grupi i ekspertëve gjatë vitit 2017 Kosova i kishte 10.905.25 km². Kufiri administrativ midis Malit të Zi dhe Serbisë, përkatësisht Kosovës dhe Malit të Zi është vënë para 75 vjetëve, por deri më sot nuk ka pasur kundërshtime as nga faktorët politikë të kohës së periudhës komuniste dhe postkomuniste, as nga grupacionet politike, as nga komunat që kufizohen me këtë ish-Republikë e as nga popullata shqiptare e këtyre zonave kufitare; asnjë qytetar i vetëm shqiptar i këtyre zonave deri sot nuk ofroi asnjë dëshmi se e ka pronën andej kufirit, ndërsa tatimin e paguan në një komunë të Kosovës.

Prandaj i gjithë diskursi ishte i natyrës politike dhe i luftës për pushtet. Pasojat e këtij politizimi janë mbajtja peng e jetës së gjithmbarshme ekonomike dhe shoqërore të Kosovës për disa vjet, rrezikimi i integritetit të Kosovës në proceset euroatlantike dhe bllokimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve të vendit në zonën Schengen. Kufijtë e sotëm të Kosovës shtrihen deri atje sa mund të mbulohen me dokumentacion administrativ, kadastral e menaxherial dhe mekanizma operacionalë në terren për më shumë se shtatë dekada. Gjatë demarkimit ka mundësi vetëm të një marrëveshjeje: shkëmbim i territorit "metër për metër dhe cilësi për cilësi", deri 150 metra, atje ku palët kanë ndonjë nevojë të diktuar nga struktura e relievit, p. sh. rreth ndonjë rruge, burimi të ujit etj. Kjo mundësi nga pala malazeze gjithnjë ka ekzistuar deri më 4 qershor 2020 kur skadoi afati ligjor për ndonjë rishikim në frymën e marrëveshjes ndërkombëtare pas ratifikimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 21 mars 2018; Kuvendi i Malit të Zi këtë marrëveshje e kishte ratifikuar që në vitin 2015.

Kryeministri Kurti në prag të zgjedhjes së Driton Abazoviqit Kryeministër i Malit të Zi (u zgjodh më 28 prill 2022), deklaroi se do të flas me të për çështjen e kufirit të Kosovës me Malin e Zi. Abazoviqi, ndërkaq, më 10.05.2022 në një intervistë për Klan Kosovën deklaroi se "çështja e demarkacionit mes të Kosovës dhe Malit të Zi ka marrë fund"! Ndërsa më 25 Mars 2022 Kabineti i Presidentit Gjukanoviq tha se çështja e kufirit të Malit të Zi me Kosovën ka përfunduar më 2015 dhe përfundimisht më 2018, kur e ratifikoi Marrëveshjen edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës me 80 vota. Edhe në vizitën që pati më 18 maj 2022 në Prishtinë e deklaroi të njëjtën gjë. Lidhur me kufirin Kosovë-Mal i Zi, ai deklaroi se "ne nuk dëshirojmë të krijojmë probleme dhe jam më se i sigurt se do t'u përmbahemi dokumenteve që i kemi nënshkruar (më 2015 dhe 2018) dhe nëpërmjet punës së komisioneve të përbashkëta për demarkacionin do të krijojmë kushtet e domosdoshme për korrigjime për të cilat pajtohemi", për të vijuar se "kufiri është problematik vetëm për dikë që synon të krijojë probleme". Të gjitha mediet kosovare e dhanë këtë lajm, ndërkaq vetëm gazetatat pro presidentit Gjukanoviq, "Pobjeda" e Podgoricës, nuk e tha asnjë fjalë për demarkacionin.

Ndërkaq, më 19.07.2022, ish-presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanoviq, nënshkruet i një Letërdeklarate me presidentin Hashim Thaçi më 16. 02. 2018 për mundësinë e korrigjimit eventual të kufirit Kosovë-Mal i Zi në sektorë të caktuar, theksoi "se në Kosovë u keqprezantua dhe u keqkuptua procesi i demarkacionit. Nuk u dhanë shpjegime të

sakëta rreth problemit të kufirit. Për mendimin tim, një keqkuptim erdhi si pasojë e statusit të pashpjeguar sa duhet të njerëzve që jetojnë pranë kufirit shtetëror. Nuk ka asnjë shembull të krijimit të një shënjimi të kufirit shtetëror për ta sinkronizuar atë me pronën private të disa personave. Ata që jetojnë pranë kufirit nuk duhet të kenë ndonjë vështirësi në përdorimin e pronës së tyre në vendet fqinje. Përkundrazi, njerëzit që jetojnë afër kufirit, duhet të përdorin pa probleme pronën e tyre dhe të kenë njëfarë stimulimi nga të dy shtetet në zhvillimin e aktiviteteve të tyre bujqësore. Do ritheksuar se komisionet shtetërore kanë arritur një marrëveshje për kufirin dhe dy qeveritë e kanë ratifikuar. Ajo u nënshkrua në Vjenë në vitin 2015 dhe dy parlamentet kombëtare e kanë ratifikuar marrëveshjen dhe tani duhet ta zbatojnë përmes punës së përbashkët të Komisionit Kombëtar të ekspertëve të demarkacionit”. Mjerisht, nga ana e Kosovës ky Komision as që u formua ndonjëherë.

Lidhur me këtë marrëveshje, publicisti Veton Surroi kishte theksuar se “është bërë për t’i bindur deputetët që të votojnë. Ajo është marrëveshje që ka mundur të bëhet edhe para dy vjetësh. Nga aspekti i ligjit dhe përmbajtjes asgjë nuk ndryshon. Në aspektin përmbajtësor kufiri është ashtu siç e kanë nënshkruar ministrat e jashtëm dhe ashtu siç e kanë ratifikuar Kuvendi i Kosovës dhe i Malit të Zi dhe kapaciteti për ta ndryshuar atë vijë kufitare është i njëjtë siç ka qenë në vitin 2015” (22. 03. 2018).

Në përputhje me nenin 4 të Marrëveshjes, deri më 4 qershor të vitit 2020 është dashur që trupat punuese të dy vendeve tashmë ta përfundonin demarkimin, por Komisioni ynë punues as që pati guxim profesional të takohej, së paku një herë, me Komisionin e Malit të Zi, ndonëse pala malazeze qysh më 9 korrik 2018 i kërkoi Qeverisë së Kosovës që komisionet përkatëse të kufijve të takoheshin dhe të fillonin punën për vënien e gurëve të sionorëve shtetërorë midis Kosovës dhe Malit të Zi (demarkimi) në afatin obligativ ligjor, por Komisioni dhe Qeveria Haradinaj më as që u dëgjuan të gjallë. Nuk bëri zë as Qeveria Kurti 1 dhe heshti Qeveria Kurti 2 dhe kufiri mbeti atje ku ka qenë tash e shtatë dekada e gjysmë. Më 10.09.2021 Kryeministri Kurti, në mënyrë që ta mbajë gënjeshtren gjallë, e emëroi F. Isufin këshilltar për pro-bono (“hayrat”) për kufirin. Megjithatë, avazi i gënjeshtërave me demarkacionin në Kosovë vazhdoi. Gënjeshtarët këmbëngulnin! Haradinaj: kufiri është aty ku them unë! Kurti: nuk do të lë guralec pa lëvizur deri në kthimin e 8.200 ha! Osmani: kufiri është aty ku e (s’e)

votova, ndërsa këshilltari i Kurtit pro-bono dhe dallkauku tjetër, Bulliqi, vetëprononcoheshin se janë autorë të 8.200 ha të remë.

Tema e demarkacionit nisi dhe mbeti një kauzë e rrejshme. Liderët partiakë dhe grupet kryengritëse ndoqën rrugën e maksimës së "babait" të kombit serb (Qosiq): gënje, gënje, gënje me mijëra herë, atëherë gënjeshtër bëhet e vërtetë! "Ekspertët" Isufi dhe Bulliqi thoshin se më të besueshme dhe më kredibile janë hartat e APJ-së të Beogradit sesa të tjerat. Ja një hartë e tillë, ku shihet ku është Çakorri, Kulla e Zhlebit dhe Bjelluha (në Mal të Zi)!



Harta vështruese-topografike 1:500.000 e Institutit Ushtarako-Gjeografik të Beogradit

Të kujtojmë se nga fillimi i vitit 2015 e deri më 21 mars 2018, kur u miratua Marrëveshja ndërkombëtare për demarkacionin me Malin e Zi (me 80 vota), pa e hequr asnjë presje, u zhvillua një diskurs shterp, pa asnjë argument, në luftë për pushtet të disa individëve dhe grupacioneve politike të opozitës së atëhershme. Këtë agjendë e ndihmuan edhe disa deputetë të pozitës së mëparshme (LDK). Opozita e atëhershme (AAK, LVV, NISMA) nuk e kishte shumicën për ta penguar miratimin e

Marrëveshjes ndërkombëtare, por fallanga e LDK-së me afër gjysmën nga 30 deputetë gjithsej si pozitë përfundimisht e bllokuan Marrëveshjen dhe Kosova mbeti e izoluar për lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj në hapësirën e BE-së. Kjo fallangë, me V. Osmanin në krye, atëherë ndiqte një rrugë krejtësisht irracionale, në kundërshtim të plotë me qëndrimet e subjektit që i përkiste, të kryetarit të tij (I. Mustafa), që ishte njëherësh edhe kryetar i Qeverisë, por edhe të faktorit ndërkombëtar euroatlantik dhe interesit të Kosovës. Votat e kësaj fallange të LDK-së ishin vendimtare për t'u votuar ose jo Marrëveshja për liberalizimin e vizave. Fallanga tha jo! PDK-ja me 37 deputetë, përveç dy deputetëve, ishte e gatshme ta votonte Marrëveshjen.

Jetën politike dhe parlamentare opozita e atëhershme e shndërroi në një cirk dhe arenë gladiatorësh, ndërsa opinionin shqiptar e ndau në “patriotë” dhe “tradhtarë” (!), duke i keqpërdorur edhe emocionet e njerëzve, ngase territori është edhe çështje emocionale. Komponenti i posesizmit moral (i kemi varrezat andej kufirit, kemi bërë luftëra për kufij, krejt andej janë shqiptarë!) nuk zgjidh asgjë, përveç që ndez emocionet e njerëzve! Opozita e kohës ushtroi dhunë të pashembullt kundër institucioneve të vendit, duke i përdorur vezët, gazin lotsjellës, sprejin, zjarrin, gurët, tullat, shishet e ujit, shishet e molotovit, etj. Kundër institucioneve të shtetit mbetën pa u hedhur vetëm “Napalm-bombat”. Me veprimet e saj u izolua vendi dhe u krijua imazh i keq në botë. Kryetari i atëhershëm i Komunës së Prishtinës (anëtar i kreut të VV-së), Shpend Ahmeti, gëzohej, dilte dhe shikonte a po digjej mirë qyteti, diçka që nuk ka ndodhur në rruzullin tokësor. Fatkeqësisht, edhe një pjesë e medieeve dhe e shoqërisë civile në përgjithësi ishte rreshtuar në anën e së keqes.

A ka mëkat më të madh që në emër të mbrojtjes së interesave shtetërore ta përdhosësh shtetin dhe qytetarët e tij t'i lësh të izoluar. Anash hilet e BE-së që sot e gjithë ditën shkojnë deri në nivel racist, faji kryesor është i brendshëm. Gënjejnë, mashtrojnë, zhvatin, djegin, shkatërrojnë dhe në fund, përsëri në emër të “interesit shtetëror”, e lëpijnë atë që e kishin pështyrë me vite, duke e votuar të njëjtin dokument pa ia hequr asnjë shkronjë. Si mbulesë i kishin nga fillimi gënjeshttrat e dy diletantëve, që shtireshin si ekspertë (F. Isufi dhe Sh. Bulliqi), që e lëshuan rrenën se Kosova po humb 8. 200 ha (!), ndërsa Kryeministri Haradinaj, në luftë për pushtet, me para dhe kërcënim, i futi në agjendën e vet. Në fund, “hauz-eksperti” Isufi e braktisi Komisionin e Kryeministrit, ndërsa “Kallakunxhi” tjetër, Bulliqi, e braktisi edhe partinë ku ishte anëtar tri dekada (LDK) për të gjetur strehë dhe mbrojtje në një parti tjetër (LVV)

dhe po vazhdon të gënjejë kinse po punon për kufijtë e Kosovës me shtetet e tjera përreth, përfshirë Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut me të cilën procesi tashmë ishte përmbyllur. Komisioni në krye me këta mashtrues kurrë nuk i prezantoi në harta sipërfaqet e humbura në hektarë dhe metra në zonat dhe sektorët e caktuar në kufi me Malin e Zi, siç i prezantoi Komisioni Shtetëror për Matjen e Territorit të Republikës së Kosovës (KSHMTRK) sipërfaqet e humbura me Maqedoninë konform kërkesave të faktorit ndërkombëtar (Plani i Ahtisarit) deri në hektarë e metra katrorë. Kosova në raport me Maqedoninë e Veriut rezultoi të kishte bilanc të përgjithshëm negativ prej 191 ha ose 1.91 km² (komunat kadastrale Debëllde dhe Restelicë minus, ndërsa Dimcë plus), ndërkaq me Malin e Zi nuk humbej asnjë hektar dhe metër katror. KSHMTRK bëri matjen e territorit të vendit të vet, ndërsa “ekspertët” e ish-kryeministrit Haradinaj bënë matjen e “arave” të huaja (të Malit të Zi). Mali i Zi nga 1945 e deri më sot e ka të njëjtën sipërfaqe: 13.812 km², të referuar në ish-Entin Federativ të Statistikës deri në vitin 2006 kur u pavarësua dhe pas këtij viti edhe në EUROSTAT dhe në OKB.

Ambasadori amerikan në Kosovë G. Delawie, në bazë të gjetjeve profesionale të State Departamentit, të mbështetura në rezultatet e analizave të materialeve përkatëse nga viti 1940 deri më 2016, disa herë kishte theksuar se “8. 200 ha janë të rremë”! Konstatimin se vija kufitare e Kosovës me Malin e Zi është pa ndryshime e nxorën edhe komisionet e tjera, vendore dhe ndërkombëtare (çfarë ishte Komisioni ad hoc i ftuar nga Presidentja Jahjaga, i përbërë nga ekspertët Fletcher M. Burton nga SHBA, Dr. Ing. Herbert Wilmes nga Gjermania dhe Fred Newton nga Anglia). Ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare për kufirin në relacion Kosovë-Mal i Zi e kërkuan edhe presidenti i SHBA-së B. Obama dhe nënkryetari J. Biden, zyrtarët e NATO-s, të BE-së, etj. Ta kundërshtosh pa asnjë argument Amerikën dhe NATO-n, që na çliruan e pavarësuan, është absurd! Për kundërshtarët “kryengritës”, SHBA-ja janë të mira kur u përgjigjen interesave të tyre personale, por kur shtrojnë kërkesa të tjera, atëherë ato nuk bëjnë! Kështu u sollën ndaj SHBA-së Haradinaj, Kurti dhe Sadriu-Osmani! Një ditë (16.05.2022) njëri nga këta na deklaroi se “Kosova është Amerikë, Amerika është Kosovë....”!

SHBA na i siguroi edhe njohjet ndërkombëtare në kufijtë ekzistues (10.905 km²), të mbështetur në Kushtetutën e KSAK-së të vitit 1974, në Komisionin e Badinterit (1991-1993), në Planin e Ahtisarit (2007), në Kushtetutën e RK të vitit 2008, në Deklaratën e Pavarësisë 2008, në vendimin e GJND-së (2010) dhe në Rezolutën e Kuvendit të Republikës

së Kosovës të dt. 25 qershor 2015. Por, grupet e interesit e kishin objektiv vetëm pushtetin. Në faqen zyrtare të Qeverisë Mustafa ishte i publikuar Raporti i hollësishëm i KSHMTRK, i përbërë nga gjetjet e 12 përfaqësuesve të organizatave dhe agjencive profesionale, shkencore e menaxheriale dhe të shoqërisë civile, me pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve të instancave ndërkombëtare në cilësi të vëzhguesve (NATO, BE, SHBA). Aty gjendet gjithë faktografia, në qindra faqe (gjeoinformacioni, hartat e kadastrit të tokave, hartat topografike, skicat, të dhënat statistikore, planet zhvillimore e mjedisore, baza ligjore, faktet shkencore etj., që lidhen me madhësinë territoriale të Kosovës dhe të njëjësive më të vogla territoriale-administrative). U dëshmuar se kufijtë e sotëm të Kosovës shtrihen deri atje sa mund të mbulohen me dokumentacion administrativ, kadastral, hartografik e menaxherial dhe nga mekanizmat operacionalë në terren nga viti 1945.

Ish-shefi i pseudoekspertëve, Haradinaj, pasi erdhi në krye të Qeverisë (9.09.2017), pa hezitim dha urdhrin, duke e caktuar edhe rezultatin: "Komisioni ka me thënë se kufiri është në Çakorr, në Kullë e në Maje të Larta. Pra, keni parasysh, kështu ka me thënë Komisioni" (16. 10. 2017). I thënçin komision "i pavarur profesional-shkencor", në krye me Bulliqët, i cili nuk pati asfarë kurajo për t'i thënë jo diktatit pushtetor. Ndërkaq, Kryeministri Kurti, pas zgjedhjeve të 6.10.2019, dha deklaratë shallvaregjera: "Nuk do të lë guralec pa lëvizur deri në kthimin e 8 mijë e 200 hektarëve që iu dhanë Malit të Zi" (11.11.2019). Më 23 maj 2020 kryeministri në detyrë, Kurti, zhvilloi një bisedë me presidentin e Malit të Zi M. Gjokanoviq, në të cilën u trajtuan vetëm dy çështje: pandemia dhe dialogu me Serbinë, ndërkaq asnjë fjalë nuk pati për problemin e kufirit dhe rishikimin e tij. Ambasada amerikane në Prishtinë prononcimet e rreme të Komisionit i quajti dofarë "dokërraportesh" të gënjeshtarëve (2018). Ndërkaq, dhe një deklaratë e dy presidentëve (Thaçi-Vujanoviq, 2018), me mundësi të rishikimit dhe korrigjimit të gabimeve eventuale, por jo edhe të pranimit të argumenteve se Kosova ka humbur territor, mbeti një letër e pavlerë. Tentativa e Haradinajt për ta futur njëfarë "rishikimi" të demarkacionit në programin e Qeverisë Hoti (2020) nuk ishte asgjë tjetër pos mashtrim i radhës. Me agjenda të rrejtshme gjithë jetën duan të mbesin në politikë dhe në pushtet! Por krejt çka nuk ratifikohet në Parlamentin e Malit të Zi nuk ka asnjë vlerë juridike. Mali i Zi e ka përfunduar punën me ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në Parlamentin e tij më 28 dhjetor 2015, të nënshkruar në Vjenë më 26 gusht 2015. Në këtë frymë është edhe deklarata e Abazoviqit se "çështja e demarkacionit në mes

të Kosovës dhe Malit të Zi ka marrë fund” (10.05.2022). Presidenti Gjokanoviç, në një vizitë në Kosovë më 18. 05. 2022 përsëri e konfirmoi atë që e kishte thënë Kabineti i tij më 25. 03. 2022!

Sipas kundërshtarëve të demarkacionit, vija kufitare duhej të fuste brenda kornizës territoriale të Kosovës Çakorri, Zhlebin e Bjelluhën dhe Kosova ta zgjeronte territorin nga 10.905.25 km² në 10.987.25 km². Por, kur erdhën në pushtet, ish-opozitarët nuk ia kthyen Kosovës hektarët ”e humbur”. Nuk ka hartë profesionale, dëshmi kadastrale dhe dokumente të tjera nga viti 1945 e deri më sot, ku Çakorri, Bjelluha dhe Zhlebi janë brenda territorit të Kosovës. Të gjithë e dinin, nga popullata vendore e rripit kufitar me Malin e Zi, pushteti lokal dhe pushteti qendror e grupet politike sentencën e moçme se ”Shelgu nuk bën rrush”. Në mars 2009 kryefamiljarët e rripit kufitar, me nënshkrimet e tyre, kërkonin leje nga autoritetet e komunave të Malit të Zi që t’i shfrytëzonin pronat e tyre të ligjshme (kullosat, stanet dhe bjeshkët), të cilat tash e shtatë dekada e gjysmë gjenden në territorin e këtij shteti dhe atje i kanë paguar edhe taksat. Për këtë kryefamiljarët i kanë vënë në dijeni edhe strukturat pushtetore të Republikës së Kosovës, komunat dhe ministritë përkatëse.

Ishte i kotë ”urdhri” i një kryeministri (Haradinaj) dhe ”lëvizja e guralecit” nga kryeministri tjetër (Kurti). Iku koha! Më 21 mars 2022 u bënë katër vjet nga ratifikimi i Marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por për shënimin e vijës kufitare midis dy shteteve mbeti një afat deri më 4 qershor të vitit 2020, ndërsa Marrëveshja u procedua përmes rrugëve diplomatike. Deri më 4 qershor të vitit 2020 gjatë demarkimit kishte mundësi bile për ndonjë korrigjim të vijës së kufirit sipas parimeve profesionale ”metër për metër dhe cilësi për cilësi”, në rast të ndonjë rruge apo burimi të ujit në terrenet komplekse gjeohapësinor. Nga pala malazeze gjithnjë ka ekzistuar kjo mundësi dhe gatishmëri, por, mjerisht, nga ana kosovare as kjo nuk është shfrytëzuar dhe prandaj ikën të gjitha afatet e ligjshme dhe gënjeshtër e madhe prej 8. 200 ha imagjinare u shua përfundimisht. Fajtorët nga opozita e atëhershme (Haradinaj, Kurti dhe Limaj me grupet e tyre politike) dhe fallanga e LDK-së e prirë nga V. Osmani mbajnë përgjegjësi qytetare dhe institucionale për mosliberalizimin e vizave, kurse pseudo-ekspertët, dy dallkaukë, do t’i rëndojë përgjithmonë përgjegjësia dhe ndërgjegjja profesionale, të cilën as që e kishin pasur ndonjëherë.

Shemsi Krasniqi, Prishtinë

VËSHTRIM MBI LIBRIN E
MUHAMEDIN KULLASHIT:
*ÇËSHTJA E KOSOVËS NË HAPËSIRËN PUBLIKE TË
FRANCËS. ANALIZA DHE REFLEKSIONE,*
ASHAK, 2021, PRISHTINË.

Libri i Muhamedin Kullashit “ÇËSHTJA E KOSOVËS NË HAPËSIRËN PUBLIKE TË FRANCËS. Analiza dhe refleksione”, përveçse përmban analiza lucide dhe refleksione të thella për çështjen e Kosovës dhe vendin e saj në hapësirën publike të Francës, shërben edhe si një lloj katalogu i autorëve dhe personaliteteve të ndryshme, qofshin ata shkrimtarë, historianë, filozofë, sociologë, antropologë, juristë, gjuhëtarë, gazetarë, zyrtarë publikë, politikanë, ekspertë të ndryshëm, intelektualë dhe akademikë të shquar francezë, të cilët janë marrë me Kosovën në periudhën më të ndjeshme të historisë së saj, atë të viteve '90 e pak më vonë. Dhe jo vetëm i autorëve dhe personaliteteve, por libri është edhe një përmbledhje e aktiviteteve, manifestimeve, organizimeve që janë mbajtur në atë kohë në Francë, qoftë për të diskutuar çështjen e Kosovës, qoftë krizën dhe konfliktet në ish-Jugosllavi. Libri përmban analiza dhe refleksione mbi shkrimet, diskutimet, vështrimet dhe polemikat e ndryshme, duke filluar nga artikujt e gazetave ditore e javore, debatet televizive, ligjëratat mysafire nëpër universitete të ndryshme të Francës dhe jashtë saj, kumtesat dhe fjalimet nëpër tribuna, konferenca dhe simpoziume të shumta, raportet e organizatave ndërkombëtare, deri te librat dhe publikimet e vetë autorit, madje edhe ato të mbështetura nga UNESCO dhe të përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës. Mund të themi se libri në fjalë është si një dramë e mendimit për Kosovën.

Autori i librit, Muhamedin Kullashi, i njohur si studiues i frytshëm, në këtë rast është edhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë dhe aktor në skenën e këtij mendimi. Është insajder, kronist, polemist, debatues, analist, por edhe krijues i këtij mendimi. Si filozof dhe intelektual i angazhuar, autor i shumë librave, profesor i Universitetit “Parisi 8”, atij universiteti ku kanë ligjëruar emra të mëdhenj të filozofisë bashkëkohore franceze, si njohës i mirë i teorive dhe rrymave të

mendimit filozofik, social dhe politik, me këtë libër dëshmohej edhe si njohës i mirë i materialit historik, faktografik dhe empirik që ka të bëjë me Kosovën. Në krejt këtë punë, ai është bashkëveprues me intelektualë të shquar francezë dhe si i informuar mirë, është edhe informues i drejtë, jo vetëm i elitës kulturore dhe politike, por edhe i publikut të përgjithshëm francez për çështjen e Kosovës, për ngjarjet e saj në dekadën e fundit të shekullit XX dhe fillimin e XXI. Në një fazë të mëvonshme dhe po ashtu, jetike për historinë e Kosovës, atë të pavarësisë, autorin e gjejmë edhe si diplomat, përkatësisht ambasador i parë i Republikës së Kosovës në Francë.

Libri në fjalë përmban analiza pertinente për proceset socio-politike dhe historike të Kosovës që prej viteve '80 e këndej. Krahas analizës dhe përshkrimit të proceseve makrohistorike, vendore dhe rajonale, aty hasen analiza dhe përshkrime të rasteve tipike dhe atyre jotipike, duke iu referuar jo vetëm ngjarjeve historike, por edhe përditshmërisë dhe jetës reale njerëzore. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe luftërat që pasuan, shkelja e të drejtave të njeriut, diskursi publik dhe prodhimi i urrejtjes, perceptimi i "Tjetrit" dhe identiteti, përndjekjet dhe proceset gjyqësore-politike, debatet për natalitetin dhe demografinë, diferencimet politike të viteve '80, rezistenca paqësore në krye me Ibrahim Rugovën e viteve '90, mbyllja e shkollave dhe pastrimi i institucioneve, aparteidi, pastaj dëbimi i dhunshëm dhe pastrimit etnik i viteve '98-'99, terrori, masakrat, krimet serbe dhe fshehja e krimit, pastaj edhe lufta e armatosur e UÇK-së dhe fushata e bombardimeve të NATO-s, janë vetëm disa nga temat që trajtohen në këtë libër. Janë tema pra që janë trajtuar nëpër tubime të ndryshme, nëpër shkrime dhe kumtesa të autorëve francezë dhe të tjerë, por edhe nga vetë autori. Për ta bërë më të lehtë për lexuesin, krejt aktivitetet e organizuara, tubimet, konferencat, tryezat, botimet e përmbledhjeve, autori i përmend datën dhe vendin ku janë mbajtur, emrat e pjesëmarrësve, në disa raste edhe pyetjet që janë shtruar dhe përgjigjet që janë dhënë, titujt e kumtesave të lexuara, e në fund edhe titujt e përmbledhjeve të botuara, përfshirë vendin dhe vitin e botimit. Kësisoj, ky libër është pikënisje e qëndrueshme për çdo studim tjetër që ka të bëjë me çështjen e Kosovës në opinionin publik francez, në periudhën e kalimit nga shekulli XX në XXI.

Autori ka polemizuar me emra të njohur të elitës kulturore franceze, disa prej tyre edhe me famë botërore. Ai u kundërpërgjigjet me argumente shkrimeve, deklarimeve dhe qëndrimeve të tyre, të cilët qoftë për shkak të bindjeve ideologjike ose të ndikimit serb, janë treguar

të padrejtë në trajtimin dhe mbarështrimin e çështjes së Kosovës, duke shkuar aq larg, sa edhe t'i mohojnë krimet e bëra nga regjimi serb. Ai me një zgjuarsiri të pashoqe i ka regjistruar shkrimet, thëniet dhe deklaratat e tyre, nuancat e mendimit, kuptimet dhe nënkuptimet e fjalëve dhe ka reaguar në mënyrë të qartë duke ofruar shpjegime të bazuara në fakte dhe argumente. Një shembull për këtë është reagimi ndaj artikullit “*Kosova: lehtësia e padurueshme e informimit*” të autores Elysabeth Lévy, artikull i botuar në revistën “Le Débat”, revistë e drejtuar nga filozofi Marcel Gauchet dhe historiani francez me famë botërore Pierre Nora, ky i fundit njohur për konceptin “vendi i kujtesës” (*lieu de mémoire*). Artikulli në fjalë i mohonte krimet serbe në Kosovë duke i quajtur të supozuara. Kullashi shpreh habi se si një historian i njohur me konceptin vendi i kujtesës, qëllimisht promovon harresën e krimit, përkatësisht mohimin e tij, dhe për këtë i përgjigjet me artikull të mbështetur në fakte dhe dëshmi. Mohimi i krimit, qoftë edhe si injorim i përmasave të tij, ishte mjaft i përhapur në mesin e gazetarëve, intelektualëve, shkrimtarëve dhe politikanëve francezë. Ky është shembulli edhe i sociologut Régis Debray, i cili kishte bërë një vizitë në Kosovë qysh në ditët e para të bombardimeve të NATO-s, dhe i kishte shkruar Presidentit Chirac, gjoja se nuk kishte pasur pastrim etnik në Kosovë. Kësisoj, Debray bëhet një zëdhënës i regjimit serb dhe bie në pozitat e “revizionizmit” dhe “negacionizmit”, terma këto që, siç shpjegon Kullashi, përshkruanin mohimin e krimeve të fashizmit mbi hebrenjtë. Atij pastaj i kundërvihet në të njëjtën mënyrë sociologu Alain Joxe duke e quajtur veprimin e Debray si pjesë e një “kretenizmi internacional”, pra fjala është për grupe proserbe që e kundërshtojnë intervenimin e NATO-s me logjikën antiimperialiste. Më tutje Joxe për UÇK-në thotë se ajo zhvillon luftë çlirimtare kundër një kolonializmi fashist (Fq. 203). Kësisoj, në librin e Kullashit hasim edhe në polemika ndërmjet vetë intelektualëve francezë.

Vëmendje të njëjtë ka treguar edhe ndaj atyre që kanë pasur qëndrim të drejtë dhe korrekt për Kosovën. Fjalët e tyre, të thëna në kontekste të ndryshme, i ka nënvizuar, i ka potencuar, i ka bërë të qasshme për publikun dhe pastaj i ka analizuar dhe përdorur për ta treguar rikonfigurimin e opinionit publik francez dhe atë të elitave kulturore ose politike. Këtë qasje, këtë metodë pune, autori e ka përdorur si për t'i analizuar shkrimet e botuara në medie ose fjalimet nëpër tryeza, tubime ose aktivitete kulturore, ashtu edhe ato të politikës. Pra, kjo ka të bëjë jo vetëm me autorë dhe intelektualë të ndryshëm, por edhe me zyrtarë të lartë të shtetit, ministra, madje edhe vetë presidentët

francezë. Në këtë rast, autori përmend Mitterrand-in dhe Chirac-un, të cilët dallojnë shumë në qëndrimet në raport me ngjarjet në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi. Kullashi në observatoriumin e tij zë momente pikante. Për shembull, deklarata e Presidentit Chirac mbi agresionin serb ndaj Kosovës, me rastin e sulmit në Prekaz. Fjala ‘agresion’ sikurse edhe shprehja ‘barbari serbe’, ose edhe ajo ‘gangrena e të pathënshmes’ (*innommable*) në fjalorin e presidentit francez janë paralajmërim i një politike tjetër, i një politike me përfshirje etike, në krahasim me atë të Mitterrand-it. Kështu Kullashi i percepton dhe intercepton ndryshimet, diskursin, çasjen, aktin politik, edhe përmes fjalëve ose shprehjeve të caktuara, nuancave kuptimore të fjalës, e jo vetëm përmes deklarimeve të hapura publike dhe vendimeve ose veprimeve politike e ushtarake. Në këtë libër, autori i kushton vend të merituar politikës së bazuar në etikë të Presidentit Chirac.

Bashkëveprimi i tij me miq dhe intelektualë të shquar francezë si: Claude Lefort, Antoine Garapon, Alain Brossat, Jean-Yves Potel, André Gluksmann, Olivier Mongin, Pascale Bruckner, Bernard Henri Lévy, Pierre Hassner, Paul Garde, Véronique-Nahoum-Grappe, Patrice Canivez, Alain Joxe, Alain Finkielkraut e shumë të tjerë, botimet e përbashkëta, tryezat dhe konferencat, madje edhe vizitat e shumë prej tyre në Kosovë, kanë bërë që opinionin francez të ndryshojë për të mirë në raport me Kosovën dhe të drejtën e saj për të qenë e pavarur. Në fakt, kjo ka bërë që të hiqet mjegulla në opinionin francez dhe të kuptohet drejt çështja e Kosovës. Së bashku me ta dhe me bashkëveprimtarë të tjerë, kanë themeluar Komitetin e Kosovës, e pastaj edhe Shoqatën “Fehmi Agani” për të sensibilizuar çështjen e Kosovës dhe për t’i dërguar mesazhet e duhura opinionit francez. Komiteti i Kosovës kishte organizuar takimin e parë të Ibrahim Rugovës me autoritetet franceze, pastaj kishte botuar një libër bisedash me të, ku bisedat i kishin zhvilluar nga Marie-Françoise Allain dhe Xavier Galmiche, ndërsa parathënien e kishte bërë Ismail Kadare. Libri, shkruan Kullashi, pati një jehonë mjaft të fortë në opinion dhe u citua si burim për të dhëna lidhur me situatën në Kosovë (Fq.51). Një libër tjetër po ashtu të rëndësishëm, Komiteti i Kosovës e kishte bërë edhe për intelektualin dhe politikanin e shquar Kosovar, bashkëpunëtorin e ngushtë të Rugovës, profesorin Fehmi Agani. Libri është një përmbledhje dokumentesh mbi krimet masive serbe prej vitit 1981 deri në vitin 1999, për terrorin serb ndaj shqiptarëve nëpër shumë vite dhe është një përgjigje ndaj fushatës anti-intervenim të NATO-s të dirigjuar nga qarqet proserbe dhe majtistët “antiimperialistë” (Fq.224). Sipas Kullashit, kultura politike e Aganit

kishte lënë mbresa të pashlyera te diplomatët dhe intelektualët francezë (Fq.225). Ndër shumë aktivitete të ndryshme, Komiteti Kosova, në bashkëpunim edhe me disa shoqata të tjera, me rastin e sulmit të forcave serbe në Prekaz, kishte organizuar një protestë të madhe në sheshin Trocadero, më 7 mars 1998. Në atë protestë kishin marrë pjesë shqiptarë të ardhur nga shume vende evropiane, ishte nënshkruar një apel nga më se 300 intelektualë, filozofë, shkrimtarë, artistë dhe shkencëtarë francezë (Fq.132). “Kjo ishte njëra nga ngjarjet dramatike ku thurej miqësia dhe solidariteti midis shqiptarëve dhe francezëve, prej qytetarëve të rëndomtë deri tek intelektualët e rangut më të lartë” – shkruan Kullashi (Fq.133)

Libri i Kullashit nuk është i ndërtuar mbi pjesë ose kapituj të ndarë që do të fokusoheshin në periudha konkrete historike, por është një tërësi shkrimesh të bëra kryesisht sipas rendit të ngjarjeve, ku shqyrtohen, siç thotë vetë autori në fjalën hyrëse, analizat, studimet dhe debatet për çështjen e Kosovës në hapësirën publike të Francës në nivele të ndryshme të opinionit publik, duke filluar nga revistat shkencore, mediet, qarqet shtetërore politike, Parlamenti dhe Senati, e njëherazi edhe shoqëria civile franceze (Fq.11). Ndonëse periudha e studimit kap ngjarjet midis viteve 1991-2001, ai vende-vende bën analiza të ngjarjeve dhe proceseve historike edhe para kësaj periudhe, ngjarjeve dhe proceseve të cilat paraqesin kontekstin e zhvillimeve të mëvonshme.

Siç dihet, dhjetëvjeçari i fokusuar në libër është i stërmbushur me ngjarje të bujshme, shumë prej të cilave meritojnë studime të veçanta. Autori në mënyrë mjeshtërore i ndërlidh ngjarjet e periudhës së shqyrtuar me ngjarjet e periudhave paraprake, ashtu siç në fakt është edhe vetë historia, ashtu siç është edhe vetë logjika e kauzaliteteve dhe transformimeve shoqërore. Kësisoj, autori bën mirë që merr në shqyrtim fillimet e viteve '80, si kohë kthese, kur filluan të lëkundën themelet e Jugosllavisë. Është vështirë dhe thuaja se e pamundur të kuptohen ngjarjet e viteve '90 pa i kuptuar ato të viteve '80. Ka pasur shumë debate atëherë për shpërbërjen e Jugosllavisë, edhe brenda ish-hapësirës jugosllave, por edhe jashtë saj. Ka pasur edhe pikëpamje të ndryshme, si brenda asaj hapësire, ashtu edhe jashtë saj. Shumica e tyre si pikënisje të shpërbërjes e marrin fundin e viteve '80, por autori duke njohur çështjen edhe nga përvoja e vetë jetësore, debatin mbi shpërbërjen e nis me fillimin e viteve '80, pra me kualifikimin nga ana e regjimit jugosllav, si kundërrevolucion të lëvizjes studentore në Kosovë dhe kërkesës “Kosova Republikë”. Kjo lëvizje dhe kjo kërkesë,

cek autori, “u sulmua ashpër dhe u diabolizua si obskurantiste dhe destruktive”. Shkrimtarët dhe akademikët serbë, sikurse politikanët e tyre, këtë e trajtonin si një tradhti, si një komplot ndaj Serbisë dhe popullit serb, për çka do të duhej të bëheshin ndryshime; e ndryshimet i bënë në atë mënyrë që e krijuan klimën e mosbesimit, të “tradhtisë”, të “rrezikimit të qenies kombëtare serbe”, siç thoshin ata mu në “zemrën” ose në “djepin” e Serbisë, pra në Kosovë. Për ata shqiptarët ishin “Tjetri” në mesin e tyre dhe “Tjetri” është fajtori për çdo gjë, prandaj edhe meriton çdo ndëshkim, madje të mos i lejohet as për t’u larë në pishinën publike, as të mos i blihet buka në furrë, as të mos lejohet shkollimi në gjuhën amtare, as informimi, as shërimi në klinikat publike, as sigurimi shëndetësor për fëmijët, e rrjedhimisht pra, përmes masave ligjore diskriminuese të vijë deri te pengimi i natalitetit. Nataliteti dhe shtimi demografik i shqiptarëve, në diskursin publik serb atëherë, përshkruhej me fraza tepër banale. Këto dhe plot forma të tjera paragjykimi dhe diskriminimi hapën rrugën drejt aparteidit. Për konceptin e “Tjetrit” në kontekstin e raportit me Serbinë dhe Kosovën, autori ka një libër *“Effacer l’autre”* (Të hiqet tjetri!) dhe i kushtohet kryesisht fshehjes së krimeve, pra fshehjes së planifikuar dhe organizuar mirë të krimeve të bëra nga forcat serbe.

Duke e përshkruar klimën e krijuar në ish-Jugosllavi dhe duke shpjeguar rolin e shkrimtarëve dhe akademikëve serbë, si edhe të Kishës Ortodokse Serbe në krijimin e saj, në hartimin e programeve nacionale të cilat i paraprinë aparteidit të viteve ’90, Kullashi tregon se këto kanë zënë fill qysh në fillim të viteve ’80. Pra fillimisht që diferencimi ideopolitik, përndjekja dhe përjashtimi nga puna i profesorëve universitarë dhe intelektualëve shqiptarë, përjashtimin e mjekëve nga klinikat, pastaj pastrimi etnik të krejt institucioneve, përjashtimet masive nga puna të punëtorëve shqiptarë, e në fund edhe pastrimi etnik i krejt vendit, ku vetëm në periudhën mes marsit dhe qershorit të vitit 1999, rreth një milion shqiptarë u dëbuan dhunshëm nga Kosova. Kështu, Kullashi ofron një të vërtetë të panjohur mirë për publikun francez, të vërtetën historike e cila shtrihet në një trajektore kohore prej dy-tri dekadash, e jo prej dy-tre vjetësh, siç tentohej të paraqitej atje.

Duke qenë se fjala është për një dekadë të mbushur me ngjarje historike, jo vetëm në Kosovë, por edhe në viset e tjera të ish-Jugosllavisë, sidomos në Kroaci, Slloveni, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi dhe duke qenë se këto ngjarje janë të ndërlidhura mes veti, sepse bëhet fjalë për dezintegrimin e një bashkësie shtetërore, atëherë edhe

libri është një përmbledhje e shumë ngjarjeve, debateve, analizave, bisedave, publikimeve që kanë të bëjnë me ato ngjarje. Prandaj në një vështrim të shkurtër nuk mund të përmbliidhen të gjithat, por këtu po i përmendim vetëm disa momente, sa për të parë qasjen që ka ndjekur autori në këtë libër. Një vëmendje të theksuar, për shembull, i kushton shqyrtimit mbi librin *“Vukovar, Sarajevo... La guerre en ex-Yougoslavie”* (Vukovari, Sarajeva ... Lufta në ish-Jugosllavi), i botuar nga Esprit, në vitin 1993, përfshihen shumë autorë francezë, por edhe nga Beogradi, Sarajeva, Zagrebi dhe Prishtina. Kullashi bën analiza të qëndrimeve për secilin, por është mjaft interesant qëndrimi i politologut Pierre Hasner i cili flet për pafuqinë e Bashkësisë Ndërkombëtare përballë terrorit ndaj popullsisë civile joserbe në Bosnjë, Kroaci. Ai ia përshkruan disa karakteristike Bashkësisë Ndërkombëtare, e ndër të parat, fakti se ajo nuk ekziston fare. Duke qenë një “koncert i fuqive që mbështetet në një përzierje të garave dhe bashkëpunimit” (Fq.61) nuk është e aftë për ta shprehur vullnetin e vet. Luftërat në ish-Jugosllavi kanë nxitur shumë debate, përfshirë edhe nevojën e transformimit të vetë OKB-së. Në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe shqyrtimi mbi kumtesën e Pascal Bruckner me titull mjaft intrigues “Evropa e sëmurë nga vetvetja”. Sëmundjen e Evropës Bruckner-i e shpjegon me faktin se ka një hapësirë të përbashkët kulturore, por nuk ka ekzistencë të përbashkët politike, ka kontraverza të mbrendshme, të cilat janë shpërfaqur veçanërisht gjatë luftërave në Ballkan. Vetë Kullashi në këtë libër kishte marrë pjesë me punimin “Kosova dhe shpërbërja e Jugosllavisë”. Ai përveçse bën një hyrje mbi evolucionin e krizës jugosllave, një analize të mendësisë së regjimit serb, të praktikave të tij diskriminuese, bën edhe një paralajmërim ose më mirë të themi, parashikim që vërtetohet pas pesë vjetëve, pra në vitet 1998-1999 kur shpërthen lufta në Kosovë. Kullashi në punimin e vet thotë se “regjimi i Milosheviçit i cili përballet me përçarje të mbrendshme në Serbi, mund të hapë sërish një “betejë të Kosovës” për ta forcuar kohezionin e shtetit serb” (Fq.78). Më tutje shpjegon se rreziku për të vjen nga vetë logjika e atij regjimi. Ai do ta realizojë shtetin serb etnikisht të pastër, e këtë nuk mund ta bëjë kur në Kosovë, në “zembrën e serbizmit” 90% e popullsisë janë shqiptarë. Masat politike, ushtarake dhe policore nuk janë të mjaftueshme dhe asnjë masë represive nuk ka arritur ta ndryshojë atitudën e tyre, kështu që mbetet vetëm përjashtimi radikal “i tjetrit” (Fq.71). Përjashtimi radikal “i tjetrit”, pra pastrimi etnik i Kosovës, në të vërtetë, ndodhi në vitin 1999 kur mbi një milion shqiptarë u dëbuan dhunshëm nga trojet e veta. Ky punim i Kullashit

pra mund të kuptohet edhe si një paralajmërim i asaj që do të pasonte, pra i luftës në Kosovë.

Përmbledhja e punimeve me titull “Të flasësh për kampet, te mendosh gjenocidet” e botuar nga “Albin Michel” në vitin 1999, nga Konferenca e mbajtur në Sorbonë, në vitin 1977 ku kishin marrë pjesë mbi 35 profesorë nga Evropa dhe SHBA-ja, përmban edhe punimin e Kullashit me titull “Spastrimi etnik dhe gjenocidi në ish-Jugosllavi”. Në atë punim bën një shpjegim të hollësishëm të krizës jugosllave duke filluar nga viti 1981 dhe duke thënë se fillimi i fundit i Jugosllavisë do të nisë dhe do të përfundojë në Kosovë. Punimin e nis me dy citate, njëri nga Memorandumi i Vasa Çubrilloviçit, i vitit 1937, e tjetri nga një dokument i Kishës Ortodokse Serbe i vitit 1989, ku në të dytë në mënyrë shumë të qartë reflektohet qëllimi i Serbisë për debimin e shqiptarëve nga Kosova. Aty pastaj tregon mitologjinë politike serbe në lidhje me Kosovën, sidomos mizanskenat e festimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës ku zhvillohet një diskurs i urrejtjes së paparë dhe kërcënimit permanent ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ajo politikë e bazuar në urrejtje e suprimoi autonominë e Kosovës, por shqiptarët ndërtuan sistem paralel dhe nuk iu nënshtruan regjimit serb.

Vlen të ceket edhe një element tjetër që përmban libri. Nuk është i tëri vetëm analiza dhe refleksione mbi pikëpamjet dhe qëndrimet e folura ose të shkruara, por edhe vështirime, përjetime dhe impresione mbi gjendjet e krijuara, mbi ndjesinë, solidaritetin e një populli të madh dhe të lirë siç janë francezët, me një popull të vogël dhe të shtypur siç ishin shqiptarët e Kosovës në atë kohë. Autori përshkruan atmosferën dhe ndjenjën e empatisë dhe solidaritetit të popullit francez me popullin e Kosovës në ditët më tragjike të historisë së tij, në periudhën e dëbimit të dhunshëm nga vatrata e veta. Populli francez ato ditë u tregua mjaft solidar, sepse 400.000 familje u paraqitën vullnetarë për të strehuar refugjatë kosovarë. Megjithatë, shteti kishte përzgjedhur një mundësi tjetër duke iu ofruar strehim nëpër banesat shoqërore mbi 7000 refugjatëve, por gjithnjë duke ofruar mikpritjen, kujdesin dhe dashamirësinë e veçantë për ta, gjë që sipas dëshmimeve në terren, ka mbetur e pashlyer në kujtesën e kosovarëve edhe sot e kësaj dite, dhe se për atë mikpritje, ata do të jenë falënderues gjithmonë.

Mbresa dhe atmosfera impulsive përmend edhe nga tubimet dhe aktivitetet e ndryshme artistike dhe kulturore që janë mbajtur qoftë nga teatrot e ndryshëm të Parisit apo edhe të qyteteve të tjera, qoftë nga qendrat e ndryshme kulturore. Aty përmenden jo vetëm diskutimet e intelektualëve dhe shkrimtarëve, si Bernard-Henri Lévy, Ismail Kadare,

Alain Finkelkraute, André Glucksmann, Pascale Bruckner e tjerë, përfshirë edhe vetën e tij. Në këto tubime, krahas diskutimeve, artistët me shfaqjet e veta, me sublimimin artistik të tragjedisë kosovare, të tragjedisë së mëhershme boshnjake, me përqeshjen e politikanëve francezë dhe ndërkombëtarë, sidomos përqeshjen e gjuhës së drunjtë të tyre, krijonin mesazhe me efekte dhe domethënie të mëdha. Njërin prej këtyre aktiviteteve kulturore e përmend në mënyrë të veçantë, atë që është mbajtur në Les Halles, në vitin 1999, ku veç pikave muzikore dhe artistike shqiptare dhe franceze, kishte pasur edhe tryeza dhe diskutime. Ishte krijuar një atmosferë e jashtëzakonshme solidariteti me Kosovën, dhe në atë atmosferë për 12 orë rresht kishte qëndruar edhe ministri i atëhershëm i Kulturës Jack Lang.

Për fund, libri i autorit Muhamedin Kullashi *“Çështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës. Analiza dhe refleksione”* do të duhej të shërbejë si model edhe për studime të tjera me tematikë të ngjashme, por në vendet e tjera, që po ashtu kanë qenë të përfshira aktivisht në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Dihet se në shumë vende perëndimore janë mbajtur tubime politike, takime diplomatike, tryeza, konferenca shkencore, aktivitete kulturore dhe artistike, protesta e demonstrata, por nuk ka mjaftueshëm studime për to, nuk ka ndonjë përmbledhje që dokumenton autorët, shkrimet, qëndrimet, konkluzionet, si dhe efektet në opinionin publik të atij vendi në raport me Kosovën e atyre viteve ose atë të sotmen. Regjistrimi i ngjarjeve, sistemimi i fakteve, shqyrtimi i qëndrimeve, deklaratave, publikimeve, përshkrimi i aktiviteteve, qofshin ato politike, diplomatike, kulturore, artistike, apo edhe humanitare, pastaj analiza dhe reflektimi për to, janë më se të dobishme për njohjen e historisë nëpër të cilën ka kaluar Kosova në dekadat e fundit, për ruajtjen e kujtesës kolektive dhe për të kuptuarit e drejtë të rrugës nëpër të cilën kemi kaluar, cakun të cilin kemi arritur dhe vizionin të cilin e kemi para vetës. Studimet e tilla do të jenë shumë të nevojshme edhe për brezat e ardhshëm, sepse sfidat e një epoke, për fat të keq ndodh që nganjëherë mbijetojnë ose rishfaqen në forma të ndryshme edhe në epokat e tjera. Evidenca, ruajtja dhe arkivimi i kujtesës, argumentimi shkencor i bazuar në fakte, artikulimi i drejtë i qëndrimeve, thënia e fjalës së duhur në vendin dhe kohën e duhur, është detyrë, është emanacion. Libri i Kullashit është një shembull për këtë.

Krejt në fund, atë që ndoshta do të duhej thënë në fillim: përpara fjalës hyrëse, në libër qëndron dedikimi bërë *miqve francezë, të cilët gjatë shumë vjetëve punuan me përkushtim për lirinë e Kosovës*. Ky

dedikim i qëlluar është po ashtu një shembull se si duhet të jemi mirë-njohës për miqtë e Kosovës, për punën e tyre me përkushtim, për ballafaqimet e tyre me kundërshtarët që nuk duan ta shohin të vërtetën në sy, për kontributin e tyre në ndriçimin e çështjes së Kosovës, për humanizmin, lirinë, drejtësinë, demokracinë dhe shtetësinë e Kosovës. Miqtë francezë të cilëve u referohet autori kanë shënuar një epokë kthese për Kosovën, për kuptimin e drejtë të çështjes së saj në Francë.

GËZIM SELACI: *Atdhe Hetemi, Lëvizjet studentore për Republikën e Kosovës, 1968, 1981 dhe 1997* nga (London: Palgrave, 2019 dhe Prishtinë: Artini, 2020).

Libri “Lëvizjet studentore për Republikën e Kosovës, 1968, 1981 dhe 1997” bazohet në një qasje historike dhe një studim të gjerë empirik për të analizuar tri demonstratat e studentëve të Universitetit të Prishtinës në vitet ‘68, ‘81 dhe ‘97 të shekullit të kaluar. Studimi vërteton se secila nga demonstratat e studentëve kishte kërkesa pak a shumë të ndryshme dhe të dalluara: arsim të lartë në gjuhën amtare (më 1968), kushte më të mira për jetesë në universitet (më 1981) dhe autonomi akademike në universitet (më 1997), por autori argumenton se në të triat u shkri kërkesa për republikë (qoftë brenda a jashtë Federatës Jugosllave), sado që ky nuk ishte qëllimi kryesor ose fillestar i tyre (p. 42).*

Kështu, libri analizon demonstratat studentore të shekullit të kaluar si pjesë të një lëvizjeje shoqërore në Kosovë për republikën dhe shtetin e Kosovës. Teza kryesore e librit është se këto tri demonstrata studentore ishin vendimtare në zhvillimin e ngjarjeve të cilat çuan në pavarësimin e Kosovës (f.38), duke qenë se ruajtën vizionin për Republikën e Kosovës (f.40), si dhe luajtën rol në mobilizimin politik të shoqërisë kosovare dhe ngritjen e çështjes së Kosovës në nivel ndërkombëtar (f. 43). Studimi thekson dallimet në mes karaktereve dhe rrethanave të të tri lëvizjeve, por që, megjithatë, mund të shihen si një protestë e përbashkët e studentëve kundër diskriminimit të shqiptarëve dhe që mobilizuan shoqërinë në një lëvizje emancipuese në kohët kur elitat politike ishin të palëvizshme ose më të kufizuara në veprimin e tyre.

Përmes një qasjeje historike dhe një studimi të gjerë empirik që përfshin rrëfime gojore të pjesëmarrësve dhe dëshmitarëve të atyre ngjarjeve nga mbi 30 intervista origjinale dhe një numër të konsiderueshëm burimesh bibliografike, autori arrin të përqsë rrëfimet e pjesëtarëve të “grupeve ilegale” dhe të organizatorëve të lëvizjeve studentore, të përfaqësuesve politikë të të tri periudhave, të studiuesve, gazetarëve dhe intelektualëve, të veprimtarëve të shoqërisë civile, të ish-punonjësve të shërbimit shtetëror të sigurisë së Jugosllavisë me dokumente zyrtare, reportazhe mediatike dhe raporte agjencish shtetërore nga një numër materialesh arkivore nga arkiva dhe biblioteka në Prishtinë, Tiranë dhe Beograd.

Ky material i pasur empirik vihet për analizë brenda traditës teorike të sociologjisë dhe të shkencës politike që postulon se lëvizjet shoqërore dhe protesta janë motorë të ndryshimeve politike. Kështu, shpjegimi i

autorit është tipik për një analizë sociologjike dhe politologjike të lëvizjeve shoqërore, për aq sa analizon faktorët emocionalë (indinjata nga trajtimi i padrejtë i shqiptarëve në Jugosllavi); faktorët kulturorë/-identitarë (formimi i vetëdijes politike te studentët); rolin e ideve, interesave të përbashkëta (statusi i “Republikës” si çlirim dhe mundësi për vetëvendosje dhe, rrjedhimisht, zhvillim e përparim të mbarë shoqërisë kosovare); mobilizimin e resurseve (studentëve të tjerë dhe shoqërisë së gjerë); rolin e institucionit (Universitetin e Prishtinës) në tërë këto dinamika; si edhe shansin ose faktorin nxitës (katalizatorin) (pakënaqësia e studentëve me kushtet jetësore në konvikt dhe mensë).

Në këtë studim, autori arrin të bashkojë hulumtimin origjinal empirik me analizën dhe interpretimin teorik, në një sintezë të pashoqe në hulumtimet e deritanishme mbi temën e demonstratave të studentëve dhe lëvizjet shoqërore në përgjithësi në Kosovë. Me një fjalë, ky studim përbën një lëvrin të mirëpritur teorik dhe historik-empirik në një tokë të shkelur fare pak nga studiuesit e historisë politike dhe sociologjike të Kosovës.

Studimi hedh dritë mbi kushtet rrethanore në të cilat u mundësuan dhe ngjanë tri demonstratat e mëdha studentore në Kosovë dhe faktorët përcaktues dhe ndikues tek ato. Sa për ilustrim, autori argumenton se lëvizjet studentore të vitit 1981 lindën në kontekst të politikave diskriminuese të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve, por u ndikuan edhe nga Shqipëria, së paku tërthorazi, përmes bashkëpunimit që Universiteti i Prishtinës kishte me pedagogët nga Shqipëria (f.39). Gjithashtu, mbetet e hapur mundësia për ndonjë formë ndikimi të faktorëve të jashtëm, domethënë të agjenturave të shteteve të huaja, por tani për tani nuk ka prova, por vetëm pretendime për këtë mundësi. Sidoqoftë, masivizimi i demonstratës dhe shndërrimi i saj në një lëvizje të gjerë, tregon se nuk bëhej fjalë për një demonstratë të nxitur a të shkaktuar artificialisht ose të orkestruar nga jashtë, por, siç shprehet autori, për një “dukuri historike që në një çast të caktuar del nga kushtet shoqërore”. Ky çast, në demonstratat e vitit '81, ishte kur shpërtheu zemërata me kushtet e padenja për studentët, me pabarazitë e dukshme dhe pakënaqësitë ekonomike, e të ngjashme, që në teoritë e revolucionit dhe protestës, rëndom merren si shpjegime (f.41). Mirëpo, siç e dimë nga teoria, shpjegime të tilla janë faktorë të nevojshëm, por të pamjaftueshëm të shpërthimit të protestës, andaj autori thekson edhe një moment të rëndësishëm dhe vendimtar: vetëdijesimin politik të shoqërisë që e kishte mundësuar progresi i përgjithshëm politik dhe ekonomik në atë kohë në Jugosllavi dhe ishte ndihmuar, veçanërisht nga Universiteti i Prishtinës

(f.42). Pra, ka një moment të rëndësishëm politik në secilën nga këto demonstrata që meritojnë vëmendje për një analizë më të thellë të këtyre ngjarjeve.

Studimi përqendrohet në këto tri momente politike dhe secila prej tyre analizohet në tri faza, para, gjatë dhe pas ngjarjeve, si dhe në tri nivele: mikronivel, mezonivel dhe makronivel, që përbën një vrojtim të zgjuar të këtyre ngjarjeve. Analiza e secilës demonstratë në tri faza tregon kushtet rrethanore, ndikimet socio-politike të demonstratave, zhvillimin dhe ndikimin e secilës demonstratë në rrjedhat politike dhe kulturore në shoqërinë e Kosovës. Tre nivelet e analizës së secilës demonstratë ofrojnë një të kuptuar të përjetimit dhe identiteteve personale (etnike dhe ideologjike) të pjesëmarrësve (mikroniveli); të rolit ose ndikimit të universitetit, të dinamikës së ndërrimit të brezave dhe konfliktin ndërbreznor, të elitave shtetërore, intelektualëve dhe akademikëve (mezoniveli), si dhe të ndikimeve të forcave politike shtetërore në rajon (Serbia, Shqipëria), por edhe më gjerë në nivel ndërkombëtar (“Perëndimi”, “Lindja”) (f.59).

Kontribut veçanërisht i rëndësishëm i librit është se ai vë në analizë historike Universitetin e Prishtinës dhe mobilizimin e studentëve si prishës të status quos dhe koncepteve politike mbizotëruese të “Obllastit” Autonom të Kosovës e Metohisë, më 1968, të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës më 1981 dhe të Republikës “së parë” të Kosovës, më 1997 për të thurur një rrëfim koherent të tri demonstratave studentore. Këtë rrëfim e përshkon rigoroziteti shkencor, vështirimi i kompleksitetit të ngjarjeve dhe kuptimeve të tyre, qasja kritike ndaj burimeve, interpretimet e fakteve larg glorifikimeve dhe gjykimeve të ngjarjeve apo të protagonistëve të saj. Autori është i vëmendshëm ndaj kufizimit që rrëfimet e protagonistëve – sot politikanë aktivë dhe personalitete në poste publike, që pjesëmarrjen e tyre në këto demonstrata mund ta kenë përdorur si kapital politik – përbëjnë për rigorozitetin dhe objektivitetin e synuar shkencor (f. 67). Andaj, ai shkon përtej dëshmive dhe përshkrimeve të pjesëmarrësve në ngjarjet në fjalë, për të ofruar një analizë të ndërvlerësishme së “lëvizjeve studentore me proceset arsimore, politike e shoqërore” në Kosovë, Jugosllavi, Shqipëri, e më gjerë.

Si i tillë, ky studim plotëson një boshllëk në literaturën e lëvizjeve shoqërore, ku ka munguar fokusi i studiuesve në mobilizimin e studentëve dhe rolin e universitetit në lëvizjet e protestës në “shoqëritë marginale”, siç ishte shoqëria e Kosovës në Jugosllavi dhe nën push-timin serb. Në anën tjetër, lëvizjet e studentëve në Kosovë kundrohen e

analizohen brenda traditës së teorizimit të lëvizjeve shoqërore, duke i zhveshur ato nga gjykimi, idealizimi dhe romantizimi i tyre.

Analiza historike e Universitetit të Prishtinës vë në pah ndërveprimin e politikës së arsimit të lartë me vetëdijen politike në shoqëri; politikës shtetërore me politikën e protestës, andaj autori, pashmangshëm, synon të gjejë natyrën e marrëdhënieve në mes Universitetit, aktorëve shtetërorë dhe studentëve (f. 49). Në analizën e autorit, Universiteti i Prishtinës na del si një objekt që synohej të kontrollohej nga forca të mëdha politike të kohës: Jugosllavia, Kosova, Serbia dhe Shqipëria: domethënë (1) nga elitat politike jugosllave që përkrahnin platformën e federalizimit/decentralizimit, (2) nga politika e Serbisë që donte ta kthente Kosovën nën administrimin ose pushtimin e saj, (3) nga elitat “progresiste” shqiptare të Kosovës jugosllave që synonin arsimimin, aftësimin dhe emancipimin e shqiptarëve në frymën e “vëllazërim-bashkimit” titist, si dhe (4) nga politika e Tiranës që synonte zgjerimin e komunizmit stalinist edhe te shqiptarët në Jugosllavi. Në këtë mënyrë, përqendrimi i analizës në Universitetin e Prishtinës na mundëson të kuptojmë luftërat për mbizotërim të aktorëve shtetërorë, si edhe politikat identitare dhe ideologjike në Krahinën e Kosovës në Jugosllavinë federative dhe, më vonë, në Jugosllavinë e dominuar nga hegjemonia serbe.

Duke shqyrtuar rolin, ndikimin dhe ndërhyrjen e politikës në Universitetin e Prishtinës që nga themelimi i tij, ky libër çel një shteg drejt një teme që pret të hulumtohet dhe kuptimësohet: ndërveprimin e Universitetit me politikën, domethënë, rolin politik të Universitetit në shoqëri, si dhe ndërhyrjen e politikës në Universitet edhe në periudhat e mëvonshme që ky libër nuk i përfshin, domethënë pas vitit 1999.

Për të përmbledhur, rëndësia e këtij libri qëndron në pasurimin empirik të literaturës së lëvizjeve shoqërore dhe ndërtimit të shtetit, ndërsa lëvizjet studentore të shekullit të kaluar në Kosovë i shtron për analizë brenda traditës studimore të lëvizjeve shoqërore. Veç kësaj, libri përbën një studim për Universitetin e Prishtinës, duke vënë në pah funksionin politik të themelimit të Universitetit, sfidat politike që e kanë përcjellë funksionimin e tij, rolin politik të tij dhe të studentëve si krijues të vetëdijes politike dhe ndikues në rrjedhat politike, por edhe ndërhyrjet e politikës në universitet.

* Referencat nga kllapa nga Atdhe Hetemi, *Lëvizjet studentore për Republikën e Kosovës, 1968, 1981 dhe 1997* (Prishtinë: Artini, 2020).

STUDIME SHOQËRORE

9

2023

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 22.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup